

R A P O R T

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI PLOTËSIMIN E PLANIT DHE TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 1967 DHE DETYRAT E PROJEKTPLANIT DHE TË PROJEKTBUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 1968»

11 dhjetor 1967

Shoqe dhe shokë,

Ky Plenum mbliidhet në një kohë, kur i gjithë populli ynë, si një trup i vetëm, është ngritur në këmbë dhe me ndërgjegje të lartë revolucionare po kryen vepra heroizmi me rëndësi historike në zbërthimin dhe zbatimin krijues të vendimeve të Kongresit V të Partisë dhe të mësimëve të shokut Enver Hoxha, kur vija e përgjithshme marksiste-leniniste e Partisë sonë po korr fitore të njëpasnjëshme në të gjitha drejtimet, si në zhvillimin revolucionar të vendit tonë ashtu edhe në zhvillimin e mëtejshëm të forcave revolucionare në botë dhe me rritjen e autoritetit të PPSH dhe të RPSH në arenën ndërkombëtare.

Punonjësit tanë, gra e burra, të reja e të rinj, duke përfshirë edhe fëmijët e pleqtë, kanë vënë dhe po vënë çdo ditë në jetë me frymë e optimizëm revolucionar të paparë dhe me besim të patundur në forcat e veta idetë e mëdha të Partisë dhe mësimet e shokut Enver Hoxha, duke kapërcyer me guxim e mençuri çdo pengesë e vështirësi dhe duke kthyer në realitet çdo parashikim të planeve tona. Inisiativa komuniste të mëdha e të guximshme kanë shpërthyer si një lumë i papërmbajtur në çdo fushë, ideologjike, politike, ekonomike, kulturele e shoqërore, në qytet e në fshat.

Si kurorëzim i vrullit revolucionar dhe i përpjekjeve shembullore të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste dhe të inteligjencies popullore detyrat e planit të vitit 1967 janë plotësuar e tejkaluar si asnjëherë deri sot. Kjo është garanci e sigurtë se detyra edhe më të guximshme e më revolucionare do të plotësohen në të ardhshmen.

I

MBI PËRFUNDIMET NË PLOTËSIMIN E PLANIT DHE TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 1967

Kur u aprovua plani i katërt pesëvjeçar, Partia jonë ishte e ndërgjegjshme se ky ishte një plan mobilizues, i drejtë, revolucionar dhe real. Detyrat ishin shumë më të mëdha se ato të pesëvjeçarit të tretë. Por, Partia kishte besim se masat që hartuan dhe aprovuan vetë planin do të vinin në lëvizje të gjitha forcat e tyre fizike e mendore, do të luftonin me këmbëngulje për shfrytëzimin e të gjitha mundësive dhe rezervave për ta plotësuar me nder këtë program madhështor. Jeta tregoi se ato fjalët i bënë realitet, plani i katërt pesëvjeçar, siç po e tregojnë këta dy vjetët e parë, po plotësohet më së miri.

Gjatë vjetëve 1966 dhe 1967 të marrur së bashku prodhimi i përgjithshëm industrial dhe bujqësor u plotësua në masën 102 për qind. Veç ai industrial 103 për qind dhe ai bujqësor rreth 100 për qind. Si pasojë ka pasur një përmirësim të dukshëm të mirëqenies materiale të punonjësve në qytet dhe në fshat. Në fund të vitit në vazhdim të ardhurat reale për frymë, kundrejt vitit 1965, parashikohen të jenë 105 për qind dhe ato të fshatarësisë 110 për qind. Kjo është një fitore e madhe e vijës së përgjithshme të Partisë në rrugën e ndërtimit socialist të vendit.

1. — Sipas të dhënave paraprake detyrat e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1967, për treguesit më kryesorë, parashikohen të plotësohen si vijon:

Prodhimi i përgjithshëm industrial parashikohet të plotësohet 102 për qind kundrejt planit, ose 11 për qind më shumë se në vitin 1966.

Punonjësit e industrisë kanë punuar më mirë se çdo vit tjetër për përvetësimin e plotë të aftësive prodhuese në përdorim, për ngritjen e aftësive të reja prodhuese me forcat e veta dhe për përvetësimin e aftësive të reja që ndërtohen me ndihmën e RP të Kinës. Kështu uzina e plehrave fosfatike do të arrijë që në vitin e parë të përvetësojë rreth 70 për qind të aftësisë prodhuese, fabrika e çimentos në Fushë-Krujë — 83 për qind, fabrika e fibrës në Shkodër — 92 për qind, kombinati i tekstileve «Mao Ce Dun» në Berat — 80 për qind etj. Me kujdesin e organeve të Partisë dhe të pushtetit janë arritur përfundime mjaft të mira në tërheqjen më të pushtetit të mendimit krijues të masave për inisiativa, novacione dhe mendime krijuese. Shumë linja të reja janë ngritur në Tiranë e rrethe të tjera.

Dy vjet me radhë punonjësit e bujqësisë, duke përfituar edhe nga kushtet e mira atmosferike, kanë arritur përfundime

të kënaqshme në plotësimin e planit të prodhimeve bujqësore. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor këtë vit parashikohet të plotësohet rreth 100 për qind, me një rritje prej 12 për qind kundrejt vitit të kaluar dhe 26 për qind kundrejt vitit 1965.

Sipas vlerësimeve paraprake plani i prodhimit dhe i grumbullimit të drithërave të bukës, i lule diellit, i duhanit, i panxhar sheqerit, i ullinjve, i qumshtit dhe i vezëve do të tejkalohet; plani i prodhimit dhe i grumbullimit të perimeve, i rrushit dhe i mishit mund të plotësohet 100 për qind; plani i prodhimit dhe i grumbullimit të pambukut, patates, fasules, tagjive, pemëve dhe i leshit nuk do të plotësohet.

Gjatë këtij viti, në prodhimin e grurit është arritur rendimenti mesatar 13,1 kv/ha., rendiment më i lartë deri sot në vendin tonë.

Plani i vitit 1967 për hapjen e tokave të reja deri më 1 dhjetor u plotësua gjithsejt 118 për qind nga e cila për tokat arë — 123 për qind.

Në transformimin socialist të fshatit ka qenë një fitore e shënuar përfundimi i plotë dhe brenda një kohe shumë të shkurtrë i kolektivizimit të bujqësisë në zonat malore. Tani në kooperativat bujqësore përfshihen 98 për qind e ekonomive bujqësore dhe 98,3 për qind e gjithë sipërfaqes së tokës së punuar.

Duke zbatuar me entuziazëm dhe frymë të lartë revolucionare Deklaratën e Komitetit Qendror të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH të 29 prillit 1967, punonjësit e NBSH-ve hoqën dorë vullnetarisht nga oborri dhe bagëtia personale, ndërsa fshatarësia kooperativiste pakësoi oborrin kooperativist dhe bagëtinë në masën e rekomanduar.

Kohët e fundit po përhapet gjithnjë e më shumë lëvizja për grumbullimin e viçave meshkuj nga oborret kooperativiste sipas inisiativës revolucionare të kooperativistëve të Gorishtit.

Në zbatim të orientimit që dha Plenumi i Komitetit Qendror në muajin korrik të vitit 1966, kur shqyrtoi dhe aprovoi projekt-direktivat e pesëvjeçarit të katërt, krahas planit të shtetit kolektivat punonjëse dhe kooperativat bujqësore hartuan edhe planet e tyre të brendshme. Jeta tregoi se planet e brendshme, duke përfshirë në to rezervat e zbuluara nga masat punonjëse, u bënë pikënisje për organizimin më të mirë të punës dhe në këtë mënyrë, ndihmuan për të siguruar plotësimin dhe tejkalimin e detyrave të planit të shtetit. Planet e brendshme në bujqësi luajtën një rol edhe më të madh pse u dhanë mundësi kooperativave t'u shpërndajnë anëtarëve një pjesë të prodhimeve mbi planin e shtetit.

Orientimet e Kongresit V të Partisë për të ndihmuar në mënyrë të gjithanshme kooperativat e reja malore vunë në lëvizje

të gjithë punonjësit e qytetit e të fshatit. U morën një sërë inisiativash për të ndihmuar këto kooperativa për forcimin e tyre ekonomik dhe organizativ nëpërmjet dërgimit të kuadrove me përvojë, dërgimit të vullnetarëve, marrjes në kujdestari të kooperativave më të forta ekonomikisht ose bashkimit me to, dërgimit të forcave për hapjen e tokave të reja, dhënies më shumë kredi dhe bursa për në shkolla nga shteti etj.

Detyrat e planit të vitit 1967 për lëvizjen e mallrave, për të tria llojet e transportit, parashikohen të plotësohen 103 për qind dhe 102 për qind në ton/km. Gjatë këtij viti është ndjekur më mirë plotësimi i detyrave për lëvizjen e mallrave kryesore, sidomos të mallrave të eksport-importit, dhe ka pasur një shfrytëzim më të mirë të mjeteve.

Përfundime të mira u arritën edhe në fushën e investimeve dhe të ndërtimeve. Plani i investimeve për vitin 1967 parashikohet të plotësohet rreth 100 për qind dhe plani i ndërtimeve — rreth 101 për qind. Investimet, në krahasim me vitin e kaluar, janë rritur mbi 9 për qind dhe ndërtimet — afro 12 për qind. Megjithëse plani i ndërtimeve për vitin në vazhdim ishte i ngjeshur, punonjësit e ndërtimit punuan më mirë se çdo vit tjetër dhe bënë të mundur që të dorëzohen për shfrytëzim një sërë veprash industriale, bujqësore e shoqërore-kulturale. Për t'u vënë në dukje është puna e madhe që ata bënë për ndërtimin e rreth 140 veprave ujitëse të mëdha e të vogla kryesisht në zonat malore e kodrinore, si rrjedhim aftësia ujitëse rritet mbi 13 mijë ha. kundrejt 8 mijë ha. që parashikonte plani i këtij viti.

Qarkullimi i mallrave parashikohet të plotësohet 102 për qind. Plani i shitjes së mallrave kryesore industriale dhe ushqimore në përgjithësi do të plotësohet sipas detyrave të caktuara. Gjatë këtij viti parashikohet të shiten 18 mijë ton drithëra buke nga 23 mijë ton që ishin në plan. Grumbullimi i drithërave të bukës parashikohet të plotësohet 111 për qind kundrejt planit, i patates — 90 për qind, i pambukut — 87 për qind, i fasuleve, i orizit çeltik dhe i elbit distik — 100 për qind, i panxharit të sheqerit — 116 për qind, i duhanit (vit kalendarik) — 107 për qind, i lule diellit — 103 për qind, i ullinjve — 142 për qind, i qumshtit — 105 për qind, i mishit peshë e gjallë — 93 për qind etj. Rrjeti i tregëtisë është zgjeruar dhe përmirësuar, veçanërisht në fshatrat e zonave të thella, me rreth 500 dyqane të reja, duke krijuar kështu kushte më të përshtatshme për një furnizim më të mirë të popullsisë fshatare.

Duke u mbështetur në përfundimet e deritanishme parashikohet që plani i eksportit të plotësohet në masën 107 për qind. Ky është një përfundim që tregon se tashmë kudo ka shqetësim për plotësimin dhe tejkalimin e detyrave të eksportit.

Si pasojë e plotësimit të detyrave që caktonte plani i prodhimit industrial e bujqësor dhe të qarkullimit të mallrave, buxheti i shtetit për vitin 1967 parashikohet të plotësohet në të ardhurat 101 për qind dhe në shpenzimet 100,7 për qind me një tepriçë të ardhurash mbi shpenzimet prej 110 milion lekë nga 100 milion që ishte parashikimi.

Deklarata e Komitetit Qendror të Partisë dhe e Këshillit të Ministrave e 29 prillit caktonte një sërë masash me karakter të thellë ideopolitik dhe ekonomik-financiar. Kooperativave bujqësore dhe veçanërisht atyre malore iu dha një ndihmë më e madhe nga ana e shtetit nëpërmjet kreditit me afat të gjatë e të shkurtër; kooperativat e reja u përjashtuan nga tatimi financiar dhe u hoq tatimi për oborret kooperativiste. Gjithashtu gjatë vitit 1967 u hoq tatimi mbi të ardhurat nga të gjithë punëtorët dhe nëpunësit me paga të ulëta dhe u bë një zbritje e çmimeve të shitjes me pakicë për disa mallra ushqimore dhe industriale. Nga të gjitha këto masa, punonjësit patën një përfitim prej 90 milion lekësh.

Përparime janë shënuar gjithashtu në zhvillimin e arsimit, të kulturës e të shëndetësisë. Me gjithë vështirësitë që janë hasur në plotësimin e planit, numri i nxënësve dhe i studentëve në krahasim me të kaluarën ka shënuar një rritje të mëtejshme.

Këtë vit mbaruan shkollat e larta 1 200 studentë baras me 104 për qind kundrejt planit dhe 106 për qind kundrejt vitit të kaluar.

Si përfundim i punës së madhe të kryer nga punonjësit për plotësimin dhe tejkalimin e detyrave, i plotësimit të prodhimit industrial dhe në veçanti të atij bujqësor si edhe i masave të veçanta të marrura nga Komiteti Qendror dhe Këshilli i Ministrave në dobi të punonjësve në përgjithësi dhe të atyre të zonave malore në veçanti, gjatë këtij viti ka pasur një përmirësim të ndieshëm të mirëqenies materiale të punonjësve.

Vënia në jetë e masave të marrura në dobi të punonjësve kërkonte edhe burimet e nevojshme financiare. Kjo u arrit me përpjekjet e kolektivave punonjëse, të cilat, nën drejtimin e organizatave të Partisë, duke zbatuar drejt porositë e mbledhjes së Këshillit të Ministrave të 20 korrikut¹, bënë një punë të mirë dhe gjetën mundësi për rritjen e detyrave të planit të prodhimit dhe të uljes së mëtejshme të kostos për vitin 1967 në rreth 100 milion

¹ Kjo mbledhje e Këshillit të Ministrave diskutoi dhe aprovoi raportin e paraqitur nga Komisioni i Planit të Shtetit «Mbi plotësimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 1967».

lekë, duke rritur në këtë mënyrë edhe fitimin e ndërmarrjeve dhe të organizatave ekonomike. Veç kësaj edhe të ardhurat e parashikuara në buxhet nga kooperativat bujqësore, si pasojë e punës së mirë të tyre dhe e vitit të mbarë bujqësor, do të tejkalohen në rreth 10 milion lekë.

Në këtë mënyrë buxheti i shtetit financoi rregullisht të gjitha nevojat e parashikuara në plan për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës, përballoi masat që u morën në dobi të kooperativave bujqësore dhe të punonjësve të qytetit dhe njëkohësisht siguroi mjetet e burimet e nevojshme monetare për rritjen e rezervave të sigurimit të ndërmarrjeve dhe të organizatave ekonomike në rreth 70 milion lekë.

2. — Natyrisht në punën tonë kemi pasur edhe mjaft të meta e dobësi dhe në është dashur të kapërcejmë shumë vështirësi e pengesa. Shqyrtimi i thellë e me sy kritik i të metave dhe i dobësive në punë nga organet e Partisë dhe të shtetit dhe marrja e masave për mënjanimin e tyre është kusht i domosdoshëm për arritjen e fitoreve të reja edhe më të mëdha në të ardhshmen.

Vëmë në dukje se plani i prodhimit industrial, megjithëse si nëntëmujor është plotësuar 102 për qind, në ritmikë dhe në llojet e prodhimeve ai ka të meta: ndërsa si gjashtëmujor plani u plotësua 103 për qind, në tremujorin e tretë pati rënie, u plotësua 101 për qind. Në qoftë se dy degë të Ministrisë së Industri-Minierave nuk e plotësuan planin si gjashtëmujor në tremujorin e tretë nuk e plotësuan planin 9 degë të saj. Këtu ka arsye objektive e subjektive. Ka raste për të cilat ka penguar mosardhja e lëndëve të para dhe e pajisjeve nga importi, por ka edhe raste kur tejkalimet e planeve nuk janë plotësuar, kryesisht, me kursimin e lëndëve të para e të materialeve të ndryshme, si rrjedhim janë përdorur rezervat e sigurimit. Në përgjithësi në lëmin e prodhimit industrial vërehet ende prirja për të mbivlerësuar prodhimin në vleftë, duke mos luftuar në shkallën e duhur për të plotësuar planin në të gjitha llojet dhe sasitë e prodhimit, për të cilat ka nevojë ekonomia. Kështu nga 66 zëra të nomenklaturës së Këshillit të Ministrave të RPSH si nëntëmujor plani u plotësua në 39 zëra, kurse në tremujorin e tretë në 36. Kjo gjendje është diçka më e rëndë për mallrat e përdorimit të gjerë të nomenklaturës së ministrive, të komiteteve ekzekutive dhe të ndërmarrjeve. Është e domosdoshme që Ministria e Industri-Minierave, organet e Partisë e të shtetit në rrethe, t'i dalin përpara kësaj gjendjeje, ta bëjnë çështje të të gjithë punonjësve dhe të marrin masa të atilla që të sigurojnë prodhimin në kohë e sipas llojeve e sasive që para-

shikon plani dhe t'u shpërndahen në afatet e caktuara përdoruesve.

Edhe në bujqësi, me gjithë përfundimet e mira të arritura në plotësimin e planit, puna për përhapjen e organizuar të përvojës së përparuar dhe për thellimin e eksperimentimit shkencor ka pasur të meta e dobësi. Mosplotësimi i prodhimit të patates, fasules dhe sidomos i pambukut kërkon që organet e bujqësisë në qendër dhe në rrethe të nxjerrin mësimë dhe të marrin masa që kjo gjë të mos përsëritet më.

Problem që duhet të na shqetësojë shumë është gjendja e blegtorisë e veçanërisht shtimi i pendeve të qeve. Ditën e regjistrimit të përgjithshëm të blegtorisë, më 15 gusht 1967, numri i qeve në të gjithë vendin ishte 88 mijë krerë kundrejt 105 mijë krerëve që duhet të jetë sipas planit, në fund të këtij viti.

Shkaku i kësaj rënieje dhe i mosplotësimit të planit të qeve duhet kërkuar, ndër të tjera, edhe në atë që komitetet e Partisë në rrethe dhe organizatat-bazë, komitetet ekzekutive dhe vetë Ministria e Bujqësisë nuk kanë treguar kujdesin e duhur për këtë problem, që ka një rëndësi të veçantë për perspektivën e zhvillimit të bujqësisë sonë.

Të meta dhe vështirësi ka pasur edhe në transport, në ndërtime, në tregëti dhe në degët e tjera të ekonomisë dhe të kulturës. Kështu në transport vazhdon të ketë akoma përdorim jo të mirë të mjeteve, si pasojë e dobësive në organizimin e punës për ngarkim-shkarkimin e mallrave e në mosshfrytëzimin në masën e duhur dhe si duhet të rimorkiove etj. nga Ministria e Komunikacionit. Ndërsa është bërë një punë e mirë nga punonjësit e Ministrisë së Ndërtimit për plotësimin në kohë të punimeve në veprat kryesore dhe të mëdha, por shpesh janë lënë pas dore punimet në veprat e vogla.

Byroja Politike ka besim se këto të meta e të tjera si këto që janë vënë re gjatë këtij viti do të kuptohen drejt dhe se, me një punë më të mirë e më të organizuar për njohjen e thellë të tyre, do të shtohen përpjekjet për t'i luftuar ato. Janë të gjitha mundësitë që këto të meta të mënjanohen.

II

DETYRAT KRYESORE TË PROJEKTPLANIT DHE TË PROJEKTBUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 1968

Projektplanit dhe projektbuxheti i shtetit janë përpunuar në konsultim të gjerë me masat punonjëse. Shkalla e pjesëmarrjes së punonjësve në shqyrtimin e treguesve të planit e të buxhetit

është rritur në krahasim me të kaluarën. Këtë vit u punua më mirë si nga ana organizative, ashtu edhe metodologjike për hartimin e projektplaneve ekonomiko-financiare në ndërmarrjet, organizatat ekonomike dhe komitetet ekzekutive të k.p. të rrethëve. Në këtë mënyrë u bë e mundur që të gërshetohen më drejt detyrat e planit pesëvjeçar me projektplanin vjetor për vitin 1968, të nxitet interesimi i kolektivave punonjëse për të zbuluar dhe për të vënë sa më mirë në përdorim rezervat e brendshme si dhe të shkurtohet afati për hartimin e projektplaneve duke lënë më shumë kohë për zgjidhjen e problemeve të plotësimit të planit.

1. — Karakteristikat dhe veçoritë kryesore të projektplanit dhe të projektbuxhetit për vitin 1968

Projektplanit dhe projektbuxheti i shtetit për vitin 1968 që parashtrojmë në këtë plenum për shqyrtim dhe aprovim shprehin në mënyrë të përgjithshme vijën e drejtë revolucionare, marksiste-leniniste që ndjek Partia jonë në zhvillimin e vendit; ata pasqyrojnë vendosmërinë e patundur dhe ndërgjegjen e lartë revolucionare të punonjësve për të zbatuar me vazhdimësi vendimet e Kongresit V të Partisë; ata shprehin vrullin e madh dhe të pandalshëm që ka marrë zhvillimi i ekonomisë dhe i kulturës sonë popullore në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, veçanërisht gjatë këtyre dy vjetëve të parë të pesëvjeçarit të katërt.

Projektplanit dhe projektbuxheti i shtetit për vitin 1968 mbështeten, në radhë të parë, në detyrat që parashikon plani i pesëvjeçarit të katërt për këtë vit; në përfundimet mjaft të mira që janë arritur gjatë vjetëve 1966-1967; në bazën e shëndoshë materialo-teknike të ekonomisë sonë të krijuar deri sot; në kushtet konkrete të brendshme dhe të jashtme dhe në nevojat që i paraqiten ekonomisë dhe mbrojtjes së vendit; në entuziazmin, vrullin revolucionar dhe vendosmërinë e punonjësve për të ecur gjithnjë përpara duke u mbështetur gjithmonë në forcat tona dhe mbi të gjitha në vijën e drejtë e forcën e madhe drejtuese dhe organizuese të Partisë, në unitetin e çelniktë të popullit tonë rreth Partisë. Duke analizuar detyrat, ritmet dhe përpjesëtimet e caktuara në projektplan për këtë vit, dalin në pah:

Së pari, detyrat për rritjen e prodhimit dhe të treguesve të tjerë janë të ngjeshura e revolucionare, por të drejta dhe reale. Treguesit kryesorë, kundrejt planit të vitit 1967, kanë këtë rritje: prodhimi i përgjithshëm industrial e bujqësor së bashku rreth 17 për qind; veç e veç ai industrial 20,7 për qind dhe ai bujqësor

rreth 12 për qind; ndërtimet 7 për qind, të ardhurat kombëtare rreth 17 për qind; qarkullimi i mallrave me pakicë 9 për qind, eksporti 18 për qind, importi 14 për qind, rendimenti i punës në industri 6 për qind dhe në ndërtim 9 për qind. Të ardhurat e buxhetit të shtetit kundrejt plotësimit të pritshëm rriten 7,6 për qind, kurse shpenzimet — 9,8 për qind. Plotësimi i tyre kërkon një punë më të organizuar, përpjekje më të mëdha, vënien në përdorim të të gjitha forcave për të kapërcyer vështirësitë dhe për t'u dalë atyre me kohë përpara e për të zgjidhur problemet që ngre ecja e vrullshme përpara.

Së dyti, detyrat e projektplanit dhe të projektbuxhetit të shtetit për vitin 1968 janë shumë të ngjeshura në fushën e shpërndarjes të të ardhurave kombëtare, por të përbalueshme si nga pikëpamja materiale ashtu dhe financiare.

Të ardhurat kombëtare të shpërndara me gjithë kreditin sipas projektplanit të vitit 1968, në krahasim me planin e vitit 1967, do të rriten rreth 13 për qind. Në vitin 1968 pesha specifike e fondit të akumulimit në të ardhurat kombëtare të shpërndara (me gjithë kreditin) do të arrijë rreth 32,6 për qind nga 29,8 për qind që pritet të plotësohet për vitin 1967. Kjo rritje është mjaft e madhe dhe vjen për arsye të rritjes së ndieshme të rezervave materiale shtetërore të të gjitha hallkave dhe të fuqizimit e të përmirësimit të strukturës e të gjendjes së mallrave në rrjetin e tregëtisë.

Për këto arsye edhe projektbuxheti i shtetit karakterizohet nga një rritje e ndieshme e shpenzimeve për financimin e ekonomisë popullore. Në përgjithësi projektbuxheti i shtetit paraqitet shumë i shtërnguar me një tepricë të ardhurash mbi shpenzimet prej vetëm 40 milion lekë, nga rreth 110 milion që pritet të dalë për vitin 1967.

Plotësimi i këtyre detyrave kërkon të vihen në veprim të gjitha burimet njerëzore, materiale dhe financiare të vendit. Është e domosdoshme që problemi i kursimeve të bëhet çështje e vazhdueshme dhe e ndërgegjeshme e masave, të bëhet shprehje e çdo punonjësi kudo që të punojë e të veprojë ai.

Është për t'u vënë në dukje se ndërsa për zbatimin e porosive të mbledhjes së Këshillit të Ministrave të RPSH të 20 korrikut në uljen e shpenzimeve të këtij viti u tregua një vëmendje e veçantë në hartimin e projektkostove për planin e vitit 1968 nga një sërë ndërmarrjesh nuk u punua mirë, sepse disa drejtues nuk organizuan si duhet shtrimin dhe shqyrtimin e tyre në kolektivat punonjëse. Prandaj Ministria e Industri-Minierave, pasi i shqyrtoi ato, uli 52 milion lekë dhe Ministria e Ndërtimit — 10 milion lekë kundrejt projekteve të ndërmarrjeve;

për këto të dyja me propozimin e Komisionit të Planit të Shtetit e të Ministrisë së Financave u ulën dhe 27 milion lekë të tjerë.

Së treti, me detyrat e caktuara në projektplanin e vitit 1968 sigurohet përmirësimi dhe tejkalimi i detyrave të parashikuara në planin e katërt pesëvjeçar për këtë vit.

Prodhimi i përgjithshëm industrial do të jetë 9,3 për qind më i madh se detyra e caktuar në planin pesëvjeçar për këtë vit. Prodhimi i mjeteve të prodhimit do të rritet rreth 9,7 për qind dhe i sendeve të konsumit — 8,8 për qind. Në këtë mënyrë pesha specifike e prodhimit të përgjithshëm industrial në prodhimin e përgjithshëm industrial e bujqësor do të arrijë 57,5 për qind nga 55,6 për qind që parashikohet si pesëvjeçar, ndërsa pesha specifike e prodhimit të mjeteve të prodhimit, në prodhimin e përgjithshëm industrial arrin në 55,8 për qind.

Investimet do të jenë gjithsejt rreth 7 për qind më të mëdha se detyra e caktuar në planin pesëvjeçar për vitin 1968. Kjo shtesë do të bëhet kryesisht në investimet prodhuese, të cilat shtohen 8 për qind kundrejt pesëvjeçarit, duke i drejtuar ato në radhë të parë në sektorin e bujqësisë. Me këto ndryshime pesha specifike e investimeve prodhuese do të arrijë 85,8 për qind nga 83,6 për qind që është caktuar në planin pesëvjeçar.

Të ardhurat kombëtare do të shtohen 10 për qind mbi detyrën e pesëvjeçarit. Kjo shtesë do të shpërndahet rreth 90 për qind për rritjen e fondit të akumulimit dhe rreth 10 për qind për rritjen e fondit të konsumit.

Qarkullimi i mallrave do të jetë afro 4,5 për qind më i madh se detyra e caktuar në pesëvjeçar për këtë vit, ose 9 për qind më shumë se plani i vitit 1967.

Përmirësimet mbi detyrat e pesëvjeçarit do të ketë gjithashtu në uljen e kostos dhe të shpenzimeve të qarkullimit, duke siguruar një shtesë akumulimi prej rreth 60 milion lekë.

Si pasojë mirëqenia materiale e punonjësve në qytet dhe në fshat do të ketë një përmirësim të dukshëm; të ardhurat reale për frymë për punëtorët e nëpunësit do të jenë 107 për qind në krahasim me vitin 1965, nga 109-111 për qind që parashikohen për vitin 1970, dhe për fshatarësinë do të jenë 117 për qind nga 120-125 që parashikon pesëvjeçari për vitin 1970.

Në përcaktimin e këtyre detyrave janë pasur parasysh porositë e Plenumit III të Komitetit Qendror të Partisë për industrinë mekanike dhe për kursimet. Është synuar në vendosjen e një regjimi të rreptë kursimi në përdorimin e lëndëve të para, e karburanteve, e energjisë elektrike, e materialeve deficitare, në rritjen e rendimentit të punës etj. me qëllim që të shfrytëzohen më mirë mundësitë dhe burimet tona.

Për këto e të tjera si këto, kërkesat kanë qenë prapë të

fryra. Me gjithë uljen e normativave të furnizimit, përsëri nevojat në shkallë kombëtare plotësohen me vështirësi të madhe dhe rezerva e qeverisë për disa mallra e lëndë të para është shumë e vogël dhe në ndonjë rast, si në lëndën e drurit, është fare e paktë.

Normativat e furnizimit të lëndës së drurit për vitin 1968 janë ulur. Në këtë mënyrë jo vetëm që nuk u morën parasysh kërkesat e fryra, por u bë edhe një ulje e mëtejshme kundrejt vitit 1967 nga 7 për qind deri në 15 për qind sipas llojeve të punimeve. Në lëndën e drurit, me gjithë përpjekjet e bëra për kursim, përsëri mbetet mjaft për të bërë, duke filluar që nga prerja, përpunimi dhe deri në përdorimin e saj në industri, ndërtime etj.

Në hartimin e projektplanit që shqyrtojmë, me gjithë përpjekjet për t'iu përmbajtur pesëvjeçarit, prapëseprapë u detyruam të parashikojmë 3,5 për qind prerje të lëndës së drurit më shumë nga pesëvjeçari. Prandaj shtrohet me forcë të veçantë që me sasi të planifikuara jo vetëm të plotësohen detyrat e planit, por me kursim të mëtejshëm të shtohet rezerva e sigurimit pranë përdoruesve, me qëllim që të krijohen kushte më të mira si për vitin 1968 ashtu edhe për vitin 1969.

Me qëllim që të njihet më mirë gjendja reale e pyjeve dhe aftësia e tyre në lëndë druri, Ministria e Bujqësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Industri-Minierave dhe komitetet ekzekutive të rretheve, brenda vitit 1968 të bëjë kadastrimin shkencor dhe vlerësimin e plotë të aftësisë prodhuese të krejt pyjeve të vendit.

E pakënaqshme është gjendja edhe me energjinë elektrike. Parashikimet e pesëvjeçarit tejkalohen 67 milion kilovat-orë. Kjo shtesë e energjisë do të përballohet kryesisht nga termocentralet, pra me shpenzim më të madh naftë, karburantesh dhe qymyrguri. Në këto kushte ka rëndësi të veçantë kursimi me plan i energjisë elektrike, në mënyrë që jo vetëm të mos lejohet shpenzimi i saj mbi planin, por përkundrazi të kursehen sasi të planifikuara dhe t'i vihet fre shpërdorimit të energjisë elektrike që bëhet kudo.

Duke vënë theksin mbi këta dy zëra, kjo nuk do të thotë se janë vetëm këta, e tillë është gjendja edhe në karburantet, çimenton etj. Prandaj për të gjitha organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, për të gjitha kolektivat punonjëse shtrohet detyra që të shohin vazhdimisht me vëmendje më të madhe, ruajtjen dhe përdorimin me kursim të lëndëve të para, të lëndës djegëse dhe të çdo materiali.

2. — Disa nga detyrat kryesore sipas degëve të ndryshme të ekonomisë dhe të kulturës

Në vitin 1968 prodhimi i përgjithshëm industrial e tejkalon me 68 milion lekë nivelin që parashikon plani i katërt pesëvjeçar për vitin 1969. Gati në të gjitha degët e industrisë projektplanit i vitit 1968 paraqitet me rritje si kundrejt planit të vitit 1967 ashtu edhe kundrejt pesëvjeçarit.

Në vitin 1968 Ministria e Industri-Minierave do të rritë prodhimin industrial 27 për qind dhe sipas degëve: industria e naftës 22 për qind, industria e bakrit 50 për qind, industria kimike 53 për qind, industria elektrike 37 për qind, industria e material ndërtimit 35 për qind etj.

Rritja e prodhimit industrial vjen kryesisht nga përvetësimi më i mirë i aftësive prodhuese në përdorim dhe i atyre të reja, ve, duke i tejkaluar treguesit e pesëvjeçarit për këtë vit si dhe nga rritja e rendimentit të punës. Prandaj Ministria e Industri-Minierave dhe ndërmarrjet e saja vartëse duhet të marrin masa të shpejta dhe në kohë për përgatitjen e vënien në shfrytëzim sa më parë të veprave të reja industriale e minerale; për shfrytëzimin me ngarkesë më të plotë të veprave të porsavëna në shfrytëzim, në mënyrë që të vazhdojë prodhimi me rritje dhe pa ndërprerje; të forcojnë organizimin e punës e të prodhimit dhe të sigurojnë një furnizim pa ndërprerje.

Ministria e Industri-Minierave të marrë masa të veçanta për prodhimet e eksportit, si p.sh. për kromin që të ngrëjë sa më shumë me anë të seleksionimit përmbajtjen në Cr_2O_3 , për industrinë ushqimore, që prodhimet tona të sigurojnë sa më shumë tregje, qoftë për cilësinë e tyre të lartë, qoftë për paraqitjen dhe ambalazhin, po kështu për industrinë e veshmbathjes dhe për prodhimet e artizanatit.

Masa të veçanta organizative dhe kontrolli gjithashtu duhet të marrë Ministria e Industri-Minierave për prodhimet që caktohen për nevojat e brendshme e, në radhë të parë, të mos rendet pas prodhimit në vleftë, por të sigurohet me çdo kusht prodhimi në lloje dhe cilësi sipas nomenklaturës dhe kontratave me përdoruesit, të prodhojë sa më shumë mallra të thjeshta, të forta, të bukura e të lira duke shfrytëzuar për këtë të gjitha mundësitë që krijon vazhdimisht inisiativa krijuese e punonjësve të talentuar të industrisë sonë.

Prodhimi i përgjithshëm bujqësor parashikohet të ketë një rritje prej rreth 12 për qind ose rreth 1 për qind mbi planin e pesëvjeçarit të katërt, ndërsa kundrejt vitit 1965 rritja arrin në rreth 41 për qind. Nga prodhimi i përgjithshëm bujqësor pro-

dhimi i bimëve të arave rritet 16 për qind, i frutikulturës — 3 për qind, i blegtorisë — 8 për qind dhe i pyjeve — 5 për qind.

Gjatë vitit të ardhshëm është parashikuar që prodhimi i drithërave të bukës të rritet 11 për qind, i patateve — 46 për qind, i orizit — 21 për qind, i lule diellit — 52 për qind, i perimeve — 14 për qind, i fasuleve — 15 për qind etj.

Gjatë vitit 1968 do të hapen 25 mijë ha toka të reja, nga të cilat 20 mijë për ara. Rendimentet e bimëve të arave, kundrejt planit të vitit 1967, do të rriten: në drithërat e bukës 8 për qind, në oriz 6 për qind, në pambuk 9 për qind, në duhan 7 për qind, në lule dielli 16 për qind etj.

Plotësimi i planit të prodhimit bujqësor përbën kushtin më të rëndësishëm për plotësimin e planit të ekonomisë popullore në tërësi. Për ne janë të qarta vështirësitë që i krijohen ekonomisë sonë nga mosplotësimi i planit të prodhimeve bujqësore dhe të mirat që i vijnë asaj nga plotësimi e tejkalimi i detyrave në bujqësi. Prandaj detyra më e rëndësishme ku duhet përqëndruar vëmendja e të gjitha organeve të Partisë, të shtetit e të ekonomisë dhe veçanërisht e atyre të bujqësisë, në qendër dhe në bazë, është plotësimi dhe tejkalimi me çdo kusht i planit të prodhimit bujqësor në të gjithë treguesit e veçanërisht në drithërat e bukës dhe pataten. Për këtë duhet të përgatitemi dhe të marrim të gjitha masat politike, organizative e teknike që të përballojmë një vit bujqësor jo të mirë, ose me shira e përmbytje ose me thatësi. Prandaj, duke filluar që nga mbjellja e grurit e për të gjitha bimët e tjera me radhë, të kryhen siç duhet punimet e kullimit, të mbjelljes me kohë e të ujitjes si dhe të merren të gjitha masat e tjera agroteknike në mënyrë që ato t'u përgjigjen plotësisht kushteve që mund të paraqiten.

Thatësira e madhe e kësaj vjeshte ka dëmtuar dhe mund të dëmtojë një pjesë të të mbjellave, mund të dëmtojë prodhimin e ullinjve dhe bazën kullosore të bagëtisë. Prandaj të merren masa që pasojat e kësaj thatësie të jenë sa më të vogla. Në të njëjtën kohë të përgatitemi sa më mirë për pranverën e ardhshme.

Të nxjerrim mësim nga përvoja e këtij viti kur mbjelljet e pranverës, për shkak të shirave të prillit, u kryen me vonesë dhe si rrjedhim prodhimi i pambukut nuk plotësohet veçse 87 për qind. Edhe prodhimi i misrit, po të mos kishte bërë kohë e mirë në tetor e në nëntor, do të dëmtohej, siç na është dëmtuar çdo vit. Prandaj është e domosdoshme që Ministria e Bujqësisë, komitetet ekzekutive të rretheve dhe punonjësit e bujqësisë të marrin të gjitha masat që mbjelljet e pranverës të kryhen sa më herët.

Për të përballuar nevojat e ekonomisë për lëvizjen e mallrave është parashikuar që transporti i mallrave të rritet gjithsejt 8 për qind më shumë në ton kilometra se në vitin 1967. Plotë-

simi i kësaj detyre kërkon që ndërmarrjet e Ministrisë së Komunikacionit dhe ndërmarrjet e Ministrisë së Industri-Minierave dhe të dikastereve të tjera të forcojnë bashkëpunimin për një shfrytëzim më të plotë të mjeteve të transportit, për të mënjanuar vonesat në ngarkim-shkarkim, dhe për të siguruar në kohë dhe në sasi mallrat që do të transportohen. Për ndërmarrjet e Ministrisë së Komunikacionit dhe të gjitha dikastereve të tjera problemi i përdorimit të rimorkiove duhet të bëhet një çështje e madhe e të gjithë punonjësve, duke ua bërë të njohur leverdinë e madhe ekonomike që ka përdorimi i tyre. Ministria e Komunikacionit dhe organet e Partisë e të pushtetit në rrethe duhet të tregojnë një vëmendje më të madhe për plotësimin e planeve që kanë lidhje me fshatin.

Projektplani i vitit 1968 parashikon që vëllimi i investimeve të jetë 95 për qind kundrejt planit të vitit 1967 ose 7 për qind më tepër se pesëvjeçari. Ndërsa vëllimi i ndërtimeve kundrejt planit të vitit 1967, është parashikuar të rritet gjithsejt 7 për qind, ai që do të kryhet nga Ministria e Ndërtimit të rritet 11 për qind. Megjithatë vëllimi i përgjithshëm i investimeve është më i ulët nga viti 1967, investimet për bujqësinë janë parashikuar me një rritje prej rreth 22 për qind. Pjesa më e madhe e vëllimit të ndërtimeve të vitit të ardhshëm është parashikuar për vepra ujitëse dhe të bonifikimit, për veprat që ndërtohen me ndihmën e RP të Kinës, për hekurudhën Rrogozhinë-Fier etj. Gjatë vitit të ardhshëm për veprat ujitëse dhe të bonifikimit parashikohet të kryhet një vëllim ndërtimesh prej 42 për qind më shumë se në vitin 1967 dhe do të vihen nën ujë gjithsejt 11 mijë ha. tokë.

Vepra më e madhe në ndërtimet e këtij pesëvjeçari është hidrocentrali i Vaut të Dejës. Punimet në këtë vepër kanë filluar dhe si fillim kanë shkuar në mënyrë të kënaqshme. Por madhësia dhe vështirësia e tyre janë të tilla që kërkojnë organizim, mekanizim dhe drejtim shumë më të përsosur se në çdo vepër tjetër të ndërtuar deri sot. Viti 1968 është vendimtar për të kryer punimet e domosdoshme në këtë vepër dhe për t'u vënë ajo në shfrytëzim të plotë në fund të vitit 1971.

Për këtë është e domosdoshme që Ministria e Ndërtimit, Ministria e Tregëtisë, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit të Shkodrës, dhe Ministria e Industri-Minierave të bashkëpunojnë në vazhdimësi dhe të marrin të gjitha masat organizative dhe teknike, të sigurimit të projekteve, të pajisjeve, të materialeve dhe të fuqisë punëtore të kualifikuar e të thjeshtë, në mënyrë që të sigurohet çdo gjë që duhet në kohën e duhur.

Ministria e Ndërtimit, krahas detyrave të mëdha për hidrocentralin e Vaut të Dejës, për hekurudhën Rrogozhinë-Fier e për rrugën e Malësisë së Madhe, të përqëndrojë edhe më shumë vë-

mendjen në veprat e bonifikimit e të ujitjes sidomos në zonat kodrinore e malore. Komitetet ekzekutive të rretheve të njohin nga afër dhe në vazhdimësi gjendjen e punimeve në veprat ujore të bujqësisë, duke plotësuar më mirë nevojat në fuqi punëtore dhe duke bërë që fshatarësia ta ketë vazhdimisht në qendër të vëmendjes mbarëvajtjen e këtyre punimeve.

Ministria e Ndërtimit, Drejtorja e Ekonomisë Komunale dhe komitetet ekzekutive të rretheve të bashkëpunojnë sa më ngushtë për zbatimin e porosisë së Kongresit V të Partisë që me të njëjtat fonde të ndërtojmë më shumë banesa dhe të strehojmë më shumë familje. Të vihen në jetë në të gjitha qytetet tipat e rinj të banesave të projektuara sipas studimit të përbashkët të bërë ndër-mjet Institutit të Projektimit dhe disa komiteteve ekzekutive për të strehuar me të njëjtat fonde 10 deri 25 për qind më shumë familje.

Në këtë plenum do të shqyrtojmë dhe do të aprovojmë vendimin «Mbi elektrifikimin e krejt fshatrave të vendit deri më 8 Nëntor 1971». Ky do të jetë një aksion me rëndësi politike shumë të madhe dhe një nga shtatë më të bukura për gjithë popullin tonë. Populli ynë do të hidhet i tëri në veprim si një trup i vetëm për ta vënë atë në jetë edhe para afatit, por ne duhet t'i përgjigjemi me organizim e me bazën materialo-teknike. Prandaj Ministria e Ndërtimit, Ministria e Industri-Minierave, Ministria e Tregëtisë dhe Drejtorja e Ekonomisë Komunale të marrin menjëherë të gjitha masat për organizimin e punës së projektimit e të ndërtimit, për sigurimin e materialeve e të pajisjeve që do të prodhohen në vend, për sigurimin e materialeve e të pajisjeve që do të vijnë nga jashtë dhe për organizimin më të mirë të zbatimit të punimeve. Ashtu siç duhet të punojnë organet qendrore, po kështu, edhe diçka më shumë, duhet të punojnë edhe komitetet ekzekutive të rretheve, në mënyrë që kjo ndërmarrje me rëndësi historike të mbarojë më së miri për nder të 30-vjetorit të themelimit të Partisë sonë.

Që të përballohet si duhet vëllimi i madh i ndërtimeve, organizatat e kantieret e ndërtimit duhet të forcojnë e të organizojnë më mirë punën e tyre dhe të rritin shkallën e mekanizimit të punimeve. Projektuesit duhet ta kuptojnë më gjerë e më thellë domosdoshmërinë e projektimit me kursim dhe me frymë revolucionare, pa prekur qëndrueshmërinë e veprave. Ministria e Ndërtimit dhe organizatat-bazë të Partisë të këmbëngulin më shumë për të mënjanuar prirjen që kanë ndërmarrjet e ndërtimit për të filluar shumë vepra në një kohë dhe të zbatohet porosia që të plotësojnë planin për çdo vepër sipas afateve të parashikuara. Nga ana tjetër, ndërmarrjet e ndërtimit të porositen që të mos marrin përsipër ndërtimin e veprave jashtë planit pa si-

guruar më parë, nga ata që u ngarkojnë, ndërtimin e këtyre veprave, projektet, bazën materiale dhe fuqinë punëtore përkatëse.

Mbi bazën e detyrave që parashikohen për rritjen e prodhimit industrial dhe bujqësor, në këtë projektplan është parashikuar të përmirësohet më tej furnizimi i popullit me mallra të përdorimit të gjerë dhe me treguesit e tjerë të mirëqenies materiale e kulturele të punonjësve. Të ardhurat kombëtare do të rriten rreth 17 për qind. Nga të ardhurat kombëtare pjesa për konsum rritet gjithsej 8 për qind dhe pjesa për akumulim — rreth 27 për qind. Qarkullimi i mallrave të tregëtisë parashikohet të rritet 9 për qind më shumë se në vitin 1967. Kjo do të thotë që në vitin 1968 nga Ministria e Tregëtisë do të arrihet niveli i qarkullimit të mallrave të vitit 1969. Përmirësime do të ketë në furnizimin e të gjitha mallrave kryesore ushqimore dhe industriale.

Detyra të mëdha parashikohen gjithashtu në zhvillimin e mëtejshëm të arsimit e të shëndetësisë, të përgatitjes së kuadrove, të shërbimeve të artizanatit, të komunales etj.

Në arsim, për të përballuar rritjen e numrit të nxënësve të rinj në shkollat e mesme profesionale e në shkollat e larta dhe në mënyrë të veçantë për të tërhequr më shumë vajza nga zonat e thella malore në konviktet e shkollave 8-vjeçare dhe të gjimnazëve, është parashikuar që numri i bursave të jetë 4700 nga 3800 që ishte këtë vit shkollor.

Për përgatitjen dhe kualifikimin e punëtorëve, në shkollat e ulëta profesionale dhe në kurset me ndërprerje nga puna është parashikuar të ketë një rritje të madhe kundrejt pesëvjeçarit. Numri i punëtorëve të rinj do të rritet rreth 6 mijë vetë më shumë kundrejt pesëvjeçarit dhe numri i punëtorëve të kualifikuar rreth 29 mijë vetë më shumë. Kjo rritje do të bëhet kryesisht në industri e bujqësi.

Si rrjedhim i zhvillimit të prodhimit industrial dhe bujqësor është bërë e mundur që vëllimi i eksportit të rritet 18 për qind më shumë nga plani i vitit 1967 dhe 7 për qind kundrejt pesëvjeçarit. Për të përballuar më së miri detyrat në lëmin e eksportit, ministritë prodhuese dhe organet e tregëtisë së jashtme, t'i kushtojnë një vëmendje më të madhe përmirësimit të cilësisë dhe të ambalazhimit.

Në shqyrtimin që i bëri projektplanit dhe projektbuxhetit Byroja Politike e KQ të PPSH u dhanë mendime dhe u bënë propozime për përmirësimin e treguesve të planit. U ngarkua Kryesia e Këshillit të Ministrave të RPSH që të shqyrtonte mundësitë për të përfshirë një pjesë të tyre në plan dhe pjesën tjetër ta ketë parasysh për ta parë gjatë zbatimit të planit.

Kryesia e Këshillit të Ministrave i shqyrtoi me vëmendje të veçantë këto porosi dhe arriti në përfundim se këto shtesa mbi

projektplanin mund të bëhen tani që ai u është shpërndarë anëtarëve të Plenumit të KQ të PPSH. Në prodhimin industrial të bëhen 49 milion lekë shtesë, në prodhimin bujqësor — 40 milion lekë, në grumbullimet (fshat e sektor shtetëror) — 3,5 milion lekë, nga i cili grumbullimi i drithërave nga fshatarësia të rritet 2 mijë ton, në investimet — 25 milion lekë (kjo bëhet për shtesën në elektrifikimin e fshatit), në banesat — 12,7 milion lekë, në import — 23,2 milion lekë valutë, në fondin e pagave — 7 milion lekë, për shtesën e numrit të punonjësve dhe në gjendjen e mallrave (mbi xhiron e planifikuar) në rrjetin e tregëtisë — 68 milion lekë mallra. . . Fondi i mallrave, që do të shtohet mbi gjendjen në rrjetin e tregëtisë në fund të vitit në vazhdim dhe mbi xhiron e planifikuar për vitin 1968 arrin gjithsejt në 338 milion lekë. Me këto mallra dhe me përmirësimin e strukturës së tyre u bëhet ballë edhe zgjerimit të rrjetit të tregëtisë në fshat edhe fuqisë blerëse që do të krijojë fshatarësia nga tejkalmi i planit të shtetit, nëpërmjet plotësimit të planit të brendshëm.

Me këto shtesa dhe me disa ndryshime të tjera parashikimet e buxhetit kanë një farë përmirësimi.

Në këtë projekt, një pjesë të planeve të brendshme të ndërmarrjeve me ndërgjegje i kemi kthyer në plan shteti. Dhe kjo është bërë si nga baza ashtu dhe nga organet qendrore. Mjaft kolektiva punonjëse dhe drejtues të pushtetit në rrethe propozuan përmirësimin e treguesve të planit të këtij viti mbi detyrat e pesëvjeçarit. Kurse në përcaktimin e detyrave për bujqësinë në projektplan, me përjashtim të 10 mijë ha. tokave të reja të hapura në vjetët 1966-1967, në plan nuk janë llogaritur tejkalmimet e rendimenteve të arritura në të dy vjetët e këtij pesëvjeçari dhe ato që do të arrihen vitin që vjen. Këto i janë lënë bazës për t'i përfshirë në planin e saj të brendshëm. Mbetet detyrë e të gjitha organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë që kur të analizohet plotësimi i planit të vitit 1967 dhe të zbërthehen e të shtrohen detyrat e planit të vitit 1968, të gjitha kolektivat punonjëse, kooperativat bujqësore dhe komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve të hartojnë plane të brendshme me detyra sa më mobilizuese, zbatim i të cilave të garantojë plotësimin qind për qind të planit që do të aprovohet në këtë plenum. Është e domosdoshme të kihet parasysh, sidomos nga kooperativat bujqësore dhe fermat, që në rastet kur ato kanë arritur që sivjet parashikimet e planeve të brendshme të vitit 1968 të bëjnë parashikime mbi këto për planin e brendshëm që do të hartojnë për vitin 1968.

III

DISA ÇËSHTJE MBI TË CILAT MENDOJMË TË PËRQËNDROHET VËMENDJA GJATË ZBATIMIT TË DETYRAVE TË PLANIT DHE TË BUXHETIT PËR VITIN 1968

Puna e madhe, vetëmohuese e krijuese e zhvilluar gjatë vitit në vazhdim nga masat punonjëse të qytetit e të fshatit u kurorezua me përfundime shumë të mira. Për të dytin vit vendi ynë plotëson më së miri planin dhe buxhetin e shtetit. Në asnjë pesëvjeçar nuk kemi pasur një fillim kaq të mbarë dhe kjo është një fitore e madhe që e ka burimin e saj në thellimin e revolucionit tonë, në rritjen e ndërgjegjes dhe të atdhedashurisë socialiste, në punën dhe entuziazmin e njerëzve tanë, në udhëheqjen e drejtë, të urtë e largpamëse të Partisë.

Janë të gjitha mundësitë që detyrat dhe shifrat që u paraqitën për projektplanin dhe projektbuxhetin e vitit 1968 të arrihen dhe të tejkalohen. Për këtë kërkohet të mbajmë të ngritur entuziazmin dhe vrullin e masave, të ngremë më lart frymën revolucionare, të thellojmë më tej vijën e masave, të vëmë kurdoherë politikën në plan të parë dhe të zhvillojmë luftën e klasave, të qëndrojmë kurdoherë dhe kudo në krye të punës, duke e organizuar e drejtuar atë në përshtatje me kërkesat e kohës dhe me vrullin e pandalshëm e krijuese të punonjësve.

Ne po i futemi vitit 1968, vitit të tretë të pesëvjeçarit të katërt, me një bazë materialo-teknike më të fuqishme, me një entuziazëm më të madh se kurrë ndonjëherë, me një përvojë shumë të pasur. Është detyrë e të gjithëve që përvojën e pasur të masave që u manifestua me kaq shkëlqim në organizimin e punës të prodhimit dhe të drejtimit të ekonomisë ta kemi gjithmonë parasysh, ta grumbullojmë, ta studjojmë, ta përgjithësojmë dhe ta çojmë atë gjithmonë përpara.

Byroja Politike e KQ të PPSH e mbështetur në përfundimet e arritura dhe në detyrat e reja që përmbajnë projektplanin dhe projektbuxheti i vitit 1968, shtron këto çështje nga më kryesoret, ku mendon të përqëndrohen përpjekjet e organizatave të Partisë, të shtetit dhe të organizatave të masave, përpjekjet e të gjithë punonjësve të qytetit e të fshatit.

1. — Të vëmë të gjitha forcat për zbatimin e orientimeve që dha Kongresi V i Partisë për zhvillimin e shpejtë të bujqësisë në përgjithësi dhe të zonave malore në veçanti

Karakteristikë e planit të vitit 1968 për zhvillimin e bujqësisë është se për herë të parë në planin unik të shtetit përfshihet e gjithë bujqësia, si sektor socialist. Kështu pushteti ynë tani mbështetet plotësisht në të gjitha degët e prodhimit ku sundojnë marrëdhëniet socialiste.

Karakteristikë tjetër e rëndësishme e planit të vitit 1968 për bujqësinë është se, për herë të parë gjatë gjithë periudhës së pasçlirimit, ky plan mbështetet në dy vjetë të mbarë. Kjo i jep një bazë më të qëndrueshme e më të sigurtë plotësimit të detyrave të mëdha që caktohen në bujqësi për vitin 1968. Tani më tepër se kurrë po vërtetohen në jetë rezervat dhe mundësitë e mëdha që kemi për rritjen e prodhimit bujqësor me ritme shumë më të shpejta se sa mendohej më parë.

Dhe së fundi detyrat e planit të vitit 1968 në bujqësi janë të mëdha, më të mëdhatë që janë shtruar deri tani. Prandaj mund të thuhet se viti 1968 është një nga vjetët më përcaktues për plotësimin e të gjitha detyrave të pesëvjeçarit në bujqësi.

Plotësimi i detyrave në bujqësi mbështetet, përveç të tjerave, edhe në forcimin e mëtejshëm të bazës materialo-teknike: plehurat organike do të rriten 7 për qind më shumë, plehurat kimike — 108 për qind, aftësia ujitëse — 8 për qind, punimi qilizme — 8 për qind, shtimi i numrit të qeve — 12 për qind, mekanizimi i punimeve bujqësore — 5 për qind etj. Mbi të gjitha plani i vitit 1968 kërkon në radhë të parë punën e gjithanshme këmbëngulëse të vetë fshatarësisë dhe ndihmën, kujdesin e vëmendjen e veçantë të organeve të Partisë e të pushtetit në qendër e në bazë.

a) Byroja Politike mendon se janë krijuar kushtet për të organizuar një lëvizje të gjerë për revolucionarizimin e mëtejshëm të prodhimit bujqësor. Ne sot kemi mundësi si asnjëherë më parë për një rritje më të shpejtë të prodhimit. Gati në të gjitha ekonomitë bujqësore ka skuadra ose brigada që kanë marrë mbi 30 kv. grurë për ha dhe 40-50 kv misër për ha. Këta tregues që më parë ishin të rrallë tani po zgjerohen. Prandaj kjo përvojë kaq e mirë në marrjen e rendimenteve të larta të shtrihet për prodhimin e drithërave të bukës të paktën në një të tretën e sipërfaqes së grurit dhe në një të katërtën e sipërfaqes së misrit. Në këtë sipërfaqe të përqëndrohet puna dhe përpjekjet kryesore dhe të merren mesatarisht jo më pak se 30 kv grurë për hektar dhe 40 kv misër për hektar, me kusht që të sigurohet rendimenti i planifikuar për pjesën tjetër. Vendimi i marrë

nga Këshilli Popullor i Rrethit të Dibrës për të vënë në jetë këtë lëvizje revolucionare s'ka dyshim se do të gjejë mbështetje në të gjitha rrethet.

Zbatimi i kësaj lëvizjeje nga të gjitha rrethet do të shënonte një fitore shumë të madhe, pse do të sigurohej buka në vend para afatit nëpërmjet kalimit të eksperimentimit shkencor nga ngastra të kufizuara në sipërfaqe të gjera. Byroja Politike e KQ të PPSH shpreh besimin se punonjësit e bujqësisë do ta përqafojnë dhe zgjidhin me nder edhe këtë orientim revolucionar me rëndësi jetike për bujqësinë dhe për gjithë ekonominë e vendit.

b) Në luftën dhe përpjekjet e Partisë dhe të gjithë punonjësve të bujqësisë për sigurimin e bukës në vend, një vëmendje më e madhe duhet t'i kushtohet rritjes së mëtejshme të prodhimit të patates. Për këtë është e domosdoshme që komitetet e Partisë, organizatat-bazë dhe gjithë komunistët të bëjnë një punë më të gjerë sqaruese politike me masat për t'u prerë rrugën disa shfaqjeve të padrejta që janë vërejtur në zhvillimin e patates, siç është në ndonjë rast, prirja për kufizimin e sipërfaqes, ngurrimet se patatja del me kosto të lartë e me humbje, përpjekjet e pamjaftueshme për sigurimin e farës së patates nga vetë ekonomitë bujqësore etj. Plotësimi i planit të prodhimit të patates dhe përdorimi i saj për bukë të shihet në radhë të parë, si veprim politik dhe të luftohet me këmbëngulje jo vetëm për zgjerimin e sipërfaqeve sipas planit e për plotësimin e tejkalimin e rendimenteve, por edhe për përdorimin e saj për bukë, në radhë të parë, nga vetë prodhuesit. Në zonat e ngrohta e fushore të synohet për të mbjellë patate sa më të hershme, jo vetëm për të rritur eksportin, por edhe për shfrytëzimin më të mirë të tokës, duke mbjellë pas vjeljes së saj misër hamullor.

c) Partia i ka kushtuar dhe i kushton vazhdimisht vëmendje të veçantë zhvillimit të blegtorisë, si një domosdoshmëri objektive, si një nga faktorët më të rëndësishëm dhe më përcaktues për zhvillimin e të gjithë bujqësisë. Shoku Enver në fjalën e tij «Mbi kooperimin dhe revolucionin tekniko-shkencor» theksoi edhe një herë domosdoshmërinë për një kooperim të harmonishëm e me baza shkencore të bujqësisë me blegtorinë. Plotësimi të këtyre detyrave i shërben edhe vendimi i Komitetit Qendror të PPSH «Mbi masat që duhen marrë për shtimin e mëtejshëm të lopëve, përmirësimin e racës së tyre dhe shtimin e qeve të punës». Tani e gjithë Partia dhe të gjithë punonjësit e bujqësisë po marrin masa dhe po punojnë për zbrëthimin e zbatimin e detyrave që dalin nga ky vendim.

Byroja Politike tërheq vëmendjen e Ministrisë së Bujqësisë, komiteteve ekzekutive të rretheve dhe e të gjithë punonjësve të bujqësisë që të shumëfishojnë përpjekjet e tyre për të sigu-

ruar një rritje të qëndrueshme të numrit të krerëve të të gjitha llojeve të bagëtisë.

Nga regjistrimi i blegtorisë i 15 gushtit 1967 del se plani i zhvillimit numerik i gjedheve dhe i lopëve do të plotësohet, por i qeve të punës jo; mund të plotësohet plani i të dhirtave, por do të ketë boshllëqe të mëdha në numrin e të leshtave, të një-thundrakëve dhe të shpendëve.

Duhet thënë se megjithëse rrethet kanë shqyrtuar përfundimet e regjistrimit të blegtorisë, dhe me të gjitha masat e marrura, ende nuk zbatohen kudo masat teknike për skartimet dhe nuk janë mënjanuar therjet pa vend, sidomos të bagëtive të imta. Në tregjet e disa qyteteve, si në Shkodër, Elbasan e Tiranë në fund të muajit tetor ende shiteshin bagëti të imta që mund të vlenin për mbarështrim. Prandaj organet shtetërore dhe organizatat e Partisë të forcojnë punën sqaruese e bindëse dhe njëkohësisht të marrin masa të veçanta teknike e organizative për të mos lejuar që skartimi të bëhet pa kriter dhe jashtë kontrollit teknik të organeve të bujqësisë. Krahas me këtë, të luftohen me rreptësinë më të madhe të gjitha shfaqjet dhe prirjet e gabuara e të dëmshme që vërehen në disa rrethe, veçanërisht të zonës fushore, ku ka mendime që, me zhvillimin e gjedhit e të lopës, duhet të pakësohen bagëtitë e imta.

Një vëmendje më të madhe dhe të vazhdueshme duhet t'i kushtojmë forcimit të bazës ushqimore. Vërehet se, me gjithë kritikën e herëpashershme që ka bërë Partia, në zbatimin e detyrave që përcaktojnë forcimin e vazhdueshëm të bazës ushqimore ka të meta të mëdha dhe këto kanë penguar zbatimin e detyrave për zhvillimin e blegtorisë.

Kështu në vitin 1966 plani i mbjelljes së bimëve për ushqimin e bagëtisë u plotësua vetëm 91 për qind dhe në pranverën e këtij viti 97 për qind. Disa rrethe, si Saranda, Puka, Tepelena e të tjera mbollën vetëm gjysmën e sipërfaqes së planifikuar.

Këtë vjeshtë, për shkak të thatësisë, kullotat në disa zona janë zhvilluar dobët, hasëllet po ashtu, kurse mbjelljet e bimëve për ushqimin e bagëtisë deri më 1 dhjetor janë plotësuar vetëm 92 për qind dhe mbjelljet e hasëlleve — 93 për qind, në një kohë kur mbjelljet në përgjithësi janë plotësuar 108 për qind. Planin e mbjelljeve të bimëve të tjera të vjeshtës është tejkalkuar 6 300 ha., kurse ai i mbjelljeve të bimëve foragjere nuk është plotësuar për 530 ha.

Partia gjithmonë ka tërhequr vëmendjen e punonjësve të bujqësisë dhe të organizatave-bazë të Partisë që të vlerësojnë drejt njësoj si bimët e tjera edhe bimët që përdoren për ushqimin e bagëtisë. Ka ardhur koha që për këtë të bëhet me të vër-

tetë një kthesë rrënjësore. Duhet të kuptohet një herë e mirë nga të gjithë, se pa zhvilluar dhe forcuar vazhdimisht bazën ushqimore të blegtorisë, nuk mund të gjejmë zbatim të plotë detyrat e mëdha që ka shtruar Kongresi V i Partisë për zhvillimin e blegtorisë në përgjithësi dhe sidomos vendimi i fundit i Komitetit Qendror të Partisë «Mbi masat që duhen marrë për shtimin e mëtejshëm të lopëve, përmirësimin e racës së tyre dhe shtimin e qëve të punës».

ç) *Të përqëndrohet më shumë vëmendja e organeve të Partisë dhe të pushtetit në zonat kodrinore e malore.*

Në zonat kodrinore e malore kemi 500 kooperativa bujqësore të reja të porsangritura, në kushte relativisht më të vështira se të tjerat. Por dhe kooperativat e tjera të këtyre zonave kanë nevojë për një ndihmë më të madhe, të gjithanshme dhe më të organizuar.

Në përgjithësi detyrat për hapjen e tokave të reja, për zhvillimin e blegtorisë e sidomos për sigurimin e qëve të punës, për rritjen e prodhimit të drithit, të patates etj. janë më të mëdha e shumë më të vështira për zonat kodrinore e malore, ato janë përcaktuese në plotësimin e planit të gjithë bujqësisë.

Transformimi i thellë revolucionar që po kryhet në zonat kodrinore e malore ka bërë që fshatarësia e këtyre zonave, të ngrihet në këmbë dhe të bëjë një punë me të vërtetë shumë të madhe dhe të paparë. Kjo është garancia më e sigurtë e plotësimin të planit të bujqësisë. Krahas punës dhe përpjekjeve të vetë fshatarësisë të zonave kodrinore e malore, të cilat luajnë rolin vendimtar, në projektplan janë parashikuar për këto zona edhe disa masa mbi detyrat e pesëvjeçarit, siç është shpërndarja e plehrave kimike, ndërtimi i veprave ujitëse, furnizimi me farëra, me vegla bujqësore, me fidana, me kafshë race etj. Gjithashtu mbi detyrat e pesëvjeçarit do të elektrifikohen më shumë fshatra të këtyre zonave e do të dërgohen më shumë nxënës e studentë me bursë në shkollat e ndryshme etj.

Është e domosdoshme që ndihma për fshatarësinë e zonave kodrinore e malore me kadro politikisht të ngritur dhe teknikisht të aftë si edhe me njerëz që të ngulen atje për një kohë të gjatë të vazhdojë edhe më tej, më e organizuar dhe më me perspektivë, ashtu siç ka porositur Kongresi V i Partisë dhe shoku Enver Hoxha. Zhvillimi i shpejtë i zonave kodrinore e malore përbën sot për ne, një nga detyrat më të mëdha, prandaj ky të jetë në qendër të vëmendjes në të gjithë veprimtarinë e Partisë e të shtetit.

Për të vënë në jetë programin perspektiv madhështor që ka shtruar Kongresi V i Partisë dhe shoku Enver Hoxha për shtimin e mëtejshëm dhe me ritme më të shpejta të sipërfaqes së tokës

së punuar e në radhë të parë në zonat kodrinore e malore, me porosi të Komitetit Qendror të PPSH dhe të Qeverisë së RPSH, Komisioni i Planit të Shtetit dhe Ministria e Bujqësisë, në bashkëpunim të ngushtë me komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve, kanë filluar studimin mbi mundësitë maksimale që ka vendi ynë për hapjen e tokave të reja, për problemet e popullimit të disa zonave në malësi, për mekanizimin e punimeve bujqësore në fushë, për shtimin e mëtejshëm të aftësisë ujitëse etj. Ky është një studim i rëndësishëm, sepse problemet që do të studjohen janë jetike për të ardhshmen e vendit tonë. Prandaj organizatat-bazë të Partisë dhe të gjitha organet e Partisë e të pushtetit në rrethe dhe në qendër, t'i kushtojnë një vëmendje të posaçme studimit të këtyre problemeve, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të qartë e të saktë të gjendjes dhe të mundësive në njerëz e në materiale të tjera që kërkohen për hartimin e një programi për zhvillimin e bujqësisë në të ardhshmen.

d) *Krahas hapjes së tokave të reja t'u kushtojmë një vëmendje më të madhe sistemimit të ngastrave të rrafshta dhe në veçanti sistemimit e mbrojtjes së tokave të pjerrëta si dhe shfrytëzimit të plotë të të gjithë sipërfaqes.*

Hapja e tokave të reja si sasi po shkon kudo mirë. Në këta dy vjetët e parë të pesëvjeçarit, 1966-1967, po sigurohet një tejkalim i hapjes së tokave të reja mbi 10 mijë ha. Janë të gjitha mundësitë që plani pesëvjeçar i hapjes së tokave të reja të plotësohet brenda katër vjetëve. Megjithëkëtë duhen vënë në dukje disa të meta që vërtetohen: evidenca statistikore dhe kadastra mbi hapjen e tokave të reja kanë mospërputhje të madhe ndërmjet tyre. Evidenca statistikore prej 1 janarit 1966 deri më 30 qershor 1967 jep 51,5 mijë ha. toka të reja të hapura, kurse kadastra jep 39,3 mijë ha. Këtë del se në dhënien e evidencës ka teprime dhe në kadastër ka ngadalësi. Prandaj Ministria e Bujqësisë, dikasteret e tjera dhe komitetet ekzekutive të rretheve të marrin masa të shpejta që të ndreqen këto të meta. Të gjithë e dimë se pjesa dërmuese e tokave të reja gjatë këtij pesëvjeçari po hapet në sipërfaqe të pjerrëta. Po duhet të theksojmë se në përgjithësi pak po punohet për ngritjen e tarracave në tokat e reja dhe në ato të hapura gjatë pesëvjeçarit të kaluar, shumë pak masa mbrojtëse e pyllëzime kryhen për tokat kodrinore e malore, për t'i mbrojtur ato nga gërryerjet dhe shpërlarja.

Është mirë të nxjerrim mësim nga e kaluara; të mos kënaqemi vetëm me hapjen e tokave të reja dhe me rendimentet e vjetëve të parë të tyre; uji vepron në to në mënyrë shkatërrimtare, ato shkatërrohen dhe varfërohen shumë shpejt, siç ka ndodhur në pesëvjeçarët e kaluar. Prandaj theksojmë edhe një herë porositë që u dhanë në Plenumin e Komitetit Qendror të Par-

tisë mbi aprovimin e projektdirektivave të Kongresit V të Partisë që të bëhet rregull i përgjithshëm që asnjë tokë e re e hapur të mos regjistrohet në kadastër dhe të mos raportohet në qoftë se nuk është filluar sistemimi në tarraca. Të kryhet sistemimi në tarraca i 50 mijë ha tokave të hapura në pesëvjeçarët e kaluar dhe të merren masa mbrojtëse me kanale, gjerdehe e pyllëzime përreth 100 mijë ha toka të tjera të hapura në pesëvjeçarin e kaluar.

Vetëm brenda vjetëve 1966-1967 janë prishur rreth 3000 ha toka ara. Kaq toka buke sa janë prishur për dy vjet, ka afërsisht rrethi i Tropojës, ose më pak se kaq kanë rrethet e Mirditës, Pukës etj. Organet e Partisë, të shtetit dhe të bujqësisë duhet t'i dalin përpara këtij problemi sa nuk është vonë. Fshatarësia është e gatshme të bëjë ç'i thotë Partia, nëse puna çalon në këtë lëmë kjo vjen për fajin tonë.

Deficiti më i vogël në inventaret dhe shpërdorimi më i vogël në ekonomi dënohet me ligj, ndërsa deficitet dhe shpërdorimet në fondin e tokës, që përbën mjetin themelor në bujqësi, nuk i nënshtrohen një kontrolli dhe gjykimi të fortë nga masat, nga populli. Prandaj, për ruajtjen e tokës nga gërryerja e shpërlarja, ose për zënien e tokave pa vend me vepra ndërtimi duhet të marrin përgjegjësi të plotë të gjitha organet, si në bazë ashtu dhe në qendër.

2. — **Forcimi i mëtejshëm i punimeve gjeologo-zbuluese për plotësimin e detyrave dhe përgatitjen e vendburimeve për shfrytëzim**

Në përputhje me detyrat e caktuara nga Kongresi V i Partisë për sektorin e gjeologjisë, gjatë dy vjetëve të parë të pesëvjeçarit është punuar mirë për gjetjen, zbulimin dhe rritjen e shtimit të rezervave të naftës dhe të mineraleve të ngurta në vendburimet e vjetra si dhe në zbulimin e vendburimeve të reja.

Si rrjedhim i punës së madhe e të palodhur të zhvilluar nga gjeologët tanë gjendja e përgjithshme e rezervave të zbuluara të naftës dhe e mineraleve të tjera të ngurta më 1 janar 1968 në krahasim me gjendjen e tyre në fillim të pesëvjeçarit jo vetëm që nuk ulet nga tejkalimi i planit të prodhimit, por përkundrazi përmirësohet: në naftë 17,2 për qind, në qymyrguri 14 për qind, në mineralin e kromit 13 për qind, në atë të bakrit 7,2 për qind, në hekur-nikel 6,8 për qind etj. Rritja e rezervave industriale të mineraleve të dobishme është shoqëruar edhe me hapjen e përgatitjen për shfrytëzim të minierave dhe vendburimeve të reja...

Këto përfundime të kënaqshme në kërkimet gjeologjike dhe në rritjen e rezervave industriale kanë rritur efektivitetin e punimeve gjeologjike-kërkuese dhe kanë siguruar baza më të shëndosha për prodhimin e planifikuar dhe në disa raste për tejkalimin e detyrave të parashikuara si pesëvjeçar.

a) *Detyrat e planit të vitit 1968 për gjeologjinë janë të mëdha.* Vëllimi i shpim-kërkimeve në naftë parashikohet të jetë afër 12 për qind më shumë kundrejt sasisë që parashikonte pesëvjeçari, kurse detyra për rritjen e rezervave është parashikuar të jetë afër 12 për qind më shumë nga sa parashikonte pesëvjeçari.

Kërkimet e naftës gjatë vitit të ardhshëm do të zhvillohen në një shkallë më të gjerë në strukturat e reja, me ndërtim gjeologjik të përshtatshëm dhe më të përgatitur... Do të vazhdojnë punimet e shpimit për konturimin dhe ngritjen në kategori të rezervave në vendburimet e vjetra. Synimi kryesor për kërkimin e vendburimeve të reja të naftës edhe në vitin 1968 do të jenë gëlqerorët, pa lënë pasdore edhe kërkimin në shtresat ranore. Kërkimet për naftë do të drejtohen sidomos për gjetjen e naftës së lehtë.

Gjithashtu, gjatë vitit 1968 do të vazhdojnë punimet për dëndësimin e kërkimit, për vlerësimin e mëtejshëm dhe vënien në shfrytëzim të vendburimit gazmbajtës të Divjakës dhe për sqarimin e zonës së gazit në strukturat e Durrësit.

Kohët e fundit Byroja Politike e KQ të PPSH mori në shqyrtim të veçantë punën e bërë në industrinë e naftës dhe përcaktoi detyra dhe orientime jo vetëm për vitin që vjen, por për një periudhë të gjatë. Ministria e Industri-Minierave, organet e Partisë dhe të pushtetit në rrethet Berat e Fier dhe drejtoritë e ndërmarrjet e naftës të zërthejnë e të vënë në jetë këto detyra dhe orientime.

b) *Në lëmin e kërkimeve dhe të zbulimeve gjeologjike të mineraleve të ngurta parashikohet të intensifikohen punimet gjeologjike në krom, bakër, pirit, qymyrguri etj.* Për këtë qëllim shpime kreluis të llogaritura në pesëvjeçar për vitin 1968 parashikohet të kryhen 12 për qind më tepër...

Në vitin 1968 punimet e kërkimit për mineralin e kromit do të përqëndrohen në zonën e Bulqizë-Martaneshit që është zona kryesore dhe në zonën e Tropojës e të Kukësit; për kërkimet e mineralit të bakrit punimet do të vazhdojnë në zonën e Mirditës, të Pukës, të Kukësit dhe të Korçës.

Me gjithë përparimet e rëndësishme, të arritura në lëmin e gjeologjisë për mineralet e ngurta, shkalla e njohjes së perspektivës është akoma prapa, në krahasim me sigurimin e rezervave industriale dhe kërkesat e zhvillimit të ekonomisë. Përfundimet

e arritura janë në përgjithësi të mira dhe nxitëse, prandaj në të ardhshmen duhet punuar më shumë edhe në këtë fushë.

Së pari, ne kemi zbuluar deri sot më tepër mineralet e ngurta që kanë pasur dalje në sipërfaqe, kurse për trupat dhe vendburimet që nuk kanë dalje në sipërfaqe është punuar më pak dhe përfundimet e arritura kanë qenë të pakta. Në të ardhshmen duhet të forcohen punimet përgjithësuere shkencore të materialeve faktike me vlerë të grumbulluar prej vjetësh, për të përcaktuar ligjshmërinë e përhapjes së mineraleve të dobishme, në mënyrë që të mund të orientohen dhe të forcohen punimet duke siguruar një efektivitet sa më të mirë.

Së dyti, të nisur nga detyrat dhe nevojat e rritjes së prodhimit punonjësit e gjeologjisë vëmendjen kryesore e kanë drejtuar në rritjen dhe zbulimin e rezervave për shfrytëzim. Një praktikë e tillë errëson perspektivën e bazën për planifikimin dhe rritjen e rezervave sidomos për vjetët e ardhshëm. Sigurimi i sa më shumë rezervave të kategorisë C₂ është një kusht i domosdoshëm, pa plotësimin e të cilit nuk ka si ecet përpara me ritme prodhimi gjithmonë në rritje, është një kusht shumë i rëndësishëm për orientimin e drejtë të punimeve gjeologo-zbuluese. Ministria e Industri-Minierave të forcojë më shumë kontrollin mbi ndërmarrjet për zbatimin e kësaj detyre.

Së treti, detyrë e dorës së parë për gjeologjinë në kohën e sotme duhet të jetë rritja e efektivitetit të studimeve gjeologjike. Për këtë është e domosdoshme të përmirësohet shumë cilësia e projektimit të punimeve nga ana teknike dhe shkencore.

c) Punonjësit e minierave të kromit në Bulqizë dhe në Batër gjatë vitit në vazhdim bënë një punë shumë të mirë; ata rishikuan mundësitë për rritjen e prodhimit të mineralit në sasi dhe në cilësi. P.sh. punonjësit e Bulqizës rritën treguesin e nxjerrjes së mineralit, të parashikuar në planin pesëvjeçar, duke filluar nga viti 1968... E njëjta gjë u bë edhe nga punonjësit e ndërmarrjes minerale të kromit në Batër. Kjo inisiativë e guximshme dhe e dobishme e punonjësve të Bulqizës mendojmë se mund të përhapet e të përqafohet, në radhë të parë nga minierat e tjera dhe nga të gjitha kolektivat punonjëse të Republikës.

Punonjësve të minierës së Bulqizës, duke marrë këtë inisiativë do t'u duhet të kapërcejnë disa vështirësi. Megjithëse rezervat e shfrytëzueshme të mineralit të kromit janë të mira, shkalla e përgatitjes së fronteve të shfrytëzimit është prapa. Nga një gjendje e tillë prodhimi i planifikuar nuk është në përpjesëtim të drejtë me sasinë e përgjithshme të rezervave të zbuluara dhe me perspektivën që paraqit ky vendburim i rëndësishëm. E njëjta gjë ndodh edhe në disa miniera të tjera. Si rregull dhe për kushtet tona është e domosdoshme që krahas shti-

mit të rezervave të mineralit të ecin edhe punimet përgatitore për nxjerrjen e tij. Prandaj është mirë të kihet parasysh kurdoherë kjo anë.

Siç dihet, plani i prodhimit të bakrit blistër këta vjetët e fundit është plotësuar dhe kjo ka ardhur si pasojë e vënies në shfrytëzim të vendburimit të Gjogjanit dhe të Uzinës së Metalurgjisë të Kukësit. Por zbulimi i dheut në minierën e Gjogjanit sa vjen dhe po krijon një gjendje shqetësuese, dhe kjo ka për të sjellë patjetër vështirësi jo vetëm në mundësitë e rritjes së prodhimit të bakrit blistër për të ardhshmen, por edhe në plotësimin e detyrave të caktuara. Kjo gjendje është krijuar nga mosplotësimi i nevojave të minierës së Gjogjanit me punëtorë të thjeshtë e të kualifikuar si dhe nga mosshfrytëzimi i mirë i mjeteve të transportit. Duke mos u kryer ritmet e zbulimit, krahas me detyrat e nxjerrjes së mineralit është krijuar një deficit në zbulim, i barabartë me punën e një viti. Është e domosdoshme që Ministria e Industri-Minierave dhe Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Rrethit Kukës të marrin të gjitha masat për të ndrequr gjendjen në një kohë sa më të shkurtër...

Punimet përgatitore në minierat e reja të qymyrgurit duhet të intensifikohen në mënyrë që të arrijmë sa më shpejt aftësinë nxjerrëse të projektuar... Jeta çdo ditë po vërteton se kërkesat për lëndët djegëse po shtohen.

Krahas mineraleve kryesore ndërtimi i veprave të rëndësishme të industrisë kimike e të material-ndërtimit dhe perspektivat e zhvillimit të ekonomisë ngrenë gjithashtu domosdoshmërinë që gjatë vitit 1968 të intensifikohen punimet për kërkimin dhe shtimin e mëtejshëm të rezervave industriale.

3. — Mbi disa çështje të bilancit të të ardhurave e të shpenzimeve të popullsisë dhe të qarkullimit monetar

Tejkalimi i planeve të prodhimit industrial e bujqësor dhe i numrit të punonjësve, si rrjedhim edhe i fondit të pagave, kanë sjellë rritjen e fuqisë blerëse të popullsisë, mbi parashikimet. Me të gjitha masat e marrura gjatë vjetëve 1966 dhe 1967, për t'i bërë ballë shtesës së fuqisë blerëse, nuk ka qenë e mundur që të thithej e gjithë shtesa mbi parashikimin e parasë në qarkullim dhe në të dy këta vjet është shënuar një shtim në qarkullimin monetar mbi sasitë e parashikuara në planin e arkës. Deri këtu nuk mund të thuhet se ka ndodhur ndonjë gjë shumë shqetësuese. Byroja Politike e KQ të PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH për këtë çështje janë shqetësuar gjithmonë dhe

natyrisht kjo duhet të na shqetësojë edhe në të ardhshmen, pse këtu nuk është vetëm ana financiare e problemit, por më tepër ajo politike, që lidhet me furnizimin më të mirë të popullit me mallra të përdorimit të gjerë.

Në vendin tonë fuqia blerëse e lekut ka ruajtur qëndrueshmërinë e vet si një monedhë e shëndoshë. Megjithatë forcimi i mëtejshëm i qarkullimit monetar ka qenë dhe mbetet gjithmonë një problem i rëndësishëm, i cili kërkon vëmendjen më të madhe të organeve të Partisë dhe në veçanti të shtetit, në qendër e në bazë. Ritmet e rritjes së qarkullimit monetar të vërtetuar këta dy vjetët e fundit dëshmojnë për një rritje të fuqisë blerëse të popullsisë, gjë që është e mirë se lidhet me shtimin e prodhimit, me zënien e njerëzve në punë dhe me rritjen e rendimentit, nga ana tjetër tregojnë se ekonomia jonë me mallrat që ka nxjerrë për përdorim të gjerë dhe me shërbimet e ndryshme që kryhen nuk ka qenë në gjendje të përballojë shtesën e fuqisë blerëse mbi parashikimet.

Duke u nisur nga ky fakt, por dhe duke pasur parasysh gjendjen e sotme të qarkullimit monetar gjatë hartimit të projektplanit të vitit 1968 u studjua me vëmendje të veçantë bilanci i të ardhurave dhe i shpenzimeve të popullsisë; u shqyrtuan të gjitha mundësitë e mbulimit të fuqisë blerëse me mallra të nevojshme dhe u caktua qarkullimi i mallrave dhe xhirot e tjera me para në dorë në një masë të barabartë me fuqinë blerëse të popullsisë; veç këtyre, siç u tha më lart, u dhanë mallra më tepër për shtimin e gjendjes në rrjetin e tregëtisë. Pra janë krijuar mundësi për forcimin e mëtejshëm të qarkullimit monetar.

Byroja Politike e KQ të PPSH e gjykon të domosdoshme të ndalet në këtë problem e të theksojmë këto çështje kryesore:

Së pari, dikasteret, ndërmarrjet tregëtare dhe ato prodhuese, krahas kujdesit për të siguruar mallrat me vëllim të madh të nomenklaturës së Këshillit të Ministrave të RPSH një vëmendje të veçantë t'u kushtojnë mallrave të nomenklaturave të tjera, d.m.th. të ministrive, të komiteteve ekzekutive të rretheve dhe të vetë ndërmarrjeve. Ndërmarrjet prodhuese të kuptojnë më thellë nevojën që ka ekonomia për sa më shumë mallra të përdorimit të gjerë. Organet tregëtare të bëjnë një luftë të përpunimit të drurit, të industrisë mekanike, ushqimore dhe me kooperativat e artizanatit, që të sigurojnë sa më shumë mallra që shpërndahen prej tyre, që prodhohen kryesisht me lëndë vendi, me mbeturina dhe me materiale që gjenden më lehtë. Ministria e Industri-Minierave dhe Ministria e Tregëtisë, bashkë me ndërmarrjet e tyre vartëse, të bashkëpunojnë më shumë për gjetjen e mundësive të reja për prodhimin e mallrave, qof-

të dhe me lëndë të parë të importuar nga jashtë, brenda kufijve të importit që i janë dhënë tregëtisë, me qëllim që të sjellin sa të jetë e mundur më pak prodhime të gatshme nga jashtë. Një veprim i tillë ka rëndësi të veçantë si ekonomike ashtu edhe politike e ideologjike.

Duke siguruar një shtim të këtyre mallrave jo vetëm do të krijohen kushte për një furnizim më të mirë të popullsisë me mallra, për të cilat ajo ka nevojë, por do të bëhet e mundur që të nxitet prodhimi i vendit dhe të thithen më lehtë dhe më shpejt lekët në qarkullim.

Së dyti, të merren masa për një shpërndarje në përpjesëtim të drejtë të mallrave midis fshatit dhe qytetit, pasi vërehen një sërë të metash dhe mungesash. Në shpërndarjen e mallrave të mbahen më mirë parasysh numri i banorëve të fshatit dhe të qytetit, fuqia blerëse sipas rretheve dhe nevojat që kanë ato për këto ose ato lloje mallrash. Ka raste jo të pakta kur në njësitë tregëtare të qyteteve ka mallra që i shërbejnë vetëm fshatit dhe anasjelltas etj. Komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve të qëndrojnë më shumë e më mirë në krye të organeve të tregëtisë, të cilat duhet të tregohen edhe më shumë të vëmendshme. Ndarja më me kujdes e mallrave midis fshatit dhe qytetit dhe jo në mënyrë mekanike, por duke e parë gjendjen në vend, sidomos në rrethet malore dhe zgjerimi i rrjetit të tregëtisë në fshat me ritme më të shpejta do t'i krijojnë fshatarit kushtet e duhura për t'i gjetur mallrat sa më afër vendit të banimit.

Organet e tregëtisë të mos harrojnë se në krahasim me tre vjet më parë gjendja e fshatit ka ndryshuar shumë. Ndërsa më përpara ishte më lehtë të thithej fuqia blerëse e fshatarësisë, sepse në blerjet e tyre një vend me rëndësi e zinte drithi, tani, që sigurimi i bukës është vënë në rrugë të mbarë dhe shitja e drithit nga shteti ka shkuar duke u ulur, thithja e fuqisë blerëse të fshatarësisë bëhet çdo vit e më e ndërlikuar. Prandaj organet e tregëtisë duhet të luftojnë për të marrë nga organet prodhuese mallra me strukturë më të gjerë që kërkohen dhe plotësojnë nevojat e fshatit.

Së treti, të vendoset një kontroll shumë i rreptë në marrjen dhe në mbajtjen e fuqisë punëtore, duke iu përmbajtur fondit të pagave të pranuar në planin e shtetit. Nevojat që mund të lindin mbi ato të parashikuara në plan të përballohen kryesisht me tejkalimin e rendimentit të punës.

Të bëhet një punë shumë e madhe ideopolitike dhe organizative nga organet e Partisë e të shtetit, sidomos nga Ministria e Financave, Banka e Shtetit dhe arkat e kursimit për kthimin në afat të kredive të dhëna kooperativave bujqësore dhe popullsisë, për rritjen e depozitave të kursimit, sidomos nga popullsia

fshatare. Organet e Partisë dhe të shtetit të bëjnë një punë politike të vazhdueshme me punonjësit, me qëllim që të mos vërtetohen në të ardhshmen raste si ai i vitit 1967, por përkundrazi të shtohen sa më shumë depozitimet e tyre në arkat e kursimit.

Të përkrahet e të përhapet inisiativa e mirë që kanë marrë kooperativistët në disa rrethe për t'i falur kooperativës këstet për dorëzimin e bagëtive ose për t'i shtyrë në një afat të gjatë.

Çështja e derdhjeve në fondet e pandara dhe kalimtare nga kooperativat bujqësore të jetë vazhdimisht në qendër e në bazë. Për këtë të punohet me durim për të bindur kooperativat, në mënyrë që puna e filluar në vitin 1967 të mos mbetet një fushatë e përkohshme. Të synohet që në fondet e pandara kooperativat bujqësore për vitin 1968 të kalojnë mesatarisht 15 për qind të të gjitha të ardhurave të tyre në të holla duke u bazuar në statutin tip, në vartësi me fuqinë ekonomike të kooperativave, brenda kufijve 10 deri 20 për qind. Po kështu të kalohet edhe në fondet kalimtare rreth 3 për qind. T'u bëhet e qartë kooperativave bujqësore që krijimi dhe shtimi i fondeve të pandara dhe kalimtare, lidhet drejtpërdrejt me nevojat e riprodhimit, me zbatimin e parimit të mbështetjes në forcat e veta, me vënien e interesit të përgjithshëm dhe perspektiv mbi interesin e ngushtë dhe të çastit.

Së katërti, në bilancin e fuqisë blerëse të popullsisë një vend me rëndësi zënë shpenzimet jotregëtare dhe në mënyrë të veçantë shpenzimet e popullsisë për shërbimet e ndryshme. Prandaj të bëhen përpjekje më të mëdha që të zgjerohen sa më shumë llojet e shërbimeve për popullin, të shtrihen ato në thellësi etj. Në bazë të të dhënave del se në disa rrethe shërbimeve për frymë të popullsisë janë në një nivel shumë të ulët... Gjithashtu kooperativat e artizanatit të punojnë më mirë dhe të përhapin më shpejt përvojën e qytetit të Tiranës në grumbullimin dhe përpunimin e mbeturinave dhe të hedhurinave, t'i përpunojnë ato duke i kthyer në mallra të përdorimit të gjerë dhe t'i shpjen kryesisht në fshat.

Së fundi, organet e planifikimit, të financës dhe të bankës në qendër dhe në rreth të ndjekin me vëmendje të veçantë dhe nga afër çështjet që kanë lidhje me fuqinë blerëse të popullsisë e me qarkullimin monetar dhe të nxjerrin mësim për përsosmërinë e hartimit të bilancit të të ardhurave e të shpenzimeve të popullsisë e të ndihmojnë organet e prodhimit e të tregëtisë vazhdimisht për prodhimin dhe shpërndarjen e mallrave në sasi e lloje, në fshat e në qytet.

Shokë,

Organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, duke u mbështetur në vendimin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi luftën kundër burokratizmit për një metodë e stil revolucionar në punë», në dokumentet e tjera revolucionarizuese të Partisë të këtyre vjetëve të fundit dhe në mësimet e shokut Enver Hoxha, kanë marrë një sërë masash, të cilat kanë ndihmuar për arritjen e përfundimeve, për të cilat folëm më sipër.

Duke analizuar përfundimet e arritura, duken edhe rezultatet e këtyre masave dhe roli i tyre në zhvillimin e vendit, në revolucionarizimin e ndërgjegjes së njerëzve, të inisiativës dhe të mendimit të tyre krijues, në vendosjen mbi baza më të shëndosha të lidhjeve në mes të aparateve shtetërore e të Partisë me masat punonjëse, të zgjidhjes më drejt dhe më shpejt të problemeve dhe në zbulimin e përdorimin më të gjerë të rezervave të brendshme.

Këtë e tregon më së miri edhe puna e bërë për hartimin e projektplanit për vitin 1968, duke filluar nga pjesëmarrja e gjerë dhe e organizuar e masave e deri në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e tyre midis organeve shtetërore në bazë e në qendër. Kjo u duk dhe në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të RPSH, e cila u karakterizua nga një frymë e shëndoshë parimore e shikimit të gjerave në prizmin e interesit të përgjithshëm. Përmirësimet janë vërejtur edhe në punën e komiteteve ekzekutive; por ato ende nuk janë zhveshur sa duhet nga lokalizmi.

Hovi revolucionar i paparë që ka shpërthyer kudo, dhënia e më shumë kompetencave dikastereve, komiteteve ekzekutive të rretheve, ndërmarrjeve dhe thjeshtimet në fushën e planifikimit, të statistikës e të kontabilitetit janë bërë mbështetje dhe pikënisje nxitëse për përmirësimin e metodës dhe të stilit revolucionar në punë. Thjeshtimet në sistemin e planifikimit e në punën e llogarisë bënë të mundur që punonjësit e planit, të financës e të llogarisë si dhe gjithë punonjësit e tjerë të aparateve shtetërore të lidhen më mirë me jetën, me prodhimin dhe kështu të mësojnë e të ndihmojnë më shumë për zhvillimin e forcave prodhuese, forcimin e regjimit të kursimit dhe mbrojtjen e pasurisë socialiste.

Ekonomia jonë zhvillohet e drejtohet në bazë të një plani të vetëm shtetëror, pra në bazë të parimit të centralizimit demokratik. Zbatimi sa më i thellë i këtij parimi kërkon nxitjen e mendimit krijues dhe drejtimin e centralizuar.

Me gjithë përparimet e arritura te disa kuadro drejtues duken aty-këtu raste të një kuptimi të ngushtë të të drejtave që u janë dhënë me kalimin e kompetencave nga lart-poshtë, siç është rasti me rendimentin e punës, fuqinë punëtore, investimet, ndërtimet etj. Është e nevojshme që krahas të drejtave të kuptohen e të zbatohen dhe detyrat që lindin nga rritja e kompetencave, sepse ekonomia jonë drejtohet e zhvillohet në bazë të një plani të vetëm shtetëror, pra ai ka nevojë të bashkërendohet me të gjitha degët dhe rrethet dhe si i tillë të zbatohet nga të gjithë.

Partia dhe shoku Enver na mësojnë se që të drejtosh është një art më vete. Por të drejtosh me metodë e stil revolucionar është edhe më shumë se art. Prandaj para organeve të Partisë e të shtetit shtrohet gjithmonë e më me forcë që të nxjerrim mësim nga ky entuziazëm e vrull i paparë i punonjësve tanë dhe nga kjo punë e krijimtari e një ndërgjegjeje shumë të lartë. Të përgjithësojmë me stil revolucionar këtë përvojë kaq të madhe për të përmirësuar metodën e drejtimit, për të nxitur e për të kanalizuar sa më shpejt e sa më mirë hovin dhe inisiativat revolucionare gjithmonë në rritje të punonjësve. Organet e Partisë dhe të shtetit, të vazhdojnë më me këmbëngulje luftën kundër burokratizmit, në radhë të parë, kundër sorollatjes në punë, kundër shfaqjeve të nënvleftësimit të mendimit dhe gjykimit të punonjësve, kundër frymës së rehatisë e stilit të vjetër në punë dhe kundër çdo shfaqjeje që nuk i përshtatet frymës revolucionare, ndërgjegjes së lartë, vendosmërisë shembullore dhe atdhedashurisë socialiste të punonjësve tanë.

Punonjësit, në fshat e në qytet, të entuziazmuar nga heroizmat që kryhen kudo në vendin tonë si shprehje e dashurisë për Partinë e për shokun Enver Hoxha, nga solidariteti i paparë për njëri-tjetrin, siç u shfaq me rastin e fatkeqësisë që goditi rrethet e Dibrës dhe të Librazhdit dhe të frymëzuar nga Fjala e shokut Enver «Mbi kooperimin dhe revolucionin tekniko-shkencor» ziejnë dhe bluajnë si kurrë ndonjëherë në mendjen e tyre si e si të dalin me më shumë mendime, propozime, racionalizime dhe inisiativa për ta çuar gjithmonë e më shumë përpara revolucionin në prodhim, në ndërtim, në arsim, kulturë e në çdo veprimtari tjetër.

Organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, me rastin e shtruarjes së detyrave të planit të vitit 1968 të nxitin, e të dëgjojnë me vëmendje më të madhe vërejtjet, mendimet dhe propozimet e punonjësve dhe t'i përfshijnë ato në planet e brendshme të ndërmarrjeve, kooperativave bujqësore dhe të çdo qendre pune.

Ne hymë në vitin 1968, viti i tretë i planit të katërt pesëvjeçar, me një përvojë më të madhe dhe shumë të pasur, më të armatosur ideologjikisht e politikisht, me një bazë materiale e teknike më të fuqishme dhe në një atmosferë entuziazmi revolucionar të papërmbajtur, që na lejon të kapërcejmë çdo pengesë e vështirësi.

Byroja Politike e KQ të PPSH u bën thirrje të gjitha organizatave të Partisë dhe organizatave të masave, organeve shtetërore dhe të ekonomisë, gjithë punonjësve të vendit tonë që të venë të gjitha forcat, aftësitë dhe dijenitë e tyre për të plotësuar me nder detyrat e planit të vitit 1968, për të krijuar në këtë mënyrë kushtet për plotësimin para afatit të planit të katërt pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të RP të Shqipërisë.

Byroja Politike ka besim të plotë se klasa punëtore heroike, fshatarësia revolucionare dhe inteligjencia popullore, si kurdoherë, do të punojnë e do të luftojnë me vendosmëri e hov revolucionar edhe më të madh për të plotësuar dhe tejkaluar detyrat e planit të vitit 1968.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

PLenumi I Komitetit Qendror të PPSH «Mbi Planin e Zhvillimit Ekonomik e Kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë Për vitin 1968»

12 dhjetor 1967

Plenumi IV i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i mbledhur në datën 11-12 dhjetor 1967, pasi dëgjoi dhe shqyrtoi raportin «Mbi plotësimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1967 dhe detyrat e projektplanit dhe të projektbuxhetit për vitin 1968», mbajtur nga anëtarë i Byrosë Politike të Komitetit Qendror, shoku Spiro Koleka,

V e n d o s i :

1. — Të aprovojë raportin si dhe orientimet kryesore të zhvillimit ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë për vitin 1968.
2. — Porositen organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë që të marrin të gjitha masat e duhura për zbatimin e shifrave të planit e të buxhetit të shtetit si dhe të detyrave që u dalin për realizimin dhe tejkalimin me sukses të tyre.

PLenumi I Komitetit Qendror të PPSH

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI ELEKTRIFIKIMIN E KREJT FSHATRAVE TË VENDIT DERI MË 8 NËNTOR 1971, ME RASTIN E 30-VJETORIT TË THEMELIMIT TË PARTISË»

12 dhjetor 1967

Partia dhe qeveria, kurdoherë, e kanë konsideruar elektrifikimin e gjithë vendit si një nga detyrat më themelore në luftën për ndërtimin e socializmit, për zhvillimin dhe përparimin e gjithë anshëm ekonomik e kultural të atdheut tonë. Ato gjithnjë janë frymëzuar nga ideja e madhe leniniste se pushteti i diktaturës së proletariatit dhe elektrifikimi i gjithë vendit janë dy kushtet kryesore për krijimin e shoqërisë komuniste.

Gjatë vjetëve të pushtetit popullor industria elektrike te ne është zhvilluar me shpejtësi. Si rrjedhim i ndërtimit të hidrocentraleve, si ai «V.I.Lenin» në Tiranë, «K. Marks» dhe «F. Engels» mbi lumin e Matit, «J.Stalin» në Bistricë dhe i ngritjes së termocentraleve, në vitin 1967 prodhimi i energjisë elektrike është 129 herë më i madh se ai i vitit 1945. Tani po punohet për ndërtimin e një hidrocentrali të ri të madh në Vaun e Dejës, mbi lumin Drin.

Komiteti Qendror i Partisë, duke zbatuar planin për elektrifikimin e gjithë vendit, një kujdes të veçantë i ka kushtuar edhe elektrifikimit të fshatrave. Me kujdesin e pushtetit popullor, deri tani janë elektrifikuar 730 fshatra, ose afro 29 për qind e numrit të përgjithshëm të fshatrave të Republikës. Sipas planit perspektiv të aprovuar në vitin 1960, elektrifikimi i plotë i të gjitha fshatrave të vendit tonë parashikohej të përfundonte në vitin 1985.

Komiteti Qendror i Partisë konsideron se, tashmë, janë krijuar kushtet konkrete materialo-teknike dhe mundësitë praktike për të shpejtuar ritmin e elektrifikimit të fshatrave.

Duke u mbështetur në vrullin revolucionar të masave tona punonjëse, në punën e tyre vetëmohuese për ndërtimin e socializmit dhe lulëzimin e atdheut, në iniciativat e tyre krijuese për

të shpejtuar ritmet e ndërtimit të socializmit, në vendosmërinë e tyre për të kapërcyer çdo pengesë dhe për të arritur çdo objektiv revolucionar, si dhe në mundësitë konkrete për shpejtimin e elektrifikimit të plotë të fshatrave të vendit tonë, Plenumi IV i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur në datën 11-12 dhjetor 1967,

Vendosi:

1. — Të merren të gjitha masat e nevojshme për të përfunduar elektrifikimin e të gjitha fshatrave të vendit tonë deri në datën 8 Nëntor 1971, në festën jubilarë të 30-vjetorit të themelimit të Partisë sonë të lavdishme, duke arritur kështu që 14 vjet para afatit të parashikuar nga plani perspektiv i elektrifikimit të fshatit, në Republikën Popullore të Shqipërisë të mos mbetet asnjë fshat pa u ndriçuar me dritë elektrike.

2. — Komiteti Qendror i Partisë u bën thirrje të zjarrtë klases punëtore, fshatarësisë punonjëse, inteligjencies popullore, u bën thirrje të gjitha organeve dhe organizatave të Partisë, gjithë komunistëve, si dhe të gjitha organeve shtetërore dhe ekonomike të vendit, që, për nder të jubileut të madh të 30-vjetorit të themelimit të Partisë, të mobilizojnë të gjitha energjitë për zbatimin e detyrës historike të elektrifikimit të plotë të të gjitha fshatrave të vendit tonë deri më 8 Nëntor të vitit 1971. Komiteti Qendror u bën atyre thirrje që të hidhen në sulm të përgjithshëm për të tejkaluar sa më shumë realizimin e planit të shtetit të caktuar nga Kongresi V i Partisë, për shtimin e prodhimit, sidomos për shtimin mbi planin të prodhimit të mallrave për eksport, në mënyrë që të shtohet eksporti mbi planin dhe të rriten mundësitë për importin e materialeve të nevojshme për realizimin e detyrës së mësipërme historike; të mobilizohen për përmirësimin rrënjësor të cilësisë së prodhimit dhe të punës, për rritjen e rendimentit, uljen e kostos dhe forcimin e regjimit të kursimit.

3. — Komiteti Qendror i Partisë u bën thirrje organizatave të masave, të gjitha ndërmarrjeve ekonomike shtetërore, organizatave të kooperativave të artizanatit dhe të konsumit, njësisive dhe reparteve të Ushtrisë Popullore, institucioneve të ndryshme shtetërore, si dhe kooperativave bujqësore, që të çohen të gjithë në këmbë për elektrifikimin e plotë të fshatrave të vendit tonë për nder të 30-vjetorit të themelimit të Partisë, të organizojnë kooperimin sa më të përsosur në shkallë rrethi dhe në shkallë kombëtare për të kontribuar efektivisht dhe sa më shumë që të jetë e mundur për shkurtimin e shpenzimeve që do të bëjë shteti për elektrifikimin e fshatit dhe për zbatimin me sukses të kësaj

detyre të madhe historike. Elektrifikimi i plotë i fshatrave të vendit tonë, për nder të 30-vjetorit të themelimit të Partisë, të kthehet në një lëvizje të fuqishme revolucionare që të përfshijë të gjitha masat punonjëse dhe t'i japë një hov të mëtejshëm shpejtimit të ritmeve të ndërtimit të socializmit në Shqipëri.

Komiteti Qendror i PPSH ka besim të plotë se populli ynë heroik dhe punëtor, nën udhëheqjen e Partisë, do t'i përgjigjet me entuziazëm kësaj thirrjeje të Partisë dhe do ta zbatojë me sukses këtë detyrë të madhe historike, e cila është një shprehje tjetër e kujdesit të vazhdueshëm të Partisë për lulëzimin e mëtejshëm të jetës në fshatin tonë socialist, një shfaqje konkrete e vitalitetit të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, një hap i ri drejt ngushtimit të mëtejshëm të ndryshimit midis fshatit e qytetit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 299 (6024), 14 dhjetor 1967*

DEKLARATË

E KOMITETIT QENDROR TË PPSH DHE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH MBI AGRESIONIN E REVIZIONISTËVE SOVJETIKË DHE TË SATELITËVE TË TYRE KUNDËR RS TË ÇEKOSLLOVAKISË DHE POPULLIT ÇEKOSLLOVAK

22 gusht 1968

Natën e datës 20-21 gusht të vitit 1968, forcat ushtarake të Bashkimit Sovjetik, RP të Polonisë, RD Gjermane, RP të Hungarisë dhe RP të Bullgarisë, në kundërshtim flagrant me të gjitha normat që rregullojnë marrëdhëniet midis shteteve, në mënyrë të befasishme, të pabesë dhe me metoda fashiste kryen agresionin brutal kundër RS Çekoslllovakë dhe popullit çekoslllovak, duke pushtuar me forcë gjithë territorin e RS Çekoslllovakë.

Ndërsa forcat ushtarake të pushtimit sulmuan dhe shkelën territorin çekoslllovak nga shumë drejtime në të njëjtën kohë, udhëheqja tradhtarë revizioniste çekoslllovakë, me Aleksandër Dubçekun në krye, konsekuente në rrugën e tradhtisë së interesave të popullit të vet dhe e tmerruar nga forca e agresorëve, kapitulloi në mënyrën më të turpshme, duke i bërë thirrje popullit çekoslllovak dhe ushtrisë së tij që të mos bëjnë asnjë rezistencë për mbrojtjen e atdheut të vet kundër forcave ushtarake pushuese të huaja.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë denoncojnë dhe dënojnë me vendosmërinë më të madhe agresionin barbar të revizionistëve sovjetikë dhe të shërbëtorëve të tyre kundër RS Çekoslllovakë dhe popullit çekoslllovak.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë konsiderojnë se tragjedia çekoslllovakë e ka burimin në Kongresin XX të PK të Bashkimit Sovjetik, që përmbysi vijën marksiste-leniniste të PK të

Bashkimit Sovjetik të Lenin-Stalinit, duke e zëvendësuar atë me vijën revizioniste reaksionare hrushoviane dhe që çoi në gjallërimin e forcave revizioniste edhe në Çekoslovakë, që çoi në rrjedhime katastrofike në vetë Bashkimin Sovjetik dhe vuri në vështirësi gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Pushtimi ushtarak i Çekoslovakisë nga ana e revizionistëve sovjetikë dhe e shërbëtorëve të tyre është produkt i strategjisë globale të bashkëpunimit të udhëheqjes tradhtarë revizioniste sovjetike me imperializmin amerikan.

Agresioni i revizionistëve sovjetikë dhe i shërbëtorëve të tyre kundër Çekoslovakisë është një agresion i tipit fashist dhe përbën shkeljen më flagrante të parimit të lirisë dhe të sovranitetit të popujve. Ky agresion i turpshëm përfaqëson poshtërimin më të madh që u ka bërë klika revizioniste hrushoviane e Brezhnjev-Kosiginit nderit dhe prestigjitet të Bashkimit Sovjetik e të popullit sovjetik. Pas këtij agresioni të poshtë, askush në botë nuk mund të ketë as më të voglin besim në udhëheqjen revizioniste sovjetike. Ai është paralajmërimi më i madh për popullin sovjetik, për popujt e vendeve socialiste dhe të vendeve që sundohen nga klikat revizioniste, për popujt e Evropës dhe të të gjithë botës mbi rrezikshmërinë e klikës revizioniste kundërrivolucionare që sundon sot në Bashkimin Sovjetik, mbi qëllimet dhe metodat e saja imperialiste dhe fashiste për sundimin e popujve, duke u mbështetur në bashkëpunimin e saj me imperializmin amerikan.

Agresioni revizionist kundër RS Çekoslovake, që u krye në emër të Traktatit të Varshavës, vërteton edhe një herë atë që kanë deklaruar prej kohësh Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë se Traktati i Varshavës ka pushuar së qeni një pakt mbrojtës i vendeve socialiste, pjesëmarrëse në të, nga agresioni imperialist dhe revanshizmi gjermano-perëndimor. Traktati i Varshavës, nga një traktat paqeje, është kthyer në një traktat lufte skllavëruese, nga një traktat mbrojtjeje kundër agresionit imperialist, është kthyer në një traktat agresiv kundër vetë vendeve socialiste. Prandaj Partia e Punës e Shqipërisë, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe populli shqiptar e dënojnë me neveritje këtë traktat agresiv dhe deklarojnë solemnisht se kushdo që do të guxojë të prejë kufijtë e shenjtë të Republikës Popullore të Shqipërisë, qofshin edhe pjesëtarë të Traktatit të Varshavës, do të marrë përgjigjen e merituar dhe do të gjejë vdekjen e sigurtë nga populli shqiptar i bashkuar si një trup i vetëm rreth Partisë dhe qeverisë së tij.

Në këto çaste tragjike për popullin çekoslovak, Partia e Pu-

nës e Shqipërisë, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe populli shqiptar i shprehin popullit vëlla çekoslovak solidaritetin dhe përkrahjen internacionaliste më të vendosur. Ata kanë besim në shpirtin revolucionar dhe lirisdashës të popullit çekoslovak. Ata konsiderojnë se e vetmja rrugë shpëtimi dhe për të rifituar lirinë për popullin çekoslovak është rruga e luftës pa kompromis dhe deri në fund kundër pushtuesve të huaj, revizionistëve sovjetikë, gjermanë, polakë, hungarezë dhe bullgarë, lufta kundër imperializmit amerikan dhe revanshizmit gjerman, lufta kundër gjithë revizionistëve dhe reaksionarëve të vendit. Kjo luftë ka për të qenë e vështirë dhe e gjatë. Por është e vetmja rrugë e drejtë dhe e mundshme për shpëtimin e Çekoslovakisë, për mbrojtjen e lirisë dhe të socializmit. Populli shqiptar këtë rrugë ka ndjekur, prandaj ai qëndron sot i lirë dhe sovran, duke mposhtur planet imperialisto-revizioniste.

Populli shqiptar është i bindur nga eksperiencia dhe historia e vet shekullore se liria nuk dhurohet, por fitohet me gjak e sakrificë. Prandaj Partia e Punës e Shqipërisë, qeveria dhe populli shqiptar u bëjnë thirrje komunistëve revolucionarë të vërtetë çekoslovakë dhe popullit lirisdashës çekoslovak të ngrihen në luftë pa kompromis dhe deri në fund kundër pushtuesve revizionistë dhe kundër armiqve të brendshëm dhe të kenë besim se ata nuk janë vetëm, se me luftën e tyre janë të gjithë popujt lirisdashës të botës, janë edhe komunistët e revolucionarët e vërtetë dhe popujt e Bashkimit Sovjetik, të RD Gjermane, të Polonisë, të Hungarisë dhe të Bullgarisë, të cilët vuajnë nën zgjedhën e klikave revizioniste, që organizuan agresionin barbar kundër Çekoslovakisë. Komunistët shqiptarë dhe populli shqiptar do të jenë kurdoherë me luftën për liri të popullit çekoslovak. Populli çekoslovak me siguri do të fitojë në këtë luftë çlirimtare.

Partia e Punës e Shqipërisë, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe populli shqiptar kanë besim dhe u bëjnë thirrje bolshevikëve të vërtetë sovjetikë dhe popullit sovjetik që të ngrihen në luftë kundër klikës revizionisto-fashiste që po i shtyp, të ripërtërijnë Revolucionin e madh të Tetorit, duke varrosur një herë e përgjithmonë Kongresin XX famëkeq dhe rrjedhimet e tij tragjike në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përmbysur klikën revizioniste të Brezhnjev-Kosiginit, duke bërë që të largohen forcat pushtuese sovjetike nga Çekoslovakia dhe nga të gjitha vendet e tjera ku janë vendosur për sundim.

Partia e Punës e Shqipërisë, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe populli shqiptar u bëjnë thirrje të gjithë komunistëve revolucionarë të botës, gjithë popujve liridashës të botës, që të solidarizohen me çështjen e shenjtë të lirisë së popullit çekoslovak, të dënojnë këtë agresion barbar të revizionistëve sovjetikë e të shërbëtorëve të tyre dhe të mposhtin komplotin e madh sovjeto-amerikan për sundimin e botës, komplot i cili po bëhet baza e rigjallërimit të metodave fashiste në shtypjen e popujve dhe zhdukjen e lirisë së tyre.

KOMITETI QENDROR I PPSH KËSHILLI I MINISTRAVE I RPSH

Botohet sipas gazetës

«Zëri i popullit» Nr. 202 (6241).

23 shkurt 1969

PLENUMI V I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 5 shtator 1968

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 5 shtator 1968, nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbajt mbledhja e Plenumit V të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila shqyrtoi dhe diskutoi raportin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë, shokut Enver Hoxha, «Mbi gjendjen aktuale ndërkombëtare» si dhe raportin e anëtarit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë dhe Kryetarit të Këshillit të Ministrave të RPSH, shokut Mehmet Shehu, «Mbi denoncimin e Traktatit të Varshavës nga Republika Popullore e Shqipërisë».

Në fund të punimeve të tij, Plenumi i Komitetit Qendror aprovoi njëzëri raportet e paraqitura në këtë mbledhje dhe mori vendimet përkatëse.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

«MBI GJENDJEN AKTUALE NDËRKOMBËTARE»

Raport i mbajtur në Plenumin V të KQ të PPSH nga Sekretari i Parë i KQ të PPSH, shoku Enver Hoxha

5 shtator 1968

Të dashur shokë,

Byroja Politike, në mbledhjen e saj të datës 3 shtator 1968, pasi shqyrtoi dhe analizoi gjendjen ndërkombëtare në përgjithësi e në veçanti evenimentet tragjike që ndodhën këto kohët e fundit në Republikën Socialiste të Çekosllovakisë, pasi studjoi gjendjen politike, ushtarake dhe juridike të Traktatit të Varshavës, nën dritën e agresionit fashist të Çekosllovakisë nga ana e qeverisë sovjetike, polake, gjermanolindore, hungareze dhe bullgare, vendosi të thërrasë në këtë sesion Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë dhe t'i parashtrojë për diskutim e aprovim konkluzionet e arritura mbi këtë traktat tashmë agresiv. Shoku Mehmet do t'ju vërë në korrent të këtyre vendimeve e propozimeve të Byrosë Politike.

Para se t'i jap fjalën shokut Mehmet, dëshiroj të theksoj disa momente të ngjarjeve aktuale ndërkombëtare dhe detyrat që i dalin Partisë, popullit dhe pushtetit tonë në këto situata. Përkundraiz denoncimi i Traktatit të Varshavës nga Republika Popullore e Shqipërisë në këto momente politike shumë të favorshme dhe duke pasur nga ana jonë të gjitha të drejtat dhe arsyet politike, ideologjike, ligjore etj., do ta ngrëjë akoma më lart prestigjin e Partisë, të popullit, të qeverisë dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë në sytë e të gjithë popujve përparimtarë të botës. Nga ana tjetër, Republika Popullore e Shqipërisë, duke denoncuar këtë traktat agresiv nga i cili ajo, «de facto», ishte përjashtuar me kohë nga anëtarët revizionistë të traktatit, forcon pozitat e saja dhe eviton një rrezik të mundshëm agresiv që ne me kohë e kishim parasysh në luftën tonë me revizionistët sovjetikë, rrezik ky që u vërtetua plotësisht në Çekosllovakia.

Unë dëshiroj të theksoj se kur u nënshkrua Traktati i Var-

shavës (1955) ishte një situatë tjetër, e cila tani ka ndryshuar katërcipërisht, sepse që nga tradhëtia e revizionistëve sovjetikë etj. ka ndryshuar krejtësisht karakteri i këtij Traktati si politikisht e ideologjikisht ashtu edhe ushtarakisht.

Në kohën e nënshkrimit të Traktatit të Varshavës, domethënë pas vdekjes së Stalinit dhe para Mbledhjes së Bukureshtit, aty nga shkurti i vitit 1956, kur akoma nuk kishin dalë në dritë si duhet pikëpamjet revizioniste të grupit të Nikita Hrushovit, kishte shenja të dukshme të një farë nxitjeje drejt liberalizmit politik dhe ideologjik në Bashkimin Sovjetik dhe sidomos në drejtim të afrimit me revizionistët jugosllavë... Por, megjithëse në atë kohë revizionistët sovjetikë nuk kishin dalë hapur me tezat e tyre, momentet politike paraqiteshin të atilla që kërkonin nënshkrimin e Traktatit të Varshavës, i cili u krijua për të ruajtur pavarësinë e të gjitha shteteve socialiste veç e veç dhe të kampit socialist bashkërisht, kundër agresionit imperialist dhe bllokut agresiv të NATO-s dhe për mosdërhyrjen në punët e tyre të brendshme. Në këtë mënyrë nënshkrimi i Traktatit të Varshavës nga ne ishte i drejtë, progresiv, e lupte situata, prandaj Partia dhe qeveria jonë e pranuan dhe e firmosën atë.

Por duhet thënë se Traktati i Varshavës për ne edhe atëhere ekzistonte vetëm në letër, marrëdhëniet ushtarake lidhur me mbrojtjen e vendit tonë, me furnizimin e armatimeve në kuadrin e këtij traktati dhe marrëveshjet përkatëse bëheshin brenda dy shteteve, midis Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë, kurse përsa u përket çështjeve të tjera si anëtarë të Traktatit të Varshavës ne trajtoheshim me gjithë kuptimin e fjalës si figurantë. Në një gjendje të tillë ishin edhe vendet e tjera anëtare të Traktatit të Varshavës. Mundet që sovjetikët bënin edhe mbledhje të veçanta me pjesëtarë të tjerë të këtij traktati pa pjesëmarrjen e Shqipërisë, por ne shikonim se mbledhjet e përbashkëta bëheshin krejtësisht formale, siç ishte për shembull mbledhja për të zgjedhur herë pas here sekretarin e përgjithshëm të komitetit politik konsultativ dhe komandantin e përgjithshëm. Pra, me një fjalë, Traktati i Varshavës nuk funksiononte si një organizëm kolektiv i vendeve anëtare.

Kur ne goditëm tradhëtinë e madhe të revizionistëve sovjetikë dhe të gjithë revizionistëve të tjerë modernë, atëhere u duk hapur qëndrimi armiqësor i këtyre tradhëtarëve ndaj Partisë, qeverisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë në të gjitha drejtimet, në lëmin politik, ideologjik, ekonomik dhe ushtarak. Pra edhe Traktati i Varshavës për Partinë dhe për popullin tonë jo vetëm që nuk ishte më një mjet mbrojtës, por në të kundërtën, ai përbente një kërcënim për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Në fakt, që në atë kohë, revizionistët ne na përjashtuan nga Traktati.

Byroja Politike dhe Komiteti Qendror i Partisë sonë me kohë e kanë pasur të qartë këtë situatë politike dhe ushtarake të Traktatit të Varshavës, prandaj me prishjen e marrëdhënieve me vendet revizioniste, gjithë mbrojtja jonë është ndërtuar në mbrojtje rrethore të gjithanshme, duke pritur çdo rrezik sulmi si nga vendet imperialiste, ashtu dhe nga ato revizioniste...

Në fakt, duke qenë të përjashtuar nga Traktati i Varshavës, ne kemi kundërshtuar gjithnjë veprimet e tij të padrejta, por vendet pjesëmarrëse asnjëherë nuk i kanë pranuar kërkesat tona. Ata mund të kenë marrë edhe ndonjë vendim të brendshëm e të na kenë përjashtuar nga Traktati i Varshavës, por edhe sikur të mos e kenë marrë këtë vendim të fshehtë, efektivisht ne ishim të përjashtuar.

Ngjarjet e fundit të Çekosllovakisë vërtetojnë atë që ne parashikojmë me kohë, se Traktati i Varshavës nuk e ka më karakterin për të cilin ai u krijua. Të gjitha vendet e Traktatit të Varshavës, ku në fuqi janë klikat revizioniste, me përjashtim të Rumanisë, sulmuan në mënyrë të fshehtë dhe fashiste Çekosllovakinë, pra e përdorën Traktatin e Varshavës si një mjet shtypjeje e skllavërimi kundër një vendi anëtar të këtij Traktati. Pra ndodhi ajo që parashikonte Byroja Politike e Partisë sonë, që u krijuan situata të tilla politike që ne ta denoncojmë këtë Traktat. Denoncimi i Traktatit të Varshavës në këtë situatë ndërkombëtare do të gjejë përkrahjen dhe aprovimin e plotë të të gjithë popullit shqiptar, të Partisë, si edhe të elementëve demokratë përparimtarë të botës dhe të marksistë-leninistëve të vërtetë, të cilët do ta aprovonjë këtë veprim politik të Republikës Popullore të Shqipërisë. Kështu do të forcohet mbrojtja jonë, do të rritet simpatia dhe autoriteti i Partisë, i qeverisë dhe i Republikës Popullore të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, sepse në këto momente kur revizionistët sovjetikë me urë në dorë po kërcënojnë edhe vetë vendet e Traktatit të Varshavës, ne ua përplasim fytyrës dhe demaskojmë botërisht dhe trimërisht aktet e tyre fashiste.

Por, a është në favorin tonë denoncimi i Traktatit të Varshavës në këtë koniunkturë ndërkombëtare? Në këtë situatë të krijuar nga revizionistët sovjetikë në kushtet e acarimit të krizës që ka kapur vendet kapitaliste, kur forcohet gjithnjë e më shumë aleanca sovjeto-amerikane për të shtypur luftërat çlirimtare të popujve të botës, ne themi se ky denoncim është në favorin tonë. Ne mendojmë dhe gjykojmë se ekzistenca e Traktatit të Varshavës nuk luante asnjë rol pozitiv për mbrojtjen e vendit tonë, përkundrazi ishte një rrezik, që vazhdon të mbetet edhe pasi ta revokojmë këtë Traktat. Pra në këtë rast ne nuk humbasim asgjë. Edhe armiqtë e tjerë, imperialistët, gjithashtu nuk lëshojnë, ata janë po ata, që kërkojnë të na sulmojnë dhe të na robërojnë,

prandaj edhe në këtë drejtim asgjë nuk ndryshon. Përsa u përket rreziqeve dhe mbrojtjes së vendit tonë, denoncimi i Traktatit të Varshavës nuk prish asgjë.

Deri dje, në teori, imperialistët amerikanë e miqtë e tyre mund të thoshin se nuk duhet ta godasim Shqipërinë pasi mund të vihet në lëvizje Traktati i Varshavës. Për ne ky supozim teorik s'ka asnjë vlerë se qenia ose jo e Shqipërisë në Traktatin e Varshavës nuk mund të ketë asnjë efekt përta në përket strategjisë së NATO-s në Ballkan, prandaj në të dy rastet imperialistët mund të na sulmojnë.

Por, në këto koniunktura, merr rëndësi të veçantë revokimi i Traktatit të Varshavës nga ana e Republikës Popullore të Shqipërisë. Kur ne revokojmë Traktatin e Varshavës, vendet e NATO-s nuk mund të vënë përpara arsyetimin se «e sulmojmë Shqipërinë pse është anëtare e Traktatit të Varshavës», por do të sulmojnë një vend që nuk është anëtar i Traktatit të Varshavës, kështu u heqim këtë argument nga dora e tyre. Prandaj në të dy tablotë denoncimi i Traktatit të Varshavës nuk çënon aspak çështjen e mbrojtjes së vendit tonë. Ky veprim është qind për qind në favorin tonë. Propaganda e revizionistëve modernë do të çirret se «Shqipëria u lidh tani me NATO-n» etj., por kjo nuk pi ujë asgjekundi, ata le të lehin, siç kanë lehur deri tani, se me siguri do të demaskohen pa mëshirë nga jeta dhe nga qëndrimet revolucionare e të vendosura të Partisë dhe të popullit tonë. Prandaj, shokë, është mirë që këtë çështje me rëndësi të madhe ta diskutojmë dhe të vendosim.

Komiteti Qendror i Partisë është plotësisht në dijeni të zhvillimit të ngjarjeve në arenën ndërkombëtare dhe në veçanti të ngjarjeve në Republikën Socialiste të Çekosllovakisë e në vendet revizioniste. «Zëri i popullit» dhe i gjithë shtypi i vendit tonë kanë informuar me hollësi mbi ngjarjet, kanë mbajtur qëndrimet e duhura revolucionare mbi to dhe kanë bërë analiza të hollësishme për të sqaruar prejardhjen e veprimeve agresive tradhëtare revizioniste, si ato të revizionistëve sovjetikë dhe të satelitëve të tyre agresorë, ashtu edhe të revizionistëve kapitullantë e tradhëtarë çekosllovakë. Prandaj mendojmë se nuk është e nevojshme të trajtojmë kronologjinë e ngjarjeve.

Dëshiroj të ritheksoj atë që ka parashikuar drejt Partia jonë dhe Komiteti Qendror i saj, krizën e madhe që vërtetohet dhe thellohet çdo vit e më shumë në kampin e revizionistëve modernë. Të gjitha këto ndodhi dhe ato që do të vërtetohen në të ardhshmen e që do të jenë akoma më katastrofike për revizionistët, janë rezultat dhe konsekuencë e tradhëtisë së tyre ndaj marksizëm-leninizmit, është kursi kapitalist që ata morën në ideologji, në politikë, në ekonomi, në organizimin e partisë, të shtetit dhe të ekonomisë.

Likuidimi nga revizionistët sovjetikë dhe revizionistët e tjerë i fitoreve të socializmit në vendet e tyre, shndërrimi i partive marksiste-leniniste në parti borgjeze socialdemokrate, transformimi i ekonomisë në një ekonomi kapitaliste, sollën si rezultat të pavitueshëm ndryshimin e politikës së tyre të brendshme dhe botërore në një politikë shoviniste, shtypëse, fashiste, të sundimit me forcë e me terror mbi popujt e tyre, të ndryshimit të qëllimit të aleancave të ndryshme të arritura në mes tyre, në aleanca skllavëruese politike, ekonomike e ushtarake në favor të shtetit më të fuqishëm revizionist, që është Bashkimi Sovjetik, mbi sateletët e tij dhe më në fund të krijimit të aleancës sovjetiko-amerikane për ndarjen e sferave të influencës, për sundimin e botës nga dy fuqitë e mëdha, për luftën me armë dhe pa armë kundër lëvizjes komuniste ndërkombëtare, kundër socializmit dhe luftërave nacionalçlirimtare të popujve.

E gjithë kjo rrugë tradhëtare e përshkuar nga revizionistët hrushovianë dhe shërbëtorët e tyre, që nga Kongresi XX i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, është për ta plot disfata të bujshme e të pandërprera. Piramidat e vendosura prej tyre në këtë rrugë janë piramida me themele të lëkundshme e të kalbura, të vëna me përpjekje të mëdha e të dëshpëruara që i kanë demaskuar plotësisht dhe përfundimisht jo vetëm në sytë e komunistëve revolucionarë, jo vetëm në sytë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, por edhe në sytë e të gjithë njerëzve të ndershëm të botës.

E gjithë kjo veprimtari e ethshme tradhëtare e revizionistëve sovjetikë dhe e shërbëtorëve të tyre u zhvillua, kur është në proces e thellohet kriza e përgjithshme e kapitalizmit botëror, me imperializmin amerikan në krye. Pikërisht për ta shpëtuar kapitalizmin botëror nga kriza e rëndë dhe nga revolucioni, revizionistët hrushovianë dhe shërbëtorët e tyre ndërmorën rolin e tradhëtisë, të grevëthyesve të revolucionit e të luftërave nacionalçlirimtare të popujve, të maskuar me parullat e urryera «bota pa luftëra, bota pa armë», «bashkekzistencë paqësore» etj. Natyrisht në momentet e favorshme revolucionare, brenda krizës së madhe e të përgjithshme të kapitalizmit botëror, kriza në vetë gjirin e revizionistëve modernë, të këtyre kapitalistëve të rinj, do të shtohet, do të thellohet dhe do të acarohet.

Në radhë të parë, revizionistët sovjetikë do të humbisnin hegjemoninë dhe kontrollin absolut politik, ideologjik dhe ekonomik mbi sateletët e tyre dhe mbi të gjithë krerët revizionistë të partive të ndryshme. Në këtë shpartallim të tyre, jo vetëm që do të influenconte ideologjia antimarksiste dhe format e reja që adaptoheshin, por imperializmi amerikan, në radhë të parë, dhe kapitalizmi botëror, secili veç e veç e të gjithë së toku, do të ndër-

merrnin siç ndërmorën «ndërtimin e urave» për aktivizimin e minimin të sundimit sovjetik, për aktivizimin e policentrizmit e të tendencave centrifugale nga Moska, për aktivizimin e liberalizmit të jetës në vendet ku sundonin revizionistët.

Revizionistët sovjetikë pësuan humbje kolosale prestigji, autoriteti dhe ekonomike në të gjithë këtë zhvillim dhe sa më tepër që humbisnin, aq më shumë lidhej klika tradhëtare e Kremlinit me imperializmin amerikan, i cili nga aleancat me revizionistët sovjetikë kapërceu krizën indoneziane, atë domenikane, indo-pakistaneze, krizën me Francën e shumë të tjera...

Mund të imagjinohet fare lehtë gjendja e dëshpëruar e revizionistëve sovjetikë. Ata ndodhen në mes të zjarreve. Nga një anë lufta e rreptë, e pamëshirshme dhe parimore që u bëjnë atyre Partia e Punës e Shqipërisë, Partia Komuniste e Kinës dhe të gjitha partitë e reja marksiste-leniniste e revolucionarët e vërtetë në të katër anët e botës. Kjo luftë i ka demaskuar katërcipërisht. Nga ana tjetër, ata duhet të mbajnë në zep, të shtypin, të gënjejnë opinionin brenda vendit dhe njëkohësisht të bëjnë transformime kapitaliste, të lidhen sa më ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe tok me ta të përgatitin luftën kundër Republikës Popullore të Kinës, por edhe t'i shpëtojnë sa të jetë e mundur invadimit «paqësor» amerikan, që ka në plan minimin total të fuqisë së tyre.

Më në fund, revizionistët sovjetikë janë në hall të madh se duan të kenë nën zep gjithë revizionistët e botës, për të cilët kanë aq shumë nevojë t'u mbajnë ison dhe të formojnë perden e tymit. Mbi të gjitha, revizionistët sovjetikë përpiqen të ruajnë hegjemoninë politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake mbi sateletët e tyre të Evropës...

Loja e madhe që luhet në Evropë është bashkimi i Gjermanisë. Ky është edhe synimi i Bonit dhe i imperializmit amerikan. Nga ana e tyre bëhen përpjekje që Republika Demokratike Gjermane të likuidohet pa luftë. Zhdukja nga harta e Evropës e Republikës Demokratike Gjermane dhe krijimi i Rajhut të ri, është epiqendra për të likuiduar influencën sovjetike ndër sateletët e saj evropianë dhe për zhvillimin e marrëdhënieve të tyre miqësore me Bonin. Ofertat e Bonit po zënë vend në klikat revizioniste. Sovjetikët, Zhivkovi, Gomulka, Titua, Ulbrihti vetë, e të tjerë janë shumë sensibil në kreditë e shumta që marrin nga Boni, presin me gëzim turistët gjermanë. Këto bënë që Bashkimi Sovjetik, Jugosllavia dhe Rumania të lidhin marrëdhënie diplomatike me Bonin. Në këtë rrugë ishin gati edhe çekët e bullgarët, për të mos folur për hungarezët...

Revizionistët sovjetikë kanë frikë dhe nuk angazhohen të nënshkruajnë traktatin e paqes me Republikën Demokratike

Gjermane dhe e sakrifikojnë këtë për hir të interesit të aleancës sovjeta-amerikane. Atëhere ç'i vënë përballë zgjidhjes së këtij problemi bazë? Sfumatura! Mbledhjen dhe propozimet e parealizueshme të Karlovi Varit dhe shthurjen ideologjike në kampin e tyre, ose konferencën e ardhshme e të falimentuar të Moskës!

Në të tilla koniunktura ndërkombëtare plasi kriza çekoslovakë, e cila ziente gati që prej një viti, krizë e brendshme e revizionizmit çekoslovak, ku kishin futur duart deri në bërren revizionistët sovjetikë dhe që ne e kemi analizuar e faktet në përgjithësi na kanë dhënë të drejtë.

Klika e Dubçekut rrëzoi atë të Novotnit dhe mori kursin revan drejt Perëndimit. U prish ekuilibri strategjiko-ushtarak i mbrojtjes së Bashkimit Sovjetik. Për sovjetikët Republika Demokratike Gjermane dhe Republika Popullore e Hungarisë gjendeshin të rrezikuara jo vetëm politikisht, por edhe ushtarakisht. Ngjarjet pra po precipitoheshin. Revizionistët sovjetikë, gjermanë dhe polakë gjendeshin në hall të madh. Në Poloni, në shembullin e Çekoslovakisë, filluan demonstratat kundër Gomulkës. Gjermanët e Ulbrihtit s'i përbante gjë, ata prisnin sinjalin.

Klika e Dubçekut u rezistoi kundërshtarëve të tij në Drezden, të cilët u mblodhën më vonë në Varshavë dhe i dhanë klikës së Dubçekut ultimatumun që dimë, që edhe këtë shtypi i Partisë sonë e ka analizuar drejt, duke mbajtur qëndrim të vendosur e parimor.

Mbledhjet e mëvonshme të organizuara nga revizionistët sovjetikë dhe shërbëtorët e tyre në Çerna mbi Tisu, në Bratislavë dhe komunikatat e tyre që u lëshuan, ju i dini. Dini gjithashtu edhe për manevrat ushtarake të të pestëve të Traktatit të Varshavës brenda në Çekoslovakë e më vonë gjatë kufijve të saj, dini për vajtjen «triumfale» të Titos dhe të Çaushekut në Pragë. Ju jeni në dijeni për të gjitha këto nga shtypi ynë, i cili i komentoi gjerësisht në rrugën e vërtetë marksiste-leniniste.

Artikujt, komentet e shtypit tonë dhe të radio Tiranës janë ndjekur me interesim të madh dhe kanë ngritur autoritetin e Partisë sonë, për qëndrimet e saj heroike, të vendosura, të drejta, marksiste-leniniste. Në mënyrë të veçantë brenda në Çekoslovakë ato kanë bërë përshtypje të madhe për qartësinë dhe objektivitetin e tyre.

Sulmi fashist dhe okupacioni i Çekoslovakisë nga ana e revizionistëve sovjetikë, ia çorri krejtësisht maskën klikës së Kremilit. Jo vetëm këto, por edhe metodat e përdorura, që nga presionet, shantazhet, të puthurat e Juda Iskaritot në Bratislavë dhe sulmi në befasi, në errësirën e natës, pa pasur asnjë fakt, qoftë edhe formal, që të arsyetonte ndërhyrjen brutale me armë, i japin kësaj ndërhyrjeje kuptimin e vërtetë që ka, fashiste, imperialiste.

E njollosën prestigjin e Bashkimit Sovjetik si vendi i parë i socializmit!

Revizionistët sovjetikë në mënyrë sistematike, vepruan dhe veprojnë me një plan djallëzor pikërisht që ta zhdukun në sytë e botës atë kredi kolosale të fituar, si vendi i parë i socializmit. Kjo është humbja më e madhe që pësoi komunizmi dhe që do t'u duhet kohë, gjak e djersë komunistëve sovjetikë të vërtetë dhe të gjithë marksistë-leninistëve në botë për ta fituar përsëri. Përsa u përket vetë revizionistëve sovjetikë, ata e humbën edhe atë pak kredi që mund të kishin te revizionistët e vendeve të tjera dhe te elementët e lëkundshëm oportunistë, pse i gjithë ky moçal, ky llum i komunizmit ndërkombëtar, megjithëqë në dukje, nuk pajtohet me veprimet brutale dhe agresive të revizionistëve sovjetikë, nuk pajtohet me imperializmin dhe hegjemoninë sovjetike. Ky llum është pjesë përbërëse e atij kapitalizmi kombëtar që synon të forcojë hegjemoninë e vet mbi të tjerët. Ky llum të paktën ëndërronte që revizionistët sovjetikë politikën e tyre të «bashkekzistencës paqësore» të mos e transformonin në një politikë brutale që të rrezikonte hegjemoninë e vendeve të tjera kapitaliste, te të cilët revizionistët janë shërbëtorë.

Prandaj, me okupimin brutal të Çekoslovakisë ne shohim se gati të gjitha partitë revizioniste të botës, nga janë e nga s'janë, me Partinë Komuniste Franceze dhe Partinë Komuniste Italiane në ballë, po deklarohen haptazi kundër okupimit me armë të Çekoslovakisë nga ana e revizionistëve sovjetikë. Përçarja në gjirin e revizionizmit modern, ashtu siç e kemi parashikuar, po thellohet, pavarësisht se ata nuk do t'i presin lidhjet me njëri-tjetrin dhe formalisht do t'i kurdisin përsëri. Por, sidoqoftë, baza e këtyre partive është krejt përtokë, e krimbur, e paqenë, e lëkundshme. Vetë borgjezia kombëtare e tyre do të bëjë kërdinë në radhët e këtyre partive për ta dobësuar e likuiduar edhe atë pak influencë relative që u kishte mbetur.

Partia Komuniste revizioniste e Bashkimit Sovjetik, të paktën për disa muaj, do të mbetet e vetmuar, e izoluar, do të ketë vetëm ato katër parti që e ndoqën në sulmin mbi Çekoslovakinë dhe disa sahanlëpirës të emigracionit apatride¹ dhe që «masë» kanë vetëm personin e tyre e ideal të vetëm rublën sovjetike.

Pra, ashtu siç parashikuam, konferenca revizioniste e Moskës u komprometua, por edhe sikur sovjetikët të arrijnë ta mbledhin atë, do ta bëjnë me kërcënime e me forcën e «rublës», ajo do të jetë për të qeshur.

Mbi të gjitha sulmi i armatosur kundër Çekoslovakisë ka qenë një katastrofë për revizionistët sovjetikë, një vetëvrasje.

¹ Pa atdhe.

Është fakt se ky veprim është një grusht për politikën e tyre të «bashkekzistencës paqësore» dhe një dështim i paguar i politikës së tyre revizioniste liberale. Krahu i majtë revizionist në Bashkimin Sovjetik ose «konservatorët revizionistë», siç kërkojnë t'i quajnë, i detyruan liberalët të pushonin dhe këtu kanë luajtur kryesisht konsiderata të mbrojtjes strategjike dhe prestigjit. U erdhi armiku në derë dhe thika në grykë.

Po flitet që në udhëheqjen aktuale revizioniste sovjetike do të bëhet ndryshimi i «gardës». Natyrisht kriza që ekziston në udhëheqjen revizioniste sovjetike do të thellohet. Por asnjë iluzion nuk duhet të kihet për ata që eventualisht mund të vijnë. Ata do të jenë si këta që mund të largohen, të gjithë janë puçistë revizionistë.

Por një ndryshim i «gardës» do ta zgjojë ca «Ivanin» që e ka zënë gjumi i rëndë. Nën presionin e ngjarjeve ai mund të fillojë disi të mendojë, përse ngjasin këto dhe ç'duhet të bëjë? Kjo është ana pozitive e ndryshimeve që mund të bëhen. Ndryshimet do ta dobësojnë udhëheqjen revizioniste dhe do të nxitin rezistencën. Në gjirin e satelitëve, një ndryshim i «gardës» në Kremlin, mund të shkaktojë dhe duhet të shkaktojë ndryshime zinxhir në mos përnjëherësh, gradualisht, në mos kudo, në disa.

Sidoqoftë, disa muaj më parë se të bëhej sulmi mbi Çekoslovakinë krahu «i majtë konservator» mori masa ushtarake periferike për të siguruar «prapavijën» dhe «paravijën» e Bashkimit Sovjetik. Kështu që me këtë rast forcoi okupacionin në Poloni, në Republikën Demokratike Gjermane, dhe pasi okupoj ushtarakisht Çekoslovakinë, nga e cila trupat sovjetike nuk do të largohen kurrë, forcoi garnizonet në Hungari dhe në Bullgari, ku kontingjenti i ushtrisë sovjetike është veshur me uniformën e ushtrisë bullgare. E tërë kjo e diktuar nga frika e revizionistëve sovjetikë nga një shpartallim total i satelitëve dhe shpërbërja e tyre plotësisht nga Bashkimi Sovjetik dhe nga një shpërthim analog ose revolucionar brendapërbrenda në Bashkimin Sovjetik. Mund të bëjmë pra edhe hipotezën se i gjithë ky operacion mund të ketë pasur këtë objektiv.

Pra, ndërrohet ose jo «garda» në Kremlin, revizionistët sovjetikë i ka kapur një panik i madh, si brenda ashtu edhe jashtë dhe kanë vënë në plan të parë çështjen e mbrojtjes së kësaj situatë edhe me armë, edhe duke okupuar me armë Çekoslovakinë, edhe duke ditur e duke qenë të bindur se as polonezët as gjermanolindorët dhe as hungarezët nuk janë dakord me ta. Situatat koniunkturale i bëjnë këta të jenë hëpërhë gjoja solidarë me këto veprime të sovjetikëve.

Pra këtej e tutje zgjidhja e çështjeve dhe e kontradiktave që

do të ashpërsohen dhe do të thellohen në mes të revizionistëve sovjetikë dhe satelitëve të tjerë anëtarë të Traktatit të Varshavës, do të imponohen me forcë nga sovjetikët ose do të përfundojnë në përlëshje me armë. Tjetër rrugë nuk ka për ta.

Shembulli më tipik për të gjithë satelitët e Bashkimit Sovjetik është Çekoslovakia. Ajo u okupua, edhe të tjerat janë okupuar. Forcat e okupacionit sovjetik në Republikën Çekosllloake tash do të diktojnë ligjin atje, do të caktojnë udhëheqjen e partisë dhe të qeverisë çekosllloake. Kongresi çekoslllovak i «Partisë Komuniste Çekosllloake», në qoftë se ky do të bëhet, do të zhvillohet sipas direktivave të ardhura nga Moska. Çekoslovakia pra u shndërrua në një koloni sovjetike. Kështu do të kthehet edhe Polonia, edhe Republika Demokratike Gjermane, edhe Hungaria, për të mos folur pastaj për Bullgarinë që është bërë me kohë e tillë. Kjo është rruga dhe këtë rrugë e ndryshojnë vetëm konfliktet e armatosura në mes të klikave, rrugë kjo që komprometon vetëm zgjedhën koloniale sovjetike, *ndërsa revolucioni proletar është mjeti më i mirë që i jep fund definitivisht kësaj tragjedi dhe intrige të kurdisur nga imperialistët sovjetikë dhe imperializmi botëror.*

Prandaj momentet janë shumë të favorshme për marksistë-leninistët e vërtetë, për revolucionarët kudo në botë. Ata duhet të organizojnë dhe të hedhin popujt e tyre në rezistencë e në luftë të armatosur kundër revizionizmit modern si edhe kundër imperializmit.

Agresorët revizionistë sovjetikë pësuan disfatë të madhe dhe të turpshme me agresionin fashist që bënë kundër popullit dhe Republikës Çekosllloake. I gjithë opinioni botëror është ngritur kundër tyre. Veprimi i tyre është imoral, cinik, fashist. Ata nuk kanë asnjë bazë politike, ideologjike dhe ligjore. Të gjitha argumentimet e tyre për agresionin që kryen janë bosh dhe false. Tradhëtarët e marksizëm-leninizmit dhe udhëheqësit e rrugës tradhëtare të revizionizmit nuk mund të akuzojnë revizionistët çekoslllovakë për tradhëti ndaj marksizëm-leninizmit dhe për rrugë revizioniste.

Nuk mund, tradhëtarët revizionistë sovjetikë, që janë partnerët, miqtë dhe aleatët politikë dhe ideologjikë të imperializmit amerikan, të akuzojnë revizionistët çekoslllovakë se shkojnë drejt aleancës së ngushtë me kapitalizmin botëror.

Nuk mund, tradhëtarët revizionistë sovjetikë, që kanë bastarduar Partinë Bolshevike në një parti pa shpirt, në një parti pa norma leniniste, në një parti socialdemokrate që e mbajnë vetëm për emër e për të thënë se ekziston, të akuzojnë revizionistët çekoslllovakë se po e shkallmojnë Partinë Komuniste Çekosllloake dhe po e shndërrojnë atë në një parti socialdemokrate.

Nuk mund, revizionistët sovjetikë, që po ndërtojnë vetë kapitalizmin në Bashkimin Sovjetik, duke shkallmuar socializmin me ligjet, normat dhe format organizative të tija, të akuzojnë revizionistët çekoslovakë se po ndërtojnë në vendin e tyre kapitalizmin, duke shkallmuar socializmin.

Nuk mund, revizionistët sovjetikë, që po marrin kredi kolosale nga kapitalizmi botëror të akuzojnë revizionistët çekoslovakë pse marrin dhe kërkojnë të marrin kredi nga kapitalistët.

Nuk mund, revizionistët sovjetikë, që kanë lidhje diplomatike e lidhje të tjera me Bonin, të kërkojnë që revizionistët çekoslovakë të mos vendosin të tilla marrëdhënie me Bonin.

Mund ta zgjatim numrin e qëndrimeve të revizionistëve sovjetikë. Vetvetiu del pyetja dhe rezulton edhe përgjegjia: Ç'të drejtë politike, morale, ideologjike dhe juridike kanë revizionistët sovjetikë mbi revizionistët çekoslovakë? Ç'të drejta kanë që t'u kërkojnë atyre llogari dhe ca më keq akoma t'i sulmojnë me armë dhe të okupojnë popullin dhe Republikën Çekoslllovakë? Asnjë të drejtë!

E gjithë kjo pra vërteton atë që kemi thënë se revizionistët janë tradhëtarë, janë imperialistë, janë fashistë. Me këtë që bënë në Çekosllovaki, ata çorren çdo maskë, vërtetuan atë se për ata, ashtu si për fashistët, nuk ekziston as miqësi as parime as aleancë as traktat as demokraci as liri as pavarësi e sovranitet i popujve. Çdo gjë ata e shtypin, e marrin nëpër këmbë, e vënë nën çizme, me armë dhe me gjak.

Arsyetimi zyrtar revizionist sovjetik i agresionit kundër Çekoslllovakisë është në vetvete një demaskim i madh për ta. Përveç të tjerave ata thonë sikur gjoja janë ftuar të ndërhyjnë në Çekosllovaki «nga personalitete çekoslllovakë», që as emrat nuk guxojnë t'i japin, pse mund të jetë një bllof, por edhe sikur të jetë, ata nuk mund të jenë veçse tradhëtarë, spiunë të tyre, kolaboracionistë, kuislingë të urryer. Që të ndërhysh në një vend duhet të të kërkojë ndihmën zyrtare qeveria legale e atij vendi. Ata nuk i ftuan as qeveria çekoslllovakë as presidenti i Republikës as Komiteti Qendror as parlamenti. Të paktën Hitleri i mori me forcë firmën presidentit Hasha, kur sulmoi Çekosllovakinë.

Okupatorët revizionistë sovjetikë, kur ndërmorën këtë vepër, mendonin se që të nesërmen udhëheqja çekoslllovakë do t'u binte në gjunjë. Kjo udhëheqje revizioniste që kapitulloi në fakt, që i la kufijtë hapur dhe nuk dha urdhër të mbroheshin, kapitulloi për të dytën herë në Moskë dhe hyri në shërbim të okupatorëve. Por sovjetikët do të bëjnë përpjekje të mëdha për të gjetur njerëz të sigurtë, qind për qind të tyre, me të cilët të formojnë të paktën një qeveri kuislinge hije të qëndrueshme. Kjo do të jetë disfata tjetër e tyre e madhe. Me siguri ata do të gjejnë qojle

dhe tradhëtarë, por rezistenca nuk do të shuhet. Sovjetikët do të gjejnë ndonjë Kadar çek, por çështja do të zhvillohet ndryshe nga ajo e Hungarisë.

Akti i tyre barbar nuk do t'i lejojë të riorganizojnë, siç mendojnë revizionistët sovjetikë, Partinë Komuniste Çekoslllovakë, pa të cilën nuk mund të legalizojnë veprën e tyre fashiste. Por ata mund të arrijnë me zor të gënjejnë një pjesë, sa për të kapërcyer vështirësitë e para dhe për të lënë përshtypjen se «ndërhyrja ishte e nevojshme, shpëtimtare, çdo gjë u normalizua dhe vazhdon miqësia», dhe fillojnë shkëmbimet e delegacioneve me të përqaftuara e me të puthura si të Judës. Por kjo asgjë nuk do të zgjidhë. Çdo ditë e më shumë situata në Çekosllovaki do të bëhet e vështirë për okupatorët dhe e mirë për revolucionarët.

Marksistë-leninistëve të vërtetë çekoslllovakë do t'u duhet të organizojnë sa më parë Partinë Komuniste Çekoslllovakë marksiste-leniniste në ilegalitet, do t'u duhet të organizojnë frontin e rezistencës në baza parimore, por jo sektare, do t'u duhet të hedhin klasën punëtore dhe popullin çekoslllovak nga mbrojtja pasive aktuale, në mbrojtje aktive, me greva e demonstrata, në goditje me armë dhe në organizimin e luftës partizane. Janë momente nacionale shumë të përshtatshme këto që mund të shfrytëzohen në kulm, pa prituri asgjë dhe nga askush. Bisedimet, tratativat, lëshimet ndaj okupatorëve, do të duhet të goditen pa mëshirë. Do të duhet të demaskohen shpresat për ndihmë nga ana e imperializmit dhe të goditen ndërhyrjet e tyre, si dhe agjentët e tyre, të cilët do të përpiqen në çdo etapë të marrin drejtimin e rezistencës.

Rezistenca pasive e çekoslllovakëve është pozitive në fillim, por nuk zgjidh gjithçka. Kjo u jep kohë edhe okupatorëve të organizohen. Ata duan qetësi që të plotësojnë kusarinë dhe agresionin. Qetësia atyre u duhet edhe për opinionin e brendshëm në vendet e tyre, opinion të cilin ata e gënjejnë paturpësisht.

Prandaj revolucionarët marksistë-leninistë çekoslllovakë duhet të kuptojnë rëndësinë e madhe që ka organizimi i rezistencës me armë në drejtim të ngritjes së opinionit në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste. Ata duhet të kuptojnë se prapavijat e okupatorëve revizionistë duhet të jenë në lëvizje, të shqetësuara dhe duhet t'u bëjnë presion udhëheqjeve tradhëtare të vendeve të tyre.

Bojkotimi total i ushtrive okupuese të revizionistëve është një taktikë e mirë dhe sa më i plotë që të bëhet aq më mirë do të jetë. Urrejtja kundër tyre duhet të rritet në popull. Ushtarët sovjetikë po të duan le të nxjerrin konkluzione. Njëkohësisht do të nevojitet të zhvillohet një propagandë sqaruese disfatiste në radhët e ushtrisë së okupatorëve për të demaskuar revizioniz-

min modern, revizionizmin hrushovian, tradhëtinë e udhëheqjes sovjetike, shkatërrimin e socializmit nga ana e tyre. U duhet thënë ushtarëve sovjetikë se kur ishte gjallë Stalini ata shkuan si çlirimtarë në Çekoslllovakë, kurse tani që në krye të tyre kanë ardhur tradhëtarët antistalinistë, këta vijnë si okupatorë në Çekoslllovakë. Një punë e tillë është e mirë dhe e domosdoshme të bëhet, por mendojmë se nuk do të jetë e mjaftueshme, në rast se forcat okupuese nuk do të goditen me armë dhe nuk do të hidhen jashtë kufirit të Çekoslllovakisë, ndryshe ata nuk do të dalin andej.

Mbrojtja e Çekoslllovakisë, siç e keni konstatuar, bëhet nga pozita të ndryshme. Pozita jonë si dhe e çdo partie tjetër me të vërtetë marksiste-leniniste është ajo më e drejta, revolucionarja, marksiste-leninistja, që mbron lirinë, pavarësinë, sovranitetin dhe socializmin e vërtetë në Çekoslllovakë. Ajo lufton e demaskon nga rrënjët revizionistët okupatorë, me ata sovjetikë në krye, imperializmin amerikan dhe borgjezinë kapitaliste botërore, si edhe revizionistët kapitullantë çekoslllovakë, të vjetër e të rinj, tok me borgjezinë reaksionare çekosllavake.

Në krizën çekosllavake u duk qartë se imperializmi amerikan dhe borgjezia kapitaliste botërore, u lanë dorë të lirë sovjetikëve të vepronin. Ndërhyrja e tyre ishte një propagandë gazetareske, e sipërfaqshme. Marrëveshjet e fshehta sovjeto-amerikane në Kemp Dejvid dhe në Glasboro kanë ndarë zonat e influencës në mes të dy superfuqive agresore për sundimin e botës dhe kanë përcaktuar me siguri strategjinë dhe taktikën e tyre të përbashkët. Kjo ka hyrë gjerësisht në veprim nën mbulesën e «bashkëzistencës paqësore». Këtë gjë nuk e vërteton vetëm ngjarja e Çekoslllovakisë dhe nënshkrimi i një sërë traktatesh dhe marrëveshjesh në mes SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik, por e vërtetojnë të gjitha qëndrimet antirevolucionare dhe tradhëtare të udhëheqjes sovjetike në lidhje me Amerikën Latine, me sulmin e Izraelit kundër vendeve arabe, po e vërtetojnë më së miri «bashkëzistenca» aq e përzemërt dhe ndarja e zonave të influencës në mes amerikanëve dhe sovjetikëve në vendet arabe dhe në Lindjen e Mesme në përgjithësi, këtë e vërteton miqësia aq e përzemërt e Flotës VI Amerikane dhe asaj sovjetike që bashkëjetojnë në ujërat dhe në portet e Mesdheut si dy aleatë të ngushtë dhe të vërtetë që kanë të njëjtin qëllim, të mbajnë nën zgjedhë popujt e Mesdheut, t'i shfrytëzojnë ata brutalisht nga çdo pikëpamje, të shtypin me armë çdo lëvizje revolucionare të tyre.

Në luftën agresive fashiste që përgatitin të dy fuqitë e mëdha imperialiste, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik, kundër Republikës Popullore të Kinës, Republikës Popullore të Shqipërisë dhe komunizmit ndërkombëtar, përpiqen, natyrisht, që t'u imponojnë

vullnetin dhe politikën e tyre të gjithë pjesëtarëve respektivë të Paktit të NATO-s dhe të Traktatit të Varshavës dhe në rast pamundësie këto do t'ua imponojnë me forcën e armëve dhe me presione të tjera. Këto dy shtete agresore imperialiste duan t'i kenë të qeta dhe nën vartësinë e tyre absolute të gjitha «prapavijat» e tyre botërore. A do t'ia arrijnë një gjëje të tillë? Koha do ta vërtetojë këtë, por për një kohë të gjatë kjo s'do të jetë e mundur, sepse kontraktat në gjirin e tyre do të veprojnë dhe do të thellohen.

Klika revizioniste e Beogradit është treguar aktive në mbrojtjen e revizionistëve çekoslllovakë dhe ka kundërshtuar okupimin e Çekoslllovakisë... Tani Titua është vënë përpara alternativave të rënda. Brenda në vendin e tij gjendja është rrëmuje dhe në këtë gjendje rrëmuje, degjenerimi politik, ideologjik, nacionalist, atij i duhet të riorganizojë mbrojtjen e vendit, se tani nuk mund të llogaritë më në ndihmën e Kadarëve e Dubčekëve me shokë. Sot Jugosllavia gjendet e rrethuar nga revizionistët sovjetikë, të cilët diktojnë çdo gjë me forcën e armëve mbi satelitët e tyre të Traktatit të Varshavës.

Prandaj udhëheqjes jugosllave, sikundër deklaruan zyrtarisht vetë, u ka dalë si detyrë urgjente çështja e mbrojtjes së kufijve veriorë dhe lindorë të tyre... Organizimi i mbrojtjes jugosllave kundër çdo tentative invadimi të Jugosllavisë nga ana e sovjetikëve, janë për ne në favor... Këto koniunktura ne duhet t'i ndjekim me kujdesin më të madh.

Është fakt se kërcënimi i kufijve të shtetit jugosllav nga ana e revizionistëve sovjetikë po bëhet më i dukshëm. Në rast se vërtetohet edhe invadimi i Rumanisë nga ana e sovjetikëve, atëherë kërcënimi për Jugosllavinë shtohet. Sidoqoftë invadohet ose hyn në «mënyrë paqësore» Rumania nën diktatin e Moskës, asgjë nuk e ndryshon kërcënimin e Jugosllavisë. Këtij kërcënimi mund t'i bëjë ballë vetëm rezistenca e popullit jugosllav, në rast se reziston me armë...

Përveç kësaj, politikisht, por edhe nga ana strategjike, Jugosllavia për NATO-n edhe pa qenë në të, në planet e saj strategjike konsiderohej si një pjesë e hapësirës mbrojtëse të NATO-s. Ky kufi tani rrezikohet dhe ka mundësi që dispozitat luftarake, strategjike, ofensive dhe të mbrojtjes së NATO-s për sektorin jugosllav, grek, të Mesdheut dhe të Adriatikut, të preçizohen më shumë.

Këtu del çështja e përhershme e mbrojtjes së atdheut tonë. Ne vazhdimisht kemi qenë të rrethuar gjeografikisht me armiqtë të egër, të pabesë, agresorë, fashistë dhe mbrojtja e atdheut tonë është parashikuar dhe ndërtuar që t'u bëjë ballë në çdo kohë, çdo agresori, ose grupi agresorësh. Një mbrojtje e tillë duhet të

forcohet në kulm, për arsytet e shtimit të kërcënimit që përmenda më lart. Ne duhet të mbajmë kurdoherë parasysh kontradiktat në mes fqinjve tanë në lidhje me Shqipërinë, kontradikta që veprojnë jo njëloj në koniunktura të ndryshme dhe kur pri-shet ekuilibri i forcave në një sektor të caktuar, ose në shumë sektore të botës.

Prandaj ne duhet të jemi plotësisht të gatshëm, vazhdimisht shumë vigjilentë, të ndjekim me kujdesin më të madh ngjarjet dhe të bëjmë deduksione sa më ekzakte për mbrojtjen tonë të gjithanshme nga të katër anët e kufijve, qoftë nga toka, qoftë nga deti, qoftë dhe nga ajri. Llogaritë e mbrojtjes sonë duhet të bëhen si kurdoherë të bazuara, kryesisht në forcat tona të armatosura, në forcën e armatosur të të gjithë popullit dhe në një luftë vendimtare dhe fitimtare deri në fund mbi të gjithë armiqtë tanë.

Në këto situata të ndërlikuara ndërkombëtare dhe veçanërisht në Evropën Qendrore, por sidomos në Ballkan, vigjilenca e popullit, e Partisë, e pushtetit dhe e qeverisë sonë, duhet të jetë në kulm. *Ne duhet të jemi të përgatitur më së miri për t'i bërë ballë çdo evenimenti, qoftë edhe të papritur. Asgjë nuk duhet të na gjejë në befasi dhe sidomos në drejtim të mbrojtjes së atdheut, së cilës duhet t'i kushtojmë edhe më shumë se çdo herë tjetër kujdesin më të madh.*

Në Parti, në popull, në ushtri, të forcojmë e të kalitim besimin e patundur në forcat tona, të ngremë në kulm patriotizmin, guximin, heroizmin në masat e gjera. Të gjitha këto duhet të lidhen ngushtë me një punë politike dhe ideologjike shumë të thellë dhe me një veprimtari praktike shumë revolucionare. Të gjithë njerëzit duhet të bëhen të ndërgjegjshëm për situatat e brendshme dhe ndërkombëtare, të jetojnë me këmbë mbi tokë dhe jo me ëndrra e supozime të kota. Çdo fjalë, çdo veprim, nga kushdo, duhet të matet dhe t'i shërbejë vetëm interesit të Partisë, të popullit, të socializmit.

Puna politike dhe ideologjike e thellë, zbatimimi me përpikëri të madhe dhe me një disiplinë të hekurt i vijës dhe i normave të Partisë, kudo do të bëjë që patriotizmi i masave të jetë i thellë e me kuptim të madh, që heroizmi i masave të mos jetë diçka individuale ose e përkohshme, por masive dhe e përhershme. Vetëm kështu zhduket nga njerëzit ndjenja e mburrjeve të sëmurura që të lënë në baltë në momente të vështira, vetëm kështu zhduket ndjenja e frikës ose e panikut. Këto të këqija e kanë burimin e tyre te një punë politike e përciptë.

Kur themi se duhet të jemi të përgatitur plotësisht, duhet ta kuptojmë këtë çështje si nga ana politike, ideologjike e ushtarake, ashtu edhe nga ana ekonomike. Punët te ne, jo vetëm që

duhet të vazhdojnë normalisht, në vijën e drejtë që na kanë caktuar Kongresi dhe Partia, por, duke qenë të ndërgjegjshëm për çdo situatë që krijohet e që sjell me vete edhe anët e mira, po edhe vështirësi të reja, ne duhet të organizojmë punën tonë akoma më mirë në çdo sektor. Asgjë nuk duhet të lëmë mangut, punën e sotme të mos e lëmë për nesër, se nesër kemi punë tjetër. Të punojmë me mend në kokë, me hov, me temp revolucionar. Të vëmë në lëvizje masat, të kemi besim në to, të kemi besim te kuadrat e rinj, të mos jemi sektarë ndaj tyre, t'i ndihmojmë, t'i korrigjojmë kur bëjnë gabime, t'u japim përgjegjësi në punë. Neve, brezit të vjetër, na bie detyra e shenjtë e Partisë ta bëjmë absolutisht drejt këtë gjë. Kur do ta bëjmë, në rast se nuk e bëjmë tani sa jemi gjallë dhe që kemi mundësi të japim ndihmën dhe eksperiencën tonë në këtë çështje jetike për Partinë?

I madh e i vogël duhet ta ndjejë veten politikisht dhe praktikisht të mobilizuar totalisht në punë për çështjen e madhe të atdheut tonë socialist. Më fort se kurrë duhet të shkëlqejë vitaliteti i çelniktë i Partisë dhe i popullit tonë; më fort se kurrë duhet të ngrihet vigjilenca revolucionare e Partisë dhe e masave ndaj çdo armiku e keqbërësi, të hapët ose të maskuar, të jashtëm dhe të brendshëm; më fort se kurrë ne duhet të punojmë që uniteti në radhët e Partisë dhe uniteti i Partisë me popullin të kaliten në kulm, nëpërmjet zbatimit të normave jetëdhënëse të Partisë dhe nëpërmjet zhvillimit të pandërprerë të luftës së klasave.

Situata e Partisë sonë, e vendit tonë, e popullit tonë, është jashtëzakonisht e fortë. Ta forcojmë këtë çdo ditë e më shumë, kjo është i tërë qëllimi i jetës sonë, kjo është detyra jonë kryesore. Prandaj armiqtë kanë thyer dhe do të thyejnë kurdoherë kokën, ne do t'i shtypim ata për vdekje në rast se tentojnë të prekin Partinë tonë, popullin tonë dhe Republikën Popullore të Shqipërisë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

«MBI DENONCIMIN E TRAKTATIT TË VARSHAVËS NGA REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË»

*Raport i mbajtur në Plenumin V të KQ të PPSH nga anëtari
i Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe Kryetar i Këshillit
të Ministrave të RPSH, shoku Mehmet Shehu*

5 shtator 1968

Shokë,

Ne dëgjuam raportin shumë të rëndësishëm të shokut Enver në lidhje me zhvillimin e ngjarjeve ndërkombëtare që kanë çuar në ndryshimin rrënjësor të karakterit të Traktatit të Varshavës dhe që e bëjnë Partinë tonë të arrijë në konkluzionin dhe në vendimin për të dalë nga ky Traktat. Gjithashtu shoku Enver trajtoi këtu perspektivën e zhvillimit të ngjarjeve ndërkombëtare, tiparet e karakteristikat më kryesore të kësaj gjendjeje dhe shpjegoi eventualitetet në zhvillimin e ngjarjeve ndërkombëtare në drejtime të ndryshme.

Unë jam plotësisht dakord me raportin që mbajti këtu shoku Enver, dhe në raportin tim do të përpiqem më tepër të shtjelloj një sërë faktesh dhe ngjarjesh konkrete, të cilat përcaktojnë qartë evolucionin që ka pësuar Traktati i Varshavës që nga koha e krijimit të tij dhe deri më sot.

Vendi ynë aderoi në Traktatin e Varshavës qysh në kohën e krijimit të tij, d.m.th. qysh në vitin 1955. Në atë situatë ishte i nevojshëm që të krijohet një koalicion i kampit socialist për të përballuar rreziqet nga agresioni imperialist dhe nga aktivizimi i revanshistëve të Gjermanisë Perëndimore. Parimet mbi të cilat u themelua Traktati i Varshavës ishin të drejta, parime të larta të marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar që u shërbenin interesave të kampit socialist dhe të secilit nga tetë vendet që merrnin pjesë në të. Por këto parime të larta që qëndronin në themel të Traktatit të Varshavës dhe ky karakter i drejtë i tij, gjatë këtyre 13 vjetëve, qëkurse u krijua ky Traktat,

kanë ndryshuar gradualisht, derisa ka ardhur në këtë pikë në të cilën po jetojmë, kur Traktati i Varshavës nuk është më një traktat paqeje, siç ishte më parë, për mbrojtjen e çështjes së socializmit dhe të revolucionit. Ky Traktat, tashmë është kthyer në një koalicion agresiv dhe në një instrument në duart e udhëheqjes revizioniste sovjetike, jo më për të përballuar një agresion eventual nga imperialistët amerikanë, me të cilët ajo ka hyrë në bashkëpunim për ndarjen e zonave të influencës e për të sunduar botën, duke synuar sidomos mposhtjen e RP të Kinës, por në një instrument agresioni dhe shtypjeje të lirisë së popujve. Ky Traktat është kthyer në një instrument në duart e udhëheqjes revizioniste sovjetike kundër vetë popujve të vendeve pjesëmarrëse në të.

Siç e dini, udhëheqja revizioniste sovjetike dhe shërbëtorët e saj, që bëjnë pjesë në Traktatin e Varshavës, e kanë përjashtuar prej kohësh «de facto» Republikën Popullore të Shqipërisë nga Traktati i Varshavës. Ky Traktat, që u krijua si kundërpeshë e NATO-s për të kundërshtuar planet agresive dhe qëllimet e bllokut imperialist të NATO-s, është kthyer në një bazë për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit sovjeto-amerikan. Kulmi i degjenerimit të Traktatit të Varshavës dhe i përmbysjes rrënjësore të karakterit origjinal të tij të drejtë arriti me kryerjen e veprimit më poshtëruës për Bashkimin Sovjetik, krimin e madh nëpërmjet agresionit të tipit fashist kundër Çekosllovakisë dhe popullit çekoslovak, të cilin, siç e dini, Partia jonë e ka dënuar.

Por qëndrimet dhe shkaqet e ndryshimit të karakterit të drejtë të Traktatit të Varshavës nga udhëheqja revizioniste sovjetike ne duhet t'i konceptojmë, në radhë të parë e mbi të gjitha, si qëndrime e shkaqe me karakter ideologjik dhe jo me karakter thjesht procedural ose organizativ. Burimi i degjenerimit të Traktatit të Varshavës është Kongresi XX i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ku Nikita Hrushovi përmbysi vijën e drejtë marksiste-leniniste të mëparshme të PK të BS të Lenin-Stalinit dhe e zëvendësoi atë me vijën revizioniste kundërrevolucionare hrushoviane.

Dihet që Traktati i Varshavës u krijua më 14 maj 1955, kurse Kongresi XX i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik u mbajt në shkurt 1956. Ne morëm pjesë në këtë Traktat me zemër të hapur, si revolucionarë të vendosur, dhe u mbështetëm në dokumentin e paraqitur, në klauzolat e tija me përmbajtje të drejtë revolucionare. Ne nuk dinim akoma se çfarë do të bënte Hrushovi në Kongresin XX.

Ju e dini mirë se si ka reaguar Partia jonë në lidhje me Kongresin XX të PK të BS. Formalisht ne e kemi aprovuar atë; por të mos marrim anën formale, po të marrim anën thelbësore

të çështjes: të gjithë e dimë se si Partia jonë nuk lejoi që të zbatoheshin në vendin tonë normat dhe parimet e Kongresit XX të PK të BS. Në një mënyrë apo në tjetrën Partia jonë i është kundërvënë Kongresit XX të PK të BS, megjithëse në atë kohë, në vitin 1956, akoma nuk e dinte se ku synonte konkretisht dhe përfundimisht Hrushovi. Partia jonë, qysh në fillim është vënë në fërkim me vijën e Kongresit XX si për çështjen e Stalinit, për çështjen e Jugosllavisë e të tjera. Ju e dini që bile, para se të mbahej Kongresi XX i PK të BS, d.m.th. disa ditë pasi u firmos Traktati i Varshavës, Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë sonë me letër, me dokument të firmosur nga shoku Enver, në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ka kundërshtuar haptas rehabilitimin ideologjik të udhëheqjes jugosllave nga udhëheqja e PK të BS.

Lufta, përpjekjet e Partisë dhe të qeverisë sonë qysh pas Kongresit XX, kur filluan të dukeshin shenjat e para të shkeljes së parimeve të drejta të këtij Traktati nga udhëheqja revizioniste sovjetike, kanë kaluar një sërë etapash.

Etapa e parë e luftës së Partisë dhe të qeverisë sonë kundër veprimeve të Hrushovit, siç thashë edhe më lart, fillon që nga viti 1955, pas nënshkrimit të Traktatit të Varshavës, në lidhje me rehabilitimin e udhëheqjes revizioniste jugosllave dhe shkon deri në qershor 1960 në Konferencën e Bukureshtit. Në këtë etapë ne kemi pasur fërkimet, rezistencën e Partisë sonë, rezistencën fillestare, herë të heshtur e herë gjysmë të hapur, por akoma nuk kishim dalë haptas kundër veprimeve të Hrushovit. Këtu hyn rezistenca jonë kundër vijës së Kongresit XX, kundërshtimi që ka bërë Partia jonë kundër rehabilitimit të udhëheqjes jugosllave, mbrojtja konkrete e vijës së Stalinit, flamurin e të cilit Partia jonë e ka mbajtur kurdoherë lart e kurrë nuk e ka lëshuar atë, lufta që ka bërë Partia jonë kundër ndërhyrjes së udhëheqjes jugosllave për të përmbysur gjendjen në Partinë dhe në shtetin tonë me anën e Konferencës së Partisë të Tiranës, në prill të vitit 1956, ndërhyrje që ka pasur edhe mbështetjen e udhëheqjes hrushoviane të BS. Të gjitha këto janë fakte që kanë çuar gradualisht, por në rritje, në acarimin e marrëdhënieve tona me udhëheqjen revizioniste sovjetike, dhe që kanë çuar, nga ana tjetër, që udhëheqja sovjetike ta ashpërsonte akoma më tepër qëndrimin e saj kundër nesh në kuadrin e Traktatit të Varshavës. Në kundërshtim me Kongresin XX, Partia jonë ka ruajtur dhe ka forcuar normat leniniste në Partinë dhe në shtetin tonë. Më vonë, ju i dini përpjekjet e hapura që ka pasur Partia jonë, Byroja Politike dhe shoku Enver me udhëheqjen e Hrushovit në lidhje me Konferencën e Partisë të Tiranës, në lidhje me çështjen e Liri Gegës,

si dhe më pas për çështjen e Panajot Plakut. Të gjitha këto e ashpërsuan dhe vazhdonin ta ashpërsnin akoma më shumë fërkimin midis nesh dhe udhëheqjes revizioniste sovjetike.

Veç kësaj, Partia dhe qeveria jonë në atë kohë, në atë etapë fillestare për të cilën po flasim, nuk ka ndenjur pa vepruar edhe në kuadrin e Traktatit të Varshavës. Partia jonë ka nuhatur qëllimet e këqija të udhëheqjes së Hrushovit për të shkelur normat e Traktatit të Varshavës dhe qysh në fillim ka bërë rezistencë, aq sa i lejohej në ato momente dhe në ato rrethana, për të mbrojtur zbatimin e klauzolave të drejta të Traktatit të Varshavës, në mënyrë që ky Traktat të ruante karakterin e tij të vërtetë si një mjet mbrojtës, si dhe për ushtrimin e funksioneve tona si të barabartë.

Dihet se hrushovianët qysh në vitin 1956, menjëherë pas Kongresit XX, bile disa ditë pas mbarimit të kongresit, kur akoma delegacioni ynë ndodhej në Moskë, organizuan mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, ku menjëherë na shtruan çështjen për të shkurtuar, pa asnjë kuptim, strukturën organizative të ushtrisë sonë, për ta zvogëluar atë dhe për ta kthyer ushtrinë tonë nga një ushtri efektive në ato rrethana, në një ushtri vetëm simbolike. Revizionistët hrushovianë u përpoqën ta argumentonin këtë me faktin që, meqenëse Shqipëria ishte anëtare e Traktatit të Varshavës, po t'i vinte ndonjë rrezik asaj, gjoja kishte kush ta mbronte. Mirëpo një gjë e tillë ishte e rrezikshme për mbrojtjen e vendit tonë, sepse ishte çarmatim i përgjithshëm i Shqipërisë që rrethohej nga armiq.

Kundërshtimet të gjitha këtyre përpjekjeve të hrushovianëve Partia dhe qeveria jonë kanë bërë çmos që ta ruanin dhe ta forconin fuqinë mbrojtëse në atë shkallë që të ishte e aftë për të mbrojtur vendin. Që në atë kohë u duk se udhëheqja revizioniste sovjetike në krijimin e Traktatit të Varshavës kishte prapamendime. Klauzolat e drejta, nenet e drejta ishin vënë nga ana e tyre në këtë Traktat vetëm për demagogji, vetëm sa për të hedhur hi syve, si një maskë, ndërsa në realitet qëllimet e tyre ishin për t'i kthyer në figurante dhe vasale të vërteta vendet pjesëtare të Traktatit të Varshavës. Mbledhjet e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, ose çdo mbledhje tjetër me karakter ushtarak, ishin bërë me të vërtetë të neveritshme, mbledhje sa për formë, sa për të aprovuar atë që diktohej nga udhëheqja sovjetike.

Në bazë të marrëveshjeve të përfunduara midis shteteve pjesëtare të Traktatit të Varshavës, Ministrat e Mbrojtjes të këtyre vendeve duhej të ishin zëvendëskomandantë të përgjithshëm të Traktatit të Varshavës, si rrjedhim edhe Ministri ynë i Mbrojtjes duhej të ishte zëvendëskomandant i përgjithshëm. Kurse ko-

mandant i përgjithshëm i Traktatit të Varshavës ka qenë kurdoherë një zëvendësministër i mbrojtjes i Bashkimit Sovjetik. Kështu, Konjevi ka qenë zëvendësministër i mbrojtjes së Bashkimit Sovjetik, po ashtu Greçko e me radhë, ndërsa të ashtuquajturit «zëvendëskomandantë» kanë pasur vetëm «hapsat e kashtë», d.m.th. askush nuk i ka pyetur këta, jo vetëm përsa i përket Shqipërisë, por edhe përsa u përket pjesëtarëve të tjerë. Shkelje flagrante e brutale të tilla janë bërë edhe në drejtim të Shtabit të Përgjithshëm të Traktatit të Varshavës, që kurdoherë ka qenë dhe është në duart e oficerëve sovjetikë, të cilët kanë komanduar e diktuar. Pra, duke filluar që pas Kongresit XX, u dukën këto shenja që ishin flagrante, por aq sa mund t'i kuptonim ne, kundrejt të cilave kemi bërë atë rezistencë, që mund të bëhej në atë kohë.

Pastaj, pas këtyre ngjarjeve që përmenda më sipër, Partisë dhe qeverisë sonë i tërhoqi vëmendjen takimi që pati Hrushovi me Venizellosin, para vitit 1960 ose aty afër, ku Hrushovi bëri premtimet e njohura, që i dimë të gjithë, për zgjidhjen e çështjes së «Vorio Epirit», dhe u angazhua para Venizellosit se «do të ushtronte influencën e tij» d.m.th. presionin e tij mbi udhëheqjen tonë për këtë çështje, por që s'mundi ta bënte dot një gjë të tillë, sepse mori përgjigjen e merituar që në orvatjen e tij të parë.

Por të gjitha këto ngjarje dhe rrethana i çuan marrëdhëniet tona në një ashpërsim të mëtejshëm, qoftë lidhur me çështjet ideopolitike të vijës së përgjithshme marksiste-leniniste, qoftë për zbatimin e neneve të Traktatit të Varshavës. Udhëheqja jonë, Byroja Politike, nën drejtimin e shokut Enver dhe me iniciativën e tij, kishin mundur të kuptonin deri diku se po shkeleshin parimet marksiste-leniniste dhe dispozitat e Traktatit të Varshavës dhe ne bënim rezistencë në atë shkallë që na e lejonte gjendja e krijuar në atë kohë.

Fërkimet që pati Partia dhe qeveria jonë në kuadrin e Traktatit të Varshavës me udhëheqjen revizioniste sovjetike filluan të shpërthejnë hapur, të buçasin në etapën tjetër, në *etapën e dytë*, që mund të themi se fillon nga Konferenca e Bukureshtit e qershorit 1960 e deri në gusht të vitit 1961, kur ne «de facto» na përjashtuan fare nga Traktati i Varshavës. Në këtë etapë përfshihen një sërë ngjarjesh dhe evenimentesh të rëndësishme.

Deri në Konferencën e Bukureshtit rezistenca, përpjekjet, lufta që kishim bërë ne kishte mbetur midis nesh dhe Hrushovit, d.m.th. me shkëmbim letrash, me debate që kemi bërë në mbledhje të përbashkëta etj. Dihet mirë lufta e ashpër që u bë midis delegacionit tonë dhe udhëheqjes hrushoviane kur vajtëm në Moskë si delegacion zyrtar në vitin 1957. Por në vitin 1960 Partia jonë e pa se nuk mund të qëndronim më tej në këtë kuadër të

luftës që i bënim udhëheqjes revizioniste sovjetike për zbatimin e parimeve marksiste-leniniste dhe kundër shkeljeve të tyre në kurrizin tonë, të Partisë sonë, të popullit tonë dhe të kampit socialist. Nuk mund të qëndrohej më, por duhej të dilej hapur. Atëhere Partia jonë doli, kundërsulmoi në mënyrë marksiste në Konferencën e Bukureshtit.

Siç e dimë të gjithë, kjo e tërhoqi Nikita Hrushovin, sepse ai nuk e priste që e vërteta t'i thuhej hapur, mendonte se këto fërkime që ne kishim pasur me të mund të kishin qenë vetëm për çështjen e Jugosllavisë dhe ndoshta për nostalgji për çështjen e Stalinit. Por pas Konferencës së Bukureshtit, udhëheqja revizioniste sovjetike u hodh në sulm të përgjithshëm për të përmbysur udhëheqjen këtu te ne, saqë vuri Liri Belishovën dhe të tjerë njerëz rreth e përçark saj për të përçarë udhëheqjen tonë, kështu që gjendja e marrëdhënieve tona vazhdoi të acarohet akoma më tej.

Pas Konferencës së Bukureshtit, vjen Mbledhja e Partive Komuniste e Punëtores që u mbajt në Moskë, ku Partia jonë, siç e dini, doli haptas me raportin historik që mbajti shoku Enver në emër të Komitetit Qendror të Partisë, raport i cili do të mbetet me të vërtetë një monument i pavdekshëm në historinë e Partisë sonë dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Kur ne dënuam haptas udhëheqjen revizioniste sovjetike me emër, ajo u tërbua akoma më shumë, saqë në Mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, të mbajtur në mars 1961, disa muaj pas mbledhjes së Moskës, Hrushovi iu shmang rendit të ditës për të cilën ishte thirrur mbledhja, i tërbuar akoma më tepër nga ajo që në këtë mbledhje nuk asistoi as shoku Enver as unë (dhe përse nuk vajtëm ne të dy në atë mbledhje arsyet dihen), atëhere ai shkeli rendin e ditës të kësaj mbledhjeje, mobilizoi të gjithë gardën e tij revizioniste, Gomulken me shokë, u hodh në sulm të hapur kundër Partisë dhe qeverisë sonë. Kjo mbledhje shënoi, si të thuash, një pikënisje për dënimin e hapur nga ana e tyre, të vendit tonë në kuadrin e Traktatit të Varshavës, për të na përjashtuar «de facto» nga Traktati i Varshavës.

Pas kësaj mbledhjeje që i acaroi akoma më shumë marrëdhëniet dhe Shqipëria praktikisht konsiderohej si «e izoluar», d.m.th. e përjashtuar nga Traktati i Varshavës, ju e dini luftën që është bërë midis nesh dhe qeverisë sovjetike për çështjen e bazës së Vlorës. Në bazë të marrëveshjeve të përfunduara midis qeverisë sonë dhe qeverisë sovjetike, ne pranuan krijimin e bazës së përbashkët ushtarako-detare në Vlorë. Por; sipas këtyre marrëveshjeve, baza detare e Vlorës varej nga Ministria jonë e Mbrojtjes, nga qeveria jonë, nga këto organe i merrte urdherat.

e jo nga qeveria sovjetike, dhe të gjitha mjetet detare të të gjitha llojeve konsideroheshin dhe ishin pronë e Republikës Popullore të Shqipërisë. Sovjetikët, pas mbledhjes së Moskës, sidomos në muajt prill-maj 1961, kur në bazën e Vlorës situata u acarua në kulm, u përpoqën me të gjitha mënyrat që të krijojnë edhe pretekste me anë provokacionesh të ndryshme. U bënë me qindra provokacione kundrejt oficerëve dhe ushtarëve tanë që të krijohej një pretekst, ndoshta edhe për ndërhyrje ushtarake, për ta mbajtur këtë «gozhdë» këtu në vendin tonë, bazën e Vlorës. Ata donin që të komandonin, por ne nuk i lejonim, sepse në bazë të marrëveshjeve ishim ne zotër të kësaj baze ushtarako-detare e jo ata dhe çështja shkoi deri në atë shkallë, sa që ata provokonin vazhdimisht për të na tërhequr në kurthin e tyre. Por është meritë e udhëheqjes sonë, e Byrosë Politike, e shokut Enver, e shokëve të ushtrisë në mbajtjen e gjakftohësisë, të korrektesës dhe të vendosmërisë për të qëndruar deri në fund, për të mos lejuar shkeljen e të drejtave të atdheut tonë në bazën ushtarako-detare të Vlorës. Më në fund këta armiq hrushovianë u shporrën, duke na grabitur, siç e dini, edhe 8 nëndetëse dhe shumë mjete të tjera detare, ndërsa ne mbajtëm ato që mbajtëm. Ata thonë se ne u kemi grabitur atyre mjetet, ndërsa në të vërtetë juridikisht ata na kanë grabitur neve nëndetëset dhe mjetet e tjera detare.

Pas kësaj, pasi u shporrën nga baza e Vlorës, u organizua ajo mbledhja e famshme e gushtit 1961, ku ata kërkuan me insistim të shkonte shoku Enver, të shkoja edhe unë si kryetar i qeverisë, d.m.th. të ishte mbledhje e nivelit të lartë. Byroja Politike e KQ të Partisë sonë nuk e pa të arsyeshme që të shkonim ne të dy në Moskë në atë rast, për arsyet që dihen. Shkuan shokë të tjerë në këtë mbledhje, që ishte kulmi i veprimit të padrejtë të udhëheqjes hrushoviane për ta përjashtuar «de facto» Shqipërinë nga Traktati i Varshavës. Ata padrejtësisht refuzuan ta pranonin delegacionin tonë në këtë mbledhje të Komitetit Politik Konsultativ të gushtit 1961.

Traktati i Varshavës përcakton se në Mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ marrin pjesë «të deleguar» të vendeve pjesëmarrëse dhe nuk thotë shprehimisht se të deleguar konsiderohen vetëm Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë dhe Kryetari i Këshillit të Ministrave; kështu që ne ishim krejtësisht në rregull në caktimin e delegacionit, i cili përbëhej nga shoku Ramiz Alia, shoku Behar Shtylla etj., por ata e bojkotuan atë. Kur shokët tanë, në hapjen e mbledhjes thanë: «Ne jemi përfaqësuesit e Partisë dhe të qeverisë shqiptare dhe nuk luajmë që këtu», atëhere Hrushovi u detyrua të shpërndante mbledhjen. Ai dhe revizionistët e tjerë dolën përjashta dhe në sallë mbetën

vetëm shokët tanë. Ky ishte pra përjashtimi «de facto» i Shqipërisë nga Traktati i Varshavës.

Shikoni, pra, se deri në ç'shikallë kishte arritur qëndrimi i udhëheqjes revizioniste sovjetike hrushoviane ndaj vendit tonë në Traktatin e Varshavës, d.m.th. ne jo vetëm që nuk luanim asnjë rol, përse i përket barazisë në këtë Traktat, por ne ishim në kushte diskriminuese për të vetmen arsye se kundërshtonim veprimet antimarksiste të udhëheqjes hrushoviane. Të gjitha këto qëndrime që ka mbajtur Hrushovi dhe klika e tij në këto mbledhje të Traktatit të Varshavës, në çështjen e bazës së Vlorës, në organizimin e bllokadës etj., e kanë burimin te rezistenca e Partisë sonë kundër vijës tradhëtare të Kongresit XX.

Më pas, Hrushovi, duke vazhduar rrugën e tij armiqësore kundër Partisë dhe popullit shqiptar, tërhoqi gjithë specialistët sovjetikë nga Shqipëria, dëboi studentët tanë nga Bashkimi Sovjetik, prishi të gjitha marrëveshjet ekonomike, ndërpreu dhënien e kredive që ishin parashikuar, organizoi bllokadën ekonomike dhe më në fund dëboi edhe përfaqësuesin e ushtrisë sonë që ishte pranë Shtabit të Përgjithshëm të Traktatit të Varshavës, shokun Halim Ramohito. Atëhere ç'i mbeti Shqipërisë në Traktatin e Varshavës? Dhe të gjitha këto që përmenda më lart ndodhën në vitin 1961, 7 vjet si sot.

Përveç këtyre që përmenda, kemi edhe komplotin e madh famëkeq të armiqve tanë të jashtëm, ku përzihej edhe udhëheqja hrushoviane sovjetike, komplot që u zbulua me procesin e Teme Sejkos, ku doli në shesh edhe qëllimi i tyre për të përmbysur udhëheqjen e Partisë e të shtetit tonë. Hrushovi e kishte parë që në Konferencën e Bukureshtit, por sidomos në Konferencën e Moskës, që udhëheqja jonë ishte armike e betuar e tij dhe u përpoq me të gjitha mënyrat për ta likuiduar atë edhe fizikisht ose për ta përmbysur me anën e kompleteve e të gjitha mënyrat, por nuk mundi.

Së fundi, vjen etapa tjetër, *etapa e tretë*, që përfaqëson luftën e Partisë dhe të qeverisë sonë kundër veprimeve armiqësore të udhëheqjes sovjetike pas Mbledhjes së Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës në gusht të vitit 1961, d.m.th. pas këtyre ngjarjeve kur praktikisht na përjashtuan nga Traktati i Varshavës. Kjo etapë fillon me thirrjen e Hrushovit për kundërrivolucion në Shqipëri në tetor 1961 në Kongresin XXII të PK të BS dhe që shoqërohej me akuzën e turpshme dhe shpifëse të Hrushovit kundër udhëheqjes sonë si «agjente e imperializmit» dhe, më së fundi, në dhjetor të vitit 1961, Bashkimi Sovjetik i preu edhe marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë socialiste, duke përzënë ambasadorin dhe gjithë personelin e ambasadës sonë

nga Moska dhe duke tërhequr njëkohësisht ambasadorin dhe gjithë personelin e ambasadës së tyre nga Tirana.

Duke filluar që nga viti 1961, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë nuk është pyetur dhe nuk është ftuar kurrë për të marrë pjesë në mbledhjet e shumta që janë bërë në kuadrin e Traktatit të Varshavës dhe asnjëherë nuk është vënë në dijeni nga pjesëmarrësit në këto mbledhje mbi vendimet që janë marrë atje. Për të gjitha këto vendime dhe veprime, të cilat janë në kundërshtim flagrant me dispozitat e Traktatit të Varshavës dhe në përgjithësi në kundërshtim me interesat e Republikës Popullore të Shqipërisë, të socializmit e të paqes, Republika Popullore e Shqipërisë nuk mban asnjë përgjegjësi.

Në këtë kuadër hyn edhe shtyrja e firmosjes së traktatit të paqes me Gjermaninë. Kur ne ishim akoma pjesëtarë të Traktatit të Varshavës kishim vendosur bashkërisht që traktati i paqes me Gjermaninë të firmosej brenda vitit 1961 me të dy shtetet gjermane ose me Gjermaninë Lindore dhe, mbi këtë bazë, të zgjidhej edhe çështja e Berlinit Perëndimor. Këtë vendim Hrushovi e shtyu pa na pyetur e pa na njoftuar, në mënyrë të njëanshme dhe arbitrare. Ne, nga ana jonë, protestuam për këtë veprim të Hrushovit dhe kemi bërë luftën tonë duke mbajtur qëndrim parimor mbi këtë çështje, që njihet nga ju të gjithë.

Më vonë, në vitin 1963, udhëheqja revizioniste sovjetike përfundoi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Anglinë traktatin famëkeq të Moskës mbi ndalimin e pjesshëm të provave të armëve bërthamore dhe tash së fundi, para pak muajsh, revizionistët sovjetikë nënshkruan me imperialistët amerikanë edhe traktatin mbi mospërhapjen e armëve bërthamore. Të dy këto traktate janë përfunduar pa pjesëmarrjen tonë dhe pa pyetur fare Qeverinë e Republikës Popullore të Shqipërisë.

Qeveria jonë i ka dënuar këto dy traktate si një komplot të ri kundërrevolucionar amerikan-sovjetik kundër interesave të popujve dhe që janë në kundërshtim flagrant me frymën dhe dispozitat e Traktatit të Varshavës.

Këto dy traktate drejtohen në radhë të parë, kundër Republikës Popullore të Kinës, për të «frenuar» e «bllokuar» Kinën Popullore, e cila është bërë pengesa kryesore për qëllimet kundër-revolucionare të aleancës sovjeto-amerikane, për qëllimet e tyre për ndarjen dhe sundimin e botës.

Nga ana e udhëheqjes sovjetike janë bërë edhe shumë pazarllëqe të tjera me NATO-n, siç janë p.sh. përpjekjet për arritjen e një marrëveshjeje për një «pakt mossulmimi» midis Traktatit të Varshavës dhe NATO-s etj.

Me pak fjalë, duke filluar që nga viti 1961 ne nuk jemi ftuar

kurrë dhe as që jemi vënë në dijeni për mbledhjet e vendimet e marrura në kuadrin e Traktatit të Varshavës dhe nuk mbajmë asnjë përgjegjësi për të gjitha vendimet dhe veprimet e tyre.

Siç e shikoni, qysh atëhere ne kemi pasur të drejtën juridike e morale që të dilnim nga Traktati i Varshavës, ta denonconim atë. Udhëheqja jonë, Byroja Politike e KQ të Partisë e ka diskutuar disa herë këtë çështje dhe ka arritur në konkluzionin se ne kishim plotësisht të drejtë që të dilnim qysh atëhere nga Traktati i Varshavës. Dhe ja, tani pas agresionit të tipit fashist kundër Çekosllovakisë, të cilin e shpjegoi shumë mirë dhe në mënyrë të plotë shoku Enver, Byroja Politike e KQ të Partisë mendon, siç e tha edhe shoku Enver, se tani është momenti më i përshtatshëm që ne të dalim «de jure» nga Traktati i Varshavës dhe ta denoncojmë atë.

Partia dhe qeveria jonë, përveç luftës ideologjike që kanë bërë kundër vijës antimarksiste të revizionistëve sovjetikë dhe satelitëve të tyre, kanë luftuar edhe në terrenin konkret politik e vazhdimisht, dhe për këtë flasin qartë dokumentet e Partisë dhe të qeverisë sonë.

Ne nuk kemi qëndruar indiferentë dhe duarkryq kundër këtyre veprimeve armiqësore të revizionistëve hrushovianë; jo vetëm gjatë kohës që ishim brenda Traktatit të Varshavës si anëtarë efektivë, por edhe pasi na përjashtuan «de facto» që nga gushti i 1961-së, qeveria jonë ka ndërhyrë, ka ngritur zërin kundër këtyre veprimeve armiqësore të udhëheqjes revizioniste sovjetike e satelitëve të saj të Traktatit të Varshavës.

Kështu, që në notën e 5 shkurtit 1962 të qeverisë sonë, pasi i hidhen Hrushovit dhe udhëheqjes sovjetike të gjitha në fytyrë, theksohet midis të tjerave se «... çdo mbledhje e Traktatit të Varshavës e bërë pa ftuar edhe Qeverinë e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe çdo vendim i marrur në një mbledhje të tillë janë të paligjshme dhe jodetyruese, se në kushte të tilla të shkeljes brutale të drejtave të një shteti anëtar, vetë Traktati i Varshavës mbetet pa fuqi vepruese, gjë për të cilën janë përgjegjëse qeveritë e shteteve të tjera pjesëmarrëse në këtë Traktat».

Në notën e qeverisë sonë të 14 marsit 1963, drejtuar të gjitha qeverive të vendeve pjesëmarrëse të Traktatit të Varshavës, thuhet ndër të tjera: «... qeveria sovjetike e kryesuar nga N. Hrushovi dhe pas saj qeveritë e shteteve të tjera pjesëmarrëse ka kohë që jo vetëm nuk e zbatojnë Traktatin e Varshavës në lidhje me Republikën Popullore të Shqipërisë, por e kanë shkelur plotësisht këtë Traktat».

Në letrën që qeveria jonë i drejtoi Mbledhjes së Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës në janar të vitit 1965, ndër të tjera thuhet: «... shteteve të tjera anëtare u bie

përgjegjësi e posaçme që kanë lejuar qeverinë sovjetike të kryesuar nga Nikita Hrushovi të kryejë veprime jashtëzakonisht armiqësore ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë, shtet socialist dhe anëtar efektiv i barabartë i Traktatit të Varshavës».

Ka edhe dokumente të tjera, por unë citova vetëm disa nga më kryesoret. Dokumenti i fundit është, siç e dini, Deklarata e rëndësishme e Komitetit Qendror të Partisë sonë dhe e Këshillit të Ministrave e kohëve të fundit në lidhje me agresionin e tipit fashist të revizionistëve sovjetikë dhe të satelitëve të tyre, katër shteteve të tjera, kundër Çekosllovakisë.

Agresioni i Traktatit të Varshavës, d.m.th. i Ushtrisë Sovjetike dhe i ushtrive të katër shteteve të tjera pjesëtare të Traktatit të Varshavës kundër Çekosllovakisë është kulmi i degjenerimit të Traktatit të Varshavës... Ne e dënuam këtë agresion, si një agresion të tipit fashist, bile të pabesë, sepse në mbledhjen e Bratislavës revizionistët e Traktatit të Varshavës u puthën me revizionistët çekosllovakë dhe të nesërmen të 5 vendet e Traktatit të Varshavës i futën thikën befasisht popullit çekosllovak. Qëndrimi që mbajtëm ne duke dënuar agresionin sovjetik në Çekosllovakë është i vetmi qëndrim i drejtë.

Tashti ka ardhur koha që ne ta denoncojmë Traktatin e Varshavës e të dalim ligjërisht nga ky Traktat, kurse «de facto» ne jemi përjashtuar me kohë, na kanë përjashtuar revizionistët, nga ky Traktat. Por, për ta denoncuar nga ana ligjore Traktatin e Varshavës, duhet të mblidhet edhe Kuvendi Popullor.

Ne e kemi bërë detyrën tonë si revolucionarë. Partia dhe qeveria jonë kanë luftuar në kuadrin e Traktatit të Varshavës për t'u respektuar parimet që qëndronin në themel të këtij Traktati, por ka qenë e pamundur t'ia arrinim qëllimit, e kjo jo për fajin tonë. Kështu, detyrën tonë ne e kemi bërë. Tashti justifikohet plotësisht përpara gjithë botës dalja jonë nga Traktati i Varshavës edhe «de jure», do ta bëjmë edhe këtë.

Natyrisht, dalja nga Traktati i Varshavës ne nuk na do bëson, në të kundërtën, ne forcojmë pozitat tona juridike ndërkombëtare për mbrojtjen tonë, nuk i lëmë në dorë asnjë element justifikues udhëheqjes revizioniste sovjetike për ndërhyrje ushtarake kundër vendit tonë në asnjë rrethanë... Në këtë mënyrë, pozita jonë juridike forcohet dhe përse i përket mbrojtjes reale konkrete me forcat e armatosura dhe popullin e armatosur të vendit tonë.

Dalja jonë nga Traktati i Varshavës, nuk sjell asnjë ndryshim në planin tonë operativ e strategjik për mbrojtjen e vendit tonë nga ndonjë agresion i jashtëm. Përse? Sepse Byroja Politike dhe Këshilli i Mbrojtjes e kanë parashikuar situatën me kohë, që nga Konferenca e Moskës dhe bile përpara Konferencës së Moskës,

që nga Konferenca e Bukureshtit, se revizionistët hrushovianë janë armiq të tërbuar dhe prej tyre ne nuk mund të presim asgjë të mirë veç së keqes, bile edhe agresion të armatosur kundër vendit tonë. Ne sot jemi në gjendje të mbrohemi nga çdo agresion i jashtëm, qoftë nga Traktati i Varshavës, qoftë nga NATO, ngado që të vijë agresioni dhe kushdo qoftë agresori... Kështu që në planet tona operative e strategjike të mbrojtjes, dalja jonë nga Traktati i Varshavës nuk çënon asgjë, por natyrisht këtu del detyra jonë që ta forcojmë më tej e vazhdimisht mbrojtjen tonë, ashtu siç e tha shoku Enver.

Përse i përket anës ekonomike, siç e dini, me Bashkimin Sovjetik ne nuk kemi asnjë marrëdhënie ekonomike, ata i kanë prerë me kohë këto marrëdhënie. Kështu që ne sot kemi marrëdhënie ekonomike mbi bazën e kleringut me vendet e tjera të Traktatit të Varshavës, por jo me Bashkimin Sovjetik. Me daljen tonë nga Traktati i Varshavës ne mendojmë se këto vende (Rumania, Polonia, Bullgaria, Hungaria, RD Gjermane) do të vazhdojnë të mbajnë marrëdhënie tregëtare me ne. Por edhe sikur të marrim parasysht që disa nga këto vende do t'i presin fare marrëdhëniet ekonomike me vendin tonë, ne mendojmë, shokë, se jemi në gjendje që me fuqinë tonë ekonomike ta përballojmë këtë situatë, sepse ato mallra që eksportojmë ne në këto vende janë mallra krejtësisht të vlefshme për të gjithë tregun ndërkombëtar...

Të gjitha këto ndryshime, zhvillimi i këtyre ngjarjeve tregojnë forcën e vitalitetin e Partisë dhe të popullit tonë dhe drejtësinë e vijës së Partisë sonë; dhe ne krenohemi se ato që ka parashikuar vija jonë, vija e Partisë sonë janë realizuar. Në lëmin e zhvillimit të ngjarjeve në gjendjen ndërkombëtare dhe në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare janë vërtetuar të gjitha parashikimet e Partisë sonë. Partia jonë e ka parashikuar këtë evolucion, këtë zhvillim të ngjarjeve në këtë mënyrë dhe koha na ka dhënë të drejtë kurdoherë. Shumë rreziqe kemi kaluar, imagjinoni pak, shokë, se ç'do të ndodhte sikur udhëheqja jonë, të kishte qenë miope në lidhje me Traktatin e Varshavës. Merrni një çështje të vogël, një nga këto që u thanë këtu, çështjen e bazës së Vlorës. Sikur ne të mos kishim qenë të qartë politikisht dhe ideologjikisht mbi qëllimet armiqësore të N. Hrushovit, një gabim që mund të ishte bërë në këtë drejtim, do të ishte sot bomba në gjirin e atdheut tonë, do të ishte baza për pushtimin ushtarak të Shqipërisë. Partia jonë s'ka bërë asnjë gabim në këtë drejtim, duke parashikuar me kohë rreziqet. Kjo është një meritë e madhe e udhëheqjes së Partisë sonë, por në radhë të parë është merita e shokut Enver në parashikimin me kohë të rreziqeve, të situatave e të koniunkturave që do të krijoheshin dhe në parapregatitjen për

çdo situatë e në të gjitha drejtimet si politikisht, ekonomiskisht e ushtarakisht për të përballuar situatat që parashikohesh të dilnin. Prandaj ne duhet të jemi krenarë për veprimtarinë e Partisë dhe të popullit tonë.

Ne dalim nga Traktati i Varshavës si revolucionarë, me ballë hapur. Dhe, me këtë rast, prestigji i atdheut tonë, i Partisë sonë, i pushtetit tonë dhe i popullit tonë rritet një mijë herë më shumë, sepse s'ka ndodhur në asnjë traktat në botë, as në Traktatin e Varshavës dhe as në ndonjë traktat tjetër borgjez, që të dalë nga traktati një shtet i vogël, t'ua përplasë në fytyrë të vërtetën pjesëtarëve të tjerë dhe të dalë jashtë botërisht, pa pasur frikë nga kurrkush. Shqipëria këtë po e bën dhe tashti ne dalim nga Traktati i Varshavës me ndërjegje e vendosmëri, dhe situatën e shikojmë e duhet ta shikojmë me optimizëm, ashtu siç e vlerësoi shoku Enver.

Situata nuk do të mbetet në vend, ajo do të zhvillohet me baticë e me zhaticë, por në përgjithësi do të zhvillohet në favorin e revolucionit. Edhe në Bashkimin Sovjetik do të ketë zhvillime, por çfarëdo zhvillime qofshin këto, edhe ndërrimi i «gardës», ik njëri e hajde tjetri, prapë edhe kjo do të çojë akoma më tej në thellimin e krizës së tyre, drejt varrit po shkojnë dhe atje do të shkojnë revizionistët patjetër.

Rruga jonë është e gjatë, ajo është një luftë klasore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, ne i kemi marrë parasysh këto qysh atë ditë që Partia jonë, vendosi të dalë haptas në luftë ballë për ballë, në sheshin e luftës kundër revizionizmit botëror me Hrushovin në krye, dhe tani, me daljen nga Traktati i Varshavës, ne futemi në një etapë tjetër, në etapën kur jemi jashtë Traktatit të Varshavës, kur jemi haptas edhe juridikisht kundër Traktatit të Varshavës, sikurse kemi qenë dhe jemi kundër bllokut të NATO-s. Prandaj tani na dalin detyra të reja, ashtu siç tha shoku Enver.

Në këto kushte, ne duhet dhe do t'i përballojmë me gjakftohtësi e guxim vështirësitë që mund të lindin për ne në gjendjen ndërkombëtare. Ne duhet që daljen nga Traktati i Varshavës ta pasojmë me një shpërthim të përgjithshëm e të mëtejshëm të hovit revolucionar të Partisë, popullit, pushtetit, të organizatave të masave në të dy drejtimet, si në drejtim të kazmës ashtu edhe në drejtim të pushkës. Ne duhet të punojmë akoma më shumë për realizimin e detyrave ekonomike; ne kemi pasur suksese të mëdha sidomos këta dy vjetët e fundit në industri, bujqësi dhe në të gjithë sektorët e tjerë, por duhet të punojmë akoma më shumë tashti për të forcuar akoma më tepër ekonominë tonë popullore, për ngritjen e nivelit të jetesës. Të kuptojmë mirë se jemi në rrethim, po ndërtoj-

më socializmin duke u mbështetur në forcat tona, jemi duke hedhur vallen në gojën e ujkut, prandaj nuk na lejohet, ashtu siç tha shoku Enver, që punën e sotme ta lëmë për nesër, se nesër kemi për të pasur punë të tjera dhe ato që marrim angazhim, ato që themi se do t'i bëjmë, duhet t'i bëjmë me të vërtetë, t'i kthejmë fjalët tona në vepra. Prandaj duhet të shumëfishojmë forcat tona, energjitë tona për të punuar më me hov për realizimin e planeve të shtetit, për rritjen më tej të forcave prodhuese e për të përsosur marrëdhëniet socialiste në prodhim.

Nga ana tjetër, duhet medoemos të forcojmë akoma më shumë edhe mbrojtjen e vendit, të punojmë edhe më tepër, duke përgatitur ushtarakisht gjithë popullin për mbrojtjen e atdheut, duke e kthyer Shqipërinë socialiste në një kala akoma më të pamposhtur edhe në aspektin ushtarak...

Ne kemi bindjen se dalja jonë nga Traktati i Varshavës do të rritë akoma më tepër entuziazmin e popullit tonë, të Partisë sonë dhe do t'i hedhë masat punonjëse dhe komunistët e kuadrot në një hov të mëtejshëm revolucionar për zbatimin e të gjitha detyrave, qoftë në lidhje me ndërtimin ekonomik, qoftë edhe në lidhje me forcimin e mëtejshëm të mbrojtjes së atdheut tonë dhe kjo do t'i rritë, natyrisht, edhe në shkallë ndërkombëtare, prestigjin dhe pozitën ndërkombëtare të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI DENONCIMIN E TRAKTATIT TË VARSHAVËS NGA REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË»

5 shtator 1968

Plenumi V i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e tij të datës 5 shtator 1968, pasi shqyrtoi dhe diskutoi raportin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, «Mbi gjendjen aktuale ndërkombëtare», si dhe raportin e anëtarit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH, shokut Mehmet Shehu, «Mbi denoncimin e Traktatit të Varshavës nga Republika Popullore e Shqipërisë»,

V e n d o s i :

1. — Të aprovojë plotësisht raportin «Mbi gjendjen aktuale ndërkombëtare» mbajtur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, si dhe raportin «Mbi denoncimin e Traktatit të Varshavës nga Republika Popullore e Shqipërisë», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH, shoku Mehmet Shehu.

2. — Të aprovojë propozimin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH për denoncimin e Traktatit të Varshavës nga ana e Republikës Popullore të Shqipërisë.

3. — T'i rekomandojë Presidiumit të Kuvendit Popullor që të thërrisë sesionin e Kuvendit Popullor për shqyrtimin dhe aprovimin e projektligjit mbi denoncimin e Traktatit të Varshavës.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PLENUMI VI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 27-28 shtator 1968

K O M U N I K A T Ë

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 27 dhe 28 shtator 1968, nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbajt mbledhja e Plenumit VI të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Plenumi i Komitetit Qendror dëgjoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi thellimin e revolucionit socialist nëpërmjet zhvillimit të luftës klasore dhe zbatimit të vijës së masave», paraqitur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Ramiz Alia.

Pasi diskutoi mbi çështjen e mësipërme, Plenumi i Komitetit Qendror aprovoi njëzëri raportin e paraqitur dhe mori vendimin përkatës.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

R A P O R T

I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI THELLIMIN E REVOLUCIONIT SOCIALIST NËPËRMJET ZHVILLIMIT TË LUFTËS KLASORE DHE ZBATIMIT TË VIJËS SË MASAVE»

27 shtator 1968

Shokë,

Në të katër anët e atdheut, në Jug e në Veri, në fshatra e në qytete, Partia ka ngritur peshë në këmbë komunistët dhe gjithë popullin në luftë të vendosur për ta çuar gjithnjë e më përpara revolucionin socialist dhe për t'i mbyllur shtigjet çdo mundësie për lindjen e revizionizmit dhe restaurimin e kapitalizmit.

«Vetëm po të analizojmë kohën që nga mbajtja e Kongresit V e deri tani, thotë shoku Enver, ne vërejmë ç'hov të madh të paparë revolucionar ka krijuar Partia, ç'energji kolosale janë hedhur në luftë, sa rezerva të mëdha janë dukur dhe sa të tjera flenë akoma. Ç'heroizëm masiv është krijuar dhe sa me vrull aksionet ndjekin aksionet. Është krijuar kudo një optimizëm i madh, një gëzim nga puna edhe nga lodhja që nuk shkon kot, ka një etje të madhe për të mësuar, për t'u korrigjuar, për t'u spastruar nga të këqijat e së kaluarës. Kjo është një shkundje e të këqijave në masë dhe ky është spastrimi më rrënjësor, më me bazë, pse kjo kalon nga ndërgjegjia individuale në ndërgjegjen kolektive»¹.

Atmosfera revolucionare që sundon në mbarë vendin, fryma e aksionit dhe ndërgjegjia e lartë në punë që karakterizojnë gjithë njerëzit tanë dhe që mishërohet në veprat e tyre he-

roi, tregojnë se në zhvillimin e revolucionit tonë po kryhet një hop i ri cilësor, se revolucioni socialist po thellohet dhe ka hyrë tani në një fazë të re më të lartë.

Kjo fazë e re karakterizohet nga një sulm frontal kundër të gjitha «njollave» të shoqërisë së vjetër feudalo-borgjeze: në ekonomi e në politikë, në ideologji e në kulturë, në zakonet e në jetën e popullit. Këto «njolla», që janë trashëguar nga re-ndi i vjetër, mbi gërmadhat e të cilit ndërtohet shoqëria e re socialiste, që kushtëzohen nga shkalla e pjekurisë socialo-ekonomike të socializmit dhe që mbahen gjallë e ushqehen nga bota e vjetër kapitaliste e revizioniste që na rrethon, jo vetëm që pengojnë marshimin tonë përpara, por në qoftë se kundër tyre nuk bëhet një luftë e vendosur e këmbëngulëse, ato përmbajnë në vetëvete rrezikun e madh të kthimit prapa drejt kapitalizmit.

Lufta e madhe që po bën Partia jonë, në krye të klasës punëtore dhe masave punonjëse, për revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit, ka për qëllim të afirmojë kudo parimet dhe normat socialiste proletare, të sigurojë zhvillimin e pandërprerë të revolucionit socialist në të gjitha fushat e jetës.

Këtë luftë Partia jonë nuk po e fillon sot. Kjo luftë ka filluar bashkë me lindjen e Partisë dhe ka ardhur duke u rritur e duke u forcuar vazhdimisht. Sot rrethanat kërkojnë dhe kushtet janë krijuar për të ndërmarrë një sulm në front të gjerë kundër të gjitha mbeturinave të së kaluarës dhe shfaqjeve të huaja, për çrrënjosjen e tyre nga jeta e shoqërisë sonë.

Revolucioni socialist është një revolucion i pandërprerë. Ai nuk mbaron as me marrjen e pushtetit dhe as me ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit. Gjithë procesi i ndërtimit të socializmit e të komunizmit është proces i zhvillimit e i thellimit të revolucionit proletar në fushat: politike, ekonomike e ideologjike. Ndërprerja e luftës revolucionare, ndalimi i revolucionit në mes të rrugës, është fatale për fatet e socializmit. Çështja është se gjatë gjithë periudhës së kalimit nga kapitalizmi në komunizëm vazhdon lufta e klasave, vazhdon lufta midis dy rrugëve: socialiste e kapitaliste. Kjo është kontradikta themelore e gjithë kësaj periudhe.

Eksperiencia e asaj që ndodhi në Bashkimin Sovjetik e gjetkë, ku revizionistët, pasi usurpuan udhëheqjen e partisë dhe të shtetit, i hapën rrugën rivendosjes së kapitalizmit, tregoi se rreziku nuk vjen vetëm nga klasat shfrytëzuese e mbeturinat e tyre, nga kundërrevolucioni i tyre me dhunë, as vetëm nga imperializmi i jashtëm, nga agresioni i tij i armatosur, por vjen edhe nga degjenerimi borgjezo-revizionist, që e ka bazën pikërisht në «njollat» e shoqërisë së vjetër kapitaliste që ruhen akoma në socializëm.

¹ Enver Hoxha, Raporte e fjalime 1967-1968, f. 327.

Duke përgjithësuar eksperiencën e revolucionit tonë si dhe të revolucionit botëror, me të mirat e të këqijat e tyre, Partia me shokun Enver në krye, kanë nxjerrë mësimet e konkluzione të mëdha teorike e praktike, që hapin rrugë të reja për të çuar përpara revolucionin tonë fitimtar dhe përbëjnë një kontribut me vlerë në pasurimin e eksperiencës historike të diktaturës së proletariatit.

Të gjitha këto mësimet e konkluzione janë shprehur në një sërë dokumentesh të rëndësishme të Komitetit Qendror të Partisë dhe, në mënyrë të veçantë, në shumë fjalime programatike të shokut Enver. Mbi bazën e tyre këta vjetët e fundit janë marrë një varg masash dhe kanë shpërthyer një zinxhir inisiativash, të cilat në kompleksin e tyre formojnë atë që ne quajmë revolucionarizim të jetës së vendit.

Ku synojnë këto masa e inisiativa?

Së pari, ato synojnë të revolucionarizojnë njerëzit, ndërgjegjen dhe botëkuptimin e tyre, t'i armatosin ata me ideologjinë e klasës punëtore. Kjo është e lidhur me faktin që njeriu është faktori vendimtar në çdo punë e në çdo sektor dhe karakteri e drejtimi i veprimtarisë së tij varet drejtpërdrejt nga ç'ide udhëhiqet e për ç'qëllime punon e lufton ai në jetë. Njerëzit bëjnë revolucionin, njerëzit bëjnë edhe kundërrevolucionin. Këtë del se të revolucionarizosh jetën e vendit, para së gjithash e mbi të gjitha, do të thotë të revolucionarizosh njerëzit. Prandaj dhe në themel të gjithë procesit të revolucionarizimit qëndron thellimi i revolucionit ideologjik, lufta për edukimin klasor revolucionar të punonjësve, e cila, sidomos pas fitores së revolucionit në fushën politike dhe ekonomike, del në plan të parë dhe merr një rëndësi të veçantë. Këtij qëllimi i shërbejnë intensifikimi i luftës kundër ideologjisë borgjeze e mikroborgjeze, feudale e patriarkale, kundër zakoneve prapanike dhe besimeve e paragjykimeve fetare, revolucionarizimi i shkollës, i letërsisë e i artit, i gjithë frontit ideologjik e kultural.

Së dyti, ato synojnë ta spastrojnë superstrukturën tonë nga çdo gjë e vjetër dhe e huaj që nuk përputhet me bazën ekonomike të socializmit që ne kemi ndërtuar, ta përsosin e ta revolucionarizojnë atë, me qëllim që ajo t'i shërbejë më mirë dhe në mënyrë më efektive bazës socialiste dhe gjithë zhvillimit të vendit në rrugën e socializmit e të komunizmit. Në këtë çështje Partia ka parasysh tezën marksiste se superstruktura nuk është thjesht një produkt pasiv i bazës ekonomike, por një forcë e madhe krijuese, roli i së cilës, sidomos në socializëm, është vendimtar.

Është një e vërtetë e pakundërshtueshme e materializmit

historik se superstruktura përcaktohet nga baza. Por është gjithashtu një e vërtetë e provuar nga jeta se degjenerimi i superstrukturës socialiste, i partisë dhe i diktaturës së proletariatit, i frontit ideologjik e kultural, çon në ndryshimin e karakterit të gjithë rendit shoqëroro-ekonomik. Degjenerimi borgjez i socializmit në Bashkimin Sovjetik e gjetkë filloi pikërisht nga degjenerimi i superstrukturës. Prandaj mbrojtja e karakterit klasor proletar dhe revolucionarizimi i vazhdueshëm i superstrukturës përbëjnë një ndër detyrat themelore për të çuar përpara revolucionin në të gjitha fushat. Këtij qëllimi i shërbejnë masat e marrura kundër shfaqjeve të burokratizmit e për forcimin e diktaturës së proletariatit, për rritjen e rolit udhëheqës dhe revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë, për zgjerimin e të gjitha formave të demokracisë proletare e rritjen e kontrollit të klasës punëtore e masave punonjëse, për revolucionarizimin e ushtrisë e rritjen e fuqisë mbrojtëse të vendit, për forcimin e organizatave të masave e rritjen e rolit të tyre në sistemin e diktaturës së proletariatit etj. etj.

Së treti, ato synojnë të përsosin më tej marrëdhëniet shoqërore socialiste dhe sidomos marrëdhëniet ekonomike në rrugë të drejtë revolucionare, me qëllim që këto të sigurojnë jo vetëm një zhvillim të mëtejshëm të forcave prodhuese, por edhe të konsolidojnë parimet e socializmit dhe të ngrenë ndërgjegjen socialiste të njerëzve, duke i vënë ata në kushte të tilla socialo-ekonomike që të edukohen e të kaliten si revolucionarë konsekuentë. Në qoftë se lihet pasdore aspekti social e ideologjik dhe shihet vetëm leverdia ekonomike në ndryshimet që bëhen në marrëdhëniet në prodhim, kjo shpie në shkallimin e ndërgjegjes revolucionare të kuadrove e të punonjësve dhe në minimin e gjithë rendit socialist. Pikërisht këtu qëndron thelbi kundërrevolucionar i të gjitha reformave ekonomike të revizionistëve, sepse në bazë të tyre qëndron parimi tregëtar kapitalist i fitimit, i leverdisë, i stimulit material, të cilin ata e kanë shndërruar në motivin e vetëm të punës dhe të jetës së njerëzve. Përsosjes së mëtejshme në rrugë revolucionare të marrëdhënieve në prodhim i shërbejnë masat që ka marrë Partia për likuidimin e mbeturinave të pronës private, për shkurtimin e oborreve kooperativiste, për zvogëlimin e diferencave midis pagave të larta dhe të ulëta, për t'i dhënë epërsi stimulit moral në punë, për vendosjen e marrëdhënieve të drejta midis kuadrove dhe masave, për zgjerimin e sistemit të punës me norma kolektive etj. etj.

Së katërti, ato synojnë që mbi bazën e revolucionarizimit të njerëzve, e forcimit të superstrukturës dhe të përsosjes së marrëdhënieve në prodhim t'i jepet një shtytje e re prodhimit,

zhvillimit të forcave prodhuese, revolucionit tekniko-shkencor, me qëllim që të rritet fuqia ekonomike e mbrojtëse e vendit dhe të ngrihet gradualisht niveli i jetesës së popullit. Faktet flasin qartë se kurrë ndonjëherë më mirë se këta dy-tre vjetët e fundit nuk janë realizuar planet e shtetit si në industri, në bujqësi, apo arsim e kulturë. Klasa jonë punëtore, e cila qëndron në ballë të luftës për revolucionarizimin e jetës së vendit, në shumë sektorë të rëndësishëm të prodhimit, që sivjet po arrin treguesit e planifikuar për vitin 1970. Ajo, bashkë me inteligjencien e prodhimit, duke iu përveshur revolucionit tekniko-shkencor, me forcat e veta, po projektton, prodhon dhe ndërton jo vetëm linja e reparte të reja, por edhe fabrika e uzina të mëdha e të ndërlikuara, siç është uzina e përpunimit të naftës që u ngrit në Fier. Fshatarësia kooperativiste po lufton për rendimente të larta. Sivjet, me gjithë kushtet jo të favorshme klimaterike, plani i prodhimit të grurit, jo vetëm u realizua, por edhe u tejkalua. Disa rrethe si Kruja, Mati, Durrësi, Lushnja etj. iu afruan ose i arritën edhe rendimentet e planifikuara për vitin 1970. Me entuziazëm të madh po punohet për të plotësuar detyrën e Partisë dhe të qeverisë që brenda vitit 1971 në të gjitha fshatrat të shkojë drita elektrike. Aksionet e masave si ato të rinisë për ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë-Fier dhe të rrugës së Malësisë së Madhe, që janë në përfundim e sipër, aksioni për ndërtimin e banesave me punë vullnetare, aksionet e shumta lokale për hapje tokash të reja apo kanalesh ujitëse etj., shprehin gjithashtu hovin e madh krijues që karakterizon masat tona punonjëse.

Procesi i revolucionarizimit ka përfshirë të gjitha fushat e jetës, të gjithë punonjësit, të gjithë sektorët e krahinat e vendit. Ky proces po zhvillohet te ne në mënyrë të organizuar e nën drejtimin e Partisë, duke zbatuar gjerësisht vijën e masave, duke u mbështetur në masat dhe duke i tërhequr ato aktivisht në zhvillimin dhe në drejtimin e tij. Për zhvillimin e këtij procesi Partia po përdor metoda aktive revolucionare, duke kombinuar drejt orientimet nga lart me inisiativat e lëvizjet revolucionare të masave nga poshtë.

Përvoja e fituar në zhvillimin e revolucionit tonë është përvoja e një vendi ku procesi i konsolidimit dhe i forcimit të diktaturës së proletariatit është bërë dhe bëhet në mënyrë të pandalshme e konsekuente, ku Partia nëpërmjet zhvillimit të vendosur të luftës klasore i ka shpartalluar gjithë armiqtë me vendosmëri, duke mos u dhënë kurrë atyre mundësi ta kthejnë procesin revolucionar prapa, drejt kundërrevolucionit borgjez dhe rivendosjes së kapitalizmit, por as edhe t'i vënë në rrezik seriozisht, qoftë edhe për një periudhë të caktuar, dik-

taturën e proletariatit, fatet e socializmit. Kjo përvojë e Partisë sonë është prova më e shkëlqyer e vijës së saj të drejtë marksiste-leniniste, e udhëheqjes revolucionare dhe largpamëse të Komitetit të saj Qendror, me shokun Enver Hoxha në krye.

Hapi ynë në revolucion është i pandalshëm. Besimi ynë në fitoren përfundimtare është i pathyeshëm. Por në asnjë mënyrë nuk duhet të dehemi nga sukseset dhe të na rritet mendja, sepse edhe ne nuk jemi të imunizuar nga rreziku i revizionizmit dhe i rivendosjes së kapitalizmit për sa kohë ekziston ndikimi i ideologjisë borgjeze, i «njollave» të shoqërisë së vjetër dhe presioni e kërcënimi imperialisto-revizionist. Prandaj detyra jonë është të mbajmë gjithmonë të mprehtë tehun e shpatës sonë të luftës klasore, të jemi kurdoherë në sulm kundër të gjithë armiqtë të klasës dhe të gjitha formave të ideologjisë së klasave shfrytëzuese, të forcojmë vazhdimisht rendin tonë socialist dhe të çojmë përpara me guxim procesin e revolucionarizimit.

Revolucionarizimi i jetës së vendit përbën thelbin e tërë luftës e punës së Partisë, të klasës punëtore e të masave punonjëse, ai ka të bëjë me rrugën e zhvillimit të vendit drejt ndërtimit të plotë të socializmit e të komunizmit. Si i tillë ky problem nuk mund të zërthehet në të gjitha aspektet e me hollësi në një mbledhje të vetme të plenumit. Për këtë nuk është as nevoja, sepse Partia e ka përcaktuar qartë vijën e saj në të gjitha fushat e për të gjitha çështjet. Prandaj në këtë plenum do të ndalemi vetëm në disa probleme të para kryesisht në aspektin politik e ideologjik dhe që Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë mendon se kanë sot rëndësi të dorës së parë për thellimin e mëtejshëm të revolucionit tonë socialist.

*
*
*

Procesi i revolucionarizimit të jetës së vendit është një proces lufte, që ndesh dhe nuk mund të mos ndeshë në rezistencën e forcave, traditave, zakoneve, ideologjisë e moralit të shoqërisë së vjetër kapitaliste që ne po varrosim. Në këtë luftë ne duhet ta përqëndrojmë zjarrin kundër atyre të këqijave që janë më të rrezikshme dhe që na pengojnë më shumë dhe konkretisht: kundër burokratizmit dhe shfaqjeve të tija në formën e teknokratizmit e intelektualizmit, kundër tërheqjes pas interesit personal dhe kundër konservatorizmit. Këto janë pengesat kryesore në rrugën tonë revolucionare, me to ne ndeshemi kudo, në çdo hap të jetës e në të gjitha fushat e veprimtarisë.

Luftën kundër këtyre të këqijave duhet ta shohim si një aspekt themelor të luftës së klasave, sepse të gjitha ato janë reflekse të mënyrës borgjeze të të menduarit e të vepruarit, janë reflekse të ideologjisë e të praktikës së klasave shfrytëzuese, të papajtueshme me teorinë dhe me praktikën e socializmit shkencor proletar. Siç tregon eksperiencia e tragjedisë revizioniste që ndodhi në Bashkimin Sovjetik e gjetkë, të këqijat që përmendëm më lart, janë ato që të tërheqin prapa, që i hapin rrugën degjenerimit borgjez e revizionist të socializmit. Prandaj thellimi i mëtejshëm i revolucionit socialist është i pandarë nga lufta kundër tyre dhe rruga më e drejtë për ta bërë këtë luftë është ndjekja me konsekuencë e vijës së masave.

1. — Të luftojmë më me vendosmëri kundër burokratizmit, duke përfeksionuar vazhdimisht marrëdhëniet midis kadrove dhe masave

Një nga çështjet kardinale të luftës së Partisë për revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit është thellimi i luftës kundër burokratizmit. Partia dhe shoku Enver vazhdimisht kanë tërhequr vëmendjen e komunistëve dhe të gjithë punonjësve për rrezikun që paraqet burokratizmi për fatet e socializmit, si koncept dhe metodë drejtimi e huaj për socializmin, si koncept borgjez kundërrevolucionar dhe metodë pune e diktaturës së klasave shfrytëzuese.

Partia jonë, që nga themelimi i saj dhe sidomos nga çlirimi i vendit e këtej, ka punuar e ka luftuar për t'i ruajtur pushtetin popullor dhe organet e Partisë nga rreziku i burokratizmit të tyre. Kjo është edhe një nga arsyet që te ne nuk kaloi revizionizmi, nuk degjeneruan diktatura e proletariatit dhe Partia.

Në mënyrë të veçantë burokratizmit i është dhënë e po i jepet një goditje e fuqishme dhe e gjithanshme këta vjetët e fundit. Detyrat dhe masat konkrete në këtë drejtim janë përcaktuar në shumë dokumente të Partisë dhe fjalime të shokut Enver. Në këto dokumente e materiale historike Partia ka zbuluar rrënjët objektive e subjektive të shfaqjes dhe të zhvillimit të burokratizmit, ka treguar karakterin e tij klasor dhe ka përcaktuar rrugët e drejta për çrrënjosjen e tij.

Duke u bazuar në këto dokumente e materiale, organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike, si dhe organizatat e masave kanë bërë një punë të madhe dhe kanë arritur mjaft rezultate të mira, të cilat kanë forcuar diktaturën e proletariatit, karakterin demokratik të pushtetit tonë popullor,

lidhjet e Partisë e të pushtetit me masat, unitetin Parti-klasë-popull.

Në këtë punë të madhe Partia ka grumbulluar një eksperiencë të pasur, e cila duhet të na shërbejë për ta çuar akoma më përpara luftën kundër burokratizmit. Ne jemi të ndërgjegjshëm, dhe Partia këtë e ka theksuar gjithnjë, se lufta kundër burokratizmit, si një nga aspektet më të rëndësishme të luftës së klasave, është një luftë e ndërlikuar dhe e shumanshme ideologjike dhe politike, ekonomike dhe organizative, kulturele dhe administrative, një luftë e gjatë që do të vazhdojë aq kohë, sa do të vazhdojë lufta e klasave, aq kohë sa do të ekzistojë vetë shteti proletar.

Prandaj, me gjithë rezultatet e arritura, nuk ka vend për asnjë ndjenjë vetëkënaqësie për të menduar se tani gjithçka është në rregull dhe mund të flemë të qetë. Ne duhet të na tërheqë seriozisht vëmendjen vërejtja, kritika e shokut Enver në fjalën «Kontrolli i klasës punëtore», ku ai thotë:

«Për luftën kundër burokracisë, të cilën Partia e ka ngritur me forcë, flitet shumë, po kuptohet për lumë. Pikërisht, në një kohë kur flitet dhe thuhet se është kuptuar lufta kundër burokratizmit, në parim dhe në praktikë shkohet duke e forcuar burokratizmin nga ana e aparateve shtetërore, dikastereve etj. dhe, si pa të keq, kjo gjë aprovohet edhe nga komitetet e Partisë në rrethe»¹.

Moskuptimi i drejtë i luftës kundër burokratizmit e ka burimin të mosthellimi sa duhet në mësimet e marksizëm-leninizmit, në idetë e Partisë dhe të shokut Enver për këtë çështje, të trajtimi i kësaj lufte si një fushatë e përkohshme dhe jo si një detyrë e përhershme, për të cilën duhet luftuar çdo ditë, çdo orë, vazhdimisht, sa herë që vihen re dhe kudo që vihen re shfaqje burokratike, të kuptimi i ngushtë i luftës kundër burokratizmit si një çështje shkresash e organikash, si një çështje thjesht teknike e organizative.

Thelbin e luftës kundër burokratizmit e përbën vendosja e marrëdhënieve të drejta midis kadrove dhe masave. Në qoftë se këto marrëdhënie nuk vihen dhe nuk përsosen vazhdimisht mbi baza të drejta socialiste, lind në mënyrë të pashmangshme rreziku i burokratizimit dhe i degjenerimit të kadrove, të cilët nga shërbëtorë të popullit gradualisht shndërrohen në një shtresë e klasë të re borgjeze, që ndjek një politikë borgjeze, që e përdor pushtetin për ta vënë veten në një pozitë të privilegjuar e për të sunduar mbi popullin. Kështu

1 Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 405.

midis saj dhe masave krijohen marrëdhënie shtypjeje e shfrytëzimi, prona shoqërore humbet gradualisht karakterin e saj socialist dhe shndërrohet në një pronë të tipit kapitalist shtetëror. Pikërisht kështu ndodhi në Jugosllavi, në Bashkimin Sovjetik dhe në të gjitha vendet e tjera ku kanë ardhur në fuqi revizionistët.

F. Engelsi, duke përgjithësuar eksperiencën e Komunës së Parisit, ka thënë se

«...klasa punëtore, për të mbrojtur e konsoliduar fitoren e saj, duhet jo vetëm të shkatërrojë nga themelet aparatin e shtetit të vjetër borgjez, por njëkohësisht të sigurojë edhe veten nga deputetët dhe nëpunësit e vet, duke marrë masat e nevojshme që shteti, organet dhe njerëzit e tij të mos shndërrohen në zotër e sundimtarë mbi popullin»¹.

Është një meritë e madhe e Partisë sonë, e cila duke i vlerësuar si duhet kuadrot, ka treguar dhe tregon kujdesin më të madh për ta, për t'i ruajtur të pastër e revolucionarë, për t'i edukuar e kalitur ata vazhdimisht, për t'i lidhur gjithnjë e më ngushtë me masat. Te ne në fuqi është klasa punëtore, diktatura e proletariatit, në udhëheqje është Partia jonë marksiste-leniniste, midis kuadrove dhe masave nuk ka kontradikta antagonistike.

Por në qoftë se ne nuk luftojmë seriozisht kundër burokratizmit dhe shfaqjeve të tija, në qoftë se nuk u presim rrugën me vendosmëri qëndrimeve krejt të huaja të disa kuadrove në marrëdhëniet e tyre me masat, lindja e kontradiktave antagonistike midis tyre është e pashmangshme. Prandaj Partia është e papajtueshme dhe dënon me rreptësi rastet kur ndonjë kuadër sillet si padron dhe me mospërfillje me masat, mbyl kritikën e tyre, orvatet të frenojë inisiativën dhe vetëveprimin e masave.

Kuadrot e molepsur nga burokratizmi nuk kanë besim te masat, te forca dhe ndërgjegjia e tyre, prandaj marrëdhëniet me masat përpiqen t'i ndërtojnë si nëpunësit e vjetër, mbi baza krejt zyrtare e burokratike, duke u mbështetur kryesisht në masat administrative. Tipik është rasti i kryesisë së kooperativës bujqësore të Poshnjës në rrethin e Beratit, e cila, «për të disiplinuar» marrëdhëniet e punonjësve në kooperativë ka hartuar një kod të brendshëm me 13 nene, ku për çdo gjë parashikohen sanksione të ndryshme, që nga prerja e ditëve të punës e deri te gjobitja e nënave që nuk dërgojnë fëmijët në çerdhe!

Kuptimi i cekët i luftës kundër burokratizmit bën që edhe

direktivat e Partisë e ligjet e shtetit, format e organizimit dhe të drejtimit, të cilat frymëzohen nga qëllimi i lartë për t'u shërbyer masave dhe për ndërtimin e socializmit, të kuptohen dhe të zbatohen në mënyrë burokratike, duke shtrembëruar kështu vetë thelbin e tyre. Këto veprime të burokratëve, si rregull, bëhen nën flamurin gjoja të zbatimit të direktivave të Partisë dhe të mbrojtjes së ligjeve të shtetit; ata e identifikojnë veten me klasën, me pushtetin, me Partinë. Me këtë shpjegohet fakti që veprimet burokratike shpesh janë të pakapshme dhe burokratët të padukshëm. Kjo e bën rrezikun e burokratizmit edhe më serioz.

Direktiva parimore e Partisë mbi kontrollin e klasës punëtore dhe format e organizimit për ushtrimin e tij u shtrembërua nga burokratët në një mënyrë të tillë, sa që komisionet e kontrollit punëtor u shndërruan në fakt në organe të kontrollit të administratave mbi punëtorët. E njëjta gjë ndodhi edhe me këshillat teknike, të cilat u veshën me fuqi të atilla, sa për shumë çështje zëvendësuan rolin e organizatës së Partisë dhe të kolektivit. Një shtrembërim i tillë i direktivave të Partisë vihet re edhe lidhur me rolin e mbledhjeve të prodhimit në ndërmarrjet ekonomike. Në fakt, në shumë raste këto mbledhje, të cilat janë krijuar me qëllim që klasa punëtore të thotë fjalën e saj për të gjitha çështjet e veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjes, janë shndërruar, në emër të drejtimit unik, në mbledhje ku disa drejtorë vetëm kërkojnë llogari e shtrojnë detyra, nuk dëgjojnë zërin e masave dhe spostojnë rolin e bashkimeve profesionale.

Shfaqje të shtrembërimeve të direktivave të Partisë dhe të ligjeve të shtetit duken edhe në fusha të tjera. Inisiativa për ndërtimin e banesave me punë vullnetare është pritur me entuziazëm nga të gjithë punonjësit dhe deri tani është bërë një punë e madhe për kryerjen me sukses të këtij aksioni të rëndësishëm. Por kjo lëvizje u nxori telashe burokratëve, sepse ajo nuk përputhet me konceptet dhe me metodën e tyre të punës burokratike. Prandaj, nga njëra anë ata nxjerrin një mori pengesash që e frenojnë këtë lëvizje, ndërsa, nga ana tjetër, vihen re shfaqje për ta zgjidhur këtë problem në rrugë burokratike, duke shtrembëruar edhe thelbin e direktivës së Partisë. Në disa raste u vendos që punëtorët, pa përjashtim, të punonin në ndërmarrjet e tyre ose edhe në ndërmarrje të tjera 1-2 orë në ditë mbi 8-orëshin për të krijuar kështu fonde suplementare për ndërtimin e banesave të reja. Në ndonjë rast tjetër u vendos që çdo punëtor të paguante nga 10-20 lekë të rinj në muaj si kontribut për sigurimin e rrogës së shokëve që dërgoheshin me punë të përhershme për ndërtimin e banesa-

¹ Shih: K. Marks e F. Engels. Vepra të zgjedhura, vëll. I. f. 453-454.

ve. Këto «inisiativa» çuan edhe në allishverishe të tilla si ai që ndodhi në Fier, ku drejtori i SMT-së, duke e konsideruar veten si pronar të mjeteve të shtetit, vendosi t'i japë kryetarit të kooperativës së Darzës për nevojat e kooperativës një traktor, ndërsa ky i fundit t'i dërgonte, sikur të ishin bujqit e tij, 20 kooperativistë që do të punonin për ndërtimin e banesave të traktoristëve. Thonë se këto veprime janë aprovuar nga kolektivat. Megjithëse kjo është e pabesueshme, prapë autorët e këtyre veprimeve nuk mund të justifikohen, sepse është e qartë se këtu janë marrë nëpër këmbë të drejtat e punonjësve dhe rregullat e ligjet e shtetit. Mbi këtë bazë lindin dhe nuk mund të mos lindin kontradikta dhe fërkime midis kuadrove dhe masave.

Me gjithë përmirësimet e arritura në përpunimin e një metode dhe stili revolucionar në punën e organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, të bazuar në vijën e masave, ekziston akoma kontradikta midis vijës së drejtë të Partisë për luftën kundër burokratizmit dhe metodës konkrete të punës për vënien në jetë të kësaj vije. Shfaqjet burokratike në metodën e punës shpien në vetë shtrembërimin e vijës së drejtë. Prandaj ne duhet të ndalemi seriozisht në këtë kontradiktë. Çelësin për ta kapërcyer këtë kontradiktë, për të përpunuar një metodë të drejtë, duhet ta kërkojmë në vetë vijën e drejtë të Partisë, në mësimet e marksizëm-leninizmit dhe të shokut Enver.

Pikërisht nga mosthellimi si duhet në këto mësimet, ka raste, jo të rralla, të kthimit prapa drejt formave dhe metodave të dënuara e tanimë të kapërcyera, si në punën e organeve të Partisë, ashtu edhe në ato të shtetit e të ekonomisë. Dihet se një masë e rëndësishme për përmirësimin e metodës së punës ishte pakësimi i korrespondencës, i relacioneve apo i formularëve statistikorë, shkurtimi i njerëzve dhe i hallkave të tepërta në aparatet shtetërore dhe ekonomike, decentralizimi i kompetencave për t'u dhënë më shumë inisiativë organeve vartëse dhe lokale, përqëndrimi i vëmendjes në punën e gjallë me njerëzit dhe në kontrollin e zbatimit të detyrave etj. Të gjitha këto e kanë gjallëruar punën e organeve dhe të aparateve tona, i kanë bërë ato më të zhdërvjellta, kanë forcuar lidhjet e tyre me masat dhe i kanë bërë ato më të afta për kryerjen e detyrave të mëdha që kanë përpara.

Është e domosdoshme që masat e marrura në këtë drejtim të çohen deri në fund, sepse duken qartë prirja për t'u kthyer te e vjetra, te shkresat e relacionet e shumta e te organikat e fryra. Bile për këtë janë zbuluar edhe metoda «origjinale»: për të krijuar përshtypjen fiktive se numri i shkresave të hyra

e të dala është pakësuar, nuk regjistrohen të gjitha në librat e protokollit, relacionet dhe të dhënat statistikore kërkohen e dërgohen në formë «private», vendin e urdhërave të shkruar e kanë zënë ato me telefon, ndërsa për fryrjen e organikave përdoret e drejta për të marrë fuqi punëtore, ose njerëzit e tepërt paguhen jo nga qendra apo sektori ku punojnë efektivisht, por ku figurojnë formalisht në punë. Raste të tilla ka edhe në organet qendrore, si në Ministrinë e Bujqësisë apo të Tregëtisë etj. A nuk flasin këto fakte e raste se disa organizata partie e organe shtetërore luftën kundër burokratizmit e kuptojnë në mënyrë krejt formale?!

Kohët e fundit, gjoja në emër të zbatimit të vijës së masave dhe për edukimin e tyre, janë shtuar shumë mbledhjet, konsultat, konferencat, takimet etj. etj. Duhet thënë copë se mbledhjet e shumta janë fukarallëk, janë një shfaqje e burokratizmit që zëvendëson punën e gjallë me mbledhje. Mbledhjet jo vetëm shpesh janë pa bërëqet e të lodhshme, por po të ecet me ritmin që kanë filluar, bëhen të dëmshme, sepse i largojnë njerëzit nga puna prodhuese, u marrin atyre kohën e domosdoshme për pushim dhe për edukim. Duhet hedhur poshtë pikëpamja se edukimi i njerëzve bëhet vetëm nëpër mbledhje. Rruga më e drejtë për edukimin e masave është aksioni revolucionar, hedhja e masave në luftë për zgjidhjen e problemeve konkrete. Edhe lidhja e kuadrove me masat, zbatimi i vijës së masave, njohja e mendimeve të masave nuk arrihen vetëm nëpërmjet mbledhjeve të mërzitshme. Ka shumë mundësi dhe rrugë të tjera, bile shumë më efektive.

Partia, klasa punëtore dhe të gjithë punonjësit, me një heroizëm të paparë, po luftojnë për zgjidhjen me sukses të shumë detyrave të mëdha aktuale siç janë: progresi teknik dhe kooperimi, rritja e rendimenteve në bujqësi dhe përparimi i zonave malore, elektrifikimi i të gjitha fshatrave, revolucionarizimi i shkollës dhe thellimi i revolucionit ideologjik etj. Si rezultat i vijës së drejtë të Partisë kanë lindur shumë mendime dhe lëvizje revolucionare në të gjithë sektorët. Në këto kushte bëhen akoma më të padurueshme format e ngushta dhe stereotipe të punës, rutina, mungesa e inisiativës dhe shfaqje të tjera të burokratizmit, sepse ato frenojnë vulltin e madh që ka shpërthyer në masat dhe i mbyllin rrugën së resë. Në këtë drejtim duhen luftuar edhe prirjet për t'u kthyer te një centralizim i tepëruar i kompetencave që janë në kundërshtim me zhvillimin e inisiativës e të vetëveprimit të masave dhe të organeve të bazës, siç janë prirjet e disa dikastereve që, nga «frika» se mos humbasin «kontrollin», përpiqen të dinë dhe të kenë në dorë çdo gjë.

Veprimet burokratike burojnë nga konceptet burokratike, prandaj pa luftuar këto koncepte, nuk mund të luftohen shfaqjet e ndryshme të burokratizmit. Partia e ka thënë se konceptet që formojnë burokratët dhe burokratizmin janë idealiste, metafizike, antipopullore, janë konceptet e egoizmit e të individualizmit, të karrierizmit e të servilizmit, që mbivlerësojnë e absolutizojnë rolin e individëve të veçantë dhe nënvleftësojnë e mohojnë rolin e klasës e të masave. Këtej del nevoja e forcimit të punës sonë për njohjen e për përvetësimin e thellë të ideve të Partisë për luftën kundër burokratizmit dhe koncepteve që e formojnë atë, për edukimin e kuadrove me botëkuptimin marksist-leninist, që ata kudo e kurdoherë ta konsiderojnë veten si shërbëtorë të popullit, të mendojnë, të punojnë dhe të jetojnë si revolucionarë.

Lufta kundër burokratizmit nuk është vetëm luftë për të shkatërruar diçka, konceptet dhe metodat borgjeze mbi mënyrën e drejtimit të punëve, por edhe luftë për të formuar dhe për të forcuar metodën tonë marksiste-leniniste të udhëheqjes, për të edukuar komunistët e kuadrot që të punojnë e të drejtojnë me një metodë e stil të ri revolucionar. Detyra e organizatave të Partisë është që ta kuptojnë mirë këtë çështje dhe në procesin e luftës revolucionare t'i zhvillojnë në mënyrë krijuese metodën dhe stilin tonë të punës, duke i pasuruar ato vazhdimisht në mënyrë të zhdërvjellët e me guxim dhe jo në mënyrë mekanike e formale.

Rreziku i burokratizmit është një rrezik, në radhë të parë, për kuadrot. Por burokratizimi i kuadrove infekton edhe masat, sepse ai mbjell në to pasivitet dhe indiferentizëm, mendimin e gabuar se çdo gjë «e dinë ata lart» e «vendoset nga lart», kultivon në to veti morale të huaja për frymën revolucionare, si nënshtrimin e frikën, mungesën e kurajës e të guximit etj. Ne duhet të nxjerrim mësim të mëdha nga ato raste kur punonjësit e disa ndërmarrjeve nuk ngrenë zërin me forcë dhe nuk u tregojnë vendin burokratëve të bazës apo të qendrës, që shkelin vijën e Partisë e ligjet e shtetit, që marrin nëpër këmbë të drejtat e punonjësve. Kjo do të thotë se ne duhet të forcojmë punën tonë jo vetëm me kuadrot, por në radhë të parë me klasën punëtore e masat punonjëse, për të formuar në to koncepte të drejta mbi burokratizmin dhe si duhet luftuar ai, për t'i bërë të ndërgjegjshme se ato janë zotërit e vërtetë të vendit, për të edukuar në to guximin për të luftuar kundër kujtdo që largohet nga rruga e drejtë. E meta themelore është pikërisht në faktin se luftën kundër burokratizmit nuk e kanë marrë në dorë si duhet vetë masat. Prandaj në këtë drejtim duhet bërë edhe kthesa kryesore në punën tonë.

Pa e marrë në dorë vetë masat luftën kundër burokratizmit, pa i mobilizuar dhe pa i hedhur ato me tërë forcat në këtë luftë, burokratizmi jo vetëm nuk do të zhduket, por do të forcohet akoma më shumë. Lufta kundër burokratizmit vetëm nga lart, ose kryesisht nga lart, është një metodë burokratike ose gjysmëburokratike dhe me një metodë të tillë nuk mund të luftohet burokratizmi. Diskutimi i gjerë popullor që u bë pas vendimit të Byrosë Politike për luftën kundër burokratizmit, pas fjalimit të shokut Enver «Mbi revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë e të pushtetit» dhe pas fjalës së tij të fundit «Kontrolli i klasës punëtore», tregoi qartë se ç'forcë të madhe ka gjykimi revolucionar i klasës dhe i masës dhe ç'rezultate kolosale arrihen kur çështjet e luftës kundër burokratizmit bëhen të masave.

Për të bërë me sukses luftën kundër burokratizmit nuk mjafton vetëm të kesh koncepte të drejta dhe një metodë të drejtë. Për këtë është e domosdoshme që kuadrot e masat të vihen në kushte të tilla objektive, që kuadrot të mos shpëputen nga masat dhe që masat të mund të luajnë efektivisht rolin e tyre vendimtar. Si materialistë ne duhet të mos harrojmë se vetë konceptet dhe metoda e drejtë, në fund të fundit, formohen e përcaktohen nga kushtet objektive, nga marrëdhëniet reale në të cilat jetojnë e punojnë njerëzit.

Partia dhe shoku Enver kanë shpjeguar disa herë rëndësinë e madhe që kanë masa të tilla si pjesëmarrja e kuadrove drejtpërdrejt në punën prodhuese, si dhe qarkullimi sistematik i tyre për forcimin e lidhjeve të kuadrove me punonjësit. Partia ka vënë në dukje edhe vlerën e madhe ideologjike, edukative dhe politike të këtyre masave.

Si po zbatohen këto vendime? Në përgjithësi mirë. Por ka edhe shumë dobësi, të cilat tregojnë se vendimet e Partisë për këto çështje nuk janë kuptuar thellë dhe në gjerësinë e tyre. Pjesëmarrja e kuadrove drejtpërdrejt në prodhim disa herë kufizohet në kryerjen e një pune të thjeshtë fizike, në fabrika ose në arë. Por me kaq nuk u arrihet qëllimeve që synon Partia. Çështja është që kuadrot jo vetëm të punojnë, por edhe të rrojnë me punëtorët e fshatarët, të futen në botën e tyre, të marrin pjesë aktive në veprimtarinë e tyre edukative kulturalë, të kalojnë bashkë me ta kohën e lirë, me fjalë të tjera të shkrihen me jetën dhe me punën e tyre. Ndryshe direktiva e Partisë nuk zbatohet drejt dhe vihet në plan të parë forcimi i muskujve mbi forcimin e ndërgjegjes revolucionare. Nga ana tjetër, nuk është e drejtë as praktika që ndiqet në disa raste kur kuadrot që shkojnë për të bërë punën prodhuese vihen në një pozitë të privilegjuar, luajnë rolin e kontrollues-

ve dhe organizuesve të punës, ngarkohen me shumë detyra studimi e analiza, duke lënë kështu përshtypjen se kanë vajtur si një ekip pune, se sa për të punuar e për të jetuar bashkë me punëtorët e fshatarët. Kjo do të thotë se edhe në këtë rast ata e vënë veten jo në pozitën e nxënësit, por të mësuesit, që ka shkuar në bazë jo kryesisht për të mësuar nga masat, por për t'u dhënë mend atyre. Kështu nuk edukohen kuadrot, nuk kaliten ata si revolucionarë.

Kuptimet e ngushta dhe formale të direktivave të Partisë pengojnë edhe kryerjen e plotë të porosisë mbi qarkullimin e kuadrit. Po të marrim vetëm dikasteret qendrore do të shohim se mjaft ngadalë po ecin në këtë drejtim, sidomos dobët paraqiten ato me plotësimin e grafikut për këtë vit. Qarkullimi nuk po përfshin akoma kuadrot kryesorë të dikastereve. Në kundërshtim me orientimet e dhëna, disa dikastere dhe në mënyrë të veçantë Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, e Tregëtisë dhe e Industri-Minierave, të gjithë kuadrot ose shumicën e atyre që kanë lëvizur gjatë vitit 1967, i kanë mbajtur në qytetin e Tiranës. Ka edhe raste që ndonjë kuadër, pa mbushur akoma vitin që është dërguar në bazë, thirret përsëri me punë në Tiranë në dikasteret qendrore. Nga ana e tyre edhe rrethet me shumë vështirësi i japin kuadrot që u kërkohen për dikasteret qendrore, duke penguar kështu zbatimin e politikës së qarkullimit të kuadrit. Të gjitha këto kanë të bëjnë me konceptet dhe me praktikën burokratike.

Ne duhet të thellohem akoma më shumë në direktivën e shokut Enver lidhur me emërimin dhe me lëvizjen e kuadrove. Çështja është që pozita e kuadrove në punë, posti i tyre, të mos përcaktohet vetëm ose kryesisht nga lart, sepse kjo nuk mund të mos kultivojë në kuadrot tendencën karrieriste e servile ndaj epërëve dhe tendenca fodullëku e arrogancë ndaj masave. Për vendosjen e marrëdhënieve të drejta midis kuadrove dhe masave, siç ka thënë shoku Enver, rëndësi të veçantë ka që pozita e kuadrove të përcaktohet jo vetëm nga lart, por edhe nga poshtë, nga masat. Fjala është për një kombinim më të mirë të monopolit të Partisë në politikën e kuadrit me zbatimin e vijës së masave.

Qëllimi i gjithë luftës dhe i punës së Partisë është që procesi i zhvillimit socialist të vendit të mos shndërrohet në një proces burokratik, por të ruajë dhe të forcojë gjithnjë frymën dhe karakterin e tij revolucionar, ku klasa punëtore, masat punonjëse, si krijueset e historisë, të thonë fjalën e tyre dhe të luajnë rolin vendimtar që u përket. Këtu synojnë në fund të fundit të gjitha masat revolucionarizuese që ka marrë dhe që merr vazhdimisht Partia. Këtë duhet ta rrenjosim thellë

në ndërgjegjen e të gjithë kuadrove, komunistëve dhe punonjësve, në mënyrë që mësimet e Partisë të mos mbeten parulla abstrakte, por të vihen plotësisht dhe efektivisht në jetë.

Kjo kërkon që të forcohet më tej puna edukative e Partisë dhe e shtetit me masat, sepse është fakt se shkalla e pjesëmarrjes së masave në drejtimin e punëve shtetërore e shoqërore, shkalla e zgjerimit të demokracisë së masave, varet drejtpërdrejt nga shkalla e ndërgjegjes politike dhe e kulturës së tyre.

Detyra të mëdha kanë edhe organizatat e masave. Roli i tyre në sistemin e diktaturës së proletarietit është i madh. Ideja se ato janë rripa transmisioni që e lidhin Partinë me masat, nuk duhet kuptuar ngushtë, në mënyrë thjesht mekanike. Ato nuk janë dhe nuk duhet të jenë zbatuese mekanike të disa detyrave të kufizuara, por duhet të bëhen shkolla të mëdha të edukimit revolucionar të masave dhe tribuna të zërit të tyre, që krahas punës për edukimin ideopolitik të masave, t'i tërheqin këto aktivisht në drejtimin e jetës së vendit, në ushtrimin e kontrollit të tyre mbi këdo e mbi çdo gjë.

Që klasa punëtore dhe masat punonjëse të luajnë akoma më efektivisht rolin që u përket në gjithë jetën e vendit, është e nevojshme të merren edhe masa të tjera organizative e administrative. Gjatë kohëve të fundit është përmirësuar në mënyrë të dukshme puna e këshillave popullore të të gjitha instancave, është rritur kontrolli i tyre mbi organet ekzekutive, janë forcuar lidhjet e këshilltarëve dhe të deputetëve me masat e popullit etj. Po akoma ka vend për një përsosje të mëtejshme të organizimit dhe të funksionimit të këshillave popullore deri në Kuvendin Popullor. Gjatë diskutimit të fjalës së shokut Enver «Kontrolli i klasës punëtore» është ngritur problemi i kombinimit më të mirë të parimit të drejtimit unik në ndërmarrjet ekonomike me inisiativën dhe rolin e punonjësve. Në kooperativat bujqësore gjithashtu duhen zbatuar e përsosur më tej format e demokracisë kooperativiste. Rreth këtyre çështjeve dhe të tjerave si këto ndoshta del nevoja të bëhen studime të veçanta nga organet përkatëse.

Por duhet të jetë e qartë se, sado të merren masa organizative konkrete për zgjerimin e demokracisë e vënien më mirë në jetë të parimit të centralizmit demokratik, këto nuk do të kenë efektin e tyre, në qoftë se më parë nuk kuptohen drejt e thellë politikisht. Format e organizimit e të drejtimit janë dhe mbeten gjithnjë forma. Tërë puna varet se çfarë përmbajtje futet në to, cilit qëllim i shërbejnë, varet nga njerëzit që punojnë në to, nga ndërgjegjia e tyre klasore. Edhe format më demokratike mund të shndërrohen në burokratike, po nuk

u kuptua esenca e tyre ideopolitike dhe po ranë në duart e burokratëve.

Më në fund duhet theksuar se lufta kundër burokratizmit, kundër centralizmit burokratik, kërkon jo vetëm zgjerimin e thellimin e demokracisë, por edhe zbatimin me rreptësi të centralizmit demokratik. Vetëm duke e kuptuar kështu çështjen mund të luftohen me sukses edhe disa fenomene negative. Nuk përjashtohet mundësia, dhe në jetë ka raste të tilla, që, nën parullën e thellimit të demokracisë, në radhët e punonjësve të paformuar si duhet politikisht e ideologjikisht mund të duken shfaqje të shthurjes së disiplinës proletare dhe të anarkizmit, ashtu si në radhët e kuadrove mund të duken shfaqje të dikasterializmit e të lokalizmit të ngushtë që nënvleftësojnë e mohojnë nevojën e centralizmit. Duke e përqëndruar zjarrin e luftës për zgjerimin e demokracisë dhe kundër centralizmit burokratik, ne duhet të luftojmë njëkohësisht me vendosmëri kundër çdo shfaqjeje të indisiplinimit dhe të decentralizmit anarkik. Liria dhe disiplina, demokracia dhe centralizmi janë dy anë të lidhura ngushtë midis tyre, që nuk mund të ekzistojnë njëra pa tjetrën. Çdo trajtim i njëanshëm është krejt i gabuar teorikisht dhe shumë i dëmshëm politikisht.

2. — Të luftojmë kundër teknokratizmit e intelektualizmit si shfaqje të huaja e burokratike

Lufta kundër burokratizmit është e pandarë nga lufta kundër teknokratizmit dhe intelektualizmit që në thelb janë produkt dhe ushqim i burokratizmit. Ato janë një përsosje e burokracisë në përputhje me rolin e madh që ka marrë shkencë e teknika në zhvillimin e shoqërisë, janë shprehje të ideologjisë dhe të politikës borgjeze në fazën e tanishme të sundimit të kapitalit monopolist. Ato janë të huaja për rendin socialist, sepse mohojnë rolin e masave dhe në mënyrë të veçantë rolin udhëheqës të klasës punëtore në sistemin e diktaturës së proletariatit, mohojnë parimin themelor të vënies në plan të parë të politikës proletare. Teknokratizmi dhe intelektualizmi i hapën rrugën degjenerimit borgjez të disa vendeve socialiste dhe sot po përdoren gjerësisht nga revizionistët për rivendosjen e plotë të kapitalizmit në këto vende.

Revizionistët, duke shtrembëruar tezën marksiste mbi rolin e forcave prodhuese dhe të ekonomisë përgjithësisht në zhvillimin e shoqërisë, u larguan nga abc-ja e marksizmit, nga roli vendimtar i njeriut dhe nga prioriteti i politikës mbi ekonominë. Kjo i çoi ata në mohimin e rolit të partisë si shtabi

politik i proletariatit që drejton gjithë jetën e vendit dhe në shndërrimin e saj në një organizatë thjesht ekonomike që merret me drejtimin e industrisë e të bujqësisë; kjo bëri që në krye të të gjitha organeve të partisë e të pushtetit të vihen teknikët e specialistët e degëve të ndryshme, që në politikën e kuadrit të shihen vetëm aftësitë profesionale të njerëzve, që t'i jepet epërsi edukimit ekonomik e tekniko-profesional të komunistëve e punonjësve dhe të lihet pas dore edukimi i tyre ideopolitik, që çështjet e ndërtimit ekonomik të shihen vetëm ose kryesisht në prizmin e leverdisë ekonomike, të fitimit etj. Të gjitha këto kultivuan teknokratizmin dhe ekonomizmin, minuan politikën proletare dhe ndërgjegjen revolucionare të njerëzve, i hapën rrugën rivendosjes së kapitalizmit.

Nga ana tjetër, duke shtrembëruar kuptimin dhe rolin e vërtetë të punës intelektuale dhe të vetë inteligjencies në shoqërinë socialiste, revizionistët mbollën në masë përbuzjen për punën fizike, nënvleftësuan rolin vendimtar të masave punonjëse, vunë kudo në krye të punëve intelektualët, duke minuar rolin udhëheqës të klasës punëtore si klasa në fuqi. Ata u larguan nga kriteri klasor për pranimet në parti, hapën dyert për dyndjen e intelektualëve duke shproletarizuar kështu përbërjen e partisë e sidomos të organeve të saj udhëheqëse. Për ta bërë inteligjencien një mbështetje për politikën e tyre tradhëtare, revizionistët i krijuan asaj gjithfarë privilegjesh dhe kultivuan në të rendjen pas pasurisë e titujve, pas lavdisë e rehatisë personale, pas një jete të lehtë e të shthurur, pas posteve e qosheve të ngrohta. Të gjitha këto e bënë inteligjencien të burokratizuar dhe të degjeneruar, elitën e «regjimit proletar», të destinuar të udhëheqë e të drejtojnë klasën punëtore e masat punonjëse, të cilat duhet vetëm të punojnë e të prodhojnë, kurse ajo të bëjë ligjin, politikën, të vendosë për gjithçka.

Duke e parë çështjen në dritën e kësaj eksperience negative, ashtu si deri sot, ne duhet të jemi shumë vigjilentë dhe të bëjmë një luftë të vendosur kundër çdo shfaqjeje të teknokratizmit, ekonomizmit e intelektualizmit, sepse edhe njerëzit tanë nuk janë të imunizuar nga këto sëmundje, në qoftë se kundër tyre nuk merren të gjitha masat profilaktike.

Për t'u prerë rrugën këtyre të këqijave, ne duhet të zbatojmë me konsekuencë parimin themelor të Partisë për vënien e politikës proletare në plan të parë. Këtë e ka theksuar vazhdimisht Partia dhe ky parim është vënë dhe po vihet gjithnjë e më mirë në jetë. Por megjithëkëtë nuk janë të rralla rastet që ky parim mbetet një parullë abstrakte dhe nuk mishërohet kurdoherë dhe në të gjitha veprimet e punët e njerëzve

tanë, sidomos te disa punonjës të aparateve shtetërore e të ekonomisë. Si rrjedhim, në metodën e tyre të punës vihet re një trajtim i ngushtë dhe i njëanshëm i problemeve të ndryshme, të cilat shihen nga ana thjesht tekniko-ekonomike me syrin e specialistit dhe të teknokratit. A nuk flet për këtë fakti që shokët e Ministrisë së Bujqësisë, ndërsa preokupohen me të drejtë dhe merren shumë me problemet që kanë të bëjnë me zhvillimin e prodhimit bujqësor e blegtoral, me përpunimin dhe me përhapjen e një agroteknike të përparuar, nuk tregojnë gjithë kujdesin e duhur për përsosjen e marrëdhënieve në prodhim, për të ndërmarrë studime me karakter jo vetëm thjesht teknik, por edhe socialo-ekonomik, siç janë problemet e organizimit e të shpërblimit të punës në kooperativa bujqësore, të marrëdhënieve fshat-qytet, individ-kooperativë-shtet, të aleancës së klasës punëtore me fshatërsinë etj. Një vërejtje e tillë mund të bëhet edhe për dikasteret e tjera qendrore, duke përfshirë edhe Komisionin e Planit të Shtetit, të cilat shpesh i rrëmben praktikizmi, rutina e punëve të përditshme dhe nuk thellohen sa dhe si duhet në problemet e mëdha aktuale dhe perspektive të politikës ekonomike të Partisë për sektorët e tyre.

Shfaqje të tilla ka edhe në punën e organeve dhe të organizatave të Partisë, disa nga shokët e të cilave priren shumë nga problemet konkrete të ekonomisë në kurriz e në dëm të problemeve ideologjike, politike, kulturele e sociale, i shohin problemet ekonomike nga ana thjesht teknike, duke lënë pas dore aspektin politik e ideologjik të tyre, dublojnë punën e organeve shtetërore dhe ekonomike dhe harrojnë se kryesore në punën e Partisë është puna e gjallë me njerëzit, për edukimin, mobilizimin dhe organizimin e tyre.

Faktorët vendimtarë që çojnë përpara prodhimin dhe gjithë jetën e vendit janë njeriu, janë masat punonjëse. Kjo do të thotë se pa nënvleftësuar aspak nevojën e përsosjes së vazhdueshme të teknikës në të gjithë sektorët e ekonomisë, si dhe rolin e madh të specialistëve të degëve të ndryshme, ne duhet të mbështetemi fort te njerëzit, te masat, t'i drejtohem ndërgjegjës së tyre, të vëmë në lëvizje inisiativën dhe forcën e tyre të pashtershme krijuese. Kjo është garancia kryesore e të gjitha sukseseve tona. Në këtë drejtim jeta na ka dhënë mësim të mëdha. Puna e bërë për likuidimin e pasojave të tërmetit në rrethet e Dibrës e të Librazhdit është një shembull i shkëlqyer se si, në kundërshtim me të gjitha konceptet burokratike e teknokratike, në kushte jashtëzakonisht të vështira, por në saje të frymës së lartë revolucionare të njerëzve të edukuar nga Partia, që e bënë natën ditë, që s'pyetën për dë-

borë e ngrica, u thyen shumë norma teknike në ndërtim, në praktikën e planifikimit dhe të organizimit dhe u arritën, në një kohë rekord, rezultate kolosale, që përbëjnë një fitore të madhe të vijës së drejtë të Partisë. Shoku Enver e analizoi thellë vlerën e gjithanshme të kësaj përvoje të fituar brenda një muaji dhe bëri thirrje që nga ky shembull i madh të nxjerrim mësim të gjithë. Dhe mësimet u nxorën e do të nxirren edhe nga shembuj të tjerë të këtij lloji që lindin vazhdimisht në jetën tonë plot dinamizëm. Kusht i domosdoshëm për këtë është të thyhen e të hidhen poshtë konceptet e ngushta konservatore, burokratike e teknokratike. Pa këtë nuk mund të shpërthejnë të fuqishme vrulli dhe inisiativa krijuese e masave.

Njerëzit tanë duhet të mos harrojnë kurrë objektivin kryesor të të gjithë punës dhe të luftës sonë që është njeriu me të gjitha interesat e kërkesat e tija materiale e shpirtërore. Parullat e Partisë që njeriu është kapitali më i çmuar, që kujdesi për njerëzit duhet të jetë në qendër të vëmendjes, i njohin dhe i përsëritin të gjithë. Por në punën e kuadrove dhe të organeve tona të Partisë e të shtetit disa herë vihet re prirja teknokratike për t'u tërhequr kryesisht nga teknika e planet, nga treguesit e ndryshëm tekniko-ekonomikë dhe nuk shohin se prapa tyre qëndrojnë njerëzit, punonjësit me nevojat e kërkesat e tyre, me preokupacionet e vështirësitë etj. Kjo është më e theksuar sidomos në disa quadro të administratave, duke përfshirë edhe ata të dikastereve qendrore, të cilët interesohen edhe për detajet më të vogla teknike, vidthat e bulonat, por fare pak interesohen të pyesin se si jetojnë, ç'halle kanë e ç'probleme i shqetësojnë punonjësit, që vënë në përdorim teknikën dhe për të cilët futet në prodhim teknika, bëhen planet e ndërtohet socializmi. Nga kjo frymë teknokratike vuajnë edhe disa punonjës të Partisë, të cilët shpeshherë dinë, bile me hollësi, edhe treguesit më të detajuar të planit, por pak kujdesen të dinë se sa fëmijë lindin e vdesin në fshat, si jetojnë, rriten e edukohen ata etj. Të gjitha këto tregojnë se disa shokë, të infektuar keq nga ekonomizmi e teknokratizmi, shpesh i shndërrojnë ekonominë, planet, teknikën në qëllim në vetëvete, ndërsa punonjësit i shohin vetëm ose kryesisht si «fuqi punëtore», duke harruar kështu kryesoren — se pa kujdesin për njerëzit, për jetën e mirëqenien e tyre, revolucionin dhe ndërtimi i socializmit nuk do të kishin asnjë kuptim.

Për t'u prerë rrugën shfaqjeve të teknokratizmit, ekonomizmit e intelektualizmit duhet të ruhen raporte të drejta midis edukimit tekniko-profesional dhe edukimit ideopolitik të kuadrove, komunistëve e punonjësve, duke vënë në plan të parë edukimin ideopolitik e duke i dhënë epërsi atij.

Në qoftë se njerëzit pajisen vetëm ose kryesisht me arsim

e kulturë, me dije tekniko-profesionale dhe nënvleftësohet sado pak edukimi ideopolitik për kalitjen e tyre revolucionare kjo, siç tregon eksperiencia e vendeve revizioniste, është e mbarsur me pasoja shumë të këqija, sepse kultivon në kuadrot e në inteligjencien ndjenjën e epërsisë e të mendjemadhësisë, bën që në ta të zënë vend tiparet e intelektualizmit e të teknokratizmit, i shkëput kuadrot nga masat e i vë ata mbi masat, çon, pra, në mënyrë të pashmangshme në largimin nga politika proletare dhe në shkarjen, dashur pa dashur, në prehrin e politikës dhe të ideologjisë së huaj borgjeze e revizioniste, sepse asnjëri në kushtet e sotme të vazhdimit të luftës së klasave nuk mund të qëndrojë jashtë politikës dhe ideologjisë së klasave.

Pikërisht mbi bazën e vendosjes së raporteve të drejta midis edukimit ideopolitik dhe edukimit tekniko-profesional, duke vënë në plan të parë edukimin ideopolitik, po bëhet e duhet të bëhet edhe revolucionarizimi i shkollës sonë, nga e cila duhet të dalin jo vetëm specialistë të zot për degët e ndryshme të ekonomisë e të kulturës popullore, por para së gjithash njerëz të brumosur me ideologjinë e Partisë, besnikë ndaj interesave të popullit, luftëtarë të vendosur për çështjen e komunizmit. Është për këtë arsye që shoku Enver në fjalimin e tij «Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë», theksoi me forcë të madhe idenë se

«...shtylla e saj kurrizore, e cila do ta udhëheqë atë në çdo drejtim e në çdo transformim të saj, është filozofia materialiste marksiste-leniniste»¹.

Duke i dhënë epërsi edukimit ideopolitik, Partia lufton jo vetëm kundër profesionalizmit të ngushtë, por edhe kundër politikanizmit abstrakt, kundër drejtimit të punëve vetëm me parulla e fraza të përgjithshme politike, pa njohur thellë specifikën e punës në çdo sektor, anën e saj teknike, bazat e saja shkencore. Kjo do të thotë që kuadrot, të gjithë njerëzit tanë, duhet të jenë jo vetëm të qartë e të formuar mirë politikisht, por edhe njerëz të zot me njohuri të thella tekniko-profesionale, të aftë për të drejtuar e për të punuar në baza shkencore. Këtë del rëndësia e thirrjes së shokut Enver që të gjithë t'i futemi revolucionit tekniko-shkencor, të zotërojmë shkencën dhe teknikën moderne si një kusht vendimtar për zhvillimin e vendit e përparimin e popullit tonë.

Çdo klasë nuk bën dot pa inteligjencien e vet. Prandaj edhe klasa punëtore krijon inteligjencien e saj, e cila siç ka thënë

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 358.

Lenini: «...do të mbetet një shtresë e veçantë deri në arritjen e shkallës më të lartë të zhvillimit të shoqërisë komuniste...»¹. Është një meritë e madhe e Partisë sonë që ajo ka mundur, gjatë vjetëve të pushtetit popullor, të krijojë një inteligjencie të re e të madhe në numër, të dalë nga gjiri i klasës punëtore e i masave punonjëse dhe të lidhur ngushtë me to, të edukuar në frymën e socializmit dhe që punon me ndërgjegje të lartë për çështjen e madhe të popullit e të Partisë.

Jo nga natyra e saj, por nga shkëputja e punës mendore prej punës fizike, nga pozita e roli i saj në drejtimin dhe në organizimin e punëve, si dhe nga vetë karakteri i veprimtarisë së saj, si një punë kryesisht me karakter individual, inteligjencia është një shtresë mjaft e prekshme dhe e infektueshme nga botëkuptimi, ideologjia, politika dhe morali i huaj borgjez e revizionist, është e prirur për t'u shkëputur nga masat e për ta vënë veten mbi masat, për të mbivlerësuar rolin, zotësitë e talentet e saj, për të shkarë në pozitat e egoizmit e të mendjemadhësisë intelektuale, për ta quajtur veten si forcën e vetme të aftë për të drejtuar e për të udhëhequr. Ajo është, pra, një arenë me shumë rëndësi e luftës së klasave.

Prandaj organizatat e Partisë duhet të forcojnë gjithnjë e më shumë punën edukative me intelektualët, si dhe me rininë shkollore e studenteske. Duke nxjerrë mësim nga ajo se si e kanë katandisur inteligjencien kapitalistët e revizionistët dhe për ç'qëllime po e përdorin, ne duhet të punojmë që inteligjencia jonë të studjojë me këmbëngulje marksizëm-leninizmin dhe mësimet e Partisë e të shokut Enver, që ajo vazhdimisht, në punën dhe në luftën për ndërtimin e socializmit, të kalitet si revolucionare. Ne duhet që inteligjencien tonë ta lidhim e ta shkrijmë më mirë me punëtorët e me fshatarët, me jetën, punën dhe me luftën e tyre, ta bëjmë që ajo krahas librit të mbajë më fort në dorë edhe kazmën e pushkën, të luftojmë çdo shfaqje të mendjemadhësisë intelektuale e të lavdisë personale, çdo prirje për të përçmuar e për të përbuzur aftësitë krijuese fizike e mendore të masave punonjëse, të rrënojmë thellë te ajo se dijet e fituara nuk janë as «për të grumbulluar kulturë» për vete, as për t'u dalluar si «më i zoti» ndër të tjerët, por për t'i vënë ato në shërbim të ekonomisë dhe të kulturës së popullit. Shërbimi i devotshëm dhe pa asnjë kusht për çështjen e Partisë dhe për interesat e popullit — ja cili është ideali dhe motivi më i lartë i jetës për çdo intelektual të vendit tonë.

Kujdes i veçantë duhet treguar sidomos për inteligjencien krijuese, e cila luan një rol të madh në edukimin komunist të

¹ Shih: V. I. Lenin. Veprat e plota, bot. i pestë rus., vëll. 44, f. 351.

masave. Shkrimtarët e artistët tanë, në gjithë krijimtarinë e tyre, duhet t'u përmbahen fort parimeve klasore proletare, të luftojnë për pastërtinë ideologjike të letërsisë, artit dhe kulturës sonë socialiste, kundër çfarëdo ndikimi e shfaqjeje të huaj, të shkruajnë, të pikturojnë, të kompozojnë e të ekzekutojnë, jo për të kënaqur shijet e një «elite» që është në gjendje «të kuptojë» artin, por për masat e gjera të popullit, për ngritjen e ndërgjegjes dhe të kulturës së tyre proletare.

«Rrojmë në kohëra historike dhe vendimtare, shokë, ka thënë shoku Enver, kur Partia po udhëheq revolucionin në mënyrë të shkëlqyeshme. Askush nuk duhet të mbetet jashtë këtij revolucioni të madh. I madh e i vogël duhet të kontribuojë, të mendojë, të punojë për të, në të gjitha drejtimet, në të gjitha specialitetet, me të gjitha kapacitetet. Mendimet dhe veprat e cilitdo duhet të jenë të lidhura me nyje të pazgjidhshme me revolucionin tonë, krijimtaria e çdo njeriu duhet të frymëzohet nga revolucioni i masave që udhëheq Partia dhe ta fuqizojë këtë revolucion. Këndej duhet të frymëzohen pedagogët dhe mësuesit, shkrimtarët, poetët, kompozitorët, këngëtarët, artistët, profesorët, shkencëtarët; kënde, nga revolucioni proletar, nga vepra masive e popullit për ndërtimin e socializmit dhe krijimin e të mirave materiale, duhet të udhëhiqen e të frymëzohen të gjithë njerëzit tanë në punët e ndryshme të tyre dhe për revolucionin, për socializmin të destinohet çdo punë, çdo krijimtari e tyre»¹.

Te ne në fuqi është klasa punëtore, ajo udhëheq e drejton gjithë jetën e vendit. Ky është një parim themelor, pa të cilin nuk ka diktaturë të proletariatit. Roli udhëheqës i klasës punëtore do të ruhet deri në fitoren e plotë të komunizmit në shkallë botërore. Çdo nënvleftësim i këtij roli të çon në revizionizëm e në kapitalizëm.

Këtë parim e kanë në majë të gjuhës edhe revizionistët, të cilët me demagogji përpiqen të mbulojnë tradhëtinë e tyre. Por si mund të luajë rolin e saj udhëheqës klasa punëtore, kur partia e saj komuniste ka humbur karakterin e saj klasor proletar dhe është shndërruar në parti të të gjithë popullit, ose kur diktatura e proletariatit ka pushuar së ekzistuari dhe shteti proletar është shndërruar në një shtet të të gjithë popullit? Për ç'rol udhëheqës të klasës punëtore mund të bëhet fjalë në vendet revizioniste, ku klasa punëtore mund të nënshtrohet, dekompozohet, korruptohet, kthehet nga një forcë politike, në një

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 326.

apendiks ekonomik, nga një forcë drejtuese, në një forcë të thjeshtë prodhuese? Në fuqi në këto vende nuk është klasa punëtore, por pikërisht borgjezia e re kapitaliste e përbërë nga kuadrot e burokratizuar e të degjeneruar të partisë, të pushtetit, të ekonomisë dhe të inteligjencies, të cilët kanë vendosur diktaturën e tyre të egër mbi klasën punëtore e mbi masat punonjëse dhe po rivendosin me shpejtësi kapitalizmin në të gjitha fushat.

Shoku Enver na mëson se klasa punëtore duhet të luajë rolin e saj udhëheqës e kontrollues, jo vetëm nëpërmjet partisë dhe shtetit të saj proletar, por edhe drejtpërdrejt, duke thënë fjalën e saj për çdo gjë, duke marrë pjesë aktive në drejtimin e të gjitha punëve dhe duke ushtruar kontrollin e saj proletar mbi këdo. Kjo do të thotë që roli i klasës duhet të jetë vendimtar, brenda ndërmarrjes ku ajo punon dhe jashtë saj, në sektorët e tjerë të ekonomisë e të kulturës, në gjithë jetën e vendit. Ajo duhet t'i japë tonin çdo punë, të futë kudo frymën dhe ideologjinë e saj revolucionare, të luftojë me guxim çdo shfaqje të burokratizmit, teknokratizmit, ekonomizmit e intelektualizmit, të mbrojë nga shpifjet e intrigat të gjithë ata kuadro e punonjës që punojnë mirë, të korrigjojë ata që bëjnë gabime dhe të shtypë ata që ecin në rrugë të shtrembër e që janë të pandreqshëm. Të gjithë duhet të pranojnë rolin udhëheqës të klasës punëtore dhe t'i nënshtrohen kontrollit të saj. Kjo përputhet plotësisht me interesat e të gjithë punonjësve, të cilët i bashkon qëllimi i madh i socializmit e i komunizmit, ku i prin klasa punëtore dhe partia e saj revolucionare.

Forcimit të rolit udhëheqës të klasës punëtore i shërben edhe orientimi i dhënë për zgjerimin e radhëve të Partisë me punëtorë dhe sidomos për të sjellë në organet udhëheqëse të Partisë më shumë punëtorë drejtpërdrejt nga prodhimi. Partia e klasës punëtore, jo vetëm nga ideologjia, nga idealet e qëllimet e saj, por edhe nga përbërja klasore, duhet të jetë parti proletare. Kjo është një nga garancitë kryesore që partia të qëndrojë revolucionare e të mos rrëshqasë në revizionizëm. Prandaj duhet ta shpiem plotësisht në vend këtë porosi të Partisë, bile duhet ta shtrijmë këtë orientim edhe për organet e pushtetit, sidomos për ato të zgjedhurat, si dhe për organet drejtuese të organizatave të masave, duke thyer çdo pengesë e duke kapërcyer çdo ngurrim. Ngurrimet për të sjellë në organet udhëheqëse të Partisë kuadro punëtorë që punojnë drejtpërdrejt në prodhim, siç ka thënë shoku Enver, kanë në vetëvete krimbin e një mentaliteti joklasor, të një fryme prej intelektualit dhe burokrati borgjez të vogël, të mbivlerësimit që i bëjnë vetes shokët që kanë një stazh pune si udhëheqës, duke e konsideruar veten si të pazëvendësueshëm dhe duke nënvleftësuar kështu aftësitë e mëdha të klasës punë-

tore, aftësitë drejtuese dhe organizuese të saj, ndërgjegjen, virtytet dhe vendosmërinë e klasës.

Që kjo masë e Partisë të zbatohet me sukses në jetë dhe të japë rezultatet e veta pozitive, duhet gjithashtu që, nga njëra anë, të bëjmë një punë të menduar dhe të organizuar mirë për përgatitjen dhe për edukimin e kuadrove të rinj punëtorë, sepse, megjithëse më pak se të tjerët, edhe ata nuk janë të përjashtuar nga rreziku i burokratizimit, po që se nuk edukohen, nuk kaliten dhe nuk revolucionarizohen vazhdimisht në kudhrën e Partisë, të jetës dhe të luftës revolucionare, dhe nga ana tjetër, duhet të ndryshojmë rrënjësisht metodën e punës së byrove dhe të komiteteve të Partisë, pasi kuadrot e rinj punëtorë që punojnë drejtpërdrejt në prodhim nuk mund t'i përballojnë dot mbledhjet e shumta e të gjata, relacionet e raportet lumë e ujë, ekipet që venë e vijnë pa pushim etj. Kushtet e reja kërkojnë edhe një metodë të re pune.

Rritja e rolit udhëheqës dhe e kontrollit të klasës punëtorë në tërë jetën e vendit është një kusht vendimtar për luftën me sukses kundër burokratizimit dhe të gjitha shfaqjeve të tija në formën e teknokratizimit, ekonomizmit dhe intelektualizmit, është garancia kryesore për zhvillimin e pandërprerë të revolucionit tonë proletar.

3. — Të luftojmë kundër konservatorizmit, t'i hapim rrugë së resë, përparimtares

Një pengesë tjetër në rrugën tonë për revolucionarizimin e mëtejshëm të gjithë jetës së vendit është lufta me të vjetrën, të prapambeturën dhe konservatoren, për t'i hapur rrugë së resë, përparimtares. Duke folur për proceset revolucionare që janë kryer dhe kryhen sot te ne shoku Enver thotë:

«Gjatë këtyre proceseve, e reja ka luftuar me të vjetrën, ka çarë rrugën përpara dhe e ka mundur të vjetrën, por jo plotësisht. Procesi i shembjes të së vjetrës, sidomos në ideologji, është i gjatë, është një luftë e ashpër me botëkuptimet, me konceptet e prapambetura, me mbeturinat e tyre, me mundësinë e ringjalljes në ndërgjegjen e individit dhe me rrezikshmërinë në një rikthim masiv të këtyre botëkuptimeve idealiste»¹.

Pa një luftë të vendosur kundër koncepteve të vjetra prapanike, mbeturinave borgjeze e mikroborgjeze në ndërgjegjen e

njerëzve, normave të moralit borgjez e feudal në mënyrën e jetesës e zakonet e popullit, pikëpamjeve të ngushta anakronike që u ka ikur koha, formave e metodave të vjetruara të punës, me fjalë të tjera pa një luftë të vendosur kundër të gjitha shfaqjeve të konservatorizmit, për të mposhtur rezistencën që ai bën, herë në mënyrë të dukshme e herë në mënyrë të padukshme, nuk mund të zhvillohet i vrullshëm revolucioni ynë. Konservatorizmi është armik i revolucionit, sepse ndërsa ai mbron të vjetrën, të prapambeturën, atë që i ka ikur koha e po vdes, revolucioni lufton për të renë, përparimtares, për atë që lind e zhvillohet dhe ka të ardhshmen përpara.

Lufta që bën Partia jonë kundër konservatorizmit dhe rrënjëve të tija ideologjike, kundër çdo gjëje që pengon marshimin fitimtar të revolucionit tonë, buron nga vetë natyra dhe karakteri i Partisë sonë, si parti revolucionare, nga vetë ideologjia marksiste-leniniste që i shikon gjërat gjithmonë në zhvillim, është me të renë dhe e përgatit në mënyrë të ndërgjegjshme fitoren e saj. Në thelb kjo është lufta për të ecur gjithnjë përpara dhe për të mos u kthyer kurrë prapa drejt revizionizmit e kapitalizmit, të cilët megjithëse përpiqen të vishen me maska të reja, gjoja të kohës, në fakt përfaqësojnë botën e vjetër që po vdes; janë vjetërsira, prandaj edhe e kanë bazën në vjetërsirat; janë regres, prandaj edhe e kanë bazën në konceptet dhe në pikëpamjet regresive.

Në veprimtarinë praktike të organizatave të Partisë dhe atyre të masave, të organeve shtetërore dhe ekonomike, të institucioneve kulturele dhe arsimore, në shumë raste vihet re një kuptim i ngushtë mbi konservatorizmin, sikur lufta kundër tij ka të bëjë vetëm me zakonet e vjetra prapanike ose vetëm me mbeturinat e trashëguara nga shoqëria e vjetër. Prandaj ndodh që edhe luftën e tyre e ngushtojnë brenda këtij kuadri.

S'ka asnjë dyshim se lufta kundër zakoneve prapanike e «njollave» të shoqërisë së vjetër është një aspekt me rëndësi i luftës kundër konservatorizmit dhe këtu ka vend për të bërë shumë kritikë, pasi kjo luftë nuk bëhet gjithmonë mirë, pasi ka një punë me hope, bëhen lëshime dhe disa lëvizje e inisiativa janë lënë në mes të rrugës etj.

Por konservatorizmi nuk mbetet brenda këtyre caqeve, ai shtrihet edhe në fusha të tjera, përfshin sektorë, individë e grupe individësh të tjerë, bëhet fre dhe pengesë për çdo gjë përparimtare dhe novatore. Prandaj edhe lufta kundër tij duhet të shtrihet në të gjitha fushat, si pjesë e luftës për revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit.

Të marrim sektorin ekonomik, çështjet e revolucionit tekniko-shkencor. Në këtë drejtim po bëhet një punë e madhe.

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 309.

Këtë e shohim në shumë ndërmarrje, të cilat u janë futur me guxim mekanizimeve, ngritjes së linjave teknologjike, deri te rikonstruksioni i plotë i repartëve ose i të gjithë ndërmarrjes. Njerëzit mendojnë më shumë për të tashmen, por edhe për perspektivën, që nga punëtorët, teknikët dhe inxhinierët, deri te drejtuesit, në bazë ose në dikastere, të cilët bëjnë propozime, marrin inisiativa dhe luftojnë për të çarë përpara. Për këtë flet qartë hovi që ka marrë lëvizja për shpikje e racionalizime, si dhe zhvillimi i sesioneve masive shkencore që janë mbajtur në rrethe, qendra pune, kooperativa bujqësore dhe institucione të ndryshme. Ky proces i madh për zhvillimin e për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor duhet vazhduar me këmbëngulje, në luftë me të gjitha pengesat që kanë lidhje me konservatorizmin, rutinën, me kapjen fort pas formave të vjetëruara të organizimit të prodhimit, me frikën ndaj gjërave të reja e kështu me radhë. Tendencat artizanale në sektorët e ndryshëm të prodhimit industrial janë mjaft të theksuara. Janë pikërisht këto tendenca, të cilat bëjnë që disa fabrika e qendra prodhimi si për shembull uzina «Dinamo» në Tiranë e ndonjë tjetër, të vazhdojnë të punojnë me të vjetrën, pa bërë përpjekje që të modernizojnë procesin e prodhimit, që të kenë linja dhe karta teknologjike, laboratore etj. Por edhe në vetë Ministrinë e Industri-Minierave duhet të ketë një koncept më të qartë dhe të bëhet një punë më serioze për të kaluar në forma më të përparura të organizimit të prodhimit industrial mbi bazën e kooperimit, profilizimit dhe specializimit, për nxitjen në shkallën e duhur të mekanizimeve, për futjen e teknologjisë së re, për ngritjen e laboratoreve ose për rikonstruksionet.

Tendenca konservatore në drejtimin e prodhimit dhe në zbatimin e direktivave ekonomike të Partisë janë edhe përpjekjet që bëjnë disa kuadro drejtues për të pasur në ndërmarrje një sërë repartesh ndihmëse, si ofiçina mekanike, reparte zdrucktharie etj., duke synuar kështu drejt një farë pavarësie prodhuese, në vend që këto nevoja të plotësohen në kuadrin e kooperimit e të specializimit të prodhimit, duke vendosur lidhje sa më të ngushta midis ndërmarrjeve. Ka një vendim të Plenumit të Komitetit Qendror për çështjen e kooperimit industrial dhe për shfrytëzimin më racional të maqinave metalprerëse. Por ky vendim nuk po zbatohet mirë. A nuk flet ky fakt për rrënjët e forta që ka konservatorizmi, «frika» për të punuar në një mënyrë të re?

Probleme të tilla ka edhe për çështjet e prodhimit bujqësor, për futjen e agroteknikës së përparuar dhe të formave të përparura të organizimit të punës, për ngritjen dhe zhvillimin e sektorëve të rinj prodhues si të blegtorisë, frutikulturës, perime-

ve dhe aktiviteteve të tjera ndihmëse, për kalimin edhe në fshat në një drejtim më shkencor të ekonomive të mëdha bujqësore. Sukseset e mëdha të shumë rretheve në rritjen e rendimenteve bujqësore janë arritur kryesisht si rrjedhim i përmbysjes së shumë koncepteve konservatore, që i pengonin njerëzit të shkëputeshin nga praktikat e vjetra mbi punimin e tokës apo shërbimin ndaj bimëve. Po kështu për hapjen e tokave të reja është dashur të thyhen shumë koncepte prapanike, sipas të cilave mundësitë tona në këtë drejtim janë shumë të kufizuara. Pa thyer konceptet konservatore, nuk mund t'u hapet rruga agroteknikës moderne dhe eksperiencës së përparuar. Në rrethin e Sarandës kultura e orizit njihet mirë dhe është kultivuar prej kohësh. Megjithatë atje merret një rendiment shumë më i ulët se në rrethin e Durrësit, ku kjo bimë nuk ka veçse pak vjet që mbillet. Siç duket tradicionalizmi ose ndjenja e të kënaqurit me pak i pengon shokët e Sarandës që të përfitojnë nga eksperiencia e përparuar e rrethit të Durrësit.

Procesi i revolucionarizimit është shtrirë edhe në fushën e letërsisë, artit, arsimit e shkencës dhe kudo po bëhet një punë e madhe për të vënë në jetë direktivat dhe orientimet e Partisë. Kthesa e filluar duhet thelluar më tej e çuar deri në fund. Kjo nuk mund të arrihet pa luftuar dhe pa hequr dorë nga disa forma, mjete shprehëse artistike, organizime dhe koncepte estetike, pedagogjike ose shkencore, që nuk pajtohen me frymën e ideologjisë sonë dhe nuk u përgjigjen detyrave të etapës së re të ndërtimit tonë socialist. Shfaqjet e konservatorizmit që vihen re në këto fusha janë pengesë për zhvillimin e letërsisë dhe të artit të ri revolucionar e socialist, për revolucionarizimin e shkollës dhe për mendimin e ri shkencor. Këtu nuk është fjala për të mohuar traditën e mirë, trashëgimin pozitiv letrar artistik, pedagogjik apo shkencor, por për t'i hapur rrugë zhvillimit të revolucionit edhe në këta sektorë me rëndësi ideologjike të Partisë.

Në metodën e punës së organeve të Partisë e të pushtetit, në qendër e në rrethe, ka shumë gjëra të mira. Por duhet thënë se në përgjithësi ndryshimet janë akoma të vogla dhe nuk i përgjigjen si duhet zhvillimit dialektik të realitetit tonë. Shumë punonjës të këtyre organeve vazhdojnë punën me të vjetrën, duke e vënë veten në pozita metafizike e konservatore. Vazhdojnë «konferencat» mbi nevojën e rritjes së prodhimit industrial, mbi ngritjen e rendimentit dhe uljen e kostos, vazhdojnë «këshillat» si duhet organizuar puna në ndërmarrje dhe si duhet punuar për racionalizime apo novatorizma, në një kohë kur punëtorët, drejtuesit dhe specialistët e prodhimit, që tani janë të shumtë, me shkollë dhe eksperiencë të pasur, të gjitha këto jo

vetëm i dinë shumë mirë, por edhe i vënë në jetë me talent dhe me heroizëm. Këta në vend të fjalëve duan përkrahjen aktive për të çuar përpara prodhimin, duan furnizim të rregullt me lëndë të parë, duan materiale suplementare dhe të veçanta për novatorizmat dhe racionalizimet, duan kooperim me institucionet qendrore dhe ndërmarrje të tjera, duan të njohin eksperiencën e mirë, të grumbullojnë dhe të përpunuar nga specialistë të zot të qendrës apo të rrethit, duan të shkëmbejnë mendime për perspektivën, në mënyrë që t'u hapen horizonte të reja etj. etj.

Përsa i përket fshatit, ka ikur koha kur shokët tanë këshillonin edhe si duhet mbjellur gruri në tokë të sistemuar në formën e kurrrizit të peshkut, me rreshta të ngushtë apo të gjerë, kur duhet mbjellë pambuku dhe si i duhet bërë çekanka, si të organizohen brigadat e blegtorisë etj., sepse tani në fshat janë bërë ndryshime të mëdha, njerëzit janë aftësuar e janë kualifikuar, kuadrot kanë fituar një përvojë të madhe. Por disa shokë vazhdojnë akoma me të vjetrën, u bien poshtë e përpjetë fshatrave, shkojnë arë më arë, lodhen ditë e natë, duke kujtuar se kështu janë «operativë», por pak merren me njerëzit e me konceptet e tyre, pak i ndihmojnë për të ndërtuar një metodë e stil revolucionar në punë, pak bëjnë edhe për organizimin konkret të punës, për t'u hapur perspektivën organizatave bazë të Partisë, organizatave të masave dhe vetes së tyre.

Duhet të jetë e qartë se të vazhdosh punën si më parë, pa pasur parasysh kushtet e krijuara, është antidialektike dhe refleksi i konservatorizmit. Të kemi më shumë besim te punëtorët e fshatarët, te drejtuesit e specialistët e bazës, në aftësitë e në talentet e tyre. T'u lëmë atyre më shumë inisiativë, t'i ndihmojmë ata për të kuptuar thellë direktivat e Partisë dhe t'u vijmë në ndihmë për të kapërcyer vështirësitë që u dalin. Plenumi i Komitetit Qendror i Qershorit 1963 shtroi detyra të mëdha për përmirësimin e gjendjes socialo-ekonomike të fshatit. Me gjithë rezultatet e arritura dhe ndryshimet e mëdha që janë bërë, disa detyra të tija akoma nuk kanë marrë rrugë si duhet. Përse, për shembull, për sigurimin e orendive shtëpiake duhet të pritët nga lart në vend që t'u jepet fshatarëve, nën kontroll dhe me rregulla të caktuara, e drejta ta sigurojnë vetë lëndën dhe të aktivizohen mjeshtrit e shumtë, që gjenden kudo në fshatra, të bëjnë vetë orendi nga më të ndryshmet për nevojat e kooperativistëve? Në një kohë kur në fshat ka me mijëra të rinj që kanë mbaruar ushtrinë, ku kanë fituar zanate të shumëllojta, organizimi i shërbimeve të artizanatit në disa rrethe është akoma prapa. Përse të mos organizohen të gjitha këto forca të kualifikuara, përse të mos përfitohet nga eksperiencia e disa kooperativave ku këto shërbime janë organizuar më së miri?

Me të drejtë problemi i drithit është në qendër të vëmendjes të organeve të Partisë dhe të pushtetit. Por kjo nuk do të thotë aspak që të lihen pas dore sektorët e tjerë, siç është, për shembull, prodhimi i zarzavateve, të cilat nuk janë më pak të nevojshme, si për popullsinë e qyteteve, ashtu edhe për atë të vetë fshatrave. Ç'i pengon shokët e rretheve ta zgjidhin këtë problem me inisiativë? Apo mos vallë mendohet që edhe kjo çështje të zgjidhet në mënyrë të centralizuar e të planifikuar nga lart? Pa luftuar prangat e konservatorizmit dhe të burokratizmit, pa zhvilluar gjerësisht inisiativën, nuk mund të zbatohen me sukses direktivat e vendimet e Partisë.

Shoku Enver ka kritikuar shumë rëndë konservatorizmin në politikën e kuadrit, që shfaqet në mosbesimin ndaj kuadrove të rinj, për t'i ngritur ata me guxim në përgjegjësi, ka vënë në dukje të këqijat që vijnë prej tij dhe burimet ideologjike të konservatorizmit në këtë fushë. Ai ka thënë:

«Ç'do të thotë të jesh konservator në politikën e kuadrit? Kjo do të thotë të mos ecësh me zhvillimin e vullshëm të revolucionit tonë, të mos e kuptosh këtë zhvillim, të mos e ndjekësh ose të tërhiqesh zvarrë, duke e frenuar zhvillimin. Kjo natyrisht do të thotë të mos i kesh të qarta parimet e Partisë, të kesh rezerva, të mos kesh besim në zhvillimin krijues dhe të nënvleftësosh rolin e masave, aftësitë e tyre politike, organizative dhe të mbivlerësosh e të kënaqesh vetëm me atë që është bërë; të kesh frikë nga çdo gjë që është e re, novatore, premtuese, të kesh frikë se mos bëhen gabime dhe të preferosh të frenosh, gjoja se mund të bëhen gabime më pak»¹.

Duhet pranuar hapur se konceptet konservatore, lidhur me ngritjen e kuadrove të rinj, kanë rrënjë të thella. Në fakt direktiva e Partisë shumë ngadalë dhe me shumë vështirësi po vihet në jetë. Duket qartë se shokët tanë nuk e kanë kuptuar thellë këtë direktivë të Partisë dhe nuk kanë reflektuar si duhet për të. Kjo është një çështje që ka të bëjë me të sotmen dhe të ardhshmen e Partisë, të diktaturës së proletariatit e të socializmit në vendin tonë. Në qoftë se nuk i ngremë dhe nuk i përgatitim që sot kuadrot e rinj, atëherë kur do ta bëjmë këtë punë? Shokët tanë nuk duhet të harrojnë se kur Partia dhe populli u besuan atyre për herë të parë përgjegjësira të mëdha, jo vetëm ishin në moshë shumë të re, por nuk e kishin atë kulturë dhe ato aftësi, që kanë sot kuadrot e rinj, të edukuar me kujdes nga Partia, të armatosur me ideologjinë e saj dhe me kulturë të gjerë profe-

1 Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 319-320.

sionale. Prandaj duhet t'u shpallim një luftë të vendosur koncepteve konservatore në politikën e kuadrit, sepse pa i thyer këto koncepte, nuk mund t'u hapet rruga kuadrove të rinj, të cilët, duke përfituar nga eksperiencia e kuadrove të vjetër dhe në bashkëpunim me ta, të çojnë përpara dhe të vënë në shërbim të popullit e të socializmit energjitë, dinamizmin dhe talentin e tyre.

Prej këtej del se luftën kundër konservatorizmit, për t'i hapur rrugë së resë përparimtare, duhet ta shikojmë jo si luftë kundër një mbeturine të thjeshtë të çfarëdo lloji, por në radhë të parë si një luftë ideologjike midis dy botëkuptimeve, atij materialist dhe idealist, midis dy metodave, asaj dialektike dhe metafizike, luftë midis së resë dhe së vjetrës, përparimtares dhe të prapambeturës, si një formë e luftës së klasave. Kjo nuk është gjithashtu një luftë e thjeshtë për çështje formash, për të hedhur poshtë disa forma pune dhe për t'i zëvendësuar ato me disa të tjera, megjithëse edhe format luajnë një rol të madh kur janë të mira e të kohës dhe pengojnë kur janë të këqija e të vjetëruara, por është kryesisht një luftë konceptesh, botëkuptimesh për çështje të brendisë, të përmbajtjes së punës politike, ideologjike, ekonomike dhe organizative në gjithë veprimtarinë e Partisë dhe të organeve shtetërore.

Kur flasim për luftën kundër së vjetrës konservatore, kjo nuk do të thotë se ne luftojmë kundër çdo gjëje të vjetër, ashtu si kur luftojmë për të renë përparimtare, kjo nuk do të thotë se ne përkrahim çdo gjë të re, pa shikuar përmbajtjen e saj klasore. Përkundrazi, ne jemi dhe duhet të jemi deri në fund tendenciozë nga ana politike. Organizatat e Partisë nuk duhet të humbasin në asnjë rast vigjilencën, por të dallojnë mirë atë që është me të vërtetë e re, nga ajo që nuk është e tillë, të luftojnë si kundër rasteve që nën flamurin e luftës kundër konservatorizmit mohohen rezultatet e arritura, ashtu edhe kundër rasteve që, nën emrin e së resë, shtrembërohen vija e Partisë, ideologjia e saj, parimet themelore të ndërtimit socialist.

Lufta kundër konservatorizmit është një luftë e gjatë dhe e vazhdueshme, që nuk do të marrë fund asnjëherë, sepse shoqëria jonë është në zhvillim të pandërprerë, ku kurdoherë diçka lind e zhvillohet dhe diçka vjetërohet e duhet mohuar. Organizatat e Partisë duhet ta njohin dhe të qëndrojnë në krye të këtij procesi dialektik, ta udhëheqin atë, duke u mbështetur fort në mësimet e marksizëm-leninizmit dhe të Partisë sonë, duke tërhequr në këtë luftë masat më të gjera të popullit, nga radhët e klasës punëtore, fshatarësisë kooperativiste, rinisë, gruas dhe inteligjencies popullore.

4. — Të luftojmë ndjenjën e tërheqjes pas interesit personal, të vëmë kudo e kurdoherë interesin e përgjithshëm mbi interesin personal

Partia jonë, duke vlerësuar kurdoherë drejt rolin vendimtar të njeriut, të armatosur me ideologjinë marksiste-leniniste gjatë gjithë jetës së saj është kapur fort pas kësaj hallke themelore. Në goftë se revolucioni ynë marshon përpara fitimtar, duke u bërë ballë të gjitha furtunave të kohës, kjo është e lidhur pikërisht me faktin që Partia ka bërë një punë kolosale për formimin dhe për farkëtimin e njeriut të ri me të vërtetë revolucionar dhe në këtë drejtim ka arritur rezultate të shkëlqyera, të cilat kanë forcuar socializmin dhe janë garancia më e sigurtë e së ardhshmes komuniste.

Në themel të kësaj pune ka qenë dhe është lufta për edukimin e njerëzve në frymën e vënies së interesit të përgjithshëm të popullit, atdheut, socializmit mbi gjithçka, për t'u shërbyer atyre me besnikëri e vetëmohim, duke çrrënjësuar çdo shfaqje të vënies së interesit personal mbi interesin e përgjithshëm. Nga fakti se cili interes vihet në plan të parë, interesi i përgjithshëm apo interesi personal, varet gjithë drejtimi i veprimtarisë së njerëzve, rruga e zhvillimit të vendit, fati i revolucionit. Vënia e interesit të përgjithshëm mbi interesin personal e çon revolucionin përpara në rrugën drejt socializmit e komunizmit, ndërsa vënia e interesit personal mbi interesin e përgjithshëm i hap rrugën kundërrevolucionit, kthimit prapa drejt kapitalizmit.

Kjo është një çështje thellësisht parimore dhe një vijë demarkacioni midis socializmit e kapitalizmit, marksizëm-leninizmit e revizionizmit. Të vësh në plan të parë interesin personal, kjo do të thotë të vësh në plan të parë individin dhe jo kolektivin, interesat e pjesëve dhe jo ato themelore, interesat e çastit dhe jo ato të perspektivës, stimulim material dhe jo atë moral, egoizmin nacional dhe jo internacionalizmin proletar. Shkarja në këto pozita të çon në oportunizëm e revizionizëm. Këtu duhet kërkuar një nga burimet më të rëndësishme të degjenerimit borgjez të socializmit në Bashkimin Sovjetik e gjtëkë.

Ndjenja e tërheqjes pas interesit personal, që e ka bazën në pronën private dhe në ideologjinë e klasave shfrytëzuese, është një ndjenjë me rrënjë shumë të thella, sepse ajo është kultivuar në ndërgjegjen e njerëzve me shekuj. Ajo ruhet e do të ruhet për një kohë shumë të gjatë, edhe pas likuidimit të pronës private dhe të klasave shfrytëzuese, për shumë arsye, objektive e subjektive, të brendshme e të jashtme. Ajo do të zhduket si një forcë regresive vetëm me fitoren e plotë të komunizmit në shkallë botërore. Prandaj përderisa ekziston kjo ndjenjë, ajo përmban

në vetëvete mikrobin për degjenerimin e njerëzve, përbën shtratin mbi bazën e të cilit zhvillohet ideologjia borgjeze e revizioniste, që janë pararoja e kundërrevolucionit politik. Prandaj ndjenja e tërheqjes pas interesit personal është një nga pengesat më të mëdha në rrugën tonë dhe, pa një luftë të vendosur e të vazhdueshme kundër saj, nuk mund të ecë përpara revolucionin.

Lidhur me këtë çështje organizatat e Partisë duhet ta bëjnë mirë të qartë se ndjenja e tërheqjes pas interesit personal nuk shfaqet vetëm në sferën materiale, në rendjen pas parasë, pas rrogës më të madhe, pas privilegjeve dhe përfitimeve materiale, në tendencat për t'i dhënë sa më pak shoqërisë dhe për të zhvatuar sa më shumë prej saj, apo për të zënë ndonjë vend të rehatshëm në qytet. Ajo shfaqet në njëmijë e një formë të tjera, shtrihet edhe në tiparet morale që kanë të bëjnë me karakterin e njeriut, siç janë: egoizmi e individualizmi, cmira e ambicia personale, intriga e gënjeshtria, karrierizmi e servilizmi, arroganca e mendjemadhësia, rehatia e lavdia personale, familjariteti e akra-ballëku, konformizmi e indiferentizmi, lokalizmi e dikasterializmi etj. etj. Kjo do të thotë se në këtë drejtim ka shumë probleme, shtrihet një fushë e gjerë veprimi për edukimin e njerëzve me normat e moralit komunist, në frymën e vënies së interesave të revolucionit mbi gjithçka.

Vënia e interesit të përgjithshëm mbi interesin personal është një veti e njerëzve me ndërgjegje e me moral të lartë, që nuk mbyllen si mikroborgjezë në guaskën e botës së tyre të ngushtë, që nuk mendojnë si egoistë vetëm për vete, që nuk kujdesen si individualistë vetëm për interesat e tyre të vogla, por kuptimin e qëllimin e jetës së tyre e shohin në luftën për t'i shërbyer sa më mirë çlirimit e përparimit të popullit, arritjes së idealeve të larta të socializmit e të komunizmit. Në këtë luftë ata formohen si revolucionarë me një botë të pasur shpirtërore, me ide e me motive të mëdha shoqërore, pajisen me virtyte të larta, afirmojnë personalitetin e tyre dhe gjejnë lumturinë më të madhe në jetë.

Është pikërisht ky kuptim revolucionar i jetës ai që e bëri Adem Rekën të shkojë deri në aktin më të lartë të vetëmohimit, duke dhënë jetën e tij për mbrojtjen e pasurisë së popullit. Kjo e bëri vajzën 15-vjeçare të Dukagjinit Shkurte Vatën një heroinë, që me shembullin e saj të madh ngriti peshë në këmbë tërë vendin, që heroizmi individual të kthehet në një heroizëm masiv. Kur fshatarët e kooperativave të zonave fushore u dhuruan falas vëllezërve të tyre të zonave malore mijëra krerë bagëti për forcimin ekonomik e përparimin e kooperativave të këtyre zonave, kjo ishte një shprehje e lartë e solidaritetit socialist, e

vënies së interesit të përgjithshëm mbi interesat e tyre të veçanta, e kuptimit të thellë të detyrës së shtruar nga Partia për zhvillimin e zonave malore, si një detyrë në interes të të gjithë vendit.

Përparimi i zonave malore dhe përgjithësisht i fshatit tonë kërkon, përveç të tjerave, që atje të shkojnë më shumë quadro e specialistë të ndryshëm agronomë e zooteknikë, mjekë e infermierë, arsimtarë e punëtorë partie. Kësaj thirrjeje të Partisë i janë përgjigjur me mijëra nga klasa punëtorë e rinia, të cilët, pa marrë parasysh asnjë vështirësi e sakrificë, kanë shkuar vullnetarë për 1 deri 3 vjet në fshat. Vendi i nderit për çdo njeri është të shkojë atje ku ka nevojë populli, atdheu, këtë e kërkon interesi i përgjithshëm, të cilit duhet t'i nënshtrohen interesat personale, sepse vetëm mbi bazën e përparimit të përgjithshëm mund të arrihet edhe zhvillimi i gjithanshëm i çdo njeriu.

E përgjithshmja dhe personalja te ne janë të lidhura ngushtë e të pandara. Sistemi socialist krijon kushtet objektive dhe politika e drejtë e Partisë kushtet subjektive për vendosjen e raporteve të drejta midis interesave të ndryshme në socializëm, për kombinimin dhe harmonizimin e tyre. Kur këto interesa kuptohen dhe zbatohen drejt, midis tyre nuk ka kontradikta. Ajo që është në interesin e përgjithshëm është në të njëjtën kohë edhe në interes të çdo punonjësi të veçantë, ashtu si puna e çdo njeriu në çfarëdo sektor të ekonomisë socialiste që ai punon ka një vlerë të madhe shoqërore, u shërben interesave të popullit, ndërtimit të socializmit. Por në qoftë se ndiqet një politikë e gabuar, ose interesat formohen nën ndikimin e ideologjisë borgjeze e të mbeturinave të saja, atëherë lindja e kontradiktave është e pashmangshme. Dhe në qoftë se këto kontradikta, që në fillim nuk janë antagonistë, nuk zgjidhen drejt e në kohën e duhur, ato shndërrohen në kontradikta antagonistë që rrezikojnë fatet e socializmit.

Interesat personale janë interesa objektive krejt të ligjshme e të natyrshme. Shoqëria nuk është diçka abstrakte, por përbëhet nga njerëz, ashtu si interesi i përgjithshëm nuk është diçka abstrakte, por formohet nga tërësia e interesave jetike të punonjësve. Prandaj lufta jonë nuk drejtohet kundër interesit personal, por kundër vënies së tij mbi interesin e përgjithshëm. Ne jemi për kombinimin dhe harmonizimin e tyre, duke ia nënshtuar interesat personale interesave të klasës, të popullit, të revolucionit dhe të socializmit.

Keqkuptimet në këtë çështje kanë çuar në disa raste edhe në qëndrime e veprime të gabuara e subjektive, në kundërshtim me orientimet e Partisë dhe me ligjet e shtetit. Në emër e për hir gjoja të interesave të përgjithshme disa herë merren nëpër këmbë interesat e të drejtat e ligjshme të punonjësve, nuk

përfillen kërkesat e nevojat e tyre të ngutshme. Dhe kur punonjësit ngrenë zërin për këto çështje, u mbyllet goja me akuza se këto gjoja janë shfaqje të tërheqjes pas interesit personal etj. etj.

Njihet nga të gjithë inisiativa e fshatarësisë patriote të vendit tonë për shkurtimin e oborrit dhe të bagëtisë personale. Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave në Deklaratën e përbashkët të 29 prillit 1967, duke përkrahur këtë inisiativë, porositën që toka e bagëtia e kolektivizuar, si rrjedhim i kësaj inisiative, të vihen në shërbim të plotësimit më të mirë të nevojave të kooperativave me perime, fruta e prodhime të tjera bujqësore e blegtorale. Por shumë kooperativa, duke i rënë shkurt këtij problemi, duke u nisur edhe nga mendimi se «gjalpi mbetet në lakror», nuk e zbatuan plotësisht këtë direktivë.

Në disa raste të tjera, me etiketën e mbrojtjes së interesave shoqërore dhe të parullës që të punojmë e të jetojmë si revolucionarë, kryhen disa veprime e merren disa inisiativa që prekin interesat personale të punonjësve. Çfarë interesash shoqërore mbrojnë disa drejtues të ndërmarrjeve ekonomike kur nuk kujdesen për t'u krijuar punëtorëve kushtet e nevojshme të punës, nuk marrin masa për sigurimin teknik, nuk interesohen për mbrojtjen e shëndetit, për ambiente të kulturuara e higjienike në bazë të rregullave të siguruar nga shteti me ligj?

Çështja e raportit midis interesit personal, kolektiv e të përgjithshëm është një çështje themelore e tërë politikës së Partisë. Kjo ka të bëjë me vendosjen e marrëdhënieve e të përpjesëtimeve të drejta midis fondit të akumulimit dhe fondit të konsumit, midis prodhimit të mjeteve të prodhimit dhe prodhimit të mjeteve të konsumit, midis rritjes së prodhimit dhe ngritjes së mirëqenies së popullit, midis zhvillimit të të gjithë vendit dhe zonave të veçanta, midis kooperativave bujqësore dhe shtetit, midis detyrave kombëtare e ndërkombëtare etj. Të kombinosh drejt të gjitha këto interesa e raporte, në thelb do të thotë të kombinosh drejt interesat e çastit me ato të perspektivës.

Të udhëhiqesh vetëm nga interesat e çastit e të harrosh ato të perspektivës, kjo do të thotë të mendosh vetëm për sot e jo edhe për nesër, gjë që nuk bëhet as në ekonominë familjare e jo më në ekonominë socialiste, do të thotë të jesh i siguruar mirë sot, por të gjendesh para vështirësive, të papriturave e rreziqeve të mëdha nesër, të mendosh vetëm për vete e të lësh pas dore detyrat për brezat e ardhshëm, të plotësosh interesat e pjesshme e kërkesat e sotme dhe të braktisësh interesat themelore, qëllimet dhe idealet revolucionare.

Por është gjithashtu gabim të udhëhiqesh vetëm nga interesat e perspektivës dhe të harrosh e të lësh pas dore luftën për interesat e çastit e të pjesshme, për plotësimin e kërkesave dhe të

nevojave të sotme të punonjësve. Çdo brez kryen detyra historike të caktuara, kush më të rënda e kush më të lehta, kush më të mëdha e kush më të vogla. Dhe çdo brez punon jo vetëm për të ardhshmen, por edhe për të sotmen, ka të drejtë të gëzojë, në këtë apo atë masë, sipas mundësive dhe kushteve, frutet e punës së tij. Kjo do të thotë se, duke vënë në plan të parë interesat themelore e të perspektivës, arritjen e qëllimeve dhe të idealeve revolucionare në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, duhet treguar gjithë kujdesi për plotësimin sa më të mirë të kërkesave dhe të nevojave të sotme të punonjësve të vendit, duke ngritur vazhdimisht e në përpjesëtime të drejta, që lejojnë mundësitë e krijuara, nivelin e jetesës së tyre.

Ne duhet patjetër të akumulojmë dhe rrethanat na kanë detyruar që normën e akumulimit ta kemi relativisht të lartë. Por në të njëjtën kohë ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet që detyrat e caktuara nga Kongresi V i Partisë për rritjen e mirëqenies së popullit jo vetëm të realizohen, por edhe të tejkalohen. Ne duhet patjetër të kursejmë, të kursejmë në çdo gjë e në të gjitha drejtimet, për të rritur prodhimin dhe për të krijuar rezervat e nevojshme, që të jemi të siguruar mirë për çdo situatë, për t'i bërë ballë çdo rreziku e të papriture. Por të njëjtin preokupacion duhet të tregojmë edhe për të shfrytëzuar çdo mundësi e rezervë, për të plotësuar gjithnjë e më mirë nevojat e kërkesat në rritje të popullit për mallra e shërbime të ndryshme.

Në këtë drejtim duhet të kemi parasysh edhe raportet që duhet të ekzistojnë në zhvillimin dhe nivelin e jetesës së zonave dhe grupeve të ndryshme të popullsisë së vendit, me qëllim që shpërpjesëtimet midis tyre të vijnë duke u zvogëluar gradualisht. Si tendencë e përgjithshme, sidomos këta vjetët e fundit, dallimi midis qytetit dhe fshatit përta u përket të ardhurave për frymë ka ardhur duke u ngushtuar. Megjithatë sot, të ardhurat e qytetarit janë më të larta se ato të fshatarit, ndërsa në fshat, ato të fushës janë shumë më të larta se ato të zonave të thella malore. Për këtë është e domosdoshme që, pa prekur zhvillimin e qyteteve dhe nivelin e jetesës së popullsisë qytetare, bile duke e ngritur edhe atë, t'i jepet precedencë zhvillimit të fshatit dhe ngritjes së nivelit të jetesës në fshat; ashtu si pa prekur zhvillimin e fshatrave të zonës fushore dhe nivelin e jetesës së popullsisë së kësaj zone, bile duke e ngritur edhe atë, t'i jepet precedencë zhvillimit të fshatrave të zonave malore dhe ngritjes së nivelit të jetesës së popullsisë të këtyre zonave, duke bërë një shpërndarje dhe rishpërndarje më të drejtë të të ardhurave kombëtare. Kjo çështje duhet kuptuar drejt, si nga punonjësit e qytetit, ashtu edhe nga ata të fshatrave fushore, si një problem

që lidhet me zhvillimin e tërë vendit dhe që e lyp interesi i përgjithshëm i shoqërisë sonë socialiste.

Interesat e grupit, lokale e dikasteriale janë interesa që ekzistojnë objektivisht dhe ato nuk mund të mos merren parasysh dhe aq më keq të injorohen. Por, megjithatë, këto interesa nuk duhet në asnjë mënyrë të vihen mbi interesat e përgjithshme të shoqërisë, përkundrazi ato duhet t'u nënshtrohen këtyre të fundit. Duke mos kuptuar mirë raportin e drejtë që duhet të vendoset midis këtyre lloj interesash, shpeshherë disa kooperativave, rretheve e dikasterëve qendrore, u tërheq kërraba më shumë nga vetja e tyre dhe në zgjidhjen e problemeve vuajnë akoma nga fryma e «shpirtit të repartit». Kjo vihet re në tendencat për të mos i zbuluar e për të mos i shfrytëzuar në maksimumin e mundshëm rezervat e brendshme, në kërkesat e fryra për investime e materiale të importit e deficitare, në çështjet e lëvizjes së kuadrit etj. etj.

Partia duhet të tregojë të gjithë kujdesin e saj për vendosjen mbi baza të drejta marksiste-leniniste të raportit midis interesave të ndryshme në socializëm, si një çështje me rëndësi jetike për zhvillimin e vendit, për forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë dhe të unitetit të popullit rreth Partisë e pushtetit popullor. Ajo duhet të bëjë një punë të madhe për sqarimin e drejtë dhe të thellë të këtyre problemeve dhe sidomos të intensifikojë luftën e saj kundër çdo shfaqjeje të vënies së interesave personale e të veçanta mbi interesat kolektive e të përgjithshme, t'i edukojë të gjithë punonjësit që në çdo hap të jetës së tyre të frymëzohen e të udhëhiqen nga interesat e popullit e të Partisë, nga idealet e revolucionit e të socializmit dhe t'u shërbejnë atyre me besnikëri, duke qenë të gatshëm të bëjnë çdo sakrificë, të japin edhe jetën në emër të këtyre interesave dhe idealeve.

Ne jetojmë sot në një nga periudhat më revolucionare dhe më të pasura të krijimtarisë së Partisë sonë. Si rezultat i vijës së drejtë të Partisë dhe i luftës për thellimin e mëtejshëm të revolucionit ne kemi një gjendje politike, ekonomike, ideologjike e ushtarake më të shëndoshë se kurrë. Uniteti i Partisë rreth Komitetit Qendror, me shokun Enver në krye, është i çelniqtë. Lidhjet e Partisë me klasën punëtore dhe me masat e gjera të popullit janë të pathyeshme. Të bashkuar si një trup i vetëm, Parti dhe popull, duke mbajtur lart flamurin e revolucionit, të

marksizëm-leninizmit dhe të luftës kundër imperializmit e revizionizmit modern, marshojnë fitimtarë përpara dhe kryejnë me sukses e me përgjegjësi të lartë detyrat e tyre kombëtare dhe ndërkombëtare.

Jeta ka provuar dhe po provon vazhdimisht drejtësinë e vijës revolucionare, marksiste-leniniste të Partisë, si për çështjet e revolucionit dhe të ndërtimit tonë socialist, ashtu edhe për problemet e zhvillimit të sotëm botëror. Shikoni ç'po ndodh në botën kapitaliste e revizioniste: kriza të thella, kacafytje prej banditësh, shthurje e plotë ideologjike, politike dhe morale, vështirësi dhe kontradikta të mëdha ekonomike, të cilat vërtetojnë plotësisht ato që ka thënë vazhdimisht Partia jonë. Shikoni sa poshtë kanë rënë revizionistët modernë, me ata sovjetikë në krye. Puna ka arritur deri atje sa «unitetin» midis tyre ta ruajnë ose ta rivendosin me forcën e armëve. Agresioni kundër Çekosllovakisë tregoi jo vetëm gjendjen e rëndë në të cilën ndodhet kampi revizionist dhe kontradiktat e papajtueshme që e brejnë atë, por edhe degjenerimin e plotë të klikës revizioniste hrushoviane të Bashkimit Sovjetik në një klikë imperialiste, fashiste, agresive. Ngjarjet në botë tregojnë se situata zhvillohet në favorin tonë, të forcave marksiste-leniniste revolucionare që po ngrihen dhe që do të përmbysin në zjarrin e revolucionit të gjithë armiqtë e popujve dhe të komunizmit.

Detyra jonë është të ecim pa u ndalur në rrugën që ka përcaktuar dhe na prin Partia, duke kapërcyer çdo pengesë e vështirësi, duke mbajtur lart vigjilencën dhe frymën revolucionare, duke qëndruar me vendosmëri në pozitë klasore proletare dhe duke zhvilluar me konsekuencë luftën e klasave kundër të gjithë armiqtë të popullit e të socializmit. Kjo detyrë buron nga vetë realiteti i sotëm në botë, ku bëhet një luftë e ashpër klasore midis socializmit e kapitalizmit, midis marksizëm-leninizmit e revizionizmit dhe kur brenda vendit vazhdon lufta midis dy rrugeve — socialiste e kapitaliste.

Thellimi i mëtejshëm i revolucionit tonë, lufta kundër të metave e dobësive të rritjes, kundër çdo mbeturine e shfaqjeje të huaj që kritikojmë hapur e me guxim në këtë plenum — gjë që tregon forcën e Partisë dhe të pushtetit tonë popullor, vendosmërinë për të çuar deri në fund revolucionarizimin e jetës së vendit — është një proces i zhvillimit të luftës klasore, e cila, si forcë lëvizëse e shoqërisë edhe në socializëm, është ajo armë e fuqishme në duart e klasës punëtore dhe të Partisë së saj revolucionare për realizimin e qëllimit të madh, fitores së socializmit e të komunizmit.

Partia, në shumë dokumente, ka shpjeguar gjerësisht, si aspektin parimor të luftës së klasave, rëndësinë e kuptimit të drejtë

të saj, ashtu edhe detyrat e organizatave të Partisë për zhvillimin me sukses të luftës klasore në fushat e ndryshme të veprimtarisë.

Ne duhet të mbajmë kurdoherë parasysh porosinë e Partisë se qëndrimi në pozitat e luftës së klasave, apo largimi nga këto pozita, është një gur prove, një vijë demarkacioni që i dallon marksistë-leninistët nga revizionistët, revolucionarët nga kundërshtarët e revolucionit, se çdo largim nga pozitat klasore të proletariatit dhe nga lufta e tij e klasës çon në mënyrë të pashmangshme në pozitat klasore të borgjezisë dhe në shërbim të saj për minimin e revolucionit e të socializmit.

Thelbi i çdo lloj oportunizmi e revizionizmi është fshirja e kufijve midis klasave, midis miqve dhe armiqve të klasës, është heqja dorë nga lufta e klasave dhe predikimi i pajtimit, i harmonisë dhe i bashkëpunimit midis klasave. Këtu qëndron edhe tradhëtia e revizionistëve të sotëm hrushovianë, të cilët kanë kaluar plotësisht në pozitat klasore të borgjezisë, janë shndërruar në aleatë e shërbëtorë të saj, në mbytës të revolucionit e varrëmihës të socializmit.

Përderisa lufta e klasave përshkon gjithë periudhën e kalimit deri në komunizëm dhe përfshin gjithë sektorët e jetës: politikën, ekonominë, arsimin dhe ideologjinë, pushtetin dhe gjithë veprimtarinë tonë, këtë luftë ne duhet ta shohim si detyrë të përherëshme të çdo komunisti, të çdo organizate, ta bëjmë kudo, në të gjitha fushat dhe jo vetëm në disa sektorë, ta bëjmë jo vetëm te të tjerët, por edhe në veten tonë.

Organizatave të Partisë duhet të luftojnë shfaqjet e ndryshme të indiferentizmit apo të konformizmit, që vihen re aty-këtu në disa njerëz, duke përfshirë edhe komunistë, si shfaqje të ideologjisë borgjeze, të papajtueshme me frymën luftarake e revolucionare të Partisë. Lufta kundër tyre është një aspekt me rëndësi i luftës së klasave, sepse indiferentizmi e konformizmi i largojnë njerëzit nga lufta revolucionare, mbjellin në ta pasivitet, topisin kurajën dhe guximin e njerëzve për të kundërshtuar çdo gjë të huaj për interesat e popullit dhe të revolucionit. Organizatat e Partisë duhet të bëjnë një punë të madhe me njerëzit, qofshin këta me Parti ose pa parti, të cilët duhet t'i karakterizojë një qëndrim aktiv e kritik ndaj çdo gjëje, një frymë e lartë klasore papajtueshmërie me mbeturinat e shfaqjet e huaja, me sjelljet dhe çdo gjë që bie në kundërshtim me ideologjinë e me moralin proletar. Ky është një drejtim i rëndësishëm i punës së Partisë për edukimin klasor revolucionar të komunistëve dhe të punonjëseve.

Organizatave të Partisë dhe komunistët duhet ta kenë të qartë se lufta e klasave zhvillohet si kundër armiqve të njohur, spiu-

nëve dhe kundërrevolucionarëve, ashtu edhe në gjirin e popullit, ajo zhvillohet kundër armiqve të brendshëm, por edhe kundër armiqve të jashtëm; kundër sabotimeve dhe diversionit ekonomik e politik, por edhe kundër shfaqjeve të huaja dhe mbeturinave të ideologjisë borgjeze, bartës të të cilave shpesh janë edhe njerëzit tanë. Zhvillimi i luftës së klasave në këto fusha ka veçoritë e veta. Këto veçori duhen mbajtur kurdoherë parasysh, me qëllim që në çdo rast të përcaktohet një qëndrim i drejtë dhe të zbatohet një metodë e drejtë lufte. Është fakt se ndërsa lufta kundër armikut të njohur të klasës, të brendshëm dhe të jashtëm, kuptohet dhe zhvillohet drejt, lufta e klasave sidomos në frontin ideologjik që tani është arena kryesore e luftës klasore brenda vendit, lufta kundër shfaqjeve të huaja, kundër zakoneve prapanike apo kundër burokratizmit etj., akoma nuk kuptohet si duhet dhe si rrjedhim zhvillohet më dobët. Kjo duhet të tërheqë vëmendjen tonë. Ne nuk duhet të nënvleftësojmë luftën e klasave në gjirin e popullit dhe sidomos luftën në frontin ideologjik, sepse nga kjo vijnë shumë të këqija për fatet e socializmit. Të mos harrojmë se lufta në këtë fushë është një luftë e vështirë, jo vetëm sepse bartës të koncepteve dhe të botëkuptimeve të huaja janë shpesh njerëzit tanë, shokët tanë me të cilët punojmë e jetojmë, por edhe sepse kjo luftë nuk bëhet dot me ligje e me urdhëresa, ajo kërkon përpjekje të mëdha, kërkon një punë të vazhdueshme edukative, bindëse, kërkon takt e zgjuarësi, kërkon marrjen e një kompleksi masash politike, ekonomike, organizative etj.

Duke pasur parasysh veçoritë e luftës klasore në fushat e ndryshme, organizatat e Partisë duhet të bëjnë një luftë në dy fronte: si kundër qëndrimeve oportuniste e liberale, ashtu edhe kundër qëndrimeve sektare e të ngurta. Duhet kuptuar se si qëndrimet oportuniste, ashtu edhe ato sektare janë të rrezikshme. Partia ka folur vazhdimisht për këtë çështje. Ne duhet të vëmë si kurdoherë një kufi të qartë e të prerë midis nesh dhe armiqve tanë, midis ideologjisë sonë dhe ideologjisë armiqësore dhe asnjëherë nuk duhet të dobësojmë ndaj tyre luftën tonë klasore. Në të njëjtën kohë nuk duhet të ngatërrojmë njerëzit tanë me armiqët tanë, nuk duhet të jemi të ngurtë e sektarë, por si marksistë-dialektikë, punët dhe njerëzit t'i shohim në zhvillim e ndryshim, duke bërë dallimin në konceptet, sjelljet e qëndrimet e tyre, duke bërë me ta një punë të diferencuar. Ne duhet të kemi besim të pakufishëm te masat dhe një urrejtje të madhe ndaj armiqve të klasës, të cilët as nuk duhet t'i mbivlerësojmë, por as edhe t'i nënvleftësojmë; të jemi kurdoherë vigjilentë ndaj veprimtarisë dhe ideologjisë armiqësore dhe, në të njëjtën kohë, të përpiqemi të ndreqim e të shpëtojmë të gjithë ata që

mund dhe duan të ndreqen e të shpëtohen; të mbajmë vazhdimisht të mprehtë diktaturën e proletariatit kundër armiqve tanë dhe të zhvillojmë gjerësisht demokracinë proletare për masat e popullit.

Partia na mëson që edhe në zhvillimin e luftës së klasave duhet t'i përmbahemi me vendosmëri vijës së masave. Kjo do të thotë që, ashtu si deri sot, të mbështetemi fort te masat dhe t'i ngremë ato ta bëjnë vetë luftën e klasave. Vetëm kur masat janë të ndërgjegjshme dhe e marrin vetë në duart e tyre çështjen e mbrojtjes së fitoreve të revolucionit e të socializmit, nuk mund të kalojë asnjë armik apo rrymë armiqësore, mund t'i pritët rruga çdo të keqeje dhe të sigurohet vazhdimësia e revolucionit socialist. Tërheqja aktive dhe e drejtëpërdrejtë e masave në luftën e klasave është shkolla më e madhe për vetëdukimin dhe kalitjen e masave me frymën dhe ndërgjegjen klasore proletare, për ngritjen e nivelit të tyre ideologjik e politik, për mprehjen e vigjilencës revolucionare. Revolucionar i vërtetë është dhe mund të bëhet vetëm ai që futet në revolucion, që merr pjesë aktive në luftën e klasave. Jashtë revolucionit, jashtë luftës së klasave, nuk ka dhe nuk mund të ketë edukim klasor revolucionar.

Zhvillimi me konsekuencë e në rrugë të drejtë i luftës së klasave në të gjitha fushat duhet të na shërbejë për forcimin e për kalitjen e mëtejshme të unitetit të madh të popullit e të Partisë, në të cilin qëndron forca jonë, garancia e të gjitha fitoreve tona. Lufta e klasave dhe uniteti i popullit jo vetëm nuk përjashtojnë njëri-tjetrin, por janë të varur dhe ushtrojnë një ndikim reciprok mbi njëri-tjetrin. Sa më drejt të zhvillohet lufta klasore, pra, sa më shumë pozita të fitojë socializmi në fushat e ndryshme të veprimtarisë, aq më shumë kushte të favorshme krijohen për forcimin e unitetit të popullit. Nga ana tjetër, sa më i çelniktë të jetë ky unitet, sa më bazë të shëndoshë e të gjerë të ketë ai, aq më me sukses mund të zhvillohet lufta klasore kundër armiqve të klasës dhe ideologjisë së tyre reaksionare.

Uniteti i çelniktë i popullit tonë rreth Partisë dhe i Partisë rreth Komitetit Qendror, me shokun Enver Hoxha në krye, e ka treguar kurdoherë me forcë vitalitetin e tij luftarak. Në mënyrë të veçantë dhe me një forcë të paparë ai u shpreh këto kohët e fundit. Populli ynë priti me entuziazëm dhe e aprovoi njëzëri e plotësisht vendimin e Kuvendit Popullor për denoncimin e Traktatit të Varshavës nga ana e Republikës Popullore të Shqipërisë. Me një gatishmëri shembullore, me vendosmëri e disiplinë ushtarake dhe me një ndërgjegje të lartë për detyrën e shenjtë të mbrojtjes së lirisë së atdheut dhe të fitoreve të socializmit, njëzërit tanë po zbatojnë të gjitha masat e vendosura për forcimin e gatishmërisë luftarake, në mënyrë që edhe armiku më i pabesë

të mos na zërë kurrë dhe në asnjë drejtim në befasi. Detyra e të gjitha organizatave të Partisë dhe e të gjithë komunistëve është që këtë unitet ta forcojnë e ta kalitin pareshtur.

Garancia e të gjitha fitoreve dhe e së ardhshmes sonë të ndritur është Partia. Ne kemi një Parti të fortë, revolucionare, që u përmbahet me konsekuencë parimeve të marksizëm-leninizmit dhe u shërben me besnikëri interesave të popullit dhe të socializmit. Në procesin e luftës për zhvillimin e pandërprerë të revolucionit, ashtu si në të gjitha fushat e tjera, janë arritur suksese të mëdha edhe në vetë forcimin e Partisë, të punës së saj drejtuese dhe organizuese, të jetës së brendshme dhe të veprimtarisë ideologjiko-edukative. Por ne duhet të kemi vazhdimisht parasysh porosinë e shokut Enver që

«... kalitjes së pareshtur të Partisë sonë, zhvillimit dhe thellimit të frymës së saj luftarake e revolucionare, forcimit të rolit të saj udhëheqës në të gjitha hallkat e ndërtimit socialist, duhet t'i kushtojmë kujdesin më të madh, t'i kushtojmë zemrën dhe mendjen tonë»¹.

Eksperienca historike dhe realiteti i ditëve tona vërtetojnë plotësisht mësimet e marksizëm-leninizmit se pa udhëheqjen e Partisë jo vetëm revolucionit nuk mund të ecë përpara, por rreziqe të mëdha e kërcënojnë atë. Forcimi i rolit udhëheqës të Partisë merr një rëndësi të veçantë, sidomos në fazën e tanishme të zhvillimit të revolucionit tonë, kur Partia lufton për zgjidhjen e detyrave të mëdha në të gjitha fushat e aq më tepër në fushën e ideologjisë, për forcimin dhe për kalitjen e njeriut të ri dhe të unitetit ideologjik të të gjithë punonjësve.

Në këto kushte ne duhet të forcojmë më tej punën e organizatave të Partisë, të ngremë rolin e tyre drejtues, edukues, organizues e kontrollues kudo ku ato veprojnë; të zgjerojmë sferën e veprimtarisë së tyre, në mënyrë që ato të mos kufizohen vetëm në punët praktike e korrente që kanë lidhje me planin e prodhimit, por të merren më shumë me problemet politiko-ideologjike, me zbatimin e vijës së Partisë; të rritim përgjegjësinë e çdo komunisti për detyrat e Partisë, inisiativën dhe vetëveprimin e organizatave-bazë dhe të të gjithë anëtarëve të Partisë; të punojmë pa u lodhur për forcimin e demokracisë në Parti, për respektimin dhe për zbatimin me rreptësi të normave leniniste që qëndrojnë në themel të punës dhe të jetës së saj, të gjallërojmë gjithë jetën e brendshme të organizatave të Partisë, që ajo të

¹ Shih në këtë vëllim f. 118-119.

ziejë nga debatet dhe nga mendimet krijuese, që organizatat e Partisë të jenë gjithnjë kudhra të kalitjes së komunistëve.

Puna ideologjike e Partisë duhet të ngrihet në një shkallë më të lartë, të lidhet më ngushtë me të gjitha problemet e jetës së vendit dhe t'i shërbejë më mirë zgjidhjes së detyrave të mëdha të ndërtimit tonë socialist. Gjithë puna e Partisë është një e tërë dhe e pandarë. Por sidomos çështjet ideopolitike dhe ato organizative, që përbëjnë thelbin e veprimtarisë së organizatave të Partisë, janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, prandaj ato duhen kombinuar dhe duhen harmonizuar.

Forcimi i punës edukative kërkon përmirësimin e mëtejshëm të metodës së punës ideologjike. Eksperiencia e përgjithshme e Partisë ka forcuar akoma më shumë bindjen për epërsinë e padiskutueshme të aksionit si metodë revolucionare të edukimit të komunistëve, të klasës punëtore, të rinisë dhe të gjithë punonjësve. Gërshetimi i aksionit me studimin e marksizëm-leninizmit është rruga më efektive për t'i mbyllur shtigjet çdo të keqeje dhe çdo rreziku, për të çuar përpara çështjen e socializmit, për të zgjidhur me sukses edhe problemet që trajtohen në këtë raport. Këtë metodë ne duhet ta praktikojmë gjerësisht, sepse në këtë mënyrë edukimi i komunistëve dhe i kuadrove nuk bëhet në forma të mbyllura e të ngushta si edukimi i një «elite» në vetvete, por ai bëhet bashkë dhe shkrihet me edukimin e klasës punëtore dhe të gjithë punonjësve.

Puna ideologjike e Partisë është një punë shumë e gjerë, ajo nuk kufizohet vetëm në disa forma të caktuara, siç janë sistemi i arsimit në Parti, konferencat, leksionet dhe shtypi dhe është monopoli i disa njerëzve të specializuar në këtë fushë. Kjo punë bëhet në rrugë e forma të shumta dhe ne duhet të përdorim më mirë të gjitha mjetet për këtë qëllim, që nga mbledhjet e organizatave të Partisë dhe të organizatave të masave, e deri te shkolla, letërsia artistike, teatri e kinemaja. Nga koncepti i ngushtë që e redukton punën ideologjike të Partisë vetëm në disa forma, duhet të çlirohen, në radhë të parë, vetë punonjësit e agjitacionit e të propagandës, që nga aparati i Komitetit Qendror e deri te komitetet e Partisë të rretheve.

Puna edukative e Partisë duhet të jetë më e zhdërvjellët, në mënyrë që t'i mësojmë dhe t'i edukojmë njerëzit në format më të përshtatshme e më të ndryshme. Për këtë le të përfitojmë nga përvoja e njerëzve që janë të gatshëm, të zot e me talent në qytete e fshatra, në fabrika e shkolla, të mbështetemi në ta, të marrim parasysh mendimet e tyre dhe t'i ngarkojmë të organizojnë punën në përshtatje me kushtet e çdo rrethi e qendre pune.

Për forcimin e punës së saj në të gjitha drejtimet, Partia ka tani në dorë shumë materiale e dokumente të rëndësishme të

Komitetit Qendror dhe shumë fjalime të shokut Enver, të cilat janë një pasuri me vlerë të madhe, ku komunistët dhe të gjithë punonjësit mund të gjejnë çelësin për zgjidhjen e problemeve që u dalin. Duke qenë të lidhura ngushtë me jetën, këto materiale bëjnë që parimet e marksizëm-leninizmit të mos mbeten abstrakte, por të jenë të kapshme e të kuptueshme nga të gjithë. Komitetet dhe organizatat e Partisë, kuadrot dhe të gjithë komunistët, duhet t'i studjojnë më me kujdes dhe të thellohen akoma më mirë në përmbajtjen e këtyre materialeve, sepse kuptimet e ngushta e të njëanshme, shtrembërimet e keqkuptimet në problemet e mëdha që ka shtruar Partia dhe që po diskutojmë në këtë plenum e kanë burimin edhe në studimin e sipërfaqshëm të direktivave të Partisë.

Për edukimin e komunistëve dhe të gjithë punonjësve një rëndësi të jashtzakonshme ka botimi i Veprave të shokut Enver dhe botimi i Historisë së PPSH. Veprat e shokut Enver janë një armë e fuqishme për kalitjen ideologjike të anëtarëve të Partisë, të klasës punëtore, të rinisë dhe të gjithë punonjësve. Në to mishërohet vija e përgjithshme revolucionare e Partisë sonë që nga themelimi i saj. Ato janë përgjithësimi më i plotë dhe më i saktë i eksperiencës së revolucionit e të ndërtimit tonë socialist. Ato përfaqësojnë zbatimin krijues të së vërtetës së përgjithshme të marksizëm-leninizmit në kushtet konkrete të Shqipërisë. Njëkohësisht ato janë edhe një kontribut me vlerë në thesarin e marksizëm-leninizmit, në pasurimin e teorisë e të praktikës së socializmit shkencor.

Një ngjarje me rëndësi të madhe në jetën politike e ideologjike të Partisë është edhe botimi i Historisë së PPSH, e cila së shpejti do të dalë në qarkullim. Në këtë vepër është paraqitur në mënyrë sistematike rruga revolucionare që ka përshkuar Partia jonë, lufta e madhe që ajo ka bërë për interesat e popullit e të atdheut, të revolucionit e të socializmit, në shkallë kombëtare e ndërkombëtare. Historia e PPSH është marksizëm-leninizmi në veprim në kushtet e vendit tonë.

Detyra jonë është që këto armë të fuqishme që na jep në dorë Partia, të dimë t'i përvetësojmë e t'i përdorim si duhet në luftën tonë për socializëm. Ato duhet të na shërbejnë si bazë për të ndërmarrë një aksion të madh ideologjik, për studimin e tyre të organizuar, në format më të ndryshme, nga komunistët, klasa punëtore, rinia, fshatarësia dhe inteligjencia popullore.

Shokë,

Lufta e Partisë për thellimin e revolucionit tonë socialist është një proces kompleks dhe i gjatë. Në këtë raport të Byrosë Politike u ndalëm vetëm në disa çështje dhe këto duke i parë kryesisht në aspektin e tyre ideologjik e politik. Konkluzionet e këtij raporti, me siguri, do të pasurohen me diskutimet tuaja, në të cilat përgjithësohet eksperiencia e madhe e punës dhe e luftës së përditshme të Partisë në rrethe e sektorë të veçantë të punës. Kështu punimet e këtij Plenumi do të ndihmojnë për t'i dhënë një hov të ri punës së Partisë, të organeve të pushtetit dhe të ekonomisë. Byroja Politike është e bindur se organizatat e Partisë do të dinë t'i mobilizojnë punonjësit tanë akoma më mirë, në mënyrë që të realizohen me sukses të gjitha detyrat që kemi përpara dhe të marsojmë gjithnjë fitimtarë në rrugën e revolucionit e të socializmit, në të cilën na udhëheqin me siguri e largpamësi marksiste-leniniste Partia jonë e lavdishme e Punës dhe shoku Enver.

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 237 (6276), 3 tetor 1968

V E N D I M
I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH
«MBI THELLIMIN E REVOLUCIONIT SOCIALIST
NËPËRMJET ZHVILLIMIT TË LUFTËS KLASORE
DHE ZBATIMIT TË VIJËS SË MASAVE»

28 shtator 1968

Plenumi VI i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në mbledhjen e tij të datës 27 dhe 28 shtator 1968, pasi dëgjoji dhe diskutoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi thellimin e revolucionit socialist nëpërmjet zhvillimit të luftës klasore dhe zbatimit të vijës së masave», mbajtur nga anëtarë i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Ramiz Alia,

Vendosi:

1. — Të aprovojë plotësisht raportin «Mbi thellimin e revolucionit socialist nëpërmjet zhvillimit të luftës klasore dhe zbatimit të vijës së masave».
2. — Të porosit të gjitha organizatat dhe komitetet e Partisë për ta pasur parasysh këtë raport në veprimtarinë e tyre.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**PËRSHËNDETJE E KOMITETIT QENDROR TË PPSH
DREJTUAR SHOKUT ENVER HOXHA ME RASTIN
E 60-VJETORIT TË DITËLINDJES**

16 tetor 1968

I dashur shoku Enver,

Në emër të anëtarëve të Partisë, të klasës punëtore dhe të fshatarësisë kooperativiste, të grave, të rinisë, të ushtarëve dhe të inteligjencies së vendit tonë, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, me rastin e 60-vjetorit të ditëlindjes Suaj, Ju dërgon përshëndetjet më të zjarrta revolucionare dhe urimet më të përzemërta: të rroni sa malet tona kreshnike, për të mirën e popullit dhe të Partisë sonë, udhëheqësi, mësuesi dhe shoku ynë i dashur Enver!

Duke festuar jubileun e 60-vjetorit të ditëlindjes Suaj, komunistët dhe gjithë punonjësit e atdheut tonë socialist sjellin ndër mend gjithë rrugën e përshkuar nga populli ynë gjatë këtyre tri dekadave të fundit, luftërat heroike, përpjekjet e pashembullta, punën e palodhur dhe fitoret e shkëlqyera që ka arritur populli ynë, nën udhëheqjen e lavdishme të Partisë sonë dhe që janë të pandara nga jeta dhe vepra Juaj revolucionare si udhëheqës i lavdishëm i Partisë dhe i popullit tonë.

Realizimi më i madh, fitorja themelore e popullit tonë, garancia e të gjitha suksesëve, garancia e fitores së socializmit në Shqipëri, është krijimi i Partisë sonë, si parti revolucionare e klasës punëtore, si parti e tipit të ri, që udhëhiqet nga teoria marksiste-leniniste. Ju, shoku Enver, në ditët e stuhishme të Luftës Nacionalçlirimtare të popullit tonë, në kushtet e rënda të ilegalitetit, në rrethanat e pushtimit fashist italian në Shqipëri, themeluat Partinë heroike Komuniste Shqiptare (sot Partia e Punës). Me veprimtarinë Tuaj revolucionare, si udhëheqës dhe mësues i Partisë sonë, gjatë këtyre 27 vjetëve të ekzistencës së saj, Ju keni dhënë kontributin më të madh për kalitjen ideologjike të Partisë sonë me mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, për forcimin e unitetit të çelniktë të Partisë, për for-

cimin e vazhdueshëm të rolit të saj udhëheqës si pararojë e klasës punëtore. E gjithë vepra e madhe revolucionare dhe historike e Partisë sonë është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me emrin Tuaj, i dashur shoku Enver.

Partia e bëri klasën punëtore, fshatarësinë punonjëse, gjithë popullin punonjës të ndërgjegjshëm për forcën e tij, për aftësinë e tij, për vitalitetin e tij. I udhëhequr me besnikëri e heroizëm nga Partia dhe Komiteti i saj Qendror me Ju në krye, shoku Enver, populli shqiptar, në ditët e errëta të pushtimit fashist, rroku armët, shpërtheu kryengritjen e armatosur, përmbysi fashizmin dhe regjimin feudoborgjez, çliroi atdheun dhe vendosi pushtetin popullor.

Nën udhëheqjen e Partisë, me Ju në krye, shoku Enver, Shqipëria, nga një vend i skllavëruar dhe gjysmëkolonial, u shndërrua në një vend socialist i lirë dhe sovran, me kufij të paprekshëm, me rend shoqëror të pathyeshëm, me ekonomi socialiste të përparuar, në një vend që ecën përpara me hov revolucionar të pandalshëm, duke mbajtur në një dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën, në një vend që është bërë fener ndriçues i socializmit në Evropë.

Industrializimi socialist i vendit, kolektivizimi i bujqësisë, ndërtimi dhe zhvillimi i arsimit dhe i kulturës socialiste, organizimi i fuqisë mbrojtëse të pathyeshme të vendit, forcimi i vazhdueshëm i diktaturës së proletariatit, rritja e vazhdueshme e mirëqenies së popullit, forcimi i pozitave ndërkombëtare të vendit tonë, shpërthimi dhe zhvillimi i hovshëm i revolucionarizimit të pandërprerë të të gjithë jetës së vendit, që ka për qëllim çuarjen deri në fund të revolucionit dhe bërjen të pamundur të lindjes së revizionizmit dhe të restaurimit të kapitalizmit në vendin tonë, janë fitore me rëndësi historike të arritura nga populli dhe Partia jonë nën udhëheqjen Tuaj të lavdishme, i shtrenjti shoku Enver.

Të gjitha sukseset dhe fitoret e Partisë dhe të popullit tonë janë arritur nëpërmjet përpjekjesh dhe luftërash të ashpra klasore në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Partia jonë, nën udhëheqjen e Komitetit të saj Qendror, me Ju në krye, shoku Enver, e ka zhvilluar gjithmonë drejt dhe në mënyrë konsekuente luftën e klasave, si brenda ashtu edhe jashtë radhëve të saja, si në shkallë kombëtare ashtu edhe në shkallë ndërkombëtare. Partia jonë, e armatosur me mësimet e marksizëm-leninizmit dhe nën udhëheqjen Tuaj, ka kaluar përmes dallgëve të rënda të luftës klasore dhe është regjur e kalitur në këto dallgë. Uniteti i pathyeshëm i popullit rreth Partisë dhe i Partisë rreth Komitetit të saj Qendror është forcuar e çelnikosur pikërisht në këto dallgë të luftës klasore. Partia jonë nuk ka lejuar kurrë që në

gjirin e saj të ngrënë krye pikëpamje, rryma, fraksione dhe vija të kundërta me vijën e Partisë. Partia jonë s'është pajtuar kurrë me armiqtë e klasës, nuk u ka bërë atyre kurrë asnjë koncesion. Veçanërisht e ashpër ka qenë lufta e Partisë sonë kundër revizionizmit modern, titist e hrushovian dhe në këtë luftë Partia jonë ka dalë kurdoherë fitimtare.

Sot Republika Popullore e Shqipërisë ka dalë në arenën ndërkombëtare si një shtet socialist me autoritet të padiskutueshëm, që është i pamposhtur dhe i papërkulshëm përpara të gjithë armiqtve, dhe Partia e Punës e Shqipërisë është afirmuar në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare si një brigadë sulmuese dhe heroike. Republika jonë Popullore dhe Partia e Punës e Shqipërisë, konsekuente në luftën e tyre parimore dhe në vendosmërinë revolucionare për të mbrojtur çështjen e lirisë së popujve dhe të pastërtisë së marksizëm-leninizmit, kanë luftuar dhe do të luftojnë edhe në të ardhshmen dhëmb për dhëmb me armiqtë imperialistë, me imperializmin amerikan në krye dhe me revizionistët modernë, me në krye klikën tradhëtare hrushoviane të Bashkimit Sovjetik e klikën renegate titiste jugosllave, që janë armiq të betuar të marksizëm-leninizmit, të çështjes së socializmit e të komunizmit. Pozita ndërkombëtare dhe respekti e simpatia që gëzojnë sot në botë vendi ynë dhe Partia jonë, si dhe të gjitha fitoret historike në lëmin e çështjeve ndërkombëtare, janë arritur në saje të udhëheqjes Suaj revolucionare marksiste-leniniste, i dashur mësuesi ynë shoku Enver.

Duke studjuar thellë mësimet e pavdekshme të klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe duke i zbatuar këto mësimet në mënyrë krijuese në kushtet e vendit tonë, Ju keni përpunuar një sërë tezash të rëndësishme, teorike dhe praktike, që kanë të bëjnë me sigurimin e fitores përfundimtare të rrugës socialiste në Shqipëri dhe që përbëjnë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të marksizëm-leninizmit në kushtet aktuale të ashpërsimit të luftës së klasave në shkallë ndërkombëtare, kur revizionizmi modern ka mundur që të usurpojë pushtetin shtetëror dhe të Partisë në atdheun e Leninit dhe të Stalinit, si dhe në shumicën e vendeve socialiste, kur imperializmi është futur në fazën përfundimtare të kalbëzimit të tij, kur imperializmi amerikan dhe revizionizmi sovjetik, për të zgjatur jetën e tyre dhe për të sunduar botën, kanë hyrë në aleancë të shenjtë me njëri-tjetrin, kurse, nga ana tjetër, forcat revolucionare dhe përparimtare të botës janë hedhur në luftë dhe po e zhvillojnë atë çdo ditë e më tepër për varrosjen e imperializmit dhe të revizionizmit modern.

I dashur shoku Enver,

Sot, në 60-vjetorin e ditëlindjes Suaj, komunistët dhe populli ynë, me një ndjenjë gëzimi të papërskrueshëm, dashurie dhe besnikërie të pakufishme, shprehin mirënjohjen e thellë ndaj Partisë sonë heroike dhe ndaj Jush, i dashur shoku Enver, themelues dhe udhëheqës i saj i lavdishëm, për gjithçka është bërë dhe po bëhet për të mirën e popullit tonë, të atdheut tonë socialist dhe të çështjes së revolucionit e të komunizmit. Ne, komunistët shqiptarë dhe populli shqiptar, krenohemi për veprën e madhe të Partisë sonë, krenohemi për mësuesin dhe udhëheqësin tonë të sprovuar shoku Enver.

Në emër të të gjithë anëtarëve të Partisë ne Ju sigurojmë, i dashur shoku Enver, se do të vëmë të gjitha forcat për zbatimin e vijës së Partisë, për ta çuar revolucionin tonë deri në fund, do t'u qëndrojmë besnikë deri në fund mësimëve të marksizëm-leninizmit, të Partisë sonë dhe mësimëve Tuaja, shoku Enver; Ju sigurojmë se do të ruajmë si gjënë më të shtrenjtë unitetin ideologjik, politik dhe organizativ të Partisë; do të ruajmë dhe do të forcojmë gjithmonë disiplinën e çelniqtë dhe të ndërgjegjshme, vullnetin e hekurt për zbatimin e vijës së Partisë sonë; do të jemi kurdoherë të parët në sakrifica dhe të fundit në pretendime, të gatshëm për të dhënë edhe jetën për interesat e larta të popullit dhe për çështjen e komunizmit; do të jemi të lidhur ngushtë me masat, nxënës besnikë të mësuesit të pagabueshëm popull, modestë e të drejtë si Partia dhe vendimet e saj, militantë konsekuentë në zhvillimin e luftës së klasave, për forcimin e vazhdueshëm të rolit udhëheqës të Partisë, për forcimin e vazhdueshëm të diktaturës së proletariatit dhe për forcimin e rolit udhëheqës të klasës punëtore; do të jemi vigjilentë e parimorë, të papajtueshëm me të metat dhe gabimet, të ashpër në luftën kundër armiqtve dhe të dashur me popullin, ushtarë të vendosur për të punuar e për të luftuar në frontet më të vështira, ku e kërkon ndërtimi i socializmit dhe mbrojtja e atdheut, duke vënë kurdoherë e mbi të gjitha interesat e larta të popullit, të socializmit, të revolucionit.

Me këto virtyte e cilësi të larta i ka edukuar Partia jonë dhe Ju, shoku Enver, gjithë komunistët shqiptarë. Ju personalisht, shoku Enver, në tërë jetën dhe luftën Tuaj revolucionare shumëvjeçare si komunist dhe udhëheqës, jeni shembull i madh i revolucionarit proletar, i udhëheqësit proletar, i mësuesit proletar, te i cili janë mishëruar këto virtyte e cilësi të larta. Të gjithë anëtarët e Partisë, të gjithë ne, shokët dhe bashkëluftëtarët Tuaj, mësojmë e do të mësojmë në çdo hap të jetës dhe të veprimtarisë sonë revolucionare nga mësimet dhe shembulli Juaj i lartë revolucionar konsekuent.

Në emër të komunistëve, në emër të të gjithë popullit, edhe një herë Ju urojmë me gjithë zemër, i dashur shoku Enver, jetë të gjatë, të rroni sa malet tona, për të na udhëhequr triumfalisht drejt fitores përfundimtare të rrugës socialiste, për të mirën dhe lumturinë e popullit tonë, për të mirën e lëvizjes komuniste ndër-kombëtare, për të mirën dhe triumfin e marksizëm-leninizmit, të socializmit dhe të komunizmit!

**KOMITETI QENDROR
I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË**

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 248 (6287), 16 tetor 1968*

V E N D I M

**I KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI STUDIMIN
E HISTORISË SË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË**

19 nëntor 1968

Botimi i Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë është një ngjarje me rëndësi të madhe në jetën ideologjike e shkencore të vendit.

Në tekstin e Historisë së Partisë është paraqitur rruga e lavdishme që ka kaluar Partia jonë, është përgjithësuar mbi baza shkencore marksiste-leniniste përvoja revolucionare e Partisë dhe e masave punonjëse në luftën për çlirimin kombëtar e shoqëror, për ndërtimin e shoqërisë së re socialiste dhe për ruajtjen e fitoreve të arritura.

Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë është historia e një partie revolucionare të klasës punëtore, që ka përpunuar dhe ka ndjekur në të gjitha etapat e revolucionit një vijë politike të drejtë, që ka zbatuar me besnikëri dhe në mënyrë krijuese marksizëm-leninizmin, që e ka udhëhequr me pjekuri të lartë dhe heroizëm popullin shqiptar në betejat e mëdha klasore dhe i ka siguruar atij fitore me rëndësi historike.

Vija dhe veprimtaria revolucionare e Partisë së Punës të Shqipërisë janë marksizëm-leninizmi në veprim, ato pasqyrojnë lidhjen e tij organike me praktikën e luftës revolucionare të Partisë së klasës punëtore dhe të masave punonjëse shqiptare. Përvoja revolucionare e Partisë përbën në të njëjtën kohë një pasurim të marksizëm-leninizmit.

Partia e Punës e Shqipërisë e ka ruajtur pastërtinë e vijës së vet revolucionare, unitetin e vet ideologjik e organizativ mbi baza marksiste-leniniste në luftë të vendosur parimore kundër oportunitizmit e sektarizmit, sidomos kundër revizionizmit, në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.

Partia e Punës e Shqipërisë ka lindur, është rritur dhe është forcuar si parti revolucionare e klasës punëtore në luftën klasore

kundër fashizmit italian e gjerman, kundër çifligarëve, bajraktarëve dhe borgjezisë vendëse, kundër imperializmit amerikan dhe anglez e shërbëtorëve të tyre, kundër revizionizmit titist dhe revizionizmit hrushovian, kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste.

Komiteti Qendror i PPSH, duke pasur parasysh se rruga e luftës ngadhjnjëtare revolucionare e Partisë është një shkollë e madhe e marksizëm-leninizmit në veprim dhe zhvillim krijues për komunistët dhe punonjësit tanë dhe se teksti i Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë, në të cilin pasqyrohet kjo rrugë, duhet të shërbejë si një armë e shëndoshë dhe e mprehtë ideologjike e politike për studimin e marksizëm-leninizmit nga komunistët, nga klasa punëtore, nga të gjithë punonjësit, porosit:

1. — Studimi i Historisë së Partisë t'u shërbejë njohjes së thellë të rrugës revolucionare të lavdishme të Partisë, përvetësimit të parimeve marksiste-leniniste dhe të mësimëve të mëdha të saj, formimit të njeriut të ri me moralin komunist, me ideologjinë proletare, mobilizimit të komunistëve e të gjithë punonjësve me të tëra forcat për plotësimin e detyrave të revolucionarizimit të mëtejshëm të Partisë e të gjithë jetës së vendit, ndriçimit të rrugës e të perspektivës së ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste e komuniste; forcimit të luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, rritjes së gatishmërisë për mbrojtjen e atdheut.

Në mënyrë të veçantë studimi i Historisë së Partisë të shërbejë:

— për të njohur besnikërinë e Partisë ndaj parimeve të marksizëm-leninizmit, qartësinë politike dhe pjekurinë e saj të lartë, guximin e saj revolucionar dhe zotësinë e saj për zbatimin e marksizëm-leninizmit në mënyrë krijuese në kushtet e Shqipërisë dhe në rrethanat konkrete ndërkombëtare, duke nxjerrë që këtej mësimin se besnikëria ndaj parimeve marksiste-leniniste dhe aftësia për të zbatuar me vendosmëri e në mënyrë krijuese këto parime janë garanci për kryerjen me sukses të misionit historik nga partia e klasës punëtore e të detyrave revolucionare nga çdo komunist;

— për të mësuar se si Partia jonë ka mundur të bindë masat popullore në drejtësinë e vijës së saj politike dhe mbi këtë bazë të krijojë lidhje të çelnikta me masat, t'i ruajë e t'i forcojë vazhdimisht këto lidhje, se si vija e Partisë është bërë vija e masave dhe masat punonjëse me Partinë në krye kanë luftuar e luftojnë me heroizëm për zbatimin e saj, për të njohur përvojën e madhe të Partisë në krijimin e Frontit, si mishërim i unitetit të popullit rreth Partisë në luftën për çlirimin kombëtar e shoqëror dhe për ndërtimin socialist të vendit, duke nxjerrë që këtej

mësimin marksist-leninist se, kur komunistët janë të lidhur ngushtë me masat, shkrihen me to, zbatojnë vijën e masave, mësojnë çdo ditë nga masat dhe i mësojnë ato, i nënshtrohen kontrollit të tyre, ata janë të pathyeshëm; se sa më e gjerë dhe e gjallë të jetë pjesëmarrja e drejtëpërdrejtë e masave në revolucion e në ndërtimin socialist, në qeverisjen e vendit, në drejtimin e ekonomisë e të kulturës, aq më e sigurtë është fitorja;

— për të njohur e për të kuptuar ideologjikisht luftën parimore që ka bërë Partia për ruajtjen e vijës së saj të drejtë e të unitetit të saj ideologjik e organizativ mbi baza marksiste-leniniste, për zbatimin revolucionar të normave marksiste-leniniste të jetës së brendshme të partisë së klasës punëtore, duke nxjerrë që këtej mësimin se kuptimi ideologjik dhe zbatimi revolucionar i normave marksiste-leniniste të jetës së brendshme të partisë së klasës punëtore janë kushti i parë i domosdoshëm që ajo të mos degjenerohet në parti borgjezo-revizioniste, por të ruajë të paprekur karakterin e vet proletar e të mundë kështu të plotësojë misionin e madh të udhëheqjes së revolucionit, të ndërtimit të shoqërisë socialiste e komuniste;

— për të mësuar se me sa vendosmëri, mjeshtëri dhe shpirt krijues e ka zbatuar Partia jonë parimin marksist-leninist të udhëheqjes së klasës punëtore në revolucion e në ndërtimin socialist, duke nxjerrë që këtej mësimin se klasa punëtore mund ta kryejë me sukses rolin e vet udhëheqës vetëm nëpërmjet partisë së vet politike dhe, me vendosjen e diktaturës së proletariatit, edhe nëpërmjet kësaj diktature, me kusht që udhëheqja nëpërmjet partisë e diktaturës së proletariatit të shoqërohet me kontrollin e drejtëpërdrejtë të klasës punëtore në të gjitha fushat e jetës — në pushtetin politik, në ekonomi, në arsim e kulturë dhe kudo; se kontrolli i drejtëpërdrejtë i klasës punëtore është faktor vendimtar për të mënjanuar degjenerimin borgjezo-revizionist të diktaturës së proletariatit, për t'i mbyllur shtigjet lindjes së revizionizmit dhe kthimit prapa të vendit në kapitalizëm;

— për të njohur luftën e klasave që ka zhvilluar Partia tok me masat punonjëse në etapat e ndryshme të revolucionit, duke nxjerrë që këtej mësimin marksist-leninist se lufta e klasave është një fenomen objektiv, rrjedhimisht e pashmangshme dhe përfshin të gjitha fushat politike, ekonomike, shoqërore, ideologjike e kulture, në frontin e brendshëm dhe në frontin e jashtëm; se ajo është një forcë lëvizëse kryesore jo vetëm për sa kohë ekzistojnë klasat shfrytëzuese, por edhe kur zhduken këto, si klasë, në luftën për fitoren e plotë e përfundimtare të rrugës socialiste mbi atë kapitaliste në gjithë botën; se pas zhdukjes së klasave shfrytëzuese ajo vazhdon në të gjitha fushat, por

sidomos është përqëndruar në fushën e ideologjisë e të kulturës kundër koncepteve e shfaqjeve të huaja, kundër ideologjisë borgjeze, për zhdukjen e «njollave» të shoqërisë së vjetër; se heqja dorë nga lufta e klasave ose zbutja e saj të çon në revizionizëm e në rivendosjen e kapitalizmit;

— për të njohur politikën dhe përvojën e Partisë në ndërtimin e socializmit, për vendosjen e marrëdhënieve socialiste në prodhim dhe përsosjen e tyre të vazhdueshme në rrugë revolucionare marksiste-leniniste, për zhvillimin e forcave prodhuese nëpërmjet industrializimit të vendit, intensifikimit të bujqësisë dhe krijimit të një ekonomie kombëtare shumëdegëshe, për ngritjen e pandërprerë të mirëqenies materiale dhe të nivelit kulturalo-arsimor të masave, duke nxjerrë që këtej mësimin marksist-leninist se përsosja e vazhdueshme e marrëdhënieve socialiste në prodhim është një garanci për të mos lejuar lindjen e shtresave të privilegjuara borgjeze dhe degjenerimin borgjezo-revizionist të rendit ekonomiko-shoqëror socialist, se zbatimi i drejtë i parimit të mbështetjes në forcat e veta siguron një zhvillim me ritme të shpejta të ekonomisë popullore dhe garanton pavarësinë ekonomike të vendit; se mënyra e prodhimit socialist kërkon medoemos zbatimin e parimit të harmonizimit të interesave vetjake e të çastit me interesat e përgjithshme e të perspektivës, duke ua nënshtruar kurdoherë interesat vetjake e të çastit interesave të përgjithshme e të perspektivës; se rritja e mirëqenies së njerëzve duhet të sigurojë plotësimin e nevojave materiale, kulturele e shpirtërore të të gjithë popullit dhe jo të grupeve të veçanta, në përshtatje me shkallën e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të vendit;

— për të njohur politikën e luftën e Partisë për krijimin dhe forcimin e aleancës së çelniktë midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse si edhe rolin udhëheqës të klasës punëtore në këtë aleancë, për përdorimin në revolucion edhe në ndërtimin socialist të vendit të energjive të mëdha revolucionare e patriotike të fshatarësisë punonjëse, për plotësimin e ëndrrave e dëshirave të saja dhe për kolektivizimin e zhvillimin e gjithanshëm të fshatit mbi baza socialiste, duke nxjerrë që këtej mësimin marksist-leninist se në aleancën e çelniktë të klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse qëndron forca dhe pathyeshmëria e çështjes së revolucionit e të socializmit, garancia e fitores përfundimtare të kësaj çështjeje, se vetëm nën udhëheqjen e klasës punëtore e të partisë së saj fshatarësia mund të fitojë çlirimin e plotë shoqëror, se fshati mund të zhvillohet me hapa të shpejtë në rrugën e ngushtimit shkallë-shkallë deri në zhdukjen e dallimeve thelbësore me qytetin;

— për të njohur përpjekjet e vazhdueshme të Partisë për

krijimin e inteligjencies së re socialiste, për përgatitjen e kuadrove të të gjitha degëve të ekonomisë e të kulturës, kujdesin e saj të madh për edukimin e tyre me ideologjinë proletare dhe kalitjen në veprimin revolucionar, duke nxjerrë që këtej mësimin marksist-leninist se kontrolli i vazhdueshëm i klasës punëtore dhe i fshatarësisë punonjëse mbi kuadrot e gjithë inteligjencien, edukimi i vazhdueshëm i klasor revolucionar dhe shkrirja e kuadrove, e gjithë inteligjencies me punëtorët e fshatarët është kusht i domosdoshëm për t'i mbrojtur ata nga sëmundjet e rrezikshme të burokratizmit, të individualizimit, të karrierizmit, të mendjemadhësisë, të jetës së rehatshme, të intelektualizmit dhe teknokratizmit, për të ruajtur e për të forcuar te ata thjeshtësinë proletare, besnikërinë ndaj çështjes së proletariatit, të socializmit;

— për ta edukuar rininë me besnikërinë deri në fund ndaj rrugës heroike revolucionare të paraardhësve të vet, ndaj Partisë së klasës punëtore e socializmit, për kalitjen e pareshtur revolucionare të brezit të ri edhe nëpërmjet shkollës edhe nëpërmjet veprimit revolucionar, për të siguruar që ai të jetë i gatshëm për çdo sakrificë dhe i përgatitur nga çdo pikëpamje për t'i shërbyer popullit, atdheut, socializmit, të jetë i denjë për ta çuar më tej stafetën e revolucionit në rrugën e marksizëm-leninizmit;

— për të mësuar ç'vigjilencë të lartë ka treguar vetë Partia dhe si e ka rrënjësuar ajo një vigjilencë të tillë në të gjithë punonjësit kundër synimeve dhe veprimtarisë së armiqtve të brendshëm e të jashtëm, ç'kujdes të vazhdueshëm ka treguar ajo për mbrojtjen e fitoreve të atdheut socialist, duke nxjerrë që këtej mësimin marksist-leninist se vigjilenca dhe gatishmëria e lartë moralo-politike dhe ushtarake, përgatitja e mbarë popullit për mbrojtjen e atdheut socialist është po aq e domosdoshme për ndërtimin me sukses të shoqërisë socialiste e komuniste, sa është edhe kryerja e detyrave të mëdha të zhvillimit ekonomik, kultural e shoqëror të vendit.

Pra, Historia e Partisë nuk duhet të studjohet si një histori e thjeshtë, por si një kurs i zbatimit krijues të marksizëm-leninizmit, si një gërshetim i materializmit dialektik e historik me vijën politike dhe praktikën revolucionare të Partisë sonë. Nga një studim i tillë duhen nxjerrë në pah, para së gjithash, mësimet e mëdha të Partisë, me synim që të kuptohen nga ana ideologjike këto mësimet dhe të përdoren si armë e fuqishme në zgjidhjen e detyrave e të problemeve aktuale.

2. — Studimi i Historisë së Partisë të bëhet i gërshetuar me studimin e materialeve të kongreseve, të konferencave, të

plenumëve të KQ të PPSH, të Veprave të shokut Enver, sipas periudhave dhe problemeve përkatëse.

Nëpërmjet studimit të Historisë së Partisë të studjohen gjithashtu ligjet e materializmit dialektik e historik të mishëruara në vijën dhe në luftën e Partisë.

3. — Studimi i Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë të vlejë si një mjet për të përmirësuar gjithë punën e propagandës së Partisë për ta ngritur atë në shkallën e kërkesave të kohës, të vrullit të pashembullt revolucionar që ka pushtuar masat tona punonjëse, për ta vënë atë në pararojë të luftës për revolucionarizimin e mëtejshëm të vendit.

Organizimi i punës për studimin e Historisë së Partisë të ndihmojë drejtpërdrejt në zhdukjen e cektësisë e të formalizmit në punën e propagandës, të formulave stereotipe, të frazave boshë, duke forcuar anën e argumentimit teorik të fenomeneve, të problemeve e detyrave, për krijimin e bindjes ideologjike te njerëzit.

Nëpërmjet studimit të Historisë së Partisë të sigurohet plotësimi i detyrës që shtroi Kongresi V i Partisë që marksizëm-leninizmi, ideologjia shkencore e klasës punëtore, të mos mbetet privilegj i disa njerëzve, por të bëhet pronë e masave të gjera punonjëse, të mos mbetet diçka abstrakte, por të shndërrohet në një forcë të madhe materiale për transformimin revolucionar të botës.

4. — Botimi i Historisë së Partisë të shërbejë për t'u dhënë një shtytje studimeve për problemet shoqërore e ideologjike, masivizimit dhe revolucionarizimit të këtyre studimeve.

Komiteti Qendror kërkon të ngrihet në një nivel më të lartë organizimi i punës për përgjithësimin e përvojës revolucionare të Partisë e të masave në shkallë rrethi dhe në çdo ndërmarje, kooperativë dhe institucion arsimor e kultural, duke tërhequr në këtë punë kuadrot e Partisë, të shtetit, të organizatave ekonomike, shoqërore e kulture dhe një numër të madh punëtorësh e fshatarësh.

Masivizimi i studimeve për problemet ideologjike e shoqërore të ndihmojë drejtpërdrejt për një studim më të mirë të Historisë së Partisë, për ta bërë propagandën e Partisë më luftarake e frutdhënëse, për të ngritur në një shkallë më të lartë shkencore punën drejtuese të organeve dhe të organizatave të Partisë.

Përgjithësimi i përvojës revolucionare të Partisë dhe të masave të shërbejë për pasurimin dhe për përpunimin e mëtejshëm të Historisë së Partisë.

5. — Studimi i Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë të organizohet në Parti, në klasën punëtore, në masën e fshatarësisë kooperativiste, në inteligjencien, në rini, në ushtri, duke

zënë një vend kryesor në gjithë sistemin e propagandës së Partisë.

6. — Për studimin e Historisë së Partisë të përdoren format e ndryshme më të përshtatshme të propagandës, duke filluar nga leximi i thjeshtë deri te studimi i thelluar e i shoqëruar me veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit, dokumentet e Partisë dhe Veprat e shokut Enver. Në organizimin e kësaj pune të mbahen parasysh shtresat e ndryshme të popullsisë, shkalla e përgatitjes ideologjike dhe arsimore. Për të gjitha kategoritë duhet të organizohen diskutime rreth çështjeve të Historisë së Partisë që studjohen.

Historia e Partisë të studjohet në të gjitha shkollat e mesme e të larta, si një lëndë kryesore e marksizëm-leninizmit.

Veç këtyre, komitetet e Partisë duhet të çelin edhe kurse të posaçme të Historisë së Partisë, ku të marrin pjesë kuadro dhe punonjës të përparuar, sipas nevojave.

7. — Për të siguruar një studim sa më të thellë të Historisë së Partisë nga ana e komunistëve dhe e masave punonjëse, komitetet e Partisë të rretheve t'i kushtojnë vëmendje të posaçme përgatitjes së një rrjeti të gjerë propagandistësh të Historisë së Partisë nëpërmjet kursesh, seminaresh dhe formash të tjera.

8. — Pranë Shkollës së Partisë «V.I.Lenin» të organizohen kurse të posaçme periodike, ku të kalojnë një numër sa më i madh kuadros të Partisë për një studim më të thellë të problemeve e të mësimëve që dalin nga Historia e Partisë si dhe të metodës së studimit të kësaj historie, të dokumenteve të Partisë e të Veprave të shokut Enver.

9. — Rruga e drejtë revolucionare e Partisë sonë dhe mësimet që dalin nga studimi i historisë së saj do të kuptohen e do të përvetësohen më thellë duke e organizuar më mirë studimin e veprave të klasikëve të marksizëm-leninizmit. Këto vepra përbëjnë thesarin e madh për formimin e botëkuptimit materialist, marksist-leninist të njerëzve. Ato u kanë ndriçuar dhe do t'u ndriçojnë kurdoherë rrugën Partisë së Punës dhe punonjësve shqiptarë në luftën për të arritur fitoren përfundimtare të socializmit e të komunizmit.

*
* * *

Le të shërbejë studimi i Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë për të forcuar besimin në doktrinën e pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, për të përvetësuar mësi-

met e mëdha të Partisë sonë me shokun Enver në krye dhe le të bëhet një burim i madh frymëzimi në luftën për të vënë në jetë këto mësimë dhe për të marshuar pa u ndalur në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste e të komunizmit.

**KOMITETI QENDROR
I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË**

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 278 (6317), 20 nëntor 1968*

PLENUMI VII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 26-27 dhjetor 1968

K O M U N I K A T Ë

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 26 dhe 27 dhjetor 1968, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi VII i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i cili mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi plotësimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1968 dhe detyrat e projektplanit e të projektbuxhetit të shtetit për vitin 1969», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave, shoku Spiro Koleka.

Pasi diskutoi gjerësisht rreth raportit të paraqitur, Plenumi i Komitetit Qendror e aprovoi atë njëzëri dhe mori vendimet përkatëse.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

R A P O R T

I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI PLOTËSIMIN E PLANIT DHE TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 1968 DHE DETYRAT E PROJEKTPLANIT E TË PROJEKTBUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 1969»

26 dhjetor 1968

Shoqe dhe shokë,

Në këtë mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror Byroja Politike shtron për shqyrtim: përfundimet e arritura në plotësimin e planit e të buxhetit të vitit 1968, projektplanin e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës e projektbuxhetin e shtetit për vitin 1969 dhe detyrat më të rëndësishme, ku duhet të përqëndrohet vëmendja e organeve dhe e organizatave të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë për plotësimin e planit dhe të buxhetit.

Byroja Politike vëren me kënaqësi se masat punonjëse të vendit tonë, të frymëzuara nga mësimet dritëdhënëse të Partisë dhe të shokut Enver, kanë vënë të gjitha forcat për të përvetësuar ideologjinë tonë fitimtare, për t'u pastruar sa më shumë nga mbeturinat dhe «njollat» që trashëgojnë nga e kaluara dhe për forcimin e unitetit popull-Parti dhe të aftësisë mbrojtëse të vendit. Ato kanë punuar më shumë e më mirë se çdo vit tjetër për të vënë në jetë detyrat e mëdha që shtroi Plenumi IV i Komitetit Qendror të Partisë. E gjithë jeta dhe veprimtaria e popullit tonë, gjatë vitit 1968, karakterizohet nga një rritje e madhe e inisiativave krijuese dhe e heroizmit, vrullit e optimizmit revolucionar, në luftë kundër vështirësive, kundër shfaqjeve të burokratizmit e të konservatorizmit, për të çuar më përpara revolucionin në të gjitha fushat e jetës.

Vendimet e rëndësishme të Komitetit Qendror, fjalimet programatike të shokut Enver Hoxha, fushata për dhënie llogari e zgjedhje në Parti dhe për nder të 60-vjetorit të shokut Enver, dokumentet e tjera të Partisë, akti i vendosur, i guximshëm e

revolucionar i Partisë e i qeverisë për denoncimin në kohën e duhur të Traktatit të Varshavës e daljen e vendit tonë nga ai dhe demaskimin e klikës revizioniste të carëve të rinj për agresionin e saj fashist kundër Çekoslovakisë, kanë ngritur në një lartësi të paparë entuziazmin, atdhedashurinë, vigjilencën, gatishmërinë luftarake dhe vrullin revolucionar të popullit tonë të mrekullueshëm, i kanë dhënë një hov të veçantë dhe një shtytje të re e më të fuqishme punës, mendimit krijues të masave punonjëse dhe emulacionit socialist në luftën për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

Ngritja në lartësi të reja dhe marshimi gjithmonë përpara i revolucionit, pjesëmarrja e drejtëpërdrejtë dhe më e gjerë e masave punonjëse në këtë revolucion, kuptimi gjithnjë e më i drejtë i domosdoshmërisë për transformime të thella e revolucionare nga ana e klasës punëtore dhe e të gjitha masave punonjëse, përbëjnë karakteristikën dalluese që ka spikatur gjatë këtij viti, karakteristikë kjo që është bërë forca lëvizëse për arritjen e përfundimeve të shkëlqyera në revolucionarizimin e mëtejshëm të të gjithë jetës së vendit, si në qytet e në fshat, ashtu dhe në fushën e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës.

Një pasqyrë e gjallë e vrullit revolucionar dhe e përpjekjeve shembullore të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste dhe të inteligjencies popullore, në ballë të të cilave, si kurdoherë, ka qenë klasa heroike punëtore me Partinë në krye, janë përfundimet e mira që janë arritur në plotësimin e detyrave të planit të vitit 1968 dhe gjatë tre vjetëve të pesëvjeçarit të katërt në të gjitha degët e ekonomisë e të kulturës.

I

MBI PLOTËSIMIN E PLANIT DHE TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 1968

Detyrat e caktuara nga Kongresi V i Partisë për tre vjetët 1966-1968, në përgjithësi, janë plotësuar në mënyrë të kënaqshme. Prodhimi i përgjithshëm industrial u plotësua 106 për qind. Gjatë vitit 1968 ky parashikohet të jetë më i lartë nga ai i pesëvjeçarit për vitin 1969; në disa degë, si në industrinë e bakrit, të hekur-nikelit, të material-ndërtimit, të punim-drurit dhe të letrës, arrihet dhe tejkalohet edhe pesëvjeçari për vitin 1970. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor për të tre vjetët së bashku plotësohet rreth 97 për qind. Për vitin 1968 ai është 28,1 për

qind më i madh se në vitin 1965. Veçori karakteristike e këtyre 3 vjetëve të pesëvjeçarit të katërt është se prodhimi i përgjithshëm bujqësor ka filluar të ketë më shumë qëndrueshmëri dhe rritje nga njëri vit në tjetrin. Vëllimi i investimeve për të tre vjetët të marrur së bashku u plotësua 103 për qind. Të ardhurat kombëtare në vitin 1968 u rritën 35 për qind kundrejt vitit 1965; qarkullimi i mallrave, u rrit 21,8 për qind; të ardhurat reale të punëtorëve e të nëpunësve u rritën 10 për qind dhe të ardhurat reale të fshatarësisë — 14 për qind. Eksporti si trevjeçar u tejkalua 6,3 për qind.

Fitoret e arritura gjatë këtyre tre vjetëve janë një dëshmi e gjallë e kuptimit dhe e vënies në jetë nga masat punonjëse të mësimave të Partisë e të shokut Enver për revolucionarizimin e jetës së vendit. Ato janë një mbështetje e fuqishme dhe garanci e sigurtë për të ecur përpara më shpejt dhe më me siguri për plotësimin para kohe të detyrave të pesëvjeçarit.

Përfundimet e arritura gjatë vitit 1968 në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës në përgjithësi janë të kënaqshme.

Punonjësit e industrisë në përgjithësi dhe ata të gjeologjisë, naftës e minierave në veçanti, kanë kuptuar dhe kanë zbatuar drejt porositë e Kongresit V të Partisë, për të zbuluar burime e mundësi të reja dhe për t'i përdorur ato sa më shpejt e më me dobi. Duke vënë në jetë porositë e Plenumit III të Komitetit Qendror për revolucionin tekniko-shkencor ata ngritën gjatë këtij viti në një shkallë më të lartë mendimin krijues dhe inisiativat revolucionare; ndërtuan me forcat e veta reparte e linja të reja, shtuan prodhimin e mallrave të përdorimit të gjërë dhe plotësuan planin e përgjithshëm industrial 101 për qind, duke prodhuar 17 për qind më shumë se në vitin 1967.

Me përjashtim të rretheve të Përmetit, të Tepelenës, të Sarandës dhe të Fierit që e kanë plotësuar planin nëntëmujor përkatësisht: 97,8 për qind, 94,2 për qind, 99,5 për qind dhe 99,4 për qind, të gjitha rrethet e kanë plotësuar dhe e kanë tejkaluar planin e prodhimit të përgjithshëm industrial. Midis rretheve dallohen veçanërisht rrethi i Tiranës, i Durrësit, i Shkodrës, i Elbasanit, i Korçës, i Lushnjës, i Krujës, i Gjirokastrës, i Lezhës dhe i Gramshit.

Punonjësit e ndërmarrjeve bujqësore dhe fshatarësia kooperative bënë një luftë këmbëngulëse për të marrë sa të ishte e mundur më shumë prodhim. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor për të tre vjetët u plotësua rreth 97 për qind, për bimët e arave — rreth 99 për qind, për drithërat e bukës — rreth 105 për qind dhe për blegtorinë — rreth 96 për qind. Për vitin në vazhdim punonjësit e bujqësisë morën zotime të guximshme dhe punuan si asnjëherë tjetër për zbatimin e orientimeve të Plenumit IV

të Komitetit Qendror të Partisë për të marrë nga 1/3 e sipërfaqes së mbjellë me grurë 30 kv. për hektar dhe nga 1/4 e sipërfaqes së mbjellë me misër 40 kv. për hektar. Puna e madhe e kujdesi i vazhdueshëm i punonjësve të bujqësisë bënë të mundur që prodhimi i përgjithshëm bujqësor, megjithëse plani u plotësua rreth 91 për qind, të mos bjerë nën atë të vitit të kaluar. Planin e shtetit në prodhimin e drithërave të bukës u plotësua 105 për qind. Ai është më i larti që është arritur deri sot në vendin tonë. Pa punën e madhe të fshatarësisë, në këtë vit bujqësor me çrregullime kaq të mëdha atmosferike, dëmet në bujqësi do të kishin qenë më të mëdha.

Gjatë vitit 1968 përfundime të mira kanë arritur punonjësit e bujqësisë të rrethit të Durrësit për prodhimin dhe grumbullimin e drithërave të bukës, orizit, qumshtit, mishit e fasules; të rrethit të Matit për prodhimin dhe grumbullimin e drithërave të bukës, patates, duhanit, qumshtit e mishit; të rrethit të Tiranës për prodhimin dhe grumbullimin e drithërave të bukës, orizit, qumshtit e mishit; të rrethit të Lushnjës e të Krujës për prodhime të larta në grurë dhe të rrethit të Korçës për prodhimin e panxhar-sheqerit, të duhanit e të tjera.

Me përfundime të pakënaqshme e mbyllin vitin 1968 punonjësit e bujqësisë të rrethit të Tepelenës e të Përmetit, të cilët, përveç mishit, nuk plotësojnë planin e shtetit në asnjë nga llojet e prodhimeve bujqësore e blegtorale, të rretheve të Beratit, të Durrësit, të Fierit e të Lushnjës për prodhim shumë të keq të pambukut, të rretheve të Elbasanit e të Shkodrës për prodhimin dhe grumbullimin e keq të duhanit e të tjera.

Me përfundime të mira e mbyllin vitin 1968 punonjësit e tregëtisë socialiste, të cilët në qarkullimin e mallrave për fshatin arritën afërsisht masën e parashikuar për vitin 1970 dhe për qytetin atë të vitit 1969. Rrjeti i dyqaneve në fshat gjatë një viti e gjysmë u rrit sa në 10 vjetët e mëparshëm të marrur së bashku.

Për përmirësimin e furnizimit, të shërbimit të popullit, të zgjerimit të rrjetit të tregëtisë, sigurimin e rezervës së mallrave, tejkalimin e planeve të qarkullimit dhe rritjen e nivelit të tregëtisë në qytetet dhe qendrat e punës dallohen në mënyrë të veçantë rrethet dhe organizatat tregëtare të Durrësit, Elbasanit, Gjirokastrës, Korçës, Librazhdit, Shkodrës dhe Tiranës. Mungesa në furnizimin ritmik të popullit me perime, qepë, patate, mallra të decentralizuara etj. janë vërejtur sidomos në rrethet dhe në organizatat tregëtare të Gramshit, Lushnjës, Sarandës dhe Tepelenës.

Përfundime të mira janë arritur edhe në plotësimin e detyrave të planit në fushën e investimeve dhe ndërtimeve, në

transport, në arsim, shëndetësi etj. Gjithashtu përfundime të mira janë arritur në plotësimin e buxhetit të shtetit: në të ardhurat — 100,3 për qind dhe në shpenzimet — 97,7 për qind.

Gjatë vitit 1968 u bënë përpjekje më të mëdha për zbatimin e Deklaratës së Komitetit Qendror të Partisë e të Këshillit të Ministrave të 29 prillit 1967. Furnizimi i kooperativistëve e i punonjësve të fermave shtetërore me perime, qumësht etj. ka qenë më i mirë se vitin e kaluar. Një hop i madh përpara u bë në fshat për ngritjen dhe për zgjerimin e rrjetit të artizanatit dhe të punishteve industriale, si pasojë e të cilave është përmirësuar shërbimi ndaj kooperativistëve. Ngritja e mensave, furrave, çerdheve, kopshteve e vendeve për larjen e teshave etj. kanë lehtësuar mjaft punën e gruas në fshat. Duke vlerësuar përfundimet e arritura vetëm si fillim i mirë, organizatat e Partisë të mos kënaqen, por të zbulojnë shkaqet, të kritikojnë të metat që janë vërtetuar dhe të dendësojnë punën e tyre për të çuar më përpara e për të thelluar më tej masat për zbatimin e Deklaratës, sidomos në kooperativat e zonave kodrinore-malore.

Gjatë vitit në vazhdim u plotësua më së miri detyra e caktuar nga Plenumi IV i Komitetit Qendror të Partisë mbi elektrifikimin e fshatit. Deri në ditët e para të nëntorit u elektrifikuan 300 fshatra, kundrejt 244 fshatra që parashikon plani.

Një përhapje të gjerë mori inisiativa revolucionare e frymëzuar nga fjala e shokut Enver në Peshkopi për ndërtimin e banesave me punë vullnetare. Në vitin 1968 nga shteti u ndërjuan 3000 apartamente ose 100 për qind kundrejt planit dhe me punë vullnetare — rreth 2500 kundrejt 4000 që ishte zotimi. Si vit i parë në këtë lëvizje, kjo është një fitore e madhe. Përvoja e këtij viti do të shërbejë për një organizim më të mirë të kësaj lëvizjeje nga ana e shtetit dhe për të përdorur më mirë e më drejt gatishmërinë e punonjësve për të punuar vullnetarisht në ndërtimin e banesave të çdo lloji dhe në veçanti të atyre më të thjeshta.

Me gjithë përfundimet e kënaqshme që u përmendën, Byroja Politike e quan të domosdoshme të theksojë se duhen bërë përpjekje të tjera më të mëdha për të mënjeluar të metat e dobësitë në punë dhe për të kapërcyer më shpejt vështirësitë që dalin përpara.

Gjatë vitit 1968 është punuar më mirë për ndjekjen dhe për zbatimin e planit në çdo tregues; në krahasim me të kaluarën janë shënuar përparime. Megjithëse metodologjikisht çështja e planit dhe e ndjekjes së plotësimit të tij për çdo lloj prodhimi është zgjidhur drejt dhe me gjithë punën e vazhdueshme sqaruese e bindëse të Partisë, ka ende drejtues të ekonomisë, të organeve shtetërore dhe të Partisë, të cilët në punën e tyre pri-

ren më shumë nga plotësimi i planit në treguesit e përgjithshëm në vleftë dhe lënë në dorë të dytë plotësimin e planit sipas llojeve, për çdo zë dhe në kohën e caktuar.

Të meta dhe dobësi vërehen gjithashtu në prodhimin dhe në furnizimin e popullit me disa mallra të përdorimit të gjerë, në përpjekjet e pamjaftueshme që bëhen për rritjen e rendimentit në punë dhe për uljen e kostos së prodhimeve, për thjeshtësimin dhe përmirësimin e cilësisë së ndërtimeve, për shfrytëzimin e mirë të automjeteve, rimorkiove e tjera. Duhet theksuar se problemet e treguesve cilësorë të planit e në veçanti të rritjes së rendimentit të punës dhe të uljes së kostos ende nuk janë bërë probleme të klasës punëtore e të fshatarësisë dhe nuk janë marrë në dorë siç duhet nga këto.

Duke kritikuar të metat e dobësitë në punë, të cilat do të shtjellohen më poshtë, Byroja Politike mendon se përvoja shumë e pasur e masave punonjëse në prodhim dhe në organizimin e punës, që u përfitua në vitin 1968 duhet shikuar jo vetëm si fitore e madhe e vijës së Partisë dhe e përpjekjeve heroike të popullit tonë, por ajo duhet përgjithësuar, përhapur dhe zhvilluar më tej si një mjet i fuqishëm kundër të metave e dobësive dhe për kapërcimin e vështirësive. Është e domosdoshme që organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë këtej të nxjerrin mësimet e nevojshme për përmirësimin gjithmonë e më shumë të metodës dhe të stilit në punë dhe duke mësuar e përfituar nga masat, të veprojnë më me guxim dhe më me shkathtësi për ta çuar punën edhe më përpara, që drejtimi i ekonomisë t'u përgjigjet kërkesave të kohës dhe vrullit revolucionar të masave.

II

DETYRAT KRYESORE TË PROJEKTPLANIT DHE TË PROJEKTBUXHETIT PËR VITIN 1969

Projektplani dhe projektbuxheti për vitin 1969 u hartuan me pjesëmarrjen e gjerë të punonjësve, të cilët, me propozimet e tyre të vlefshme dhe të guximshme, bënë të mundur që në përgjithësi të tejkalohen parashikimet e pesëvjeçarit në treguesit më të rëndësishëm.

Projektplani i vitit 1969 mbështetet në detyrat kryesore që cakton pesëvjeçari, në bazën materialo-teknike dhe në përfundimet që janë arritur deri sot në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës, në entuziazmin, vrullin revolucionar, mençurinë dhe vendosmërinë e punonjësve për të ecur përpara, duke u mbështetur në forcat tona dhe, mbi të gjitha, në vijën e drejtë e në

forcën e madhe organizuese e drejtuese të Partisë dhe në unitetin e pathyeshëm të popullit me Partinë.

Në përcaktimin e treguesve të projektplanit dhe të projektbuxhetit për vitin e ardhshëm janë mbajtur parasysh vendimet dhe porositë e Komitetit Qendror për të shtuar kujdesin për përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetesës të masave punonjëse, orientimet për rritjen e prodhimit të mallrave të përdorimit të gjerë, për zhvillimin në përgjithësi të fshatit, e sidomos të zonave kodrinore e malore, për zhvillimin e artizanatit dhe të punishteve industriale në fshat, për lehtësimin e punës së gruas dhe në përgjithësi për revolucionarizimin e të gjithë jetës së vendit.

Projektplanit dhe projektbuxheti i shtetit për vitin 1969 parashikojnë detyra të mëdha, por plotësisht të mundshme për t'u vënë në jetë. Prodhimi i përgjithshëm industrial e bujqësor kundrejt vitit 1968 do të rritet 16,2 për qind, nga i cili, prodhimi i përgjithshëm industrial 12,4 për qind dhe prodhimi i përgjithshëm bujqësor 22,1 për qind më shumë. Nga prodhimi i përgjithshëm industrial, prodhimi i grupit A (mjete prodhimi) do të rritet 13,1 për qind dhe prodhimi i grupit B (mallra përdorimi) — 11,5 për qind.

Rritje të ndjeshme janë parashikuar në projektplan për vëllimin e investimeve dhe të ndërtimeve: investimet do të rriten 31,5 për qind, ndërtime — 22 për qind; nga këto ndërtime prodhuese nuk kanë rritje kundrejt vitit 1968, kurse ndërtime jo-prodhuese do të rriten 109 për qind më shumë.

Vëllimi i transportit të mallrave do të rritet 8,5 për qind në ton kilometër dhe transporti i udhëtarëve 13,3 për qind. Ministria e Komunikacionit dhe ndërmarrjet e saja të marrin masa për të përballuar nevojat e transportimit të mallrave, duke shfrytëzuar më mirë automjetet e në veçanti rimorkiot, sidomos gjatë tremujorëve të parë e të dytë. Ndërmarrjet prodhuese të sigurojnë jo vetëm ngarkim-shkarkim më të shpejtë të mjeteve, por prodhimin sipas kontratave e të mos përsëritin atë që ndodh gati çdo vit, sidomos në sharrat, që të mos sigurohet plotësisht malli në tremujorët e parë e të dytë.

Treguesit që karakterizojnë mirëqenien e masave punonjëse kundrejt vitit 1968 do të rriten: të ardhurat kombëtare — 16,4 për qind, qarkullimi i mallrave — 10,9 për qind; të ardhurat reale të punëtorëve e të nëpunësve kundrejt vitit 1965 do të rriten 14-16 për qind dhe të ardhurat reale të fshatarësisë — 24-26 për qind; numri i nxënësve dhe i studentëve, kundrejt vitit 1968, do të rritet 6 për qind, eksporti do të rritet 8,7 për qind, të ardhurat në projektbuxhetin do të rriten 17,5 për qind dhe shpenzimet — 18 për qind.

Plotësimi i këtyre detyrave do të bëjë të mundur që vendi ynë të bëjë hapa të tjerë të rëndësishëm përpara në zbatimin e direktivave të Kongresit V të Partisë për zhvillimin e forcave prodhuese dhe për përmirësimin e mirëqenies materiale dhe të ngritjes kulturele të punonjësve.

Projektplanit dhe projektbuxheti i shtetit për vitin 1969 paraqitin disa veçori, ndër të cilat më kryesoret janë:

Së pari, shumica e treguesve të rëndësishëm të planit të vitit 1969 tejkalojnë detyrat e caktuara në planin pesëvjeçar për këtë vit dhe në shumë prodhime arrihen e tejkalojnë detyrat e caktuara në pesëvjeçar edhe për vitin 1970. Kështu p.sh. prodhimi i përgjithshëm industrial, duke u mbështetur në një shfrytëzim më të mirë të aftësive prodhuese, në burimet dhe rezervat e reja të brendshme, në uzinat e fabrikat e reja që vihen në shfrytëzim gjatë vitit 1968 si dhe në fabrikat, repartet e linjat e reja të ndërtuara me vetë forcat e kolektivave punonjëse, është parashikuar rreth 8 për qind më shumë se në vitin 1970. Po kështu parashikohet të tejkalojnë detyrat e vitit 1970 në investime, në ndërtime, në të ardhurat kombëtare, në qarkullimin e mallrave, në eksportin etj.

Së dyti, detyra për rritjen e prodhimit të përgjithshëm bujqësor prej 22,1 për qind në vitin 1969 kundrejt vitit 1968, e barabartë me detyrën e parashikuar në pesëvjeçar, është njëkohësisht më e larta që është caktuar deri sot në zhvillimin e bujqësisë. Në planin e prodhimit të primeve, të lule diellit, të qumshtit e të lopëve janë parashikuar detyra më të mëdha se pesëvjeçari.

Së treti, në projektplan është parashikuar që vëllimi i investimeve të rritet 30,3 për qind dhe vëllimi i ndërtimeve — 28,4 për qind më shumë se pesëvjeçari.

Kjo rritje e madhe e ndërtimeve për vitin 1969 bëhet me qëllim që t'i jepet një shtytje më e fortë dhe më e shpejtë zhvillimit të forcave prodhuese dhe përmirësimit të ndjeshëm të kushteve të punës e të jetesës së klasës punëtore dhe të punonjësve në përgjithësi. Ndërtime për sektorët shoqërorë e kulturale të jenë rreth 3,4 herë më shumë kundrejt vitit 1968 dhe për banesat — 67 për qind.

Së katërti, fondi i akumulimit për planin e vitit 1969 parashikohet të rritet 28 për qind më shumë se në vitin 1968 dhe fondi i konsumit — 14 për qind. Peshat specifike e akumulimit do të jetë 35,1 për qind nga 27,9 për qind sipas pesëvjeçarit. Me gjithë këtë rritje të akumulimit niveli i jetesës së masave punonjëse jo vetëm që nuk ulet, por përkundrazi përmirësohet. Gjatë shqyrtimit të projektplanit Byroja Politike e KQ të PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH mbajtën parasysh që brenda

mundësive maksimale të sigurohej si zhvillimi i forcave prodhuese (për të cilat investimet dhe ndërtimet janë mjaft të larta kundrejt pesëvjeçarit), ashtu edhe përmirësimi i ndjeshëm i kushteve të punës dhe të jetesës së klasës punëtore dhe të punonjësve në përgjithësi.

Gjatë këtyre viteve, në zbatim të vendimeve të Kongresit V të Partisë, të fjalimeve programatike të shokut Enver Hoxha mbi revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit, mbi emancipimin e plotë të gruas, mbi kooperimin dhe revolucionin tekniko-shkencor, mbi revolucionarizimin e mëtejshëm të arsimit e të kulturës dhe mbi kontrollin e klasës punëtore, kanë lindur nevoja për investime e për ndërtime mbi parashikimet e pesëvjeçarit. Këto investime e ndërtime kanë krijuar kushte si për zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese, ashtu edhe për përmirësimin e kushteve të jetesës së punonjësve. Këtë, përveç të tjerave, e dëshmojnë rritja e prodhimit industrial të grupit B, 9 për qind më shumë në vitin 1968 kundrejt pesëvjeçarit dhe 14 për qind më shumë në projektplanin e vitit 1969 dhe rritja e qarkullimit të mallrave përkatësisht — 6 për qind më shumë dhe 12 për qind.

Së pesti, në projektplan parashikohet që të ardhurat reale për frymë, në krahasim me vitin 1965, të rriten për punëtorë e për nëpunës (punonjës në marrëdhënie pune me shtetin) 14-16 për qind dhe për fshatarësinë 24-26 për qind, ndërsa pesëvjeçari parashikon që të ardhurat reale në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, të rriten 9-11 për qind për punëtorët e për nëpunësit dhe 20-25 për qind për fshatarësinë. Pra, siç shihet, në qytet rritja e të ardhurave reale për frymë arrin që në vitin 1969 afërsisht 1,5 herë detyrën e caktuar në pesëvjeçar për vitin 1970, kurse në fshat të ardhurat reale për frymë rriten me ritme më të ulëta se ato të qytetit. Kjo do të përmirësojë më tej gjendjen e qytetit, por do ta bëjë edhe më të theksuar dallimin qytet-fshat.

Rritja me ritme më të shpejta e të ardhurave të punonjësve në marrëdhënie pune me shtetin nga ritmi i caktuar në Kongresin V të Partisë ka ardhur si pasojë:

a) E rritjes së pjesëmarrjes në punë, në industri, bujqësi, ndërtim, tregëti etj. mbi parashikimet e pesëvjeçarit: deri në fund të këtij viti kanë hyrë në marrëdhënie pune me shtetin 27 mijë punëtorë më shumë; ky numër në fund të vitit 1969 parashikohet të ngrihet në 43 mijë vetë.

b) E një sërë masash të marrura në vitin 1967 në dobi të punëtorëve e të nëpunësve si p.sh. rregullimi i pagave të ulëta, heqja e tatimit mbi të ardhurat, ulja e kuotës së bashkimeve profesionale etj. të cilat, duke zbritur efektin e heqjes së kom-

pensimit të veshmbathjes, të stimujve materialë etj., kanë dhënë një përfitim vjetor prej rreth 45 milion lekë.

Vëmë në dukje se, ndërsa për numrin e punëtorëve mbi parashikimet e pesëvjeçarit, kemi pasur rritje të prodhimit industrial, të vëllimit të ndërtimeve, të zgjerimit të rrjetit të tregëtisë (dhe tejkalim të qarkullimit të mallrave) dhe të shërbimeve, për fshatarësinë nuk është përfshirë tejkalimi i planit të shtetit ose plotësimi i planeve të brendshme për vitin 1969 dhe si rrjedhim edhe i rritjes përkatëse të të ardhurave për frymë.

Nga sa u tha më sipër del e domosdoshme që organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë të marrin masa të veçanta për plotësimin medoemos të planeve të brendshme sidomos në bujqësi, të mbajnë mirë parasysh gjatë zbatimit të planit furnizimin e fshatit me mallra të përdorimit të gjerë dhe të mendojnë me kohë e të parashikojnë masat që duhen marrë në dobi të fshatarësisë, sidomos të asaj të zonave malore, me qëllim që të arrihet një harmonizim më i mirë i rritjes së mirëqenies së fshatit në krahasim me qytetin.

Megjithëse detyrat e projektplanit të vitit 1969, për të gjitha degët e ekonomisë, janë më të mëdha se çdo vit tjetër, nuk ka asnjë dyshim se punonjësit tanë, me mendimet, krijimtarinë dhe vrullin revolucionar që i karakterizon, kur të shtrojnë për zberthim planin e aprovuar për vitin 1969, do të gjejnë burime e mundësi të reja për të siguruar jo vetëm plotësimin, por edhe tejkalimin e këtyre detyrave. Organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, gjatë zberthimit dhe shtrimit të planit të vitit të ardhshëm të bëjnë një punë politike të posaçme për t'ua bërë sa më të qarta të gjithë punonjësve detyrat e këtij plani dhe t'u shtjellojnë në mënyrë të veçantë rëndësinë dhe kuptimin politik të planeve të brendshme.

III

MBI DISA PROBLEME E DETYRA, KU DUHET TË PËRQËNDROJMË VËMENDJEN PËR PLOTËSIMIN E PLANIT DHE TË BUXHETIT PËR VITIN 1969

A) 1. — Organizatat dhe komitetet e Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë, në lëmin e rritjes së prodhimit industrial, krahas masave të tjera, një kujdes të veçantë të tregojnë për industrinë e naftës. Për të përballuar nevojat e ekonomisë me naftë dhe me nënprodhimet e saj, gjatë vitit 1969 parashikohet të prodhohen rreth 100 mijë ton më shumë nga sa para-

shikon plani i katërt pesëvjeçar për vitin 1970 dhe baras me detyrën që ka caktuar më vonë qeveria për këtë vit.

Kërkimet gjeologjike për naftë të hollë dhe zbulim rezervash gazi deri tani nuk kanë dhënë përfundimet që priteshin. Kjo ka bërë që të pakësohet prodhimi i naftës së hollë dhe i gazit për vitin 1969. Ky deficit është mbuluar duke rritur prodhimin e naftës brut mbi detyrat e pesëvjeçarit.

Përpunimi i naftës më të trashë nga sa është parashikuar në pesëvjeçar dhe mosplotësimi i prodhimit të gazit na detyron që edhe gjatë vitit 1969, për të përbulluar nevojat e ekonomisë, të importojmë mijëra ton benzinë, gazoil, vajguri dhe solar mbi parashikimet e pesëvjeçarit.

Ministria Industri-Minierave dhe organet e Partisë e të pushtetit në rrethet që merren me industrinë e naftës të shumëfishojnë përpjekjet për të shtuar më tej rezervat e naftës dhe të gazit, për të zbuluar vendburime të reja me naftë të hollë e me gaz, për të përbulluar nevojat në lëndë djegëse për vetë industrinë, që nga viti në vit po rriten me shpejtësi të madhe. Njëkohësisht organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë në qendër e në bazë të tregojnë shqetësim të veçantë dhe ta shtrojnë e ta bëjnë problem të madh të kolektivave punonjëse çështjen e kursimit të karburantëve dhe të lëndëve djegëse në përgjithësi, duke vendosur një kontroll dhe disiplinë shumë të fortë në përdorimin e tyre, duke mos lejuar as shpërdorimin më të vogël.

2. — *Shfrytëzimi i plotë i aftësive prodhuese të industrisë ushqimore dhe asaj të lehtë kërkon sigurimin e lëndëve të para nëpërmjet rritjes së prodhimit dhe të grumbullimeve të prodhimeve bujqësore e blegtorale.* Përvoja e disa vjetëve me radhë ka treguar se komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve dhe Ministria e Bujqësisë nuk u kanë kushtuar sa duhet vëmendje ndërmarrjeve të industrisë ushqimore dhe asaj të lehtë për t'u siguruar në sasi e në kohë lëndët e para të nevojshme për shfrytëzimin e plotë të aftësive prodhuese.

Gjatë vitit 1968 plani i prodhimit të salcës së domates u plotësua vetëm 36 për qind, pse rrethi i Vlorës, i Lushnjës e i Fierit nuk prodhuan domate në sasi e duar-duar, në një kohë kur u importua një linjë e veçantë për prodhimin e salcës dhe kjo mbeti pa u shfrytëzuar. Plani i prodhimit të kompostos u plotësua rreth 51 për qind, i perimeve të konservuara rreth 83 për qind etj. Për mungesë përpjekjesh nga komitetet ekzekutive të rretheve: Burrel, Kukës, Mirditë, Pukë, Shkodër etj., grumbullimi i shqemes me vështirësi u plotësua rreth 15 për qind, kurse tre-katër vjet më parë grumbullohej pesë-gjashtë herë më shumë. Si rrjedhim, plani i prodhimit të ekstraktit të shqemes u

plotësua vetëm 90 ton, në një kohë kur fabrika ka aftësi prodhimi për rreth 1200 ton ekstrakt tanini.

Organet e Partisë dhe të pushtetit të rretheve të sipërme çështjen e mosgrumbullimit të shqemes ta shohin jo si një çështje të thjeshtë ekonomike, por si një shprehje të lidhjes me pronën e punën vetjake. Tre-katër vjet përpara shqema në malësitë e Veriut grumbullohej nga ekonomitë vetjake. Mosgrumbullimi nga kooperativat tregon se nuk bëhet sa duhet punë politike nga organet dhe nga organizatat e Partisë për të bindur njerëzit se këto shfaqje nuk pajtohen me botëkuptimin proletar dhe kjo është në dëm, në radhë të parë, të vetë anëtarëve të kooperativave.

Prodhimi i industrisë ushqimore dhe i industrisë së lehtë vitin që vjen do të rritet përkatësisht 7,6 për qind dhe 11,2 për qind, prandaj edhe detyrat e furnizimit me prodhime bujqësore do të jenë më të mëdha dhe më të gjera në llojshmëri, sidomos për perimet. Ministria e Bujqësisë, komitetet ekzekutive të rretheve, ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore të bëjnë kthesë në lëmin e furnizimit të industrisë ushqimore me prodhime perimesh duar-duar, nëpërmjet mbjelljeve të hershme dhe të vona, me llojet e perimeve në përshtatje me kërkesat e tregut të jashtëm dhe të brendshëm. Ministria e Industrisë, nga ana tjetër, të marrë masa për të zgjidhur më shpejt problemet e grumbullimit dhe të pranimit të tyre nga ndërmarrjet e industrisë ushqimore.

3. — *Organet e Partisë dhe të pushtetit t'i kushtojnë më shumë vëmendje marrjes së masave dhe shumëfishimit të përpjekjeve për plotësimin e detyrave në bujqësi, veçanërisht për organizimin dhe forcimin e shërbimit të mbrojtjes së bimëve.*

Për të siguruar bukën në vend dhe për të plotësuar detyrat e tjera të caktuara nga Kongresi V i Partisë, në lëmin e bujqësisë kërkohet një punë më e organizuar, përpjekje më të mëdha për vënien në përdorim të të gjitha forcave dhe mjeteve për të kapërcyer vështirësitë dhe për t'u dalë me kohë përpara të papriturave që mund të vijnë nga kushtet jo të mira të klimës. Organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë të përqëndrojnë vëmendjen në radhë të parë, në prodhimin e drithërave të bukës, por pa venitur kujdesin që duhet të tregojnë edhe për të gjitha llojet e prodhimeve të tjera bujqësore e blegtorale, në përshtatje me rëndësinë dhe peshën që ato kanë për ekonominë në tërësi.

Për t'ia arritur qëllimit është e domosdoshme që lëvizjen

për eksperimentimin shkencor masiv në bujqësi ta zhvillojmë më tej e më gjerë. Lëvizja revolucionare, që në 1/3 e sipërfaqes së grurit të merren 30 kv. për hektar e në 1/4 e sipërfaqes së misrit 40 kv. për hektar dhe në pjesën tjetër rendimentin e planifikuar, të vazhdojë më tej me hov e besim në fitore, të zbatohet në mënyrë më të organizuar e më dinamike. Çdo rreth dhe ekonomi bujqësore ka veçoritë e veta, prandaj edhe rendimentet e larta të parashikohen në përputhje me to, të jenë të diferencuara e mobilizuese në të gjitha rastet. Në rrethet fushore, sidomos në ato ku shteti ka bërë investime kolosale për bonifikime e ujitje, rendimenti i grurit 30 kv/ha dhe i misrit 40 kv/ha mund të merret në sipërfaqe më të mëdha se në 1/3 dhe 1/4, ose në 1/3 e sipërfaqes së grurit dhe 1/4 e sipërfaqes së misrit të merren zotime për rendimente më të larta se 30 e 40 kv/ha. Eksperimentimi shkencor masiv dhe lëvizja revolucionare për të marrë rendimente të larta, siç veprohet për grurin dhe për misrin, në vitin 1969 të shtrihet edhe në patatën, në bimët industriale, në blegtori e të tjera, në masën që do të gjykojnë organet e Partisë dhe të pushtetit në bazë dhe në përshtatje me kushtet e secilit rreth.

Organizatat e Partisë dhe organet shtetërore të punojnë më shumë e më mirë për të sqaruar dhe për të bindur plotësisht punonjësit e bujqësisë se, për të plotësuar detyrat në bujqësi, rolin kryesor në përcaktimin e fatit të prodhimit e luajnë masat agroteknike dhe faktori vendimtar që vendos mbi zbatimin e tyre është puna dhe vetëm puna e njerëzve. Koha dhe faktorët e jashtëm mund të bëhen të pafuqishëm ndaj punës dhe forcës së njeriut. Në këtë vështrim është e domosdoshme që vitin e ardhshëm të organizohet shumë më mirë se deri tani kryerja e shërbimeve agroteknike në tërësinë e tyre dhe në mënyrë të veçantë mbrojtja e bimëve nga dëmtuesit e ndryshëm. Përfundimet e dobëta të këtij viti në disa prodhime bujqësore treguan qartë se lufta për mbrojtjen e bimëve nga dëmtuesit dhe nga sëmundjet e ndryshme ndodhet në një shkallë të ulët dhe nuk u përgjigjet detyrave të mëdha dhe problemeve të ndërlikuara që kanë dalë e po dalin çdo vit në këtë lëmë. Dëmtimi në një masë kaq të madhe i pambukut nga krimbi, i duhanit nga vru-gu e të tjera gjatë këtij viti dëshmojnë qartë për këtë.

Përvoja ka treguar se dëmtuesit dhe sëmundjet në bujqësi zhvillohen e përhapen në masë, veçanërisht kur gjejnë kushte të përshtatshme klimatike, sikurse kanë qenë kushtet e këtij viti. Por jeta ka vërtetuar gjithashtu se dëmtimet kanë qenë më të vogla në ato ekonomi bujqësore ku të gjitha hallkat e kodit agroteknik zbatohen në një shkallë më të lartë dhe ku është organizuar më mirë tërheqja e të gjithë punonjësve në

luftën për mënjanimin e shkaqeve që ndihmojnë në zhvillimin e dëmtuesve dhe të sëmundjeve. P.sh. në rrethin e Lezhës mbrojtja e bimëve është organizuar më mirë se në rrethet e tjera. Me këtë problem merren të gjithë specialistët e bujqësisë, në çdo ekonomi bujqësore shtetërore e kooperativiste janë ngritur grupe për zbulimin dhe për luftimin e insekteve e sëmundjeve, janë hedhur në veprim të gjithë punonjësit e bujqësisë. Në përgjithësi dëmtuesit janë luftuar në kohën e duhur dhe pasojat e këqija të tyre kanë qenë relativisht më të vogla. Duke u mbështetur në përvojën e rrethit të Lezhës dhe të ekonomive të tjera është e domosdoshme që edhe për këtë problem të mbështetemi te masat, ta bëjmë problem të tyre, të hedhim fshatarësinë dhe të gjithë punonjësit e bujqësisë në luftë për mënjanimin e shkaqeve që ndihmojnë në zhvillimin e dëmtuesve e të sëmundjeve dhe për shfarosjen e dëmtuesve dhe të insekteve të dëmshme; të pengojmë në çdo mënyrë përhapjen e tyre në të ardhshmen nga njëra zonë te tjetra. Ministria e Bujqësisë dhe institutet shkencore përkatëse të marrin masa të ngutshme për të organizuar, drejtuar dhe kontrolluar punën për shërbimin e mbrojtjes së bimëve dhe për furnizimin me kohë të rretheve me mjete luftimi.

4. — *Përmirësimi rrënjësor i gjendjes në blegtori dhe forcimi i mëtejshëm i bazës ushqimore të saj është një problem që ende nuk është vënë në rrugë si duhet dhe që kërkon përpjekje të jashtzakonshme për të ngritur në këmbë masat e për t'i bërë ato më të vetëdijshme mbi domosdoshmërinë e zgjidhjes së tij.*

Projektplani i vitit 1969 parashikon një zhvillim të mëtejshëm të blegtorisë në përshtatje me detyrat e caktuara në planin e katërt pesëvjeçar dhe me kërkesat e reja më të mëdha për përmirësimin e furnizimit të punonjësve me prodhime blegtorale. Në përgjithësi detyrat për rritjen e gjedhit mbështeten në një bazë më të fortë riprodhimi, të krijuar sidomos pas daljes së vendimit të Komitetit Qendror «Mbi masat që duhen marrë për shtimin e mëtejshëm të lopëve, përmirësimin e racës së tyre dhe shtimin e qeve të punës». Detyra relativisht të mëdha janë parashikuar për shtimin e numrit të shpendëve dhe për prodhimin e mishit të tyre. Inisiativa që shpërtheu në përgjegje të thirrjes së Partisë që edhe zonat malore të bëhen burim qumshti, mishi, gjalpi, djathi, përhapja e lopëve në malësi, dhënia falas e bagëtive nga kooperativat e fushës, kooperativave të zonave kodrinore e malore, të gjitha këto janë një mbësh-

tetje e fortë për plotësimin e detyrave që caktoi Kongresi V i Partisë.

Në kushtet e tanishme sigurimi i ushqimeve përbën problemin numër një për blegtorinë. Nuk mund të shkojë blegtoria përpara me hapat e dëshiruar pa zgjidhur problemin e bazës ushqimore. Këtë e ka thënë gjithmonë Partia, por zgjidhja e këtij problemi ka mbetur ende në duar të pak njerëzve. Ministria e Bujqësisë, organet e Partisë dhe të pushtetit në rreth dhe organizatat-bazë të Partisë në kooperativat bujqësore e fermat ta bëjnë këtë çështje të masave; ta marrin këto në duart e tyre këtë problem dhe të detyrojnë administratat e kooperativave e të ndërmarrjeve bujqësore që, për sigurimin e ushqimeve për bagëtinë, të kalojnë vendosmërisht në marrjen e masave konkrete, në radhë të parë, për të rritur rendimentin e bimëve forrajere dhe për të shfrytëzuar plotësisht, më mirë e më drejt tokat që planifikohen për ushqimin e bagëtisë.

5. — *Të bëhen përpjekje më të mëdha për rritjen më shumë të prodhimit të mallrave të përdorimit të gjerë dhe për zgjerimin e shërbimeve dhe meremetimeve për popullsinë.*

Furnizimi i popullit me prodhime bujqësore e mallra industriale është përmirësuar nga viti në vit. Por në treg ndihet mungesë për disa mallra si pasojë e mosplotësimin të planit dhe e përdorimit të disa prodhimeve për qëllime të tjera. Edhe shërbimet e meremetimit e artizanatit e të komunales në qytete janë shtuar çdo vit, por ato nuk u përgjigjen siç duhet kërkesave gjithmonë në rritje. Organet qendrore, organet e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë në rrethe, organizatat-bazë të Partisë në qendra pune, klasa punëtore dhe të gjithë punonjësit e bujqësisë, problemet e qarkullimit të mallrave e të furnizimit të popullit dhe problemet e shërbimeve e të meremetimeve të artizanatit e të komunales, duhet t'i shohin si çështje shumë të rëndësishme të lidhjeve të drejtëpërdrejta midis Partisë e masave dhe si rrjedhim të bëjnë kthesë në këtë fushë.

Për këtë problem të madh gjatë këtij viti nga komitetet ekzekutive të rretheve dhe organet qendrore u bë një studim i veçantë për vitet 1968-1970. Ky studim u shqyrtua nga Këshilli i Ministrave i RPSH e Byroja Politike e KQ të PPSH dhe u përcaktuan masat konkrete, si për zgjerimin e aftësive të industrisë që prodhon mallra të përdorimit të gjerë, për kohën e tanishme dhe në perspektivë, ashtu dhe për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes së monedhës në qarkullim.

Gjatë hartimit të projektplanit për vitin 1969 përsëri ky problem u shqyrtua me kujdes, duke pasur parasysh edhe ma-

sat që u përcaktuan nga Këshilli i Ministrave dhe Byroja Politike. Fuqia blerëse e popullsisë në vitin 1969 ka një rritje prej rreth 10 për qind kundrejt vitit 1968. Kjo fuqi blerëse është mbuluar me mallra dhe shërbime. Por, duke u nisur nga përvoja e deritanishme, është lënë një rritje e monedhës në qarkullim si pasojë e rritjes dhe e zhvillimit të ekonomisë në përgjithësi, e rritjes së numrit të njerëzve në marrëdhënie pune me shtetin, e rritjes së të ardhurave të fshatarësisë, e zgjerimit të marrëdhënieve monetare në fshat, e zgjerimit të rrjetit të tregëtisë gati në çdo fshat etj.

Përvoja e deritanishme na mëson dhe kërkon që t'u dalim përpara të papriturave në këtë fushë, prandaj:

a) Dikasteret, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve të përqëndrojnë vëmendjen dhe të vendosin një kontroll shumë të rreptë në radhë të parë në marrjen dhe në mbajtjen e fuqisë punëtore, duke iu përmbajtur pa asnjë lëndje fondit të pagave të caktuar në planin e shtetit;

b) organizatat e Partisë në ndërmarrjet tregëtare dhe ato prodhuese, krahas kujdesit për të siguruar mallrat e përdorimit të gjerë të nomenklaturës së përqëndruar, t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë edhe prodhimit të mallrave të nomenklaturave të dikasterit, të komiteteve ekzekutive dhe të ndërmarrjeve;

c) Organet e tregëtisë të bëjnë një luftë të pandërprerë, veçanërisht me ndërmarrjet e industrisë së lehtë, e industrisë së përpunimit të drurit, e industrisë mekanike, e industrisë ushqimore, me kooperativat e artizanatit etj. që të sigurojnë sa më shumë mallra që shpërndahen prej tyre e që prodhohen kryesisht me lëndë të parë vendi, me mbeturina e materiale që gjenden më lehtë.

ç) Organizatat-bazë, komitetet e Partisë e komitetet ekzekutive në rrethe dhe drejtuesit e ekonomisë të synojnë që, nëpërmjet shtimit të mallrave të përdorimit të gjerë dhe zgjerimit të shërbimeve e meremetimeve të artizanatit e komunales, jo vetëm të krijohen kushte për një furnizim më të mirë të popullsisë me mallra dhe për përmirësimin e shërbimeve për të cilat ajo ka shumë nevojë, por të bëhet e mundur që të nxitet prodhimi i vendit dhe të thithet më lehtë dhe më shpejt fuqia blerëse e popullit.

Këtu është e domosdoshme të theksojmë se prodhimi i mallrave të përdorimit të gjerë duhet të kuptohet dhe të zbatohet në tërësinë e tij të plotë, si për mallrat industriale, ashtu edhe për mallrat ose lëndët e para bujqësore e blegtorale. Vëmendje të veçantë e të vazhdueshme kërkon sidomos prodhimi i mishit, qumshtit, djathit, perimeve, frutave etj., të cilat në përdorim të drejtëpërdrejtë ose të përpunuar, thithin pjesën më të madhe të

buxhetit të çdo familjeje. Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë e ato ekzekutive në rrethe dhe të gjitha organizatat e Partisë në kooperativat e ndërmarrjet bujqësore të shqyrtojnë në frymë të thellë autokritike gjendjen dhe masat për prodhimin e mallrave ushqimore dhe të zbulojnë rezerva të reja për shtimin e tyre.

Në projektplanin e vitit 1969 janë parashikuar masa për shtimin e prodhimit të mishit veçanërisht të mishit të shpendëve... Për këtë është e domosdoshme të merren masa të posaçme me kohë nga organet shtetërore përkatëse dhe kooperativat bujqësore për prodhimin dhe shpërndarjen e inkubatorëve, për prodhimin dhe grumbullimin e vezëve, për ndërtimin e kotecëve të zogjve e të tjera. Masat për rritjen e shpendëve për vezë e mish të merren me frymë revolucionare dhe me ndjenjën e përgjegjësisë përpara Partisë për zbatimin e tyre. Ka ardhur koha që të heqim dorë nga fjalët e shumta dhe të prodhojmë më shumë mish, jo vetëm nga shpendët, por edhe nga derri, pse aty-këtu ka tërheqje nga prodhimi i mishit të derrit, pse gjoja nuk e ha populli. Masa të ngutshme duhen marrë për sigurimin e farërave për mbjelljen e perimeve, që zënë vitin që vjen një sipërfaqe 50 për qind më të madhe se këtë vit.

B) Përveç çështjeve e detyrave të mësipërme Byroja Politike e KQ të PPSH mendon se të tri problemet që do të trajtohen më poshtë kërkojnë për një kohë të gjatë vëmendje të veçantë nga të gjitha organizatat e Partisë, organet shtetërore e të ekonomisë.

1. — *Çdo dikaster, çdo rreth, çdo ndërmarrje e kooperativë të plotësojë planin e prodhimit industrial e bujqësor në të gjitha llojet e zërat, në kohë dhe t'i jepet fund rendjes pas prodhimit të përgjithshëm në vleftë.*

Prodhimi i përgjithshëm industrial në vleftë gjatë vitit në vazhdim u plotësua, ndërsa sipas dikastereve, llojeve e zërave të prodhimeve detyrat e planit nuk u plotësuan. Kështu, gjatë 9 muajve të këtij viti prodhimi i përgjithshëm industrial është plotësuar 103 për qind, kurse Ministria e Tregëtisë, Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Arsimit dhe e Kulturës nuk e kanë plotësuar. Ministria Industri-Minierave prodhimin e përgjithshëm industrial po për këtë periudhë e ka plotësuar 103,5 për qind, por nga 15 degë në 4 prej tyre detyrat nuk janë plotësuar. Prodhimi në natyrë sipas llojeve të nomenklaturës së Këshillit të Ministrave dhe të ministrisë pritet të plotësohet rreth 75 për qind. Industria e naftës p.sh. prodhimin e përgjithshëm në vleftë e plotëson rreth 102 për qind, por krijon deficite në prodhimin e benzinës, vajgurit dhe solarit.

E njëjta gjë ndodh edhe me prodhimin industrial sipas rretheve. Nga 14 rrethe që kanë në planin e shtetit për të prodhuar deri në 60 lloje mallrash, vetëm rrethi i Kukësit e i Matit kanë plotësuar planin në të gjitha zërat, kurse rrethi i Krujës e ka plotësuar vetëm në 40 për qind të zërave, i Përmetit — në 53 për qind, i Gramshit — në 55 për qind e të tjera.

Kujdes krejt i pamjaftueshëm tregohet për plotësimin e planit të disa mallrave të ashtuquajtura të vogla dhe me vleftë të ulët, të cilat rëndojnë mbi përdoruesit, sepse ato janë të domosdoshme dhe lidhen drejtpërdrejt me plotësimin e nevojave të tyre. Qëllimi më i lartë i Partisë është plotësimi gjithmonë e më mirë i nevojave të popullit. Por, ndërmjet kërkesave e nevojave të popullit nga njëra anë, dhe qëndrimit burokratik të mjaft kuadrove që tërhiqen nga interesat e çastit e të ngushta të ndërmarrjes, të rrethit apo të dikasterit, nga ana tjetër, ka një kontradiktë, e cila duhet të kapërcehet medoemos, ndryshe kjo do të dëmtojë rëndë politikën e Partisë.

Organizatat e Partisë në fshat kanë bërë e po bëjnë një punë të madhe politike dhe edukative për zbatimin e vendimeve të Plenumit të KQ të PPSH të Qershorit 1963, për të zhdukur prapambetjen në mënyrën e jetesës, për të përmirësuar përbërjen dhe mënyrën e të gatuarit e të ushqyerit, kushtet e fjetes, të higjienës etj. dhe si rrjedhim janë arritur përparime të dukshme në këtë fushë. Por, puna e organizatave të Partisë has në vështirësi të mëdha për zbatimin e direktivave të Partisë, pse nuk shoqërohet kurdoherë edhe me marrjen e masave organizativo-teknike nga organet shtetërore e të ekonomisë, pse prodhimi i disa mallrave nuk plotësohet sipas planeve dhe detyrave të caktuara.

Organizatat e Partisë bëjnë punë të madhe që të bindin fshatarët të flenë në kushte më të mira. Por kur NISH Prodhimet e Lushnjës, të Peshkopisë etj., nuk plotësojnë planin e prodhimit të shtretërve, të sustave për shtretër, të dollapeve të rrobave, të mindereve e të tjera, atëhere kjo, natyrisht, nuk mund të mos ndikojë për keq në zgjidhjen e kësaj detyre.

Organizatat e Partisë në fshat luftojnë, gjithashtu, që fshatarët të mos hanë në një enë, që secili të hajë në enë më vete, që të mos hanë më në sofër, por në tryezë, që të ngrihet në një shkallë më të lartë higjiena, pastërtia etj., por kjo punë e Partisë nuk gjen kurdoherë mbështetje materiale, sepse p.sh. NISH Prodhimet Berat e Pogradec nuk plotësojnë planin e prodhimit të tryezave e të dollapëve të kuzhinave; NISH Porcelani nuk plotëson planin e prodhimit të pjatave e tasave; asnjë kooperativë artizanati nuk plotëson planin e prodhimit të fshesave, kurse organet e bujqësisë në rrethe nuk marrin masat e

nevojshme për prodhimin e lëndës së parë për fshesat etj.

Në fshat ndihet nevojë për poçeri të trashë, për tulla e tje-gulla, gëlqere, nallane, shporta e prodhime të tjera që mbështen në shfrytëzimin e lëndëve të para lokale. Përse nuk plotësohen më mirë këto nevoja, kur për këto prodhime nuk kërkohen as pajisje e materiale importi? Përse nuk nxitet dhe nuk organizohet vetëveprimi dhe inisiativa e kooperativave bujqësore për të zgjidhur sa më shpejt e sa më mirë këto probleme? Ç'bëjnë Komisioni i Planit, ministritë përkatëse dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve?

Kështu ndodh edhe në ndërtim. Gjatë nëntëmujorit të këtij viti, plani i ndërtimeve në tërësi (kufi e nën kufi) nga ndërmarrjet e Ministrisë së Ndërtimit është plotësuar 96,9 pëi qind, ndërsa në veprat kufi vetëm 87,5 për qind; nga 127 vepra kufi plani u plotësua e u tejkalua vetëm në 30 vepra. Planit i ndërtimeve në lëmin e industrisë nga Ministria e Ndërtimit është plotësuar 102,6 për qind, ndërsa nga të 42 veprat kufi vetëm në 9 janë plotësuar detyrat sipas planit; nga 30 vepra të bujqësisë vetëm në 7 prej tyre janë plotësuar detyrat sipas planit; plani i ndërtimit për komunikacionin është plotësuar 101,8 për qind, ndërsa nga 22 vepra kufi plani është plotësuar vetëm në 10 prej tyre e të tjera. Në të njëjtën kohë plani i ndërtimit të veprave nën kufi dhe i veprave jashtë planit është plotësuar 137,1 për qind. Ky tejkalim i veprave nën kufi, veç të metave të ndërmarrjeve të ndërtimit, shpjegohet, në radhë të parë, me presionin e madh që bëjnë ndaj organizatave të ndërtimit rrethet, të cilat, të nisura nga interesat e ngushta të tyre, u japin epërsi veprave të vogla e me rëndësi lokale.

Ministrinë e Ndërtimit duhet ta shqetësojë shumë fakti se nga 16 ndërmarrje të saja, vetëm 10 prej tyre plotësojnë planin vjetor dhe vetëm në vleftë.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave kanë tërhequr vazhdimisht vëmendjen ndaj shfaqjeve e qëndrimeve që pengojnë plotësimin e planit në të gjithë treguesit. Ata kanë theksuar vazhdimisht se ekonomia popullore ka nevojë për të gjitha llojet e prodhimeve dhe në atë masë që janë përfshirë në planin e shtetit. Çdo lloj prodhimi ka vendin e vet në plan e në ekonomi dhe si rregull, ai nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësohet me tejkalimin e një prodhimi tjetër. Duke u dhënë epërsi një ose disa prodhimeve, për të cilat duhet të tregohet një kujdes i veçantë, në të njëjtën kohë dhe krahas këtyre, duhet t'u kushtohet medoemos vëmendja e duhur edhe prodhimeve të tjera. Po atëherë, përse ndodh në mënyrë të përsëritur një gjë e tillë? Si punojnë dhe si drejtojnë shokët ministra dhe aparati i tyre? Përse lejojnë ata që në degë të ndryshme të

industrisë, në ndërtim, në komunikacion, plani të mos plotësohet në të gjitha zërat? A nuk tregojnë këto të dhëna se aparatet tona qendrore dhe drejtuesit e tyre ende nuk janë shkëputur dhe nuk po shkëputen vendosmërisht nga metoda dhe stili i vjetër i punës, nga ndjekja me hope e çështjeve dhe e problemeve të prodhimit?

A i ka tërhequr vëmendjen komitetit të Partisë dhe komitetit ekzekutiv të k.p. të rrethit të Beratit fakti se ky rreth që ka plotësuar planin e prodhimit të përgjithshëm industrial si nëntëmujor 102,9 për qind, nuk ka plotësuar veçse 81 zëra nga 161 të planifikuara dhe zë vendin e 24-t midis rretheve në plotësimin e kësaj detyre? A janë shqetësuar dhe a e kanë bërë problem komiteti i Partisë dhe komiteti ekzekutiv i k.p. të rrethit të Fierit, që nga 163 zëra të planit të prodhimit industrial ka plotësuar vetëm 98 zëra dhe për pasojë zë vendin e 19-të midis rretheve të tjera? Po kështu rrethi i Tiranës, i cili ka plotësuar planin e prodhimit industrial gjatë nëntë muajve 106,8 për qind, kurse për plotësimin e planit sipas zërave zë vendin e 9-të, rrethi i Shkodrës vendin e 7-të etj.

Ku e ka burimin kjo gjendje? Natyrisht, këtu mund të ketë edhe shkaqe objektive, por duke qenë se këto çrregullime nuk ndodhin vetëm në fund të vitit, por ndeshen gjatë gjithë vitit, kjo tregon se nuk luftohet me këmbëngulje e në mënyrë sistematike për mënjanimin dhe kapërcimin e shkaqeve objektive. Arsyet kryesore duhen kërkuar, në radhë të parë, në punën e pamjaftueshme politike dhe edukative të shoqëruar me masat e duhura organizative dhe ekonomike, në mënyrë që kuadrot, specialistët dhe punonjësit të bëhen të vetëdijshëm për domosdoshmërinë e plotësimit të planit në të gjitha llojet, zërat e në kohë dhe t'u pritët rruga të gjitha shfaqjeve e veprimeve që bien në kundërshtim me vijën dhe me direktivat e Partisë. Organet qendrore të shtetit dhe të ekonomisë, komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve dhe organizatat e Partisë në çdo qendër pune duhet të luftojnë sistematikisht për të çrrënjësuar konceptin dhe praktikën konservatore dhe antisocialiste të rendjes pas prodhimit të përgjithshëm në vleftë, pas disa treguesve «kryesorë». Plotësimi i planit në prodhimin e përgjithshëm në vleftë nuk është qëllim në vetvete. Detyrë themelore e të gjitha organeve dhe organizatave ekonomike është plotësimi gjithnjë e më mirë i kërkesave dhe i nevojave të ekonomisë dhe të popullit me të gjitha llojet e prodhimeve të planifikuara, pa bërë asnjë dallim.

Në bujqësi gjithashtu nuk luftohet sa duhet dhe, për pasojë, plani nuk plotësohet sipas zërave të prodhimit as në tërësi si Republikë as në çdo rreth. Gjatë vitit në vazhdim u arritën përfundime të mira në prodhimin e drithërave të bukës, por plani i

prodhimit të pambukut nuk plotësohet veçse rreth 40 për qind, i duhanit — rreth 75 për qind, i ullirit — 20 për qind, e të tjera. Mosplotësimi i planit vetëm në pambuk e duhan krijon një deficit të ndjeshëm në bilancin e pagesave të tregëtisë së jashtme.

Edhe rrethet që kanë arritur përfundime të mira në bujqësi, nuk i kanë plotësuar detyrat e planit në të gjitha llojet e prodhimeve. Kështu p.sh. rrethi i Durrësit nuk plotëson planin e prodhimit të pambukut, patates, duhanit e lule diellit; rrethi i Krutës nuk plotëson planin e patates, duhanit, lule diellit, qumshtit, mishit; rrethi i Korçës nuk plotëson planin e drithërave të bukës, të lule diellit, të qumshtit; rrethi i Tiranës nuk plotëson planin e patates, duhanit dhe lule diellit. Po kështu janë edhe rrethet e tjera.

Kushtet e këqija atmosferike, natyrisht, kanë ndikuar në prodhim, por nuk është e drejtë t'ua hedhim atyre krejtësisht këto deficite, sepse, me gjithë kushtet e këqija atmosferike, në grurë e në misër u morën rendimente të mira; edhe në prodhimin e panxharit të sheqerit, megjithëse në rrethin e Korçës nuk ranë shira për një kohë të gjatë, përfundimet gjithashtu janë mjaft të mira. Prandaj është e domosdoshme që të zbulohen dhe të njihen mirë të gjitha shkaqet e këtij prodhimi kaq të ulët në pambuk, duhan, qumësht, mish e të tjera. Të marrim p.sh. pambukun. Pa nënvlehtësuar kushtet atmosferike, duhet thënë se gjatë këtij viti janë vërejtur pakujdesi të theksuara në prodhimin dhe në ruajtjen e farës, në mbjelljen (sidomos në mbirjen) me vonesë, në mungesën e qarkullimit bujqësor, në moskryerjen në kohën e duhur të shërbimeve kulturore.

Në Kongresin V të Partisë shoku Mehmet Shehu ka thënë: «Një kooperativë bujqësore mund të thotë se e siguron prodhimin e bukës me forcat e veta vetëm atëhere kur prodhimi i drithërave të bukës të sigurohet jo vetëm për një vit, por kur gjen stabilitet katër-pesë vjet rresht, duke mos u varur prodhimi nga koha, por vetëm nga puna e njerëzve, kur buka prodhohet jo vetëm atëhere kur moti është i mirë dhe bie shi në qershor dhe në korrik, por edhe atëhere kur dimrit vërshojnë shira të mëdha, kur mbjelljet pengohen nga thatësira apo nga shirat dhe behari bën thatësirë. Kur të mos varemë më nga mëshira e kohës, vetëm atëhere mund të themi se mund të sigurojmë një stabilitet në prodhimin bujqësor»¹.

Byroja Politike e quan të nevojshme të theksojë se Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive

¹ Mehmet Shehu. Raport i mbajtur në Kongresin V të PPSH, f. 73, Tiranë, 1967.

të k.p. të rretheve nuk e kanë kryer si duhet detyrën e tyre, nuk kanë drejtuar, organizuar dhe kontrolluar punën në mënyrë që lufta e punonjësve të bujqësisë, për t'u bërë sa më shumë të pavarur nga kushtet atmosferike, të ngrihej në një shkallë më të lartë.

Përvoja e këtij viti tregon se ndikimi për keq i kushteve atmosferike mund të kapërcehet dhe detyrat në fushën e rritjes së prodhimit bujqësor mund të plotësohen, por për këtë duhet të ngrihen në këmbë e tërë Partia dhe të gjithë punonjësit e bujqësisë. Ministria e Bujqësisë, komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve, komitetet dhe organizatat e Partisë duhet t'i kishin dalë me kohë punës përpara, pse s'e kishin vështirë të kuptonin se mosplotësimi i planit në të gjitha llojet e prodhimeve bujqësore e blegtorale, përveç pasojave ekonomike, përbën një problem të madh politik, pse kjo thëllon shpërpjestimin në të ardhurat reale për frymë midis fshatit e qytetit dhe vështirëson furnizimin e klasës punëtore.

Një shembull i mirë që duhet të përgjithësohet në të gjitha rrethet dhe për të gjitha llojet e bimëve bujqësore është puna e organizatës së Partisë të rrethit të Lushnjës për kapërcimin e vështirësive të klimës në prodhimin e grurit.

Ministria e Bujqësisë dhe specialistët e saj në rrethe të ndihmojnë vazhdimisht dhe konkretisht për t'i zbuluar dhe për t'ua bërë të njohur në kohën e duhur punonjësve të bujqësisë dëmet që vijnë nga kushtet e këqija atmosferike dhe të organizojnë e të udhëheqin më mirë tërheqjen e tyre në luftë për kapërcimin e vështirësive. Ministria e Bujqësisë, që ka përgjegjësinë kryesore, dhe komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve të analizojnë në mënyrë të gjithanshme e të thellë shkaqet, të zbulojnë rrënjët e dobësive dhe të metave e të nxjerrin mësim jo vetëm për bimën e pambukut, por edhe për duhanin, ullirin, lule diellin, qumshtin, mishin etj. Të marrin masa që deficitet e vitit 1968 në pambukun, duhanin etj. të mos përsëriten më, që të shumëfishohen, në radhë të parë, përpjekjet për stabilizimin e prodhimit të drithërave të bukës dhe krahas kësaj edhe për stabilizimin e prodhimit bujqësor e blegtoral, ashtu siç porosit Kongresi V i Partisë.

2. — *Të përqëndrojmë forcat për të zbatuar në kohë detyrat e mëdha të parashikuara në projektplanin e vitit 1969 në lëmin e ndërtimeve, duke e parë këtë vit si përcaktues për ndërtime shumë më të gjera, më të mëdha e më të ndërlikuara në vjetët e ardhshëm.*

Investimet dhe ndërtimet e zbatuara në vendin tonë kanë luajtur një rol të madh në fuqizimin e gjithanshëm të degëve të

ndryshme të ekonomisë dhe të kulturës. Ato kanë qenë një faktor i dorës së parë për industrializimin socialist të vendit, për fuqizimin me hapa të shpejtë të bujqësisë, për zhvillimin e kulturës, për përmirësimin e kushteve të banimit, për rritjen në përgjithësi të forcave prodhuese dhe për forcimin e bazës materialo-teknike të socializmit në vendin tonë.

Puna e madhe që është bërë dhe përfundimet që janë arritur në fushën e ndërtimeve nga punëtorët dhe nga punonjësit e ndërtimit nën udhëheqjen e Partisë, janë një dëshmi e gjallë e krijimtarsisë dhe e cilësisë për ndërtim të popullit tonë, e përparimit dhe e zhvillimit të gjithanshëm të ekonomisë dhe të kulturës në rrugën e ndërtimit socialist të vendit.

Punimet e vitit të parafundit të pesëvjeçarit janë të një rëndësie vendimtare dhe lidhen me zbatimin e punimeve përfundimtare për vënien në shfrytëzim të disa veprave me rëndësi industriale, për kryerjen e bonifikimeve dhe të veprave të reja ujitëse, për ndërtim rrugësh dhe asfaltinain e tyre, për ndërtime më të mëdha shoqëroro-kulturale etj.

Edhe projektplanin i vitit 1969, ashtu si edhe në vjetët e mëparshëm, ka në themel të tij orientimin e përgjithshëm të Partisë që, nëpërmjet ndërtimeve të reja të shpejtohet industrializimi socialist i vendit, të zgjerohen punimet e ndërtimit për rritjen e prodhimit bujqësor, të zhvillohen degët e tjera të kulturës dhe të përmirësohen kushtet e punës dhe të jetesës së punonjësve.

Rritja e vëllimit të ndërtimeve, për të cilën u fol më sipër, është edhe më e rëndë, po të merret parasysh edhe ndryshimi i strukturës së ndërtimeve dhe shpërndarja e tyre. Veç kësaj, gjatë vitit 1969, organet e Partisë e të pushtetit dhe organizatat e ndërtimit duhet të bëjnë një punë shumë të madhe për t'u përgatitur për ndërtime si vëllim dhe si madhësi, më të rënda, e më të vështira, siç do të jenë veprat e reja që do të ndërtohen me ndihmën internacionaliste të RP të Kinës sipas marrëveshjes së përfunduar kohët e fundit.

Ndihma e re ekonomike që do të na jepet nga RP e Kinës, është një fitore e madhe e shkëlqyer e vijës së Partisë sonë me shokun Enver Hoxha në krye.

Vëllimi i ndërtimeve nuk matet vetëm me sasinë e veprave, por me llojin, madhësinë dhe rëndësinë e jashtëzakonshme që ato kanë për zhvillimin perspektiv të forcave prodhuese të vendit tonë. Veprat që do të ngrihen me ndihmën e RP të Kinës përbëjnë strumbullarin e veprave përcaktuese të industrisë së rëndë që do të ndërtojmë në pesëvjeçarin e ardhshëm dhe që do t'i zgjerojmë në pesëvjeçarët e mëpastajmë. Veçanërisht zhvillimi me ritme më të shpejta i kërkimeve gjeologjike, ndërtimi dhe mekanizimi i plotë i dy minierave të hekur-nikelit, pasurimi i minera-

leve të kromit, bakrit, qymyrgurit, fosforitit dhe azbestit prijnë industrializimin e vendit, në zbulimin dhe shfrytëzimin e pasurive të nëntokës sonë.

Metallurgjia e zezë e hekur-nikelit që do të ndërtohet në vendin tonë është një fitore e madhe e shkencëtarëve tanë e kinezë, që të nxjerrin nga minerali dhe nikelin edhe hekurin. Kjo ka qenë edhe ëndërr e neve të gjithëve, që të prodhojmë çelikin në vend nga minerali ynë në sasi të madhe dhe në këtë mënyrë të sigurojmë për të ardhshmen zhvillimin e prodhimit të mjeteve të prodhimit, për t'u bërë sa më shumë të pavarur nga importi i çelikut, kaq i domosdoshëm për industrializimin e vendit, ndërtimin e socializmit dhe njëkohësisht për të shtuar të ardhurat nga eksporti i mineralit të përpunuar.

Përpunimi i thellë i naftës ka rëndësi të jashtëzakonshme për plotësimin e nevojave gjithmonë në rritje për karburante të cilësisë e standardeve botërore, për të na bërë krejt të pavarur në këtë lëmë nga importi.

Hidrocentrali i Fierzës është vepër shumë e guximshme në lëmin e ndërtimeve, nyje rregulluese në shkallën e hidrocentraleve mbi lumin Drin e lumenjtë e tjerë dhe burim kryesor, pa të cilin nuk mund të flitej për ndërtim të metallurgjisë së zezë dhe të zhvillimit me ritme më të shpejta të industrisë në përgjithësi dhe të asaj minerare në veçanti. Nga hidrocentrali i Fierzës ne nuk do të marrim vetëm rreth 1 miliard e 700 milion kilovat-orë energji elektrike, por do të rregullojmë edhe aftësinë e hidrocentralit «Ma» Ce Dun» dhe të hidrocentraleve të tjera të sotme.

Vetëm këto pak fjalë mbi kërkimet gjeologjike, ndërtimin e mekanizimit të minierave, pasurimin e mineraleve dhe karakteristikat e këtyre tri veprave mund të jepnin një ide se ç'perspektiva të mëdha e të shkëlqyera i hapen vendit tonë në të ardhshmen.

Cilat janë problemet kryesore dhe ku duhet të përqëndrohet vëmendja e organeve të Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë në fushën e ndërtimeve?

Së pari, të organizohet puna në mënyrë të atillë që të mos shpërndahen punimet e ndërtimit, por të përqëndrohen, në sa më pak vepra, atje ku është e mundur të mbarojnë shpejt një pjesë e tyre dhe pastaj të fillojnë të tjera, për të arritur kështu që në fund të vitit të ketë sa më pak vepra të filluara dhe të papërfunduara. Të luftohet prirja që kanë investitorët që me fondet nën kufi kërkojnë të fillohet nga puna në shumë vepra të vogla. Kjo bën që veprat të mos përfundojnë dhe të mos vihen në shfrytëzim, gjë që ka pasoja të dëmshme për ekonominë.

Së dyti, të ecet me ritme më të shpejta në revolucionarizimin e projektimit të ndërtimeve. Përmirësimet në thjeshtimin e ndërtimeve janë të ngadalshme dhe të vogla; projektohen dhe

zbatohen përsëri vepra të rënda, me shtesa të panevojshme dhe të kushtueshme. Përvoja e deritanishme ka treguar se te disa drejtues të dikastereve, të organeve të Partisë dhe të pushtetit në rrethe, ka një kuptim jo të drejtë mbi thjeshtimin e veprave të ndërtimit, ka një lloj «gare» të pashpallur midis investitorëve dhe rretheve për të ndërtuar vepra të kushtueshme, të ngarkuara me vend e pa vend, ushqehet prirja drejt veprave luksoze etj. Edhe te projektuesit, në përgjithësi, nuk ka koncepte të qarta mbi thjeshtimin e ndërtimeve. Të nisur nga pikëpamje jo të drejta, siç është «rendja pas lavdisë personale», ata nuk kanë bërë sa duhet përpjekje për të hequr gjërat e tepërta në projektimin e veprave.

Komiteti Qendror ngre si një detyrë të ngutshme partie përpara organeve të Partisë e të pushtetit, përpara investitorëve e sidomos përpara Ministrisë së Ndërtimit e organeve të saj vartëse në radhë të parë, përpara projektuesve, që të vendosin një vetëkontroll dhe kontroll të rreptë në lëmin e projektimit dhe të zbatimit, për të ndërtuar vetëm atë që është e domosdoshme. Të tërhiqet mendimi krijues i të gjithë punonjësve të ndërtimit në lëmin e thjeshtimit të ndërtimeve, duke e bërë këtë një lëvizje revolucionare masive.

Së treti, për të fuqizuar më shumë aftësinë ndërtuese të shtetit tonë, për të bërë një ndarje pune më të drejtë ndërmjet Ministrisë së Ndërtimit dhe komiteteve ekzekutive të k.p. të rretheve, të cilat sot kanë mundësi dhe aftësi drejtuese dhe organizuese shumë më të mëdha se në të kaluarën, për të përballuar detyrat e mëdha që i ngarkohen ndërtimit, për të plotësuar në kohë dhe më mirë, në radhë të parë, punimet për ndërtimin e veprave të mëdha të industrisë, të bujqësisë, të komunikacionit etj. dhe ato sipas rretheve, kohët e fundit Këshilli i Ministrave mori masa për një riorganizim të gjithanshëm të ndërmarrjeve të ndërtimit. Organet e Partisë dhe të pushtetit në rrethe t'i kushtojnë vëmendje të veçantë vënies së shpejtë në zbatim të këtij riorganizimi, të njihen më afër dhe në mënyrë të vazhdueshme me gjendjen dhe me problemet e ndërtimeve, të ndihmojnë ndërmarrjet për kapërcimin e vështirësive të fillimit e t'i vënë ato në pozita luftarake për të plotësuar dhe për të tejkaluar detyrat e caktuara në planin e shtetit. Vëmendje më e madhe dhe e veçantë t'u kushtohet ndërmarrjeve që kryejnë punime të specializuara, që zbatojnë ndërtime industriale, hidroteknike, bonifikimi, rrugë etj. Punimet që zbatohen këto ndërmarrje kanë karakter kombëtar dhe lidhen kryesisht me vepra shumë të rëndësishme për ekonominë tonë, prandaj duhet kuptuar drejt kjo çështje dhe të mos largohet për asnjë çast vëmendja e organeve të Partisë dhe të pushtetit në bazë nga këto ndërmarrje. Vëmendja

të përqëndrohet, në radhë të parë në problemet kyçe siç janë p.sh. plotësimi në kohë i nevojave me fuqi punëtore e specialistë dhe me kuadro inxhiniero-teknikë, krijimi i kushteve të mira të punës dhe të jetesës për punëtorët, ngritja dhe edukimi ideologjik, tekniko-profesional e kultural i punëtorëve, furnizimi ritmik dhe në sasi të nevojshme me materiale të ndërtimit, mekanizimi i thjeshtë e i gjithanshëm i punimeve etj. Riorganizimi i ndërmarrjeve të ndërtimit në ndërmarrje me bazë rrethi dhe në ndërmarrje të specializuara të varura drejtpërdrejt nga Ministria e Ndërtimit, për ndërtim veprash të mëdha, mund të shërbejë si pikënisje dhe si shembull edhe për riorganizime të ngjashme në dikastere e veprimtari të tjera shtetërore, për një kalim të mëtejshëm të disa kompetencave nga dikasteret në komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve, duke arritur kështu në një ndarje pune dhe metodë e stil drejtimi që t'u lejojë organeve qendrore të përqëndrohen më shumë në veprimtaritë më të rëndësishme dhe në një punë më të gjerë, më të thellë e më efektive kërkimore e përgjithësuese.

Së katërti, puna e bërë nga punonjësit e ndërtimit, në lëmin e revolucionit tekniko-shkencor, për industrializimin e ndërtimit sipas porosive të Partisë, ka shënuar përparime të kënaqshme. Por në këtë fushë mbetet ende shumë për të bërë, prandaj të punohet dhe të ecet më me guxim përpara në industrializimin gjithnjë e më të gjerë të pjesëve të ndryshme të ndërtimeve, me qëllim që të shpejtohet ndërtimi i veprave, të përmirësohet cilësia e ndërtimeve dhe të ulët kostoja e tyre. Punëtorët, teknikët dhe inxhinierët të synojnë për të vënë në jetë teknikën e përparuar, të përvetësojnë dhe të përdorin gjerësisht materialet e lehta, të vënë në përdorim një numër më të gjerë të pjesëve të parandërruara dhe të përhapin gjerësisht përvojën e përparuar nga një ndërmarrje në tjetrën dhe nga një rreth në tjetrin.

Së pesti, duke filluar nga tremujori i parë i vitit të ardhshëm në vendin tonë do të vijnë grupet e specialistëve kinezë për studimin dhe për projektimin e veprave të mëdha që parashikohen në marrëveshjen e re ndërmjet vendit tonë dhe RP të Kinës. Është e domosdoshme dhe e ngutshme të merren masa organizative të shpejta për të plotësuar në kohë të gjitha nevojat në njerëz dhe në materiale. Studimet dhe projektimet do të bëhen në vendet e ndërtimit. Kjo shpejton dhe lehtëson punën, por në të njëjtën kohë na ngarkon me detyra të veçanta. Ndiham dhe gatishmëria e palës kineze nuk kanë munguar. Ne duhet t'u përgjigjemi të gjitha kërkesave dhe nevojave në kohë dhe në mënyrë të plotë. Kjo çështje, pra, duhet të kuptohet si një çështje e madhe politike nga organet e Partisë dhe të pushtetit, në qendër dhe në rrethe. Vepra si hidrocentrali i Fierzës, meta-

lurgjia e zezë, uzinat e përpunimit të thellë të naftës e të tjera, janë vepra të rënda, jo vetëm për vendin tonë, por edhe për vende më të mëdha e me fuqi ekonomike më të zhvilluar. Prandaj viti 1969 duhet të jetë viti i përgatitjeve të gjithanshme për të përballuar ndërtime gjithnjë e më të mëdha të vjetëve të ardhshëm.

Së gjashti, rritja e madhe e vëllimit të ndërtimeve, në vjetët e ardhshëm shtrun para organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë si detyrë të ngutshme marrjen e masave të veçanta për rritjen e prodhimit të materialeve të ndërtimit, me qëllim që të sigurohet furnizimi dhe krijimi i rezervave pranë çdo vepre për një punë të pandërprerë. Në zbatim të kësaj detyre të ngutshme organet përkatëse shtetërore janë ngarkuar të shikojnë mundësitë e zgjerimit të fabrikave të tullave etj. Përpara këtyre kërkesave të mëdha për materiale ndërtimi në të ardhshmen, të kufizohet shitja e disa materialeve të ndërtimit si tulla, tjegulla, lëndë druri, gëlqere etj. për fshatarësinë. Vetë kooperativat bujqësore ose në kooperim me njëra-tjetrën, të prodhojnë tulla, tjegulla, lëndë druri, gëlqere dhe materiale të tjera për plotësimin e nevojave të tyre.

3. — *Të kuptojmë politikisht dhe ideologjikisht domosdoshmërinë e marrjes së masave për rritjen e rendimentit të punës në ekonominë popullore.*

Partia vazhdimisht ka theksuar dhe ka nënvizuar se rritja e rendimentit të punës është një nga çështjet më të rëndësishme për triumfin e rendit socialist dhe faktor përcaktues për shtimin e prodhimit dhe për uljen e kostos. Gjatë tre vjetëve 1966-1968 në rritjen e rendimentit të punës janë arritur përfundime të mira në disa degë të industrisë, në ndërtim dhe në komunikacion.

Në degën e industrisë së bitumit, qymyrgurit, bakrit, kromit, hekur-nikelit, të metalurgjisë, të industrisë kimike, elektrike, qeramike, të material ndërtimit, të drurit dhe të letrës, rendimenti i punës në vitin 1968 është më i lartë se në vitin 1965. Me përjashtim të industrisë së naftës, qymyrgurit, kromit, industrisë mekanike dhe ushqimore, në degët e tjera të industrisë rendimenti i punës ka arritur atë të parashikuar në pesëvjeçar.

Me gjithë përparimet në këta vjetët e fundit, masa e rendimentit të punës, dinamika dhe ritmet e rritjes së tij, në përgjithësi, nuk kanë qenë të kënaqshme dhe nuk u janë përgjegjur ritmeve të larta të zhvillimit të ekonomisë popullore. Ndërsa prodhimi i përgjithshëm industrial gjatë vitit në vazhdim u rrit rreth 48 për qind në krahasim me vitin 1965, rendimenti i punës u arrit 97 për qind.

Në rendimentin e punës vërehen këto gjëra: gjatë vitit 1968, në krahasim me vitin 1965, rendimenti mesatar i punës në prodhimin industrial ka 3 për qind rënie; detyrat për rritjen e rendimentit të punës nuk plotësohen as sipas pesëvjeçarit as sipas planit vjetor, në të cilin përfshihen edhe faktorët e rinj që kanë lindur gjatë kësaj kohe; gjatë vitit në vazhdim, në krahasim me vjetët e mëparshëm, rënia e rendimentit jo vetëm u ndal, por pati edhe një rritje prej 2,4 për qind në krahasim me vitin e kaluar.

Në vitet 1967 e 1968 rritja e prodhimit industrial është siguruar krejtësisht nga rritja e numrit të fuqisë punëtore. Si pasojë, jo vetëm se është rënduar kostoja me shpenzime më të mëdha, por kanë lindur edhe vështirësi për sigurimin e fuqisë punëtore, dhe kemi qenë të detyruar të tërheqim fuqi punëtore nga fshati.

Gjatë vitit 1968 janë marrë fuqi punëtore mbi planin. Edhe për vitin 1969 janë bërë kërkesa shumë të mëdha për rritjen e fuqisë punëtore, gjë që tregon se organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit në bazë nuk janë thëlluar sa duhet në këtë çështje dhe nuk e kanë bërë problem të klasës punëtore. Kërkesat e bazës drejtuar dikastereve ishin për një rritje prej 70 mijë vetësh, dikasteret këtë kërkesë e zbritën në 50 mijë vetë. Byroja Politike e KQ të PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH pranuan një shtesë prej 26 mijë vetësh. Po të pranoheshin kërkesat e dikastereve gjendja do të bëhej mjaft e rëndë dhe do të krijoheshin shpërpjesëtime më të thella në ekonomi, pse do të detyroheshim të tërhiqim më shumë fuqi punëtore nga fshati.

Sipas kërkesave të dikastereve rritja e prodhimit industrial në vitin 1969, kundrejt plotësimit të priturshëm, do të sigurohej 6 për qind nga rritja e rendimentit të punës dhe 94 për qind nga shtesa e fuqisë punëtore. Në projektplanin që i paraqitet këtij plenumi është pranuar që rritja e prodhimit industrial të sigurohet 44 për qind nga rritja e rendimentit të punës dhe 56 për qind nga shtesa e numrit të punëtorëve.

Në uljen e rendimentit të punës, gjatë vitit 1968 ka ndikuar për afro 8 për qind edhe ndryshimi i strukturës së prodhimit industrial dhe ngritja e linjave dhe e reparteve të reja, të cilat në etapën e parë japin rendiment të ulët. Por ulja e rendimentit të punës nuk mund dhe nuk duhet të arsyetohet vetëm me ndryshimin e strukturës së prodhimeve dhe me ngritjen e reparteve e të linjave të reja. Jeta vërteton se, me pak përjashtime, si nga ndërmarrjet, ashtu edhe nga rrethet e dikasteret, nuk ushtrohet disiplina e duhur në marrjen, vendosjen dhe ngarkimin me punë të fuqisë punëtore. Mjaft ndërmarrje mbajnë punëtorë në punë ose marrin forca të reja pa u shqetësuar se, si pasojë e kësaj, ulet rendimenti; ka edhe raste që mbahen njerëz të cilët nuk

bëjnë punën për të cilën janë marrë. Në uzinën e rafinerisë së naftës në Cërrik, në kombinatin e tekstileve «Stalin» në Tiranë, në trikotazhin «Drapër e Çekan» në Korçë dhe në shumë ndërmarrrje të tjera mbahen në punë me dhjetëra punëtorë të panevojshëm.

Ngritja e linjave të reja, për një kohë, ndikon e do të ndikojë edhe në të ardhshmen në uljen e rendimentit të punës kundrejt uzinave, linjave e reparteve të përvetësuar më parë. Byroja Politike mendon se për përvetësimin e linjave dhe të reparteve të reja duhet të vendosen afate një ose dyvjeçare, sipas rastit, brenda të cilave rendimenti i punës të arrijë atë të reparteve ose të linjave të ngjashme. Natyrisht, kjo nuk duhet kuptuar dhe zbatuar në mënyrë mekanike dhe si një masë thjesht administrative, e cila në vetvete përmban rrezikun e kufizimit të inisiativave e të lëvizjeve revolucionare, por si një masë e domosdoshme për të vënë në rrugë të drejtë një problem kaq të rëndësishëm. Ekonomia jonë socialiste ka pranuar deri sot dhe do të pranojë edhe në ardhshmen prodhimin e ndonjë malli edhe me humbje, por një gjë e tillë nuk mund dhe nuk duhet të vazhdojë për një kohë të gjatë.

Përse ka pasur rënie në rendimentin e punës dhe ç'masa duhet të marrim për të kapërcyer këtë gjendje?

Së pari, në mjaft dikastere, komitete ekzekutive e ndërmarrje ka paqartësi mbi treguesit rendiment i punës, cilësia e prodhimit, prodhimet «me vlerë të vogël» dhe shërbimet në përgjithësi. Edhe dhënia e së drejtës dikastereve për të marrë 2 për qind mbi fondin e pagave të planifikuar e ka shtuar këtë paqartësi. Shprehja «rendimenti i punës si tregues përlllogaritës» nuk është kuptuar drejt dhe si rrjedhim është lejuar të merren punëtorë mbi planin e shtetit pa u shqetësuar nëse rritet ose ulet rendimenti i punës.

Në vendimin e Këshillit të Ministrave të RPSH mbi parimet themelore të metodologjisë së planifikimit është thënë: «Megjithëse rendimenti i punës, i shprehur në vleftë, parashikohet si tregues llogaritës, rëndësia e tij mbetet gjithmonë e dorës së parë. Prandaj ministratë, institucionet e tjera qendrore, komitetet ekzekutive të rretheve dhe ndërmarrjet të tregojnë vëmendje të posaçme e të vazhdueshme për rritjen e tij, duke marrë masa të veçanta, sipas rastit, për mekanizimin e proceseve të punës, për ngritjen tekniko-profesionale të punonjësve, për futjen e teknikës së re në prodhim, për përmirësimin e organizimit socialist të punës etj.».

Së dyti, nuk bëhen përpjekje të mjaftueshme për shfrytëzimin e mekanizmave të sotme dhe për mekanizimin e mëtejshëm të proceseve të punës, në radhë të parë për mekanizimin e

thjeshtë të punimeve me forcat e veta, megjithëse në kuadrin e revolucionit tekniko-shkencor ka filluar të bëhet një punë e mirë. P.sh. ndërmarrja e shfrytëzimit pyjor në Elbasan bën vazhdimisht kërkesa për të marrë fuqi punëtoresh nga fshati, në një kohë kur lë pa shfrytëzuar me muaj të tërë disa traktorë, moto-sharra, argano etj.; në industrinë ushqimore 70-80 për qind e proceseve të punës si në heqjen e bërthamave të qershive, etiketimin e shisheve, ambalazhimit, prerjen e ullinjve etj., bëhen me dorë, kurse ndërmarrje të tjera ushqimore disa nga këto procese i kanë mekanizuar; në ndërmarrjen e industrializimit të qumshtit në Vlorë janë mekanizuar shumë procese pune, kurse në mjaft ndërmarrje të tjera të së njëjtës natyrë këto procese pune kryhen me dorë. Në NBSH «Gjergj Dimitrov» Tiranë në vend që të shfrytëzohen traktorët e lehtë për prashitje dhe mekanizmat për spërkatje këto procese pune kryhen me krahe.

Në prodhimin e artizanatit dhe në disa degë të tjera të industrisë, ku janë ngritur linja dhe reparte të reja, nuk punohet sa duhet për mekanizimin e tyre, për të kaluar shkallë-shkallë nga prodhimi i thjeshtë artizanal në prodhimin zinxhir me një teknikë të përparuar.

Viti 1969 duhet të jetë viti i një kthese rrënjësore e vendimtare për mekanizimin e proceseve të punës. Kjo çështje të kthehet në një aksion të fuqishëm, në një lëvizje revolucionare në të gjitha qendrat e prodhimit, të ndërtimit apo të shërbimit, pa pritur urdhëra nga lart, pa kërkuar shtesa mbi planin në pajisje e në materiale, jo në formë fushate, por për një kohë shumë të gjatë, që, duke u lidhur edhe me masa të tjera, të sigurojë një rritje me ritme të shpejta të rendimentit të punës. T'i bëhet thirrje klasës punëtoresh që ta marrë mirë në dorë këtë problem. Klasa punëtoresh, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjencia popullore inisiativat krijuese e lëvizjet revolucionare që kanë shpërthyer kudo për zbatimin e mësimave të Partisë dhe të shokut Enver të shprehura në fjalën e tij «Mbi kooperimin dhe revolucionin tekniko-shkencor» t'i drejtojnë në radhë të parë në fushën e mekanizimit të punimeve. Kjo është e domosdoshme jo vetëm për rritjen e rendimentit të punës, por edhe për të lehtësuar punën e punëtorëve dhe të fshatarëve, ashtu siç porositi shoku Enver në konferencën e rrethit të Tiranës. Në çdo repart, ndërmarrje e ministri të përpunohen masa konkrete për organizimin e mirë të kësaj pune dhe të mbështetet fuqimisht klasa punëtoresh. Në përfundim çdo qendër pune të caktojë sa punëtoresh do të pakësojë me anë të mekanizimeve të thjeshta të punimeve me forcat e veta.

Së treti, faktor tjetër me shumë rëndësi për rritjen e rendimentit të punës, të cilit duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë

është shfrytëzimi i kohës së punës. Shfrytëzimi i plotë i kohës së punës, në ndërmarrjet dhe në organizatat ekonomike është një nga kërkesat themelore të organizimit socialist të punës. Mirëpo në shumë ndërmarrje ka humbje të kohës së punës si brenda tetorëshit, ashtu edhe për ditë të tëra, veçanërisht në kooperativat e artizanatit dhe në ato ndërmarrje, ku shpërblimi i punës bëhet me kohë pune, në ndërmarrje që kanë karakter prodhimi stinor dhe sidomos në repartet ndihmëse. Në gjashtëmuorin e parë të këtij viti në ndërmarrjet e Ministrisë së Industri-Minierave ka pasur rreth 120 mijë ditë-pune të humbura pa arsye. Vetëm në kombinatin e tekstilit «Mao Ce Dun» kanë humbur pa arsye 8500 ditë-pune, në minierën e Alarupit 2300 ditë-pune etj. Organizatat-bazë të Partisë dhe vetë kolektivat ta marrin mirë në dorë problemin e shfrytëzimit të plotë të kohës së punës, sepse kjo çështje është e lidhur drejtpërsëdrejti me ndërgjegjen socialiste dhe me qëndrimin socialist ndaj punës.

Së katërti, zhvillimi i ekonomisë popullore me ritme gjithnjë e më të mëdha, detyrat që shtroi Plenumi III i Komitetit Qendror të Partisë në fushën e thellimit të revolucionit tekniko-shkençor, veprat e mëdha me teknikë të ndërlikuar e të përparuar që do të ndërtohen në vjetët e ardhshëm dhe kërkesat çdo ditë në rritje për prodhime, ndërtime e shërbime me cilësi të lartë, kërkojnë masa më të shpejta dhe të vazhdueshme për ngritjen e aftësive tekniko-profesionale të punëtorëve. Me gjithë përparimet e arritura, aftësimi tekniko-profesional i punëtorëve nuk ka ndjekur hap pas hapi rritjen e kërkesave që shtron zhvillimi dhe futja e teknikës në të gjithë veprimtarinë e vendit tonë. Mospërputhja ndërmjet shkallës së kualifikimit që kanë punëtorët dhe asaj që kërkojnë vendet e punës vazhdon. P.sh. në industrinë mekanike kategoria mesatare e punëtorëve është kategoria e tretë, në vend të kategorisë së katërt, që kërkohet sipas vendeve të punës. Në uzinën «Enver» nevoja është, për kategorinë 5,2, kurse gjendja është për 4,2; në uzinën e Gjeggjanit nevoja është për kategorinë 2,5, kurse gjendja është për 1,6 etj. Këtej del se, përgjithësisht, punëtorët me kualifikim të ulët, në të njëjtin proces pune ose vend pune, ku punojnë shokët e tyre me kualifikim më të lartë, japin një rendiment pune më të ulët se këta të fundit, që në shumë raste arrin në 20-30 për qind.

Së pesti, dikasteret, komitetet ekzekutive të rretheve dhe ndërmarrjet nuk po u kushtojnë vëmendjen e duhur problemeve të normimit të punës dhe veçanërisht normimit teknik të punës, në radhë të parë caktimit të normave të punës si masë harxhimi të kohës së punës, gjë e cila luan një rol të dorës së parë në çështjen e rendimentit të punës dhe njëkohësisht edhe si

masë e shpërblimit të punës. Sidomos janë pak të studjuara normat që vendosen nga vetë ndërmarrjet. Këto të meta kanë ndikuar në mjaft raste edhe në prishjen e përpjesëtimin të shpërblimit të punës në degë të ndryshme.

Pak vëmendje i kushtohet zëvendësimit të normave eksperimental-statistikore me norma teknike, megjithëse për këtë ka pasur detyra të caktuara për sektorë të veçantë. Në mjaft ndërmarrje normat janë vjetëruar dhe tejkalohen pa vështirësi, pothuajse nga të gjithë punëtorët.

Përvoja e këtyre vjetëve të fundit tregon se zgjerimi i kompetencave të organeve të bazës në fushën e organizimit të prodhimit, të normimit të punës dhe të rritjes së rendimentit të punës duhet të mbështetet në një punë të gjithanshme politike, ideologjike, organizative dhe teknike, për t'i shfrytëzuar më mirë mundësitë e rezervat e mëdha që kanë ndërmarrjet për rritjen e mëtejshme të rendimentit të punës.

Përfundimet e këtyre tre vjetëve në rritjen e pamjaftueshme të rendimentit të punës duhen kuptuar dhe pranuar si një fenomen i përkohshëm që lidhet me faktorë politikë, shoqërorë dhe ekonomikë, të diktuar nga rrethanat në të cilat zhvillohet ndërtimi socialist i vendit tonë, si dhe nga një sërë të metash që vërehen në lëmin e organizimit të punës dhe të prodhimit. Gjithë çka parashtrua më lart tregon se është e domosdoshme të kuptohet drejt problemi i rritjes së rendimentit të punës në ekonominë popullore në vjetët e ardhshëm, në radhë të parë nga organizatat-bazë të Partisë, nga organet e pushtetit dhe të ekonomisë në qendër dhe në bazë. Menjëherë, dhe pa humbur kohë t'ua bëjnë të qartë masave punonjëse që klasa punëtore ta marrë vetë në dorë këtë çështje dhe kontrolli i saj mbi administratat e ndërmarrjeve të shërbejë si një mjet i fuqishëm për organizimin më të mirë të punës dhe për rritjen e rendimentit.

Organizatat-bazë të Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë të marrin të gjitha masat që puna për plotësimin e planit të vitit 1969 të fillojë mbarë, në mënyrë që të sigurohet në vazhdimësi plotësimi ritmik i planit duke shfrytëzuar plotësisht kohën e punës.

Në të njëjtën kohë, duke mbështetur fuqimisht lëvizjen për ngritjen me forcat e veta të reparteve e linjave të reja dhe të prodhimit të mallrave të reja, dikasteret, komitetet ekzekutive të rretheve dhe ndërmarrjet të kuptojnë dhe të zbatojnë drejt kompetencat e dhëna nga qeveria, duke forcuar disiplinën, kontrollin nga lart dhe vetëkontrollin në marrjen dhe në përdorimin e fuqisë punëtore.

Kujdes të posaçëm të tregojnë komitetet ekzekutive të rre-

theve për sigurimin me kohë dhe sipas planit të nevojave për fuqi punëtore për vitin 1969, duke u dhënë epërsi minierave, sharrave, ndërtimit të veprave të mëdha si hidrocentrali «Mao Ce Dun» etj. dhe të mos lejojnë kurrësi që në sektorë të radhës së dytë (ndihmës) të mbahen punëtorë mbi planin. Për të kapërcyer vështirësitë që mund të paraqiten për sigurimin e fuqisë punëtore dhe për tërheqjen e saj nga fshati, puna në prodhim që bëjnë punonjësit administrativo-teknikë të kryhet kryesisht në ndërmarrjet e ndërtimit dhe në ndërmarrjet bujqësore shtetërore.

Byroja Politike e KQ të PPSH shpreh bindjen se organizatat bazë të Partisë, kolektivat punonjëse, dikasteret dhe organet e pushtetit në bazë, do t'i kuptojnë drejt çështjet e shtruara më sipër dhe do të vënë të gjitha forcat për të kryer shpejt, mirë e me nder detyrat që shtron Partia në këtë fushë.

Shoqe dhe shokë,

Byroja Politike dhe Këshilli i Ministrave vazhdimisht kanë tërhequr vëmendjen që, gjatë hartimit të projektplaneve nga baza deri në organet qendrore, t'u përmbahemi kuotave të aprovuara në planin pesëvjeçar. Kërkesa të fryra dhe mbi planin ka pasur çdo vit, por në hartimin e projektplanit të vitit 1969 kërkesat mbi parashikimet e pesëvjeçarit mund të themi se vërshuan si lumë, në radhë të parë për ndërtime, për import, për fuqi punëtore dhe për lëndë të para e materiale. Të mëdha kanë qenë kërkesat veçanërisht për ndërtime e për shpenzime me karakter shoqëror e kultural. Siç del, këto kërkesa e kanë burimin në mosvlerësimin e drejtë të mundësive të bazës sonë materialo-teknike dhe në moskuptimin si duhet të thelbit të fjalës së shokut Enver Hoxha «Kontrolli i klasës punëtore».

Është e kuptueshme se baza nuk mund të ketë njohuri të plota mbi mundësitë që ka ekonomia jonë në tërësi, por nuk është e pamundur që ajo të orientohet nga kuotat e pesëvjeçarit, nga përvoja e këtyre vjetëve dhe nga të dhënat e ekonomisë së rrethit. Organet e bazës në radhë të parë dhe dikasteret mund dhe duhet të ndalen e të gjykojnë më drejt kur bëjnë kërkesat për ndërtime, import, fuqi punëtore, për lëndë të para e sidomos për materiale deficitare. Klasës punëtore i duhen shtjelluar mirë mundësitë reale të shtetit tonë, në mënyrë që këto probleme të kuptohen dhe të trajtohen në prizmin politik.

Plani pesëvjeçar i ndarë në vite, i aprovuar nga Këshilli i Ministrave i RPSH për dikasteret dhe nga dikasteret për ndërmarrjet, është baza kryesore, jashtë së cilës nuk duhet të dilet,

veçse duke shtuar prodhimin, të ardhurat e rendimentin e punës brenda mundësive reale të shtetit. Natyrisht, plani dhe detyrat duhen shikuar në procesin dinamik të zhvillimit. Në këtë vështrim ndryshimet e vogla, për shtesa në radhë të parë, apo për pakësim, në planet operative vjetore, janë të pashmangshme. Por për këtë duhet të mbahen mirë parasysh dy gjëra: e para, propozimet për shtesa mbi planin pesëvjeçar për import, ndërtime, fuqi punëtore dhe lëndë të parë e materiale, si rregull, duhet të bëhen më vete, pa u përfshirë në projektplanin e shtetit. Organet qendrore bashkë me ndërmarrjet e me komitetet ekzekutive të rretheve duhet t'i shqyrtojnë me vëmendje dhe përgjegjësinë më të madhe këto propozime. Kur këto propozime nuk mund të pranohen t'u shpjegohen mirë arsytet e mospranimit shokëve të ndërmarrjeve e të komiteteve ekzekutive, për t'i bindur ata. Të mos lejohet ajo që ka ndodhur në shumë raste që disa dikastere nuk kanë vënë në dijeni rrethet mbi fatin e propozimeve të tyre; e dyta, të kemi kurdoherë kujdes që, kur shqyrtojmë propozimet dhe kërkesat e bazës, të ruhen medoemos ritmet dhe përpjesëtimet. Sikurse u tha më sipër, investimet, ndërtimet dhe shpenzimet që do të bëhen në sektorët social-kulturalë për vitin 1969, kundrejt pesëvjeçarit dhe vitit 1968, do të rriten shumë. Por duhet të nënvizojmë se këto investime e shpenzime nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin; prandaj të gjitha organet e shtetit dhe të ekonomisë, në të ardhshmen, duhet të kenë kujdes që të mos planifikojnë rritje të tyre në atë madhësi që u planifikua për vitin 1969. Të kemi si orientim të përgjithshëm që pesha specifike e investimeve dhe e shpenzimeve social-kulturale, në krahasim me vëllimin e përgjithshëm të investimeve dhe të shpenzimeve të buxhetit, të jenë në atë masë që të kenë kurdoherë përpjesëtime të drejta me investimet dhe me shpenzimet prodhuese. Veç kësaj, në ndarjen e investimeve dhe të shpenzimeve social-kulturale, si dhe për çështje të tjera të kësaj natyre, të kihet më shumë kujdes për fshatin.

Byroja Politike mendon se plotësimi i planit të vitit 1968 na mbush me besim dhe optimizëm real se objektivat që caktoi Kongresi V i Partisë në planin e katërt pesëvjeçar, masat punonjëse të vendit tonë, duke punuar edhe më me vrull e entuziazëm revolucionar, do t'i vënë në jetë patjetër dhe para afatit.

Zbatimi i detyrave që parashikohen në planin e vitit 1969, kërkon që klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjencia popullore, nën udhëheqjen e Partisë, të thellojnë masat në të gjitha fushat për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës e të prodhimit, për të çuar më përpara dhe për të vënë në jetë mësimet e Partisë dhe porositë e shokut Enver Hoxha për kooperimin dhe revolucionin tekniko-shkencor, për të siguruar një

pjesëmarrje më masive të punëtorëve në drejtimin e veprimtarisë teknike e shkencore, sepse kështu do të zgjerohet më shumë veprimtaria krijuese e punëtorëve, për të luftuar çdo shfaqje që pengon zbatimin e vendimeve të Plenumit III të Komitetit Qendror mbi përqëndrimin, kooperimin dhe specializimin e industrisë mekanike. Komiteti Qendror, porosit edhe një herë dikasteret që t'i japin ndihmë më të madhe bazës, të përkrahin dhe të nxitin më shumë zhvillimin e lëvizjeve e të iniciativave revolucionare, të cilat të synojnë, në radhë të parë, në shtimin e prodhimit, në rritjen e rendimentit të punës dhe në uljen e kostos.

Zbatimi i detyrave të planit të vitit 1969 kërkon gjithashtu që organizatat e Partisë dhe organizatat profesionale të shumëfishojnë përpjekjet e tyre për të ngritur në një shkallë më të lartë kontrollin e klasës punëtore, për ta bërë klasën punëtore më të vetëdijshme për rolin e saj historik. Përvoja e këtij viti në kuptimin dhe në zërthimin e mësimave të shokut Enver mbi kontrollin e klasës punëtore, duhet të pasurohet më tej dhe të shërbejë për të forcuar rregullin e disiplinën kudo: në punë, në prodhim, në administratë, në shoqëri, në familje dhe në të gjitha problemet që u shtruan në këtë plenum. Të goditen pa mëshirë, në çdo formë që të paraqiten, shfaqjet e nënvleftësimit të rolit dhe të kontrollit të klasës punëtore.

Zbatimi i detyrave që parashikohen në projektplanin e vitit 1969, lidhet ngushtë me përmirësimin e mëtejshëm të metodës dhe të stilit në punë, me përsosjen e mëtejshme të organizimit të punës dhe të drejtimit në përshtatje me kërkesat e kohës. Kaluan tre vjet që nga koha kur Byroja Politike e KQ të PPSH analizoi çështjen e luftës kundër burokratizmit, për një metodë e stil revolucionar në punë dhe përcaktoi masat në këtë drejtim. Gjatë kësaj kohe organet e Partisë e të shtetit kanë fituar një përvojë të madhe, të cilën duhet ta përgjithësojnë, të luftojnë më shumë për të përmirësuar më tej metodën dhe stilin në punë, në mënyrë që ato t'i përgjigjen më mirë vrullit revolucionar të masave.

Për zbatimin e plotë të këtyre detyrave kërkohet që këto të zërthehen deri në një dhe t'u bëhen të njohura punëtorëve dhe fshatarëve. T'u shtjellohet atyre nga ana politike rëndësia që ka zbatimi i tyre për ekonominë tonë, pasojat e papëlqyeshme që mund të kemi, shpërpjesëtimet që mund të krijohen në degët e ndryshme të saja dhe mosfurnizimi i mirë i popullit nga mosplotësimi i këtyre detyrave. Krahas kësaj u duhet bërë shumë mirë e qartë punonjësve rëndësia e madhe dhe nevoja e domosdoshme për të vendosur kudo e për çdo gjë një regjim shumë të rreptë kursimi në lëndët e para, materialet dhe fondet monetare, duke krijuar kushte për të rritur më tej prodhimin dhe për të për-

balluar nevojat e reja që mund të lindin. Është e qartë për të gjithë se në gjirin e ekonomisë ka dhe do të ketë vazhdimisht rezerva, zbulimi dhe vënia në përdorim e të cilave do të rritë burimet dhe do t'i sjellë ekonomisë dobi të mëdha.

S'ka asnjë dyshim se plotësimi i detyrave madhështore e të guximshme që parashikon projektplanin i vitit 1969 do të kthehet në një forcë të madhe politike: flamuri i Partisë sonë dhe emri i Republikës Popullore të Shqipërisë do të shndrisin edhe më shumë në atdheun tonë socialist, në Evropë e në botë; atdheu ynë do të bëhet edhe më i fuqishëm e populli edhe më i pamposhtur në luftën e tij të paepur, nën udhëheqjen e Partisë me shokun Enver Hoxha në krye, kundër imperializmit, me atë amerikan në krye dhe kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye.

Byroja Politike e KQ të PPSH ka besim se, duke i parë problemet dhe vetë detyrat e planit me këtë sy dhe duke i shtruar para punonjësve me frymën që porosit Partia, s'ka asnjë dyshim se klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste do të zbulojnë rezerva e mundësi të reja dhe do të marrin përsipër detyra më të mëdha e më të guximshme dhe, ashtu si deri sot, detyrat e planit të vitit 1969 do t'i plotësojnë dhe do t'i tejkalojnë me nder.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI PLANIN E ZHVILLIMIT EKONOMIK E KULTURAL TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË PËR VITIN 1969»

27 dhjetor 1968

Plenumi VII i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i mbledhur në datën 26 dhe 27 dhjetor 1968, pasi dëgjoi e shqyrtoi raportin «Mbi plotësimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1968 dhe detyrat e projektplanit e të projektbuxhetit të shtetit për vitin 1969», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave, shoku Spiro Koleka,

V e n d o s i :

1. — Të aprovojë raportin dhe orientimet kryesore mbi planin e zhvillimit ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë për vitin 1969.

2. — Porosit organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë që të marrin të gjitha masat e duhura për të zëbërthyer, për të realizuar dhe për të tejkaluar me sukses detyrat e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1969.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 311 (6350), 28 dhjetor 1968*

V E N D I M

I KOMITETIT QENDROR TË PPSH DHE I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH PËR TA SHPALLUR VITIN 1969 VIT JUBILAR TË 25-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË ATDHEUT E TË FITORES SË REVOLUCIONIT POPULLOR

16 janar 1969

Më 29 Nëntor 1969, populli shqiptar feston 25-vjetorin e Çlirimit të atdheut dhe fitoren e Revolucionit Popullor, ngjarjen më të shkëlqyer në historinë e tij të lavdishme, që hapi rrugën për shndërrimin e vendit tonë në një shtet socialist, të lirë e të përparuar, në një kështjellë të pathyeshme të socializmit në Evropë.

Kjo u arrit nga populli ynë nën udhëheqjen largpamëse marksiste-leniniste të Partisë Komuniste të Shqipërisë (sot PPSH) me shokun Enver Hoxha në krye dhe në saje të Luftës legjendare Nacionalçlirimtare që ka zhvilluar ai kundër okupatorëve nazi-fashistë e reaksionit të brendshëm, si dhe të punës së tij vetëmohuese e të talentuar që ka bërë e bën për ndërtimin e socializmit me forcat e veta, në kushtet e rrethimit kapitalist e revizionist.

Komiteti Qendror i PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH për të festuar me madhështi këtë jubile të madh,

V e n d o s ë n :

1. — Ta shpallin vitin 1969 vit jubilar të 25-vjetorit të Çlirimit të atdheut dhe të fitores së Revolucionit Popullor.

2. — Festimi i jubileut të madh të 25-vjetorit të Çlirimit të atdheut dhe i fitores së Revolucionit Popullor të shërbejnë për të treguar të kaluarën e lavdishme të periudhës së Luftës Nacionalçlirimtare dhe fitoret madhështore që ka korrur Republika

Popullore e Shqipërisë, e cila gjatë këtij një çerek shekulli ka ndryshuar rrënjësisht dhe është transformuar në një vend socialist, të fortë e të begatshëm, me industri të zhvilluar, me bujqësi kolektive të përparuar, me arsim dhe kulturë të lartë socialiste, me një ushtri popullore të pajisur me teknika moderne dhe me një popull të lavdishëm që, i kalitur me ndërgjegje të lartë politike, klasore e revolucionare, çon përpara revolucionin socialist drejt fitores së tij të plotë.

3. — Festimi i këtij jubileu të shënuar të kthehet në një aksion të madh politik, që të na shërbejë për të ngritur në një shkallë edhe më të lartë vrullin revolucionar të masave punonjëse që ka shpërthyer kudo në vendin tonë, për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit V të PPSH dhe mësimet e shokut Enver Hoxha për revolucionarizimin e mëtejshëm të gjithë jetës së vendit.

Të zhvillohen dhe të çohen më tej inisiativat dhe aksionet e mëdha që kanë shpërthyer në gjirin e masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit për perfeksionimin e gjithanshëm të marrëdhënieve socialiste në prodhim, për shtimin dhe përmirësimin e cilësisë së prodhimit si dhe t'u kushtohet një kujdes i veçantë thellimit të revolucionit tekniko-shkencor dhe eksperimentimit shkencor, në mënyrë që të realizohet para afatit plani i katërt pesëvjeçar dhe të ngrihen vazhdimisht mirëqenia e niveli i jetesës së popullit shqiptar.

Këtë fushatë ta përdorim plotësisht për forcimin e gjithanshëm të diktaturës së proletariatit, për fuqizimin e kontrollit të klasës punëtore në tërë fushat e jetës dhe në luftë kundër shfaqjeve të burokratizmit, për forcimin e aleancës revolucionare dhe të solidaritetit të madh socialist të klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse dhe inteligjencien popullore, për forcimin e disiplinës proletare në të gjitha sferat e punës, për forcimin e vigjilencës, të gatishmërisë dhe të fuqisë mbrojtëse të atdheut tonë socialist.

Gjatë vitit jubilar të bëhet një punë e gjithanshme ideologjike, politike e kulturele për edukimin klasor e revolucionar të masave, sidomos të brezit të ri, në mënyrë që jubileu i 25-vjetorit të Çlirimit të atdheut dhe i fitores së Revolucionit Popullor t'i japë një impuls tjetër edhe më të madh thellimit të mëtejshëm të revolucionit ideologjik e kultural, për të shkukur nga rrënjët gjithçka të trashëguar nga ideologjia e vjetër feudoborgjeze, revizioniste, mikroborgjeze, fetare, patriarkale, konservatore etj. Në këtë drejtim një vend kryesor të zërë organizimi sa më i mirë i studimit të Historisë së PPSH dhe i Veprave të shokut Enver Hoxha. Përvetësimi i këtyre veprave dhe i dokumenteve të tjera të Partisë të përdoren si mjete të fuqishme për kalitjen

e njeriut tonë të ri me ideologjinë proletare marksiste-leniniste, me frymën e lartë të internacionalizmit proletar dhe si burim frymëzimi për zgjidhjen me sukses të detyrave që shtrun ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste e komuniste në vendin tonë.

Të thellohet dhe të çohet përpara lufta për revolucionarizimin e gjithanshëm të shkollës, kulturës, artit dhe shkencës, duke tërhequr në këtë luftë mendimin revolucionar të masave të gjera të punëtorëve, fshatarëve, ushtarakëve dhe inteligjencies popullore.

Të ngrihet në një nivel më të lartë lufta për emancipimin e plotë të gruas. Të çohet kurdoherë përpara heroizmi masiv i masave punonjëse, të cilat, të frymëzuara nga parulla e Partisë «Një për të gjithë, të gjithë për një», kanë ndërmarrë inisiativa dhe aksione të rëndësishme ideologjike e revolucionare për të vënë kudo dhe mbi të gjitha interesin e përgjithshëm mbi atë vetjak.

4. — Viti jubilar i 25-vjetorit të Çlirimit të atdheut dhe i fitores së Revolucionit Popullor të na shërbejë për të forcuar edhe më shumë unitetin e pathyeshëm luftarak të popullit tonë në Frontin Demokratik rreth Komitetit Qendror të Partisë me shokun Enver Hoxha në krye, unitet që përbën garancinë kryesore për të sotmen dhe të ardhshmen e lumtur të Shqipërisë socialiste.

5. — Gjatë vitit jubilar të bëhet një punë e madhe propagandistike për forcimin dhe për çelnikosjen e mëtejshme të miqësisë luftarake të popullit tonë me popullin e madh kinez dhe me të gjithë popujt revolucionarë dhe forcat marksiste-leniniste kudo në botë; të punohet për demaskimin e vazhdueshëm të imperializmit me atë amerikan në krye dhe të revizionizmit modern të kryesuar nga udhëheqja revizioniste sovjetike.

6. — Në kuadrin e këtij jubileu të lavdishëm, me parullën «Shqipëria socialiste në 25-vjetorin e saj», të zhvillohen në të gjithë vendin aktivitete dhe manifestime të mëdha politike, shkencore, kulturele, artistike, fiskulturele etj. Për organizimin e festimit të këtij jubileu të madh, krijohet një Komision Qendror, i kryesuar nga anëtarin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave të RPSH, shoku Haki Toska.

7. — Komiteti Qendror i PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH u bëjnë thirrje gjithë komunistëve, gjithë popullit tonë të mrekullueshëm, që, nën udhëheqjen e Partisë me shokun Enver Hoxha në krye, vitin 1969, 25-vjetorin e lavdishëm të Çlirimit të atdheut dhe të Revolucionit Popullor, ta kthejnë në vit sulmi të pandalshëm në të gjitha fushat, për ta çuar përpara me ritme më të shpejta, me optimizëm dhe vigjilencë të lartë

revolucionare, ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste në vendin tonë, për ta bërë atdheun socialist akoma më të fuqishëm e më të begatshëm, për të shpejtuar triumfin e ideologjisë sonë të lavdishme marksiste-leniniste në mbarë botën.

**KËSHILLI I MINISTRAVE
I RPSH**

**KOMITETI QENDROR
I PPSH**

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 14 (6366), 17 janar 1969*

V E N D I M

I KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI KREMTIMIN E 100-VJETORIT TË DITËLINDJES SË V. I. LENINIT

21 prill 1969

Më 22 prill 1970 proletariati, komunistët, punonjësit dhe gjithë popujt e mbarë botës, Partia dhe masat punonjëse të vendit tonë do të festojnë 100-vjetorin e ditëlindjes së Leninit të madh.

Jeta dhe vepra e V.I. Leninit janë të lidhura në mënyrë të pandarë me luftën për krijimin e PK(b) të BRSS, me fitoren e Revolucionit të madh Socialist të Tetorit, me vendosjen e diktaturës së proletariatit dhe me krijimin e shtetit të parë socialist në botë.

V.I. Lenini, mbrojti dhe zhvilloi më tej doktrinën revolucionare të Karl Marksit dhe të Frederik Engelsit, e pasuroi atë me eksperiencën e re të luftës revolucionare të proletarëve dhe të punonjësve të mbarë botës në epokën e imperializmit, duke engritur marksizmin në një shkallë të re e më të lartë.

Si udhëheqës dhe mësues i madh i proletariatit rus e ndërkombëtar, V.I. Lenini ishte luftëtar i paepur për triumfin e idealeve të lirisë, të pavarësisë dhe të çlirimit të popujve nga zgjedha imperialiste e koloniale.

Revizionistët hrushovianë, pasi uzurpuan pushtetin dhe partinë, nën maskën e zhvillimit krijues të marksizmit dhe të luftës kundër kultit të individit të J.V. Stalinit, tradhëtuan idealet e revolucionit dhe të socializmit, varrosën teorinë revolucionare të V.I. Leninit dhe e futën vendin e Sovjetëve në rrugën e degjenerimit borgjez revizionist.

Idetë dhe doktrina revolucionare e V.I. Leninit janë sot një armë e fuqishme në duart e marksistë-leninistëve revolucionarë, të proletariatit dhe të popujve të mbarë botës në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit hrushovian. Partia e Punës e Shqipërisë, që lindi dhe u zhvillua si parti e tipit të ri leninistë-staliniane, është udhëhequr dhe udhëhiqet në gjithë veprimtarinë e saj revolucionare nga idetë dhe nga mësimet e Leninit të madh. Ajo ka luftuar dhe do të luftojë kurdoherë për mbrojtjen

e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, do të mbajë kurdoherë lart flamurin e kuq të leninizmit, në luftë për triumfin e kauzës së revolucionit e të komunizmit në mbarë botën.

Për të kremtuar me madhësi jubileun e madh, 100-vjetorin e ditëlindjes së V.I. Leninit, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë,

Vendosi:

Të organizohet një punë e gjerë propagandistike për kujtimin dhe festimin e këtij jubileu, 100-vjetorin e ditëlindjes së V.I. Leninit. Ajo të shërbejë që komunistët dhe punonjësit e vendit tonë:

a) Të njohin akoma më mirë dhe më thellë veprën revolucionare të V.I. Leninit, të përvetësojnë idetë e tija, mësimet e tij mbi partinë marksiste-leniniste, luftën e klasave, revolucionin dhe diktaturën e proletariatit, të njohin dhe të përvetësojnë thesarin ideoteorik të leninizmit;

b) të njohin luftën e madhe që ka bërë V.I. Lenini kundër oportunitizmit e revizionizmit, kontributin e madh që ka dhënë ai për mbrojtjen e marksizmit nga renegatët e revolucionit dhe të socializmit;

c) të njohin luftën dhe përpjekjet e Partisë sonë për të zbatuar idetë dhe mësimet e V.I. Leninit në praktikën tonë revolucionare, në revolucion dhe në ndërtimin socialist në përshtatje me kushtet dhe veçoritë e vendit tonë, kontributin e Partisë së Punës të Shqipërisë në zhvillimin e mëtejshëm të marksizëm-leninizmit.

Komiteti Qendror i Partisë porositi të gjitha organizatat e Partisë e të masave, të gjitha institucionet shtetërore, kulturele e arsimore, që në kuadrin e festimit të 100-vjetorit të ditëlindjes së V.I. Leninit, të organizojnë sesione shkencore, leksione e biseda, të përgatitin ekspozita etj., kushtuar jetës dhe veprës revolucionare të Leninit të madh. Organet e shtypit dhe Shtëpia botuese «Naim Frashëri» të marrin masa për të botuar artikuj propagandistikë, shkrime të tjera e kujtime mbi luftën dhe punën e tij. Kinostudioja «Shqipëria e Re» të vërë në qarkullim filma, që nxjerrin në pah figurën e V.I. Leninit.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 95 (6447), 22 prill 1969

PLENUMI VIII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 26-28 qershor 1969

K O M U N I K A T Ë

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nga 26 deri 28 qershor 1969, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi VIII i Komitetit Qendror të PPSH, i cili mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi konkluzionet e diskutimit popullor për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe kryetar i Komisionit Qendror për Arsimin pranë Komitetit Qendror të Partisë, shoku Mehmet Shehu.

Pasi diskutoi gjerësisht rreth raportit të paraqitur, Plenumi i Komitetit Qendror e aprovoi atë njëzëri dhe mori vendimet përkatëse.

Në përfundim të punimeve të Plenumit, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha mbajti një fjalim të rëndësishëm.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

R A P O R T

I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI KONKLuzionET E DISKUTIMIT POPULLOR PËR REVOLUCIONARIZIMIN E MËTEJSHËM TË SHKOLLËS SONË»

26 qershor 1969

Shokë,

Pas më shumë se një vit diskutimi të përgjithshëm popullor, tashmë janë pjekur kushtet dhe janë krijuar të gjitha mundësitë që të nxjerrim disa konkluzione themelore për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë, t'i shtrojmë ato për diskutim përfundimtar në këtë mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë dhe të përcaktojmë detyrat tona për të ardhshmen në këtë fushë.

Gjithë diskutimi popullor për problemet e arsimit është zhvilluar mbi bazën e platformës së parashtruar nga shoku Enver në Fjalën e tij të 7 marsit të vitit të kaluar «Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë». Ky fjalim historik, si dhe idetë e parashtruara nga shoku Enver për problemin e shkollës në fjalën e tij në Konferencën e 17-të të Partisë të Tiranës¹, janë një përgjithësim marksist-leninist i politikës arsimore të Partisë sonë për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhshmen, ato përbëjnë një zhvillim krijues të ideve të marksizëm-leninizmit mbi arsimin, në përshtatje me kushtet historike konkrete të vendit e të shkollës sonë të re.

Në diskutimin e kësaj çështjeje të madhe e të ndërlikuar Partia zbatoi me konsekuencë vijën e masave, iu drejtua gjykimin të popullit dhe u mbështet fuqimisht në të. Diskutimi popullor u karakterizua, para së gjithash, nga një gjerësi e masiviteteve i pashembullt. Qindra mijëra njerëz — mësues dhe nxënës, kuadro të arsimit, të kulturës e të prodhimit, prindër dhe punonjës të të gjitha fushave të jetës morën pjesë në diskutimet që u

1 «Të zbatohet me këmbëngulje e në mënyrë krijuese detyrat për revolucionarizimin e Partisë e të jetës së vendit», mbajtur më 21 dhjetor 1968.

zhvilluan në të gjitha shkollat, në ndërmarrjet, në institucionet shtetërore dhe në kooperativat bujqësore, në çdo organizatë partie dhe në organizatat e masave, në çdo lagje qyteti e në çdo fshat. Veç diskutimeve të gjera publike në shtyp, në gjithë vendin, në rrethe e në qendër, u zhvilluan gjithsejt mbi 21 000 mbledhje e konsulta, në të cilat morën pjesë rreth 600 000 vetë, d.m.th. më shumë se gjysma e popullsisë së rritur të vendit dhe diskutuan rreth 160 000 vetë. Kjo vërtetoi edhe një herë se *te ne çështja e arsimit është një çështje e madhe e Partisë, e pushtetit, e popullit, e gjithë shoqërisë.*

Ky diskutim është një shembull i gjallë i demokracisë së vërtetë socialiste në veprim, që zhvillohet e lulëzon në kushtet e diktaturës së proletarietit dhe që ka krijuar mundësi të pakufizuara që të dëgjohet, të grumbullohet, të analizohet e të sintetizohet mendimi kolektiv i masave më të gjera të popullit punonjës.

Diskutimi popullor për arsimin u karakterizua nga aprovimi njëzëri i vijës së Partisë dhe i tezave të shokut Enver për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, si një shprehje e gjallë e unitetit monolit politik e ideologjik të popullit tonë rreth Partisë.

Mbi bazën e aprovimit njëzëri të vijës së Partisë, diskutimi popullor për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës u karakterizua, gjithashtu, nga zhvillimi i një polemike të gjallë konstruktive, që nxiti mendimin krijues të të gjithë punonjësve, në mënyrë të veçantë të mësuesve e nxënësve, studentëve e pedagogëve; u bë një ballafaqim aktiv mendimesh, i shoqëruar edhe me luftë konceptesh e pikëpamjesh: iu nënshtruan kritikës konceptet e vjetra reaksionare borgjeze e revizioniste dhe po afirmohen konceptet e reja marksiste-leniniste mbi shkollën.

Kjo e bëri diskutimin popullor një aksion të madh ideologjik të edukimit masiv, një shkollë të vërtetë të edukimit klasor revolucionar në masave, sidomos të mësuesve e pedagogëve tanë. Gjatë diskutimit përsuan ndryshime të rëndësishme vetë mendimet e pjesëmarrësve, në përgjithësi u revolucionarizuan konceptet tona për arsimin e shkollën.

Diskutimi vërtetoi në praktikë se revolucionin socialist thellohet e shkon përpara nëpërmjet luftës klasore, me pjesëmarrjen aktive të masave të gjera të popullit, se zbatimi konsekuent i vijës së masave është veçanërisht i domosdoshëm e vendimtar në zhvillimin e luftës klasore ideologjike, se masat nuk janë vetëm objekt, por edhe subjekt i revolucionit ideologjik e kultural.

Krahas gjithë këtyre, diskutimi popullor që një shtytje e madhe për përmirësimin e gjithanshëm të punës në shkollë, për thellimin e aksioneve dhe të inisiativave revolucionare në lëmin

e mësimit e të edukimit, për ndërmarrjen e aksioneve dhe të inisiativave të tjera të reja në këtë fushë.

Gjatë diskutimit popullor u bë një analizë kritike për rru-
gën e zhvillimit të shkollës sonë. Nga kjo analizë u bë e qartë
se *shkolla jonë, pas Çlirimit, është zhvilluar në përgjithësi në
rrugë revolucionare e socialiste*. Prandaj, revolucionarizimi i më-
tejshëm i saj është vazhdimi e thellimi i luftës që ka bërë Partia
për realizimin e detyrave të revolucionit socialist në fushën e ar-
simit, mbështetet në tërë këtë rrugë si dhe në traditat e shquara
patriotike, demokratike e revolucionare të popullit tonë në këtë
lëmë.

Sado madhështore të jenë sukseset që kemi arritur në zhvi-
llimin e arsimit, sado të thella të jenë detyrat që qëndrojnë
para nesh për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, ne
nuk harrojmë për asnjë çast se gurët e parë në themelet e arsi-
mit tonë kombëtar janë hedhur me luftë heroike dhe janë spër-
katur me gjakun e popullit tonë, të bijve dhe të bijave të tija tri-
ma, që nga barinjët e thjeshtë që, nën sundimin otoman, mësonin
fshehurazi abetaren e parë shqipe e deri te mësuesit që u marti-
rizuan për këtë kauzë të shenjtë, deri te patriotët, mendimtarët,
shkrimtarët dhe kryengritësit e shquar shqiptarë që luftën për
kulturën kombëtare, për shkollën shqiptare, për alfabetin dhe
shkrimin shqip, për librin shqip, për gjuhën shqipe, e bashkuan
dhe e shkrinë me luftën e armatosur kundër pushtuesve të huaj.
Në këtë luftë heroike u krijuan traditat tona të shquara patrioti-
ke e laike, demokratike e revolucionare në lëmin e arsimit e të
shkollës, tradita, të cilat me krenari i kemi kultivuar dhe po i
cojmë më tutje.

Regjimi obskurantist feudoborgjez i Zogut i mori nëpër
këmbë këto tradita. Ai ndoqi në mënyrë konsekuente kursin e
ndrydhjes së arsimit, e mbajtjes së popullit në padituri dhe anal-
fabetizëm, saqë në parlamentin zogist u propozua që të frenohej
përhapja e arsimit, nga rreziku i «superprodhimit» të intelek-
tualëve! Në kushte të tilla nuk mund të bëhej fjalë për një sistem
arsimor pak a shumë koherent dhe për një shkollë të organizuar
mbi baza e kriteretë të shëndosha shkencore e pedagogjike. Fryma
dhe përmbajtja zyrtare e shkollës ishin thellësisht antidemokra-
tike dhe reaksionare, në shërbim të plotë të klasave sunduese të
vendit, të cilat i hapën rrugën edhe fashistizimit të shkollave.
Por traditat patriotike e demokratike u mbajtën gjallë nga më-
suesit përparimtarë dhe sidomos nga rinia shkollore. Prandaj
edhe ndodhi që gjatë Luftës Nacionalçlirimtare shkollat tona u
kthyen që në fillim në qendra të zjarra të rezistencës, në çerdhe
të lëvizjes çlirimtare dhe revolucionare.

Pas Çlirimit, në arsimin popullor, nën udhëheqjen e Partisë

dhe duke zbatuar vijën e drejtë të saj, është kryer një revolucion
i vërtetë në gjerësi e thellësi. Ky revolucion ka qenë një proces
i gjallë dialektik, që është karakterizuar nga ecja gjithmonë
përpara nëpërmjet kapërcimit të vështirësive të rritjes e kontra-
diktave dhe mënjanimit të të metave të ndryshme, që kanë qenë
bashkudhëtare të pashmangshme të këtij zhvillimi. Në këtë pro-
ces lufte të vazhdueshme të metat dhe gabimet nuk kanë qenë
kurrë karakteristika kryesore e shkollës sonë.

Zhdukja e analfabetizmit, shtrirja e shkollës fillore në të gjitha
skajet e vendit, realizimi thuasje i plotë i arsimit unik të dety-
ruar 8-vjeçar, zgjerimi me ritme të shpejta i arsimit të mesëm,
zgjerimi i arsimit për të rriturit, pa shpëputje nga puna, organi-
zimi për herë të parë i arsimit të lartë dhe në mënyrë të veçantë
krijimi i Universitetit Shtetëror të Tiranës — ja momentet
kryesore të zhvillimit të vullshëm në gjerësi të arsimit tonë.
Si rezultat i këtij zhvillimi, tani çdo ditë ulen në bankat e shko-
llës mbi një gjysmë milion vetë, d.m.th. më shumë se një e ka-
tërta e gjithë popullsisë së vendit, kurse nga shkollat tona deri
sot kanë dalë rreth 24 000 kuadro të mesëm dhe 12 500 kuadro
të lartë.

Në të njëjtën kohë, si rrjedhim i Reformës Arsimore të vitit
1946, i demokratizimit rrënjësor të shkollës, i krijimit të një sis-
temi të ri arsimor socialist, i ndërtimit të brendisë dhe i metoda-
ve të punës mësimorë-edukative mbi bazat e ideologjisë e të
pedagogjisë socialiste, i përpjekjeve për lidhjen e mësimit me
punën prodhuese — nga të gjitha këto, shkolla jonë e ndryshoi
krejtësisht karakterin e saj dhe u shndërrua në një shkollë so-
cialiste edhe nga përmbajtja. Në përgjithësi përmbajtja dhe
metoda e shkollës sonë janë revolucionare dhe shërbejnë si një
bazë e mirë për revolucionarizimin e mëtejshëm të saj.

Të gjitha këto transformime janë një fitore e madhe e histo-
rike e Partisë dhe e pushtetit tonë popullor, e vijës së drejtë
marksiste-leniniste të Partisë sonë në lëmin e arsimit e të kul-
turës, e ngritjes së nivelit arsimor e kultural të popullit, e pre-
gatitjes së inteligjencies së re, e edukimit komunist të brezit të
ri, janë një fitore e madhe historike në zhvillimin e revolucionit
tonë ideologjik e kultural.

Por, me gjithë sukseset e arritura dhe transformimin e për-
gjithshëm revolucionar të saj, shkolla jonë ka akoma të meta se-
rioze, saqë, si pjesë e superstrukturës, ajo nuk përputhet plotë-
sisht me strukturën ekonomiko-shoqërore të sotme. Po të mos
luftohen me forcë dhe deri në fund këto dobësi, në të ardhshmen,
një mospërputhje e tillë mund të thellohet edhe më shumë dhe
atëhere kjo do të kishte pasoja të rënda e të rrezikshme për
fatet e socializmit në vendin tonë.

Përsa i përket zhvillimit në gjerësi, korniza akoma e ngushtë e sistemit arsimor ekzistues, sidomos në sferën e shkollës së mesme e të lartë, pengon shkollimin masiv të klasës punëtore e të fshatarësisë kooperativiste dhe, si rrjedhim, kufizon ushtrimin e rolit udhëheqës të klasës punëtore dhe kontrollin e saj në përgjithësi, e në lëmin e arsimit e të kulturës në veçanti. Një mungesë e ndieshme në këtë drejtim është rrjeti akoma i kufizuar i shkollave profesionale, të ulëta e të mesme, për rininë shkollore dhe, në një shkallë edhe më të madhe, për punëtorët e fshatarët. Veçanërisht shkollat e larta të ne nuk u japin mundësi të gjera klasës punëtore dhe fshatarësisë kooperativiste për të marrë arsim të lartë.

Përgjithësisht, sistemi ekzistues i arsimit nuk i shërben në shkallën e duhur ngushtimit të dallimit midis qytetit e fshatit në sferën e arsimit e të kulturës. Arsimi i mesëm është përqëndruar pothuajse i tëri në qytete, dhe fëmijët e fshatarësisë tërhiqen akoma pak në shkollën e mesme e të lartë.

Përsa i përket përmbajtjes, në shkollat tona që përgatitin kuadro që nuk lidhen drejtpërdrejt me prodhimin, veçanërisht në shkollat e mesme të arsimit të përgjithshëm dhe në ato të artit e të kulturës, ka akoma truall për kultivimin e intelektualizmit mikroborgjez, për ndjenjën e të mësuarit për karrierë, për ushqimin e burokratizmit.

Brendia ideologjike e shkollës sonë ka akoma të meta serioze. Mësimi i marksizëm-leninizmit, sidomos në shkollat 8-vjeçare e të mesme, është akoma i pamjaftueshëm dhe, në përgjithësi, nuk zhvillohet në lartësinë e duhur. Në lëndët shkencore dhe teknike nuk realizohet gjithmonë në mënyrë konsekuente boshti ideologjik marksist-leninist dhe ka truall për influencën e ideologjisë borgjeze. Lidhja e mësimit dhe e edukimit me aktivitetin revolucionar dhe pjesëmarrja e nxënësve dhe e studentëve në jetën e gjallë të përditshme të vendit nuk janë akoma në lartësinë e duhur.

Sistemi arsimor ekzistues nuk lidhet në shkallën e duhur me prodhimin. Shkolla jonë nuk e ka lidhur akoma si duhet teorinë me praktikën, mësimin me punën dhe nuk i shërben në shkallën e duhur ngushtimit të dallimit midis punës mendore dhe punës fizike. Kështu, ajo nuk është e lidhur akoma organikisht me klasën punëtore e fshatarësinë kooperativiste, në mënyrë që nxënësit e studentët, mësuesit e pedagogët jo vetëm të mësojnë, por edhe të punojnë e të jetojnë bashkë me punëtorët e fshatarët, siç na mëson Lenini.

Shkolla jonë nuk merr akoma pjesë aktivisht dhe organikisht në përgatitjen e rinisë për mbrojtjen e atdheut, pasi mungon

lidhja organike e mësimit, sidomos e edukimit fizik, me stërvitjen ushtarake.

Në shkollë ka akoma një prapambetje të ndieshme në lëmin e metodave të mësimit e të edukimit. Gjithashtu, nuk janë zhdukur akoma mbeturinat e metodave e të formave burokratike të drejtimit të arsimit e të shkollës dhe nuk zbatohen akoma gjerësisht vija e masave dhe demokracia socialiste.

Të gjitha këto dobësi e të meta të shkollës sonë janë vështirësi të rritjes, të kushtëzuara nga faktorë objektivë e subjektivë. Në radhë të parë, ato flasin për një prapambetje relative të cilësisë së arsimit e të shkollës ndaj zhvillimit të madh dhe të vrullshëm sasior me ritme jashtëzakonisht të shpejta e të papara ndonjëherë që ka pësuar shkolla jonë. Por, në të njëjtën kohë, ato tregojnë se te ne nuk është zhdukur akoma influenza e ideologjisë borgjeze e revizioniste në përgjithësi, dhe, në mënyrë të veçantë, influenza e pedagogjisë dhe e shkollës borgjeze e revizioniste; ato tregojnë se duhet bërë një luftë e gjatë dhe sistematike për çrrënjosjen e kësaj influence. Duke kapërcyer me guxim këto vështirësi të rritjes dhe ndikimet e huaja të ideologjisë borgjeze e revizioniste, fronti ynë arsimor, i cili në përgjithësi është një front unik, që përshkohet nga ideologjia e Partisë, që militon për fitoren e socializmit e të marksizëm-leninizmit, do të mund ta kryejë akoma më mirë këtë rol.

Nga analiza e rrugës së përshkruar nga shkolla jonë del ky konkluzion themelor: *Partia jonë ka ndjekur gjithmonë një politikë të drejtë arsimore. Procesi i krijimit dhe i zhvillimit të shkollës sonë socialiste ka qenë dhe është një proces revolucionar, gjithnjë në rritje, dhe ne kemi arritur suksese të mëdha në këtë fushë: shkolla jonë është vënë në shërbim të çështjes së revolucionit e të socializmit. Megjithatë, shkolla jonë ka akoma të meta serioze dhe, në gjendjen që është sot, ajo nuk u përgjigjet plotësisht të gjitha detyrave që dalin para saj për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste në etapën e sotme e në perspektivë. Prandaj lind nevoja e domosdoshme për kryerjen e një hopi të ri e të thellë cilësor në zhvillimin e shkollës sonë, për revolucionarizimin e mëtejshëm e të gjithanshëm të saj. Dhe ne i kemi të gjitha mundësitë për zbatimin e detyrës së madhe historike e të përhershme për revolucionarizimin e pandërprerë të shkollës sonë.*

TË KRIJOJMË NJË SHKOLLË QË T'U PËRGJIGJET PLOTËSISHT DETYRAVE PËR NDËRTIMIN E PLOTË TË SHOQËRISË SOCIALISTE

Si një problem i gjerë dhe i ndërlikuar politik, ideologjik, shoqëror, pedagogjik, ekonomik dhe organizativ, revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës është një nga aksionet më të mëdha në kuadrin e gjithë kompleksit të masave që ka marrë e po merr Partia jonë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, për thellimin e mëtejshëm e të gjithanshëm të revolucionit socialist, për revolucionarizimin e jetës së vendit në të gjitha fushat, në mënyrë të veçantë për ta çuar përpara, pa ndërprerje, revolucionin socialist në lëmin e ideologjisë e të kulturës.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se kjo është një punë e vështirë që kërkon përpjekje të mëdha. Kjo kushtëzohet nga një varg faktorësh. Në radhë të parë, mungon eksperiencia pozitive e luftës për konsolidimin e plotë të shkollës socialiste, për çuarjen deri në fund të revolucionit socialist në lëmin e arsimit. Nga ana tjetër, revizionistët modernë, sidomos revizionistët sovjetikë, kanë cinguar e shtrembëruar në frymën borgjeze mësimet e marksizëm-leninizmit për çështjen e shkollës, e kanë «shartuar», si të thuash, shkollën socialiste me teorinë dhe praktikën e shkollës borgjeze, duke shkaktuar konfuzion dhe dëm të madh. Dhe, së fundi, për shkak të veçorive të vendit tonë, të kushteve historike konkrete të zhvillimit të revolucionit e të socializmit, të zhvillimit të derisotshëm të shkollës sonë në veçanti, zhvillimi i mëtejshëm i shkollës të ne nuk mund të mos ketë origjinalitetin dhe disa tipare të veta specifike, gjë që kërkon një qëndrim krijues në këtë çështje.

Në kushte të tilla, Partia jonë, duke përfituar nga eksperiencia e deritanishme, kombëtare dhe ndërkombëtare, pozitive dhe negative, ka për detyrë historike të ngrejë lart flamurin e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës, të çajë me guxim edhe në rrugë akoma të pashkelura, duke hapur shtigje të reja kalimi, të grumbullojë e të përpunojë eksperiencë të re revolucionare, të konkretizojë, të pasurojë e të zhvillojë më tej mendimin e vërtetë revolucionar marksist-leninist në këtë fushë.

Ne kemi bindjen e plotë se Partia jonë, si kurdoherë, do ta kryejë me sukses të plotë këtë detyrë historike me rëndësi jo vetëm kombëtare për fatet e revolucionit e të ndërtimit të plotë të socializmit në Shqipëri, por edhe me vlerë ndërkombëtare për teorinë dhe praktikën socialiste në fushën e arsimit. Në zgjidhjen e këtij problemi të madh e delikat ne kemi si «piketa»

orientimi idetë e klasikëve të marksizëm-leninizmit mbi arsimin dhe si fener ndriçues vijën e drejtë të Partisë sonë dhe mësimet e shokut Enver për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë, mbështetemi në mendimin krijues të popullit tonë, si dhe në vetë eksperiencën e çmueshme të shkollës sonë.

Për të përcaktuar detyrat tona për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, në radhë të parë është e nevojshme të sqarojmë nga se kushtëzohet domosdoshmëria e këtij revolucionarizimi të mëtejshëm, të parashtrojmë qartë objektivat tona në këtë fushë dhe tiparet themelore që duhet të karakterizojnë shkollën tonë të re, të përcaktojmë gjithashtu rrugët kryesore që duhet të ndjekim për të kryer revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë.

Së pari, domosdoshmëria historike e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës sonë kushtëzohet nga fakti që shkolla jonë, në gjendjen që është sot, për shkak të të metave dhe boshllëqeve që analizuam më lart, nuk u përgjigjet plotësisht detyrave të kohës e të perspektivës që qëndrojnë para saj në luftën për ndërtimin e plotë të socializmit. Ajo, si pjesë përbërëse e superstrukturës, nuk përputhet si duhet e sa duhet me strukturën e sotme ekonomiko-shoqërore të vendit tonë. Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës sonë është i domosdoshëm pikërisht për të zgjidhur këtë mospërputhje, në mënyrë që shkolla, siç ka thënë shoku Enver,

«... t'u përgjigjet nevojave të zhvillimit të prodhimit, të jetë e përshtatshme dhe t'u përgjigjet strukturës dhe superstrukturës së vendit tonë socialist»¹.

Së dyti, kjo domosdoshmëri përcaktohet nga kërkesa që shkolla, si element tepër i rëndësishëm i superstrukturës socialiste që është, jo vetëm të mos bëhet pengesë, por të luajë një rol aktiv e të fuqishëm në periudhën e tanishme e në perspektivë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste në vendin tonë dhe për përparimin e mëtejshëm drejt komunizmit, të ecë në vijën e përparuar të zhvillimit tonë revolucionar, të shërbejë në çdo fushë të jetës si një faktor i madh revolucionarizues.

Së treti, revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës është një faktor i dorës së parë dhe kusht i domosdoshëm për të çuar deri në fund revolucionarizimin e mëtejshëm të gjithë jetës së vendit, sidomos revolucionin ideologjik e kultural. Marksizëm-leninizmi na mëson se, përderisa nuk është siguruar fitorja e plotë e revolucionit socialist në fushën e ideologjisë e të kulturës, nuk mund të jenë të sigurt e të garantuara as fitoret e revolucionit socialist në fushën politike dhe ekonomike. Nga kjo rrjedh se *pa revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës nuk*

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 349.

mund të çohet deri në fund revolucionin socialist, nuk mund t'i pritët rruga rrezikut të lindjes së revizionizmit, të degjenerimit borgjez dhe të restaurimit të kapitalizmit në vendin tonë. Revolucionarizimin e mëtejshëm e të vazhdueshëm të shkollës Partia jonë e konsideron pjesë përbërëse të pandarë e shumë të rëndësishme të luftës së përgjithshme klasore për sigurimin e fitores së plotë e përfundimtare të rrugës socialiste mbi rrugën kapitaliste të zhvillimit.

Shoku Enver na porositi që *revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës ta shohim në lidhje të ngushtë dhe në përputhje me stadin aktual e perspektivën të zhvillimit të vendit tonë. Në përgjithësi, ky stad ka të bëjë me shkallën e zhvillimit të revolucionit socialist të ne, me realizimet e tij, me perspektivën e mëtejshme të thellimit të tij, të çuarjes së tij deri në fund.*

Karakteristika e përgjithshme dhe më kryesore e stadi të tanishëm të zhvillimit të vendit tonë është *kalimi nga etapa e ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Në këtë etapë, megjithëse brenda vendit janë zhdukur klasat shfrytëzuese dhe tani ekzistojnë vetëm mbeturinat e tyre, si dhe elementë të ndryshëm anti-socialistë, vazhdon të zhvillohet, si një fenomen objektiv i pashmangshëm, një luftë e ashpër klasore në të gjitha fushat, sidomos në frontin ideologjik, midis nesh dhe armiqve, po ashtu dhe në gjirin e popullit, midis dy rrugëve të kundërta — socialiste e kapitaliste; vazhdon dhe do të vazhdojë të ekzistojë rreziku i kthimit prapa, në kapitalizëm. Ky është shkaku i brendshëm përse fitorja e rrugës socialiste mbi rrugën kapitaliste të zhvillimit në vendin tonë nuk mund të konsiderohet akoma e plotë dhe përfundimtare.*

Në të njëjtën kohë, ekziston dhe do të vazhdojë të ekzistojë për një kohë shumë të gjatë *rreziku i jashtëm*, sa kohë nuk kanë triumfuar përfundimisht socializmi e komunizmi në gjithë botën. Për më tepër, ne nuk mund të harrojmë për asnjë çast se shoqërinë e plotë socialiste e ndërtojmë në kushtet e rrethimit gjeografik e strategjik të dyfishtë të vendit tonë nga armiqtë imperialistë e revizionistë, veçanërisht në kushtet e një lufte të ashpër me revizionizmin modern, i cili nuk është më thjesht një rrymë ideologjike antimarksiste, por paraqitet në arenën ndërkombëtare edhe si një forcë regresive e kundërrevolucionare që ka uzurpuar pushtetin shtetëror në Bashkimin Sovjetik e në një sërë vendesh të tjera, duke i kthyer këto vende nga socializmi në kapitalizëm.

Në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, para nesh qëndrojnë detyra të mëdha, me rëndësi historike, ndër të cilat më kryesoret janë: mbajtja lart e flamurit të luftës së kla-

save e të diktaturës së proletariatit dhe çuarja deri në fund e luftës ideologjike kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste e për krijimin e njeriut të ri, me botëkuptim marksist-leninist; kapërcimi i plotë i prapambetjes ekonomike të trashëguar nga e kaluara, ndërtimi i plotë i bazës materialo-teknike të socializmit dhe kryerja e një hopi të ri cilësor në ngritjen e nivelit të jetesës si dhe të nivelit kulturalo-arsimor të të gjithë popullit; përsosja dhe revolucionarizimi i mëtejshëm i marrëdhënieve socialiste në prodhim dhe i gjithë superstrukturës socialiste, ngushtimi gradual i dallimeve esenciale midis klasës punëtore e fshatarësisë, midis këtyre dhe inteligjencies popullore, midis punës mendore e fizike, midis qytetit e fshatit, industrisë e bujqësisë; sigurimi i mbrojtjes së fitoreve të socializmit nga çdo rrezik, i brendshëm apo i jashtëm.

Në përshtatje me të gjitha këto, *karakteristika e përgjithshme e etapës së ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste në vendin tonë është lufta për thellimin e mëtejshëm dhe për çuarjen deri në fund të revolucionit socialist, për sigurimin e fitores së plotë të socializmit në të gjitha sferat e jetës sonë.*

Në këto kushte, neve na duhet një shkollë *revolucionare konsekuente*, si nga përmbajtja, ashtu edhe nga struktura e saj, që të luajë një rol të madh aktiv, për arritjen e fitores sonë të plotë e përfundimtare në të gjitha fushat, sidomos në këto katër fronte kryesore të luftës sonë: *ideologjik, ekonomik e kultural, politik-shoqëror dhe të mbrojtjes.*

E para, shkolla jonë e re duhet të luajë një rol shumë aktiv në frontin e luftës ideologjike, për të arritur qëllimin e madh të Partisë, i cili, siç thekson shoku Enver,

«...është që, duke ndërtuar socializmin, të formojë dhe të farkëtojë njeriun e ri komunist, me botëkuptime të shëndosha politike dhe teorike marksiste-leniniste, me etikën, guston, shijen marksiste-leniniste, me shpirtin revolucionar, sulmues, të guximshëm, krijues dhe realizues marksist-leninist»¹.

Formimin dhe farkëtimin e njeriut të ri, me tipare komuniste e revolucionare, Partia jonë e ka konsideruar gjithmonë si një ndër çështjet më të rëndësishme e më jetike, nga zgjidhja e së cilës varet sukcesi në çdo front të luftës për socializmin e komunizmin, sepse *janë njerëzit ata që bëjnë revolucionin*, që me veprimtarinë e tyre çojnë përpara prodhimin dhe tërë jetën shoqërore, që *përcaktojnë në praktikë fatin e luftës së madhe*

1 Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 387.

klasore që zhvillohet sot midis dy rrugëve — socialiste e kapitaliste.

Detyra historike e shkollës sonë të re në këtë fushë është të japë një kontribut vendimtar për përgatitjen dhe edukimin e njeriut të ri *me formim të gjithanshëm komunist*, d.m.th. të brumosur me botëkuptimin proletar marksist-leninist, me bindje të thella e ideale komuniste, me normat dhe parimet e moralit komunist; të gatshëm e të aftë për t'ia kushtuar të gjitha forcat dhe energjitë e veta fizike, mendore e shpirtërore çështjes së madhe të marksizëm-leninizmit, të revolucionit e të socializmit, për t'ia nënshtruar interesin personal interesit të përgjithshëm; të pajisur me shpirt revolucionar; të guximshëm e të papërkulur, parimorë e të papajtueshëm ndaj armiqve dhe ndaj çdo gjëje të huaj e të dëmshme për kauzën tonë; masovikë, të shkrirë me njerëzit e punës e të brumosur me vetitë proletare të punëtorit; të armatosur me njohuritë shkencore e kulturele të domosdoshme për të qenë ndërtues i aftë i socializmit dhe specialist i zoti në profilin që merr; të përgatitur mirë fizikisht e ushtarakisht për mbrojtjen e atdheut e të socializmit; me edukatë e shije të shëndoshë estetike marksiste-leniniste.

Veçanërisht i madh e vendimtar është roli i shkollës sonë për edukimin e brezit të ri me idealet revolucionare të Partisë sonë, *në mënyrë që rinia heroike e vendit tonë të marrë denjësisht në duart e saja stafetën e revolucionit, ta mbajë atë lart dhe ta çojë me siguri e gjithmonë përpara, në mënyrë që ajo të rritet si një rini e qartë politikisht, e brumosur ideologjikisht, e pastër moralisht, e cila kurdoherë të mendojë si revolucionare, të punojë si revolucionare dhe të jetojë si revolucionare.*

Gjithashtu, shkollës sonë të re i përket një rol i dorës së parë për përgatitjen dhe edukimin e një inteligjencie të re, me të vërtetë revolucionare e socialiste, *besnike deri në fund ndaj çështjes së Partisë, e lidhur ngushtë me popullin punonjës, me punëtorët e fshatarët, e gatshme për t'u shkrirë me ta në luftën dhe punën e përbashkët, për të vënë kurdoherë të gjitha forcat në shërbim të popullit, të atdheut e të socializmit, duke shqelmuar çdo shfaqje të influencës së ideologjisë borgjeze e revizioniste, çdo shfaqje të egoizmit të ngushtë, të karrierizmit, të etjes për lavdi e të mendjemadhësisë, të intelektualizmit të sëmurë e të teknokratizmit, të nënvleftësimit të masave, të përbuzjes për punën prodhuese etj.*

Shkolla jonë e re do të jetë, pra, një ndër armët kryesore e më të fuqishme në duart e Partisë e të klasës punëtore në fushën e jetës shpirtërore, ku lufta për fitoren e plotë e përfundimtare të socializmit mbi kapitalizmin është veçanërisht e ashpër, e gjatë, e vështirë dhe e ndërlikuar. Ajo do të luajë një rol ve-

ndimtar për shmangien e përhapjes së ideologjisë borgjeze e revizioniste, për të luftuar e çrrënjësuar shfaqjet e influencës së kësaj ideologjie, për t'i mbyllur shtigjet përhapjes së influencës së saj në të ardhshmen, për të mos lejuar që helmi borgjez e revizionist të infektojë ndërgjegjen e njerëzve tanë, të punonjësve, veçanërisht të rinisë e të inteligjencies. Kjo luftë nuk është një qëllim në vetvete, nuk ka karakter mbrojtës. Ajo është luftë sulmuese nga ne për rrënjësimin e të ndërgjegjes socialiste në punonjësit, për konsolidimin e mëtejshëm të ideologjisë socialiste, për triumfin e plotë e përfundimtar të saj mbi ideologjinë borgjeze e revizioniste të çdo ngjyre e nuance. *Qëllimi i kësaj lufte aktive është që Shqipëria socialiste të mos e ndryshojë kurrë ngjyrën e saj të kuqe revolucionare, proletare, që të përjetësohet fitorja e vijës marksiste-leniniste të Partisë sonë, që marshimi i atdheut tonë në rrugën e socializmit e të komunizmit të shkojë kurdoherë në ngjijtje, deri në fitoren e plotë e përfundimtare të kauzës sonë në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.*

E dyta, shkolla jonë e re duhet të luajë një rol të madh aktiv në frontin e luftës për ndërtimin ekonomik e kultural të vendit, në mënyrë që, siç na mëson shoku Enver, mësimi dhe edukata në shkollë të shërbejnë

«... si një armë e fuqishme në duart e njerëzve të rinj të shoqërisë socialiste, për ta ndërtuar këtë shoqëri, për të çuar përpara prodhimin e përbashkët socialist, për të zhvilluar kulturën socialiste në shërbim të shoqërisë»¹.

Ky problem duhet parë si në prizmin e stadi të tanishëm të zhvillimit të vendit tonë, ashtu edhe duke pasur parasysh perspektivën e zhvillimit të mëtejshëm drejt shoqërisë komuniste.

Nga pikëpamja e zhvillimit të forcave prodhuese, vendi ynë ndodhet akoma në periudhën e shndërrimit në një vend industrialo-agrar. Me gjithë përparimet kolosale që kemi arritur, niveli i forcave tona prodhuese dhe i bazës së tyre tekniko-shkencore është akoma relativisht i ulët. Në këto kushte, Partia dhe shoku Enver kanë shtruar detyrën historike të *ndërtimit të plotë e me ritme më të shpejta të bazës materialo-teknike të socializmit, të zhvillimit të gjithanshëm e intensiv të forcave prodhuese të vendit, të thellimit të mëtejshëm e të vazhdueshëm të revolucionit tekniko-shkencor.*

Ekonomia jonë kombëtare, si industria ashtu edhe bujqësia, e kanë kapërcyer tashmë fazën e zhvillimit thjesht ekstensiv dhe, krahas zgjerimit të mëtejshëm, po futen gjithnjë e më shumë në rrugën e zhvillimit intensiv. Proceset teknologjike dhe

1 Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 352.

pajisja teknike e prodhimit po ngrihen e do të ngrihen çdo ditë e më shumë në një nivel me të vërtetë modern. Mekanizimi i prodhimit po shtrihet në të gjitha fushat, po hapet rruga për mekanizimin e plotë e kompleks. Krahas tij, do të zgjerohen edhe proceset e automatizimit të prodhimit. Kimizimi i prodhimit është, gjithashtu, në rendin e ditës. Gjithnjë e më shumë prodhimi po shndërrohet në një fushë të gjerë të zbatimit të drejtëpërdrejtë të shkencës moderne.

Në kuadrin e këtij zhvillimi aktual e perspektiv, *shkollës sonë i bie detyra të përgatitë punonjës e kuadro në numër të mjaftueshëm, të kualifikuar e të aftë për të gjitha degët e ekonomisë e të kulturës socialiste, që të jenë në gjendje të mbajnë mbi shpatullat e tyre këtë barrë të madhe me rëndësi historike. Asaj i bie gjithashtu detyra për ngritjen e përgjithshme e të vazhdueshme të nivelit arsimor-kultural, tekniko-profesional e shkencor të masave të gjera punonjëse të qytetit e të fshatit, detyrë të cilën Stalini e konsideronte si një ndër faktorët më vendimtarë të zhvillimit të shpejtë të ekonomisë socialiste.*

«Ç'do të bëhej, shkruante ai, sikur jo grupe të veçanta punëtorësh, por shumica e punëtorëve, ta ngrinin nivelin e tyre teknik e kultural deri në nivelin e personelit inxhiniero-teknik? Industria jonë do të ngrihej në një shkallë që s'mund ta arrijë industria e vendeve të tjera»¹.

E treta, shkollës sonë të re i përket një rol aktiv i rëndësishëm në sferën politiko-shoqërore, sidomos në këto drejtime kryesore:

a) *Në ngritjen e vazhdueshme të nivelit teorik e arsimor, kultural e shkencor të masave punonjëse, sidomos të klasës sonë punëtore, në mënyrë që klasa punëtore të bëhet gjithnjë më e përgatitur dhe më e aftë për të luajtur plotësisht rolin e saj udhëheqës në shoqërinë tonë socialiste dhe për të ushtruar në çdo fushë të jetës sonë kontrollin punëtor efektiv, vendimtar e pa të çara. Nga kjo pikëpamje, shkolla jonë do të japë një kontribut të madh për forcimin e mëtejshëm të diktaturës së proletariatit dhe për sigurimin e fitores së plotë e përfundimtare të socializmit në vendin tonë.*

b) *Për ngushtimin gradual dhe pastaj për zhdukjen e dallimeve esenciale midis punës mendore dhe punës fizike, në mënyrë që, siç thotë F. Engelsi, kjo ndarje e vjetër e punës t'ia lëshojë vendin një organizimi të tillë të prodhimit, ku secili të marrë pjesë në punë prodhuese, që është kusht i natyrshëm për ekzis-*

¹ J. V. Stalin. «Problemet ekonomike të socializmit në BRSS», botim i dytë, f. 34. Tiranë, 1968.

tenoën e njerëzve, ku puna prodhuese të bëhet një mjet i çlirimit të njerëzve, duke i dhënë mundësi secilit t'i zhvillojë në të gjitha drejtimet dhe t'i tregojë në punë të gjitha aftësitë e veta, si fizike ashtu edhe mendore. Rugët për arritjen e këtij objektivi janë tri: *zhvillimi i vrullshëm i forcave prodhuese, ngritja në një shkallë gjithnjë e më të lartë e nivelit të teknikës, sidomos automatizimi i prodhimit në shkallë të gjerë; ngritja e vazhdueshme e nivelit kulturalo-teknik të të gjithë punonjësve deri në nivelin e personelit inxhiniero-teknik e drejtues; pjesëmarrja e gjerë, efektive, e rregullt dhe e organizuar e njerëzve të punës mendore në punën fizike.*

Ne jemi të ndërgjegjshëm se dallimet esenciale midis punës mendore e asaj fizike do të zhduken plotësisht vetëm me kalimin në shoqërinë komuniste. Por është gjithashtu e padiskutueshme se shoqëria jonë që në kohën e sotme duhet të marrë masa efektive për ngushtimin gradual të këtyre dallimeve, dhe për këtë një levë e fuqishme është shkolla, e cila, ndërsa nga njëra anë, duhet të shërbejë për ngritjen e vazhdueshme të nivelit kulturalo-arsimor të masave të gjera punonjëse të qytetit e të fshatit, nga ana tjetër, duhet të kontribuojë për lidhjen dhe edukimin e rinisë shkollore, të inteligjencies së ardhshme, që në periudhën shkollore, *me punën prodhuese*, për shkrirjen e saj me punëtorët e fshatarët. Eksperienca negative e lindjes së revizionizmit në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera që dikur kanë qenë vende socialiste, tregon qartë se lënia pas dore e kësaj detyre të fundit sjell me vete pasoja tepër të rrezikshme për qështjen e socializmit.

c) *Për ngushtimin gradual dhe pastaj zhdukjen e dallimeve esenciale midis qytetit dhe fshatit, industrisë dhe bujqësisë, klasës punëtore dhe fshatarësisë, sepse, siç e ka përcaktuar F. Engelsi, edukata, në radhë të parë shkolla, do t'i japë mundësi brezit të ri të përvetësorë shpejt, në praktikë, gjithë sistemin e prodhimit dhe të kalojë me radhë, sipas nevojave të shoqërisë e prirjeve të secilit, nga një degë e prodhimit në tjetrën, nga puna industriale në atë bujqësore e anasjelltas, në vend që t'u lihet për ta bërë këtë dy klasave të ndryshme — klasës punëtore dhe fshatarësisë, dy kategorive të ndryshme punonjësish — të qytetit dhe të fshatit. Kjo ka të bëjë si me ngritjen e nivelit të përgjithshëm shkencor dhe politeknik të brendisë së punës mësimore-edukative, ashtu dhe me nevojën e likuidimit sa më të shpejtë të shpërpjesëtimit të madh që ekziston sot te ne midis fshatit e qytetit në pikëpamje të shpërndarjes së rrjetit të arsimit, veçanërisht të shkollës së mesme.*

E katërta, një rol të rëndësishëm duhet të luajë, më në fund, shkolla jonë e re për sigurimin dhe mbrojtjen e atdheut e të so-

cializmit si nga kërcënimi i armiqve të brendshëm, ashtu edhe nga rreziku i agresionit të jashtëm imperialist e revizionist. Ne duhet t'i mbajmë gjithnjë sytë hapur dhe të forcojmë paresh-tur fuqinë mbrojtëse të vendit. *Neve s'na lejohet dhe nuk duhet që pushka të na zërë ndryshk, as sot e as gjatë shumë brezash të tjerë*, porosit shoku Enver. Është e domosdoshme që i gjithë populli ynë të punojë e të vigjilojë duke mbajtur «*në një-rën dorë kazmën e në tjetrën pushkën*». Por brezi i ri është ai që në radhë të parë do t'i vërë gjoksin mbrojtjes së atdheut tonë socialist nga çdo rrezik që mund ta kërcënojë. Detyra e shkollës sonë të re në këtë fushë është që, nga njëra anë, ta edukojë rininë në frymën e patriotizmit e të gatishmërisë për të bërë sakrificat më të mëdha, për të dhënë, po qe nevoja, edhe jetën për mbrojtjen e atdheut e të socializmit dhe, nga ana tjetër, që në bankat e shkollës, t'i japë rinisë një kalitje serioze fizike e ushtarake, ta bëjë çdo të ri një ushtar të përgatitur si duhet.

Nga se duhet të karakterizohet shkolla jonë e re, në mënyrë që ajo t'u përgjigjet si duhet këtyre detyrave? Ç'fizionomi, ç'tipare dalluese themelore duhet të ketë ajo?

1. — *Shkolla jonë e re duhet të karakterizohet, para së gjithash e mbi të gjitha, nga dhënia e prioritetit absolut në tërë punën e shkollës boshtit ideologjik marksist-leninist, mësimin të marksizëm-leninizmit, formimin dhe edukimin të gjithanshëm ideologjik e politik marksist-leninist të rinisë e të gjithë punonjësve që mësojnë në shkollë, armatosjes së tyre me teorinë marksiste-leniniste, me filozofinë e materializmit dialektik e historik, me ideologjinë dhe politikën e Partisë sonë. Shoku Enver thotë se shkolla jonë*

«...duhet të përfaqësojë dhe të materializojë filozofinë tonë marksiste në të gjitha ciklet e saja, në të gjitha format e organizimit të metodave dhe të stilit...»¹;

dhe se, me gjithë ndryshimet që do të pësojë patjetër ajo nga një etapë në tjetrën në format, strukturën e përmbajtjen e saj,

«Vetëm një gjë nuk do të ndryshojë kurrë; shtylla e saj kurrizore, e cila do ta udhëheqë atë në çdo drejtim e në çdo transformim të saj, — filozofia materialiste marksiste-leniniste»².

Pikërisht forcimi i këtij boshti ideologjik marksist-leninist që do të thotë forcim i frymës e i tendenciozitetit klasor proletar në shkollë, përbën aspektin themelor e më të rëndësishëm

1 Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 349.

2 Po aty, f. 358.

të zbatimit të politikës së Partisë sonë për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, tiparin themelor të rrugës së re që po çan shkolla jonë në kushtet e sotme të kalbëzimit të shkollës kapitaliste e të degjenerimit të shkollës revizioniste, përbën drejtimin kryesor të luftës për fitoren e plotë e përfundimtare të rrugës socialiste mbi atë kapitaliste në lëmin e arsimit.

Ne synojmë që nga dyert e shkollës sonë të mos dalin thjesht njerëz me një shkallë të caktuar kulture të përgjithshme apo thjesht specialistë të degëve të ndryshme të dijes, por të dalin, para së gjithash e mbi të gjitha, *revolucionarë të vërtetë proletarë*, besnikë deri në fund ndaj çështjes së marksizëm-leninizmit e të socializmit. Ne duhet të kemi mirë parasysh se pajisja vetëm me arsim e kulturë dhe nënvleftësimi i kalitjes së shëndoshë ideopolitike revolucionare lind te njerëzit prirjet e mendjemadhësisë e të epërsisë, të shkëputjes nga masat, të intelektualizmit të sëmurë e të teknokratizmit, krijon terren të favorshëm për degjenerimin revizionist, mikroborgjez e borgjez të tyre, siç dëshmon për këtë eksperiencia negative e Bashkimit Sovjetik dhe e disa vendeve të tjera.

Boshti ideologjik marksist-leninist, duhet të përshkojë fund e krye, si një fill i kuq, tërë jetën e shkollës sonë, të gjitha format, hallkat dhe mjetet e punës së saj, ndërtimin e sistemit tonë arsimor, programet dhe tekstet, metodat e mësimin e të edukimit, organizimin dhe rregullat e jetës së brendshme e të drejtimit të shkollës.

2. — *Shkolla jonë e re duhet të ketë si bazë të tërë punës së saj mësimore-edukative trekëndëshin mësim-punë prodhuese-edukim fizik e ushtarak, në qendër të të cilit është një bosht i vetëm — boshti ideologjik marksist-leninist i Partisë sonë.*

Gërshetimi i mësimin me punën prodhuese dhe edukimin fizik e ushtarak, duhet konsideruar, në radhë të parë e kryesisht, si një çështje botëkuptimi, me karakter thellësisht ideologjik e politik. Vetëm mbi këtë bazë njeriu ynë i ri do të mund të jetë në gjendje që të mësojë, të punojë dhe të mbrojë atdheun në të njëjtën kohë, do t'i përvetësojë mirë të tria këto cilësi të domosdoshme dhe do t'i vërë ato në shërbim të luftës sonë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. Vetëm kështu ai nuk do të jetë i mangët e i çalë në asnjë nga frontet kryesorë të luftës sonë, nuk do të përgjunjet para asnjë vështirësie, nuk do të thyhet nga asnjë furtunë e stuhi dhe do ta mbajë gjithmonë lart flamurin e socializmit e të komunizmit. Bashkimi dhe shkrirja e këtyre tre komponentëve themelore në punën e tërë shkollës, janë shprehja më e drejtë e më revolucionare e brendisë së zhvillimit dhe të edukimit të gjithanshëm komunist të njeriut të ri.

Kjo përputhet plotësisht me porosinë e njohur të Marksit, i cili ka shkruar:

«Me edukatë ne kuptojmë tri gjëra:

E para: edukimi mendor.

E dyta: edukimi fizik, i tillë sikurse jepet në shkollat e gjimnastikës dhe në stërvitjet ushtarake.

E treta: arsimit teknik, i cili e njejnë njeriun me parimet kryesore të të gjitha proceseve të prodhimit dhe në të njëjtën kohë i jep fëmijës ose adoleshentit shprehitë e përdorimit të veglave më të thjeshta të të gjitha prodhimëve»¹.

Por, duke iu referuar Marksit dhe duke përmendur konceptin e tij për edukatën si një kombinim i edukimit mendor, arsimit politeknik dhe edukimit fizik e ushtarak, shpesh lihet në «harresë» lidhja e mësimimit me punën. Edhe në qoftë se flitet për edukatën e punës, si rregull, ajo trajtohet si një aspekt i edukimit moral. Në këtë mënyrë «duke u mbështetur» te Marksi, në fakt dhe në thelb, gjymtohet Marksi. Para se të zbrëthente konceptin e përgjithshëm mbi edukatën, Marksi thekson se nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë puna e fëmijëve, në qoftë se ajo nuk kombinohet me edukimin, dhe në fund nxirret konkluzionin se kombinimi i punës prodhuese, i edukimit mendor, i përgatitjes fizike dhe i arsimit politeknik do ta ngrejë klasën punëtore shumë më lart se niveli i aristokracisë dhe i borgjezisë.

Lidhja organike e mësimimit me prodhimin, e teorisë me praktikën në shkollën tonë, është me rëndësi të madhe parimore e praktike. Me gjithë realizimet e arritura deri sot në këtë fushë, ne duhet të bëjmë një hop të thellë cilësor për të zhdukur shkëputjen që ekziston akoma midis tyre në punën e shkollës sonë. Duke folur në lidhje me këtë çështje, Lenini ka thënë:

«Një nga të këqijat dhe fatkeqësitë më të mëdha, që na kanë mbetur nga shoqëria e vjetër kapitaliste, është shkëputja e plotë midis librit dhe praktikës së jetës... Pa punë, pa luftë njohja skolastike e komunizmit nga broshurat dhe veprat komuniste nuk vlen asgjë, sepse ajo do ta mbante të hapur hendekun e vjetër midis teorisë dhe praktikës, atë hendek të vjetër, që përbente tiparin më të neveritshëm të shoqërisë së vjetër borgjeze»².

Lenini thekson, gjithashtu se

1 K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. i 2-të rus., 1960, vëll. 16, f. 198.
2 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 316.

«...nuk mund të përfytyrohet ideali i një shoqërie të ardhshme pa e bashkuar arsimin me punën prodhuese të brezit të ri; as arsimit dhe edukimit pa një punë prodhuese, as puna prodhuese pa arsimin dhe edukimin nuk do të mund të vireshin në atë lartësi, që kërkohet nga shkalla e sotme e teknikës dhe nga gjendja e dijeve shkencore»¹.

Lidhja e ngushtë e mësimimit me punën prodhuese, e teorisë me praktikën, është e domosdoshme edhe si një mjet i fuqishëm edukimi dhe kalitjeje revolucionare ideologjike e morale, për të prerë nga rrënjët çdo koncept e shfaqje të aristokratizmit, të intelektualizmit e karrierizmit, të përbuzjes për punën prodhuese dhe për njerëzit e punës.

Edukimi fizik e ushtarak merr një rëndësi veçanërisht të madhe në kushtet konkrete të rrethimit armiqësor gjeografik e strategjik imperialist e revizionist të vendit tonë. Vetëm kur të zhduket plotësisht edhe rreziku i jashtëm, kur të jetë garantuar triumfi përfundimtar i socializmit në mbarë botën, vetëm atëhere përgatitja ushtarake nuk do të jetë më e nevojshme. Por edhe atëhere do të mbetet si komponent i domosdoshëm e i përhershëm i shkollës komuniste kalitja e gjithanshme fizike e brezit të ri, të cilën klasikët e marksizëm-leninizmit e konsideronin si kusht të dorës së parë për zhvillimin e gjithanshëm të njeriut, për zhvillimin e të gjitha aftësive të tija trupore e mendore në shërbim të prodhimit e të shoqërisë, burim gëzimi e optimizmi në jetë.

Realizimi i të tre komponentëve të shkollës sonë të re — mësim-punë prodhuese-edukim fizik e ushtarak — përbën një ndër rrugët kryesore për lidhjen e ngushtë të shkollës me tërë jetën tonë shoqëro-politike, krijon kushte të favorshme për pjesëmarrjen aktive të rinisë shkollore në tërë gamën e lëvizjeve revolucionare masive që kanë shpërthyer e lindin çdo ditë në të katër anët e vendit tonë, është në fakt zbatimi konkret në punën për edukimin e rinisë shkollore i parullës luftarake për të menduar, punuar e jetuar si revolucionarë.

3. — Shkolla jonë e re duhet t'u japë njerëzve një formim të përgjithshëm e të shëndoshë arsimor e kultural, shkencor e politeknik. Siç na mëson Lenini, komunist i formuar nuk mund të quhet ai që vetëm ka lexuar disa broshura e libra komuniste. Formimi komunist i njeriut mbështetet në një zhvillim të gjerë kultural, në përvetësimin kritik e revolucionar të thelbit të diturisë njerëzore të përpunuar gjatë shekujve dhe të pasqyruar në bazat kryesore të shkencave.

Prandaj në shkollë, pa nënvleftësuar aspak praktikën dhe

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 2, f. 549.

domosdoshmërinë absolute të lidhjes së teorisë me praktikën, *koha më e madhe duhet t'i kushtohet mësimin të teorisë, të shkencës, dhe të luftohen e çrrënjosen tendencat e të kënaqurit me pak, të praktikizmit e të profesionalizmit të hershëm e të ngushtë, të nënvleftësimit të teorisë, të cilat janë pasqyrime të influencës së ideologjisë së huaj të pragmatizmit borgjez. Duhet luftuar, gjithashtu, si të dëmshme tendencat vulgare të politikanizmit abstrakt e të zbrazët, si dhe të qëndrimit konservator ndaj rezultateve të shkencës e të teknikës moderne, ndaj nevojës së pasqyrit të tyre të vazhdueshëm në punën e shkollës sonë.*

Në përputhje me stadin e sotëm e perspektiv të zhvillimit të vendit, shkolla jonë duhet të ecë gjithashtu në rrugën e politeknizimit të saj të mëtejshëm gradual e të vazhdueshëm, duke pasur gjithmonë parasysh amanetin e Leninit për politeknizimin e shkollës, i cili porosiste vazhdimisht që ta bëjmë shkollën tonë një shkollë politeknike.

Politeknizimi gradual i shkollës sonë i shërben çështjes së zhvillimit e thellimit të mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor dhe të ndërtimit të plotë të bazës materialo-teknike të socializmit në vendin tonë. Ai përfaqëson, gjithashtu, një ndër rrugët për afrimin akoma më të madh të njerëzve të punës mendore e fizike, për afrimin e nivelit kulturalo-arsimor e tekniko-shkencor, si dhe të aftësisë së gjithanshme për punë të rinisë dhe të mbarë popullsisë së qytetit e të fshatit.

4. — Një ndër veçoritë dalluese më të rëndësishme të shkollës sonë të re duhet të jetë masivizimi i mëtejshëm e i vazhdueshëm i saj.

«...ne synojmë — thotë shoku Enver — t'i edukojmë në masë popullin dhe rininë, punëtorët e kooperativistët, të cilët, në një të ardhshme imediate, duhet të jenë me një kulturë të përgjithshme dhe tekniko-profesionale të mjaftueshme për t'i çuar përpara ekonominë dhe kulturën socialiste»¹.

Kjo është me rëndësi të pallogaritshme jo vetëm për t'u përgjigjur kërkesave gjithnjë në rritje të zhvillimit ekonomik e kultural të vendit në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, por është njëkohësisht një çështje e madhe parimore ideologjike, politike e shoqërore për të rritur vazhdimisht pjesëmarrjen efektive të mbarë popullit në gjithë jetën politiko-shoqërore të vendit, për të thelluar më tej demokracinë proletare, për të shkullur nga rrënjët sëmundjen e rrezikshme të bu-

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 492.

rokratizmit, për ngushtimin gradual të dallimeve esenciale midis qytetit e fshatit, punës mendore e punës fizike, për të evituar krijimin e «elitave» të privilegjuara që mund të shërbejnë si bazë e lindjes së revizionizmit.

5. — Shkolla jonë e re duhet të karakterizohet nga *vendosja efektive e kontrollit të klasës punëtore, të masave të gjera punonjëse të qytetit e të fshatit mbi tërë punën e saj*. Klasa punëtore duhet të luajë në shoqërinë tonë socialiste rolin vendimtar që i përket, ashtu siç e ka theksuar shoku Enver, si klasë në udhëheqje, e caktuar nga historia jo vetëm për të punuar në fabrikë, por, duke punuar në fabrikë, të drejtojë çdo sektor dhe të gjithë të ecin në rrugën e saj dhe të Partisë së saj në fabrika, në fusha, në administratë, në shkolla e kudo. Kjo është vendimtare për t'i ruajtur shkollën tonë dhe rininë shkollë nga çdo rrezik degjenerimi revizionist e borgjez, për ta bërë shkollën një krah të vërtetë proletare për kalitjen revolucionare të brezit të ri.

Ushtrimi i kontrollit punëtor në format më të ndryshme nga jashtë dhe hapja e dyerve të shkollës për masat e gjera të punëtorëve e të gjithë punonjësve të qytetit e të fshatit — këto janë dy rrugët kryesore për vendosjen e një kontrolli efektiv të klasës punëtore mbi tërë punën dhe jetën e shkollës.

6. — *Shkolla jonë e re duhet të karakterizohet nga zbatimi konsekuent i vijës së masave në tërë punën e saj*. Koncepti, sipas të cilit shkolla duhet konsideruar më shumë si fusha e mësuesit, e pedagogut, ku çdo gjë i nënshtrohet më shumë anës pedagogjike, metodike, është një koncept i gabuar, i cili ushqen metodën burokratike dhe teknokratike në drejtimin e arsimit dhe të punës së shkollës, pengon zbatimin e vijës së masave në drejtimin e arsimit dhe në punën e shkollës. Ne po e luftojmë me të gjitha forcat këtë koncept jo vetëm teorikisht, por edhe në praktikë, duke u udhëhequr nga mësimet e Partisë e të shokut Enver se çështja e arsimit dhe e shkollës nuk është një çështje burokratike, nuk mund të jetë as fusha e arsimtarëve në përgjithësi, nuk mund të konsiderohet vetëm fusha e teorisë së shkëputur nga prodhimi, nga puna, por ajo është një çështje e madhe e Partisë, e popullit, e ekonomisë, e strukturës dhe e superstrukturës.

7. — *Së fundi, në shkollën tonë të re, në gjithë punën mësimoro-edukative duhet të sundojnë plotësisht parimet e pedagogjisë socialiste dhe metoda pedagogjike shkencore të përshkruara fund e krye nga botëkuptimi marksist-leninist*. Ndërsa tërë jeta e brendshme e shkollës duhet të karakterizohet krejtësisht nga normat e demokracisë socialiste, nga forcimi i vetëdisiplinës proletare dhe i vetëveprimit të nxënësve e studentëve, në

bashkëpunim revolucionar me personelin arsimor, nga rritja e mëtejshme e rolit të organizatës së rinisë e të pionierit në shkollë.

Këto janë disa veçori dalluese themelore që duhet të karakterizojnë fizionominë e shkollës sonë të re që duam të ndërtojmë dhe që po ndërtojmë. Ato vërtetojnë plotësisht tezën e shokut Enver se kur flasim për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, nuk është fjala për të rregulluar ndonjë qoshe, për të bërë disa ndryshime të zakonshme në programet e tekstet shkollore, për të ndryshuar afatin e ndonjë kategorie shkolle etj. Të gjitha këto çështje kanë rëndësinë e vet, por nuk janë themeloria. Themelore është që, duke u udhëhequr nga konceptet revolucionare marksiste-leniniste, në luftë me konceptet reaksionare borgjeze e revizioniste, të bëhet një revolucionarizim i gjithanshëm tërësor i shkollës, në radhë të parë në brendinë e mësimit e të edukimit dhe, në përshtatje me të, në sistemin arsimor e strukturën e shkollave, në metodat e mësimit e të edukimit si dhe në metodën e drejtimit të arsimit popullor e të punës së shkollës. Për realizimin e tij ka rëndësi vendimtare, në radhë të parë, intensifikimi i luftës për çrrënjosjen e koncepteve e të traditave të huaja klasore borgjeze e revizioniste në çështjen e arsimit e të shkollës dhe për përpunimin e koncepteve të reja revolucionare, socialiste, marksiste-leniniste në këtë fushë.

Influenca e këtyre koncepteve e traditave të dëmshme shfaqet jo vetëm teorikisht, në mendimin pedagogjik dhe në literaturën pedagogjike, por edhe praktikisht, në organizimin e shkollave, në përcaktimin e strukturës së tyre, të brendisë së mësimit, të metodave mësimorë-edukative, etj. Merita e Partisë sonë dhe e shokut Enver qëndron në faktin se po u bëjnë një kritikë sistematike dhe të gjithanshme këtyre koncepteve, po zbulojnë si rrënjët e tyre historike, ashtu edhe pleksjen e tyre me teoritë e sotme borgjeze e revizioniste dhe, në mënyrë të veçantë, po e vënë theksin te rreziku që sjell influenca e tyre. Kjo analizë kritike nuk mbetet vetëm në mohime, por po shoqërohet me përpunimin e zhvillimin e koncepteve revolucionare marksiste-leniniste për shkollën.

Që ta revolucionarizojmë shkollën, duhet, në radhë të parë, ashtu siç porositi shoku Enver, të rrëzojmë disa koncepte borgjeze që ekzistojnë në brezin tonë për shkollën dhe që pengojnë revolucionarizimin e mëtejshëm të saj.

Së pari, koncepti se «shkolla është vendi ku mësohet» duhet të ndryshohet dhe të kthehet në konceptin sipas të cilit «shkolla është vendi ku mësohet dhe punohet».

Koncepti se «shkolla është vendi ku mësohet» është formuar historikisht në shoqërinë me klasa shfrytëzuese, si rezultat i

ndarjes së punës mendore nga puna fizike, i antagonizmit midis njerëzve të punës mendore e fizike, i monopolizimit të arsimit në duart e klasave sunduese, të cilat i përgatitnin fëmijët e tyre për t'u marrë vetëm me punë mendore dhe i edukonin në frymën e përbuzjes për punë fizike. Ky koncept i formuar gjatë shekujve ka lëshuar rrënjë të thella dhe ka molepsur në një farë shkalle edhe ndërgjegjen e punonjësve. Ai vazhdon të ushtrrojë influencën e vet edhe në shoqërinë tonë socialiste. Përkërisht kjo influencë është një nga burimet kryesore të fenomeneve të tilla negative të pakapërcyera akoma nga shkolla jonë, si njëanshmëria e saj intelektualiste, një farë shkëputje e mësimit dhe e edukimit nga praktika revolucionare e jetës, në radhë të parë nga puna prodhuese, një farë izolimi i saj nga kontakti i drejtëpërdrejtë me klasën punëtore, masat punonjëse etj. Këto fenomene negative prekin jo vetëm rininë dhe inteligjencien tonë, por edhe mbarë shoqërinë.

Kurse koncepti «shkolla është vendi ku mësohet e punohet» bazohet në mësimet e marksizëm-leninizmit mbi zhdukjen jo vetëm të kontrastit, por edhe të dallimit rrënjësor midis punës mendore e fizike, në mënyrë të veçantë bazohet në parimin marksist-leninist të lidhjes së mësimit me punën prodhuese, i cili ka rëndësi shumë të madhe veçanërisht në kushtet e sotme. Shkëputja e mësimit nga puna prodhuese dhe, mbi këtë bazë, shkëputja e punës mendore nga puna fizike, ushqimi i intelektualizmit dhe i qëndrimit larg nga puna prodhuese dhe nga njerëzit e prodhimit në rininë shkollore e studenteske, në inteligjencien e në kuadrot, janë leva ideologjike në duart e armiqve tanë, të borgjezisë e të revizionistëve, me anën e të cilave ata duan të na çoroditin e të na futin në rrugën e degjenerimit. Prandaj këtu lufta ka një karakter klasor të mprehtë ideopolitik.

Së dyti, duhet të rrëzojmë konceptin se «mësohet vetëm në shkollë, ose kryesisht në shkollë». Edhe ky koncept duhet të ndryshohet dhe të krijohet koncepti që «nuk mësohet vetëm në shkollë, por mësohet edhe në jetë, edhe në punë, këtu bile ca më shumë».

Mbivlerësimi i njëanshëm i shkollës, i edukatës që ajo jep, i mësuesve dhe i edukatorëve, nga njëra anë, dhe nënvleftësimi i praktikës revolucionare, i shkollës së vazhdueshme e të përherëshme të jetës, nga ana tjetër, trajtimi borgjez intelektualist i këtyre problemeve në pedagogji, janë burimi teorik i shumë koncepteve të tjera që pengojnë revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës. Nga ky burim ushqehet tendenca e rëndimit të programeve mësimore, e nënvleftësimit të faktit se masa që mbaron shkollën nuk ka mbaruar së mësuar, se pajisja me kulturë dhe shkritja e vazhdueshme e nivelit të përgjithshëm kultural nuk

mund të bëhet vetëm nga shkolla, por edhe nga jeta, nga puna fizike, nga puna politike, ideologjike, kulturele, ushtarake e Partisë dhe e organeve shtetërore e shoqërore.

Nga ana tjetër, ashtu siç thekson shoku Enver, kjo nuk do të thotë aspak se ne nënvleftësojmë shkollën dhe rolin që duhet të luajë ajo në hedhjen e bazave për zhvillimin dhe edukimin e gjithanshëm komunist të njeriut. Pikërisht për të luajtur këtë rol Partia i kushton një kujdes kaq të madh zhvillimit dhe revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës.

Së treti, të luftojmë konceptin se «shkolla të bën intelektual, të jep diplomë dhe punë të sigurtë», koncept që ushqen intelektualizmin dhe karrierizmin, teknokratizmin dhe burokratizmin që konsideron si qëllim përfundimtar të të gjithë shkollës mbarimin e universitetit. Ky koncept duhet zëvendësuar me konceptin revolucionar marksist-leninist se «duhet të mësoj, pasi pa dituri nuk mund t'u shërbej si duhet popullit, atdheut, shoqërisë, socializmit».

Duhet përmbytur koncepti se në shkollat e mesme profesionale pregatiten «teknikë të mesëm», në gjimnaz pregatiten «nëpunës» dhe kush mbaron shkollën e lartë duhet doemos të emërohet si «kuadër i lartë». Këto janë koncepte karrieriste dhe borgjeze për shkollën. Koncepti ynë revolucionar kërkon që ai që mbaron shkollën e mesme të mund të punojë edhe si punëtor, ai që mbaron shkollën e lartë të shërbejë jo medoemos në funksione të caktuara «për kuadro të lartë», por të punojë kudo ku është nevoja. Vetëm kështu do të hapim perspektivën e zhvillimit pa kufi të arsimit dhe në vendin tonë nuk do të ketë kurrë «saturim kuadrosh» ose «superprodhim intelektualësh».

Koncepti që e konsideron arsimin, sidomos shkallët më të larta të tij, pronë të një «elite» është trashëgim i shoqërisë me klasa shfrytëzuese dhe i shkollës së saj. Në kushtet tona shfaqja e tij pengon jo vetëm edukimin me frymën klasore revolucionare të intelektualëve e të kuadrove të rinj, por edhe përhapjen e gjerë të arsimit dhe masivizimin e pakufishëm të tij deri në shkallët më të larta. Gjithë çështja është që arsimit ynë të jetë me të vërtetë masiv, që shkolla të mos i vërë vetes si qëllim krijimin e një inteligjencie që të qëndrojë vazhdimisht si një shtresë e shkëputur, por që masa më e madhe dhe kryesore e të mësuarve të përbëhet nga punëtorët e fshatarët dhe ajo pjesë që përbën inteligjencien të shkrihet me ta.

Së katërti, të luftojmë e të çrrënjosisim konceptin prapanik «ç'na duhet shkolla!» dhe ta zëvendësojmë me konceptin përparimtar, marksist-leninist se «pa shkollë nuk ndërtohet jeta e re socialiste e komuniste».

Koncepti i nënvleftësimit të shkollës, i cili qarkullon në një

pjesë njerëzish të prodhimit, është një mbeturinë, një gjurmë e shfrytëzimit dhe e shtypjes së egër ekonomike, klasore e shpirtërore që rëndonte mbi punonjësit në shoqëritë shfrytëzuese. Ky koncept buron gjithashtu nga tërheqja pas përfitimit personal imediat, nga shikimi i shkollës si një mjet për të siguruar punë të lehtë e «qoshe të ngrohta». Ai është i lidhur me mendimin se shkolla u duhet atyre që do të merren me punë mendore e do të punojnë në zyrë, se punëtorëve e fshatarëve nuk ka ç'u duhet ndonjë shkollë e madhe! Ai është i lidhur së fundi, me shkëputjen e praktikës nga teoria, me mbivlerësimin e njëanshëm të praktikës dhe nënvleftësimin e teorisë. Lidhur me këtë, shoku Mao Ce Dun ka thënë: «...njerëzit që kanë eksperiencën e punës praktike duhet të merren me studime teorike dhe të punojnë si duhet me libra, vetëm atëhere ata do të mund ta sistematizojnë eksperiencën e tyre, të bëjnë bilancin e saj dhe ta përgjithësojnë atë nga pikëpamja teorike, nuk do të bëjnë gabimin që ta shikojnë eksperiencën e tyre të kufizuar si një të vërtetë të përgjithshme dhe do të mund t'u shmangen gabimeve me karakter empirik. Si dogmatizmi, ashtu edhe empirizmi janë shprehje e subjektivizmit, megjithëse rrjedhin nga burime krejt të kundërta»¹. Kësaj të keqeje, shkëputjes së praktikës nga teoria, ne duhet t'i shpallim luftë të pamëshirshme, po ashtu siç luftojmë e hedhim poshtë edhe shkëputjen e teorisë nga praktika.

Së pesti, të rrëzojmë konceptin se metoda më e përshtatshme e mësimit dhe e edukimit është ajo që lidhet me librin, se kulturë është vetëm teoria dhe teoria mësohet vetëm nga librat dhe ta zëvendësojmë atë me konceptin, sipas të cilit, metoda më e drejtë dhe më revolucionare është ajo që, krahas librit, bazohet në praktikën revolucionare të jetës, në eksperiencën e gjallë të masave punonjëse, në punën prodhuese të tyre. Shkolla ka për mision të madh jo vetëm t'u mësojë dituri njerëzve, por edhe t'i armatosë ata me metodën më të mirë si të mësojnë në klasë dhe jashtë saj. Vetëm kur e lidhim mësimin me punën prodhuese ne kemi zgjedhur metodën më të përshtatshme si të mësojmë e të punojmë më mirë. Duhet të kemi kurdoherë parasysh mësimin e Leninit se *teoria lind nga praktika, pasurohet nga praktika, i shërben praktikës, verifikohet në praktikë, korrigjohet nga praktika*, dhe ta mishërojmë këtë parim në metodën tonë të studimit, në shkollë e në jetë.

Prëzimi i gjithë këtyre koncepteve të vjetra borgjeze e revisioniste dhe zëvendësimi i tyre me koncepte të reja revolucio-

1 Mao Ce Dun. Vepra të zgjedhura, vëll. 4, f. 52-53.

nare marksiste-leniniste janë një kusht i domosdoshëm për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës. Ky proces revolucionarizimi konceptesh është i lidhur ngushtë me luftën që bën Partia jonë kundër burokratizmit dhe karrierizmit, intelektualizmit dhe teknokratizmit, tërheqjes pas interesit personal, konservatorizmit si dhe influencave e «njollave» të tjera të ideologjisë borgjeze e revizioniste, është i lidhur me luftën kundër këtyre koncepteve jo vetëm përgjithësisht në tërë jetën e shoqërisë sonë, por, akoma edhe më konkretisht, kundër shfaqjes së tyre në terrenin e arsimit, në punën e shkollës.

Mbi bazën e kësaj analize të detyrave tona të përgjithshme për revolucionarizimin e mëtejshëm të arsimit, të tipareve të shkollës sonë të re socialiste, të koncepteve marksiste-leniniste nga të cilat ajo duhet të udhëhiqet, mund të kuptohen më qartë detyrat konkrete që duhet të zgjidhim në lëmin e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës.

Sigurisht, kjo nuk do të thotë se me këtë diskutim dhe studim që u bënë, me këtë raport që po paraqitim, me detyrat që shtrohen e masat që propozohen të merren do të vendoset e do të zgjidhet përfundimisht çështja e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës. Ky do të ishte një kuptim metafizik, antidialektik i problemit.

Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës është një proces i vazhdueshëm dhe i pandërprerë gjatë gjithë periudhës së thellitimit e çuarjes deri në fund të revolucionit socialist, i pandarë nga revolucionarizimi i vazhdueshëm i gjithë jetës së vendit, i strukturës dhe i superstrukturës së shoqërisë sonë. Në këtë kuptim, shkolla do të pësojë gjithnjë ndryshime të reja cilësore, do të përsoset dhe do të ngrihet në një nivel gjithnjë e më të lartë.

Për më tepër, konkluzionet tona të përgjithshme për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, dhe sidomos zgjidhjet konkrete të problemeve që shtrohen në këtë fushë, kushtëzohen nga faktorë objektivë e subjektivë, të lidhur si me stadin e zhvillimit tonë të gjithanshëm, ashtu edhe me shkallën e njohjes nga ana jonë të këtyre çështjeve, si dhe të eksperiencës së grumbulluar për zgjidhjen e këtyre detyrave praktike. Prandaj, gjatë punës për zbatimin e detyrave për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, në praktikë, këto konkluzione e zgjidhje do të pasurohen dhe, në kushtet e një stadi më të lartë dhe eksperiencës më të pasur, do të marrin një pamje të re, do të përsosen më tej.

Pikërisht për këtë ne i hyjmë me guxim aksionit të madh të revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës. Ne jemi në rrugë

të drejtë, në rrugën marksiste-leniniste. Duke ecur me guxim në këtë rrugë nuk përjashtohet që ne mund të bëjmë edhe gabime të veçanta. Por rruga e përgjithshme e drejtë marksiste-leniniste na ndihmon që edhe gabimet t'i korrigjojmë gjithashtu me guxim, rrënjësisht dhe në kohën e duhur.

II

MBI REVOLUCIONARIZIMIN E SISTEMIT ARSIMOR

Ne kemi krijuar një sistem të ri arsimor, të ndërtuar mbi parime demokratike dhe socialiste, unik dhe tërësor, masiv dhe të larmishëm, me të gjitha hallkat shkollore, që nga fillorja e deri te e larta, me kategoritë e shkollave të nevojshme për vendin tonë. Ai ka luajtur një rol të madh në ngritjen e nivelit arsimor e kultural të rinisë dhe të të gjitha masave punonjëse, në përgatitjen e një ushtrie të tërë kuadrosh e specialistësh për të gjitha degët e ekonomisë e të kulturës, në krijimin e inteligjencës së re popullore.

Sot, në vendin tonë, mbi arsimin 8-vjeçar ngrihen me qindra shkolla, me shkëputje dhe pa shkëputje nga puna: 53 shkolla të ulëta tekniko-profesionale me 43 specialitete; 110 shkolla të mesme të arsimit të përgjithshëm që shtrihen në të gjitha rrethet e vendit pa përjashtim; 136 shkolla të mesme profesionale industriale, bujqësore, pedagogjike, ekonomike etj. me 51 specialitete; shkollat tona të larta dhe filialet e tyre nxjerrin kuadro të lartë për 54 specialitete. Kështu, në vendin tonë përgatiten dhe kualifikohen në mënyrë të organizuar punëtorët, teknikët dhe specialistët e profileve më të rëndësishme të ekonomisë e të kulturës.

Stadi aktual i nivelit të zhvillimit kulturalo-arsimor të vendit tonë karakterizohet: nga realizimi thuajse i plotë i arsimit të përgjithshëm të detyruar 8-vjeçar; nga përfshirja e gjerë e rinisë në arsimin e mesëm, me tendencën e zgjerimit të arsimit tekniko-profesional të mesëm; nga një zhvillim i konsiderueshëm i arsimit të lartë; nga rritja e vrullshme e shkollave pa shkëputje nga puna, në mënyrë të veçantë të shkollave tekniko-profesionale; nga rritja e formave masive të arsimit dhe të edukimit tekniko-profesional, si dhe nga një lëvizje e gjerë e eksperimentimit shkencor. Në këtë mënyrë, i gjithë vendi është kthyer në shkollë, në një vatër të madhe mësimi dhe edukimi. Po krijohen

kushte kurdoherë e më të favorshme që i gjithë populli të punojë dhe të mësojë, të krijojë dhe të eksperimentojë, të zhvillojë prodhimin dhe njëkohësisht edhe shkencën. Ky është një revolucion kulturalo-arsimor i thellë e i gjithanshëm.

Por, duke parë të metat e analizuara më lart, të cilat kanë të bëjnë si me punën e shkollës, në tërësi, ashtu edhe me sistemin arsimor në mënyrë të veçantë, me strukturën e përgjithshme dhe hallkat e tija të veçanta, është e domosdoshme të shtrojmë me forcë detyrën për revolucionarizimin e mëtejshëm të të gjithë sistemit arsimor.

Në këtë fushë ne synojmë të arrijmë gradualisht një *masivitet të pakufishëm të arsimit*, deri në shkallët e tija më të larta dhe të zhvillojmë një larmi të madhe shkollash të mesme, si dhe ta ndërtojmë strukturën e sistemit arsimor në një mënyrë të atillë, që kjo strukturë të mos bëhet pengesë për zhvillimin e brendisë revolucionare të mësimin e të edukimit, por, përkundrazi, të kthehet në një faktor vendimtar për realizimin e saj.

Sistemi i ri arsimor që propozohet, dallohet kryesisht nga këto veçori:

E para, sistemi arsimor do të ketë si bazë trekëndëshin *mësim-punë prodhuese-edukim fizik e ushtarak*.

E dyta, në sistemin arsimor do të vendoset, si pjesë përbërëse e tij, *stazhi në punën prodhuese*, gjatë të cilit të gjithë nxënësit që mbarojnë shkollën e mesme, para se të hyjnë në shkollën e lartë do të punojnë si punëtorë të thjeshtë; futja në shkollën e lartë do të bëhet *me pëlqimin e kolektivit punonjës* ku kryhet stazhi; vendoset *stazhi në punën prodhuese edhe pas mbarimit të shkollës së lartë* e para mbrojtjes së diplomës.

E treta, *unifikimi i strukturës së vitit shkollor për të gjitha llojet e shkollave të mesme; thellimi i theksuar i politeknizimit të tyre dhe vendosja e zbatimi i programeve të tilla ku lënda e marksizëm-leninizmit, si dhe disa lëndë kryesore të kulturës së përgjithshme (matematikë, fizikë, kimi) do të jepen në vëllim të barabartë ose afërsisht të barabartë në të gjitha llojet e shkollave të mesme, profesionale dhe joprofesionale, duke hapur, kështu, rrugën e gjerë për kalimin në arsimin e mesëm, jounik por të shumëllojtë, për gjithë rininë.*

E katërta, *shkurtimi i afatit të zgjatjes së ciklit në shkollat e larta.*

E pesta, zhvillimi e zgjerimi i madh i të gjitha hallkave shkollore për punëtorët e fshatarët, duke ndërtuar, kështu, një sistem të plotë e masiv shkollash pa shpëputje nga puna.

E gjashta, *shkrirja e rinisë shkollore me klasën punëtore dhe me fshatarësinë kooperativiste dhe vendosja efektive e kontrollit të drejtëpërdrejtë të klasës punëtore mbi arsimin.*

A. — MBI STRUKTURËN E SISTEMIT TË RI ARSIMOR DHE HALLKAT E TIJA TË VEÇANTA

Gjatë diskutimit popullor është rrahur shumë problemi i strukturës së sistemit të ri arsimor. Duke u mbështetur në arsyetimet që dolën nga diskutimi popullor, po paraqitim këtu shkurtimisht propozimet përfundimtare në lidhje me strukturën e sistemit të ri arsimor.

1. — Arsimi parashkollor

Deri tani, ne kemi krijuar një rrjet relativisht të gjerë institucionesh parashkollore, sidomos në qytet, kurse në fshat ai është më i kufizuar. Janë hedhur hapat e parë për t'i ndërtuar këto institucione mbi baza shkencoro-pedagogjike si dhe për të përgatitur e kualifikuar edukatorët që punojnë në to. Megjithatë, nuk kemi arritur të realizojmë akoma qëllimet themelore që ka arsimi parashkollor në shoqërinë socialiste. Arsimi parashkollor ka për detyrë të realizojë *edukimin shoqëror të fëmijëve të moshave tre deri gjashtëvjeçare, të kultivojë filizat e parë, fillestarë, të zhvillimit dhe të edukimit komunist të tyre dhe t'i përgatitë ata për të hyrë në shkollë.* Në të njëjtën kohë, ai është një kusht i rëndësishëm për emancipimin e plotë të gruas dhe për të lehtësuar familjen nga barra e mirërritjes dhe e edukimit të fëmijëve. Nga kjo pikëpamje, institucionet e arsimit parashkollor, për rëndësinë e madhe shoqërore që kanë, për qëllimet arsimore e edukative që ndjekin, duhet të konsiderohen si hallka e parë e rregullt, e përgjithshme, e sistemit tonë arsimor.

Realizimi i kësaj detyre është një problem i gjerë dhe i vështirë, me karakter jo vetëm arsimor e pedagogjik, por edhe organizativ e financiar, që ka të bëjë me sigurimin e godinave dhe të pajisjeve të nevojshme, të edukatorëve, si dhe me shpenzime të shumta. Prandaj, duke u nisur nga rëndësia e këtij problemi, por duke pasur parasysh, në të njëjtën kohë, edhe gjerësinë e vështirësitë e zbatimit të tij të plotë, është e domosdoshme që arsimi parashkollor të kthehet në një hallkë të përgjithshme (sigurisht, jo të detyrueshme) të sistemit tonë arsimor, kurse zbatimi i kësaj detyre të arrihet gradualisht, por duke shpejtuar ritmet e deritanishme, me mobilizimin e të gjitha mundësive të shtetit dhe të shoqërisë, dhe duke e pasqyruar këtë në planet përkatëse të shtetit.

2. — Arsimi i përgjithshëm unik dhe i detyrueshëm 8-vjeçar

Realizimi i arsimit të përgjithshëm unik dhe të detyrueshëm 8-vjeçar, është një fitore e madhe historike për ne në lëmin e ngritjes së nivelit arsimor e kultural të brezit të ri e të gjithë popullit. Që sivjet në klasën e pestë të shkollës 8-vjeçare janë përfshirë mbi 93 për qind e fëmijëve që mbaruan klasën e katërt. Prandaj, janë të gjitha mundësitë që gjatë dy-tre vjetëve të ardhshëm të punojmë për realizimin dhe konsolidimin përfundimtar të arsimit 8-vjeçar. Për këtë, është e nevojshme: të shtrihet akoma rrjeti i shkollave 8-vjeçare dhe të hapen shtëpi-konvikte, me shpenzimet e shtetit e të kooperativave bujqësore, për ato zona ku nuk është e mundur të kemi shkollë 8-vjeçare; të shpejtohet ritmi i pregatitjes së mësuesve të rinj për këto shkolla dhe të kualifikohet kadri ekzistues i tyre; të pasurohet në të gjitha drejtimet baza mësimoro-materiale e tyre, sidomos në fshat. Në të njëjtën kohë, shkolla 8-vjeçare, si rregull, duhet të jetë më vete, e ndarë nga shkolla e mesme. Ajo duhet të përfshijë të gjitha klasat, nga e para e deri te e teta. Shkolla fillore nuk do të ekzistojë më si shkollë më vete. Edhe kur është e veçuar, për shkak distance, ajo prapë është një njësi përbërëse e shkollës 8-vjeçare përkatëse.

Gjatë diskutimit popullor është propozuar *ulja e moshës së pranimit të fëmijëve në shkolla nga 7 në 6 vjeç*. Është theksuar me të drejtë se futja e fëmijëve një vit më parë në sistemin e organizuar të edukatës shoqërore që jepet nga shteti, ka rëndësi të madhe për zhvillimin dhe edukimin e tyre, për hedhjen e tyre një vit më parë në jetën praktike. Një ndryshim i tillë tani bëhet i mundur duke u nisur nga kushtet e reja ekonomike, shoqërore dhe arsimoro-kulturale të vendit, nga zhvillimi më i mirë fizik e psikik i fëmijëve, nga perspektiva e zgjerimit të shpejtë dhe e shtrirjes së plotë të arsimit parashkollor, nga niveli arsimor gjithnjë në rritje i prindërve dhe i familjes sonë në përgjithësi.

Në këto rrethana, mendojmë se *mund të fillojë pranimi i fëmijëve në shkollë në moshën gjashtëvjeçare*. Zbatimi konkret i kësaj do të bëhet brenda vjetëve të ardhshëm mbi bazën e planifikimit gradual, në përshtatje me mundësitë reale të shtetit e të shoqërisë për sigurimin e lokaleve shkollore e të kuadrit arsimor.

Për në qytet kjo është më e lehtë, por edhe në fshat mund dhe duhet të merren masat për ta realizuar këtë detyrë. Për të lehtësuar futjen në shkollë të fëmijëve që në moshën 6 vjeç në fshat, do të merren masa që cikli i ulët i shkollës 8-vjeçare të

shtrihet jo vetëm në çdo fshat pa përjashtim, pa marrë parasysh madhësinë e fshatit, qoftë edhe nën normat ekzistuese, por, në raste të veçanta, edhe në ndonjë lagje të veçuar të tij, duke i ndërtuar lokalet shkollore për këtë qëllim, si rregull, vetë kooperativat bujqësore.

Krahas shtrirjes së saj të plotë në gjithë vendin, shkolla 8-vjeçare në të ardhshmen duhet të forcohet *si shkollë masive unike e kulturës së përgjithshme, e detyruar, si hallka-bazë e sistemit tonë arsimor*. Detyra e saj duhet të jetë: pajisja e nxënësve me kulturë të përgjithshme e politeknike në përshtatje me moshën; edukimi i fëmijëve me dashuri për punën dhe me shprehi të thjeshta pune për të marrë pjesë në praktikën revolucionare të jetës, në masën që e lejon moshën e tyre; hedhja e bazave të edukimit politik, ideologjik moral e estetik të nxënësve; forcimi i edukimit fizik, i gërshtuar, në dy klasat e fundit, edhe me elementët më fillestarë të edukatës ushtarake, dhe pregatitja e tyre për jetën si dhe për të vazhduar shkollat e mesme.

Duke hedhur që në shkollën 8-vjeçare bazat e para për realizimin e trekëndëshit *mësim-punë prodhuese-edukim fizik e ushtarak*, në të njëjtën kohë, duhet të synojmë edhe në modernizimin shkencor-pedagogjik të saj. Për arritjen e këtij qëllimi do të ndihmojë prishja e cikleve të ndara dhe pak a shumë të pavarura nga njëra-tjetra që ekzistojnë sot brenda saj (klasat I-IV dhe V-VIII). Ruajtja e këtyre dy cikleve ka shkaktuar mjaft paralelizma të kota në programet dhe në tekstet e shkollës 8-vjeçare. Heqja e tyre do të krijojë mundësi për intensifikimin e procesit mësimor që në ciklin e ulët të shkollës 8-vjeçare, si dhe për futjen e disa njohurive të thjeshta të lidhura me zbulimet e fundit të shkencës në ciklin e lartë të saj.

Një kujdes të veçantë duhet të tregojmë *për shkollën 8-vjeçare të pakicave kombëtare*. Në përshtatje me parimin e së drejtës së arsimit në gjuhën amtare, nga i cili është udhëhequr vazhdimisht Partia jonë, do të vazhdojë puna për forcimin e shkollës 8-vjeçare të pakicës kombëtare greke, duke i kushtuar kujdes si zotërimit me baza të gjuhës greke, ashtu edhe mësimi të gjuhës shqipe.

Në periudhën e ardhshme duhet të zgjerohen shumë edhe shkollat 8-vjeçare për punonjësit e rritur që mësojnë pa shkëputje nga puna, pasi ka akoma shumë punëtorë e fshatarë të moshave relativisht të reja, sidomos shumë gra, që nuk e kanë kryer arsimin 8-vjeçar.

Kjo shkollë pa shkëputje nga puna, ashtu si edhe të gjitha shkollat e tjera të kësaj natyre të kategorive më të larta, duhet të ketë një strukturë të veçantë të vitit shkollor në përshtatje me specifikën e tyre.

Realizimi i plotë e përfundimtar i arsimit 8-vjeçar dhe konsolidimi e forcimi i gjithanshëm cilësor i shkollës 8-vjeçare, krijojnë mundësi të reja për të ngritur mbi shkollën 8-vjeçare, shkollën e mesme *jounike*, por të shumëllojtë për gjithë rininë, në përputhje me tezën e shokut Enver, i cili, duke folur për këtë çështje, thekson:

«Në qoftë se e shohim drejt këtë shumanshmëri të madhe të nevojave si në sasi, ashtu edhe në cilësi, në qoftë se e shikojmë gjithashtu plotësimin e këtyre nevojave në dinamizmin e zhvillimit dialektik materialist dhe historik, atëherë do të dalim në rrugën se nuk mund dhe nuk duhet të kemi një tip shkolle, por një gamë të tërë shkollash...»¹.

Mbi këtë bazë, sistemi ynë arsimor që ngrihet mbi shkollën 8-vjeçare, duke siguruar ngritjen e nivelit arsimor të klasës punëtore dhe të të gjitha masave punonjëse, do të jetë njëkohësisht sa më elastik e i larmishëm dhe do të ketë shumë lloje e tipa shkollash, në përputhje me kërkesat e stadit të sotëm dhe perspektiv të zhvillimit ekonomik, social dhe kultural të vendit, me kushtet e nevojat konkrete të rretheve apo të zonave të caktuara, me kërkesat e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë e të kulturës për punëtorë të thjeshtë e të kualifikuar dhe teknikë e specialistë të mesëm e të lartë. Konkretisht mbi 8-vjeçaren mund të ngrihen këto lloje shkollash:

a) *Shkolla të ulëta tekniko-profesionale*, kombëtare dhe lokale, me shkëputje dhe pa shkëputje nga puna;

b) *Shkolla të mesme, profesionale dhe të përgjithshme*, me shkëputje dhe pa shkëputje nga puna, njëdegshe, shumëdegshe dhe të bashkuara;

c) *Kurse dhe shkolla të ndryshme masive jashtë sistemit të rregullt arsimor*, që hapen sipas nevojave.

3. — Arsimi i ulët tekniko-profesional

Në të ardhshmen shkollat e ulëta tekniko-profesionale do të shtrihen e zgjerohen më shumë se deri sot. Këto shkolla do të shërbejnë për përgatitjen e punëtorëve të rinj të kualifikuar, për kualifikimin dhe ngritjen në kategori të punëtorëve, si dhe për përgatitjen e punëtorëve e të artizanëve që i nevojiten fshatit. Ato do të shtrihen jo vetëm në industri, por edhe në bujqësi,

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 352.

jo vetëm në qytet, por edhe në fshat. Në mënyrë të veçantë duhet të vëmë theksin në zgjerimin e shkollave të ulëta tekniko-profesionale *pa shkëputje nga puna*, si një rrugë shumë e përshtatshme për ngritjen masive të nivelit tekniko-profesional të punëtorëve e kooperativistëve. Në këto shkolla (pa shkëputje nga puna), mësimet duhet të vazhdojnë dy vjet, duke u përqëndruar vetëm në dhënien e njohurive teorike.

Shkollat e ulëta profesionale me shkëputje e pa shkëputje nga puna, si rregull, do të jenë të *profilit të ngushtë*. Shkollat e ulëta tekniko-profesionale për rininë shkollore do të hapen sipas nevojave të veçanta dhe do të jenë një deri dyvjeçare.

Përgatitja e punëtorëve të rinj të kualifikuar do të vazhdojë edhe nëpërmjet formës së *«nxënësve në ekonomi»*, e cila, gjithashtu, do të bëhet gjithnjë e më masive, jo si pjesë përbërëse e sistemit të rregullt arsimor, por si një rrugë e përshtatshme për sigurimin e fuqisë punëtore të re e të kualifikuar.

Si hapja e shkollave të ulëta tekniko-profesionale për rininë shkollore, ashtu edhe marrja e *«nxënësve në ekonomi»*, pasi kanë të bëjnë me sigurimin e fuqisë punëtore të re, do të bëhen *në bazë të planit të shtetit*, në bazë të nevojave që ka ekonomia.

4. — Arsimi i mesëm

Revolucionarizimi i arsimit të mesëm është problemi më i rëndësishëm dhe më i ndërlikuar në gjithë punën tonë për revolucionarizimin e sistemit arsimor.

Së pari, kjo është e lidhur me vetë perspektivën e zhvillimit të kësaj hallke të sistemit arsimor. Që tani para nesh është *hapur perspektiva e kalimit gradual në arsimin e mesëm, jounik, por të shumëllojtë, për gjithë rininë*. Për këtë do të ndihmojnë shumë si realizimi përfundimtar i arsimit 8-vjeçar, ashtu edhe zgjerimi e masivizimi i mëtejshëm i arsimit të mesëm jo vetëm në qytet, por edhe në fshat. Pikërisht në këtë rrugë do të krijojnë kushtet për të kaluar së shpejti në zbatimin gradual të *arsimit të mesëm të shumëllojtë për të gjithë*. Ky do të jetë një hop i madh, një revolucion i ri i vërtetë në ngritjen e nivelit arsimor e kultural të rinisë e të gjithë popullit.

Kalimi në arsimin e mesëm të shumëllojtë për të gjithë do të krijojë kushtet për t'i dhënë një fizionomi të re shkollës së mesme, duke kapërcyer rrënjësisht si njëanshmërinë intelektualiste që vërehet sot në shkollën e mesme të arsimit të përgjithshëm, ashtu edhe tendencat e një praktikizmi të ngushtë që vërehen në shkollat e mesme profesionale. Në këtë mënyrë, do të zbuten dhe pastaj do të zhduken ndryshimet e theksuara në përmbajtjen

e arsimit që vërehen sot në kategoritë e ndryshme të shkollave të mesme, pa prekur larminë e tyre, bile duke e zhvilluar atë më tej. Do të forcohet, kështu, në arsimin e mesëm trungu unik i formimit të përgjithshëm shkencor dhe politeknik të nxënësve.

Së dyti, ky problem është i lidhur me rolin e veçantë të shkollës së mesme në formimin e njeriut të ri. Moshë kur rinia ndjek shkollën e mesme, është vendimtare në formimin e bazave të personalitetit të njeriut, të botëkuptimit dhe të idealeve të tij, të tipareve morale dhe të shijeve të tija. Në këtë moshë, kur hidhen bazat e formimit të gjithanshëm të njeriut, si rregull, përcaktohet edhe rruga e jetës së tij.

Janë pikërisht këto arsye themelore që shkolla e mesme ka qenë një nga problemet që është trajtuar gjerësisht në diskutimin popullor, si nga ana ideologjike, ashtu edhe nga ana pedagogjike e organizative, duke u ndalur në aspekte të tilla kryesore, siç janë: qëllimi dhe detyrat e arsimit të mesëm, llojet e kategoritë e shkollave të mesme dhe përpjesëtimet midis tyre, përmbajtja e mësimit dhe e edukimit si dhe elementet themelore të kësaj përmbajtjeje, afatet dhe struktura vjetore e këtyre shkollave, kombinimi dhe alternimi i mësimit me punën prodhuese dhe edukimin fizik e ushtarak etj.

Mendimi i përgjithshëm është se duhet ta ruajmë e ta zhvillojmë më tej larminë e shkollave të mesme, duke bërë ndryshime serioze në brendinë e punës mësimorë-edukative dhe në strukturën e tyre, në mënyrë që nxënësit të marrin një formim të shëndoshë marksist-leninist në përshtatje me moshën, të përvetësojnë bazat e degëve kryesore të shkencave dhe të lëndëve teknike, të formohen teorikisht e praktikisht për punë dhe të fitojnë ngritjen politike e ideologjike dhe kalitjen fiziko-ushtarake të nevojshme për t'u përgatitur si duhet për jetën, për të marrë pjesë menjëherë në prodhimin shoqëror si dhe për të qenë të gatshëm për mbrojtjen e atdheut. Gjithashtu, të rinjtë do të kenë mundësi pastaj të vazhdojnë shkollën e lartë.

Mbi këto baza mund të zgjidhen drejtë edhe disa probleme të përgjithshme të organizimit të arsimit të mesëm, siç janë: ai i afatit të shkollave të mesme, i strukturës së vitit shkollor, i emërtimit të tyre etj.

Duke u nisur nga nevoja e realizimit të trekëndëshit mësim-punë prodhuese-edukim fizik e ushtarak, pa e ulur nivelin e përgatitjes së gjithanshme të nxënësve dhe pa e shtuar ngarkesën e tyre, është e nevojshme të ruhet afati katërvjeçar i të gjitha shkollave të mesme, profesionale dhe joprofesionale, si me shkëputje nga puna, ashtu edhe pa shkëputje nga puna.

Po kështu është e nevojshme që të gjitha shkollat e mesme për rininë shkollore të kenë një strukturë unike të vitit shkollor.

Duke u nisur nga parimi që në shkollë duhet t'i jepet prioritet mësimi të teorisë kundrejt praktikës, por gjithmonë në lidhje të ngushtë me praktikën, me punën prodhuese dhe edukimin fizik e ushtarak, struktura e vitit shkollor në të gjitha shkollat e mesme do të jetë: gjashtë muaj e gjysmë mësim (duke përfshirë edhe dy javë mësim për edukatën fizike), dy muaj e gjysmë punë prodhuese, një muaj stërvitje ushtarake dhe dy muaj pushim (dy klasat e para do të bëjnë dy muaj punë prodhuese dhe dy muaj e gjysmë pushim).

Tani ka ardhur koha ta shikojmë edhe problemin e emërtimit të shkollave të mesme. Nuk ka kuptim të përdoren më termat «teknikum», «politeknikum», «lice artistik», «gjimnaz» etj., por të kemi shkolla të mesme «industriale», «bujqësore», «ndërtimi», «tregëtare», «mjekësore», «arti» etj., kurse gjimnazi të quhet «shkollë e mesme e përgjithshme». Kështu, do të hiqet dorë edhe nga një terminologji e vjetër dhe e njëanshme, e trashëguar pjesërisht edhe nga shoqëria e shkolla e vjetër. Emërtimet e reja do t'u përgjigjen ndryshimeve që kanë pësuar e po pësojnë shkollat në shoqërinë tonë socialiste.

Të gjitha këto parime të përgjithshme do të gjejnë mishërim konkret si në shkollat e mesme të përgjithshme, ashtu edhe në ato profesionale.

Shkolla e mesme e përgjithshme, duke u mbështetur në trekëndëshin mësim-punë prodhuese-edukim fizik e ushtarak, duke u politeknizuar dhe lidhur ngushtë me prodhimin, si nëpërmjet fitimit të njohurive teorike që merren në shkollë e në qendrat e punës, (duke futur në programet e kësaj shkolle medoemos edhe ndonjë lëndë teknike, sipas rastit), ashtu edhe nëpërmjet pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë të nxënësve në punë prodhuese — me të gjitha këto ndryshime, nuk do të jetë më gjimnazi i vjetër i trashëguar nga shoqëria borgjeze, shkollë e privilegjuar e një elite, që ushqen intelektualizmin e karrierizmin, tendencën për të mbaruar me çdo kusht arsimin e lartë si mjet për t'u shkëputur nga puna prodhuese dhe për t'u marrë vetëm me punë zyre. Duke i kapërcyer përfundimisht këto të meta, ajo do të transformohet në një shkollë krejt të re, që do të përgatitë revolucionarë të rinj, të gatshëm për çdo punë në dobi të atdheut e socializmit, pa dallim nga shkollat e mesme të llojeve të tjera.

Shkolla e mesme e përgjithshme, si rregull, do të ruajë vëllimin e tanishëm të lëndëve të kulturës së përgjithshme. Në të njëjtën kohë, ajo do të realizojë lidhjen e mësimi me punën nga ana teorike dhe praktike mbi bazën e kombinimit të disa profesioneve masive, dhe, atje ku nuk ka mundësi, mbi bazën e një-profesioni, gjithmonë sipas kushteve konkrete të vendit ku ndodhet shkolla. Kjo do të shënojë politeknizimin e mëtejshëm të

saj. Por në stadin e tanishëm rrjeti i shkollave të mesme të përgjithshme, të cilat deri tani janë shtrirë në çdo rreth, nuk do të zgjerohet shumë.

Do të ketë edhe *shkolla të mesme të përgjithshme pa shkëputje nga puna*, por këto do të jenë të kufizuara; ato do të vlejnjë për të mos lënë pa arsim të mesëm kryesisht ata punonjës, sidomos të administratës, të sferës sociale e kulture dhe të qendrave të rretheve të vogla e të disa lokaliteteve, që nuk kanë mundësi të marrin arsim të mesëm profesional. Është e nevojshme që punonjësit e prodhimit të ndjekin kryesisht shkollat e mesme profesionale, sipas profileve.

Gjatë periudhës së ardhshme do t'u jepet prioritet shkollave të mesme profesionale, si për rininë shkollore, ashtu edhe për punonjësit e rritur, që i ndjekin ato pa shkëputje nga puna. Me përjashtim të shkollave të mesme profesionale të sferës socialo-kulturale, siç janë shkollat pedagogjike, ekonomiko-financiare, mjekësore, të artit etj., të cilat do të hapen në bazë të nevojave për teknikë a specialistë të këtyre profileve, të gjitha shkollat e tjera të mesme profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin, siç janë ato industriale, bujqësore, ndërtimi etj., do të shtrihen e rriten gjithnjë e më shumë. Masivizimi i tyre do të bëhet gradualisht, krahas sigurimit të kuadrit arsimor, bazës mësimoro-materiale etj.

Si rregull, në të gjitha shkollat e mesme profesionale të rinisë shkollore është e nevojshme të ruhet profili i gjerë, pasi ai u përgjigjet më mirë kushteve të tanishme të zhvillimit të ekonomisë sonë, por pa përjashtuar fare edhe ngritjen e ndonjë shkolle me profil të ngushtë, në rastet kur këtë e kërkojnë nevojat e prodhimit. Këto shkolla, si rregull, është mirë të jenë shumëdegshë, pasi kështu krijohet një ambient më i favorshëm për politeknizimin e tyre dhe përdoren më mirë kuadri arsimor e baza mësimoro-materiale. Mund të kemi shkolla të mesme profesionale të bashkuara, që të përfshijnë disa degë ose profesione nga më të ndryshmet. Kjo kushtëzohet nga sigurimi i vazhdimësisë së kontingjenteve të nxënësve, i kuadrit specialist, i bazës mësimoro-materiale etj. Në raste të caktuara, në këto shkolla, një nga këto degë, mund të jetë dhe shkolla e mesme e përgjithshme.

Në shkollat e mesme profesionale duhet të synojmë të kemi një nivel relativisht të lartë kulture të përgjithshme, të *barabartë ose afërsisht të barabartë* me atë të shkollave të mesme të përgjithshme përsa u përket disa lëndëve më kryesore të kulturës së përgjithshme (matematikë, fizikë, kimi). Kjo mund të arrihet duke ruajtur nivelin e tanishëm të kulturës tekniko-profesionale në këto shkolla dhe duke kursyer kohën e tepërt nga praktikat

mësimoro-prodhuese. Në të njëjtën kohë, duhet të kemi parasysh se në shkollat e mesme profesionale mësohen edhe lëndë shoqërore, si letërsia, historia, gjeografia, pa folur për mësimin e *marksizëm-leninizimit që është i barabartë* (si vëllim e cilësi) për të gjitha shkollat e mesme.

Të gjitha këto arrihen pa e shtuar ngarkesën e përgjithshme javore të nxënësve. Kjo do të jetë një bazë e shëndoshë për forcimin dhe politeknizimin e këtyre shkollave. Ajo do t'u japë mundësi nxënësve, që mbarojnë shkollat e mesme profesionale, të venë lirisht në shkollat e larta, *jo vetëm në vartësi nga profili, por, po të jetë e nevojshme, edhe në degë të tjera.*

Afati unik dhe struktura unike e vitit shkollor në të gjitha llojet e shkollave të mesme; barazimi i nivelit të kulturës së përgjithshme në shkollat e mesme profesionale dhe ngritja e tij thuasje në nivelin e shkollës së mesme të përgjithshme; forcimi i politeknizimit të shkollës së mesme të përgjithshme dhe i lidhjes së saj me punën prodhuese, — të gjitha këto të marrura së bashku, duke ruajtur larminë e shkollave të mesme, shënojnë një ndryshim cilësor rrënjësor në gjithë sistemin e arsimit tonë të mesëm, në brendinë e punës mësimoro-edukative të shkollës së mesme, në strukturën dhe në metodat e saja. Ato shënojnë një thellim të mëtejshëm të theksuar të politeknizimit të arsimit të mesëm dhe hapin perspektivën për masivizimin e tij të shpejtë, për shtrirjen e tij në gjithë vendin, për të përfshirë së shpejti gjithë rininë në të.

Drejt këtij masivizimi të arsimit të mesëm, sidomos tani për tani, do të ecet më shpejt nëpërmjet shkollave të mesme profesionale pa shkëputje nga puna, për punëtorët e fshatarët. Kjo punë sapo ka filluar dhe po shndërrohet në një aksion revolucionar të vetë klasës punëtore e të fshatarësisë kooperativiste si dhe të kuadrove e specialistëve të prodhimit. Sigurisht ajo do përkrahjen e gjithanshme të organeve shtetërore, ekonomike e arsimore, të inxhinierëve e agronomëve, të mësuesve e pedagogëve tanë. Në të njëjtën kohë, ne duhet të hidhemi me guxim përpara për masivizimin edhe të shkollave të mesme profesionale për rininë shkollore.

Sot janë krijuar kushtet për të ecur me guxim drejt masivizimit të arsimit të mesëm dhe, gradualisht, edhe të arsimit të lartë për punëtorët e fshatarët. Aktualisht kjo është një nga rrugët kryesore për të ngritur nivelin arsimor e kultural sidomos të klasës punëtore, për ta zgjeruar gradualisht horizontin e saj shkencor e politeknik dhe për të rritur aftësitë e saja teknike e profesionale, «deri në nivelin e personelit inxhiniero-teknik». Dhe kjo, siç thoshte Stalini, është një nga rrugët kryesore për zhdukjen e ndryshimit rrënjësor midis punës mendore e fizike.

Por kjo çështje ka një rëndësi kolosale edhe në pikëpamje politike e ideologjike. Ajo është një nga rrugët kryesore të forcimit efektiv e real të kontrollit punëtor në gjithë jetën e vendit. Ajo u krijon kushte reale klasës sonë punëtoresh dhe fshatarësisë kooperativiste që «të invadojnë» në masë bankat e shkollave, të instituteve, të fakulteteve, të ngjiten në skenë, të hyjnë në zyra, të armatosen me dije e kulturë, duke mbushur kështu edhe radhët e inteligjencisë sonë popullore me njerëz të kalitur e të dalë drejtpërdrejt nga gjiri i tyre. Në mënyrë të veçantë ajo i krijon kushte klasës punëtoresh, si klasa udhëheqëse në sistemin e diktaturës së proletariatit, që të mund të drejtojë efektivisht shtetin, ekonominë, arsimin, kulturën e të gjithë sektorët e tjerë të jetës sonë shtetërore e shoqërore. Dhe kjo nuk mund të bëhet në mënyrë artificiale e burokratike, duke i emëruar ose zgjedhur punëtorët si kuadro e në poste drejtuese, pa u interesuar, në të njëjtën kohë, për ngritjen e gjithanshme jo vetëm politike e ideologjike, por edhe kulturalo-arsimore e tekniko-profesionale të tyre. Kjo kërkon që t'i përvishemi seriozisht ngritjes arsimoro-kulturale masive të klasës punëtoresh e fshatarësisë kooperativiste, t'i nxitim ato që t'i përvishen vetë me seriozitetin më të madh kësaj pune, t'i ndihmojmë që të kapërcejnë çdo pengesë e vështirësi që mund t'u dalë në këtë rrugë. Kështu do të përmirësohen rrënjësisht edhe përbërja e gjendja shoqërore si dhe fryma klasore revolucionare e të rinjve dhe e të rriturve që do të mbarojnë arsimin e mesëm dhe si rrjedhim, edhe të lartit. Të gjitha këto janë një revolucion në vetvete në arsimin tonë.

Duke u bazuar në këtë platformë, duhet të punojmë për zgjidhjen e çështjeve konkrete të zgjerimit të shkollave të mesme profesionale për punëtorët e fshatarët. Gjatë periudhës së ardhshme është e nevojshme që profili i këtyre shkollave të jetë, zakonisht, *i ngushtë*, dhe vetëm në raste të rralla mund të ketë shkolla të tilla edhe me profil të gjerë. Këto shkolla duhet të krijohen kryesisht *pranë ndërmarrjeve të mëdha e në bazë rrethesh* dhe mund të kenë shumë profile ose një profil të vetëm, sikurse mund të jenë edhe të bashkuara (shumëdegshë). Ato duhet të kenë një bërthamë minimale kuadrosh të përhershëm, kurse kuadri tjetër, shumica, mund të merret nga prodhimi, pa u shkëputur nga funksioni kryesor i tyre. Baza materiale e këtyre shkollave duhet të sigurohet nga ndërmarrjet përkatëse.

Nxënësit që mbarojnë shkollat e mesme profesionale pa shkëputje nga puna, kur të venë në arsimin e lartë, si rregull, do të bëjnë *një vit përgatitor* me qëllim që të plotësojnë dijenitë në kulturën e përgjithshme shkencore dhe teknike.

Nxënësit që mbarojnë shkollat e mesme për rininë shkollore, si të përgjithshme, ashtu dhe profesionale, si në qytet ashtu dhe

në fshat, si djemtë ashtu edhe vajzat, duhet të bëjnë detyrimisht *një vit stazh në prodhim* dhe pastaj të kenë të drejtën të vazhdojnë shkollën e lartë.

Gjatë stazhit, nxënësit do të punojnë *bashkë me punëtorët e fshatarët* në çdo front pune ku ka nevojë shteti, si rregull në profilin përkatës, por gjithmonë në punë prodhuese dhe *në asnjë rast në punë zyre*.

Stazhi njëvjeçar në prodhim pas shkollës së mesme është i domosdoshëm, pasi nëpërmjet tij nxënësit do të edukohen e do të kaliten si revolucionarë në gjirin e klasës punëtoresh ose të fshatarësisë kooperativiste. Në këtë mënyrë, nxënësit dhe studentët, duke punuar së bashku me punëtorët dhe fshatarët në frontin e madh të prodhimit, gjatë periudhës shkollore, gjatë stazhit njëvjeçar pas shkollës së mesme, dhe, më vonë, gjatë stazhit pas mbarimit të shkollës së lartë, edukohen me tiparet e klasës punëtoresh, kuptojnë rëndësinë e madhe që ka prodhimi shoqëror, duke prodhuar vetë vlera materiale, u nënshtrohen rregullave dhe disiplinës së prodhimit, marrin pjesë aktive në tërë jetën politike, ideologjike dhe kulturele të punonjësve. Kështu, stazhi në prodhim do të jetë një *filtr* i vërtetë dhe një sitë për të gjithë ata që do të shkojnë në shkollën e lartë, sepse *vetëm ata që do të kenë treguar cilësi revolucionare, klasa punëtoresh do t'i lejojë të bëhen kuadro drejtues të prodhimit*. Prandaj, stazhin në prodhim ne duhet ta kuptojmë si një periudhë gjatë së cilës nxënësit (studentët e ardhshëm) i nënshtrohen drejtpërdrejt kontrollit të klasës punëtoresh, dhe pastaj, *me aprovimin e saj*, shkojnë në shkollën e lartë. Kështu, ne do të mund të përgatitim një inteligjencie popullore revolucionare, të edukuar me frymën e Partisë dhe të kalitur në kudhrën e klasës punëtoresh. Kjo inteligjencie i duhet shoqërisë sonë socialiste.

5. — Arsimi i lartë

Para shkollave tona të larta shtrohet detyra e përmirësimit dhe e revolucionarizimit të përgatitjes së specialistëve të rinj nga ana politike dhe ideologjike, shkencore dhe profesionale, teorike dhe praktike, për punë dhe për mbrojtjen e atdheut. Ato duhet të përgatitin kuadro të rinj revolucionarë me frymë proletare dhe, në të njëjtën kohë, specialistë të aftë, në nivelin e kërkesave si të shkencës e të teknikës moderne, ashtu edhe të ekonomisë e kulturës së vendit tonë. Në përshtatje me këto detyra, edhe në këto shkolla duhet të forcohet boshti ideologjik marksist-leninist dhe të realizohet trekëndëshi revolucionar *mësim-punë prodhuese-edukim fizik e ushtarak*. Mbi këto baza, duhet të bëhen

ndryshimet përkatëse në përmbajtje e në strukturë dhe të zgjidhen më drejt problemet e profileve të përgatitjes së kuadrit, të afateve të studimit, të pranimit të studentëve, të shtrirjes e të rritjes së arsimit të lartë etj.

Për kushtet e vendit tonë, edhe gjatë periudhës së ardhshme përgatitja e specialistëve të lartë duhet të bëhet kryesisht mbi bazën e *profilit të gjerë*. Në disa degë, pa prishur trunqun e përbashkët dhe pa kaluar në profilizim të ngushtë, mund të bëhet një nëndarje e profileve në vjetët e fundit. Si rregull, mbi këtë bazë, tani e në të ardhshmen, do të zgjerohet larmia e profileve të përgatitjes së kuadrove në shkollat tona të larta.

Gjithashtu do të merren masa që në Universitetin Shtetëror të Tiranës të përgatiten kuadro të *filozofisë* e të *ekonomisë politike* që janë të domosdoshëm për ne, qoftë si pedagogë të këtyre lëndëve, qoftë edhe si punonjës teorikë shkencorë për këta sektore shumë të rëndësishëm të frontit ideologjik.

Sipas mendimit të përgjithshëm, afati i studimeve në shkollat e larta, si rregull, mund të shkurtrohet një vit në krahasim me afatin e sotëm. Kështu, me ndonjë përjashtim, afati i studimeve të larta do të jetë 4 ose 3 vjet. Një shkurtim i tillë në periudhën e tanishme i përgjigjet më mirë detyrës së masivizimit të arsimit të lartë, pjesëmarrjes më të gjerë në të të punëtorëve e fshatarëve dhe sidomos të fëmijëve të tyre. Ai mund të realizohet, pa çënuar nivelin ideologjik, shkencor e profesional të përgatitjes së kuadrit, nëpërmjet përmirësimit të gjithanshëm të procesit mësimor, e sidomos të metodave të punës mësimore, shfrytëzimit më racional të kohës gjatë periudhës mësimore, forcimit të disiplinës në punë, si dhe shfrytëzimit të stazhit njëvjeçar pas shkollës së lartë, si pjesë përbërëse e përgatitjes së studentit.

Struktura e vitit shkollor në të gjitha shkollat e larta dhe në të gjitha degët e tyre do të jetë unike: 7 muaj mësim (këtu hyn edhe mësimi i fiskulturës), 2 muaj punë prodhuese, 1 muaj stërvitje ushtarake, 2 muaj pushim.

Pranimet në shkollat e larta, si rregull, do të bëhen në varësi nga profili i shkollës së mesme që kanë mbaruar nxënësit, kurse ata që kanë mbaruar shkollën e mesme të përgjithshme do të pranohen në çdo profil.

Pranimi i nxënësve në shkollën e lartë do të bëhet në bazë të këtyre kriterëve themelore: kushteve politike, aftësive në mësim, rezultateve të stazhit në prodhim dhe sjelljes. Sidomos në shkollat që përgatitin kuadro të frontit ideologjik, qofshin këto të mesme apo të larta, në pranimin e nxënësve apo studentëve, duhet të zbatohet me rigorozitet kriteri i zgjedhjes politike.

Do të bëhet rregull i përgjithshëm që *kush nuk bën stazhin*

njëvjeçar në prodhim pas mbarimit të shkollës së mesme, ai nuk mund të pranohet në shkollën e lartë. Edhe në shkollën e lartë pa shkëputje nga puna nuk mund të pranohet pa qenë më parë të paktën një vit drejtpërdrejt në punën prodhuese.

Gjithashtu do të bëhet rregull i përgjithshëm që, pasi të fillojë të zbatohet stazhi në punë pas shkollës së mesme, krahas rekomandimit të kolektivit të shkollës, si të trupit mësimor-edukativ, ashtu edhe të organizatës së rinisë, *nxënësit do të pranohen në shkollën e lartë vetëm pasi të merret edhe mendimi i kolektivit punonjës ku ata kanë kryer stazhin e punës. Rekomandimi i kolektivit është i domosdoshëm e vendimtar për të pranuar në shkollat e larta edhe ata që do të vazhdojnë studimet pa shkëputje nga puna.*

Të gjitha këto kushte dhe, në mënyrë të veçantë, kalimi i studentit në filtrin e klasës punëtorë, janë një garanci e madhe për zgjedhjen me kritere të shëndosha të njerëzve që do të ndjekin shkollat e larta.

Studentët do të bëjnë dhe 8-9 muaj *stazh në punë konkrete pas shkollës së lartë*, i cili është pjesë përbërëse e përgatitjes së kuadrit, i nevojshëm për përgatitjen dhe mbrojtjen e diplomës si dhe për kryerjen e një pjese të praktikës profesionale. Këtë stazh do ta bëjnë të gjithë.

Masivizimi i mëtejshëm i arsimit të lartë do të bëhet në dy rrugë: së pari, duke rritur numrin e studentëve në degët ekzistuese *me shkëputje nga puna*, si dhe duke hapur në të ardhshmen degë e specialitete të reja, gjithmonë sipas nevojave e në bazë të planit të shtetit; së dyti, duke zgjeruar arsimin *pa shkëputje nga puna* pranë shkollave të larta ekzistuese, si dhe duke hapur filiale të tyre ku nuk kemi shkolla të larta.

Si rregull, në shkollat e larta pa shkëputje nga puna afati i studimeve do të jetë një vit më i lartë se në degët përkatëse me shkëputje nga puna. Studentët që do të regjistrohen në këto shkolla pa e pasë kryer shërbimin ushtarak, do të lejohen ta mbarojnë shkollën e lartë, dhe, pas mbarimit të saj, do të bëjnë një kurs disamujor për të marrë ose plotësuar përgatitjen e nevojshme ushtarake. Në këtë rrugë, dhe sidomos duke përkrahur inisiativat për krijimin gradual të filialeve të shkollave të larta, në ato raste kur janë të gjitha mundësitë për hapjen e tyre, për sigurimin e vazhdimësisë së kontingjenteve të studentëve, të kuadrit pedagog, të bazës mësimor-materiale, etj., do të krijohen mundësi efektive për të rritur pjesëmarrjen e punonjësve të prodhimit, e sidomos të punëtorëve, në arsimin e lartë. Gjatë periudhës së ardhshme, kjo mund e duhet të bëhet një nga rrugët kryesore për proletarizimin e shkollës sonë të lartë.

Është e domosdoshme të theksojmë se, krahas shkollave që përfshihen në sistemin e rregullt arsimor, do të kemi edhe një *larmi kursesh të shumëllojshme* me afate të ndryshme, zakonisht disamujore deri në njëvjeçare, që do të ngrihen mbi bazën e arsimit 8-vjeçar e të mesëm (e në raste të veçanta, për të rriturit, edhe mbi bazën e fillores) pranë ndërmarrjeve ekonomike dhe kooperativave bujqësore e në disa raste edhe nga institucionet e dikasteret qendrore. Kurset do të plotësojnë nevojat e ngutshme të prodhimit, do të kualifikojnë e specializojnë punëtorët dhe kuadrot e mesëm. Këto kurse do të kenë *profile të ngushta dhe afate sa më të shkurtëra* dhe nuk do të japin asnjë ekuivalencë me shkollat e ulëta profesionale dhe me shkollat e mesme, përveç kurseve njëvjeçare që mund të ngrihen me nxënës që kanë mbaruar shkollat e mesme të përgjithshme, nëpërmjet të cilave ata do të përgatiten si gjeometra, llogaritarë, laborantë etj.

Do të ngrihen kurse *rikualifikimi e specializimi* edhe pas mbarimit të shkollës së lartë e pas një kohe stazhi në punë, që mund të zgjatin nga disa javë deri në një vit a më shumë, sipas nevojave dhe mundësive. Në të ardhshmen këto kurse duhet të zgjerohen gjithnjë e më shumë dhe duhet të shërbejnë jo vetëm për thellimin e njohurive të kuadrove të ndryshëm, por edhe për përgatitjen e punonjësve shkencorë me kualifikim të lartë si dhe për specializime në profile më të ngushta, sipas nevojave të ekonomisë e të kulturës.

B. — MBI REALIZIMIN NË UNITET ORGANIK TË TRE KOMPONENTËVE TË SHKOLLËS: MËSIM — PUNË PRODHUESE — EDUKIM FIZIK E USHTARAK

Ndryshimet në strukturën e sistemit arsimor në përgjithësi, në hallkat e tija të veçanta, në strukturën e vitit shkollor dhe në atë të cikleve e programeve mësimore, mund të japin efektin maksimal vetëm atëhere kur e gjithë puna e shkollës sonë, në radhë të parë përmbajtja e mësimit dhe edukimit si dhe metodat e tyre, të ndërtohen mbi bazën dhe unitetin organik të tre komponentëve të shkollës sonë të re: *mësim-punë prodhuese-edukim fizik e ushtarak*, duke vënë në qendër të tyre boshtin ideologjik marksist-leninist.

Partia u jep rëndësi të madhe të tre komponentëve të shkollës. Prandaj, në vlerësimin e punës së nxënësit e të studentit, do të merret parasysh jo vetëm shkalla e përparimit në mësim, por medoemos edhe shkalla e përparimit në punën prodhuese dhe në edukimin fizik e ushtarak, si kusht i domosdoshëm për të kaluar klasën.

1. — Në këtë fushë, duke i dhënë gjithmonë kohën më të madhe mësimi të teorisë në shkollë, para nesh qëndron gjithnjë detyra e madhe e rritjes së nivelit të gjithanshëm shkencor, teorik dhe praktik të mësimi, e modernizimit të tij, e politeknizimit të tij gjithnjë e më të thellë.

Kjo është një detyrë e madhe aktuale e në perspektivë. Ne duhet të kemi mirë parasysh se brezi i ri i sotëm do të punojë në dhjetëvjeçarët e ardhshëm, kur shkenca dhe teknika do të kenë arritur një nivel shumë më të lartë nga ai i sotmi. Për këtë qëllim është e domosdoshme që në programet dhe tekstet e të gjitha kategorive të shkollave, të gjejnë pasqyrim të gjerë sukseset e fundit të prodhimit, të shkencës dhe të teknikës. Në mënyrë të veçantë në shkollat e mesme, sidomos në shkollat e larta, duhet të rriten shumë kërkesat tona në këtë drejtim.

Në këtë front ne duhet të luftojmë në të njëjtën kohë në të dy krahët: si kundër prirjeve intelektualiste për një erudicion të tepruar, i cili shpie në mbingarkimin e programeve e të teksteve mësimore me njohuri të tepërta, të vjetruara e të dorës së dytë, ashtu edhe kundër prirjeve për praktikizëm të ngushtë, për nënvlehtësimin e teorisë, për shkurtime pa kriter të lëndës.

Rritja e nivelit shkencor të shkollës lidhet ngushtë edhe me zbatimin e arsimit politeknik. Për realizimin e këtij synimi ne mbështetemi në mësimet e klasikëve të marksizëm-leninizimit, sipas të cilëve *arsimi politeknik të njuh në teori dhe në praktikë me të gjitha degët kryesore të prodhimit, me bazat e tija shkencore*. Sa më e gjerë dhe e fortë të jetë baza e njohurive politeknike, aq më lart mund të ngjitet njeriu në përvetësimin e diturive të përgjithshme dhe profesionale, aq më shpejt mund të ecë ai në këtë rrugë. Pikërisht për këtë ne duhet t'i përvishemi me kurajë politeknizimit të shkollës. Duhet të jemi të bindur se *për shkollën tonë ka vetëm një rrugë — rruga e politeknizimit*. Siç theksonte Lenini, *shkollës politeknike i përket e ardhshmeja; ajo është shkolla e komunizmit*. Vetëkuptohet se politeknizimit i prin politikëzimi, ideologjia, dhe te ne, në socializëm, nuk mund të ketë politeknizim pa politikëzim të shkollës, pa i dhënë prioritet absolut edukimit ideologjik marksist-leninist në shkollë, aq sa edhe politeknizimi i shkollës kryhet në funksion të edukimit ideologjik.

Ne i kemi të gjitha mundësitë që t'i futemi thellimit të politeknizimit të shkollës, sepse kemi gjithë këtë industri në duart e shtetit, kemi gjithë këtë bujqësi socialiste, etj. Teknologjia dhe pajisja teknike e prodhimit tonë japin mundësi të gjera për realizimin gradual të arsimit politeknik. Prandaj të mos teorizojmë shumë për politeknizimin, por të hidhemi në praktikën e politeknizimit, për t'i bërë njerëzit që «t'u vijë përdorësh çdo gjë»,

natyrisht jo në kuptimin e praktikizimit të ngushtë, por në kuptimin e zotërimit të prodhimit, si nga ana teorike ashtu edhe nga ana praktike. Këto qëllime arrihen nëpërmjet zbatimit gradual, por sistematik, të parimit të politeknizimit në mësimdhënien e të gjitha shkencave të natyrës e teknike; forcimit të mësimin të këtyre shkencave, sidomos të matematikës në të gjitha kategoritë e shkollave; forcimit të politeknizimit të kulturës së përgjithshme në shkollat e mesme profesionale, forcimit të njohurive teorike mbi prodhimin në shkollat e mesme të përgjithshme. Në të njëjtën kohë duhet t'u kushtohet kujdes njohurive mbi organizimin dhe drejtimin e prodhimit socialist dhe administrimin ekonomik-financiar të ndërmarrjeve e kooperativave bujqësore, sidomos në shkollat e mesme tekniko-profesionale dhe në shkollat e larta të lidhura me prodhimin, duke forcuar lëndët ekzistuese të kësaj natyre dhe, atje ku është e domosdoshme, duke futur edhe lëndë të reja.

2. — Tani janë krijuar kushtet e nevojshme materiale dhe shpirtërore për të ecur më shpejt drejt një lidhjeje gjithnjë e më të gjerë e organike të mësimin me punën prodhuese, për të zbatuar gradualisht idetë gjeniale të Marksit e Leninit, të cilët thoshin:

«Në një rend shoqëror të arsyeshëm çdo fëmijë që nga mosha 9 vjeç duhet të jetë një punëtor prodhues dhe, ashtu si dhe çdo njeri i rritur, i aftë për punë, duhet t'i nënshtrohet ligjit të përgjithshëm të natyrës dhe pikërisht: që të hajë, ai duhet të punojë dhe të punojë jo vetëm me mendje, por edhe me duar»¹; dhe se «Vetëm duke punuar bashkë me punëtorët dhe fshatarët mund të bëhesh komunist i vërtetë».²

Vetëm mbi këtë bazë, teoria që mësohet në shkollë nuk do të jetë e shkëptur nga puna prodhuese e nga njerëzit e punës prodhuese.

Realizimi i kësaj detyre kërkon një luftë këmbëngulëse kundër pengesave e të metave të tilla subjektive, si: «shqetësimet» intelektualiste borgjeze se puna prodhuese do të çënojë përgatitjen teorike të nxënësve e studentëve; teorizimet e pafutshme për format e alternimit të mësimin me punën; formalizmi në organizimin e punës; interesimi krejt i pamjaftueshëm i organeve të arsimit e të shkollave, i organeve shtetërore ekonomike dhe i qendrave të prodhimit për organizimin konkret të punës pro-

1 K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. i 2-të rus., vëll. 16, f. 197.

2 V. I. Lenin, Veprat, vëll. 31, f. 333.

dhuese, për sigurimin e fronteve, vendeve e mjeteve të punës, të instruktorëve etj.; ngadalësia dhe të gjitha pengesat e tjera burokratike në zgjidhjen e këtij problemi jetik për shkollën tonë. Në të njëjtën kohë, ai kërkon si një përpunim më të thellë shkencor-pedagogjik të lidhjes së mësimin me punën, ashtu edhe marrjen e masave të gjithanshme organizative për zbatimin e saj konkret në jetë.

Puna e nxënësve dhe e studentëve, krahas qëllimeve edukative, duhet të ketë pikësnyime të qarta politetknike dhe të japë mundësi për zbatimin e konkretizimin e njohurive teorike në praktikë, për çimentimin dhe pasurimin e këtyre njohurive. Në të njëjtën kohë, ajo duhet të ndihmojë për të kuptuar organizimin socialist të punës, për të fituar disiplinën proletare në punë, për t'u pajisur me kulturën dhe shprehitë e punës. Atje ku është e domosdoshme dhe e mundshme, ajo duhet të sigurojë edhe përgatitjen profesionale të nxënësve e të studentëve. Por nuk përjashtohet që nxënësit e studentët të punojnë edhe në fronte të atilla ku, tani për tani, nuk sigurohet akoma një lidhje organike e mësimin me punën, por fitohet edukata dhe kalitja e domosdoshme e njeriut punëtor.

Sidomos në shkollat e mesme e të larta, nxënësit e studentët duhet të merren efektivisht me punë prodhuese, (duke punuar kryesisht në ndërmarrjet shtetërore e kooperativat bujqësore), dhe të synohet që ata të shkrihen në punë me punëtorët e kooperativistët dhe të bëjnë jetën e tyre.

Kjo ka rëndësi vendimtare për vënien dhe mbajtjen e shkollës gjithmonë në shërbim të revolucionit, për proletarizimin e shkollës sonë, të inteligjencies sonë të re, sepse puna prodhuese, e pleksur me mësimin dhe edukimin marksist-leninist e me pjesëmarrjen aktive të rinisë shkollërore në jetën politiko-shoqërore të vendit, i lidh si mishi me koskën rininë shkollërore, mësuesit e pedagogët dhe gjithë inteligjencien tonë të re me klasën punëto-re dhe fshatarësinë kooperativiste, në mënyrë që ata të mësojnë prej tyre, të punojnë bashkë me to dhe të shkrihen me to. Siç thotë shoku Mao Ce Dun,

«... vija e demarkacionit midis intelektualëve revolucionarë, jo-revolucionarë dhe kundër-revolucionarë është nëse janë ose nuk janë të gatshëm ata që të shkrihen me punëtorët e fshatarët dhe nëse e bëjnë me të vërtetë një gjë të tillë»¹.

1 Mao Ce Dun. Cituar sipas kryeartikullit të «Zhenminzhibaos», «Flamurit të kuq» dhe të «Ciefancjunbaos» të dt. 4 maj 1969, me rastin e jubileut të Lëvizjes së 4 majit.

Karakteri i punës prodhuese mund dhe duhet të ndryshojë në vartësi nga kategoria e shkollës. Në shkollat e mesme tekniko-profesionale dhe në fakultete të kësaj natyre, lidhja e mësimit me prodhimin do të bëhet patjetër mbi bazën e profesionit dhe të specialitetit përkatës. Kudo që është e mundshme, do të synohet që kjo formë e lidhjes së mësimit me punën të përdoret edhe në shkollat e mesme të përgjithshme, kryesisht mbi bazën e disa profesioneve masive të përafërta dhe, kur kjo nuk është e mundur, mbi bazën e një profesioni të tillë. Kurse në shkollat e mesme profesionale dhe në shkollat e larta që i shërbejnë sferës socialo-kulturale, nxënësit e studentët do të punojnë në çdo front të mundshëm pune.

Por, në të gjitha rastet, *për punë prodhuese kuptojmë atë punë efektive të nxënësve dhe të studentëve, gjatë së cilës ata prodhojnë vlera materiale të dobishme për shoqërinë.* Këtu përfshihen edhe praktikat mësimore prodhuese të disa shkollave profesionale dhe të larta bujqësore, industriale, ndërtimi etj., gjatë të cilave nxënësi dhe studenti punojnë e *prodhojnë efektivisht* dhe parapregatiten për punën prodhuese në shkallë të gjerë. Por në punën prodhuese nuk përfshihet puna që bëjnë nxënësit dhe studentët gjatë praktikave mësimore me karakter demonstrativ ose laboratorik, edhe në qoftë se ato zhvillohen në terren, gjatë të cilave ata nuk prodhojnë efektivisht, por praktikohen apo ushtrohen për të përvetësuar më mirë lëndën.

Duke e programuar në këtë mënyrë punën prodhuese të nxënësve e studentëve, duhet të bëhet e qartë se nuk duhet të kërkohet më prej tyre «punë vullnetare» gjatë ditëve të diela ose gjatë pushimeve.

Një parim i rëndësishëm nga i cili duhet të udhëhiqemi është që mësimi e puna prodhuese të kombinohen e të alternohen në mënyrë të tillë që *të mos bëhen pengesë për njëra-tjetrën.* Për këtë, nxënësit e studentët do ta bëjnë punën prodhuese me ditë të grupuara, zakonisht të ndara në 2 simestra, ose sipas stinës, si dhe gjatë muajit apo gjatë javës, në rast se e kanë bazën materiale brenda shkollës ose në reparte të veçanta. Por, në të gjitha rastet, është e domosdoshme që ndërmarrja shtetërore të ketë grafik të përhershëm dhe vjetor pune për të pasur nxënës e studentë në një numër të caktuar *gjatë çdo muaji të vitit*, njësoj si fuqinë punëtore. Intensiteti i punës së nxënësve do të jetë gjithmonë në përshtatje me moshën e tyre.

3. — Në shkollat tona, sidomos në shkollat e mesme e të larta *duhet të forcohet shumë edukimi fizik e ushtarak i rinisë.* Në zgjidhjen e kësaj detyre duhet të udhëhiqemi nga këto dy parime themelore: nga vendi i edukimit fizik në procesin e përgjithshëm të edukimit komunist dhe karakteri i këtij edukimi,

ashtu siç e përcaktonte atë Marks, si dhe nga rëndësia e përgatitjes ushtarake të rinisë në kushtet e sotme të vendit tonë.

Por edukimi fizik te ne, si në shkollë, dhe aq më tepër jashtë saj, nënvleftësohet shumë. Programi i edukimit fizik në shkollë zbatohet me të meta e boshllëqe të mëdha. Një pjesë e mirë e kuadrit që jep mësimin e fiskulturës në shkollë ka përgatitje shumë të dobët. Kurse lëvizja fiskulturale e rinisë jashtë mësimit është e kufizuar dhe e njëanshme. Shumë njerëz te ne kulturën fizike në shkollë dhe jashtë saj e shikojnë vetëm si zhvillim të disa sporteve, kryesisht të lojrave me top, që nuk përfshijnë të gjithë masën, dhe nënvleftësojnë sidomos ato lloje sporti masiv që janë bazë për zhvillimin e kalitjen e përgjithshme fizike dhe përgatitjen për mbrojtjen, si atletika, gjimnastika, noti, alpinizmi, qitja etj.

Aq më tepër nënvleftësohet përgatitja ushtarake e organizuar e sistematike e rinisë shkollore e studenteske, sigurisht jo nga vetë rinia, por në radhë të parë nga ata që duhet të merren me drejtimin e zbatimin e kësaj përgatitjeje. Përgatitja ushtarake konsiderohet jo si një komponent absolutisht i domosdoshëm i edukimit të brezit të ri në periudhën e tanishme, por si ndonjë shtojcë mekanike, e jashtme dhe artificiale. Këto pikëpamje të gabuara mund të luftohen me sukses vetëm në qoftë se kjo çështje kuptohet politikisht dhe ideologjikisht; në qoftë se kuptohet rëndësia e madhe e përgatitjes ushtarake të rinisë sonë në një kohë kur fryn nga të gjitha anët furtuna imperialiste dhe revizioniste; në qoftë se rinia shkollore e studenteske konsiderohet si një fidanishte kryesore e Ushtrisë Popullore; në qoftë se na formohet besimi se është plotësisht e mundshme të organizohet përgatitja e rregullt dhe sistematike ushtarake e rinisë shkollore e studenteske që në bankat e shkollës.

Këto koncepte revolucionare për edukimin fizik e ushtarak të rinisë janë baza nga e cila nisemi për ndërtimin e programeve përkatëse të këtij edukimi mbi kritere të drejta shkencor-pedagogjike, dhe për marrjen e masave të nevojshme organizative për zgjidhjen konkrete të detyrave që na dalin në këtë drejtim. Edukimi fizik e ushtarak duhet të zbatohet në unitet, i gërshetuar sa më organikisht, në përshtatje me moshën e seksin. Për të arritur pikësynimet më të përgjithshme të edukimit fizik, duhet që gjatë periudhës mësimore të formohen te nxënësit e studentët cilësitë kryesore fizike, siç janë: *shpejtësia, shkathtësia, guximi, forca, rezistenca* etj. Kjo kërkon që në programet e kulturës fizike t'u jepen prioritet atletikës së lehtë dhe gjimnastikës. Gjithashtu gjatë procesit të mësimit të fiskulturës, duhet të përvetësohet edhe minimumi i elementëve fillestare të përgatitjes ushtarake. Për këtë qëllim, në ndërtimin e programit të edukimit

Fizik duhet të përfshihen edhe disa elemente fillestare e të domosdoshme të përgatitjes ushtarake.

Programi i stërvitjes ushtarake të nxënësve e studentëve do të zbatohet me ditë të grupuara dhe pranë reparteve ushtarake e do të jetë i veçantë, kurse dy klasat e para të shkollës së mesme do ta bëjnë atë kryesisht pranë shkollës. Përgatitja ushtarake do të bëhet mbi bazat e artit ushtarak të *luftës popullore*, të çdo shkalle. Koha dhe vëllimi i përgatitjes ushtarake në shkollën e mesme dhe të lartë do të merren parasysh dhe do të kenë ekvivalencën përkatëse në kuadrin e përgjithshëm të shërbimit të detyrueshëm ushtarak për të rinjtë.

Si përfundim, në kushtet e tanishme, buxheti i kohës aktive (përveç pushimeve) në shkollat e mesme (pa përfshirë këtu një vit stazh në punën prodhuese pas mbarimit të shkollës së mesme) do të ketë pak a shumë këtë strukturë: *mësim* rreth 55-56 për qind, *punë prodhuese* rreth 26-27 për qind, *edukim fizik e ushtarak* rreth 17-19 për qind. Pak a shumë këtë strukturë të buxhetit të kohës aktive do të kenë edhe shkollat e larta.

Kuptohet vetëvetiu se në strukturën e vitit dhe të ciklit shkollor të shkollave për punëtorët e fshatarët, pa shkaputje nga puna (të çdo lloji dhe kategorie qofshin këto shkolla), hyn vetëm një komponent — *mësimi*, sepse *puna prodhuese* s'ka kuptim të përfshihet në program, meqë ata që ndjekin këto shkolla janë vazhdimisht drejtpërdrejt në prodhim ose e kryejnë punën prodhuese në forma të tjera, ndërsa *edukimin ushtarak* e marrin në format e caktuara nga shteti në kuadrin e sistemit paraushtarak (në rast se nuk e kanë kryer shërbimin ushtarak) ose të sistemit pasushtarak, rezervist (në rast se e kanë kryer shërbimin ushtarak).

Atyre që do të ndjekin rregullisht shkollat e mesme dhe të larta e janë në marrëdhënie pune me shtetin, dita e punës do t'u shkurtohet nga 8 në 7 orë punë në ditë mesatarisht, dhe do t'u jepen dhe leje të veçanta për përgatitjen dhe dhënien e provimeve, pa u ulur paga e tyre e zakonshme.

Këtu është e nevojshme të theksojmë se për zgjidhjen e të gjitha këtyre detyrave për zbatimin e trekëndëshit *mësim-punë prodhuese-edukim fizik e ushtarak*, një rëndësi të veçantë ka edhe trajtimi i tyre i drejtë pedagogjik. Kjo ka lidhje sidomos me përcaktimin e vendit konkret dhe të shtrirjes të secilit prej këtyre komponentëve në punën mësimoro-edukative, e përpjesëtimeve midis tyre, e gërshetimit dhe e alternimit të tyre. Vetëm kështu mund të shmangët ngarkesa jashtë mase e nxënësve dhe e studentëve jo vetëm me punë mësimore mendore, por edhe me punë prodhuese e edukim fizik e ushtarak, në mënyrë që jo vetëm të mos dëmtohet shëndeti i të rinjve, por edhe t'u lihet

atyre kohë e mjaftueshme për t'u marrë me veprimtari politiko-shoqërore, për të marrë pjesë në aktivitetet e ndryshme masive kulturore, edukative dhe sportive, si dhe për të organizuar jetesën e tyre e shfrytëzimin e kohës së lirë në një mënyrë të kulturuar.

III

MBI FORCIMIN E BOSHTIT IDEOLOGJIK MARKSIST-LENINIST NË PUNËN MËSIMORO-EDUKATIVE TË SHKOLLËS

Trekëndëshi *mësim-punë prodhuese-edukim fizik e ushtarak* mund të realizohet me sukses në gjithë punën e shkollës dhe ta vërë shkollën plotësisht në shërbim të socializmit vetëm duke pasur si qendër të vetën *boshtin ideologjik marksist-leninist*. Nga zgjidhja me sukses e këtij problemi do të varet gjithë fuqizimi i funksionit të shkollës, si një hallkë e rëndësishme për revolucionarizimin e mëtejshëm të gjithë jetës së vendit, për ndërtimin e plotë të socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë.

Forcimi i këtij boshti ka qenë një detyrë e përhershme e shkollës sonë socialiste. Në zbatimin e kësaj detyre shkolla jonë ka arritur suksese dhe rezultate të rëndësishme, me gjithë vështirësitë që i është dashur të kapërcejë për shkak të «njollave» të përmbajtjes së vjetër dhe të kuadrin arsimor relativisht të pakualifikuar në shkollën e duhur. Këto vështirësi janë shkaku kryesor i mungesave, të metave e zigzageve që janë shfaqur në këtë fushë. Kështu, duke luftuar për të përsosur përmbajtjen dhe formimin shkencor materialist të nxënësve, shkolla jonë e pat përqëndruar vëmendjen sidomos në aspektin e bazave shkencore të botëkuptimit, duke e kufizuar, kështu, formimin pothuajse kryesisht në sferën e edukatës mendore. Formimi shkencor dhe edukimi teknik e profesional i nxënësve e studentëve nuk kanë qenë lidhur gjithmonë organikisht me edukimin politik e ideologjik. Nuk ka qenë vendosur siç duhet prioriteti absolut i edukimit ideopolitik në tërë punën mësimoro-edukative të shkollës. Me gjithë përpjekjet që janë bërë në periudha të ndryshme, në shkollën tonë, prapëseprapë, nuk u vendos dot një cikël i plotë lëndësh marksiste-leniniste, sidomos në shkollën 8-vjeçare dhe të mesme. Këtu ka luajtur rolin e vet influenca e shkollës sovjetike, pikëpamja se «formimi i botëkuptimit marksist-leninist të nxënësve mund të realizohet vetvetiu nëpërmjet lëndëve të tjera mësimore, pa studjuar në mënyrë të domosdoshme marksizëm-

-leninizmin si lëndë të veçantë» që në shkollën 8-vjeçare dhe të mesme.

Në përgjithësi, në shkollën tonë, formimi ideologjik marksist-leninist i brezit të ri nuk është parë në çdo hap si një proces tërësor revolucionar, që lidh mësimin teorik me praktikën e gjallë të jetës, me punën dhe prodhimin, përvetësimin e njohurive teorike të marksizëm-leninizmit me aksionin politik dhe ideologjik, me praktikën revolucionare në kuptimin e gjerë të fjalës, me luftën për ndërtimin e socializmit.

Teorikisht, për ne ka qenë gjithnjë e qartë se mësimi dhe edukimi në shkollë duhet të jenë një proces, i cili lidh në një tërësi të vetme edukimin shkencor, njohjen dhe përvetësimin e bazave të shkencave me edukimin ideopolitik, që duhet të përshkojë si fill i kuq gjithë procesin e edukimit komunist dhe, në mënyrë të veçantë, edukatën mendore. Por në fakt, në planet, programet dhe tekstet shkollorë kjo nuk është realizuar si duhet. Jo rrallë mësimi dhe edukimi, për këtë arsye, merrnin karakter formal dhe skolare. Këtë dobësi e ka thelluar shkëputja e shkollës, sidomos e arsimit të përgjithshëm nga puna në prodhim. Në këtë drejtim kanë influencuar edhe metodat verbale të punës mësimore e edukative dhe një farë shkëputje e saj nga aktualiteti etj. Të gjitha këto, në tërësi, në procesin e punës mësimore-edukative të shkollës, kanë krijuar një farë shkëputjeje midis mësimi dhe edukatës, midis informimit dhe formimit, midis përgatitjes shkencore dhe brumosjes ideopolitike.

Fjala e shokut Enver e 7 marsit, orientimet e gjithanshme revolucionare të Partisë për forcimin e edukimit komunist të brezit të ri, si dhe diskutimi popullor, krijuan mundësi të reja për t'i kapërcyer këto dobësi në punën e shkollës dhe për të përcaktuar akoma më qartë rrugët kryesore për realizimin e boshtit ideologjik marksist-leninist në tërë jetën e shkollës. Siç na mëson shoku Enver, këto rrugë kryesore janë: *studimi i drejtëpërdrejtë i marksizëm-leninizmit në shkollë, vendosja e një cikli të plotë lëndësh marksiste-leniniste duke filluar që në shkollën 8-vjeçare e deri në shkollë të lartë; përshkrimi i të gjitha lëndëve nga ideologjia dhe politika e Partisë sonë, nga filozofia marksiste-leniniste, lidhja e gjithanshme e shkollës me praktikën revolucionare të jetës, pjesëmarrja aktive e rinisë shkollorë e studenteske në këtë praktikë revolucionare, — të marrura të tria së bashku në tërësinë dhe unitetin e tyre.*

1. — Përsa i përket studimit të lëndëve marksiste-leniniste, gjatë diskutimit popullor janë kritikuar të metat e theksuara që kanë ekzistuar në mësimin e tyre, zigzagët e shumta dhe mungesa e stabilitetit, nënvleftësimi i tyre në shkollat profesionale si dhe në të gjitha shkollat pa shkëputje nga puna, sidomos nënvleftësi-

mi i edukimit të drejtëpërdrejtë marksist-leninist në shkollën e mesme, e veçanërisht në atë 8-vjeçare. Deri kohët e fundit, një vend shumë të paktë kanë zënë këto lëndë edhe në përgatitjen e mësuesve të rinj në shkollat e mesme pedagogjike e institutet pedagogjike dyvjeçare. Edhe në shkollën e lartë, megjithëse ka pasur vazhdimisht një cikël relativisht të plotë lëndësh marksiste-leniniste, ka ndërruar shpesh struktura dhe shpërndarja e lëndëve të këtij cikli, ka ndryshuar shpesh numri i orëve, raporti midis leksioneve e seminareve etj.

Dobësi të ndieshme ka pasur edhe në sigurimin e kuadrit mësimor dhe sidomos në përpunimin e metodave të përshtatshme për dhënien e këtyre lëndëve. Në praktikën e punës së shkollës, kanë influencuar për të keq metoda e njëanshme skolare dhe akademike, verbalizmi, të mësuarit libreshk, shkëputja e mësimi nga realiteti i gjallë socialist dhe nga lufta e Partisë sonë për transformimin e tij, nga eksperiencia revolucionare teorike e praktike e saj. Edhe në mësimin e marksizëm-leninizmit kanë influencuar, kështu, kallëpet didaktike formaliste e të ngurta.

Siç shihet, me të gjitha përpjekjet e vazhdueshme e sukseset e arritura, puna për edukimin marksist-leninist të rinisë shkollorë e studenteske nuk u është përmbajtur kurdoherë si duhet detyrave dhe porosive që ka shtruar herë pas here Partia. Deri sot kjo ka qenë një ndër boshllëqet më të mëdha të shkollës në drejtim të edukimit komunist të brezit të ri përgjithësisht, dhe të formimit të tij marksist-leninist në mënyrë të veçantë.

Vjetët e fundit, këto të meta e boshllëqe të shkollës janë analizuar e kritikuar dhe janë marrë masat e para për kapërcimin e tyre. Por me të drejtë, gjatë diskutimit popullor, këto masa janë konsideruar të pamjaftueshme. Njëzëri është kërkuar *vendosja e ciklit të plotë të lëndëve marksiste-leniniste në shkollë*, që nga 8-vjeçarja e deri në të lartën. Është shprehur mendimi që në shkollë të mësohet një sistem relativisht i plotë i njohurive marksiste-leniniste, sigurisht, i shkallëzuar sipas etapave të shkollës dhe moshës së nxënësve. Është kërkuar që Historia e Partisë sonë të zërë më shumë vend në sistemin e këtyre lëndëve.

Në gjithë këtë punë për studimin e marksizëm-leninizmit në shkollë, ne nisemi nga porosia e shokut Enver se marksizëm-leninizmi në shkollën tonë të re do të mësohet

«... si lëndë e veçantë nga më kryesoret...»¹.

Kjo do të thotë që midis të gjitha lëndëve mësimore, në shkollë duhet t'u jepet *prioritet absolut* lëndëve marksiste-leniniste. Duke

1 Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 376.

folur për studimin e marksizëm-leninizmit shoku Enver shtron gjithashtu detyrën që

«... Ky studim të bëhet në mënyrë serioze, me forma të përshtatshme, të kuptueshme, me fjalë të tjera, të mësohet e gjithë sinteza filozofike materialiste e formuluar nga klasikët tanë të mëdhenj, e ilustruar me luftën dhe praktikën e Partisë sonë dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare»¹.

Në bazë të këtyre porosive, në shkollën tonë teoria marksiste-leniniste do të mësohet në mënyrë të organizuar, të programuar dhe sistematike, gjithmonë në përshtatje me moshën e nxënësve. Në bazën e studimit të marksizëm-leninizmit do të jenë mësimet dhe veprat e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Ky studim do të mbështetet gjithashtu në veprat e shokut Mao Ce Dun e të shokut Enver, në Historinë e Partisë sonë, në dokumentet e saj themelore e në praktikën e saj revolucionare si dhe në eksperiencën revolucionare të lëvizjes komuniste marksiste-leniniste ndërkombëtare.

Në bazë të këtyre kriterëve themelore, që në shkollën 8-vjeçare (në klasën VII dhe VIII) do të mësohet lënda «Edukata politike dhe morale», si abc-ja e edukimit të drejtëpërdrejtë marksist-leninist. Mendohet me të drejtë se në këto klasa nxënësit janë aq të formuar, sa të mund të përvetësojnë mirë disa njohuri krejtësisht fillestare marksiste-leniniste, kryesisht me karakter ideopolitik dhe të lidhura me aktualitetin. Njëkohësisht, do të studjohet mundësia e do të bëhen edhe eksperimentime, që të zbatohet së shpejti një program katërvjeçar i kësaj lënde për klasat V-VIII. Ndërkaq, do të forcohet trajtimi i çështjeve që lidhen me pregatitjen politike, ideologjike si dhe me problemet morale nëpërmjet këndimeve dhe leximeve letrare, që nga klasa e parë deri në të gjashtë. Krahas forcimit të lidhjes së mësimimit me aktualitetin, pasqyrimin në të të revolucionarizimit të mëtejshëm të gjithë jetës së vendit si dhe shpjegimit të thjeshtë të disa momenteve kyçe të Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë, në këtë lëndë do të flitet gjerë edhe për *sjelljen morale të fëmijëve në shkollë*, në familje e në shoqëri, si dhe për formimin e *shijeve estetike të fëmijëve në bazë të normave të edukatës socialiste*. Por, për realizimin e këtyre detyrave, një rol vendimtar ka hartimi i një teksti të përshtatshëm për moshën, të kapshëm dhe të kuptueshëm për nxënësit, dhe sidomos metoda e dhënies së mësimimit në këtë frymë.

shëm për nxënësit, dhe sidomos metoda e dhënies së mësimimit në këtë frymë.

Në të gjitha shkollat e mesme, të përgjithshme dhe profesionale, me shkëputje e pa shkëputje nga puna, në të katër klasat e tyre do të zbatohet një program unik i lëndës: «*Njohuri fillestare të marksizëm-leninizmit*». Mësimi i saj do të fillojë me Historinë e Partisë sonë dhe do të vazhdojë me nocionet elementare të ekonomisë politike dhe të filozofisë, duke ndjekur rrugën e kalimit nga konkretja te abstraktja, duke u përpjekur për t'u dhënë nxënësve edhe një sintezë elementare të botëkuptimit marksist-leninist, duke u mbështetur për këtë, si në moshën më të rritur të nxënësve, ashtu edhe në njohuritë që kanë fituar ata në shkollën e mesme nëpërmjet mësimimit të bazave të shkencave shoqërore dhe të shkencave të natyrës. Edhe këtu rëndësi vendimtare ka hartimi i një teksti të përshtatshëm, i cili të mos jetë, si deri tani, një konspekt i ngjeshur i teksteve të shkollës së lartë, i rëndë dhe i vështirë për nxënësit, si dhe përdorimi i metodave aktive të mësimimit, të lidhura ngushtë me gjithë jetën politiko-shoqërore.

Në këtë mënyrë, krahas përmirësimit rrënjësor nga pikëpamja e cilësisë, në shkollën 8-vjeçare e të mesme kemi edhe një rritje të konsiderueshme të vëllimit të orëve të caktuara për studimin e lëndëve marksiste-leniniste në masën afërsisht sa dyfishi i vëllimit të orëve që përdoren sot për to.

Në shkollat e larta, duke ruajtur strukturën dhe vëllimin e tanishëm të lëndëve marksiste-leniniste, krahas përmirësimit të brendisë dhe të metodës së dhënies së mësimimit, është e domosdoshme që të ngrihet sidomos niveli i studimit të Historisë së Partisë sonë, të mësohet ajo edhe në bazë problemesh, me qëllim që politika dhe lufta e Partisë të sintetizohet sipas etapave historike dhe çështjeve themelore, dhe të trajtohen, së bashku me dokumentet e tjera kryesore të Partisë, edhe Veprat e shokut Enver. Një studim i thellë dhe i gjithanshëm i një niveli të lartë teorik i lëndëve marksiste-leniniste do të bëhet veçanërisht gjatë përgatitjes së kadrove për ekonomi politike dhe filozofi.

2. — *Përshkrimi i të gjitha lëndëve mësimore nga boshti ideologjik marksist-leninist është një çështje tjetër shumë e rëndësishme dhe delikate. Lidhur me këtë problem, gjatë diskutimit popullor janë bërë shumë vërejtje të drejta parimore e konkrete dhe janë parashtruar kërkesa të reja që duhen marrë parasysh gjatë hartimit të programeve të reja mësimore dhe, në mënyrë të veçantë, të teksteve shkollërore, duke u mbështetur edhe në një farë tradite të krijuar në këtë fushë në shkollën tonë gjatë gjithë periudhës së paslirimit, si dhe duke vazhduar studimet dhe eksperimentimet për probleme të veçanta e konkrete.*

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 376.

Kjo është një çështje e ndërlikuar që kërkon mishërimin e vet të gjithanshëm në brendinë dhe metodat e mësimit e të edukimit. Në lidhje me këtë shoku Enver thekson:

«... tekstet, leksionet, metodat e dhënies së mësimit dhe zhvillimi i eksperimenteve dhe i praktikave, — të gjitha këto në kompleks duhet të bëhen, të rindërtohen, të zhvillohen në përputhje me teorinë tonë. Teoria jonë t'i ndritë dhe t'i shpjegojë këto hap pas hapi, në mënyrë që studenti dhe pedagogu, mësuesi dhe nxënësi të shohin konkretisht në praktikë dhe në teori se zhvillimi i vërtetë e i drejtë i shkencave ecën në rrugën përparimtare vetëm kur udhëhiqet dhe ndriçohet nga materializmi dialektik dhe historik»¹.

Pikërisht ky orientim themelor duhet të mishërohet konkretisht në tërë punën e shkollës sonë, që nga 8-vjeçarja e deri te e larta, gjithmonë në përshtatje me moshën e nxënësve.

Mendimi i përgjithshëm është se që në shkollën 8-vjeçare duhen bërë disa rregullime për të zhdukur të metat e shumta të edukimit të përgjithshëm politik dhe të formimit ideologjik të nxënësve. Sigurisht, këtu nuk është fjala për t'i ngarkuar programet dhe, aq më shumë, tekstet me koncepte dhe konkluzione filozofike, që nuk i përshtaten moshës së nxënësve. Qëllimi ynë do të jetë që të forcohet *tendencioziteti ideopolitik në të gjitha lëndët mësimore*, dhe, në mënyrë të veçantë, në këndimet dhe leximin letrar, që zënë një peshë të madhe në planin mësimor të shkollës 8-vjeçare. Ky forcim do të bëhet duke futur disa koncepte dhe konkluzione elementare botëkuptimore, në përputhje me kërkesat didaktike dhe psikologjike. Kurse në tekstet do të mbahet mirë parasysh që të përdoret terminologjia e perceptueshme për moshën, dhe zbrëthimi i brendisë së koncepteve të bëhet në atë shkallë, sa lejojnë aftësia kuptimore dhe vetë praktika e jetës së fëmijëve.

Gjatë diskutimit popullor në këtë kuadër janë bërë kritika mjaft të forta, veçanërisht për abetaren, librat e këndimit dhe antologjitë e leximit letrar të shkollës 8-vjeçare. Në to ka pasur shumë copa me përmbajtje të vjetëruar, që ushqenin ndjenjën e interesit për pronën private, për ndarjen e punëve midis burrit e gruas, që nuk pasqyrojnë si duhet rolin e madh të femrës në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin socialist, që ushqenin intelektualizmin të fëmijët që në moshë të hershme etj. Është e domosdoshme që tekstet e reja të abetares e të leximit të pastrohen rrënjësisht nga këto influenca të huaja e «njolla» të së ka-

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 377.

luarës dhe të pasqyrojnë siç duhet frymën revolucionare marksiste-leniniste të kohës në trajtimin e të gjitha këtyre problemeve.

Në programet e tekstet e reja të ciklit të ulët të shkollës 8-vjeçare (në klasat I-IV) do t'u kushtohet një vëmendje e posaçme çështjeve botëkuptimore, duke marrë parasysh se në këtë moshë hidhen themelet e para të këtij formimi, se psikika e fëmijës është shumë e ndieshme dhe regjistron me lehtësi të gjitha njohuritë, faktet, përshtypjet dhe konceptet në formën e tyre intuitive-konkrete. Për këtë qëllim, në shkollën 8-vjeçare do të përcaktohet një tematikë më e gjerë dhe më e pasur me aspekte nga Lufta Nacionalçlirimtare, nga pjesëmarrja e gruas në luftë, nga aksionet e pionierëve, nga vrulli revolucionar i masave të popullit për mbrojtjen e atdheut dhe ndërtimin socialist të vendit etj. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet figurës së njeriut të ri që po transformon jetën dhe veten e tij, luftës kundër «njollave», të shoqërisë së vjetër etj. Në këto klasa, një vend të madh do të zërë mësimi i historisë amtare dhe njohja e vendlindjes. Në ndryshim me programin e mëparshëm, i cili kishte karakter enciklopedik dhe ishte i vështirë për t'u përvetësuar, në programin e ri të kësaj lënde, nëpërmjet një materiali letrar-artistik me forcë ideoemocionale, do të jepen momentet kyçe të historisë së popullit tonë, në mënyrë të veçantë Lufta Nacionalçlirimtare dhe periudha e ndërtimit socialist të vendit.

Kjo vijë do të zbatohet edhe në ciklin e dytë të shkollës 8-vjeçare (në klasat V-VIII). Përmirësime të ndieshme në këtë cikël do të pësojë sidomos lënda e historisë. Do të ndryshojë raporti midis Historisë së vjetër e të mesjetës, nga njëra anë, dhe i Historisë së re e të sotme, nga ana tjetër, si në kursin e historisë botërore ashtu edhe në atë të Shqipërisë, në dobi të Historisë së re e të sotme, si dhe do të pasqyrohen më gjerë lufta e proletariatit botëror kundër borgjezisë, lëvizjet nacionalçlirimtare dhe anticoloniale kundër imperializmit dhe lufta kundër revizionizmit modern.

Nëpërmjet *shkencave të natyrës* dhe *matematikës* nxënësit e 8-vjeçares do të fitojnë disa koncepte shumë elementare, në përputhje me moshën, rreth fenomeneve kryesore të natyrës, do të njohin disa nga ligjet themelore të zhvillimit të botës së gjallë si dhe disa koncepte elementare mbi materien dhe lëvizjen e saj në kohë e në hapësirë etj. Këto koncepte do të fitohen duke kaluar në dy faza: në ciklin e parë (klasa I-IV) nëpërmjet rrugës intuitive-praktike, ndërsa në ciklin e dytë (klasa V-VIII) nëpërmjet përvetësimit sistematik të njohurive, ligjeve dhe aksiomave elementare shkencore mbi bazën e të mësuarit konkret, eksperimenteve, demonstrimeve, vrojttimeve etj. Në mënyrë të veçantë në ciklin e parë njohuritë nga natyra do të jepen nëpërmjet co-

pash interesante shkencoro-letrare, vrojtimesh të gjalla e detyrash praktike dhe eksperimentale.

Përmirësimi i gjithanshëm i edukimit ideopolitik në shkollën 8-vjeçare duhet bërë në lidhje të ngushtë me forcimin e përgjithshëm të punës mësimoro-edukative të pajisjes së nxënësve me njohuritë e nevojshme shkencore. Përmirësimet e ndieshme duhen bërë sidomos në mësimin e gjuhës shqipe. Mësimi i gjuhës amtare, që është një nga lëndët themelore të 8-vjeçares duhet të çlirohet nga çdo element pasiv, nga rregullat e tepërta e të panevojshme dhe nga skemat e huaja. Ai duhet të synojë që të rinjtë tanë ta përvetësojnë në mënyrë aktive gjuhën e bukur e shprehëse të popullit, të dinë ta përdorin atë drejt për shprehjen e mendimeve, për të marrë pjesë gjallërisht në gjithë veprimtarinë politiko-shoqërore, ideologjike e arsimoro-kulturale. Njohja e mirë e gjuhës shqipe, duke forcuar dashurinë për vlerat e mëdha shpirtërore të popullit tonë e për traditat e tija të pasura, duhet të bëhet edhe një mjet i fuqishëm për edukimin patriotik të brezit të ri.

Në shkollat e mesme e të larta krijohen mundësi të reja që të gjitha lëndët mësimore të përshkohen në mënyrë konsekuente nga boshti ideologjik marksist-leninist. Këtu kemi të bëjmë me një moshë më të pjekur të nxënësve e të studentëve, të cilët janë në gjendje t'i kuptojnë mirë konceptet dhe konkluzionet filozofike që mund të nxirren nga lëndët mësimore, atje ku është e nevojshme, dhe të realizojnë lidhjen midis metodës dialektike dhe studimit e shpjegimit materialist të fenomeneve shkencore. Kjo detyrë lehtësohet në një farë shkalle edhe nga fakti se në shkollat e mesme e të larta bëhet tanimë studimi sistematik i bazave të shkencave, apo i vetë shkencave të plota, duke përdorur gjerësisht abstraksionin si veprim mendor.

Megjithatë, duhet theksuar se edhe në shkollat e mesme synimi ynë nuk do të jetë ngarkimi i programeve dhe i teksteve të lëndëve mësimore me konkluzione dhe koncepte filozofike. Detyra themelore, edhe këtu, do të jetë pikësynimi për të dhënë dije të sakta, të mbështetura në teorinë materialiste dhe në metodën dialektike, dije të lidhura ngushtë me zbatimin e tyre praktik në të gjitha fushat e jetës. Duke marrë parasysh se moshë e nxënësve të shkollës së mesme është periudha e formimit të bazave të personalitetit dhe botëkuptimit pak a shumë të plotë, në lëndët e ndryshme mësimore do t'u jepet vendi i duhur ballafaqimit të ideve, teorive e shkollave të ndryshme në shkencë në atë shkallë që i përshtatet përsëri moshës së tyre, kurse në shkollën e lartë kjo metodë pune duhet të përdoret gjerësisht.

Një lëndë me rëndësi të veçantë botëkuptimore dhe edukative është *letërsia*. Tezat e shokut Enver për mësimin e letërsisë,

të parashtruara në Fjalën e tij të 7 marsit, u bënë platforma e një diskutimi të gjerë dhe të një polemike të gjallë, me rëndësi të veçantë, jo vetëm për përcaktimin e kritereve themelore të hartimit të programeve e të teksteve të letërsisë shqipe e të huaj dhe zhvillimit të kësaj lënde në shkollë, por edhe për orientimin e drejtë të shkencës sonë historiko-letrare në luftë kundër influencave të huaja të idealizmit e metafizikës, të objektivizmit borgjez e të klerikalizmit.

Duke u nisur nga tezat e shokut Enver mbi qëndrimin kritik revolucionar ndaj trashëgimisë letraro-kulturale, kombëtare e të huaj, mbi vlerësimin e anëve pozitive e negative të kësaj trashëgimie në baza shkencore marksiste-leniniste, në bazën e parimit historik dhe të tendenciozitetit tonë ideopolitik, mbi vlerësimin e traditave tona të shquara patriotike në këtë fushë, iu bë një analizë e gjerë kritike si programeve e teksteve të letërsisë, ashtu edhe studimeve tona historiko-letrare. Gjatë diskutimit u theksua me forcë mendimi se, krahas nxjerrjes në pah të vlerave pozitive të letërsisë së kaluar kombëtare e të huaj si dhe të përfaqësuesve të saj kryesorë, duhet të tregohen edhe kufizimet e tyre klasore ideore. Nga letërsia e së kaluarës, si kombëtare, ashtu dhe e huaj, duhet të mësohen në shkolla ata përfaqësues kryesorë të tyre që kanë qëndruar në pozita relativisht më përparimtare, demokratike e revolucionare. Autorët do të zgjidhen jo vetëm sipas vendit që zënë në historinë e letërsisë, sipas rrymave që përfaqësojnë, por edhe sipas rëndësisë edukativo-revolucionare të krijimtarisë së tyre. Një zgjedhje e tillë do të bëhet sidomos për autorët e letërsisë së huaj.

Në mësimin e letërsisë, letërsia shqipe do të zërë një vend më të madh se deri tani, por gjithmonë pa cunguar njohjen me vlerat më të mëdha përparimtare të trashëgimisë letrare botërore. Pa u zgjatur në letërsinë e vjetër shqipe dhe duke u kufizuar në një vështrim panoramik të saj, do t'i kushtohet kujdes sidomos krijimtarisë letraro-artistike që nga Rilindja Kombëtare e deri në ditët tona. Veçanërisht letërsia jonë e realizmit socialist do të zërë një vend më të madh në shkollë.

Gjatë mësimin do të jepet një ide mbi pasqyrimin e luftës së klasave në vetë zhvillimin e letërsisë, pasi letërsia demokratike nuk mund të kuptohet drejt dhe në mënyrë të plotë, pa folur për rrymat reaksionare si dhe pa përmendur luftën që shkrimtarët demokratë kanë zhvilluar kundër ideologjisë, kulturës dhe letërsisë borgjeze reaksionare e klerikale. Kjo panoramë në shkollën e mesme do të jepet fare shkurt, ndërsa në shkollën e lartë më gjerë.

Në mësimin e letërsisë së huaj do t'i kushtohet kujdes i veçantë analizës e trajtimit të saj nga pozita të shëndosha shken-

core marksiste-leniniste. Në këtë drejtim, deri vonë, në mjaft raste, ka munguar analiza e thellë klasore, nuk kanë dalë gjithnjë si duhet e sa duhet, krahas anëve pozitive, edhe shfaqjet e ndryshme negative që kanë pasur veprat që studjoheshin, si p.sh. vështrimet idealiste, humanizmi abstrakt, perspektiva e mjegullt etj. Duke u ndalur në mënyrë të veçantë te realizmi socialist dhe përfaqësuesit më të shquar revolucionarë të tij, nxënësit e studentët do të njihen edhe me disa probleme të letërsisë së sotme botërore, në radhë të parë në plan kritik demaskues. Tehu i parqitjes së kësaj problematike do të drejtohet kundër frymës reaksionare të letërsisë borgjeze si dhe të letërsisë e të artit të sotëm revizionist. Në shkollën e mesme këto çështje do të shtrohen shumë përmbledhtas, kurse në shkollën e lartë më gjerë, por gjithmonë në plan panoramik.

Mbi këto kritere, i gjithë mësimi i letërsisë, i tërë procesi i formimit historiko-letrar të nxënësve e studentëve dhe, krahas tij, i gjithë studimi i lëndëve shoqërore si dhe tërë puna edukative e shkollës brenda e jashtë mësimi, duhet t'i shërbejnë aktivisht edukimit ideoestetik të të rinjve, formimit të shijeve të shëndosha komuniste, luftimit të influencës së artit reaksionar dekadent e të shëmtuar borgjez e revizionist, të shijes së bastarduar të tyre.

Në programet e tekstet e *historisë* e të *gjeografisë*, krahas forcimit të efektit të madh edukativ e patriotik që ato duhet të luajnë, duhet të kapërcehen edhe shfaqjet e objektivizmit dhe të një zbatimi jo gjithmonë konsekuent të parimeve të materializmit dialektik e historik. Në histori, do të theksohen më fort disa koncepte themelore me rëndësi aktuale, si lufta e klasave në kushtet e kapitalizmit, lëvizjet nacionale antiimperialiste, revolucionet demokratike e socialiste, si dhe ngjarje konkrete të kësaj fushe, si: fitorja e revolucionit në Kinë, lëvizjet nacionalçlirimtare të popujve të Azisë, Afrikës e Amerikës Latine, lëvizja punëtore e marksiste-leniniste në vendet kapitaliste, lufta kundër revizionizmit modern etj. Po kështu, studimi i bazës dhe i superstrukturës do të bëhet jo vetëm në një raport më të drejtë në favor të bazës, por edhe në funksion të historisë së masave popullore. Të gjitha këto koncepte nuk do të jepen në atë formë siç trajtohen në materializmin historik, por do të kombinohen harmonishëm me të dhënat konkrete historike dhe do të shërbejnë si përgjithësime e mësimi që nxjerrin nxënësit nga studimi i historisë.

Si në mësimin e historisë botërore, ashtu edhe në atë të Shqipërisë, theksi do të vihet në mënyrë të veçantë në Historinë e re dhe sidomos të sotme. Kursi i veçantë i historisë së Shqipërisë, krahas studimit të Historisë së Partisë sonë, do të luajë një rol themelor në edukimin patriotik dhe ideopolitik të nxënësve.

Meqenëse Historia e re dhe e sotme botërore janë shumë të pasura në ngjarje, në shkollën e mesme do të jepen fenomenet dhe ngjarjet themelore historike, duke bërë një lidhje organike të historisë së vendeve të ndryshme, duke nxjerrë tiparet e përbashkëta të këtyre ngjarjeve, në mënyrë që të kalohet në disa përgjithësime, pa hequr dorë, atje ku është e nevojshme, nga trajtimi i veçantë sipas vendeve, i ngjarjeve dhe i fenomeneve që janë më tipike. Ndërtimi i programeve të historisë mbi bazën e fenomeneve dhe të ngjarjeve themelore historike jo vetëm që do të evitojë përsëritjen, paralelizmat dhe hollësitë e panevojshme, por, njëkohësisht, edhe do t'i ndihmojë nxënësit në nxjerrjen e konkluzioneve e të përgjithësimeve, në përvetësimin me baza shkencore të lëndës së historisë.

Në lëndët e gjeografisë do të synohet në forcimin e edukimit ideopolitik të nxënësve. Mësimi i gjeografisë së Shqipërisë, ashtu siç na porosit shoku Enver, duhet të ngjallë te nxënësit ndjenja të fuqishme atdhedashurie e krenarie kombëtare. Kurse në mësimin e gjeografisë së përgjithshme duhet të kapërcehet nënvleftësimi që u është bërë deri tani elementeve të gjeografisë politike. Trajtimi i këtyre elementeve do të bëhet së bashku me gjeografinë fizike dhe ekonomike. Në këtë kuadër, në gjeografinë ekonomike të botës do të vihet theksi në veçoritë e strukturës së ekonomisë botërore në kohën e sotme, në tendencat e përgjithshme të formimit të hartës së sotme politike të botës, në karakteristikat ekonomike të vendeve socialiste, imperialiste e kapitaliste, ish-koloniale, koloniale e revizioniste. Do të bëhet krahasimi midis këtyre vendeve për të nxjerrë disa konkluzione të përgjithshme.

Në mënyrë të veçantë në gjeografinë e Shqipërisë do të bëhet një gërshetim më i mirë midis gjeografisë fizike dhe asaj ekonomike, për të kuptuar mirë rolin e ambientit natyror në zhvillimin ekonomik dhe, nga ana tjetër, *rolin vendimtar të njeriut e të rendit tonë socialist* për transformimin e natyrës në dobi të shoqërisë.

Të gjitha këto përforcime do të bëhen pa nënvleftësuar në asnjë rast rolin e gjeografisë si shkencë e natyrës.

Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet në të ardhshmen forcimit të mëtejshëm të boshtit ideologjik në lëndët e shkencave të natyrës, në përgjithësi, si dhe në lëndët teknike dhe speciale, veçanërisht në shkollat e mesme profesionale dhe të larta. Në këto lëndë është më i madh rreziku për të rënë në njëanshmëri, qoftë në drejtim të objektivizmit borgjez, të pozitivizmit e neopozitivizmit, të studimit thjesht teknik e profesional të problemeve të shkëputura nga jeta, nga prodhimi, qoftë edhe në drejtim të formalizmit, të lidhjes artificiale të këtyre lëndëve me ligjet e filo-

zofisë. Dihet, p.sh., se në matematikë dhe në lëndët e tjera natyrore nxënësit fitojnë njohuri të shumta, që shërbejnë si bazë për forcimin e përfytyrimeve të drejta materialiste dhe për njohjen e ligjeve të përgjithshme të zhvillimit të botës. Por programet e vjetra, dhe sidomos tekstet, kanë të meta e mungesa të tilla, që nuk lejojnë të shfrytëzohen në masën e duhur këto mundësi. Edhe në këto lëndë problemi themelor duhet të jetë dhënia e dijeve të sakta, që formojnë botëkuptimin materialist në kuptimin e gjerë të fjalës, sistemin e njohurive të plota dhe shkencore, në mënyrë të veçantë, mbi natyrën.

Në matematikë, realizimi i këtyre ideve duhet të formojë bindjen se konceptet matematike nuk janë as krijime «të kulluara» të mendimit, dhe as marrëveshje paraprake midis njerëzve, por janë domosdoshmëri e lindur nga nevojat e prodhimit.

Në fizikë, një vend të gjerë duhet të zërë studimi i materies në të dy llojet e saja: të lëndës dhe të fushës, theksimi i koncepteve materialiste mbi fushën, si formë e materies, e formimit të një koncepti më të plotë mbi lëvizjen, si formë e ekzistencës së materies.

Në kimi, si disiplinë e substancave dhe e transformimeve të tyre, duhet t'u kushtohet një rëndësi e madhe përpjekjeve për zbulimin e aspekteve dialektiko-materialiste të nocioneve kimike.

Synime pak a shumë të kësaj natyre duhet të ndiqen edhe për hartimin e programeve e të teksteve të lëndëve të tjera natyrore si dhe të lëndëve teknike e speciale të shkollave të mesme profesionale e të larta. Me gjithë karakterin e theksuar teknik dhe profesional, këto lëndë kanë një fushë të gjerë për të përforcuar dhe zgjeruar te nxënësit dhe studentët, nëpërmjet shembujsh të rinj dhe studimit të fenomeneve të reja, konceptet shkencore materialiste që ata kanë fituar, duke mësuar më parë lëndët e kulturës së përgjithshme dhe, në mënyrë të veçantë, lëndët marksiste-leniniste. Në këto lëndë duhet t'i kushtohet kujdes sidomos lidhjes së shkencës me prodhimin, pasqyrimit të eksperiencës së përparuar të prodhimit tonë socialist, teknologjisë së re të prodhimit si dhe luftës për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor në vendin tonë.

Të gjitha këto pikësnyime ideopolitike, si dhe pikësnyimi për ngritjen e nivelit teorik e shkencor të shkollës, për trajtimin në nivelin e duhur shkencor e metodik të të gjitha lëndëve që mësohen në kategoritë e ndryshme të shkollave, duhet të gjejnë mishërimin e realizimin e tyre konkret në tekstet shkollore, të cilat duhet të hartohen në bazë të kriterëve të shëndosha marksiste-leniniste, në përshtatje me nivelin e zhvillimit të sotëm të shkencës dhe me kërkesat didaktike, duke u dhënë gjithmonë prioritetin

absolut kriterëve e kërkesave ideopolitike, duke u nisur nga porosia e shokut Enver, që thotë:

«Tekstet duhen konsideruar si një fushë e rëndësishme ku konkretizohen vija e Partisë, politika e saj, qëllimet dhe programet e saj të tanishme dhe përgatitja e së ardhshmes. Nuk duhet ta kuptojmë shkollën e re socialiste me çfarëdoj tekstesh, ku të bashkëjetojë botëkuptimi idealist-borgjez me atë marksist-leninist. Ne nuk duhet t'i bëjmë asnjë koncesion filozofisë idealiste borgjeze dhe as më të voglin koncesion teologjisë»¹.

Në këtë frymë duhen analizuar imtësisht të gjitha tekstet shkollore, duhen ripunuar ato dhe duhen hartuar tekste të reja. Kjo punë ka filluar që gjatë diskutimit popullor. Metoda e përdorur gjatë diskutimit popullor për t'ia nënshtruar tekstet një analize të gjerë publike jo vetëm nga mësuesit, por edhe nga prindërit, nga nxënësit e gjithë punonjësit, për t'ia nënshtruar ato një analize të imtë në grupet e punës të krijuara posaçërisht për çdo tekst, për të filluar hartimin e teksteve të reja nga kolektiva autorësh, ku të përfshihen jo vetëm pedagogë e metodistë të kualifikuar të shkollave të larta e të institucioneve qendrore, por edhe mësues e pedagogë të bazës si dhe specialistë të prodhimit — kjo metodë duhet të përgjithësohet dhe të bëhet e përhershme në punën tonë në këtë fushë.

Në hartimin e teksteve do të mbahen mirë parasysh kategoria e shkollës dhe moshën e nxënësve. Kështu, në tekstet e shkollës 8-vjeçare do të mbizotërojë materiali konkret: faktet, ngjarjet dhe fenomenet, si dhe sqarimi e interpretimi elementar e me tendenciozitet i tyre, i mbështetur në baza të drejta shkencore e ideologjike, në përshtatje me moshën e nxënësve. Në të nuk do të ketë konkluzione të veçanta filozofike, as dhe ballafaqim teorik të kundërta, pasi zhvillimi dhe formimi i përgjithshëm i nxënësve nuk e lejojnë këtë. Kjo nuk do të thotë se nuk do të ketë luftë kundër pikëpamjeve dhe shfaqjeve fetare, borgjeze dhe revizioniste, por kjo do të bëhet sipas natyrës së lëndës, nëpërmjet ballafaqimit dhe interpretimit të fakteve e të fenomeneve dhe jo të teorive përkatëse. Në shkollën e mesme do të ngrihet niveli teorik e shkencor i paraqitjes së lëndës. Një rol të veçantë do të luajnë ballafaqimi i thjeshtë në tekst i teorive, i pikëpamjeve dhe i rrymave të ndryshme, analiza klasore dhe interpretimi me tendenciozitet i tyre mbi baza marksiste-leniniste, lufta kundër pikëpamjeve borgjeze e revizioniste, vënia në dukje

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 358.

e aspektit politik dhe e historizmit në paraqitjen e ideve. Kur e lejon lënda, do të nxirren edhe konkluzione të thjeshta filozofike, në përshtatje me formimin e përgjithshëm që kanë marrë nxënësit, pa rënë në filozofime dhe shtojca mekanike.

Kurse në shkollën e lartë tekstet do të hartohen në një nivel të lartë teorik e shkencor, duke kuptuar me këtë jo shndërrimin e tyre në manuale enciklopedike voluminoze, me frazeologji, shpjegime, materiale e formulime të panevojshme, siç ngjet shpeshherë, por paraqitjen sistematike të njohurive më të domosdoshme, duke i trajtuar ato gjerësisht nga ana teorike e shkencore, duke bërë një ballafaqim aktiv të teorive të kundërta, duke pasqyruar rezultatet e fundit të zhvillimit në fushat e ndryshme të shkencës. Në raste të caktuara, tekstet e shkollave të larta mund të kenë edhe karakterin e botimeve akademike, por gjithmonë duke dalluar në to materialin që është i detyrueshëm për t'u përvetësuar prej studentëve, nga materiali tjetër plotësues.

Në të gjitha tekstet e shkollës sonë do të pasqyrohet, sipas natyrës së lëndës, thellimi i mëtejshëm i gjithanshëm i revolucionit tonë socialist. Në to do të zbatohen parimet e rëndësishme të lidhjes së njohurive me jetën e aktualitetin, me prodhimin dhe me ndërtimin e socializmit në vendin tonë, do të vihet në dukje roli i madh historik i Partisë së Punës të Shqipërisë.

Por rolin vendimtar në realizimin konkret të detyrës për forcimin e boshtit ideologjik marksist-leninist dhe revolucionarizimin e tërë procesit të mësimin e të edukimit e luajnë mësuesit e pedagogët. Programit e tekstit i jep jetë mësuesi. Prandaj, ne duhet të kemi gjithmonë parasysh porosinë e Leninit, i cili thoshte se fati i orientimit ideopolitik të një shkolle, në fund të fundit, varet e përcaktohet nga përbërja e lektorëve, e mësuesve dhe e pedagogëve, nga orientimi e formimi i tyre politik, ideologjik e shkencor. Kuptohet sa e madhe është detyra jonë për ta ngritur në një nivel shumë më të lartë punën e vazhdueshme që po bëjmë e që duhet të bëjmë për formimin dhe edukimin e armatës revolucionare të mësuesve.

«Duhet të jetë e qartë — thotë shoku Enver — se për kurrfarë revolucionarizimi të shkollës sonë nuk mund të bëhet fjalë, pa revolucionarizuar vetë ushtrinë e madhe të arsimit»¹.

Kjo kërkon që të revolucionarizohen më tej mendja e mësuesve, ndërgjegjia e tyre, metoda e stili i tyre në punë.

Kuadri arsimor që punon në shkolla duhet të dallohet, në

¹ Shih në këtë vëllim f. 165.

radhë të parë, nga cilësitë revolucionare. Për këtë, duhet të shikohet me syrin klasor përbërja e kuadrove të arsimit, ripërtëritja e tyre dhe sidomos përgatitja e kuadrove të rinj. *Brezi ynë i ri duhet të përgatitet e të edukohet nga njerëz revolucionarë.*

Çështja më themelore për edukimin e kuadrove arsimorë është ngritja e nivelit ideopolitik marksist-leninist i mësuesve ekzistues dhe i mësuesve të rinj që përgatiten në shkolla. Këtë qëllim duhet t'i shërbejë edhe studimi sistematik i organizuar nga ana e mësuesve i materializmit dialektik e historik si dhe i Historisë së Partisë sonë, si nëpërmjet seminaresh e kursesh me shkëputje nga puna, ashtu edhe në rrugën e zakonshme të formave të edukimit marksist-leninist. Në këtë vështrim, edhe gjithë puna tjetër që bëhet për kualifikimin profesional shkencor e pedagogjik të mësuesve, si në seminare e kurse me shkëputje nga puna, ashtu edhe nëpër rrethet metodike e komisionet e lëndëve, nuk duhet të zhvillohet e shkëputur nga puna për ngritjen ideopolitike marksiste-leniniste të tyre, siç është bërë shpesh deri tani, por e lidhur ngushtë organikisht me të dhe në shërbim të saj.

Një kujdes të posaçëm duhet t'i kushtojmë përgatitjes e kualifikimit të mësuesve që do të japin «Edukatën politike e morale» dhe «Njohuritë fillestare të marksizëm-leninizmit» në shkollat 8-vjeçare e të mesme.

3. — Krahas vendosjes në shkollë të ciklit të lëndëve marksiste-leniniste dhe përshkimit të të gjitha lëndëve mësimore nga filozofia jonë, boshti ideologjik marksist-leninist do të realizohet e do të forcohet edhe duke e lidhur ngushtë mësimin dhe edukimin me praktikën revolucionare të jetës në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke e lidhur atë me elementet themelore të kësaj praktike: me veprimtarinë politiko-shoqërore e veçanërisht ideologjike dhe me pjesëmarrjen e gjerë të nxënësve e studentëve në aksionet politike e ideologjike, me pjesëmarrjen e tyre në punë prodhuese, me edukimin e tyre fizik e ushtarak.

Siç porosit shoku Enver, duhet të organizohet pjesëmarrja aktive në problemet politike dhe ekonomike të vendit nga ana e nxënësve, studentëve dhe pedagogëve, pasi kështu ata dalin nga studimi libresk në jetën e gjallë revolucionare. Shoku Mao Ce Dun thotë: «Në qoftë se do të njohësh teorinë dhe metodat e revolucionit, duhet të marrësh pjesë në revolucion»¹. Kjo është rruga e vetme që nxënësit e studentët të lidhen sistematikisht me veprimin revolucionar, të zbatojnë në jetë dhe në praktikë idetë revolu-

¹ Mao Ce Dun. Vepra të zgjedhura, vëll. 1, f. 360.

cionare dhe të mos mbyllen vetëm në botën e dijes e të librave.

Por këto janë probleme të mëdha, që kanë të bëjnë si me përmbajtjen, ashtu edhe me metodat e mësimit e të edukimit, me strukturën e shkollave, me kombinimin e mësimit, punës prodhuese dhe edukimit fizik e ushtarak në strukturën vjetore të vitit shkollor, me punën brenda shkollës e jashtë saj, dhe, si të tilla, ato trajtohen gjatë gjithë raportit që po paraqitet në këtë Plenum.

IV

MBI REVOLUCIONARIZIMIN E MËTEJSHËM TË GJITHË JETËS SË SHKOLLËS DHE TË METODËS SË DREJTIMIT TË SAJ

Përveç sa u tha më sipër, revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës kërkon transformime rrënjësore edhe në lëmin e metodave të mësimit e të edukimit, në lëmin e forcimit dhe të thellimit të demokracisë socialiste në shkollë, të përmirësimit të vazhdueshëm të edukimit jashtëshkollor të brezit të ri dhe të përmirësimit të gjithanshëm të punës për drejtimin e shkollës.

1. — TË REVOLUCIONARIZOJMË E TË PËRSOSIM MË TEJ METODAT E MËSIMIT E TË EDUKIMIT

Përsa u përket metodave të mësimit e të edukimit, në shkollën tonë janë realizuar gjithashtu transformime të rëndësishme. Karakteristika e tyre themelore ka qenë depërtimi i vazhdueshëm i elementeve të reja aktive revolucionare në këtë fushë. Megjithatë, pikërisht në këtë sferë, ku, si rregull, transformimet bëhen më me ngadalësi, pasi forma mbetet gjithmonë pas përmbajtjes, shkolla jonë, siç e vërtetoi dhe diskutimi popullor, është më prapa.

Në mësim krahas formalizmit e verbalizmit, ka akoma shfaqje të theksuara të burokratizmit didaktik, përdoren skema shablone që kufizojnë krijimtarinë e mësuesve dhe ndrydhin edhe energjitë e nxënësve e i hedhin ata në pasivitet.

Kjo prapambetje në fushën e metodave të mësimit e të edukimit të fëmijëve tregon se në këtë çështje janë akoma të forta «njollat» e pedagogjisë së vjetër borgjeze dhe traditat konservatore e patriarkale të edukatës familjare e shoqërore. Në këtë drejtim, na vihet detyra që të marrim të gjitha masat për kapër-

cimin e shpejtë të kësaj prapambetjeje në shkollën tonë, përndryshe shkolla do të pengohet seriozisht për realizimin efektiv të të gjithë kompleksit të masave të tjera për revolucionarizimin e mëtejshëm të saj.

Revolucionarizimi i metodave të mësimit e të edukimit shtytjen kryesore e merr nga praktika revolucionare, nga pleksja e mësimit me veprimtarinë shoqërore politike dhe ideologjike, me punën prodhuese dhe edukimin fizik e ushtarak. Në dhënien e mësimit metoda më racionale është ajo e lidhjes së teorisë me praktikën dhe e praktikës me teorinë.

Një rëndësi vendimtare në këtë fushë ka ndërtimi i marrëdhënieve midis nxënësve e mësuesve në rrugë të drejtë revolucionare. Ky problem është i lidhur me përcaktimin nga pozitat e pedagogjisë socialiste si të vendit e rolit të mësuesit në procesin e mësimit dhe të edukimit, si organizator e udhëheqës i tij, ashtu edhe të rolit e të vendit të nxënësit në këtë proces, jo vetëm si objekt, por edhe si subjekt i këtij procesi.

Për të thelluar këtë proces, është e domosdoshme që mësuesit e pedagogët të luftojnë për t'u çliruar përfundimisht nga «njollat» e pedagogjisë së vjetër zyrtare e konservatore, duke kaluar, në gjithë procesin e mësimit e të edukimit, nga shfaqjet e tutelës mbi nxënësit e studentët, në edukimin dhe forcimin e vazhdueshëm të ndjenjës së inisiativës, të vetëveprimit, vetëkontrollit dhe vetedukimit të nxënësve e të studentëve.

Revolucionarizimi i metodës dhe i stilit në punë të mësuesit e pedagogut nuk ka të bëjë vetëm me probleme të thjeshta didaktike e teknike, por ka të bëjë, në radhë të parë, me botëkuptimin e tyre, me formimin dhe brumosjen e tyre ideologjike dhe shkencore si dhe me kulturën e mjeshtërinë e tyre profesionale, psikologjike e pedagogjike.

Kushti i parë për përmirësimin e metodës e të stilit në dhënien e mësimit është që mësuesi dhe pedagogu ta zotërojnë mirë lëndën dhe të jenë gjithmonë të përgatitur për ta zhvilluar atë me cilësi e rendiment të lartë, sepse, siç thotë shoku Enver, jashtë kësaj nuk mund të ketë as metodë, as stil të mirë në punë, si për punëtorin, ashtu edhe për mësuesin e pedagogun.

Në shkollën tonë socialiste duhet të ketë një larmi metodash e formash për dhënien e mësimit dhe elasticitet të arsyeshëm në zbatimin e tyre, duke pasur për qëllim të fundit përparimin frontal të nxënësve e studentëve. Kjo kërkon rritjen e cilësisë e të rendimentit të punës mësimore-edukative të shkollës për sigurimin e një kalueshmërie të lartë të nxënësve dhe studentëve. Lëvizja masive për kalueshmëri të lartë duhet të arrihet si me përsosjen e metodave dhe të stilit të dhënies së mësimit nga më-

suesit dhe pedagogët, ashtu edhe me përpjekjet e nxënësve e të studentëve për përvetësimin sa më të plotë të mësimit, për të mësuar sa më shumë e për të ushtruar vetëkontrollin në mësimit.

Prapambetja jonë në lidhje me përsosjen e modernizimin shkencoro-pedagogjik të metodave të mësimit, duhet të kapërcehet me intensifikimin e punës kërkimore shkencoro-pedagogjike në këtë drejtim dhe, papritur rezultatet e eksperimentimeve, të gjithë mësuesit e pedagogët të hidhen me guxim përpara për përsosjen e këtyre metodave dhe të stilit të tyre në dhënien e mësimit.

Në lidhje me përparimin e nxënësve dhe të studentëve në mësim, duhet të mobilizohet më mirë edhe *organizata e rinisë* dhe e pionierëve, për forcimin e *vetëkontrollit*, të *ndihmës reciproke* dhe të formave të tjera që i shërbejnë këtij qëllimi.

Gjatë diskutimit popullor është kritikuar metoda e deritashme e organizimit të provimeve, ku theksi vihet më shumë në kujtesën mekanike dhe në riprodhimin mekanik të lëndës nga nxënësi e studenti si dhe në një kontroll me elemente të theksuara zyrtarizmi. Nga të gjithë është kërkuar që vlerësimi i përparimit të nxënësve dhe të studentëve të jetë rezultat i kontrollit jo vetëm në fund të vitit, siç ndodh zakonisht sidomos në shkollat e larta, por gjatë gjithë vitit dhe në format më të ndryshme, duke përsosur në këtë mënyrë edhe sistemin e metodën e organizimit e të zhvillimit të provimeve, duke i zhvilluar ato në mënyrë më të lirë dhe në forma të atilla që *t'i vëmë nxënësit e studentët në pozita që të studjojnë sistematikisht gjatë gjithë vitit shkollor dhe të zhvillohet te ata mendimi krijues, për të mësuar sa më shumë jo «për notë», por për t'u bërë sa më të vlefshëm për shoqërinë dhe për t'i shërbyer asaj sa më mirë.*

Përsosja e mëtejshme e metodave të mësimit e të edukimit varet gjithashtu edhe nga forcimi e pasurimi i bazës mësimoro-materiale të shkollave. Dihet se në këtë drejtim ne jemi akoma të varfër. Prandaj na bie detyra që të marrim të gjitha masat e mundshme për forcimin dhe përsosjen e vazhdueshme të bazës mësimoro-materiale të shkollës.

Përsosja e metodave dhe e stilit në dhënien e mësimit nuk merr fund kurrë. Mësuesit dhe pedagogët tanë duhet t'i përvishen seriozisht kësaj çështjeje, të thyejnë me kurajë revolucionare pengesat e metodave tradicionale pedagogjike dhe të krijojnë metoda të reja dhe stilin e ri revolucionar, socialist, në dhënien e mësimit dhe në edukimin e nxënësve e të studentëve, për të rritur në shkallën më të lartë rendimentin e punës së tyre në dhënien e mësimit dhe në punën edukative, kurse nxënësit dhe studentët, nga ana e tyre dhe në bashkëpunim me mësuesit e pedagogët, duhet të hidhen në veprime revolucionare për përsosjen

e metodave dhe të stilit të të mësuarit, në mënyrë që ata të mësojnë sa më shumë dhe të edukohen sa më mirë për të mirën e shoqërisë, të socializmit. Këtu kemi një fushë veprimi të hapur dhe të pambarim.

2. — TË FORCOJMË E TË THELLOJMË DEMOKRACINË SOCIALISTE NË SHKOLLË

Partia jonë është përpjekur vazhdimisht që problemet e arsimit e të shkollës të bëhen një çështje e madhe e gjithë popullit, e gjithë shoqërisë. Sidomos vjetët e fundit ajo ka luftuar për një zbatim akoma më konsekuent të vijës së masave në këtë fushë. Një provë e shkëlqyer e kësaj është vetë diskutimi popullor për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës.

Megjithatë, shfaqjet e centralizmit burokratik në drejtimin e arsimit popullor dhe në jetën e shkollës nuk janë kapërcyer plotësisht akoma. Veprimtaria mësimoro-edukative e shkollës nuk i është nënshtruar akoma si duhet kontrollit të drejtpërdrejtë të klasës punëtore, të masave punonjëse. Sidomos nuk janë tërhequr akoma si duhet masat e gjera të nxënësve dhe të studentëve në organizimin dhe administrimin e gjithë jetës së shkollës. Këto shfaqje janë në kundërshtim me parimet revolucionare demokratike, mbi të cilat ndërtohet shkolla jonë dhe në bazë të të cilave përcaktohet roli i madh i rinisë shkollore e studenteske në jetën e shkollës. Këto të meta, në qoftë se nuk zhduken me kohë, kthehen në faktor frenues që pengon thellimin e mëtejshëm të demokracisë socialiste në shkollë.

Ne duhet të luftojmë për kapërcimin e të gjitha të metave që akoma vihen re në organizimin e drejtimit të shkollës. Duke luftuar me forcë kundër këtyre të metave, ne udhëhiqemi gjithmonë nga parimi i *centralizmit demokratik*, nga nevoja e forcimit të këtij parimi në drejtimin e arsimit e në jetën e shkollës. Forcimi i udhëheqjes së centralizuar shtetërore të arsimit dhe i drejtimit unik të shkollës nuk e kufizon, por, në të kundërtën, kërkon zbatimin e gjerë të *vijës së masave* në këtë fushë, kërkon pjesëmarrjen e gjerë si të rinisë shkollore e studenteske, ashtu edhe të masave punonjëse në drejtimin e shkollës. Kjo pjesëmarrje, e realizuar nëpërmjet metodave më demokratike, nuk e dobëson aspak, por, në të kundërtën, e bën më të ndërgjegjshme disiplinën shkollore.

Në lidhje me forcimin e demokracisë socialiste në shkollë, na dalin sidomos këto detyra:

Së pari, në shkollat tona, sidomos në shkollat e mesme e të larta, duhet të shtrihet më gjerë vetëveprimi i nxënësve e i studentëve në organizimin dhe drejtimin e jetës së shkollës. Ky ve-

tëveprim duhet të organizohet kurdoherë në prizmin e interesave të socializmit, t'i shërbejë revolucionarizimit të mëtejshëm të të gjithë jetës së shkollës dhe të përfshijë gjithë jetën e aktivitetin e shkollës, duke rritur ndjenjën e përgjegjesisë të rinisë shkollë për mbarëvajtjen e shkollës, për t'i bërë thellësisht të ndërgjegjshëm nxënësit e studentët, si *ndaj të drejtave*, ashtu edhe *ndaj detyrave* që kanë.

Duke u organizuar jeta e shkollës edhe mbi bazën e vetëveprimit të rinisë shkollë, *nxënësit dhe studentët do të përgjigjen, në radhë të parë, për punën dhe rezultatet e tyre në mësim, që është detyra e tyre kryesore në shkollë*. Por kjo kërkon, nga njëra anë, që të ndërmerret një lëvizje e gjerë kundër prapambetjes në mësim, *për një përparim të lartë dhe real*, duke forcuar kontrollin dhe vetëkontrollin si në gjithë kolektivin, ashtu edhe *te çdo nxënës e student i veçantë*, duke zhvilluar ndjenjën e përgjegjesisë individuale e kolektive për mësimin dhe rezultatet e tij, duke luftuar individualizmin e indiferentizmin. Nga ana tjetër, kjo kërkon që të rriten shumë pjesëmarrja e kontributi i rinisë shkollë e studenteske në diskutimin e zgjidhjen e problemeve mësimorë-educative, në mbledhjet e këshillave pedagogjike e shkencore, në analizat që bëhen për programet, tekstet, metodat e mësim, të edukimit etj.

Vetëveprimi i nxënësve dhe i studentëve duhet të gjejë shprehjen e vet konkrete në klasë dhe jashtë klasës, në konvikt dhe jashtë shkollës, *në gjithë veprimtarinë shkollë*. Edhe këtu duhet përdorur metoda e përgjithësimit të shembullit më të mirë. Dhe rinia jonë ka dhënë shumë prova për organizimin dhe vetëveprimin shembullor të saj në drejtimin e jetës shkollë. *Një shembull i shkëlqyer në këtë drejtim është inisiativa revolucionare që kanë filluar të vënë në jetë nxënësit e shkollës së mesme të kulturës në Tiranë*, të cilët kanë organizuar shumë mirë kontrollin dhe vetëkontrollin e ndihmën reciproke në mësim, saqë kanë arritur kalueshmëri 100 për qind, kanë siguruar vetë pastërti shembullorë në shkollë dhe në konvikt, organizimin e ruajtjes si sytë e ballit të pasurisë socialiste, organizimin e një pune të gjerë ideopolitike, të aktivitetëve kulturalo-artistike, sportive etj. Kjo eksperiencë e mrekullueshme e kësaj shkolle shembullorë duhet të shërbejë si bazë nisjeje *për shpërthimin e një lëvizjeje të gjerë e të përhershme të rinisë shkollë e studenteske për pjesëmarrjen e saj në drejtimin e shkollës në bazë të parimit të vetëveprimit*.

Organizimi i jetës së shkollës mbi bazën e vetëveprimit të nxënësve dhe të studentëve duhet të karakterizohet *nga një frymë e shëndoshë revolucionare, bashkëpunimi, uniteti e solidariteti, miqësie komuniste në radhët e nxënësve e të studentëve*, si dhe

midis tyre e gjithë personelit mësimor, teknik e administrativ të shkollës. Zbatimi i parimit të vetëveprimit të nxënësve e të studentëve në pjesëmarrjen e tyre në drejtimin e jetës së shkollës, kërkon *zbatimin e parimit të zgjedhjeve* nga vetë nxënësit dhe studentët të drejtuesve dhe përfaqësuesve të tyre në hallkat e ndryshme të jetës shkollë organizative, pedagogjike, kulturalë dhe politike, pa prekur në asnjë rast kompetencat e organeve shtetërore përkatëse. Kjo do të sjellë me vete edhe rritjen e mëtejshme të rolit dhe të veprimtarisë së organizatës së rinisë dhe të pionierëve në shkollë, nën udhëheqjen e organizatës së Partisë.

Së dyti, duhet të luftohet për forcimin e disiplinës proletare në shkollë, e cila ka lidhje të drejtëpërdrejtë me demokracinë socialiste në tërë jetën e shkollës si dhe me vetëveprimin e rinisë shkollë. Fryma e kësaj discipline, që duhet të përfshijë si mësuesit e pedagogët, ashtu edhe nxënësit e studentët, nuk ka asgjë të përbashkët me indiferentizmin e liberalizmin, me tendencat mikroborgjeze anarkiste dhe shkeljen e rregullit, me shpërdorimin e të drejtave demokratike, me vënien e theksit në mënyrë të njëanshme vetëm te të drejtat e duke harruar detyrat. Në mënyrë të veçantë duhet të jetë e qartë për të gjithë se për forcimin e disiplinës proletare në shkollë duhet të mbahet një qëndrim revolucionar ndaj nevojës së rregullit shkollor dhe autoritetit të merituar të mësuesit e të pedagogut.

Vendosja e një discipline të tillë proletare kërkon zhvillimin e gjithanshëm të kritikës e të autokritikës në masat e mësuesve e të pedagogëve, të nxënësve e të studentëve, si dhe forcimin e kontrollit të gjithanshëm mbi punën e shkollës. Duke luftuar për forcimin e kontrollit shtetëror në shkollë *nga lart-poshtë*, duhet ta pastrojmë kontrollin shtetëror nga shfaqjet burokratike. Nga ana tjetër, duhet të organizohet dhe të ushtrohet si duhet kontrolli *nga poshtë-lart e horizontal* i kolektivit të mësuesve dhe i pedagogëve, dhe sidomos i nxënësve e studentëve, mbi gjithë jetën e shkollës e drejtimin e saj. Kjo vijë kontrolli duhet të shtrihet patjetër edhe në marrëdhëniet midis nxënësve e mësuesve, studentëve e pedagogëve. Duhet, gjithashtu, të forcohet kontrolli i drejtëpërdrejtë i masave punonjëse e në mënyrë të veçantë i klasës punëtore mbi punën e shkollës. Të gjitha këto forma kontrolli në drejtime të ndryshme, të kurorëzuara me kontrollin e përgjithshëm të organeve dhe organizatave përkatëse të Partisë, që është forma më e lartë e kontrollit revolucionar, do ta ngrenë në një shkallë më të lartë dhe vazhdimisht disiplinën proletare në shkollë. Vetëm në këtë rrugë mund të zhvillohet gjerësisht edhe demokracia socialiste në shkollë.

Së treti, duhet të rritet pjesëmarrja aktive e nxënësve dhe e mësuesve, e studentëve dhe e pedagogëve në jetën politiko-

-shoqërore të vendit. Një front i gjerë pune për nxënësit e studentët, mësuesit e pedagogët është, siç e prekëm më sipër, pjesëmarrja e tyre e gjallë dhe e përditshme në luftën klasore ideologjike kundër pikëpamjeve borgjeze e revizioniste, kundër shfaqjeve të mënyrës borgjeze të jetesës, kundër fesë dhe zakoneve prapanike, kundër vënies së interesit personal mbi interesin e përgjithshëm, kundër çdo shfaqjeje të huaj për ideologjinë tonë marksiste-leniniste.

Dihet se pas Kongresit V të Partisë, në shkollat tona janë zhvilluar aksione të shumta me karakter politik e ideologjik në këto drejtime. Ne duhet të vazhdojmë të ecim në këtë rrugë, sepse në këtë mënyrë do të rritet akoma më shumë pjesëmarrja e rinisë shkollore e studenteske në lëvizjet e aksionet revolucionare të vendit, në diskutimet e debatet e ndryshme politike e ideologjike. Në këtë rrugë rinia shkollore e studenteske do të edukohet që të mos jetë indiferente jo vetëm ndaj gabimeve të veta, por edhe ndaj gabimeve të të tjerëve, kushdo qofshin këta, ajo do të inkurajohet që ta thotë fjalën e saj revolucionare me plot gojën dhe të hidhet me guxim në veprimin revolucionar, që të kundërshtojë pa më të voglën drojtje çdo padrejtësi shoqërore, çdo shfaqje e veprim që është në dëm të diktaturës së proletariatit, të socializmit.

Së katërti, duhet të forcohen shumë lidhjet midis shkollës dhe prindërve të nxënësve e studentëve. Prindët tanë duhet të tërhiqen gjerësisht në zgjidhjen e problemeve të shkollës, pikërisht në atë shkallë e me ato forma siç ka filluar të bëhet kjo punë gjatë diskutimit popullor. Kjo kërkon që shkolla dhe mësuesit të mos e vënë veten artificialisht në pozita «superioriteti» ndaj prindërve, t'ia nënshtrojnë veprimtarinë e tyre gjykimit të prindërve të nxënësve e studentëve dhe të mirëpresin çdo vërejtje e kritikë që ata u bëjnë. Vetëm kështu mësuesit e pedagogët do të mund të luftojnë edhe për rritjen e përgjegjësisë së prindërve për edukimin e fëmijëve e mbarëvajtjen e tyre në shkollë, për një bashkëpunim efektiv të tyre me shkollën. Këto lidhje duhet të jenë të shumëllojta, të organizuara dhe të përhershme.

3. — TË PËRMIRËSOJMË VAZHDIMISHT PUNËN TONË PËR EDUKIMIN JASHTËSHKOLLOR TË BREZIT TË RI

Edukimi komunist i brezit të ri është një detyrë e madhe, e ndërlikuar dhe me rëndësi historike, që mund të kryhet me sukses vetëm nën drejtimin e Partisë me forcat e përbashkëta të shkollës, familjes, organizatave të rinisë e të pionierëve, frontit

kulturalo-artistik, të të gjitha organizatave shoqërore si dhe të mbarë shoqërisë.

Në shoqërinë tonë socialiste ekzistojnë kushtet objektive e subjektive që në punën për edukimin komunist të brezit të ri të krijohet një ambient i përgjithshëm shoqëror i shëndoshë dhe revolucionar, një front i përgjithshëm unik edukativ dhe një interesim i përgjithshëm shtetëror e shoqëror në frymën e politikës dhe të ideologjisë së Partisë.

Një rol të madh në këtë mes luan forcimi i edukatës familjare në frymën e ideologjisë socialiste. Familja jonë socialiste, thotë shoku Enver,

«... duhet të bëhet kudhra e parë ku rinia të kalojë kalitjen e përditshme revolucionare»¹.

Në këtë kuptim, familjen tonë dhe funksionin edukativ që ajo kryen, duhet t'i shikojmë në mënyrë reale, ashtu siç janë. Me gjithë fizionominë e përgjithshme socialiste që po merr, familja jonë vazhdon të ushtrijë mbi fëmijët një larmi ndikimesh që kushtëzohen nga origjina e saj klasore, nga gjendja e saj e sotme sociale, nga formimi ideopolitik dhe zhvillimi arsimorokultural i prindërve, nga shkalla e interesimit të tyre për çështjen e edukimit të fëmijëve etj. Këtu kemi të bëjmë me norma të edukatës së vjetër patriarkale dhe me influencën e edukatës borgjeze, siç janë: interesi i ngushtë familjar dhe mbyllja në guaskën e familjes; qëndrimet konservatore prej tutori ndaj fëmijëve; ekzistenca e besimeve dhe e paragjykimeve fetare; liberalizmi dhe indiferentizmi ndaj shturjes në sjelljet e fëmijëve etj. Në luftë kundër këtyre shfaqjeve e «njollave» të së kaluarës dhe të influencës së ideologjisë së huaj, e gjithë Partia dhe levat e saja duhet të zhvillojnë një punë të gjithanshme edukative për ta bërë familjen tonë një çerdhe të vërtetë socialiste, ku rinia të ushqehet vazhdimisht me mësimet e Partisë, me ndjenja revolucionare, me virtytet më të mira të popullit tonë.

Fronti kulturalo-artistik i shërben drejtpërdrejt edukimit komunist të brezit të ri. Në kushtet e sotme, e gjithë veprimtaria kulturalo-artistike duhet t'u përgjigjet më mirë kërkesave të kohës, të shtohet nga ana e sasisë, dhe sidomos të përmirësohet në përmbajtje e cilësi. Aktualisht është shumë e ndieshme nevoja për shtimin dhe përmirësimin e literaturës artistike, si dhe të literaturës shkencore e teknike për fëmijët e rininë, të shfaqjeve skenike, të filmave, të emisioneve të radios, të shtypit dhe të të gjitha mjeteve të kulturës e propagandës masive me një përmbajtje të lartë revolucionare, në përputhje me vijën e Partisë.

Në gjithë këtë punë duhet të forcohet shumë drejtimi i Par-

¹ Shih në këtë vëllim f. 166.

tisë sidomos në luftën kundër influencës së ideologjisë borgjeze dhe revizioniste, kundër depërtimit të influencës borgjeze e revizioniste në mënyrën e jetesës, kundër shijes dhe modës borgjeze. Në këtë vështrim, e gjithë krijimtaria e veprimtaria jonë letrare, botuese, artistike e kulturele duhet të militojë më fuqishëm e më me tendenciozitet për edukimin komunist të rinisë. Pikërisht për këtë, gjatë diskutimit popullor janë bërë shumë vërejtje e kritika të drejta për materialin letrar të teksteve shkollore, për botimet e veçanta për fëmijë, për botimet e përkthimet tona letrare, për repertorin muzikor e teatral, etj., duke kërkuar që ato të pastrohen rrënjësisht nga çdo influencë e huaj dhe të vënë më mirë në qendër të vet idealet revolucionare të Partisë, vrullin e sotëm revolucionar, heronjtë e kohës sonë.

Është e domosdoshme, gjithashtu, që të forcohen edhe roli e puna e të gjitha organizatave shoqërore e organeve shtetërore, si dhe të përpunohet më mirë opinioni shoqëror për edukimin e rinisë. Në këtë fushë kanë lindur e po zhvillohen çdo ditë tradita e norma të reja socialiste, është rritur interesimi i gjithanshëm për edukimin e rinisë, për t'i krijuar asaj kudo fronte të aksionit revolucionar dhe kushtet e nevojshme për mirërritje dhe edukim, për organizimin e shëndoshë të argëtimit e të pushimit të saj, për ta pajisur atë me edukatë socialiste. Megjithatë, ne jemi akoma prapa në këtë fushë.

Jo rrallë vërehet një indiferentizëm i palejueshëm i punonjësve për sjelljen e fëmijëve jashtë shkollës e familjes në ambientet shoqërore, e sidomos në rrugë, vërehet tendenca për t'ia lënë gjithë barrën e edukimit të fëmijëve e të të rinjve vetëm shkollës, kërkesa që të gjitha problemet e vështira materiale të mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve t'i zgjidhë vetëm shteti. Të gjitha këto shfaqje duhen luftuar dhe të arrihet një shkallë më e lartë e interesimit dhe e aktivitetit të të gjithë shoqërisë për edukimin jashtëshkollor të rinisë.

Detyra jonë historike është jo vetëm të shkatërrojmë, por edhe të ndërtojmë, jo vetëm të zhdukim zakonet prapanike e mënyrën feudale e borgjeze të jetesës etj., por edhe t'i zëvendësojmë ato më të reja. Duke shkatërruar institucionet, ambientet, format e vjetra reaksionare-korruptuese për rininë, ne duhet të krijojmë institucione, ambiente, forma të reja, socialiste ku rinia të gjejë ushqimin shpirtëror edukues e argëtues komunist.

Forcat e bashkuara e të shumëfishuara të shkollës e të familjes, të organizatave të rinisë e të pionierëve, të kolektivave punonjëse dhe organizatave të masave, të institucioneve kulturele, ndërmarrjeve shtetërore e kooperativave bujqësore, të mbarrë shtetit dhe shoqërisë, të drejtuara nga Partia dhe ideologjia e saj, janë në gjendje që ta ngrenë në një nivel me të vërtetë të

lartë dhe gjithmonë në ngritje punën për edukimin komunist të rinisë.

4. — TË PËRMIRËSOJME RRËNJËSISHT PUNËN TONË PËR DREJTIMIN E SHKOLLËS

Sukseset tona të gjithanshme në zhvillimin e arsimit e në jetën e shkollës janë njëkohësisht një dëshmi e gjallë e punës së madhe të Partisë në këtë fushë, e punës së organeve shtetërore arsimore, e drejtorive të shkollave, e gjithë armatës së madhe të mësuesve dhe të pedagogëve. Por revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës shtrun me forcë nevojën e përmirësimit të gjithanshëm të punës për drejtimin e shkollës. Në këtë fushë na dalin sidomos këto detyra konkrete.

E para, duhet të përmirësohet rrënjësisht puna e drejtorive të shkollave dhe e organeve arsimore për drejtimin pedagogjik e administrativ të shkollës. Drejtoritë dhe rektoratet e shkollave duhet të mbështeten fuqimisht në masat e nxënësve dhe studentëve, të mësuesve dhe pedagogëve, duke qëndruar gjithmonë pranë tyre, duke dëgjuar me kujdes zërin e tyre, duke bashkëpunuar ngushtë me të gjitha organet dhe forcat që duhet të interesohen për mbarëvajtjen e shkollës. Në këtë drejtim, është e domosdoshme të riorganizohen e të revolucionarizohen edhe këshillat pedagogjike, ku të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e nxënësve dhe të studentëve (të zgjedhur nga ata vetë), të marrin pjesë, gjithashtu, edhe përfaqësuesit e prindërve dhe ata të klases punëtore apo fshatarësisë kooperativiste.

Para Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës e organeve të saj dalin detyra të mëdha për zbrëthimin dhe konkretizimin e orientimeve të Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës në të gjitha drejtimet. Është e nevojshme që pranë kësaj Ministrie të krijohet Instituti i Studimeve Pedagogjike. Po kështu, për t'iu përgjigjur detyrave të reja për zhvillimin e gjerë të arsimit profesional, të arsimit pa shkëputje nga puna, të lidhjes së mësimin me punën prodhuese dhe edukimin fizik e ushtarak, duhet të pësojë ndryshimet e plotësimet përkatëse edhe struktura e aparatit të kësaj Ministrie, e organeve të saja në rrethe si dhe e drejtorive të shkollave.

E dyta, duhet të përmirësohet rrënjësisht puna e organeve shtetërore dhe ekonomike, të qendrës dhe të rretheve, për zgjidhjen e problemeve të arsimit, për mbarëvajtjen dhe drejtimin e shkollës. Në kushtet e zgjerimit të mëtejshëm që po merr e do të marrë arsimit ynë dhe të lidhjes organike të mësimin me punën prodhuese dhe edukimin fizik e ushtarak, duhet organizuar në një shkallë më të lartë bashkëveprimi midis ministrive, si

dhe midis ndërmarrjeve shtetërore, kooperativave bujqësore dhe shkollave, duhet të aktivizohen intensivisht të gjitha organet shtetërore dhe ekonomike, sidomos komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, për të gjitha çështjet e organizimit të punës prodhuese të shkollave, për ndihmën e ndërmarrjeve për shkollat pa shkëputje nga puna etj.

Me zgjerimin e vrullshëm të shkollave të mesme profesionale, me shkëputje dhe pa shkëputje nga puna, në të ardhshmen drejtimi i tyre do të bëhet nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, ashtu siç drejtohen sot prej këtyre edhe shkollat e mesme të përgjithshme; kurse drejtimi i shkollave të ulëta profesionale do bëhet nga vetë ndërmarrjet përkatëse si dhe nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve. Kjo kërkon që, krahas forcimit të punës së Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës e të organeve të arsimit në bazë, gjithë dikasteret qendrore të shkunden për të ndihmuar me të gjitha mënyrat zbatimin e detyrave të reja në fushën e arsimit.

Byroja Politike mendon se Komisioni Qendror për Arsimin pranë Komitetit Qendror të Partisë duhet të vazhdojë të funksionojë edhe në të ardhshmen për drejtimin e përgjithshëm të zbatimit të masave për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës.

E treta, duhet të përmirësohet rrënjësisht puna e organizatës së pionierëve, e sidomos të rinisë, në shkolla dhe të rritet kontributi i tyre për mbarëvajtjen e shkollës. Këto organizata kanë luajtur e luajnë çdo ditë e më shumë një rol aktiv në edukimin komunist të brezit të ri. Megjithatë, puna e përditshme e tyre nuk u përgjigjet akoma në shkallën e duhur detyrave të mëdha që u takojnë atyre në fushën e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës. Në veprimtarinë e tyre në shkolla ka akoma formalizëm, shfaqje të theksuara të metodës burokratike në punë, huazim mekanik të metodave e formave të huaja të papërshtatshme për shkollën tonë. Në kushtet e tanishme është e domosdoshme të luftohet më me hov për kapërcimin e këtyre të metave, për një gjallërim të mëtejshëm dhe të pandërprerë të jetës së rinisë në shkollë. Gjithë veprimtaria e organizatës së rinisë dhe të pionierëve në shkollë duhet të ketë për objekt edukimin komunist të rinisë, forcimin e disiplinës proletare në shkollë, forcimin e vetëveprimit, të vetëkontrollit dhe të vetëdisiplinës së rinisë, bashkëpunimin e ngushtë me udhëheqjen shtetërore të shkollës, vënien në jetë të mësimave të Partisë në shkollë dhe jashtë saj.

E katërta, duhet të përmirësohet rrënjësisht puna drejtuese e Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm e të gjithanshëm

të shkollës. Kjo kërkon që të intensifikohet më tepër lufta e filluar gjatë diskutimit popullor, për të kapërcyer përfundimisht mungesën e kujdesit të nevojshëm nga ana e organeve dhe organizatave të Partisë për shkollën. Udhëheqja e Partisë mbi shkollën duhet të forcohet në përshtatje me kërkesën e përgjithshme që në punën e Partisë t'i jepet kurdoherë e në çdo rast prioritet anës politike dhe ideologjike të problemeve, duke e bërë mirë të qartë për të gjithë se sektori i arsimit është një nga sektorët më të rëndësishëm e të ndërlikuar të frontit ideologjik.

Krahas forcimit të interesimit të përgjithshëm për arsimin, komitetet dhe organizatat e Partisë duhet të interesohen edhe për edukimin ideopolitik të mësuesve e të rinisë shkollërore e studenteske. Kjo kërkon që të forcohet puna e Partisë brenda në shkollë, të gjallërohen organizatat e Partisë në shkolla, të forcohet udhëheqja e organizatave të Partisë mbi punën e organizatës së rinisë e të pionierëve dhe të organizatës profesionale të mësuesve dhe të pedagogëve.

Tani një detyrë e ngutshme është t'i përvishemi punës seriozisht e me të gjitha forcat dhe të marrim masat e nevojshme për kalimin gradual në sistemin e ri arsimor dhe përgjithësisht për zbatimin gradual të drejtimeve të ndryshme të revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës.

Përsa i përket arsimit parashkollor, krahas masave që do të merren gjatë periudhës së ardhshme për përgatitjen e kuadrove dhe sigurimin e bazës materiale, është e domosdoshme të merren masa konkrete që me forcat e përbashkëta të shtetit dhe të të gjithë shoqërisë të ecet përpara me guxim në zgjerimin e tij, sidomos në fshat, pa pretenduar plotësimin e menjëherëshëm të të gjitha nevojave materiale dhe të kuadrove me arsimin përkatës. Organet shtetërore të planifikimit, çdo vit, duhet të parashikojnë rritjen e kopshteve për fëmijë në qytet, e sidomos në fshat; duhet të nxitet hapja e kopshteve nga vetë ndërmarrjet ekonomike, e veçanërisht nga kooperativat bujqësore, me forcat e veta, dhe brenda mundësive reale, pa pretendime të mëdha, por duke u udhëhequr nga metoda revolucionare që ka përdorur Partia jonë që në fillim për luftën kundër analfabetizmit dhe për përhapjen e arsimit.

Kalimi në pranimin e fëmijëve në moshën 6 vjeç në shkollë, për shkak se kërkon një numër të madh mësuesish, dhomash për mësim dhe bazë të gjerë mësimoro-materiale, do të zbatohet duke filluar nga viti shkollor 1971-1972 dhe mund të përfundojë afërsisht në vitin shkollor 1975-1976.

Për realizimin e plotë të arsimit 8-vjeçar brenda tre vjetëve të ardhshëm, do të hapen shkolla të reja për të plotësuar këtë detyrë. Në lidhje me këtë, duhet të përhapet inisiativa për

ngritjen e konvikteve pranë kooperativave bujqësore, të inku-rajohet inisiativa e madhe e solidaritetit komunist të kooperativave të fuqishme ekonomikisht për të tërhequr në konviktet e tyre, me shpenzimet e tyre, fëmijët e kooperativave të zonave malore që janë më pak të fuqishme ekonomikisht, për të mbaruar shkollën 8-vjeçare. Shteti do të marrë masa për zgjerimin e konvikteve, për rritjen e numrit të bursave dhe për përgatitjen e numrit të nevojshëm të mësuesve të rinj për këto shkolla.

Për zgjerimin e masivizimin e arsimit të mesëm, krahas rritjes së numrit të nxënësve në të gjitha shkollat e mesme ekzistuese si dhe shtimit të shkollave të mesme pa shkëputje nga puna, gradualisht, në bazë të nevojave, kushteve dhe mundësive konkrete të çdo rrethi, duke filluar nga viti shkollor 1970-1971 do të hapen shkolla të reja të mesme jo vetëm në qytet, por edhe në fshat, duke u dhënë prioritet shkollave të mesme profesionale.

Programet dhe tekstet e reja për shkollat 8-vjeçare dhe të mesme do të zbatohen gradualisht, duke filluar nga viti shkollor 1972-1973 dhe parashikohet që ky proces të përfundojë brenda vitit 1975. Kurse shkollat e larta do të fillojnë t'i zbatojnë gradualisht planet, programet dhe tekstet e reja që nga viti shkollor 1971-1972. Deri në periudhën që do të përgatiten tekstet e reja, shkollat do të punojnë me tekstet ekzistuese, të cilat do të përmirësohen çdo vit pjesërisht dhe do të ribotohen.

Zbatim i strukturës së re të vitit shkollor mbi bazën e trekëndëshit *mësim - punë prodhuese - edukim fizik e ushtarak* do të fillojë që vitin e ardhshëm shkollor e do të plotësohet gradualisht brenda 2-3 vjetëve të ardhshëm. *Stazhi në prodhim* pas mbarimit të shkollës së mesme mund të fillojë të zbatohet pjesërisht në vitin shkollor 1972-1973 dhe plotësisht në vitin shkollor 1973-1974.

Gjatë vjetëve të ardhshëm do të merren masat e nevojshme për përgatitjen e mijëra kuadrove arsimorë që do të duhen për vënien në jetë të sistemit të ri arsimor. Gjithashtu, do të merren masa për zgjerimin dhe pasurimin e bazës materialo-mësimore e teknike të shkollave në përputhje me detyrat e reja.

Të gjitha këto masa do të krijojnë mundësi që të kalohet në zbatimin frontal të sistemit të ri arsimor duke filluar nga vjetët shkollorë 1971-1972 dhe 1972-1973 dhe duke u shtrirë gradualisht nga viti në vit. Ne mendojmë se i kemi mundësitë për zbatimin e sistemit të ri arsimor, në vija të përgjithshme, brenda periudhës 1971-1976, përveç realizimit të plotë të arsimit parashkollor dhe të arsimit të mesëm për gjithë rininë që do të duan një kohë më të gjatë për t'u vënë në jetë, në përputhje me mundësitë tona reale.

Të gjitha këto janë detyra të mëdha e të ndërlikuara. Prandaj, Këshilli i Ministrave, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës si dhe institucionet dhe organet e saj vartëse, Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Mbrojtjes Popullore, Ministria e Financave, të gjitha dikasteret dhe institucionet qendrore të interesuara, si dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve duhet të përcaktojnë në mënyrë të hollësishme masat konkrete për detyrat që u dalin dhe të përgjigjen për zbatimin e tyre.

Shokë,

Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës është një aksion i madh revolucionar në luftën për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. Ai është një dëshmi tjetër e madhe e zbatimit krijues të marksizëm-leninizmit nga Partia jonë, e luftës së saj të papajtuashme kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste, e shpirtit të saj sulmues e novator, e guximit të saj të papërkulur revolucionar për të ecur edhe nëpër shtigje të reja, të pashkeluara ndonjëherë.

Kontributi i Partisë sonë në fushën e teorisë e të praktikës së shkollës socialiste shprehet sidomos në kritikën e gjithanshme të të metave të shkollës së vjetër, të koncepteve borgjeze e revizioniste, dhe në përpunimin e vendosjen e koncepteve marksiste-leniniste për shkollën; në përcaktimin e rrugëve konkrete për zbatimin e mësimëve të klasikëve të marksizëm-leninizmit në lëmin e arsimit e të shkollës; në dhënie të prioritetit absolut boshtit ideologjik marksist-leninist, duke ia nënshtruar këtij boshti gjithë punën e shkollës; në realizimin konsequent e praktik të ëndrrës së Marksit për një shkollë me bazë trekëndëshin: *mësim - punë prodhuese - edukim fizik e ushtarak*; në politeknizimin e mëtejshëm të shkollës, duke vënë në jetë amanetin e Leninit për një shkollë politeknike; në ndërtimin e një sistemi të tërë unik dhe të plotë shkollash të të gjitha llojeve e kategorive për punëtorët e fshatarët, duke çelur kështu rrugën për ngritjen e nivelit të njohurive shkencore dhe teknike të tyre deri në nivelin e personelit inxhiniero-teknik; në zbatimin e gjerë të demokracisë socialiste, të kontrollit punëtor e të vijës së masave në punën e shkollës e në drejtimin e arsimit popullor.

Shkolla jonë e re është diametralisht e kundërta e shkollës borgjeze dhe revizioniste. Ndërsa shkolla borgjeze dhe revizio-

niste është armë në duart e borgjezisë dhe i shërben asaj për forcimin e diktaturës borgjeze, shkolla jonë socialiste është armë në duart e klasës punëtore për ndërtimin e socializmit, për të forcuar diktaturën e proletariatit dhe për të siguruar fitoren e plotë e përfundimtare të marksizëm-leninizmit e të rrugës socialiste.

Në shkollat borgjeze e revizioniste mësojnë kryesisht fëmijët e klasave sunduese, të pasanikëve, të borgjezisë së vjetër e të re, kurse te ne mësojnë fëmijët e popullit punonjës, të klasës punëtore, fshatarësisë kooperativiste, inteligjencies popullore.

Ndërsa shkolla borgjeze dhe revizioniste thëllon çdo ditë e më shumë antagonizmin e dallimet esenciale midis qytetit e fshatit, punës mendore e punës fizike, shkolla jonë socialiste ndihmon aktivisht për ngushtimin, pastaj edhe për zhdukjen e dallimeve esenciale në këto fusha.

Shkolla borgjeze e revizioniste e thëllon hendekun që ndan nxënësit e studentët nga punëtorët e fshatarët, kurse shkolla jonë socialiste i afron dhe i shkrin ata me punëtorët e fshatarët, i përgatit dhe i edukon që t'u shërbejnë atyre me të gjitha forcat.

Shkolla borgjeze dhe revizioniste i helmato të rinjtë me ideologjinë borgjeze e revizioniste, e çorodit dhe e degjeneron rininë, kurse shkolla jonë socialiste e përgatit brezin e ri për të qenë një brez revolucionar marksist-leninist, i vendosur deri në fund për çështjen e revolucionit, të socializmit e të komunizmit.

Në shkollën borgjeze dhe revizioniste nxënësit dhe studentët shtypen egërsisht nga regjimi, nga diktaturat borgjeze dhe klikat revizioniste në fuqi dhe revoltohen e luftojnë me të drejtë kundër tyre, kurse në shkollën tonë revolucionare konsekuente lulëzon demokracia socialiste dhe nxënësit e studentët qëndrojnë në pararojë të luftës për ta mbrojtur diktaturën e proletariatit, e cila prandaj edhe i armatos ata.

Ndërsa shkolla borgjeze dhe revizioniste është në gjendje konfuzioni të vazhdueshëm, në rrugën e shturjes dhe të degjenerimit, në kalbëzim të pandalshëm, shkolla jonë e re, socialiste, zhvillohet e forcohet, përparon e lulëzon çdo ditë, çan përpara me guxim drejt majave më të larta të socializmit e të komunizmit.

Diskutimi popullor për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, duke afirmuar këto tipare revolucionare marksiste-leniniste të shkollës sonë, vërtetoi edhe një herë plotësisht konkluzionin e shokut Enver në Fjalën e tij të 7 marsit të vitit të kaluar se në këtë çështje, si dhe përgjithësisht në çështjen e zhvillimit të mëtejshëm të revolucionit socialist, ne nuk mund të mos kemi parasysh edhe eksperiencën e hidhur të katastro-

fës që i ndodhi Partisë Bolshevike pas vdekjes së Stalinit, se për këtë arsye duhet

«... të mos i harrojmë për asnjë çast të gjitha këto situata, këto rreziqe, ta kemi kokën të qartë dhe dorën të hekurt kundër armiqve të popullit, të Partisë dhe të socializmit, të kemi të qartë rolin e masave dhe rëndësinë kolosale të brezit të ri që fuqizon të tanishmen dhe siguron të ardhshmen; të mos harrojmë kurrë se në të gjithë këtë luftë të madhe që zhvillon me sukses Partia, lufta për ndërtimin me sukses të një shkolle të re socialiste është një nga detyrat tona më të mëdha dhe më delikate, për të cilën kemi bindjen e plotë se Partia, si kurdoherë, për këtë dhe për çdo gjë, do të dalë me sukses»¹.

Ne kemi besim të patundur se, të ndriçuar nga ideologjia jonë ngadhënjimtare marksiste-leniniste dhe nga vija revolucionare konsekuente e Partisë sonë dhe mësimet e shokut Enver, ashtu si kurdoherë, do t'i zbatojmë me nder edhe detyrat tona për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë.

Të hidhemi, pra, shokë, në veprim, me besim në forcat tona, për zbatimin konkret të detyrave të mëdha, me rëndësi historike, që dalin para nesh për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë, për ta çuar gjithmonë përpara revolucionin tonë të pandërprerë edhe në fushën e arsimit, për të mirën e lumturinë e popullit tonë, për triumfin përfundimtar të rrugës socialiste në vendin tonë!

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 154 (6506), 29 qershor 1969*

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 389.

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI KONKLuzionet E Diskutimit Popullor Për Revolucionarizimin E Mëtejshëm Të Shkollës Sonë»

28 qershor 1969

Plenumi VIII i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 26 deri 28 qershor 1969, pasi dëgjoi dhe diskutoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi konkluzionet e diskutimit popullor për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë», mbajtur nga anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe kryetar i Komisionit Qendror për Arsimin pranë Komitetit Qendror të Partisë, shoku Mehmet Shehu,

V e n d o s i :

1. — Të aprovojë plotësisht raportin e Byrosë Politike mbi konkluzionet e diskutimit popullor për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë.

2. — Të ngarkojë Byronë Politike të Komitetit Qendror dhe Këshillin e Ministrave që të marrin të gjitha masat e nevojshme për të vënë në jetë detyrat që kanë lidhje me revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës.

3. — Të porositen të gjitha organizatat e Partisë, organet shtetërore e ekonomike dhe organizatat e masave që t'i studjojnë thellë vendimet dhe dokumentet e Partisë mbi revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës dhe ta ndërtojnë gjithë punën në mënyrë që të sigurojnë zbatimin me sukses të detyrave që rrjedhin prej tyre.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 154 (6506), 29 qershor 1969*

O R I E N T I M E

TË BYROSË POLITIKE TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË «MBI AKTIVIZIMIN DHE EDUKIMIN E MËTEJSHËM TË PENSIONISTËVE DHE TË INVALIDËVE»

13 shtator 1969

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, pasi shqyrtoi punën që kanë bërë Partia, organet shtetërore dhe organizatat e masave për aktivizimin dhe për edukimin e mëtejshëm të pensionistëve dhe të invalidëve, konstatoi me kënaqësi se gjendja moralo-politike e pensionistëve dhe e invalidëve është shumë e shëndoshë, se ata janë të rrethuar me respektin dhe me kujdesin e madh të Partisë, të shtetit dhe të gjithë shoqërisë, për gjithë atë çka kanë bërë e po bëjnë për të mirën e atdheut, të popullit e të Partisë.

Pensionistët janë një forcë e rëndësishme e cila mund të shërbejë akoma gjatë. Në të ardhshmen numri, e veçanërisht niveli dhe eksperiencia e atyre që do të dalin në pension do të rritet. Brezi që i vjen radha të dalë në pension është ai që bëri Luftën Nacionalçlirimtare, që kreu revolucionin, që u kalit në vështirësitë e vjetëve të parë të pasçlirimit, që mposhti bllokadat imperialisto-revizioniste, që është rrahur fort në dallgët e jetës dhe që nën udhëheqjen e Partisë ka dalë fitimtar. Brezat e ardhshëm gjithashtu do të kenë një aktiv të lavdishëm dhe eksperiencë më të përparuar.

Pensionistët e përgjithësisht të moshuarit që kanë luftuar e kanë punuar tërë jetën, pavarësisht nga niveli i arsimit të përgjithshëm e profesional që kanë, janë një thesar i madh i popullit, që kanë grumbulluar një eksperiencë të pasur fitimtare në të gjitha fushat e jetës. Është detyra e Partisë, e organeve shtetërore dhe e organizatave të masave që të dijnë, në mënyrë më të organizuar të shfrytëzojnë sa më shumë këtë kapital të madh për të mirën e atdheut e të socializmit.

Partia kërkon që pensionistët gjatë gjithë jetës, jo vetëm të mbështetin kudo e kurdoherë vijën e Partisë, por me punën

dhe me qëndrimet e tyre të bëhen një shembull i madh frymëzimi për brezat e ardhshëm. Ata janë pjesë e gjallë e historisë së popullit tonë, e virtyteve dhe traditave të larta të tija, të cilat nuk mund të hidhen të tëra në libra e as që mund të mësohen vetëm në shkolla, por që trashëgohen brez pas brezi në shekuj.

Prandaj Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH,

P o r o s i t:

I

Organizatat e Partisë dhe ato të masave, organet shtetërore dhe të ekonomisë ta konsiderojnë punën për edukimin e mëtjetshëm dhe për aktivizimin e pensionistëve dhe të invalidëve si një problem të rëndësishëm politik, ideologjik, shoqëroro-ekonomik dhe organizativ. Gjithë puna për edukimin dhe për aktivizimin e pensionistëve të zhvillohet në bazë të mësimëve të Partisë dhe të shokut Enver, duke mbajtur parasysh dhe orientimet e mëposhtme:

A) *Të rrënjosen koncepte sa më të drejta mbi daljen në pension dhe mbi pensionistët.*

Propaganda e Partisë, duke përdorur mjete dhe forma të ndryshme, të luftojë më me forcë kundër koncepteve të padrejta mbi daljen në pension dhe pensionistët, duke e konsideruar këtë punë, si pjesë të pandarë e të vazhdueshme të luftës për edukimin komunist të njerëzve, për vënien e interesit të përgjithshëm mbi atë personal, për krijimin e koncepteve të drejta në qëndrimin ndaj punës, për vlerësimin dhe për shfrytëzimin e drejtë të kohës, për shfrytëzimin sa më të mirë të traditave revolucionare të popullit e të Partisë etj.

Të luftohet me forcë dhe si diçka ideologjike dhe shtrembër, çdo shfaqje nënvlefësimi ndaj aftësive fizike, morale, intelektuale, teknike, organizative të pensionistëve e të të moshuarve. Organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë, organizatat e masave, kuadrot dhe brezi ynë i ri, nuk duhet të lejojnë që ky kapital i çmuar njerëzish të mbetet mënjanë, atyre nuk u lejohet ta humbasin apo të mos e vlerësojnë gjithë eksperiencën që kanë grumbulluar pensionistët e përgjithësisht të moshuarit. Këto vlera nuk duhen trajtuar në mënyrë idealiste, por ky thesar i madh mendor, moral e shoqëror duhet të vihet deri në fund në shërbim të popullit e të socializmit.

Partia duhet të bëjë një luftë të vendosur kundër egoizmit profesional dhe sedrës së sëmurë që ekzistojnë te disa specialistë të ndryshëm. Këta, dhe të gjithë, duhet të kenë parasysh

mësimin e Partisë se «të mësosh nga eksperiencia e tjetrit është një gjë e domosdoshme, ashtu siç është e domosdoshme të mësosh edhe nga eksperiencia jote». Ky mësim është i vlefshëm edhe për pensionistët e të moshuarit e tjerë, të cilët gjithashtu duhet të vazhdojnë të mësojnë si nga të rinjtë, ashtu dhe nga të tjerët dhe të mos e mbivlerësojnë eksperiencën e tyre.

Mendimet se shkenca, teknika, organizimi i ndërmarrjes apo i shkollës ka ecur përpara dhe pensionistët kanë mbetur prapa, prandaj nuk kanë ç'japin, nuk janë të drejta. Brezat që jetojnë nuk i ndajnë shekuj nga njëri-tjetri, ata vazhdojnë punën e njëri-tjetrit. Veç kësaj, edhe në kushtet e progresit teknik, çdo punonjës apo kuadër me eksperiencë të gjatë dhe me ndërgjegje të mirë ideopolitike e profesionale, është në gjendje të japë kontributin e tij të dobishëm dhe të ndihmojë në ecjen përpara të këtij progresi.

Të gjithë kanë nevojë t'i përdorin pensionistët, prandaj puna për aktivizimin e tyre nuk duhet të shikohet si një detyrë suplementare, si një barrë që kryhet për dikë tjetër, por si një nevojë për të rritur rezultatet e punës. Socializmi është vepër e masave të udhëhequra nga Partia dhe ky jo vetëm ka nevojë, por krijon edhe mundësi të gjera për shfrytëzimin e plotë të aftësive fizike e mendore të njerëzve, pavarësisht nga mosha.

Pensionistët, pa përjashtim, duhet të mendojnë se për t'i shërbyer popullit dhe Partisë nuk janë kurrë pleq. Edhe kur të jenë plakur fizikisht, Partia dhe populli kanë nevojë të madhe për këshillat dhe për mendimet e tyre krijuese, të fituara gjatë gjithë jetës plot punë e vetëmohim.

Pensionet dhe sigurimet shoqërore, janë fitore të mëdha të punonjësve tanë të arritura në pushtetin popullor, nën udhëheqjen e Partisë, që zhduku çdo frikë e shqetësim për jetesën në pleqëri dhe gjatë kohës që zgjat paaftësia për punë. Por dalja në pension duhet të kuptohet drejt politikisht dhe ideologjikisht. Të dalësh në pension, duke ia lënë vendin një tjetri më të riu, nuk do të thotë të mos punosh më, nuk do të thotë të tërhiqesh nga jeta dhe nga lufta revolucionare.

Partia, me punën e saj, duhet t'i ruajë pensionistët nga konceptet e ngushta e të vjetra mbi jetën, mbi «pleqërinë e bardhë» brenda mureve të shtëpisë, nga inercia e rehatisë mikroborgjeze. Për çdo njeri në Republikën Popullore të Shqipërisë, pavarësisht nga mosha, nuk mund të ketë kënaqësi më të madhe, jetë dhe fund më të lumtur, se të marrë pjesë aktive në luftën vigane për t'i shërbyer popullit, atdheut e Partisë. Komunistët dhe çdo patriot do të dalin në pension në bazë të ligjeve të shtetit, por për ata puna duhet të vazhdojë derisa të kenë këmbë e dorë dhe mend në kokë.

Realiteti i vendit tonë, përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës dhe të jetesës, kanë sjellë rritjen e moshës mesatare të jetës së popullsisë, zgjatjen e saj, prandaj pikëpamjet e shfaqura te disa punonjës e sektorë për të dalë sa më shpejt në pension, janë në kundërshtim me këtë realitet dhe e kanë bazën në pikëpamjet mikroborgjeze për t'i dhënë shoqërisë më pak e për të marrë prej saj më shumë.

Aktivizimi i pensionistëve bëhet mbi baza vullnetare, si një punë shumë e dobishme shoqërore që nxitet nga dëshira dhe detyra që ka çdo pensionist për t'i shërbyer shoqërisë, për të jetuar e për të punuar, derisa të ketë jetë, si revolucionar. Prandaj ata në mënyrë të organizuar të futen në masat, të shkrihen me to dhe të marrin pjesë në edukimin e tyre si aktivistë shoqërorë. Ata duhet të dëgjojnë me kujdes zërin e masës dhe t'ia transmetojnë atë organeve të Partisë e të pushtetit, të cilat duhet t'i dëgjojnë me kujdes.

Të gjitha punët që i shërbejnë shoqërisë, atdheut, që kanë të bëjnë me zbatimin e mësimave të Partisë janë të rëndësishme, të dobishme e të nderuara, prandaj duhen luftuar pikëpamjet që nënçmojnë punët shoqërore, sedra mikroborgjeze që i konsideron «të vogla», jo «dinjitoze», punët në lagje, në fshat, punën prodhuese midis popullit e rinisë. Është më e dobishme për shoqërinë që një ish-oficer ose kuadër tjetër të punojë midis punëtorëve të rinj të NISH-Cigares, kantierit detar, uzinës së sodës kaustike etj., apo midis fshatarëve kooperativistë, se sa të zërë një qoshe sa për të marrë një shpërblim e ca më keq të mos punojë fare.

Edukimi i pensionistëve duhet të bëhet nëpërmjet të gjithë punës që bën Partia për edukimin e masave, të komunistëve dhe të kuadrove, por megjithatë, duke marrë parasysh se këta janë një kategori më vete, me kërkesa e me detyra të veçanta, kërkohet edhe një punë politike dhe ideologjike e veçantë. Problemi i parë është që pensionistët të vazhdojnë punën për edukimin komunist të tyre, të ruajnë e të formojnë pikëpamje të drejta mbi të gjitha gjërat, të mbështetin vijën e Partisë, aksionet e saj, të ndihmojnë rininë të ecë përpara, të përkrahin e të ndihmojnë gratë, motrat, nënat, vajzat apo mbesat e tyre që ato të përparojnë në rrugën që u ka caktuar Partia. Partia duhet t'i mbajë mirë në korrent të situatave të gjithë pensionistët dhe invalidët edhe kur ata janë të sëmurë, të ketë në radhët e tyre agjitorët e saj, të shfrytëzojë të gjitha mundësitë që ata të shohin, të jetojnë e të gëzojnë realitetin e vendit tonë gjithnjë.

B) Për aktivizimin e pensionistëve.

Duke luftuar politikisht dhe ideologjikisht konceptet e gabuara mbi daljen në pension dhe pensionistët, si dhe kundër punës së ngushtë organizative, duhet të sigurohet aktivizimi i gjerë i pensionistëve dhe invalidëve.

Mbështetur në eksperiencën e deritanishme, aktivizimi i pensionistëve të bëhet në këto drejtime kryesore:

1. — Në edukimin patriotik të punonjësve, veçanërisht të brezit të ri. Pensionistët nuk duhet të lodhen kurrë, por të jenë agjitorë dhe propagandistë aktivë të Partisë për të ruajtur dhe për të transmetuar brez pas brezi traditat luftarake patriotike të popullit tonë, veçanërisht epopenë e Luftës Nacionalçlirimtare. Ushtarakët e të gjitha rangjeve, tani në pension, dhe të gjithë ata që kanë marrë pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare, duhet të jenë në ballë të punës që bën Partia për edukimin patriotik të rinisë. Duke qenë në radhët e ushtrisë këta kanë bërë një shkollë të madhe, prandaj eksperiencën, edukatën dhe disiplinën që kanë fituar duhet t'ua japin edhe të tjerëve. Ata do t'i bëjnë një shërbim të madh atdheut, brezit të ri, duke u angazhuar seriozisht që të shkruajnë kujtimet dhe eksperiencën e tyre nga lufta dhe nga puna, të marrin pjesë aktive në përpilimin e historikëve të lagjeve, fshatrave, qyteteve, rretheve, reparteve, kooperativave, ndërmarrjeve, shkollave apo të organizatave ku kanë milituar. Të gjithë anëtarët e bashkimit të rinisë, bijtë, niprit dhe stërniprit, do të jenë vazhdimisht në dispozicion të tyre që t'ua lehtësojnë këtë detyrë.

Pensionistët patriotë, pavarësisht nga mosha, nuk duhet të pushojnë, për asnjë çast të jenë ushtarë të Republikës e të qëndrojnë kurdoherë në roje për të mbrojtur Partinë, popullin e atdheun tonë socialist nga armiqtë imperialisto-revizionistë dhe shërbëtorët e tyre. Në rolin e oficerit apo të ushtarit, të komandantit apo të komisarit, duhet të marrin pjesë rregullisht në çetat e batalionet vullnetare, në MCR e në formacione të tjera luftarake dhe, në shembullin e tyre, të përgatitin për akte heroizmi në masë brezin e ri.

Njohja e brezit të ri me të kaluarën e vendit tonë, me vështrirësitë e vjetëve të parë pas Çlirimit, me luftën e papërkulur kundër armiqtë për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut, janë gjithashtu fusha shumë të rëndësishme për aktivizimin e pensionistëve.

2. — Në shfrytëzimin më të mirë të eksperiencës së tyre në punë. Punëtorët, teknikët, inxhinierët, agronomët, ekonomistët, e të gjithë specialistët e tjerë të prodhimit, ashtu edhe drejtuesit e ndërmarrjeve, kooperativave dhe institucioneve të

ndryshme, që kanë punuar tërë jetën me ndërgjegje për të mirën e atdheut, kur dalin në pension duhen përdorur në mënyrë të organizuar, duke u krijuar edhe kushte të përshtatshme pune, që të gjithë eksperiencën e madhe që kanë t'ua japin të tjerëve. Këta duhen aktivizuar për probleme konkrete të prodhimit, për prodhime të reja, për mekanizimin e proceseve të punës, për përmirësimin e teknologjisë së prodhimit; ata duhet të aktivizohen gjerësisht në revolucionin tekniko-shkencor, të bëjnë studime e punime shkencore, duke u dhënë të gjithë përkrahjen e nevojshme.

Në forma nga më të ndryshmet, pensionistët duhet t'ua japin eksperiencën e tyre kuadrove të rinj, duke filluar që nga ndihma në punë të vazhdueshme, në sistemin e patronazhit, duke i caktuar si drejtues e mësues në kurse e shkolla profesionale e në pallatet ose shtëpitë e pionierëve, duke i ngarkuar bashkërisht me të rinjtë për studime, projekte e zbatime, për përgatitje temash, referatesh, kumtesash etj. Gjithashtu në shpërndarjen dhe në rishpërndarjen e kuadrove, në qarkullimin e tyre nga qendra në bazë, nga qyteti në fshat, nga spitali në klinikë, nga shkolla në ndërmarrje dhe anasjelltas, duhet të mbahet mirë parasysh që kuadrove të rinj t'u krijohet mundësia për të mësuar nga më të moshuarit. Kjo nuk është një punë mekanike dhe as që rregullohet vetëm me lëvizjet ose me planet që mund të bëjmë në qoftë se kjo domosdoshmëri nuk kuptohet ideologjikisht e politikisht dhe në qoftë se nuk thyhet ideologjikisht rutina dhe mendjemadhësia që na pengojnë në këtë drejtim.

Pensionistët e frontit të arsimit dhe të kulturës, të cilët gjithashtu përbëjnë një numër të madh, duhet të mos shpëputen nga shkollat dhe nga skenat, nga fëmijët, nga bashkëpunëtorët e tyre, të grumbullojnë folklorin dhe leksikun e pasur e të bukur të popullit tonë, të aktivizohen gjerësisht në biblioteka dhe në vatrat e kulturës, në mensat e shkollave, në muzeume, në shtëpitë e pionierit, në kabinetet pedagogjike etj. Organizatat e rinisë dhe ato të bashkimeve profesionale duhet të përdorin gjerësisht punonjësit e kulturës pensionistë për të organizuar e për të drejtuar aktivitetet kulturalo-artistike në qendra pune, shkolla dhe fshatra. Pensionistët nga radhët e punonjësve të arsimit e të kulturës duhet të përdoren më tepër edhe në luftën kundër zakoneve prapanike e besimeve fetare, për një jetë më të kulturuar në lagje, fshat, qendra pune, në familje e kudo. Populli ka nevojë për talentin, kulturën dhe eksperiencën e tyre.

Kurse pensionistët mjekë, mami, infermierë dhe gjithë pensionistët e tjerë nga radhët e punonjësve të shëndetësisë, të cilët kanë një eksperiencë të pasur dhe kanë fituar një ndërgjegje

të lartë në luftën për të shpëtuar jetën e njeriut, duhet të vazhdojnë të jenë aktivistë të dalluar të Partisë, në luftën për përmirësimin e shëndetit të popullit.

Në luftë për një jetë më të kulturuar, më të pastër e më të bukur, pensionistët duhet të gjejnë një front shumë të gjerë pune. Kontributi vullnetar për ndërtimet në lagje, për parqe, lulishte, rrugë, për të ndihmuar kooperativat në fshat etj., duhet të nxitë më shumë rininë tonë, e cila duke u frymëzuar nga më të moshuarit të hidhet e tëra në aksion.

3. — *Jo të gjithë ata që plotësojnë moshën për të dalë në pension medoemos të nxirren në pension.* Ata që janë në gjendje të punojnë, kur i lejon shëndeti, kur kanë dëshirë të punojnë dhe kur shoqëria ka nevojë për punën e tyre, mund të vazhdojnë të punojnë me orar të plotë ose të kufizuar edhe pasi plotësojnë moshën e pensionit.

Organet e Partisë dhe të shtetit, duhet të krijojnë kushte pune të përshtatshme për shumë punonjës të shquar të prodhimit, të institucioneve shkencore e mësimore, të aparateve të Partisë e të shtetit, ushtarakë e kudo, me qëllim që edhe pasi plotësojnë moshën për të dalë në pension, të japin ndihmën dhe eksperiencën e tyre të çmuar. Këta të lehtësohen nga disa përgjegjësi e aktivitete, që të mund të merren kryesisht me ato punë ku mund të japin më shumë e që ka më shumë nevojë atdheu. Pranë këtyre të caktohen të punojnë si bashkëpunëtorë, ndihmës apo zëvendëskuadro të aftë e me perspektivë, që jo vetëm t'i lehtësojnë kuadrot e moshuar, por edhe të mësojnë prej tyre e të rriten. Të ndryshohet koncepti i padrejtë që ekziston disa herë për zëvendësit, si kadro më pak të përgjegjshëm, që nuk janë «as zbatues as drejtues».

Disa kadro të rëndësishëm që kanë eksperiencë të madhe, kur mbushin moshën e pensionit, mund të shkarkohen nga përgjegjësitë që kanë e të mbahen mbi organikën si këshilltarë. Këta do të jenë në numër të kufizuar në organet e Partisë e të shtetit si në qendër e në rrethe, në kombinat ose pranë disa ndërmarrjeve të rëndësishme, në reparte ushtarake, në institucione shkencor-mësimore, në spitale dhe në ndonjë rast tjetër që do të gjykohej me vend nga ministritë përkatëse.

Për të pasur një punë më me perspektivë, duhet të njihet me saktësi gjendja e punonjësve në çdo qendër pune, në mënyrë që të merren masa që lëvizja natyrale e krahëve të punës, e specialistëve dhe e kuadrove të bëhet në rrugë normale dhe që puna të shkojë përpara.

C) *Organet e Partisë dhe ato shtetërore të tregojnë kujdes të veçantë që pensionistët, shpirtërisht, moralisht e politikisht të mos shpëputen nga vendi i tyre i punës.*

Ata duhet të ruajnë gjithë jetën lidhjet me kolektivin e vjetër të tyre, i cili ka shumë nevojë për ta, por që edhe pensionistët kanë nevojë për ngrohtësinë e kolektivit ku kanë milituar pjesën më të gjallë të jetës së tyre. Por që këto lidhje të mos mbahen vetëm simbolike, është e nevojshme që pensionistët të vihen para kërkesave konkrete dhe të secili prej tyre të krijohen preokupacione të vazhdueshme për ndërmarrjen apo për institucionin ku ata kanë punuar. Ata, sipas rasteve, të thërriten në mbledhjet e hallkave të ndryshme për problemet që preokupojnë ndërmarrjen apo institucionin dhe kur e meritojnë të mbahen edhe në këshilla apo byro teknike, në kolegjiune apo këshilla pedagogjike etj.

Ata punëtorë e nëpunës pensionistë, që janë në gjendje të ndjekin qoftë dhe pa orar të caktuar jetën e ndërmarrjes, mundet që të vazhdojnë të militojnë edhe si anëtarë të organizatës profesionale të ndërmarrjes ose të qendrës së punës ku kanë qenë. Komunistët pensionistë anëtarë dhe kandidatë të PPSH, që janë në gjendje të aktivizohen në ndërmarrje qoftë edhe disa orë në ditë, ta bëjnë jetën e Partisë në ato organizata-bazë ku kanë qenë para se të dilnin në pension.

Ata pensionistë ose pensioniste që fizikisht nuk e ndjekin dot jetën e ndërmarrjes, ose ata që për arsye të lëvizjeve që kanë bërë nuk e kanë qendrën e punës në vendin e banimit, të militojnë në organizatat e masave në lagje (në organizatën e Frontit e të gruas), pa qenë nevoja të krijohen organizata e organizma të tjera. Gjithashtu komunistët pensionistë që janë po në këto kushte, të bëjnë jetën e Partisë në organizatën-bazë të Partisë në lagje.

Pas daljes në pension, pensionistët mund të japin një kontribut të mirë duke u kthyer në fshatin e lindjes. Vajtja e tyre në fshat të konsiderohet si çështje e rëndësishme partie dhe si një ndihmë e madhe që këta shokë pensionistë do të japin me eksperiencën e tyre për zhvillimin e fshatit tonë socialist. Organizatat e Partisë, ato të masave, këshillat popullore dhe kooperativat bujqësore të tregojnë interesim të madh dhe t'u krijojnë këtyre pensionistëve kushte të përshtatshme për jetesë dhe për të ushtruar aktivitetin shoqëror të tyre.

Ç) Të përdoren me kujdes të gjitha format që stimulojnë aktivizimin e pensionistëve.

Respekti i gjithë shoqërisë për pensionistët është në radhë të parë një stimul shumë i madh. Aktivizimi i tyre bëhet mbi baza vullnetare. Stimuli kryesor për punën e tyre duhet të jetë stimuli moral, duke filluar që nga qëndrimi ndaj këshillave e propozimeve të tyre, nga ftesat në raste festash dhe ngjarjesh

të shënuara, nga vënia në tabela apo dhënia e fletë-nderit dhe deri te dekorata, sipas kontributit që jep secili.

Megjithëkëtë nuk duhen përjashtuar rastet kur shteti, prodhimi, shkenca, kultura etj. kanë nevojë të aktivizojnë pensionistë për kohë dhe punime të caktuara, duke i shpërblyer dhe materialisht.

Për këtë punë dhe ndihmë që kërkojnë Partia dhe shteti nga pensionistët, nuk mund të ketë as orar as norma pune. Orari i punës dhe masa e shpërblimit të caktohet në çdo qendër pune, duke pasur kurdoherë parasysh mundësitë fizike të pensionistëve dhe në marrëveshje me pensionistin, me qendrën e punës dhe organizatën profesionale. Si rregull i përgjithshëm, duhet të pranohet që në rastet kur pensionisti shpërblehet në lekë për punën që bën, ky shpërblim plus pensionin, nuk duhet të kalojë pagën që ka pasur para se të dilte në pension (sipas kategorizimit në fuqi). Të përdoren për këto ato forma shpërblimi që njihen në bazë të ligjeve në fuqi. Veç kësaj, në masën që është e nevojshme, mund t'i caktohet çdo dikasteri për këtë qëllim një fond i veçantë mbi fondin e pagave. Për efekt të llogaritjes së rendimentit të ndërmarrjes, pensionistët që aktivizohen pjesërisht në punë, nuk duhet të llogariten si fuqi punëtore e plotë, por orët e punës që bëjnë efektivisht të konvertohen në ditë-pune punëtori.

Për të gjitha këto Këshilli i Ministrave të caktojë rregullat përkatëse me qëllim që, kur është e nevojshme, organikat dhe fondi i pagave të mos bëhen barrikadë.

D) Të rritet respekti i gjithë shoqërisë për pensionistët.

Te ne, respekti i gjithë shoqërisë për pensionistët e përgjithësisht për brezin e moshuar, nuk është thjesht një rregull mirësjelljeje për më të moshuarin, për flokët e bardhë, por një respekt i fituar në dallgët e jetës, në betejat fitimtare për gjithë atë çka ata kanë bërë për të mirën e atdheut, për atë eksperiencë kolosale që kanë grumbulluar. Ky respekt, i vënë sot në baza më të shëndosha në shoqërinë tonë socialiste në luftë kundër marrëdhënieve patriarkale e kapitaliste, duhet shtuar e forcuar.

Në gjirin e familjes ndodh që lindin e do të lindin herë pas here mosmarrëveshje për probleme të ndryshme midis të rinjve e më të moshuarve, midis prindërve dhe fëmijëve, në marrëdhëniet bashkëshortore ose midis bashkëshortëve dhe të moshuarve në familje etj. por të gjitha këto duhet të zgjidhen në rrugë të drejtë, pa bërë lëshime ideologjike, politike, në rrugën e diskutimeve, të kritikës e të autokritikës për të ruajtur dhe për të forcuar gjithmonë familjen socialiste. Të rinjtë kanë detyrë t'ua bëjnë prindërve të tyre pleqërinë më të lehtë e jetën më të gë-

zuar, sigurisht duke thënë me kurajë fjalën e tyre për pretendimet e padrejta ose kundër koncepteve e qëndrimeve konservatore të të moshuarve. Çdo i ri dhe e re, anëtar i BRPSH-së, të jetë shembull i mirë në këtë drejtim.

Komitetet ekzekutive të ndërtojnë në lagje, qytete e fshatra kënde çlodhjeje për të moshuarit. U rekomandohet kooperativave bujqësore të rritin edhe më shumë kujdesin për pleqtë e paaftë për punë e pa njeri dhe të krijojnë kushte të përshtatshme për mbajtjen e tyre.

II

Të merren të gjitha masat e nevojshme në rrugë partie e shtetërore për uljen e vazhdueshme të përçindjes së invaliditetit dhe të paaftësisë së përkohshme, për riaftësimin fizik e profesional të invalidëve. Ky problem i madh me karakter shoqëror, politik-ideologjik dhe ekonomik duhet kuptuar drejt dhe duhet ndjekur me shumë kujdes nga organizatat e Partisë dhe nën udhëheqjen e tyre nga organizatat profesionale dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e institucioneve të ndryshme. Duke i vlerësuar njerëzit si kapitalin më të çmuar, të rritet ndjenja e dashurisë për shokun, solidariteti ynë socialist, në mënyrë që të gjitha aftësitë njerëzore të përdoren me kapacitet të plotë për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut.

Organet shtetërore të respektojnë rregullat e vendosura për pranimin në punë, me qëllim që njerëzit të vendosen atje ku e lejon gjendja e tyre fizike sipas raportit të mjekut; të luftohet kundër çdo pakujdesie për mbrojtjen në punë dhe sigurimin teknik. Vetë punëtorët nuk duhet të lejojnë të shkelen këto rregulla. Kontrolli punëtor të veprojnë me të gjithë forcën si në drejtim të administratës së ndërmarrjes apo dikasterit, ashtu dhe ndaj punëtorëve të pakujdesshëm. Organet shtetërore të ngarkuara për këtë problem duhet të veprojnë me energji kundër pakujdesive dhe të zbatojnë pa asnjë lëshim kompetencat që u jep ligji për sigurimin teknik dhe të higjienës në punë, duke kombinuar kontrollin shtetëror me kontrollin e klasës punëtore.

Riaftësimi fizik i invalidëve duhet të bëhet gjithashtu problem i kolektivit, i cili duhet të ndikojë mbi administratat, organet e shëndetësisë dhe mbi vetë invalidin që ai të kthehet sa më shpejt i aftë për punë, në gjirin e kolektivit.

Ministria e Shëndetësisë të marrë masa serioze për të përmirësuar këtë shërbim, të kualifikojë kuadrot e nevojshëm brenda dhe jashtë shtetit, të përmirësojë punën në komisionet eksperto-mjeko-punëtor dhe në repartet e posaçme të protezave etj.

Ministria e Financave (Drejtoria e sigurimeve shoqërore dhe e pensioneve) në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, të Tregëtisë dhe të Industri-Minierave të marrin masa për të siguruar më shumë mjete e vegla që do të ndihmojnë në lëvizjen e invalidëve, ose për vënien në shfrytëzim të pjesëve të ndryshme të gjymtuara.

Të gjitha dikasteret, komitetet ekzekutive të rretheve, ndërmarrjet dhe qendrat e tjera të punës të marrin masa serioze për aftësimin profesional të invalidëve, duke synuar që ata në shumicën dërmuese të bëhen përsëri të aftë për punë prodhuese, ashtu siç janë bërë Nuredin Hoxha, Fuat Çela etj. Kjo punë duhet filluar që kur invalidi është në pension dhe, kur e lejojnë mjekët, edhe në sanatoriume ose spitale gjatë kohës që kurohet. Të shfrytëzohet për këtë i gjithë sistemi i shkollave e i kurseve që kemi dhe, po qe nevoja, të çelen kurse e shkolla të veçanta në rrethe, në ndërmarrje, në sanatoriume, në rang dikasteri etj. Të përdoret gjerësisht sistemi i patronazhit, duke u bërë kjo një çështje patriotike për të kthyer një njeri nga të paaftë, në plotësisht të aftë për të mirën e atdheut.

Të gjithë invalidët e riaftësuar duhet të vendosen menjëherë në punë nga vetë ndërmarrjet që i kanë pasur. Por ministrinë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore nga ana e tyre, të krijojnë reparte të veçanta me plan dhe fond page të veçantë për prodhime të ndryshme, si çadra, furça, letër, guarnicione, prodhime elektriku, riparime të ndryshme etj.

Komisionet eksperto-mjeko-punëtor në bashkëpunim me drejtuesit e ndërmarrjeve dhe me organizatën e bashkimeve profesionale të caktojnë konkretisht në çdo rreth e qendër pune, ku është punë e lehtë dhe ku e rëndë, ku e përshtatshme e ku e papërshtatshme për invalidë të ndryshëm.

Kujdesi i vazhdueshëm i Partisë, i pushtetit popullor dhe i gjithë shoqërisë, u ka dhënë invalidëve forcë për të bërë një jetë gjithnjë e më aktive dhe shumë nga këta janë bërë një shembull i madh frymëzimi për të gjithë punonjësit e vendit tonë. Këto qëndrime, ky solidaritet socialist, të ngrihet gjithnjë e më lart.

Për Byronë Politike të KQ të PPSH
Sekretari i Parë
Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI AKTIVIZIMIN DHE EDUKIMIN E MËTEJSHËM TË PENSIONISTËVE DHE TË INVALIDËVE»

13 shtator 1969

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në mbledhjen e datës 13.9.1969, pasi shqyrtoi raportin «Mbi aktivizimin dhe edukimin e mëtëjshëm të pensionistëve dhe të invalidëve»,

V e n d o s i :

1) Puna e Partisë, e organizatave të masave dhe e organeve të shtetit për aktivizimin dhe edukimin e mëtëjshëm të pensionistëve dhe të invalidëve, të zhvillohet mbi bazën e orientimeve që i bashkëngjiten këtij vendimi.

2) I rekomandohet Këshillit të Ministrave që, mbi bazën e problemeve që u paraqitën dhe u diskutuan në këtë mbledhje të Byrosë Politike, të formulojë dhe t'i paraqitë për aprovim Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH përmirësimet që i duhen bërë ligjit të sigurimeve shoqërore shtetërore.

3) Gjithashtu Këshilli i Ministrave të RPSH të studjojë mundësinë e përqëndrimit në një institucion të vetëm të problemeve të marrëdhënieve në punë, të mbrojtjes në punë, të sigurimit teknik, të pensioneve dhe të sigurimeve shoqërore.

Për Byrosë Politike të KQ të PPSH
Sekretari i Parë
Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I KOMITETIT QENDROR TË PPSH DHE I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH MBI ULJEN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË DISA MALLRAVE TË PËRDORIMIT TË GJERË, MBI DISA MASA TË TJERA FAVORIZUESE PËR KOOPERATIVAT BUJQËSORE SI DHE MBI HEQJEN KREJTËSISHT TË SISTEMIT TË TAKSAVE

6 nëntor 1969

Partia e Punës e Shqipërisë, e udhëhequr nga mësimet e marksizëm-leninizmit dhe nga interesat e larta të popullit, ka ndërtuar dhe ka zbatuar hap pas hapi me urtësi dhe me guxim revolucionar një politikë ekonomike të drejtë, si rrjedhim i së cilës populli shqiptar brenda një çerek shekulli ka arritur fitore madhështore. Në vitin 1969 të ardhurat kombëtare në krahasim me vitin 1950 parashikohet të rriten pesë herë më tepër. Sot Shqipëria ka industrinë e saj kombëtare moderne, me teknologji të përparuar, e cila prodhon 58 herë më shumë se në vitin 1938, ose 14 herë më shumë se në vitin 1950. Kolektivizimi i plotë i bujqësisë dhe ndryshimet e thella socialiste që janë bërë në këtë sektor, janë një fitore tjetër e madhe me rëndësi historike e popullit tonë. Sot Shqipëria ka një bujqësi të zhvilluar shumëdegëshe, e cila ecën përpara me ritme të shpejta në rrugën e intensifikimit. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor i vitit 1968 ishte 2,8 herë më i madh se ai i vitit 1938.

Mbi bazën e shtimit të të ardhurave kombëtare, nga viti në vit është rritur në mënyrë sistematike mirëqenia e masave punonjëse. Gjatë periudhës 1951-1969 konsumi për frymë është rritur 2,5 herë, kundrejt 1,7 herë që është rritur popullsia. Brenda kësaj periudhe, paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve është rritur 1,7 herë dhe të ardhurat reale të fshatarësisë 2 herë.

Populli ynë, i frymëzuar nga vija gjithmonë e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë të lavdishme, është ngritur në këmbë për thellimin e mëtëjshëm të revolucionit socialist në të gj-

tha fushat. Inisiativat krijuese revolucionare të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste dhe të inteligjencies popullore, vënia e interesit të përgjithshëm mbi interesin personal, thellimi i mëtejshëm i revolucionit ideologjik e kultural dhe i atij tekniko-shkencor, lufta e mbarë popullit për plotësimin dhe për tejkalimin e detyrave të planit të katërt pesëvjeçar, kanë krijuar mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese dhe për ngritjen e nivelit material e kultural të popullit.

Komiteti Qendror i PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH, të udhëhequr nga vendimet historike të Kongresit V të PPSH, në pragun e jubileut të madh të 25-vjetorit të Çlirimit të atdheut dhe të triumfit të revolucionit popullor, të mbështetur në fitoret e arritura, në zhvillimin e vrullshëm e të gjithanshëm të ekonomisë dhe në mundësitë ekonomiko-financiare të shtetit tonë socialist, vendosën që, duke filluar nga 8 nëntori i këtij viti, të zbatohen një varg masash të rëndësishme për ngritjen e mëtejshme të mirëqenies së popullit, me një shumë të përgjithshme prej 245 milion lekë, nga e cila përfitimi vjetor për popullin do të jetë 170 milion lekë. Për këtë qëllim:

1. — Të ulen çmimet e disa mallrave të përdorimit të gjerë, të barnave mjekësore, të insekticideve, të disa maqinerive bujqësore, si dhe çmimet e disa lloj shërbimesh me një përfitim për popullin prej 100 milion lekësh.

2. — Të hiqet krejtësisht sistemi i taksave, me qëllim që të çlirohen plotësisht të ardhurat e punonjësve nga çdo cungim, si dhe të hiqet pagesa e sigurimit të detyrueshëm për udhëtarët, me një përfitim vjetor për popullin prej 9 milion lekësh.

3. — Me qëllim që t'i jepet një përkrahje më e madhe fuqizimit ekonomik të kooperativave bujqësore të zonave kodrinore e malore në sferën e politikës financiare e të kreditit, si dhe për të krijuar kushte favorizuese për zhvillimin e tyre më të shpejtë e të gjithanshëm, të merren këto masa:

a) Të hiqet krejtësisht tatimi vjetor mbi të ardhurat në kooperativat bujqësore të zonave kodrinore e malore në masën 26 milion lekë.

b) Të ulen tarifat e SMT-ve për punimet që ato kryejnë në kooperativat bujqësore të zonave kodrinore e malore dhe të bëhen disa përmirësime në mënyrën e pagesës së punonjësve të brigadave të traktoristëve në këto zona. Nga kjo masë kooperativat

bujqësore të zonave të mësipërme dhe punonjësit e SMT-ve do të përfitojnë 10 milion lekë në vit.

c) Në përshtatje me kriteret që do të caktojë Këshilli i Ministrave, kooperativave bujqësore të zonave kodrinore e malore t'u falen kreditë e dhëna për blerjen e kafshëve të punës e të prodhimit, për punimet e kryera nga SMT-të e të tjera, me një shumë të përgjithshme prej 98 milion lekësh.

4. — Të rriten nga ana e shtetit çmimet e grumbullimit të mishit, leshit dhe të disa bimëve tanifere e mjekësore në masën që do të caktojë Këshilli i Ministrave me vendim të veçantë.

Masat e reja që po marrin Partia dhe qeveria i shërbejnë ngritjes së mëtejshme të nivelit të jetesës së popullit, rritjes së pagës reale të klasës punëtore dhe të ardhurave reale të fshatarësisë kooperativiste. Ato i shërbejnë gjithashtu zhvillimit me ritme më të shpejta të kooperativave bujqësore të zonave kodrinore e malore, forcimit të aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë kooperativiste, ngushtimit të dallimit midis qytetit dhe fshatit, midis fushës dhe malit, në përputhje të plotë me direktivat e Kongresit V të Partisë. Ulja e çmimeve mbi bazën e rritjes së pandërprerë të prodhimit, heqja tërësisht e sistemit të taksave si dhe masat e tjera favorizuese për kooperativat bujqësore, janë dëshmi e gjallë e politikës së drejtë revolucionare të Partisë dhe të shtetit tonë socialist. Këto masa të rëndësishme për rritjen e mirëqenies së popullit merren në vendin tonë në një kohë kur në vendet kapitaliste dhe në vendet ku në fuqi janë revizionistët modernë, vazhdon ngritja e pandërprerë e çmimeve, e taksave dhe papunësia, që sjellin vazhdimisht rritjen e shfrytëzimit dhe mjerimin e masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit.

Marrja e këtyre masave kaq të rëndësishme dëshmon edhe një herë për sukseset e mëdha që ka arritur klasa jonë punëtore dhe fshatarësia kooperativiste, për rritjen dhe fuqizimin e ekonomisë e për perspektivat e shkëlqyera që i janë hapur atdheut tonë socialist.

Komiteti Qendror i PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH shprehin besimin e tyre të patundur se populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, do të shumëfishojë përpjekjet e tija për zhvillimin e mëtejshëm të vrullshëm të prodhimit, për rritjen e rendimentit në punë dhe për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit, se ai do të vërë të gjitha forcat e tija për të punuar akoma më

me hov revolucionar për ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë.

Populli ynë, ashtu si gjithmonë, në unitet të çelniktë përreth Partisë, me besim të patundur në vijën e saj të drejtë, do të mbajë kurdoherë lart e të papërlyer flamurin fitimtar të marksizëm-leninizmit. I frymëzuar nga parulla revolucionare «Të mbajmë në njërën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën» populli ynë do të thellojë më tej revolucionin ideologjik e kultural, do të zhvillojë luftën klasore revolucionare, do të çelnikosë gjithnjë e më shumë fuqinë mbrojtëse dhe do të marshojë kurdoherë përpara në rrugën për ndërtimin e socializmit e të komunizmit.

KOMITETI QENDROR I PPSH KËSHILLI I MINISTRAVE I RPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjetet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 267 (6619), 8 nëntor 1969*

PLENUMI IX I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 26-27 dhjetor 1969

K O M U N I K A T E

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 26 dhe 27 dhjetor 1969, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi IX i Komitetit Qendror të PPSH, i cili shqyrtoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi punën e organizatave të Partisë, të masave dhe organeve ekonomike e shtetërore për rritjen e mëtejshme të rendimentit dhe forcimin e disiplinës proletare në punë», mbajtur nga sekretari i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Xhafer Spahiu.

Plenumi diskutoi gjerësisht rreth raportit, e aprovoi atë njëzëri dhe mori vendimin përkatës.

Në përfundimin e punimeve të Plenumit, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, mbajti një fjalim të rëndësishëm.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI PUNËN E ORGANIZATAVE TË PARTISË, TË MASAVE DHE ORGANEVE EKONOMIKE E SHTETËRORE PËR RRITJEN E MËTEJSHME TË RENDIMENTIT DHE FORCIMIN E DISIPLINËS PROLETARE NË PUNË»

27 dhjetor 1969

Plenumi IX i Komitetit Qendror të PPSH i mbledhur më 26 e 27 dhjetor 1969, pasi dëgjoi dhe diskutoi gjerësisht rreth raportit të Byrosë Politike «Mbi punën e organizatave të Partisë, të masave dhe organeve ekonomike e shtetërore për rritjen e mëtejshme të rendimentit dhe forcimin e disiplinës proletare në punë», të paraqitur nga sekretari i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Xhafer Spahiu,

Vërejtji:

Si rezultat i politikës së drejtë revolucionare të Partisë sonë, i luftës dhe i punës së saj në ndërtimin socialist të vendit, masat e gjera punonjëse të qytetit e të fshatit kanë arritur suksese të mëdha në plotësimin dhe në tejkalimin e detyrave historike që caktoi Kongresi V i Partisë. Një punë intensive dhe me rezultate mjaft të mira u bë sidomos gjatë këtij viti për nder të 25-vjetorit të Çlirimit të atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor. Edhe në lëmin e organizimit socialist të punës, të rritjes së rendimentit shoqëror, si dhe të forcimit të disiplinës proletare në punë, sidomos këto kohët e fundit, janë arritur suksese të rëndësishme që kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen e prodhimit dhe në përsosjen e marrëdhënieve socialiste në vendin tonë. Mjafton të themi se në vitin 1968, në krahasim me vitin 1950, rendimenti në punë në industri është rritur 2,2 herë dhe nga ky faktor është siguruar afro 60 për qind e shtesës së prodhimit, kurse në bujqësi, që nga viti 1950 e deri më 1968, nga

rritja e rendimentit është siguruar 67 për qind e shtesës së prodhimit. Edhe në sektorin e ndërtimit, të komunikacionit e të tjerë janë arritur përfundime të mira.

Megjithëkëtë, duke analizuar gjendjen e treguesve të organizimit socialist të punës, rezulton se në mjaft raste vërtetohen dobësi e të meta, të cilat e kanë burimin në kuptimin e cekët politiko-teorik dhe organizimin jo kudo të mirë të punës, në trajtimin akoma të njëanshëm të këtyre problemeve, pa bërë një punë të gjerë e sistematike me njerëzit për të kuptuar, në radhë të parë, përmbajtjen ideologjike dhe politike të tyre, gjë që ka çuar në mosplotësimin e rendimentit mesatar të punës në disa degë dhe në përgjithësi rritja e tij të bëhet me ritme të ngadalshme. E pamjaftueshme duhet konsideruar edhe puna për zbërthimin e orientimeve dhe direktivave të Partisë në lëmin e organizimit socialist të punës, për njohjen nga masat e gjera punonjëse të ligjeve objektive ekonomike, që i përcaktojnë ato, si dhe të pasojave që rrjedhin nga zbatimi i drejtë ose jo i tyre.

Në punën e tyre organizatat e Partisë dhe ato të masave, si dhe organet shtetërore e të ekonomisë nuk kanë pasur gjithnjë në qendër të vëmendjes problemet e organizimit socialist të punës. Ato nuk u janë përgjegjur kurdoherë gatishmërisë e patriotizmit të punonjësve tanë me një punë drejtuese dhe organizative të nivelit të lartë. Treguesit e punës shpesh nuk diskutohen me punëtorët ose diskutohen në mënyrë formale, pa zbërthyer shkaqet e prapambetjes dhe pa përcaktuar masa të gjithanshme për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes. Kontrolli i klasës punëtore akoma nuk po shtrihet gjerësisht në këto probleme dhe i pamjaftueshëm është vetëkontrolli e ballafaqimi. Në mënyrë të pamjaftueshme punohet për zbulimin, përpunimin, përgjithësimin dhe përhapjen e përvojës së përparuar, për t'u mbështetur më fuqimisht pas shembullit pozitiv dhe për të zhvilluar gjerësisht emulacionin socialist.

Në mënyrë të veçantë, të meta e dobësi serioze janë vërejtur në organet ekonomike e shtetërore të qendrës e të bazës, të cilat shpeshherë pajtohen që në periudhën e planifikimit me një intensitet të ulët pune dhe bëjnë kërkesa të fryra për fuqi punëtore, të pabazuara në analiza të hollësishme. Ndryshimet e drejta që u bënë në metodologjinë e planifikimit duke e përcaktuar rendimentin si «tregues llogaritës», u interpretuan në disa raste sikur ai nuk kishte më rëndësinë e mëparshme. Ndjekja e problemeve të organizimit socialist të punës, sidomos në drejtim të shfrytëzimit të kohës së punës, të normimit teknik dhe të formave të punës e të shpërblimit është bërë me të meta e boshllëqe, si nga dikasteret ashtu edhe nga komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve. Kanë çaluar edhe përpunimi e përhapja e or-

ganizuar e përvojës së përparuar në lëmin e treguesve të punës, si dhe ndihma konkrete për bazën. Nga disa organe shtetërore dhe ekonomike për këto probleme është mbajtur një qëndrim burokratik.

Këto të meta e dobësi të punës sonë, kanë sjellë si pasojë që: pjesëmarrja në punë nuk është akoma në shkallën e duhur, mjaft forca, sidomos në fshat, nuk angazhohen në çdo kohë të vitit me punë të dobishme për shoqërinë; shfrytëzimi i kohës së punës është akoma jo i plotë, sidomos brenda 8-orëshit; normat në mjaft raste shtrojnë kërkesa për plotësimin e tyre në fakt me më pak kohë-punë efektive e megjithatë nuk plotësohen nga të gjithë punonjësit; normat teknike, këta 3-4 vjetët e fundit, pothuaj kanë qëndruar në vend; ka pasur disa shtrembërimi në vendosjen e normave kolektive dhe shfaqje të barazitarizmit në pagesa; nuk bën sa duhet studime për unifikim e për rritje të normave në bazë dege. Pak përpjekje bëhen për rritjen e shkallës së mekanizimeve dhe të ndryshimeve në proceset teknologjike, maqineritë dhe pajisjet, që kemi, akoma nuk po shfrytëzohen kudo me ngarkesë të plotë gjatë kohës së punës. Llogaritja e fuqisë punëtore nuk bëhet në bazë të studimeve të gjithanshme të faktorëve analitikë, moralë e teknikë, të bilancit të kohës së punës etj.

Duke marrë parasysh këtë gjendje, si dhe detyrat e mëdha në lëmin e intensifikimit të ekonomisë sonë në të ardhshmen, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH,

Vendosi:

I

Të intensifikojmë më tej punën politike e ideologjike për një kuptim më të thellë dhe për një vlerësim më të gjerë të treguesve të punës

1. — Organizatat e Partisë dhe të masave, organet shtetërore dhe ekonomike të zhvillojnë një punë më të gjerë politike e ideologjike dhe të marrin masat e duhura organizative, për t'u bërë të qartë masave punonjëse se rritja e pandërprerë e rendimentit të punës, si ligj ekonomik i socializmit, është i lidhur ngushtë me shtimin e prodhimit dhe me rritjen e akumulimit socialist dhe përbën një nga faktorët më të rëndësishëm për ngritjen në mënyrë të vazhdueshme të mirëqenies materiale e të nivelit kultural të tyre.

Gjithashtu ato duhet t'u shpjegojnë e t'u sqarojnë vazhdimisht punonjësve, politikisht e teorikisht, në mënyrë të organizuar mirë, se rritja me ritme më të shpejta e rendimentit të punës dhe forcimi i disiplinës proletare në punë në kushtet aktuale, diktohet edhe nga një sërë faktorësh të rëndësishëm:

— Futja e ekonomisë sonë në rrugën e zhvillimit intensiv, objektivet e rëndësishme për të ardhshmen, si dhe ndërtimi i veprave të mëdha shtrojnë detyra të reja për rritjen e fondeve të akumulimit, të cilat nuk mund të sigurohen pa rritjen e shpejtë të rendimentit të punës, gjë që duhet pasur mirë parasysh që në planifikim.

— Nevojat e mëdha për fuqi punëtore dhe përballimi i tyre, në radhë të parë nga qyteti, duke tërhequr nga fshati sa të jetë e mundur më pak.

— Zgjerimi i shpejtë në të ardhshmen i rrjetit të shërbimeve, atij socialo-kultural, si dhe revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës. Në këto aktivitete do të merret një numër më i madh punonjësish, prandaj për të kompensuar punën e këtyre forcave që angazhohen në sferën joproduuese, del detyra që në sferën e prodhimit material të rritet akoma më tepër rendimenti i punës, pa lënë mënjanë këtë detyrë edhe në sferën joproduuese.

— Dobësitë e të metat që vërehen në fushën e organizimit socialist të punës dhe veçanërisht në ritmet e ulëta të rendimentit në disa degë të ekonomisë, si në industri ashtu dhe në bujqësi.

2. — Puna propagandistike e Partisë të bëjë të qarta lidhjet e ngushta dhe kontradiktat që ekzistojnë, nga njëra anë, midis ngritjes së nivelit material e kultural të masave, nëpërmjet rritjes së pandërprerë të rendimentit të punës, uljes së vazhdueshme të çmimeve etj. dhe, nga ana tjetër, midis tendencës për të mbajtur norma të ulëta e fuqi punëtore të tepërt, gjë që bie në kundërshtim me parimin e zhvillimit tonë ekonomik, sipas të cilit rendimenti i punës duhet të rritet me ritëm më të shpejtë nga paga.

Problemet e organizimit socialist të punës si nocione e kategorori ekonomike, kanë ligjet e tyre objektive të zhvillimit. Krijimi i bindjeve ideologjike, forcimi i ndërgjegjes revolucionare dhe formimi i botëkuptimit të ri materialist marksist-leninist për këto probleme të lidhet ngushtë me njohjen pikërisht të këtyre ligjeve. Në punën për njohjen e ligjeve ekonomike të socializmit, të aktivizohen gjerësisht punëtorët, personeli inxhiniero-teknik, ekonomistët dhe kuadrot e tjerë dhe të përdoren për këtë qëllim forma pune të larmishme.

3. — Organet e Partisë dhe të pushtetit në çdo qendër pune e prodhimi të thellojnë kontrollin punëtor për problemet e

organizimit socialist të punës, duke e kombinuar atë me kontrollin shtetëror e të Partisë. Klasa punëtore, si klasa hegjemone, të vihet në ballë të luftës për kalitjen e ndërgjegjes proletare, duke forcuar e duke zgjeruar kontrollin e saj punëtor kundër qëndrimeve liberale, indiferente e pasive në çrregullimet në punë, në thyerjen e disiplinës proletare etj. Të kuptohet thellë nga të gjithë se disiplina në punë nuk mund të përmirësohet, në qoftë se krahas punës politike nuk vihet një kontroll i fortë dhe i gjithanshëm. Vetë klasa punëtore e fshatarësia kooperativiste nuk duhet të lejojnë që të mos përdoret plotësisht e me efektivitetin më të madh koha e punës. Po nuk u kuptua drejt vlera e kohës së punës, nuk mund të pretendohet se i kemi kuptuar edhe shumë çështje të tjera të ndërtimit tonë socialist. Në këtë drejtim organizatat profesionale nën udhëheqjen e organizatave të Partisë, të nxitin e të inkurajojnë vetëkontrollin e ballafaqimin, mbi bazën e motos «autokritikë, kritikë, korrigjim e kalitje të ndërgjegjes socialiste».

4. — Organizatat e Partisë, ato të masave dhe organet shtetërore të ngrënë në një shkallë më të lartë emulacionin socialist, nëpërmjet zbatimit gjerësisht të aksioneve masive me goditje të përqëndruar. Të shtojnë më shumë kujdesin e tyre për zbulimin, përpunimin, përgjithësimin dhe përhapjen e mënjëhershme të përvojës së më të mirëve. Të luftojnë tendencat që vërehen në disa raste për mospërfilljen e përvojës së përparuar, prirjen për të nënvleftësuar përvojën «e vogël» që ndeshet në çdo skuadër, brigadë, turn e repart, duke kërkuar gjëra «të mëdha», dhe të edukojnë te njerëzit thjeshtësinë proletare për të mësuar nga njëri-tjetri dhe për të rritur bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke midis punonjësve, njësisive të ndryshme të prodhimit dhe rretheve, duke e konsideruar marrjen e përvojës së përparuar si një kursim efektiv e të rëndësishëm të kohës së punës.

Këshilli Qendror i BPSH dhe organizatat e tjera të masave, të përpunojnë përvojën e fituar deri tani, me qëllim që emulacioni socialist në të ardhshmen të ngrihet në një shkallë të re më të lartë dhe në shembullin e shkëlqyer të rrethit të Dibrës, të ndizet një zjarr i ri aksionesh masive revolucionare me goditje të përqëndruar në industri, në bujqësi, në ndërtim, në komunikacion e në sektorë të tjerë, si dhe t'i jepet një mbështetje e gjithanshme lëvizjes revolucionare për të fituar titullin «brigadë, repart, sektor, ndërmarrje e kooperativë sulmuese e 5-vjeçarit të katërt».

II

Të shfrytëzojmë me efekt gjithmonë e më të madh kohën e punës duke vendosur kudo një disiplinë të shëndoshë proletare

1. — Organizatat e Partisë, organet ekonomike shtetërore dhe organizatat e masave ta konsiderojnë pjesëmarrjen sa më të gjerë në punë të punonjësve, sidomos në fshat, ku rezervat janë më të mëdha dhe frontet e punës më të shumta, si një nga çështjet më kryesore për rritjen e rendimentit në punë. Në luftën për të siguruar një pjesëmarrje sa më të plotë në punë, organizatat e Partisë në fshat dhe kryesitë e kooperativave bujqësore të marrin të gjitha masat e nevojshme, që e gjithë popullsia e aftë për punë në fshat jo vetëm të marrë pjesë vazhdimisht në punë, por të mbështetet fuqimisht e të përhapet gjerësisht përvoja shumë e mirë e mjaft kooperativave bujqësore, të cilat që tani realizojnë në vit mbi 300 ditë-punë të normuar mesatarisht për çdo anëtar të aftë për punë. Të synohet që për çdo ditë kalendarike të bëhet jo më pak se një normë pune (ditë-punë e materializuar). Për t'ia arritur kësaj, përveç të tjerave, një kujdes i veçantë t'i kushtohet ndërtimit dhe vënies në përdorim sa më të gjerë të objekteve socialo-kulturale në fshat si kopshtet, çerdhet, lavanderitë, furrat e bukës, mensat etj., në mënyrë që të çlirohen sa më shumë gratë nga punët shtëpiake dhe të hidhen në prodhim si dhe burrat. Nga ana tjetër, një kujdes i gjithanshëm t'i kushtohet mënjanimin në maksimumin e mundshëm të karakterit stinor të prodhimit, sidomos në sektorin e bujqësisë, duke marrë masa konkrete për kooperimin midis bujqësisë, blegtorisë e frutikulturës, për zhvillimin e aktiviteteve ndihmëse dhe përpunimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale në kooperativat bujqësore.

Në qytete, krahas luftës për të mënjeluar mungesat pa arsye në punë, nëpërmjet kontrollit dhe vetëkontrollit të klasës punëtore, të bëhet një punë e studjuar dhe e planifikuar më mirë për të siguruar fronte të reja pune, duke zhvilluar më tej inisiativat për ngritje linjash e fabrikash të reja, si dhe për të krijuar te punonjësit bindjen se kudo që punojnë, ata i shërbejnë ndërtimit të socializmit, si në qytetin apo rrethin e tyre ashtu edhe në çdo qendër e kantier tjetër pune ku do të lindë nevoja të punojnë.

2. — E gjithë Partia, organet shtetërore dhe ekonomike, organizatat e masave, vetë punonjësit e qytetit e të fshatit, të marrin masat e nevojshme për të vendosur kudo një disiplinë të hekurt proletare në punë, për shfrytëzimin sa më mirë të kohës së punës, brenda turnit apo ditës së punës, duke e konsi-

deruar këtë si një nga çështjet më të rëndësishme për rritjen e rendimentit të punës. Çdo punonjësi t'i shpjegohet teorikisht e praktikisht rëndësia e saj, që disiplina e ndërgjegjshme proletare t'i futet secilit në gjak. Që koha e punës të kthehet «në flori», siç thotë populli, është e domosdoshme të evitohen kudo humbjet pa arsye të kohës së punës, të mënjahen ardhja me vonesë në punë, largimi para kohe si dhe lëvizjet e kota e të tjera. Gjatë gjithë kohës së punës të jenë të mobilizuara të gjitha aftësitë fizike e mendore të secilit dhe njëkohësisht të merren masa të atilla që të mënjahen mungesat e lëndëve të para, materialeve, veglave dhe instrumenteve të punës. Për këto çështje të organizohet më mirë kontrolli punëtor jo vetëm ndaj administratës, por edhe ndaj njëri-tjetrit në vetë radhët e punëtorëve.

Organet shtetërore dhe ekonomike në qendër e në bazë të marrin të gjitha masat e duhura në fushën e organizimit të prodhimit dhe të furnizimit materialo-teknik. Ato të sigurojnë në sasi, cilësi dhe kohën e duhur lëndët e para e materialet e tjera të planifikuara, duke vendosur një disiplinë të rreptë në zbatimin e kontratave të furnizimit, të shpërndarjes e të transportit; të plotësojnë veglat e mjetet e punës, si në sasi ashtu dhe në cilësi; të sigurojnë në kohë projektet dhe sheshet e ndërtimit të veprave. Çdo ndërmarrje të përgjigjet për plotësimin e kontratave një-lloj si për plotësimin e planit në sasi, në cilësi e në lloje. Një rëndësi e veçantë t'i kushtohet gjithashtu ruajtjes dhe shtimit gradual të rezervave të sigurimit të materialeve, sipas orientimeve të Partisë e të qeverisë.

Dikasteret qendrore ekonomike, si dhe organet e pushtetit e të ekonomisë në ndërmarrje e në kooperativa bujqësore duke filluar nga viti 1970 të studjojnë dhe të marrin masat përkatëse, për të ulur paaftësinë e përkohshme në punë në nivelet e planifikuara, për të përmirësuar më tej kushtet teknike e higjieno-sanitare të punës, sidomos në ato qendra pune ku ndikimi i kushteve atmosferike dhe karakteri i prodhimit sjellin pasoja të dëmshme për shëndetin e punonjësve dhe aksidente.

III

Të zgjerojmë e të përsosim më tej normimin e punës

1. — Të shtohet kujdesi i Partisë, i organeve shtetërore dhe i organizatave të masave për zgjerimin dhe për përsosjen e normimit të punës, që përbën bazën e organizimit të drejtë e shkencor të punës dhe të rritjes së rendimentit shoqëror të saj. Të bëhet një punë e gjerë politike dhe organizative, që

kudo e në çdo sektor të kuptohet domosdoshmëria absolute e normimit të punës, që çdo punëtori e kooperativisti t'i bëhet shprehur normimi i punës dhe të mendojë se nuk ka kuptim puna pa norma të mbështetura e të kontrolluara mirë teknikisht. T'i jepet fund praktikës empirike që ndodh shpesh në studimin dhe në vendosjen e normave duke u nisur vetëm nga rezultatet mesatare të arritura. Normat e reja të jenë kurdoherë rezultat i një njohjeje të gjithanshme të mundësive dhe të rezervave që ekzistojnë, ato të marrin parasysh shfrytëzimin maksimal të mundshëm të kohës së punës, të mjeteve të punës, nivelin teknik të prodhimit dhe të llogariten në bazë të rezultateve mesatare të përparuara që janë arritur në të gjitha drejtimet.

Kujdes i veçantë t'i kushtohet plotësimin të normave nga të gjithë punëtorët. Sot kemi mbi 14 për qind të punëtorëve që nuk realizojnë normat dhe kjo përbën një rezervë të madhe në rritjen e prodhimit dhe të rendimentit të punës. Organizatat e Partisë, organet drejtuese shtetërore e ekonomike në qendër e në bazë, si dhe organizatat e masave të bëjnë studime të hollësishtme, të zbulojnë shkaqet dhe të përcaktojnë masat me karakter politik, ideologjik, ekonomik e tekniko-organizativ në mënyrë që brenda një kohe sa më të shkurtër të kapërcehet prapambetja në realizimin e normave.

2. — Normimi teknik i punës të konsiderohet nga organet ekonomike dhe shtetërore të bazës e të qendrës dhe nga organizatat e Partisë e të masave si një nga detyrat më të rëndësishme në fushën e normimit të punës dhe gjatë vitit 1970 të bëhet një kthesë serioze në këtë drejtim, e cila të thellohet më tej në mënyrë të programuar gjatë vjetëve të ardhshëm. Në vendosjen e normave teknike, midis të tjerave të mbahen parasysh këto kritere kryesore:

E para, përdorimi racional i kohës së punës të punonjësve, mbi bazën e një disipline të fortë proletare në punë.

E dyta, vendosja e drejtë e njerëzve në vendet e punës, në përshatje me kualifikimin e tyre, që secili të jetë plotësisht i ngarkuar me punë.

E treta, shfrytëzimi i plotë e racional i maqinerive e mjeteve të tjera të punës dhe respektimi rigoroz i ligjeve shkencore të prodhimit.

E katërta, furnizimi i rregullt materialo-teknik.

E pesta, pasqyrimi në kohë i ndryshimeve që vijnë nga futja e teknikës dhe e teknologjisë së përparuar, nga mekanizimi i mëtejshëm i punës dhe organizimi më i mirë i prodhimit.

3. — Të forcohet puna për unifikimin e normave midis ndërmarrjeve të një dege me kushte pune pak a shumë të ba-

rabarta. Dikasteret qendrore dhe komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve, në bashkëpunim me ndërmarrjet dhe me kooperativat përkatëse të marrin masa për studimin dhe për unifikimin e normave brenda vitit 1970 *mbi bazën e rezultateve mesatare progresive* të arritura brenda degës dhe pastaj herë pas here ta rishqyrtojnë këtë çështje në përputhje me përfundimet e arritura. Normat e kooperativave bujqësore duhet të orientohen nga normat në NBSH-të dhe në këtë drejtim të përkrahet e të përgjithësohet inisiativa e atyre kooperativave bujqësore që në kushte të ngjashme, kanë aplikuar normat që zbatojnë NBSH-të.

4. — Në problemet e normimit të punës, të tërhiqet vëmendja dhe kujdesi i vetë masave punonjëse, që ato të shqyrtojnë, me syrin kritik, nivelin e kërkesave që shtrihen norma e punës në qendrën e tyre të prodhimit dhe të bëjnë korrigjimet e duhura, në mbështetje të kushteve konkrete dhe të detyrave për një shfrytëzim sa më të plotë të kohës së punës. Po kështu, kuadrot kryesorë të prodhimit, inxhinierë e teknikë, ekonomistë e specialistë të ndryshëm, ta konsiderojnë normimin e punës si një nga detyrat kryesore të tyre dhe të ndihmojnë në përcaktimin e kërkesave që duhet të shtrojnë norma, si dhe në përgatitjen e ngritjen tekniko-profesionale të ndihmësve, për t'u vënë ata më mirë në rolin e rëndësishëm që kanë.

5. — Organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë një kujdes të veçantë t'u kushtojnë formave të organizimit socialist të punës në përputhje me kushtet konkrete të prodhimit. Ato të kenë parasysh vazhdimisht, që duke filluar nga procesi teknologjik në prodhimin kryesor e deri te repartet ndihmëse, mund të ekzistojnë të 4 format e organizimit socialist të punës, domethënë puna me norma individuale, me norma kolektive, me plan-detyrë dhe me kohë. Një kujdes i posaçëm t'i kushtohet zgjerimit të punës me norma kolektive¹, e cila ndikon për edukimin e punonjësve me frymën e solidaritetit, të ndihmës reciproke e të disiplinës proletare dhe sjell përfundime të mira në rritjen e rendimentit të punës dhe në përmirësimin e cilësisë. Por kalimi nga normat individuale në norma kolektive të bëhet kurdoherë duke respektuar plotësisht orientimet përkatëse, domethënë kur për këtë kalim ekzistojnë ose krijohen kushtet objektive dhe subjektive.

1 Në shumë raste orientimet e Partisë u shkelën dhe u vunë në zbatim pa u krijuar kushtet objektive dhe subjektive.

Të bëhet një punë më e gjerë dhe këmbëngulëse, për mekanizimin dhe thëllimin e mëtejshëm të progresit teknik, duke u mbështetur në forcat dhe në mundësitë tona

1. — Të zgjerohet lëvizja për mekanizimin e proceseve të punës e të prodhimit, duke filluar nga gjërat më të thjeshta e deri te ato më komplekset dhe të kthehet kjo lëvizje në një aksion masiv e konkret për çdo kolektiv dhe punonjës. Organizatat e Partisë, si dhe organet ekonomike e shtetërore, të nxitin dhe të udhëheqin studimet konkrete në fushën e mekanizimit, të përcaktojnë objektivet imediate dhe në perspektivë për mekanizimet dhe futjen e teknikës së re dhe të sigurojnë zbatimin e shpejtë të tyre, mbështetur në mundësitë e kushtet konkrete materiale që ka kolektivi i ndërmarrjes, rrethi apo ekonomia jonë. Të krijohen, sipas mundësive në ndërmarrje, grupe me punëtorë e teknikë të aftë që të merren kryesisht me problemet e mekanizimeve dhe të ndryshimeve teknologjike, qofshin me shkëputje apo pa shkëputje nga punët e tyre të zakonshme. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim duhet të luajnë dikasteret qendrore dhe komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve, të cilat duhet jo vetëm të mbështetin lëvizjet e aksionet konkrete, por të ndihmojnë konkretisht me studimin dhe me përhapjen e përvojës e të përfundimeve të arritura, si dhe me sigurimin e bazës materiale të planifikuar dhe dhënien e ndihmës teknike për zbatimin e tyre në bazat mekanike me anën e kooperimit.

2. — Organizatat e Partisë dhe levat e saja, të bëjnë një punë më të gjerë ideopolitike për të luftuar konceptet dhe mendimet frenuese që vihen re te disa punonjës në çështjet e mekanizimeve dhe të përmirësimeve teknologjike, të cilat e kanë burimin te rutina e punës së përditshme, te tendencat artizanale në prodhim, te frika për të mos humbur «qoshet e ngrohta», ose se «mos rrezikohet plani», te mosbesimi në forcat e kuadrove e të punëtorëve të rinj të talentuar etj.

3. — Për rritjen e rendimentit nëpërmjet mekanizimeve dhe përmirësimeve teknologjike të prodhimit, organet ekonomike e shtetërore duke u mbështetur te mendimet krijuese të masave të gjera punonjëse, të shfrytëzojnë më mirë se deri tani, mundësitë e krijimit të proceseve zinxhir, të proceseve pa ndërprerje, të rikonstruksioneve të pjesshme dhe të plota, për të siguruar kështu një efikasitet më të madh në rritjen e rendimentit me shpenzime më të vogla dhe në një kohë sa më të shpejtë. Për këtë ato të kryejnë studime të plota e konkrete, si dhe llogaritje sa më të sakta tekniko-ekonomike dhe t'i reflektojnë në planet e tyre ekonomike periodike dhe të perspektivës.

4. — Për degët e ndryshme të ekonomisë lufta për mekanizimin e proceseve të punës, si dhe përmirësimet teknologjike duhet të kenë këto objekte:

a) *Në prodhimin industrial* — për sektorin e minierave të synojmë që proceset e nxjerrjes dhe të transportimit të kromit, bakrit, hekur-nikelit, qymyrgurit e të tjerë, në minierat kryesore, të mekanizohen në një shkallë sa më të gjerë; në sektorin e naftës dhe të gjeologjisë të bëhet një kthesë vendimtare në të ardhshmen për rritjen e shpejtësisë së shpimit për sondë-muaj, si në kërkim ashtu dhe në shfrytëzim, duke shkurtuar njëkohësisht në mënyrë rrënjësore kohën për çmontim, transport e montim të sondave.

Në industrinë mekanike të synohet që të rritet sa më shumë e vazhdimisht koeficienti i shfrytëzimit të maqinerive dhe ai i turneve, në krahasim me gjendjen e sotme, duke rritur shpejtësinë e prerjes së metaleve, përdorimin e atresaturave më komplekse, mekanizimin e transportit të brendshëm dhe uljen e ndjeshme të kohës ndihmëse. Duke zgjeruar në një nivel më të lartë kooperimin në shkallë dege dhe kombëtare, të rritim me ritme më të shpejta prodhimin në vend të pjesëve të këmbimit për të gjitha degët e prodhimit, si dhe të ecim më shpejt në drejtim të prodhimit të maqinerive e të pajisjeve për ekonominë e sidomos për nevojat e fshatit. Në fushën e kooperimit, Ministria e Industri-Minierave, në bashkëpunim me dikasteret e tjera, të marrin masa të shpejta, si për eliminimin e të metave dhe boshllëqeve të rëndësishme që konstatohen në planifikimin e tij, ashtu dhe për caktimin e rregullave më të forta, të detyrueshme për të gjithë, në drejtim të kontraktimeve dhe të garancive të kërkuara, për një prodhim të siguar. Krahas kësaj, dikasteret përkatëse t'i japin zgjidhje të plotë edhe riparimit të maqinerive, automjeteve e pajisjeve që disponojnë kooperativat bujqësore, inventari i të cilave nga dita në ditë po shtohet.

Në industrinë e drurit, prerja e transportimi i lëndës drusore nga pylli të mekanizohet gjerësisht deri nga fundi i pesëvjeçarit të ardhshëm, ndërsa në përpunimin e drurit të synohet për vendosjen e proceseve zinxhir e tipizimin e prodhimeve, për të shtuar në mënyrë vendimtare rendimentin në perspektivë.

Në industrinë e materialeve të ndërtimit, në atë të lehtë dhe ushqimore si objektiv kryesor në lëmin e mekanizimit të jenë proceset e transportimit, seleksionimit e manipulimit të lëndëve të para e ndihmëse, si dhe ambalazhimit e transportit të brendshëm, duke synuar që këto procese të mekanizohen sa më shumë.

b) *Në bujqësi* — rëndësi e veçantë i duhet kushtuar përdorimit të mekanizmave të thjeshta të dorës dhe atyre që tërhiqen

nga kafshët e punës. Në çdo kooperativë të synohet që shpërndarja e farës dhe e plehut, priorimi i farës, prashitjet, kositjet, shkoqja e misrit dhe një sërë punimesh në blegtori e të tjera, të mekanizohen sa më gjerësisht. Të synohet për shtrirjen e mekanizimit të mbjelljeve dhe të vjeljeve në një numër sa më të madh të kulturave të arave dhe në radhë të parë, të drithërave të bukës, si dhe të punohet edhe për mekanizimin e pastrimit të kanaleve të mëdha.

Duke marrë parasysh përdorimin stinor të një sërë pajisjesh e maqinerish bujqësore që kemi sot, vëmendja e mekanizatorëve të bujqësisë të përqëndrohet në përshtatjen e tyre për dy a më shumë operacione pune, për të siguruar një ngarkesë sa më të madhe të tyre. Ministria e Bujqësisë të caktojë pa vonesë objekte konkrete për çdo agregat e maqinë bujqësore, në mënyrë që çdo maqinë bujqësore të shfrytëzohet me efekt sa më të madh dhe për një periudhë kohe sa më të madhe gjatë vitit bujqësor.

Duke e parë çështjen e bujqësisë si çështje të të gjithëve, ndërmarrjet ekonomike shtetërore, dikasteret ekonomike si dhe komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve, në çështjet e mekanizimit kanë një fushë të pafund për të ndihmuar konkretisht në zgjidhjen e një sërë problemesh të lidhura sidomos me intensifikimin e mëtejshëm të bujqësisë dhe me rritjen e rendimentit të punës. Prandaj të luftohet në të gjitha qendrat e punës e të prodhimit, në çdo rreth e dikaster, për studimin dhe për zgjidhjen e një sërë detyrash të mekanizimit në bujqësi, dhe me forcat e tyre, duke shfrytëzuar më mirë rezervat e brendshme, të japin një ndihmë më të madhe për kooperativat bujqësore dhe sidomos për ato të zonave kodrinore e malore, ku futja e teknikës së rëndë bujqësore është më e vështirë dhe shfrytëzimi i saj objektivisht më i ulët. Kjo ndihmë të synojë në radhë të parë në riparimin në kohë të mekanizmave e të pajisjeve të fshatit si dhe në prodhimin e pajisjeve të reja për to, si për prodhimin bujqësor e blegtoral ashtu dhe për veprimtaritë ndihmëse dhe objektet socio-kulturale.

c) *Në ndërtim* — të bëhen të gjitha përpjekjet që brenda pak vjetëve, proceset e nxjerrjes dhe të përpunimit të rërës, të zhavorit, të gurit dhe prodhimi i gëlqeres në kantieret kryesore, të mekanizohen plotësisht. Gjithashtu të synohet që të mekanizohen gjerësisht gërmimet e transporti i dheut, prodhimi i betoneve dhe i llaçeve, proceset e përgatitjes e të transportit të parafabrikateve, suvatimet e bojatisjet. Të rritet në mënyrë të dukshme prodhimi dhe përdorimi i pjesëve të parapregatitura në veprat industriale, banesat, ndërtimet socio-kulturale si dhe në veprat e artit, në rrugët, hekurudhat dhe bonifikimet e ujitjen, në mënyrë që nëpërmjet parapregatitjes dhe mekanizimit,

kryesisht të mbështetur nga prodhimi në vend, të përballohet kryerja e detyrave të mëdha që ka ky sektor, duke luajtur një rol vendimtar si për ndërtimin e veprave ashtu dhe për rritjen e rendimentit, si dhe për plotësimin më me efektivitet të detyrës që caktoi Kongresi V i Partisë mbi kthimin e shesheve të ndërtimit në sheshe montimi.

c) *Në komunikacion* — mekanizimi të synojë në shpejtimin e ngarkim-shkarkimeve me më pak fuqi punëtore si dhe në vendosjen e linjave zinxhir për rimontin dhe për shërbimet e mirëmbajtjes së mjeteve të transportit. Një kujdes i veçantë i duhet kushtuar mekanizimit të manipulimit të mallrave në portet, nyjet hekurudhore e automobilistike ku akoma mobilizohen mjaft forca pune. Gjatë vjetëve 1970-1971 të bëhet një kthesë vendimtare në këtë drejtim.

d) *Në administratat shtetërore dhe ekonomike* — të futen në një shkallë më të gjerë mekanizimi i përllogaritjeve voluminoze në kontabilitet, në statistikë etj.

5. — Organet e Partisë e të pushtetit si dhe organizatat e masave të intensifikojnë dhe të zgjerojnë punën për ngritjen e nivelit ideopolitik e tekniko-profesional të masave të gjera punonjëse që ato t'u përgjigjen më së miri detyrave për rritjen e rendimentit dhe për progresin teknik të vendit tonë. Të luftohet për ruajtjen deri në fund të kontingjenteve që ndjekin shkollat e kurset sot dhe të shtohet me hapa më të shpejtë pjesëmarrja në to në të ardhshmen. Një kujdes i veçantë u duhet kushtuar punëtorëve të rinj si dhe sigurimit e përgatitjes së kuadrit dhe specialistëve të nevojshëm për objektet e reja që ndërtojmë. Gjithashtu çdo ndërmarrje të synojë që brenda një periudhe sa më të shkurtër të arrijë përpunjen e kategorisë mesatare personale të punëtorëve me kategorinë mesatare të vendit të punës.

Duke vlerësuar drejt domosdoshmërinë e rritjes së mëtejshme të rendimentit dhe të forcimit të disiplinës proletare në punë, organizatat dhe organet e Partisë, krahas punës për një kuptim më të thellë politik dhe ideologjik të tyre dhe për t'i bërë këto në radhë të parë çështje të vetë masave punonjëse, të shtojnë përpjekjet dhe kujdesin e tyre që *kudo këto probleme në periudhën e tanishme të konsiderohen çështje të një rëndësie të posaçme*. Ato, të forcojnë më tej kontrollin e tyre ndaj organeve shtetërore dhe të ekonomisë për një përmirësim rrënjësor në metodën e drejtimit të këtyre problemeve, vlerësimin e drejt-

të dhe marrjen e të gjitha masave me karakter politik dhe tekniko-organizativ, me qëllim që brenda një kohe sa më të shkurtër të gjejnë zbatim detyrat e mëdha që shtron Partia në këtë fushë të rëndësishme të veprimtarisë sonë.

Organet dhe organizatat e Partisë, ato të masave, si dhe organet shtetërore dhe ekonomike duhet të kërkojnë e të gjejnë forma të reja e sa më të efektshme për përsosjen e organizimit socialist të punës, për rritjen e rendimentit dhe forcimin e disiplinës proletare, që t'u përshtaten sa më mirë situatave revolucionare që po jetojmë. Ato, duke ngritur në këmbë masat, të kapin përnjëherësh të renë revolucionare, ta përgjithësojnë e ta zhvillojnë më tej në mënyrë të rrufeshme. T'i kushtojnë një vëmendje të madhe organizimit të vogël që nga vendi i punës së çdo punonjësi e deri te plotësimi sa më mirë i kushteve normale të punës dhe i mjeteve e objekteve të saj.

Këshilli i Ministrave, brenda vitit 1970, në mbështetje dhe të eksperimentimeve dhe të konsultimeve që janë në vazhdim, të shqyrtojë masat që duhen marrë për përmirësimin e mëtejshëm të metodologjisë së planifikimit të treguesve të punës dhe të përllogaritjes së rendimentit në të gjitha degët e ekonomisë, duke përfshirë edhe sektorin kooperativist të bujqësisë.

Viti 1969 shënoi suksese të reja në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës si dhe në rritjen e mëtejshme të nivelit të jetesës së masave punonjëse. Atdheu ynë socialist u bë më i fortë dhe i gatshëm për të shpartalluar si kurdoherë planet armiqësore të imperialistëve amerikanë, të revizionistëve modernë sovjetikë dhe të bashkëpunëtorëve të tyre ndaj vendit tonë.

Detyra të reja edhe më të mëdha shtron plani i vitit 1970, viti i fundit i pesëvjeçarit të katërt, të cilat kërkojnë një mobilizim të gjithanshëm të të gjitha forcave tona morale dhe materiale për mbylljen me sukses të tij. Kjo do të shënojë në të njëjtën kohë edhe plotësimin me sukses të detyrave të pesëvjeçarit të katërt dhe do të krijojë bazën e shëndoshë për fillimin e zbatimit të detyrave të reja e madhështore, që do të shtrijë Partia në pesëvjeçarin e ardhshëm. Diskutimi i problemeve dhe zbatimi i detyrave që shtron ky Plenum, të kthehen në një faktor të rëndësishëm dhe të materializohen në plotësimin me sukses të detyrave të parashikuara në planin e vitit 1970. Njëkohësisht të vendoset një disiplinë e rreptë kursimi në përdorimin e lëndëve të para e materialeve deficitare dhe të mos lejohet në asnjë mënyrë harxhimi i rezervave të sigurimit për tejkalimin e planit.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH shpreh bindjen se detyrat që ai shtron në lëmin e rritjes së rendimentit, të përsosjes së organizimit socialist të punës dhe të forcimit të disiplinës

proletare në punë, do të kuptohen drejt dhe gjerësisht nga masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit dhe ato do të vënë të gjitha forcat dhe energjitë e tyre për t'i plotësuar këto detyra më së miri, me ndërgjegje të lartë dhe me frymën luftarake që i karakterizon.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 311 (6663), 30 dhjetor 1969

PLENUMI X I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 25-26 qershor 1970

K O M U N I K A T Ë

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 25 e 26 qershor 1970, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi X i Komitetit Qendror të PPSH, i cili dëgjoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Ta ngremë punën organizuese të Partisë në nivelin e detyrave të etapës së sotme të ndërtimit socialist», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Hysni Kapo.

Plenumi diskutoi gjerësisht rreth raportit dhe e aprovoi atë njëzëri.

Në përfundim të punimeve të Plenumit Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, mbajti një fjalim të rëndësishëm.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

R A P O R T

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «TA NGRËMË PUNËN ORGANIZUESE TË PARTISE NË NIVELIN E DETYRAVE TË ETAPËS SË SOTME TË NDËRTIMIT SOCIALIST»

25 qershor 1970

Shokë,

Revolucioni socialist dhe ndërtimi i socializmit në vendin tonë, nën udhëheqjen e sigurtë të Partisë së Punës, me shokun Enver në krye, po shkojnë përpara në mënyrë të pandërprerë. Në këtë rrugë janë arritur fitore të mëdha.

Ne jemi futur dhe kemi bërë hapa të rëndësishëm në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Tanimë në vendin tonë është ngritur në tërësi baza ekonomike e socializmit dhe janë realizuar një varg masash me rëndësi të madhe parimore për përsosjen e mëtejshme e të vazhdueshme të marrëdhënieve socialiste në prodhim. Krahas kësaj e në përputhje me këtë, po revolucionarizohet më tej gjithë superstruktura socialiste, që nga aparati shtetëror e ushtria e deri te shkolla jonë e re, është rritur më tej roli aktiv i saj në të gjitha frontet e ndërtimit socialist e të mbrojtjes së socializmit. Në rrugën e ndërtimit të plotë të bazës materialo-teknike të socializmit, është arritur një zhvillim i vullshëm i forcave prodhuese, është përgatitur një numër i madh kuadros të kualifikuar për të gjithë sektorët, është ngritur niveli arsimor-kultural e tekniko-profesional i masave të gjera punonjëse të qytetit e të fshatit dhe po zhvillohet e thellohet revolucioni tekniko-shkencor.

Zbatimi i orientimeve historike të Kongresit V të Partisë dhe i mësimave udhërrëfyese të shokut Enver për revolucionarizimin e mëtejshëm të të gjithë jetës së vendit, ka ngritur në një shkallë të paparë ndërgjegjen socialiste, gatishmërinë, pjesëmarrjen aktive, vetëveprimin krijues dhe hovin revolucionar të masave më të gjera punonjëse të qytetit e të fshatit në të gjitha fushat e jetës — në ekonomi dhe në veprimtarinë shtetërore, në mbrojtjen e atdheut, në zgjidhjen e problemeve shoqërore, në

krijimtarinë kulturalo-artistike dhe në punët e shkollës. Inisiativat, aksionet dhe lëvizjet revolucionare masive, që thyejnë me guxim konceptet, zakonet, traditat, normat dhe shprehitë e vjetra, çdo gjë të huaj, të mykur e konservatore që bëhet pengesë në ecjen tonë të vullshme përpara, përbëjnë një ndër tiparet dalluese më karakteristike të zhvillimit të vendit tonë në etapën e tanishme dhe një ndër aspektet më jetike të thellimit të demokracisë sonë proletare.

Në procesin e këtyre transformimeve e të këtij zhvillimi revolucionar është rritur e forcuar më tej roli udhëheqës i Partisë në tërë jetën e vendit e në të gjitha hallkat, nga qendra deri poshtë në bazë. Duke nxjerrë mësim nga praktika e gjallë dialektike e jetës, organizatat dhe organet e Partisë, si edhe ato shoqërore, shtetërore dhe ekonomike, kanë përsosur më tej metodën dhe stilin e tyre të punës e të drejtimit. Në të njëjtën kohë, është forcuar e revolucionarizuar jeta e brendshme e organizatave dhe e organeve drejtuese të Partisë, është përmirësuar përbërja shoqërore e tyre me punëtorë e punonjës të prodhimit, janë ngritur në një shkallë më të lartë kritika dhe autokritika e shëndoshë komuniste, ndjenja e përgjegjësisë dhe vetëveprimi i gjallë e luftarak për zbatimin e vijës e të detyrave të Partisë.

Të gjitha këto dëshmojnë për drejtësinë dhe vitalitetin e vijës së Partisë, që përbën burimin kryesor të të gjitha fitoreve historike të popullit tonë në luftën për socializëm.

Mbi bazën e këtyre sukseseve janë krijuar mundësi e kushte të favorshme reale ekonomike, politike e ideologjike për të shtruar e zgjidhur me ritme të shpejta detyra të reja akoma më të mëdha e më komplekse. Por stadi i arritur dhe detyrat që kemi përpara kërkojnë përmirësimin rrënjësor dhe ngritjen në një shkallë më të lartë të punës organizuese të Partisë në të gjitha fushat. Kjo përbën sot një ndër hallkat themelore nga duhet të kapemi për të zgjidhur me sukses problemet e ndryshme, për t'i dhënë një shtytje të re të fuqishme gjithë ndërtimit socialist. Stalini, duke folur për rëndësinë e madhe që ka organizimi i punës, theksonte:

«Fitorja nuk vjen kurrë vetë — ajo zakonisht merret me luftë. Rezolucionet dhe deklaratat e mira në favor të vijës së përgjithshme të partisë s'janë veçse fillimi i punës, sepse ato s'tregojnë gjë tjetër veçse dëshirën për të fituar, por jo vetë fitoren. Pasi të jetë dhënë një vijë e drejtë, pasi të jetë dhënë zgjidhja e drejtë e çështjes, sukcesi varet nga puna organizative, nga organizimi i luftës për zbatimin e vijës së partisë, nga zgjedhja e mirë e njerëzve, nga kontrolli i zbatimit të vendimeve të organeve

udhëheqëse. Pa këtë, vija e drejtë e partisë dhe vendimet e drejta kanë rrezik të dëmtohen seriozisht. Për më tepër: pasi të jetë dhënë vija e drejtë politike, puna organizative vendos gjithçka, edhe fatin e vetë vijës politike, — realizimin ose dështimin e saj»¹.

Lidhur me këtë, është e nevojshme që organizatat e Partisë të bëjnë një punë më të thellë ideologjike e politike me komunistët dhe me kuadrot për të çrrënjësuar kuptimin e ngushtë e të njëanshëm, që e redukton punën organizative vetëm në problemet e forcimit të jetës së brendshme të Partisë dhe e konsideron atë detyrë vetëm të disa organizmave e kuadrove të specializuar për këto probleme. Ato duhet të rrënjësin të të gjithë një koncept më të gjerë, më të qartë e më të drejtë mbi punën organizuese të Partisë.

Vija e përgjithshme e Partisë në tërësi, si dhe çdo detyrë konkrete në veçanti, qoftë kjo ideologjike, politike, ekonomike, kulturele, ushtarake etj., ka kurdoherë edhe anën e vet organizative, me fjalë të tjera duhet shoqëruar me masa organizuese efektive, përndryshe ajo mbetet, si të thuash, në letër dhe nuk mund të vihet në jetë. Si pasojë, puna organizuese nuk është e nuk mund të jetë çështje e disa njerëzve të veçantë, «specialistë» të problemeve organizative dhe as vetëm e organizatave dhe e organeve të Partisë. Çdo punonjës, veçanërisht çdo komunist e çdo kuadër drejtues, në cilëndo fushë të jetës shoqërore që të punojë, duhet të jetë njëkohësisht një organizator në kuptimin më të gjerë të fjalës, dmth të dijë t'i organizojë në mënyrë sa më racionale punën dhe vendin e punës, shfrytëzimin e kohës, zbatimin e detyrave, kontrollin për plotësimin e tyre etj.

Por duhet thënë se në lëmin e organizimit të punës, të marrë në një aspekt të tillë të gjerë, me gjithë përmirësimet e bëra, ne kemi akoma të meta e boshllëqe, si në veprimtarinë e organizatave dhe të organeve drejtuese të Partisë e të organizatave shoqërore, ashtu edhe në veprimtarinë e organeve shtetërore dhe ekonomike, të kuadrove drejtues e të punonjësve. Është fakt se niveli i punës sonë organizuese nuk u përgjigjet në shkallën e duhur vijës politike dhe detyrave që shtron Partia në etapën e tanishme të zhvillimit tonë. Në shumë hallka ne vuajmë akoma nga rutina praktikiste dhe nga mungesa e një organizimi e drejtimi me të vërtetë shkencor të ekonomisë dhe të sektorëve të tjerë të jetës shoqërore. Kemi akoma shfaqje të theksuara të një centralizimi të tepruar e të tutelës burokratike, që pengojnë zhvillimin e plotë të inisiativës e të vetëveprimit krijues, sido-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 352.

mos të bazës e të masave punonjëse. Në organizimin e punës për edukimin komunist të punonjësve vihen re akoma shfaqje të formalizmit, të shkëputjes nga jeta e gjallë, të kënaqjes me rezultatet e jashtme. Në shumë raste kjo punë nuk shoqërohet në shkallën e duhur me masa organizative, ekonomike e teknike, gjë që ul efektivitetin e saj. Dobësi e të meta ka gjithashtu në punën për forcimin e rolit drejtues dhe edukues të organizatave të Partisë për njohjen, përgatitjen dhe ngritjen në përgjegjësi të kuadrit të ri, si dhe për shpërndarjen dhe përdorimin racional të kuadrove.

Këto dobësi e të meta kanë burimet e veta shoqërore, ekonomike dhe ideologjike. Ato janë pasojë e karakterit të theksuar mikroborgjez të vendit tonë në të kaluarën, e rrënjësjes së shprehive të pronës së vogël private e të prodhimit artizanal, e prapambetjes kulturele dhe e mungesës së traditave të një organizimi të përparuar e shkencor në punë, të trashëguara nga rendi i vjetër shoqëror. Burimin e këtyre të metave e dobësive në fuqinë e organizimit të punës, duhet ta kërkojmë gjithashtu në shfaqjet e shtrembërimet burokratike, në veprimtarinë e organeve shtetërore dhe ekonomike, në punën e Partisë e të organizatave të masave, si dhe në frymën e konservatorizmit që i lidh njerëzit pas metodave e formave të vjetra të organizimit të kapërcyera nga jeta. Nga kjo pikëpamje lufta për përsosjen e organizimit të punës ka një përmbajtje të thellë ideologjike. Atë duhet ta shohim si një luftë kundër koncepteve mikroborgjeze, burokratike e konservatore.

Një pjesë e këtyre kushteve e faktorëve frenues tanimë janë kapërcyer, ndërsa shkaqet e tjera sot mund të luftohen me sukses. Në gjithë sektorët e punës sonë është grumbulluar tanimë një përvojë e pasur dhe e gjithanshme. Ekzistojnë të gjitha mundësitë për ta ngritur tërë punën organizuese në një nivel më të lartë, në mënyrë që ajo t'u përgjigjet më mirë detyrave të kohës. Qëllimi i këtij Plenumi të Komitetit Qendror është pikërisht të tërheqë vëmendjen rreth këtij problemi jetik dhe të përcaktojë orientimet e masat konkrete që duhen marrë në këtë fushë.

I

TË PËRMIRËSOJMË ORGANIZIMIN DHE DREJTIMIN E EKONOMISË PËR NJË ZHVILLIM TË MËTEJSHËM E TË VRULLSHËM TË SAJ

Stadi i arritur, si dhe perspektivat e zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës, shtrojnë si një nevojë të ngutshme ngritjen

në një shkallë më të lartë të gjithë punës organizuese e drejtuese në fushën e ekonomisë. Sot ekonomia jonë ka arritur një zhvillim të ri sasior e cilësor. Janë krijuar e po krijohen degë të reja, sidomos të industrisë së rëndë përpunuese, të industrisë kimike etj., po ngrihen ndërmarrje të mëdha e komplekse, të pajisura me një teknikë e teknologji të përparuar, po kalohet kudo në prodhimin industrial modern, bujqësia është futur në rrugën e intensifikimit, po merr përpjestime të gjëra specializimi e kooperimi, po zhvillohet me vrull revolucioni tekniko-shkencor. Të gjitha këto tregojnë se ekonomia jonë po hyn në një etapë të re, në atë të zhvillimit të saj intensiv. Në këto kushte del e domosdoshme që të përsosen më tej format e organizimit e të drejtimit të ekonomisë, në përshtatje me stadin e ri dhe detyrat e reja dhe të hiqet dorë nga të gjitha ato forma e metoda pune që vetë jeta i ka lënë prapa.

Cilat janë në këtë periudhë problemet më të rëndësishme në fushën e organizimit e të drejtimit më të mirë të ekonomisë? Këto janë: çrënjosja e rutinës dhe ngritja e nivelit të punës drejtuese mbi baza shkencore, rritja e mëtejshme e pjesëmarrjes së masave punonjëse në drejtimin dhe administrimin e ekonomisë, përsosja e metodës së drejtimit të ekonomisë në bazë të njohjes më të thellë të ligjeve ekonomike.

Le të ndalemi më konkretisht në to:

1. — Të çrënjosim rutinën dhe të ngremë nivelin e punës drejtuese mbi baza shkencore. Me gjithë sukseset e arritura në përmirësimin e metodës së punës për drejtimin e ekonomisë, kjo mbetet akoma një problem i rëndësishëm, të cilin duhet ta mbajmë vazhdimisht parasysh. Kuadrot drejtues të sektorëve ekonomikë të kuptojnë më drejt dhe më qartë rolin dhe funksionin e tyre dhe të mos i reduktojnë ato, siç ndodh nganjëherë, në drejtimin thjesht operativ të ekonomisë, sepse një praktikë e tillë është e ngushtë, e njëanshme dhe sjell pasoja të dëmshme. Detyra e organeve dhe e kuadrove drejtues të ekonomisë, është që, krahas drejtimit operativ, të merren edhe më mirë me zbërthimin e politikës ekonomike të Partisë e të qeverisë, të drektivave e të orientimeve të tyre, të gjejnë rrugët më të drejta e më të efektshme për t'i vënë ato në jetë. Për këtë është e domosdoshme që në punën e tyre t'u kushtojnë një kujdes më të madh përgjithësimëve e studimeve shoqëroro-ekonomike e tekniko-organizative për problemet themelore të ngutshme e të perspektivës. Vetëm kështu ato do të jenë në gjendje t'i japin bazës një ndihmë me të vërtetë të vlefshme e të kualifikuar. Ne duhet të rrenjosim thellë konceptin se të merresh me studime e analiza shkencore është sot një gjë krejt e domosdoshme për një drejtim

me të vërtetë shkencor të ekonomisë sonë socialiste. Lenini i madh thoshte:

«Për përtëritjen e aparatit tonë shtetëror, ne duhet me çdo kusht t'i caktojmë vetes si detyrë: së pari — të mësojmë, së dyti — të mësojmë dhe së treti — të mësojmë dhe pastaj të kujdesemi që shkenca të mos mbetet te ne një fjalë e vdekur ose një frazë e modës (gjë që, s'kemi pse e fshehim, ndodh te ne shpeshherë), që shkenca të bëhet me të vërtetë mishi dhe gjaku ynë, që ajo të bëhet pjesë e pandarë e jetës sonë të përditshme, në mënyrë të plotë dhe me të vërtetë»¹.

Pikërisht për shkak të konceptit të ngushtë praktikist lidhur me drejtimin e ekonomisë, dikasteret dhe administratat e ndërmarrjeve nuk po merren si duhet me studimin e mjaft problemeve të rëndësishme të zhvillimit të ekonomisë sonë. Është fakt se rreth 80 për qind të problemeve që janë shqyrtuar gjatë vitit 1969 në kolegjiunet e ministrive të Industri-Minierave, të Bujqësisë, të Komunikacionit kanë qenë të karakterit operativ. Ndonëse kemi mbi 50 ndërmarrje të mëdha jo rentabël, që i shkaktojnë shtetit një humbje vjetore prej 57 milion lekësh, dhe për të cilat herë pas here janë bërë analiza të ndryshme, akoma nuk ka studime ekonomike të thella për t'i nxjerrë ato përfundimisht nga kjo gjendje. A duhej të priste Ministria e Komunikacionit që të nxitej nga lart për të ndërmarrë një studim kompleks për shfrytëzimin më racional të të gjitha mjeteve të transportit, kur dihet se kjo është një nga detyrat e saja kryesore? Me gjithë seriozitetin e problemit të kooperimit midis degëve në bujqësi dhe me gjithë orientimet e Plenumit III të Komitetit Qendror të Partisë, akoma nuk kemi studime komplekse e shkencore për këtë problem të madh.

Rutina e përditshme i shtyn shpesh organet dhe kuadrot drejtues, duke filluar nga dikasteret qendrore dhe deri poshtë në ndërmarrje e kooperativë, t'i mbytin organet e kuadrot vartës me një mori kërkesash korrente, që në një pjesë të mirë mund të shmangeshin, gjë që i detyron ata të mos i kushtohen një pune më të thelluar e studimore. Disa kuadro drejtues në praktikën e tyre as vetë nuk merren me studime dhe as vartësve të tyre nuk u llogaritin kohën që të bëjnë studime. Është e nevojshme të bëhet një luftë më këmbëngulëse në mënyrë që çdo organ e çdo kuadër t'i njohë si duhet e t'i zbatojë deri në fund detyrat që i përkasin, të mbajë përgjegjësi të plotë për punën

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 550.

e ngarkuar dhe të veprojnë me inisiativë brenda kompetencave të veta. Nga ana tjetër, duhet të luftohen e të çrrënjosen më me vendosmëri shfaqjet e tutelës e të ndërhyrjeve të pajustificuara të instancave më të larta në punën e organeve e të kuadrove vartës, duke u lënë atyre më shumë kompetencë, më tepër inisiativë e liri veprimi për të zgjidhur problemet që u takojnë, gjë që do t'i shkarkojë edhe vetë organet eprorë nga një barrë e tepërt, për t'u marrë më shumë me përgjithësime e studime.

Për të luftuar rutinën dhe rendjen pas çështjeve korrente, operative duhet të mënjanohej çrregullimet që vihen re në planifikimin e furnizimit materialo-teknik, ku caktimi i detyrave nuk përputhet kurdoherë me shpërndarjen e mjeteve materialo-teknike të nevojshme për realizimin e tyre. Veçanërisht të ndieshme janë ndryshimet dhe vonesat në furnizimin e materialeve të importit, në zbatimin e kontratave etj. Për shkak të këtyre të metave e dobësive problemet e furnizimit materialo-teknik u marrin një pjesë të madhe të kohës njerëzve, duke përfshirë edhe kuadrot drejtues kryesorë të ekonomisë nga baza deri në organet qendrore, të cilët, në vend që të merren me përgjithësime e studime, janë të detyruar të sorollaten e të bredhin çdo ditë andej këtej për të siguruar materialet e nevojshme për realizimin e planit.

Detyrat për ta çuar më tej zhvillimin e ekonomisë kërkojnë që të forcohen, të zgjerohen e të ndihmohen grupet dhe bërthamat e posaçme studimore, si poshtë në bazë, në ndërmarrje, ashtu edhe në rreth e në qendër. Ka ardhur koha që eksperimentimi shkencor, futja e metodave të reja në fushën e prodhimit, puna e kërkimeve dhe e studimeve që po stimulohet në të gjitha hallkat, të mos i lihen spontaneitetit, por të ndërtohen, të planifikohen e të disiplinohen në një shkallë shumë më të lartë se deri tani, të sigurohen për to baza materialo-eksperimentale, kuadrot dhe mjetet e tjera të nevojshme.

Rendi kooperativist në fshat është forcuar dhe kooperativat bujqësorë sot janë ekonomi të mëdha socialiste. Lufta për intensifikimin e bujqësisë, për rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, sipas parimit «më shumë, më mirë dhe më lirë», shtrun me forcë të madhe nevojën e përsosjes së punës për një drejtim më shkencor të ekonomisë së kooperativave. Mirëpo deri tani jo vetëm në kooperativat e vogla, por edhe në ato të zmadhuara ne jemi shumë prapa në lëmin e studimeve dhe të analizave shkencore me karakter agroteknik dhe ekonomiko-shoqëror. Neve nuk na lejohet që, sidomos në ekonominë e mëdha bujqësore, të mos kemi as ndonjë bërthamë të thjeshtë që të merret me disa analiza e studime elementare, krejt të domosdoshme

për zhvillimin dhe drejtimin e një ekonomie bujqësore shumë-degëshe.

Përmirësimi rrënjësor i metodës së drejtimit të ekonomisë sonë socialiste kërkon të merren sa më parë masa efektive që në të gjitha organet drejtuese të ekonomisë, duke filluar nga ndërmarrjet e kooperativat bujqësore e deri në dikasteret qendrore, të bëhet një ndarje më e mirë dhe më racionale e forcave dhe e kohës, për studime e përgjithësime dhe për ndjekjen e çështjeve korrente. Përsosja e mëtejshme e drejtimit të ekonomisë dhe zhvillimi i mendimit tonë ekonomik, kërkojnë gjithashtu që të vihet më mirë në jetë porosia që dha shoku Enver për organizimin e një pune të gjerë për njohjen e ligjeve ekonomike të socializmit nga kuadrot dhe nga masat punonjëse, për studimin masiv të problemeve të ekonomisë politike të socializmit¹.

2. — Të rritet më tej pjesëmarrja e masave punonjëse në drejtimin dhe administrimin e ekonomisë. Parimi i patundur i drejtimit të ekonomisë sonë ka qenë dhe mbetet centralizmi demokratik. Ky është një drejtim që bëhet nga shteti në emër të shoqërisë e të punonjësve, në interes të tyre, për të plotësuar nevojat e tyre materiale e kulturele dhe që mbështetet në pjesëmarrjen e organizuar të masave punonjëse në administrimin e ekonomisë. Çdo dobësim i këtij drejtimi të çon medoemos ose në forcimin e centralizmit burokratik që përjashton, pengon e kufizon pjesëmarrjen e masave punonjëse, duke i kthyer ato vetëm në objekt të drejtimit shtetëror, ose në një decentralizim liberal që u hap rrugën spontaneitetit, anarkisë, konkurrencës, papunësisë e të këqijave të tjera të sistemit kapitalist të ekonomisë, siç ngjet sot në vendet ku në fuqi janë revizionistët dhe po rivendoset kapitalizmi.

«S'ka asgjë më të gabuar se sa përzierja e centralizmit demokratik me burokratizmin dhe me shabllonizmin»²,

ka theksuar V.I. Lenini. Për këtë arsye, na mëson shoku Enver,

«Partia ka qenë dhe do të jetë kurdoherë për centralizmin demokratik, kundër centralizmit burokratik... dhe decentralizimit anarkik»³.

1 Fjala e mbajtur me punëtorë, kooperativistë dhe kuadro të rrethit të Beratit «Si duhet t'i kuptojmë dhe t'i zgjidhim drejt disa çështje të ekonomisë sonë socialiste» 26 shkurt 1969.

2 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 27, f. 228.

3 Shih në këtë vëllim f. 114.

Partia jonë, kohë pas kohe, ka marrë masa për të forcuar centralizimin demokratik, për të luftuar drejtimin burokratik dhe për të mos i lënë asnjë shteg decentralizimit liberal. Këto masa kanë qenë të drejta dhe kanë dhënë rezultate shumë të mira. Ato kanë rritur inisiativën e vetëveprimin në të gjitha nivelet e drejtimit të ekonomisë, kanë zgjeruar të drejtat dhe kompetencat e bazës. Megjithatë jeta tregon se këto masa duhen thelluar më tej, sepse ende ka shfaqje të një centralizimi të tepruar, veçanërisht në organet shtetërore qendrore. Ky centralizim shpesh merr formën e drejtimit thjesht administrativo-tekno-kematik dhe ngushton kompetencat, të drejtat e përgjegjësive e bazës. Shfaqje të tilla vihen re sidomos në planifikimin e ekonomisë, në shpërndarjen dhe përdorimin e materialeve e të mjeteve monetare, në caktimin e një numri mjaft të madh treguesish tekniko-ekonomikë nga lart etj. Nuk është aspak e nevojshme për shembull që të centralizohen çështje të tilla si caktimi i pjesëve të ndërrimit që duhet të rigjenerohen, caktimi i sasisë së perimeve që duhet të prodhohet ky ose ai rreth, caktimi i vëllimit të prodhimit për mjaft artikuj që nuk ngrenë peshë në ekonominë e përgjithshme, si bëhet nga disa organe qendrore. Çështje të tilla mund të lihen shumë mirë në kompetencë të rretheve.

Këto praktika, në qoftë se nuk ndiqen, mund të çojnë në një koncept të gabuar e burokratik lidhur me marrëdhëniet midis organeve ekonomike drejtuese dhe ndërmarrjeve, midis administratës dhe masës së punonjësve, sipas të cilit të parët kanë vetëm të drejta të caktojnë detyra, kurse të dytët, kanë vetëm detyrime e përgjegjësi për të plotësuar detyrat që u caktohen nga të parët. Centralizimi i tepruar është një nga shkaqet që i shtyn organet drejtuese të merren me gjëra të vogla korrente dhe të mos u kushtojnë vëmendjen e duhur studimeve e përgjithësisimeve.

Jeta po na bind se rritja e hovit revolucionar të masave punonjëse, forcimi i rolit udhëheqës të klasës punëtore, shtimi i kuadrove, pasurimi i përvojës së tyre dhe ndërlikimi i marrëdhënieve midis degëve e njësive ekonomike, duhet të shoqërohen me doemos me zgjerimin e kompetencave dhe të të drejtave, me rritjen e inisiativës e të përgjegjësive së drejtëpërdrejtë të çdo hallke të organeve shtetërore dhe ekonomike nga lart-poshtë, sidomos në bazë e në çdo kolektiv punonjës. Për këtë qëllim ne duhet të zbatojmë forma të tilla organizimi e drejtimi, që të lejojnë zgjerimin gjithnjë më shumë të rrethit të njerëzve që duhet të shfaqin mendimin e tyre në përgatitjen dhe marrjen e vendimeve në ndërmarrje, në kooperativë, në komitetin ekze-

kutiv, në ministri dhe deri në hartimin e planit për gjithë ekonominë e për çështje të tjera ekonomike në shkallë kombëtare. Në këtë mënyrë masat punonjëse do ta ndiejnë më thellë e do ta prekin më mirë gjendjen e tyre të vërtetë si zot të vetvetes, të ekonomisë, të punës e të produktit të prodhuar prej tyre, do të ndiejnë më mirë përgjegjësinë dhe do të mobilizojnë të gjitha forcat për realizimin e atyre vendimeve e detyrave që ata vetë i kanë marrë ose aprovuar në mënyrë të vetëdijshme.

Veç kësaj, sa më shumë të zgjerohet pjesëmarrja e punonjësve në drejtimin e ekonomisë, aq më shumë do të mobilizohen e shfrytëzohen rezervat e brendshme, do të zbulohet e përgjithësohet përvoja e përparuar. Asnjë organ qendror shtetëror dhe i ekonomisë nuk mund të jetë në gjendje t'i njohë këto më shumë e më mirë se vetë punonjësit që janë në ballafaqim të përditshëm me to. Pikërisht për këtë arsye në mjaft raste, ndonëse nga organet qendrore planifikohen detyra më të ulëta, kolektivat punonjëse i caktojnë vetes detyra më të larta dhe arrijnë rezultate më të mëdha. Kështu ka ndodhur për rritjen e përpunimit të naftës në uzinën e Cërrikut, për prodhimin e bitumit të lëngshëm për eksport, për shtimin e rezervave gjeologjike dhe të nxjerrjes së kromit në vendburimin e Batrës, për rritjen e prodhimit të tekstileve në kombinatet «Stalin» e «Mao Ce Dun», për prodhimin e tullave, të çimentos e të enëve prej qeramike në fabrikat e Tiranës etj. etj.

Por ka edhe raste kur baza paraqit një plan më të vogël se mundësitë e saja të vërteta dhe për realizimin e tij kërkon mjete materiale e financiare më shumë se sa i duhen në të vërtetë. Edhe kjo ndodh sepse nuk tërhiqet si duhet mendimi i gjallë e aktiv i vetë punonjësve në hartimin e planit.

Për të rritur më tej inisiativat dhe propozimet e punonjësve në caktimin e detyrave që duhet të marrin përsipër, si dhe në zgjedhjen e mjeteve e të rrugëve që duhet të përdorin për t'i plotësuar ato, është e nevojshme që për hartimin e planit punonjësit në bazë, ndërmarrje apo kooperativë të marrin pjesë aktive dhe ta thonë më mirë fjalën e tyre. Megjithëse këtë çështje e kemi shtruar drejt në parim dhe flasim shumë për të, në praktikë nuk ndodh kurdoherë kështu. Kur ndërmarrjeve u dërgohet plani, atyre u caktohen gati të gjithë treguesit që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomiko-prodhuese dhe lihen pak mundësi që punëtorët të propozojnë variante të tjera, gjëra të reja, të paparashikuara nga lart. Por edhe në rastin kur baza, punëtorët bëjnë propozime, ose shfaqin një inisiativë, këto, meqenëse duhet të studjohen më parë lart, të aprovohen me doemos nga dikasteret, ndodh që zvarriten, ose ngandonjëherë lihen

fare në harresë. E njëjta gjë ngjet edhe në kooperativat bujqësore, sepse edhe atyre, kur u dërgohet plani nga rrethi, në mjaft rastë u caktohen jo vetëm llojet e sasisë e prodhimeve, por deri edhe hektarët që do të mbjellin me këtë ose atë kulturë.

Një centralizim i tillë i tepruar nuk është as i domosdoshëm as i drejtë. Centralizimi i tepruar, siç na mëson shoku Enver, kur gjithëka shqyrtohet ose aprovohet nga lart, rutina, ngurrimet ose frenimet që pengojnë për t'u mbështetur fuqimisht te klasa punëtore, te kooperativistët, te teknikët, inxhinierët, drejtorët, na çon në dobësimin e vijës së masave, në mospërfilljen e mendimit dhe dëshirave të tyre. Në qoftë se lejojmë që këto gjëra të trashen, masat nuk do ta aprovonjë një metodë pune të tillë në kundërshtim me parimet e Partisë sonë. Prandaj duhet të përpigemi dhe të gjejmë forma më të përshtatshme, të cilat të lejojnë dhe të nxitin që punëtorët dhe kooperativistët të marrin pjesë më aktive se deri sot dhe ta thonë më mirë mendimin e tyre krijues si në hartimin e planeve ekonomike, ashtu dhe në luftën për zbatimin e tyre. Pa e bërë këtë, ne nuk do të mundemi të luftojmë me sukses kundër shfaqjeve të burokratizmit dhe teknokratizmit.

Organet qendrore duhet të caktojnë drejtimet e përgjithshme të zhvillimit të ekonomisë, detyrat dhe treguesit kryesorë më të domosdoshëm, që kushtëzojnë e sigurojnë zhvillimin e harmonishëm e proporcional të ekonomisë; njëkohësisht të studjojnë me kujdes propozimet e inisiativat e punonjësve, kërkesat e bazës për investime e import, t'i llogaritin e t'i matin mirë cilat prej tyre janë të mundshme e më të leverdisshme të bëhen dhe cilat jo, cilat mund të bëhen sot dhe cilat më vonë, për cilat ka nevojë më shumë e më parë ekonomia e kështu me radhë, në vend që të merren me hollësi e vogëlsira të panevojshme, duke cunguar kështu të drejtat e kompetencat e bazës.

Veç të tjerave, propozimet, inisiativat, mendimet e punonjësve, jo rrallë, pengohen edhe për faktin se planet hartohen cip më cip, gjë që e bën të vështirë të gjenden mundësi për të financuar zbatimin e inisiativave ose të propozimeve të reja që dalin nga poshtë, nga baza, dhe që janë të leverdisshme nga ana ekonomike. Në rrethana të tilla do të prishet në një anë, që të rregullohet në anën tjetër. Prandaj në këtë drejtim duhen parashikuar kurdoherë disa rezerva, disa lehtësime e kompetenca për bazën.

Shpesh është folur se duhet treguar më shumë kujdes e duhen bërë më shumë përpjekje për të shtuar prodhimin e të ashtuquajturave mallra të vogla, për të cilat kanë shumë nevojë masat punonjëse ose ekonomia popullore. Por, megjithëse në këtë drejtim janë bërë disa përpjekje, vihet re se ka akoma

mjaft mungesa, se ndërmarrjet nuk janë të interesuara të prodhojnë gjëra të vogla, që nuk ngrenë peshë në globalen, por që janë krejt të domosdoshme. Inisiativat e propozimet e punëtorëve për të prodhuar gjëra të tilla hasin në shumë vështirësi e pengesa burokratike, që nxjerrin administratat e ndërmarrjeve ose organet më të larta që i drejtojnë. Prandaj është e domosdoshme që organizatat e Partisë ta shohin këtë çështje, në radhë të parë, jo thjesht nga leverdia ekonomike imediate, por lidhur ngushtë me perspektivat e zhvillimit të ekonomisë dhe forcimin e pavarësisë së saj. Ato duhet të nxitin e të përkrahin inisiativat e mendimet krijuese të punëtorëve e të specialistëve për të shtuar prodhimin e gjithë atyre mallrave të konsumit të gjerë që sot prodhohen me pakicë në vend ose sillen nga jashtë. Për këtë qëllim është mirë të rriten rezervat e disa lëndëve të para që duhen për të prodhuar mallrat e vogla dhe të sigurohet një sasi fondesh financiare e mjetesh materiale, për të bërë aty-këtu edhe ndërtime të reja kapitale.

Në kushtet e ekonomisë sonë, kur importojmë shumë mjete e objekte pune, centralizimi i import-eksportit është i domosdoshëm dhe përbën një çështje parimore me rëndësi të madhe politike dhe ekonomike. Por format e organizimit dhe procedurat që lidhen me importin, eksportin dhe shpërndarjen e furnizimit materialo-teknik paraqitin një centralizim të rënduar dhe shpesh burokratik, i cili krijon një vëllim pune shumë të madh për organet e qendrës. Është e domosdoshme që ky centralizim të shkarkohet nga gjërat e tepërta, të kombinohet më mirë me pjesëmarrjen e bazës, me zgjerimin e kompetencave të saja dhe të përmirësohen format për organizimin e kësaj pune.

Hap pas hapi është e nevojshme të hiqet dorë edhe nga praktika e derisotme, kur organet qendrore ose administratat, pa e njoftuar fare kolektivin punonjës, ndryshojnë planet e bazës, ose ndryshojnë gjatë vitit detyrat e caktuara në planin shtetëror. Të vendoset një rregull i përgjithshëm, si për organet qendrore, ashtu edhe për administratat në ndërmarrje e kooperativa, që për çdo ndryshim të rëndësishëm të detyrave të caktuara në planin shtetëror, si rrjedhim i zbulimit të rezervave të reja ose i nevojës për të vendosur përpjesëtime më të drejta në kuadrin e ekonomisë popullore, të vihen në dijeni punonjësit, të cilët duhet të sqarohen e të binden për këto ndryshime. Shqyrtimi me partishmëri të lartë në kolektivat punonjëse i ndryshimeve që u bëhen projektplaneve ose detyrave të caktuara në planin e shtetit, duhet të shikohen nga organizatat e Partisë si një mjet për lidhjen më të ngushtë të organeve më të larta me bazën, për t'u bërë masave më mirë të njohura detyrat e reja, në mënyrë që ato vetë të përcaktojnë rrugët e

mjetet më të përshtatshme për plotësimin e tejkalimin e tyre. Më në fund të përmirësohet puna e komisioneve të planifikimit, me qëllim që të ndihmojnë në studimin e shumë çështjeve që nxjerr jeta dhe që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomiko-prodhuese të ndërmarrjeve gjatë zbatimit të planit.

3. — Të përsosim më tej metodën e drejtimit të ekonomisë në bazë të njohjes më të thellë të ligjeve ekonomike. Ngritja në një shkallë më të lartë e drejtimit të ekonomisë, vënia e tij mbi themele të shëndosha shkencore, është e mundur vetëm mbi bazën e njohjes dhe të zbatimit të vetëdijshëm të ligjeve ekonomike objektive të socializmit, mbi bazën e studimeve të mbështetura në këto ligje.

Sukseset e mëdha që janë arritur në ndërtimin socialist të vendit, në zhvillimin e vrullshëm dhe harmonik të ekonomisë popullore, tregojnë se Partia jonë ka zbatuar kurdoherë një politikë ekonomike të drejtë, të mbështetur në këto ligje. Megjithatë, detyrat e reja që shtrun zhvillimi i sotëm i ekonomisë kërkojnë që, krahas studimeve teknike e teknologjike, krahas drejtimit teknik të prodhimit, të merremi më mirë e më shumë me studime shoqëro-ekonomike në të gjitha hallkat, sidomos në bazë, për të përsosur drejtimin ekonomik të prodhimit në kuptimin e vërtetë të fjalës dhe të përpigemi për të gjetur variantet më optimale, të bazuara shkencërisht. Veçanërisht të mbahet më mirë parasysh ana ekonomike në përcaktimin e detyrave tekniko-teknologjike e organizative.

Në këtë drejtim neve na duhet të përsosim më tej organizmat ekonomike që kemi. Në fakt organizmat tona ekonomike, veçanërisht në bazë, priren më shumë nga problemet e kontabilitetit e të furnizimit. Në një pjesë të ndërmarrjeve shtetërore, dhe sidomos në kooperativat bujqësore që sot përfaqësojnë ekonominë të mëdha e komplekse, ne kemi shumë pak ekonomistë në kuptimin e vërtetë të fjalës. Për më tepër, edhe atje ku kemi kuadro ekonomistë, këta shpesh përdoren jo për drejtim e studime ekonomike, për të përcaktuar zhvillimin perspektiv dhe harmonik të ekonomisë, por ngarkohen me punë të vogla korrente, me çështje të furnizimit etj., ose për shkak të nënvlefësisë së anës ekonomike, në vendin e ekonomistit caktohen formalisht kuadro që nuk kanë përgatitjen dhe përvojën e duhur.

Prej ekonomistëve në ndërmarrje, në komitetin ekzekutiv të k.p. të rrethit apo në dikaster duhet të kërkojmë që, në radhë të parë, të merren me analizën e veprimtarinë ekonomike në shkallë ndërmarrjeje, rrethi apo dege; të bëjnë studime dhe të përkajtojnë mendime e propozime konkrete për të rritur prodhimin e këtij apo atij artikulli, për leverdinë ekonomike të njërit apo të tjetrit prodhim, të eksportit apo të importit, për ngritjen e

repartëve apo të linjave të reja; të gjejnë rrugët më të efektshme për të pakësuar shpenzimet e prodhimit, për të rritur rendimentin e punës dhe rentabilitetin; të harmonizojnë sa më mirë e më drejt treguesit që kanë të bëjnë me anë të veçanta të veprimtarisë ekonomike dhe me ruajtjen e përpjesëtimeve të drejta etj. Për këtë qëllim, organet e Partisë e të shtetit lypset të marrin masa për të ngritur kualifikimin e ekonomistëve ekzistues dhe për një përgatitje më të mirë të specialistëve të rinj në shkollat e mesme e të larta ekonomike.

Përmirësimi i organizimit të punës për drejtimin e ekonomisë kërkon patjetër që metodat e drejtimit administrativ të gërshetohen më mirë me metodat e drejtimit ekonomik. Në këtë fushë, duke u mbështetur në përvojën e deritanishme, në njohjen më të thellë të realitetit të ekonomisë sonë e të ligjeve të saj, si edhe në zhvillimin e mendimit tonë ekonomik, ne duhet të çajmë përpara e të gjejmë rrugë më të përsosura e më efektive për drejtimin e prodhimit shoqëror. Përpjekjet tona lypset të synojnë që ndërmarrja, si qeliza themelore e prodhimit shoqëror, të ketë më shumë inisiativë për të caktuar detyra sa më të larta dhe për të rritur efektivitetin e prodhimit, që ajo të interesohet më shumë për fatin e prodhimit të saj, për përparimin e teknikës, përsosjen e organizimit të punës, rritjen e rendimentit etj.

Rritja e përpjesëtimeve të prodhimit shoqëror, nevoja për ta kthyer më shumë fytyrën nga cilësia, për të zbatuar teknikën e re e teknologjinë moderne, si edhe probleme të tjera që lidhen me intensifikimin e ekonomisë, kanë nxjerrë në shesh të meta e boshllëqe në drejtimin e ekonomisë. Nganjëherë ndodh që kërkesat e konsumatorëve dhe nevojat e ekonomisë nuk plotësohen, sepse ndërmarrja «prodhon për hir të plotësisë së globalit». Ka gjithashtu raste që kontratat nuk respektohen, që plani i asortimenteve nuk plotësohet, kurse globali tejkalohe; ose raste që ndërmarrja mund të zgjerojë apo të modernizojë prodhimin, por nuk ka mjete financiare apo materiale për ta bërë këtë.

Për të mënjanuar këto të meta, përveç të tjerave, rëndësi ka që të forcohet e të përsoset zbatimi i parimeve të hozrashotit. Lidhur me këtë shoku Enver thotë:

«Ndërmarrjet duhet të përpigën vazhdimisht që me shpenzime sa më të vogla të arrijnë rezultate sa më të mëdha, të mbulojnë shpenzimet me të ardhurat e tyre dhe të sigurojnë rritjen e vazhdueshme të akumulimit të brendshëm socialist. Për arritjen e këtij qëllimi organet

shtetërore, drejtuesit e ekonomisë dhe të gjitha kolektivat punonjëse duhet të luftojnë për të përdorur drejt dhe për të forcuar levat e ekonomisë që rregullojnë veprimtarinë e ndërmarrjeve në hozrashot...»¹.

Forcimi i parimeve të hozrashotit dhe i levave ekonomike në kuadrin e drejtimit të centralizuar, do të ndihmojë për të përcaktuar nga ana e ndërmarrjeve përpjesëtime të drejta qysh në hartimin e planeve, për të bashkërenditur të gjithë treguesit e planit, për të rritur luftën për uljen e kostos, shtimin e akumulimit, kursimin e fondeve themelore e të xhiros, për shfrytëzimin e të gjitha kapaciteteve prodhuese.

Nevoja për ta ngritur tërë punën e drejtimit të ekonomisë mbi një bazë më të lartë e më të shëndoshë shkencore, duke çrrënjësuar me vendosmëri rutinën praktikiste e burokratike, ka shtruar problemin për përsosjen e mëtejshme të strukturave të aparateve përkatëse shtetërore dhe ekonomike në ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore, në komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve e në dikasteret qendrore, si dhe të kompetencave në hallkat e ndryshme të drejtimit. Qëllimi është të gjendet një mënyrë e tillë e ndarjes së kompetencave, e cila të sigurojë:

Së pari, forcimin e mëtejshëm të unitetit organik të drejtimit politik, ekonomik, teknik e operativ të zhvillimit të ekonomisë, duke përmirësuar sidomos drejtimin ekonomik e tekniko-shkencor dhe duke vënë kurdoherë në plan të parë politikën proletare të Partisë.

Së dyti, kushte më të përshtatshme që organet dhe kuadrot drejtues të merren shumë më tepër se deri tani me përgjithësimet e studime të karakterit të ngutshëm e perspektiv.

Së treti, forcimin e theksuar të përgjegjësisë në punë, zhvillimin e mëtejshëm të inisiativës e të vetëveprimit në të gjitha hallkat e instancat e ekonomisë, mënjanimin e hallkave të tepërta, të dublimit e të tutelës në aparatet tona, në mënyrë që këto të jenë sa më të thjeshta, më të lira, më të zhdërvjellta e më dinamike.

Të gjitha këto probleme e detyra të mëdha që dalin në fuqinë e organizimit e të drejtimit të ekonomisë, shtrojnë para Partisë dhe shtetit nevojën e një studimi të thellë e kompleks. Ky studim të ndërmerret sa më parë, duke tërhequr mendimin krijues të punëtorëve, kooperativistëve e specialistëve, me qëllim që të arrihet në konkluzione e masa praktike, për ta ngritur tërë drejtimin e ekonomisë sonë socialiste në një shkallë më të

¹ Shih në këtë vëllim f. 115.

lartë, që t'u përgjigjet plotësisht kërkesave të mëdha të etapës së tanishme të zhvillimit të saj.

II

PËR NJË ORGANIZIM MË TË MIRË TË PUNËS EDUKATIVE TË PARTISË

Partia jonë gjithnjë e ka konsideruar ndërtimin e socializmit vepër të masave punonjëse. Në kundërshtim me predikimet teknokratike dhe ekonomiste të revizionistëve modernë, ajo ka theksuar se forca vendimtare e gjithë zhvillimit tonë shoqëror dhe ekonomik është njeriu ynë me ndërgjegjen e tij revolucionare.

Merita e madhe e Partisë dhe madhështia e revolucionit tonë qëndrojnë pikërisht në faktin se, bashkë me transformimet kolosale të kryera në jetën materiale të vendit tonë gjatë këtyre 25 vjetëve të pushtetit popullor, ka ndryshuar dhe njeriu ynë, krijuesi dhe ndërtuesi i shoqërisë së re.

Por a mund të themi vallë se tani gjithçka është arritur në këtë fushë dhe s'kemi më ç'të bëjmë? Kurrsesi jo! Për ne është e qartë se lufta në frontin ideologjik është një luftë e gjatë, e ndërlikuar dhe nga më të vështirat. Ndërgjegjia e njeriut nuk revolucionarizohet menjëherë dhe njëkohësisht në të gjitha drejtimet. Është e njohur kontradikta që, ndonëse në shkallën e gjithë shoqërisë ideologjia socialiste të ne është ideologji sunduese, jo të gjithë njerëzit dhe jo kurdoherë udhëhiqen në tërë veprimtarinë e tyre të përditshme nga kjo ideologji. Prandaj nuk ka vend për asnjë vetëkënaqësi.

Pa nënvleftësuar aspak punën e madhe që duhet bërë gjithnjë e më mirë për studimin dhe thellimin e mëtejshëm të problemeve ideologjike, për zbrëthimin e direktivave të Partisë dhe të mësimave të shokut Enver, për përgjithësimin teorik të praktikës revolucionare të ndërtimit tonë socialist dhe të eksperiencës së madhe të Partisë sonë, sot rëndësi të dorës së parë merr *organizimi* më i mirë i punës ideologjike të Partisë me masat. Kjo përbën tani një nga detyrat më aktuale, sepse këtu qëndron edhe një nga të metat më të mëdha të punës sonë në të gjithë sektorët ideologjikë.

Ku duhet të përqëndrohet më tepër vëmendja e komiteteve dhe e organizatave të Partisë për organizimin më të mirë të punës ideologjike dhe edukative?

1. — Partia ka theksuar edhe herë të tjera se edukimi i nje-

riut të ri, kalitja e pareshtur e tij si revolucionar i vërtetë bëhet në procesin e luftës për zhvillimin e revolucionit dhe për ndërtimin e socializmit. Masat e gjera punonjëse, që marrin pjesë në këtë proces të madh lufte e pune, kalojnë në një shkollë të vërtetë të edukimit revolucionar, mësojnë jo vetëm të ndërtojnë, por dhe të drejtojnë, të qeverisin e të kontrollojnë, të dallojnë të mirën nga e keqja, atë që duhet ruajtur dhe atë që duhet hedhur poshtë.

Por jo kurdoherë e nga të gjithë kuptohet si duhet rëndësia dhe roli i madh i veprimtarisë praktike revolucionare në edukimin e njeriut. Ndodh që kur flitet për edukimin e komunistëve dhe të punonjësve, vëmendja përqëndrohet në format dhe mjetet e edukimit, në seminarët e rrethet e studimit marksist-leninist, në punën me leksione etj. dhe lufta që bëjnë dhe duhet të bëjnë komunistët dhe masat për të vënë në jetë idetë dhe vendimet e Partisë konsiderohet si një fushë tjetër, që s'ka të bëjë me edukimin.

Kështu jo rrallë takohen organizata-bazë, si në qendrat e punës, në kooperativat bujqësore e sidomos në administratë, që format e Partisë i mbledhin në rregull, ku komunistët janë të ngritur dhe diskutojnë mirë për temat e ndryshme që zhvillojnë sipas programit, por jashtë formës së edukimit të Partisë ka qetësi, kritika kundrejt të metave dhe gabimeve është e dobët, nuk bëhet si duhet luftë dhe njerëzit u shmangen ndeshjeve për problemet ideologjike, ndeshjeve me konceptet fetare e bestytinitë e ndryshme etj. Në këto raste kemi të bëjmë me një kuptim e organizim abstrakt të edukimit, me atë lloj edukimi që është i huaj e plot rreziqe për Partinë.

Shoku Enver na mëson se edukimi i vërtetë bëhet atje ku, megjithëse flitet e diskutohet ndoshta më pak, por luftohet me këmbëngulje më të madhe, zhvillohet drejt dhe vazhdimisht lufta e klasave, ku mobilizohen dhe hidhen të gjitha forcat për të vënë në jetë vendimet e Partisë, ku mbahet një qëndrim kritik ndaj dobësive, ku kontrolli punëtor dhe i masave është gjithnjë zgjuar, atje ku zien puna dhe jeta revolucionare e komunistëve dhe e punonjësve. Të këtilla organizata partie dhe organizata masash ne kemi kudo. A nuk është një shkollë e madhe kalitjeje revolucionare ajo punë dhe jetë që bëjnë komunistët dhe punonjësit e hidrocentralit «Mao Ce Dun» në Vaun e Dejës, ku luftohet me heroizëm për mposhtjen e vështirësive dhe detyrat realizohen në afatin e caktuar? A nuk janë një shkollë e vërtetë e kalitjes revolucionare puna dhe lufta heroike që bën rinia jonë për ndërtimin e hekurudhës Elbasan-Prrenjas apo ajo e minatorëve dhe e montatorëve tanë të mrekullueshëm si dhe e shumë kooperativave bujqësore në fushë e në malësi? Detyra

është që shembulli i organizatave të tilla të përhapet kudo, që në të gjitha organizatat e Partisë, në të gjitha kolektivat punonjëse, në të gjithë vendin të vlojë puna dhe jeta revolucionare për zbatimin e direktivave të Partisë në të gjitha fushat e ndërtimit socialist.

Partia është duke zhvilluar një punë të gjerë e të gjithanshme ideologjike për t'i edukuar njerëzit me shprehi dhe zakone të reja në punë, në shoqëri e në familje, ajo bën një luftë të madhe me konceptet dhe veprimet burokratike e teknokratike, me zakonet prapanike e besimet fetare, me praktikat e metodat e vjetra të drejtimit, me shfaqjet e ideologjisë borgjeze e revizioniste, me çdo gjë të huaj për shoqërinë tonë socialiste. Rezultatet në këtë luftë janë në raport të drejtë me pjesëmarrjen aktive të masave të Partisë dhe të popullit në të. Duhet ta pranojmë si rregull se, sa më e madhe e më e gjerë të jetë pjesëmarrja e Partisë dhe e gjithë popullit në këtë luftë, aq më të mëdha e më të qëndrueshme do të jenë rezultatet e saj.

Prej këtej del se organizatat-bazë dhe komitetet e Partisë, organizatat e masave dhe organet shtetërore e ekonomike duhet t'i japin rëndësi të veçantë organizimit të punës për t'i mobilizuar e hedhur në luftë dhe në veprimtari revolucionare, për zbatimin e detyrave të Partisë, gjithë komunistët dhe masat e gjera të punonjësve të qytetit e të fshatit.

Gjithë jeta e Partisë sonë, dhe në mënyrë të veçantë këta vjetët e fundit, tregon qartë vlerën e madhe edukuese të inisiativave, të lëvizjeve dhe të aksioneve që janë ndërmarrë nga Partia dhe nga masat në të gjitha fushat e jetës. Mjafton të përmendim se lëvizja revolucionare e rinisë sonë, që u përkrah nga i gjithë populli, për mbylljen e të gjitha institucioneve fetare, u dha një goditje të fuqishme besimeve fetare, zbuloi dhe demaskoi shumë veprime armiqësore që fshiheshin prapa ikonës së Krishtit dhe veladonit të priftit, hodhi poshtë mjaft dogma mistiko-fetare që feja i përdorte për t'i mbajtur njerëzit «nën frikën e zotit» etj. Ose lëvizja masive për emancipimin e gruas me anë të luftës dhe veprimit konkret për prishjen e fejesave të lidhura që në moshë të vogël, për mbrojtjen e të drejtave të gruas etj., luajti një rol të madh në përpunimin e mendjes së njerëzve, në lidhje me vendin dhe rolin e gruas në shoqërinë tonë. Po kështu aksionet me goditje të përqëndruar janë bërë tani mjete të fuqishme për edukimin e njerëzve, kanë ngritur lart gatishmërinë, mobilizimin dhe ndërgjegjen socialiste të tyre, janë bërë shkolla të edukimit revolucionar të masave më të gjera të popullit punonjës.

Këtë eksperiencë të vlefshme të Partisë ne duhet ta pasurojmë e ta thellojmë më tej, duke shmangur dobësitë që vihen re në mjaft raste, siç janë prirjet për bujë e zhurmë, mungesat

në organizim, tendencat për aksione vetëm në fushën e prodhimit etj. Është veçanërisht e nevojshme të zhvillohet dhe të inkurajohet inisiativa e bazës në lëvizjet dhe aksionet. Inisiativa nga lart për të ndërmarrë aksione të ndryshme në objektet me karakter rrethi ose zone është e mirë dhe duhet përdorur, por ajo në asnjë mënyrë nuk duhet të pengojë e të frenojë inisiativën e bazës. Vetëm kështu lëvizjet dhe aksionet do të futen në metoden e punës të çdo organizate, do të organizohen kudo, si në fshat edhe në qytet, do të drejtohen në fronte të ndryshme të prodhimit, të edukimit e të jetës shoqërore, për problemet që shqetësojnë më shumë organizatat e Partisë e ato të masave, ndërmarrjet shtetërore, kooperativat bujqësore, shkollat etj.

2. — Duke i dhënë rëndësi veprimtarisë revolucionare, nuk duhet harruar se edukimi i njerëzve kërkon gjithashtu një punë politike e ideologjike, sqaruese e bindëse të dendur dhe sistematike. Vetvetiu, në mënyrë spontane nuk mund kurrsesi të formohet ndërgjegjia revolucionare e masave as në kushtet e kapitalizmit as në socializëm. Ajo formohet dhe forcohet me një punë të gjerë sqaruese e bindëse politike dhe ideologjike, arsimore e kulturele, ekonomike dhe shkencore, që organizon dhe udhëheq Partia. Roli kryesor këtu i përket propagandës, të cilën Partia e ka vlerësuar kurdoherë si një nga armët e saja më të fuqishme për edukimin dhe mobilizimin e masave punonjëse.

Propaganda e Partisë është fuqizuar mjaft vjetët e fundit, ajo ka përballuar përgjithësisht mirë problemet e mëdha që ka shtruar Partia për revolucionarizimin e jetës së vendit. Por në kushtet e reja kërkohet që propaganda me të gjitha format e saja dhe në të gjitha nivelet, të ngrihet në lartësinë e detyrave që na shtrojnë Partia dhe shoku Enver. Ajo t'u përgjigjet më shpejt e më mirë ngjarjeve, të jetë në pararojë të luftës së masave punonjëse, të lëvizjeve dhe aksioneve revolucionare të tyre me qëllim që mësimet e Partisë e të shokut Enver t'i bëjmë bindje të brendshme të të gjithë punonjësve. Në qoftë se kjo nuk arrihet në çdo rast, shkaku duhet ta kërkojmë në mjaft të meta e dobësi që akoma nuk janë çrënjësuar përfundimisht, kundër të cilave duhet bërë një luftë e vazhdueshme dhe e vendosur.

Ne duhet të ngrihemi me të gjithë forcën kundër punës globale, që përbën aspektin më të rëndësishëm të burokratizmit në propagandën e Partisë. Globalizmi shfaqet në trajtimin abstrakt e të përgjithshëm të problemeve, shkëputur nga jeta dhe lufta e punonjësve, në përsëritjen e perifrazimin e thjeshtë të direktivave, të parimeve e të politikës së përgjithshme të Partisë, në organizimin dhe zhvillimin e saj njëlloj si në qytet ashtu dhe në fshat, si në Parti, ashtu dhe në rini, si në fushë ashtu

dhe në malësi, si në shkollat e mesme ashtu dhe në ato të larta, pa përfillur veçoritë dhe problemet e veçanta të shtresave e të grupeve të popullsisë, nivelet e ndryshme të tyre etj. Pa luftuar me tërë forcën kundër këtyre shfaqjeve të globalizmit nuk mund të priten përmirësime të dukshme në punën e propagandës. Çfarë duhet për këtë?

Së pari, kërkohet një ngritje e re cilësore e gjithë punës edukative dhe propagandistike të Partisë. Tani nuk mjaftojnë puna dhe lufta për të krijuar te njerëzit bindje të përgjithshme, si bie fjala për dobinë e pjesëmarrjes në punë, për nevojën e arsimit të rinisë etj. Çështja është si të krijojmë te ata bindje të thella e të qëndrueshme për të rrënjësuar koncepte të drejta e të reja mbi aspektet më të ndryshme të veprimtarisë së tyre në punë e shoqëri, për të futur deri në skajet më të thella të ndërgjegjes së njeriut mësimet e Partisë, ideologjinë tonë socialiste, moralin tonë proletar.

Kjo kërkon që të hiqet dorë nga ajo punë edukative e propagandistike që bëhet formalisht, pa pasur parasysh nevojat dhe gjendjen reale. Kështu, u shtrua detyra për të organizuar punën për njohjen e ligjeve të ekonomisë politike nga masat dhe puna filloj. Por si zhvillohet ajo? Në Tiranë janë mobilizuar shumë kadro ekonomistë të dikastereve qendrore dhe kjo është një gjë e mirë, por në mjaft raste temat e referateve dhe problemet që trajtohen janë të menduara nga zyra e të nxjerra nga librat, prandaj shpesh nuk kuptohen nga punëtorët dhe nuk u ngjallin atyre interes. Është tipik në këtë drejtim qëndrimi që mbahet ndaj agjitacionit figurativ. Në qoftë se duhet një kohë për të vendosur parullat, pllakatat etj. lidhur me një fushatë apo problem, duhet dy dhe trefishi i saj për t'i zëvendësuar e përtrirë ato për një problem apo fushatë tjetër. Në vatrat e shtëpitë e kulturës në fshat nuk gjen vend bosh nga «zbukurimet», por a u shërbejnë tërë ato «zbukurime» detyrave që kanë punonjësit aktualisht për të zgjidhur? Në përgjithësi jo dhe kjo nuk i shqetëson shumë organizatat dhe komitetet e Partisë në rrethe.

Duhet hequr dorë sidomos nga skemat stereotipe, ku rëndësi u jepet fjalëve të bukura, frazeologjive boshe, nga mbledhjet me «duhet», ku flet lektori, dëgjon auditori dhe pastaj njerëzit shpërndahen. Këto duhen zëvendësuar me mbledhje të gjalla, ku të ziejnë debati e diskutimi, ku të shprehet lirisht mendimi i njerëzve. Diskutimi popullor për problemet e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës dhe ai kundër zakoneve prapanike e besimeve fetare janë një shembull pozitiv i organizimit të punës ideologjike të Partisë, i cili duhet zhvilluar e thelluar më tej, jo vetëm në shkallë kombëtare, por dhe në shkallë fshati, qendre pune, zone e sektori për problemet më të ndryshme të

punës dhe të jetës që u interesojnë punonjësve tanë. Në këto raste njerëzit folën mbarë e prapë, i thanë gjërat ashtu siç i mendonin. Por nuk ndodh gjithnjë kështu. Duhet luftuar kundër çdo drojtjeje, që buron nga mendimi se «mos gaboj», «mos ma marrin për ters» etj. Në të njëjtën kohë në mbledhjet dhe diskutimet duhet të krijohet një ambient i ngrohtë shoqëror, ku punonjësit të shfaqin lirisht mendimet e tyre për punën dhe njerëzit, duke u nisur kurdoherë nga qëllimi që t'u shërbejnë sa më mirë kuptimit dhe zgjidhjes së drejtë të problemeve që diskutohen.

Së dyti, ne duhet të vëmë më mirë në qendër të punës ideologjike të Partisë edukimin e masave me shembullin pozitiv. Mjafton të kujtojmë atë hov të madh revolucionar që ngjalli në mbarë rininë dhe popullin tonë akti heroik i Adem Rekës e i Shkurte Pal Vatës, i Ismet Sali Bruçajt e i Isuf Emin Plloçit për të kuptuar vlerën e pallogaritshme që ka shembulli pozitiv në edukimin e masave punonjëse, në mobilizimin e tyre për vepra të mëdha revolucionare. Ose ç'rull u dha në përgjithësi punës dhe emulacionit për plotësimin e planit pesëvjeçar para afatit, shembulli i lartë i dhjetëra ndërmarrjeve të Tiranës, të cilat, qysh vitin që kaloi, plotësuan detyrat e pesëvjeçarit; shembulli i kooperativës bujqësore «Partizani» të Fushë-Krujës që në 4 vjet plotësoi dhe tejkaloi të gjitha detyrat e pesëvjeçarit të katërt.

Të frymëzuar prej tyre dhjetëra ndërmarrje e kooperativa, rrethet Tiranë, Krujë, Lushnjë, Gjirokastrë, Peshkopi, Kolonjë, Berat dhe Elbasan kanë plotësuar qysh tani një sërë detyrash të rëndësishme të pesëvjeçarit. Shembuj të tillë në jetën tonë, në jetën e çdo fshati, qendre pune e njësie ushtarake, gjen përditë me qindra e me mijëra. A nuk është një frymëzim i ri për të gjithë aksioni tjetër i rëndësishëm i punonjësve të rrethit të Dibrës që, brenda 6 muajve, me goditje të përqëndruar, do të zgjidhin problemin e strehimit në qytetin e Peshkopisë? Detyra e propagandës së Partisë është që këta shembuj të lartë të njerëzve dhe kolektivave pararojë, që në mendime dhe në veprime, në punë dhe në jetë udhëhiqen nga mësimet e Partisë, nga ideologjia e saj revolucionare, t'i ngrrejë e t'i bëjë flamur.

Por duhet ta pranojmë se propaganda e Partisë ende nuk e kryen si duhet këtë detyrë. Shpeshherë ajo merret më tepër me kritikën e dobësive dhe të metave të fenomeneve negative në punën e në jetën e njerëzve dhe lë pas dore zbulimin dhe propagandimin e fenomeneve të reja që lindin në jetë, të punës heroike të njerëzve tanë, të veprave të tyre revolucionare për t'i zbatuar dhe mbrojtur mësimet e Partisë, normat morale të shoqërisë sonë kundër çdo gjëje të huaj për ideologjinë socialiste.

Së treti, ne duhet të përsosim e të përdorim më mirë të gjitha format dhe mjetet e propagandës së Partisë, të cilat luajnë një rol me rëndësi të madhe në edukimin e masave, në revolucionarizimin e ndërgjegjes së tyre.

Duhet ta themi që në fillim se në shumë raste vihet re një besim i tepërt në mbledhjet, në punën verbale përgjithësisht, thua se po të mos bëhen këto, nuk ka edukim të njerëzve, ndërsa nuk i përdorim sa duhet të gjitha ato mjete të fuqishme të edukimit masiv të popullit që na ka vënë në dorë Partia. Kemi shtypin dhe librin, radion dhe kinemanë, teatrot dhe pallatet e shtëpitë e kulturës, bibliotekat dhe muzeumet etj., pa folur për rrjetin e gjerë të shkollave. Por shpesh nuk llogaritet mbi këto mjete, ose shpesh veprimtaria e tyre nuk shihet me syrin e qëllimeve edukative.

Partia ka theksuar vazhdimisht se ndaj formave të punës edukative duhet mbajtur një qëndrim krijues e novator, se ato duhet të jenë të shumëllojshme, elastike dhe të çlirta. Pa dyshim, përmirësime ka. Mjaft korniza janë thyer e kapërcyer. Një shembull i mirë është mënyra e organizimit të studimit të Historisë së Partisë sonë në forma e praktika nga më të ndryshmet. Dhe duhet thënë se, kur është fjala për forma, ku edukimi organizohet e zhvillohet pak a shumë i disiplinuar, me program e sistematik, kujdesi është më i madh. Por kjo s'është e tëra. Organizatat e Partisë dhe ato të masave duhet të mësohen t'i organizojnë më mirë e në një shkallë më të gjerë aktivitetet edukative në forma masive më të lira. Kështu, një ekskursion i përgatitur me kujdes dhe me pikësnyime të qarta në muzeume, në veprat e mëdha të socializmit, në vendet historike etj., i shërben jo më pak edukimit se një konferencë apo leksion. Po kështu edhe organizimi i aktiviteteve artistike kulturele e sportive, për të cilat duhet menduar e bërë më shumë etj.

Ka ardhur koha që, pa hequr dorë nga format masive të punës edukative, të ngulim këmbë më shumë në punën individuale me njerëzit dhe në punën që duhet të bëjë secili individualisht për t'u edukuar, duke studjuar, lexuar, dëgjuar radion, duke frekuentuar shfaqjet e ndryshme teatrale, kinematografike etj.

Veçanërisht rëndësi merr tani puna në familje, për ta kthyer edhe atë në një vatrë edukimi për të gjithë pjesëtarët e saj e sidomos për të rinjtë dhe të rejat. S'ka dyshim se familja te ne ka pësuar ndryshime të mëdha, qoftë në përbërjen e saj numerike, qoftë përsa u përket marrëdhënieve midis pjesëtarëve të saj. Por megjithatë, në stadin e sotëm të zhvillimit familja mbetet epiqendra ku ruhen e praktikohen zakone të vjetra, ku ushqehen koncepte të huaja patriarkale e në disa raste borgjeze. Push-

teti i më të madhit, pushteti i burrit është akoma i fortë në familje, kurse gruaja dhe rinia nuk kanë pozitën që u takon. Kundër këtyre koncepteve, zakoneve e praktikave fetare duhet të ndizet një luftë më e madhe brenda në familje dhe të zhvillohet një punë e gjerë edukative.

Së katërti, ne duhet t'i kushtojmë një vëmendje të veçantë punës me propagandistët dhe agjitorët, përgatitjes dhe edukimit të tyre, si një kusht vendimtar për përmirësimin e mëtejshëm të punës propagandistike dhe edukative të Partisë.

Një punë më e organizuar bëhet sot si nga Partia ashtu edhe nga organizatat e masave me propagandistët e formave të edukimit dhe kjo është një gjë e mirë që do thëlluar më tej. Por mendohet shumë pak e në disa raste aspak për masën tjetër të propagandistëve dhe agjitorëve të Partisë dhe kjo sepse ekziston mendimi i gabuar, sipas të cilit propagandist konsiderohet vetëm ai që drejton një formë, që di të mbajë një referat apo leksion. Kjo s'është e drejtë. Propagandistë dhe agjitorë janë të gjithë ata që çojnë në masat mësimet e Partisë, që i sqarojnë e i bindin masat me fjalë e vepra për drejtësinë e këtyre mësimëve, janë ata që i mobilizojnë dhe i hedhin masat në aksione konkrete. Të tillë janë, përveç komunistëve, mijëra të rinj e të reja që kalojnë në aksione dhe kurse të ndryshme, janë punëtorët dhe kooperativistët e pararojës, është armata e madhe e inteligjencies sonë popullore etj.

Zgjerimi i rrjetit të propagandistëve dhe agjitorëve shtrun para organizatave dhe komiteteve të Partisë, para organizatave të masave dhe forumeve të tyre drejtuese detyra të rëndësishme e me përgjegjësi. E gjithë kjo masë duhet organizuar e drejtuar sa më mirë, në përputhje me detyrat që shtrun Partia, me problemet që nxjerr jeta dhe puna e masave punonjëse, ajo duhet edukuar e sqaruar për direktivat e Partisë, duhet ndihmuar për kapërcimin e vështirësive që has, duhet udhëzuar si të afrohet e të lidhet më mirë me masat, si të hyjë në zemrën dhe në mendjen e tyre etj.

3. — Përmirësimi i mëtejshëm i punës ideologjike varet së tepërmi edhe nga shoqërimi i saj me masat tekniko-organizative. Shoku Enver, duke folur në Plenumin IX të Komitetit Qendror të PPSH, theksoi edhe një herë se

«Për ngritjen dhe kalitjen e ndërgjegjes revolucionare të punonjësve tanë i duhet vënë rëndësi, në radhë të parë, punës ideopolitike. Kjo është alfa e çështjes. Por nuk duhen lënë pas dore në asnjë mënyrë as masat orga-

nizativo-teknike, pse ato janë materializimi i orientimeve politike...»¹.

Por këto mësimë të rëndësishme nuk mbahen parasysh kurdoherë dhe nga të gjithë. Ka raste që absolutizohet roli i ideve, roli i punës ideologjike dhe edukative të Partisë. Ndodh që sa herë ka mungesa disipline në punë ose nuk realizohet rendimenti, gjendet shkakut vetëm në dobësitë e punës edukative. Por çfarë efekti edukativ do të ketë propaganda, puna ideopolitike me punonjësit për forcimin e disiplinës proletare, për rritjen e rendimentit etj., kur në ndërmarrje ka organizim të dobët, furnizim jo të rregullt materialo-teknik? Orientimet e Partisë dhe puna e saj e gjerë edukative për të thyer konceptet e vjetra që pengojnë emancipimin e plotë të gruas, nuk do të kishin dhënë ato rezultate që dihen prej të gjithëve, në qoftë se nuk do të shoqëroheshin me krijimin e disa kushteve materiale, siç janë hapja e çerdheve dhe e kopshteve, e mensave dhe e furrave etj., të cilat Partia po i zgjeron gradualisht. Gjithashtu ka raste që mbivlerësohet roli i masave teknike, organizative e materiale dhe nënvleftësohet roli i punës ideologjike dhe edukative, e cila duhet të përbëjë preokupacionin kryesor të Partisë.

Në krijimin e kushteve materiale ka një fushë të gjerë vepërimi për iniciativën e masave e të kuadrove.

«Për zgjidhjen e këtyre çështjeve — thekson shoku Enver — krahas punës së shtetit, duhet të bashkohen e të kontribuojnë forcat e tërë shoqërisë: prindërit e fëmijëve, uzinat e ndërmarrjet si kolektiva punonjëse, kooperativat bujqësore, të gjitha organizatat shoqërore dhe institucionet e ndryshme. Dhe ky kontribut nuk duhet të jetë me fjalë, në mënyrë akademike, por të ndihmojë në mënyrë praktike në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme konkrete»².

Jeta po tregon se sa herë që këto probleme janë bërë çështje të masave, rezultatet kanë qenë të mira. Mjafton të përmendim shembullin e rrethit të Vlorës, i cili brenda një dite me aksion me goditje të përqëndruar, ngriti 70 terrene sportive, më tepër se 100 sheshe me lodra për fëmijë etj. Po pse të mos zgjidhen në këtë rrugë krijimi i parqeve e i pikave të ndryshme turistike, celja e rrugëve të reja që lidhin fshatrat, krijimi i ambienteve

1. Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1969-1970, f. 270-271.

2. Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 513-514.

të kulturuara në qendrat e punës etj.? Mundësitë ekzistojnë. Masat tregojnë gatishmëri dhe entuziazëm. Lypsen vetëm inisiativë dhe organizim më i mirë.

Shoqërimi i punës ideologjike dhe edukative të Partisë me masa tekniko-organizative nuk do të thotë vetëm krijim i bazës materiale, por edhe përdorim racional e shfrytëzim maksimal i saj. Nuk duhet lejuar asnjë rast, siç ndodh në disa fshatra, që ndërtohet vatra e kulturës dhe kthehet në depo, hapen çerdhja dhe kopshti por fëmijët nuk dërgohen në to, mensat mbeten vetëm për të deleguarit dhe në banjo nuk lahet njeri etj. Nga këto raste, qofshin edhe të pakta, të nxjerrim mësimë për të forcuar punën politike e ideologjike të Partisë me masat.

Ne u ndalëm deri tani në disa probleme të organizimit e të drejtimit të ekonomisë e të punës edukative të Partisë me masat. Por problemet dhe detyrat në fushën e organizimit janë të shumta dhe kanë specifikën e tyre në çdo sektor. Vëmendja e Partisë duhet të përqëndrohet në disa hallka kryesore, nga të cilat duhet të kapemi për ta çuar përpara punën tonë në të gjitha frontet e ndërtimit socialist. Hallka të tilla në kohën e sotme janë rritja e rolit, e inisiativës dhe e vetëveprimit të klasës punëtore e të masave punonjëse, përmirësimi i punës me kuadrin dhe forcimi i rolit udhëheqës e organizues i organizatave të Partisë. Më poshtë po ndalemi në problemet dhe detyrat që na dalin në këto drejtime.

III

TË ZHVILLOJMË VAZHDIMISHT INISIATIVËN KRIJUESE TË MASAVE, TË FORCOJMË KONTROLLIN E KLASËS PUNËTORE

Të ngresh punën organizuese të Partisë në nivelin e detyrave të kohës do të thotë, para së gjithash e mbi të gjitha, të forcosh e përmirësosh punën për mobilizimin, organizimin dhe udhëheqjen e masave të gjera të popullit në luftë për zbatimin e vijës së Partisë, do të thotë të zhvillosh vazhdimisht inisiativën e tyre krijuese, të forcosh kontrollin punëtor, t'i hapësh

rrugë të gjerë vetëveprimit të masave, t'i tërheqësh ato aktivist në drejtimin e punëve shtetërore e shoqërore.

Kjo është një çështje thellësisht parimore dhe me rëndësi jetike, që ka të bëjë me zhvillimin e gjithanshëm të demokracisë socialiste. Pa i bërë masat të ndërgjegjshme për rolin e tyre vendimtar si zotër të vërtetë të vendit dhe pa e vënë në jetë me konsekuencë këtë rol, diktatura e proletariatit vyshket e dobësohet, socializmi burokratizohet e degjeneron.

Partia jonë i ka pasur kurdoherë parasysh këto mësimë të marksizëm-leninizmit dhe i ka zbatuar ato me vendosmëri. Periudha që po kalojmë karakterizohet pikërisht nga rritja e vullshme e ndërgjegjes së masave, nga një pjesëmarrje më e gjallë e tyre në jetën politike, ekonomike, ideologjike e shoqërore të vendit, nga shpërthimi i vullshëm i inisiativave dhe i lëvizjeve revolucionare masive, nga forcimi i kontrollit të klasës punëtore dhe i të gjithë punonjësve mbi veprimtarinë e organeve e aparateve shtetërore dhe ekonomike, nga rritja e përgjegjësisë së tyre për fatet e vendit.

Detyra e Partisë është që inisiativën dhe aktivitetin e masave t'i mbajë gjithnjë lart dhe t'i zhvillojë më tej. Në këtë drejtim rëndësi të veçantë kanë organizimi më i mirë i emulacionit socialist dhe forcimi i kontrollit punëtor.

1. — **Emulacioni socialist — metodë revolucionare për ndërtimin e socializmit.** Borgezia dhe shërbëtorët e saj me të gjitha mjetet janë përpjekur të krijojnë mendimin e të tregojnë se inisiativa private dhe konkurrenca janë stimuj «idealë» për zhvillimin shoqëror. Por e vërteta është krejt ndryshe. Konkurrenca kapitaliste, që bazohet në shfrytëzimin e egër të punonjësve, është shkatërrim e vdekje e disave, fitim e sundim i disa të tjerëve. Mbi këtë bazë ajo intensifikon gjithnjë e më shumë punën, shton shfrytëzimin, përdor talentin për spekulime e fitime, nxit individualizmin, egoizmin, urrejtjen për njeriun, pengon përdorimin e gjerë të të rejave të shkencës dhe të teknikës. Në të kundërtën, emulacioni socialist, që zëvendëson konkurrencën kapitaliste e që bazohet në çlirimin e punonjësve nga shfrytëzimi kapitalist, nxit e zhvillon pandërprerë mendimin, inisiativën e lirë, guximin, shpirtin novator krijues, u hap rrugë vrullit dhe lëvizjeve revolucionare të masave, zhvillon solidaritetin dhe ndihmën reciproke midis punonjësve, edukon një ndjenjë të lartë përgjegjësie ndaj detyrës, një qëndrim autokritik ndaj vetes, një disiplinë të vetëdijshme, një shpirt të papërkulur ndaj vështirësive.

Për emulacionin socialist bëhet zhurmë edhe në vendet ku në fuqi janë revizionistët. Por atje ku ka degjeneruar rendi

socialist as që mund të flitet për emulacion të vërtetë. Ky i ashtuquajtur emulacion është në fakt një garë e shfrenuar pas parasë, pasurimit, interesit personal, gjë që kultivon individualizmin, ndjenjën e pronës private, egoizmin, karrierizmin, ekonomizmin, burokratizmin, që kanë sjellë pasoja katastrofale sidomos në ndërgjegjen e njerëzve.

Partia jonë e ka konsideruar kurdoherë emulacionin socialist si një nga ato forca të mëdha lëvizëse të shoqërisë, që ka lindur mbi bazën e rendit socialist, si një domosdoshmëri objektive e mënyrës socialiste të prodhimit, si një shprehje e marrëdhënieve të reja në prodhim. Njerëzit tanë punojnë me vetëmohim, të udhëhequr jo nga etja për pasurim e lavdi vetjake, por të frymëzuar nga idealet e socializmit, nga vetëdija që ata punojnë për vete, për shoqërinë. Këtu qëndron një nga epërsitë më të mëdha të rendit socialist dhe një nga dallimet më themelore të tij nga rendi i vjetër kapitalist.

Pas Kongresit V të Partisë, me masat e njohura të marrura për revolucionarizimin e vendit, mbështetur në një bazë më të fuqishme materialo-teknike, në një nivel më të lartë ideologjik, arsimor e profesional të masave punonjëse, shpërthyen lëvizje të mëdha shoqërore që shënuan një ngritje të paparë në inisiativën e mendimit krijues të punonjësve dhe sollën ndryshime cilësore në zhvillimin e emulacionit. Ky stad i ri ka krijuar një kontradiktë midis vrullit, inisiativave e gatishmërisë së masave që janë në ngritje të vazhdueshme dhe prapambetjes në kuptimin, në format e organizimit dhe në udhëheqjen e kësaj pune.

Në praktikë shpeshherë emulacioni socialist kuptohet si një kategori ekonomike, si një mjet për të arritur disa rezultate të ditës në prodhim. Një koncept i tillë i ngushtë është në kundërshtim me atë që kanë theksuar Komiteti Qendror i Partisë dhe shoku Enver, *se emulacioni socialist është një metodë e përhershme e Partisë dhe e shtetit tonë për ndërtimin socialist, për zgjidhjen e problemeve së bashku me masat, një rrugë e pjesëmarrjes aktive të punonjësve në qeverisje, një stimul i fuqishëm për zhvillimin e mendimit e të inisiativës krijuese të punonjësve, një fushë e autokritikës së masave, e kontrollit dhe e korrigjimit të veprimtarisë së Partisë e të shtetit nga poshtë, një lëvizje e fuqishme ideologjike për edukimin socialist të punonjësve.* Këtë kuptim të gjithanshëm e të plotë është e domosdoshme ta rrënjosisim thellë në organizatat e Partisë, në organet shtetërore dhe organizatat shoqërore, sepse vetëm kështu ato do ta vlerësojnë drejt dhe do ta udhëheqin e organizojnë si duhet këtë punë.

Disa shokë e përfytyrojnë emulacionin socialist si një sis-

tem të caktuar formash e stimujsh dhe e matin punën që bëhet me lëvizjen e flamurëve, me tabelat e emulacionit, me publikimin e rezultateve, të cilat kanë pa dyshim rëndësinë e tyre, por nuk e kuptojnë thellë se në qendër të emulacionit socialist është njeriu me ndërgjegjen e tij dhe se suksesi në këtë drejtim varet nga puna për edukimin ideopolitik të punonjësve. Të udhëheqësh në mënyrë të gjallë e aktive emulacionin socialist, do të thotë të bësh një punë të përditshme konkrete me njerëzit, të ndjekësh luftën, rezultatet e çdo kolektivi e të çdo punonjësi të veçantë, të bësh dallimin kush punon mirë, kush keq dhe kush akoma më mirë, të vësh në dukje shembullin pozitiv, të bësh ballafaqimin. Kjo do të thotë gjithashtu të publikosh rezultatet, të stimulosh më të mirin, të organizosh ndihmën për të prapambeturin, të vrojtosh të renë që lind, ta përkrahësh e t'i hapësh asaj rrugë, të përpunosh e përhapësh eksperiencën pozitive që gjendet në çdo qelizë të jetës sonë, të shtrosh e të diskutosh së bashku me punonjësit problemet që shqetësojnë Partinë, ndërmarrjen, të kërkoh mendimin e tyre, t'u bësh atyre të qartë përse duhet të luftojnë.

Duke pasur një koncept të ngushtë e të cekët për emulacionin socialist, disa drejtues partie e të organeve shtetërore vazhdojnë akoma ta konsiderojnë atë si një problem thjesht të bashkimeve profesionale, bile vetëm të disa njerëzve të ngarkuar me këtë punë. Në të vërtetë ai është një problem i të gjithë punonjësve, i organeve shtetërore dhe në radhë të parë i organizatave të Partisë. Udhëheqja e gjallë, e efektshme, e kualifikuar, e shkathët e organizatave të Partisë, shembulli pararojë i komunistëve janë një faktor vendimtar për ta ngritur emulacionin socialist në një shkallë më të lartë.

Pengesë serioze për inisiativën e masave dhe zhvillimin e emulacionit socialist janë akoma shfaqjet e formalizmit, shabllonizmit, burokratizmit, e organizimit të keq të punës, e furnizimit jo të rregullt materialo-teknik etj. Kapërcimi i këtyre pengesave kërkon një luftë akoma më të vendosur kundër uniformitetit dhe tendencës së diktimit nga lart, kundër zvarritjeve burokratike, çorganizimit e mungesave në furnizim.

Në etapën e sotme emulacioni socialist ka marrë disa tipare të reja. Një zhvillim të madh kanë marrë inisiativat, lëvizjet dhe aksionet masive, sidomos ato me goditje të përqëndruar, po kombinohen gjithnjë e më mirë treguesit ekonomikë me elementët moralopolitikë, duke përfshirë tërë jetën e njerëzve, në punë e jashtë punës; qendra e gravitetit të tij po spostohet më shumë në bazë, po zgjerohet kudo ballafaqimi midis brigadave, reparteve e kooperativave bujqësore etj. Të gjitha këto tipare të emulacionit socialist duhen thelluar më tej. Flamurët që do

të ngrejë çdo ndërmarrje diktohen nga problemet më të rëndësishme që ajo ka. Objekt i përgjithshëm i garave duhet të bëhen medoemos shtimi i sasisë dhe përmirësimi i cilësisë së prodhimit, rritja e rendimentit të punës dhe ulja e kostos së prodhimit. Kërkesa të domosdoshme duhet të jenë gjithashtu forcimi i disiplinës proletare në punë dhe i solidaritetit punëtor, novatorizmi për të prodhuar sa më shumë artikuj të rinj, për të ndërtuar maqineri, pajisje, linja e reparte të reja, ruajtja e pronës socialiste, arsimimi e kualifikimi i punonjësve etj.

Krahas me këto emulacioni socialist duhet të synojë në formimin e një punëtori me horizont e interesa të gjëra politikoshoqërore, e një njeriu që jo vetëm punon mirë, por edhe jeton në mënyrë të re, zbaton në mënyrë shembullore normat e moralit proletar në familje e në shoqëri.

Zbulimi, përpunimi dhe përhapja e eksperiencës së përparuar përbëjnë një nga çështjet kryesore e gjithmonë aktuale të organizimit të emulacionit socialist. Në këtë fushë është bërë e po bëhet një punë e madhe, por ka akoma boshllëqe dhe vështirësi. Pengesa serioze këtu janë konservatorizmi, burokratizmi, egoizmi, konceptet artizanale etj., të cilat gjejnë shprehjen në nënvlefësimin e eksperiencës pozitive, në zvarritjen e propozimeve të punëtorëve, në mungesën e gatishmërisë për të ndihmuar punëtorët e rinj e të prapambetur, në mendjemadhësinë, lokalizmin, në konceptet: «i dimë», «i kemi bërë më parë», «s'ka ndonjë gjë të re», «s'kemi kushte» etj. Nga ana tjetër, në punën për përhapjen e eksperiencës së përparuar ka zhurmë e formalizëm. Propaganda jonë vë më mirë në dukje rezultatit që arrihet, kurse zbrërthen akoma dobët përmbajtjen e kësaj eksperience, rruget e faktorët që ndihmojnë të arrihen këto rezultate. Prandaj është e nevojshme që krahas një lufte më të vendosur me konceptet dhe tendencat frenuese që u përmendën, t'i mësojmë në radhë të parë kuadrot, organizatat e Partisë e të masave, që të merren më konkretisht e me hollësi me eksperiencën e përparuar, duke e kërkuar e përhapur atë drejtpërdrejt në vendin e punës, në brigadë, në torno, në fushë dhe jo vetëm në prodhim por edhe në arsim e shëndetësi, në jetën familjare e shoqërore.

Partia ka theksuar kurdoherë rëndësinë dhe nevojën e zhvillimit të një propagande të gjerë prodhimi, e cila shërben për të arritur tregues sa më të lartë në prodhim, duke përhapur në punonjësit të reat e shkencës e të teknikës, metodat e teknologjisë moderne, realizimet më të mira të kolektivave e të punonjësve më të përparuar. Por në mjaft raste ajo vuan nga kopjimi, shabllonizmi, nga mungesa e dinamizmit për të ndjekur jetën, problemet e kohës. Shpesh i jepet rëndësi anës së jashtme, dekorative.

Përmirësimi i propagandës së prodhimit kërkon që këtë punë ta marrë në dorë mirë sidomos Partia dhe të vërë në lëvizje organet shtetërore dhe organizatat e masave. Të gjithë kuadrot, specialistët duhet ta quajnë si detyrë të tyre të parë t'u japin njohuri teknike punëtorëve, kooperativistëve, rinisë e cila është e etur për të mësuar. Në këtë punë të tërhiqen edhe punëtorët e pararojës, fjala e të cilëve ka një fuqi të madhe bindëse.

Kryesore është që t'i japim propagandës së prodhimit një karakter masiv, dinamik, lidhur ngushtë e konkretisht me detyrën e çdo kolektivi dhe punonjësi.

«...porsa fillon procesi i çdo pune — thekson shoku Enver — duhet të fillojë njëkohësisht edhe propaganda, bile kjo është ajo që duhet të prijë...»¹.

Një propagandë e tillë, e lidhur organikisht me të tëra etapat e procesit të prodhimit, si në bujqësi ashtu dhe në industri, është më e kuptueshme dhe me një efektivitet më të madh. Kjo kërkon që jo çdo gjë të pritët nga lart, por sipas kushteve, të ndërtohet një punë konkrete që t'u hapë perspektivën punonjësve. Mbi këtë bazë ne duhet t'i rishikojmë programet e kurseve dhe të shkollave masive që janë ngritur, si në industri ashtu dhe në bujqësi. Organet shtetërore të mendojnë për më shumë botime të thjeshta e me tirazh masiv, të zgjerojnë kabinetet teknike, ekspozitat e ndryshme të prodhimit, si në ndërmarrje ashtu dhe në shkallë rrethi apo dege ekonomike dhe të luftohet që të shfrytëzohen ato sa më mirë. Detyra të mëdha kanë në këtë drejtim shtypi qendror, por sidomos ai lokal, radioja dhe filmi. Një përmirësim rrënjësor duhet të pësojë agjitacioni figurativ, si mjet shumë i efektshëm në fushën e propagandës së prodhimit.

2. — **Të forcojmë më tej kontrollin e klasës punëtore në tërë jetën e vendit.** Në luftë me revizionistët modernë, të cilët e kanë shqelmuar në teori e në praktikë misionin historik botëror të klasës punëtore dhe propagandojnë teoritë borgjeze të teknokratizmit e të intelektualizmit, Partia jonë mbron mësimet e marksizëm-leninizmit edhe në këtë çështje kardinale dhe po i zhvillon e konkretizon ato më tej në kushtet e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste në vendin tonë.

Idetë e shokut Enver mbi kontrollin punëtor janë një kontribut i ri në doktrinën marksiste-leniniste mbi rolin udhëheqës të klasës punëtore në sistemin e diktaturës së proletarietit. E reja në praktikën tonë është se klasa punëtore rolin e saj kontrollues e luan jo vetëm nga lart nëpërmjet Partisë dhe shtetit të saj proletar, por edhe nga poshtë, drejtpërdrejt si klasë.

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1969-1970, f. 300.

Kontrolli i drejtëpërdrejtë i klasës punëtore është një veprim i ndërgjegjshëm i klasës punëtore, një formë e pjesëmarrjes së saj aktive në zgjidhjen e problemeve të ndërtimit socialist, një shprehje e gjallë e demokracisë proletare në veprim, një armë e luftës kundër burokratizmit dhe mbeturinave borgjeze e mikro-borgjeze në ndërgjegjen e njerëzve, është një lëvizje e ndikimit ideologjik të klasës punëtore mbi shtresat e tjera punonjëse dhe një formë shumë e efektshme e edukimit klasor të punëtorëve. Prandaj luftën për forcimin e kontrollit punëtor, për të rritur organizimin dhe efikasitetin e tij duhet ta shohim si një detyrë të dorës së parë për zbatimin e vijës së Partisë, për përmirësimin e punës sonë në të gjitha fushat e jetës.

Në vjetët e fundit, pas Kongresit V të Partisë e sidomos pas fjalimit të shokut Enver mbi kontrollin e klasës punëtore, vihen re një kuptim dhe një zbatim më i mirë në praktikë i ideve të mëdha që ai shtronte mbi këtë çështje. Këto e kanë rritur mjaft rolin dhe përgjegjësinë e klasës punëtore për fatet e vendit, për ndërtimin e socializmit.

Por me gjithë rezultatet e arritura, duhet thënë se akoma jemi në hapat e parë drejt asaj që kërkon Partia. Kontrolli punëtor akoma nuk ka përfshirë gjithë klasën punëtore, nuk është i vazhdueshëm, nuk është i gjithanshëm e për problemet kryesore ideologjike, shoqërore dhe të prodhimit, e në mjaft raste, nuk ka forcën e duhur për të zhdukur konceptet e vjetra dhe për të rrënjësuar koncepte të reja, nuk u jep rrugë problemeve.

Një pengesë serioze për zhvillimin dhe thellimin e kontrollit punëtor janë shfaqjet e burokratizmit, të cilat me gjithë kërkesat këmbëngulëse të Partisë dhe ndryshimet që janë bërë, akoma ndeshen shpesh. Shumë gjëra të rëndësishme zgjidhen zyrtare, në rrethe të ngushta, nuk shtrohen e diskutohen mirë me masat. Kjo duket që në hartimin e projektplaneve të prodhimit, ku në fakt duhet të fillojë kontrolli punëtor. Ka herë-herë veprime arbitrare, të cilat frenojnë zërin dhe veprimin e punëtorëve, tregohet pakujdesi për të vënë në jetë propozimet e drejta të punëtorëve, gjë që frenon gjithashtu mendimin krijues të masave etj.

Të gjitha këto shtrojnë para organizatave të Partisë dhe atyre të bashkimeve profesionale detyrën që të bëjnë një punë edukuese më të shëndoshë me punonjësit, të luftojnë më me forcë kundër pengesave dhe koncepteve frenuese, që t'i hapin rrugë plotësisht ushtrimit të kontrollit të klasës punëtore mbi këdo dhe për gjithçka.

Para së gjithash të kuptohet thellë nga të gjithë se ka një dhe jo dy ose tre kontrole. Ky është kontrolli i klasës punëtore në fuqi, që realizohet në rrugë e forma të ndryshme nga lart

e nga poshtë, nën udhëheqjen e Partisë. Të gjitha format e kontrollit të ne janë në thelb një kontroll i vetëm, kontrolli i klasës punëtore. Prandaj nuk ka vend për asnjë kundërvënie të kontrollit të drejtëpërdrejtë të klasës punëtore nga poshtë, me kontrollin e saj nga lart nëpërmjet Partisë e shtetit proletar.

Të dy format e kontrollit, nga poshtë e nga lart, janë të domosdoshme, ato plotësojnë njëra-tjetrën, kanë një qëllim dhe duhet të veprojnë në unitet të plotë, por secila në rrugën e vet, në vijën e Partisë dhe nën kontrollin e Partisë. Çdo dobësim i një forme kontrolli, çon në dobësimin e kontrollit punëtor. Të luftohet çdo orvatje që, nën maskën e bashkëpunimit dhe të koordinimit të punës, kontrolli i drejtëpërdrejtë i klasës punëtore t'i nënshtrohet e të vihet nën kujdestarinë e kontrollit shtetëror e të bëhet një shtojcë e tij, siç veprojnë në disa raste organet e kontroll-revizionit në rreth. Të luftohen gjithashtu edhe ato tendenca krejt të shtrembëra të disa drejtuesve të ndërmarrjeve të ndryshme që synojnë në njëfarë ortakërie për t'i shkrirë të dy këto kontrole në një, nën pretekstin e kontrolleve të përbashkëta. Nga ana tjetër, të mos lejohet asnjë dobësim i kontrollit shtetëror nga lart, nën pretekstin se tani kemi kontrollin punëtor. Përkundrazi, kontrolli shtetëror duhet forcuar vazhdimisht dhe të ushtrohet duke u mbështetur gjerësisht në masat, duke ndjekur vijën e masave.

Kontrolli i drejtëpërdrejtë i klasës punëtore nuk është e nuk mund të jetë një kontroll spontan e arbitrar, në emër të të cilit mund të abuzojë kushdo; po ashtu, ai nuk mund dhe nuk duhet të lihet vetëm në dorën e bashkimeve profesionale, si një çështje që u përket vetëm atyre. Bashkimet profesionale duhet ta përmirësojnë më tej punën e tyre në këtë drejtim, sepse kanë të meta e dobësi. Por të kuptohet mirë nga organet dhe organizatat e Partisë se, në radhë të parë, ky është problem partie, prandaj atë duhet ta marrë në dorë vetë Partia dhe ta vlerësojë si një ndër problemet e saja më të rëndësishme, të organizatave-bazë dhe të komunistëve. Partia është kurdoherë organizuesja dhe frymëzuesja e kontrollit punëtor, na mëson shoku Enver. Eksperienca e mirë e fituar nga disa komitete partie e organizata-bazë partie, si në Tiranë, Durrës, Gjirokastër, Shkodër e në rrethe të tjera, të cilat kanë orientuar dhe përkrahur kontrollin punëtor në dikastere, komitete ekzekutive, institucione kulturele, në sektorët e shërbimit, në fshat e gjetkë, duhet të na shërbejë për ta çuar edhe më përpara këtë punë. Por udhëheqja e kontrollit të drejtëpërdrejtë të klasës punëtore nga organet dhe organizatat e Partisë nuk do të thotë që ta vëmë atë nën tutelë, ta futim në korniza e forma të ngurta,

sepse kjo do të frenonte inisiativën e vetëveprimin e klasës punëtore.

Partia duhet ta orientojë këtë kontroll, ta nxitë e ta inkurajojë, ta përkrahë me të gjitha forcat e t'i hapë rrugë, të ndërhyjë për të mënjeluar çdo pengesë që i del përpara nga kushdo qoftë. Komunistët, si pjesëtarë të repartit pararojë e të organizuar të klasës punëtore — Partisë së Punës të Shqipërisë, duhet të jenë në ballë të kontrollit punëtor. Komunistët prandaj janë komunistë, sepse janë përfaqësuesit më të ndërgjegjshëm e më aktivë të klasës punëtore, luftëtarët e vijës së parë për çështjen e saj revolucionare. Si të tillë, ata duhet të militojnë edhe në ushtrimin e kontrollit punëtor, duke qenë shembull e duke tërhequr pas vetes tërë masën e punëtorëve.

Duhet të luftohet çdo njëanshmëri në ushtrimin e kontrollit punëtor. Ky kontroll duhet të ushtrohet në radhë të parë brenda për brenda ndërmarrjes, jo vetëm mbi administratat nga poshtë-lart, por edhe në mënyrë horizontale mbi vetveten; jo vetëm për të drejtat dhe kërkesat, por në radhë të parë për kryerjen e detyrave nga vetë klasa punëtore; jo vetëm për çështjet ekonomike, por për të gjitha problemet politike, ideologjike, kulturele e sociale; jo për cikërima, por për problemet themelore të qendrës së punës, jo vetëm për të zbuluar të metat e gabimet ose për të bërë konstatime, por edhe për korigjimin e tyre në kohë. Paskëtaj dhe vetëm mbi këtë bazë kontrolli punëtor do të mund të ushtrohet edhe jashtë ndërmarrjes, në mënyrë horizontale mbi ndërmarrjet e institucionet e tjera, ashtu edhe mbi inteligjencien në fshat, mbi organet e pushtetit në rreth apo në qendër dhe mbi këdo.

Kontrolli për zbatimin dhe ruajtjen e vijës së Partisë dhe të ligjeve të diktaturës së proletariatit nuk i përket vetëm klasës punëtore, kjo detyrë u përket të gjitha masave të popullit, si në qytet, ashtu edhe në fshat. Prandaj është detyrë e rëndësishme të forcojmë kontrollin e masave kudo dhe në mënyrë të veçantë në fshat, mbi kuadrot drejtues të kooperativës, mbi organet e pushtetit, si dhe midis vetë fshatarëve, sepse këtu edhe dobësitë janë më të mëdha. Me gjithë përmirësimet që janë bërë, përsëri vërehet se në fshat nuk ndiqet si duhet vija e masave, nuk shtrohen kurdoherë për diskutim me masën e anëtarëve në front apo në asamble problemet që preokupojnë fshatin, kooperativën, ka shkelje të statutit të kooperativës dhe sistemi llogaridhënës është akoma i dobët, vërehen shfaqje të shkeljes së demokracisë kooperativiste etj. Komitetet dhe organizatat e Partisë duhet ta quajnë si një detyrë shumë të rëndësishme gjallërimin e kontrollit të drejtëpërdrejtë të masave në fshat, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha format dhe duke i vënë

më mirë në lëvizje organizatat e masave. Gjithashtu, klasa punëtore dhe bashkimet profesionale, me eksperiencën e tyre duhet t'i japin një ndihmë më të madhe, më efektive e konkrete fshatarësisë për organizimin e kontrollit nga poshtë.

Klasa punëtore, si klasa në fuqi dhe hegjemone, ka të drejtë dhe detyrë të ushtrojë kontrollin e saj drejtëpërdrejt edhe në fshat. Ky kontroll duhet të konceptohet gjerë e të kuptohet si një ndikim ideologjik dhe, para së gjithash, si një mjet për edukimin socialist të fshatarësisë kooperativiste, për të forcur më tej aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, për të ndihmuar në ngushtimin e dallimeve esenciale midis qytetit e fshatit, për të forcuar më tej demokracinë kooperativiste. Ky kontroll duhet të ushtrohet në frymë shoqërore dhe me pjesëmarrjen e gjerë të masës së kooperativistëve. Jeta ka dhënë shumë forma të ndikimit e të kontrollit të drejtëpërdrejtë të klasës punëtore në fshat, siç janë aktivizimi i punëtorëve që kanë familjet ose banojnë në fshat, lidhjet e marrjes nën kujdestari midis qendrave të punës e të prodhimit dhe kooperativave bujqësore, dërgimi i punëtorëve dhe i kuadrove në fshat, për një kohë të caktuar, aksionet për fushata të ndryshme etj, për të cilat komitetet e Partisë të rretheve, organizatat e Partisë dhe ato të masave duhet të tregojnë një kujdes më të madh, t'i organizojnë e t'i përdorin më mirë.

Një rol akoma më të madh duhet të luajë klasa punëtore edhe në fushën e arsimit e të kulturës. Eksperienca vërteton se kontrolli punëtor në këtë sektor ka një rëndësi të madhe për edukimin e inteligjencies sonë popullore, për të luftuar te ajo shfaqjet e huaja të intelektualizmit, teknokratizmit, egoizmit, karrierizmit e lavdisë personale, për të bërë që tërë veprimtaria dhe krijimtaria e saj të përshkohen kurdoherë nga ideologjia e klasës punëtore, nga vija e Partisë. Por ky kontroll shërben gjithashtu që kuadrot dhe inteligjencia të kuptojnë më mirë se te ne në fuqi është klasa punëtore, se ajo është forca drejtuese në sistemin e diktaturës së proletariatit, të kuptojnë rolin dhe vendin e tyre në shërbim të klasës punëtore, të çështjes së madhe të socializmit e të revolucionit.

Lidhur me kontrollin punëtor në fshat e në sektorë ku punon inteligjencia nuk duhet të lejohet asnjë shfaqje arbitrari-teti, fodullëku e kundërvënije të klasës punëtore me fshatarësinë e inteligjencien, ashtu siç nuk duhet të lejohet edhe çdo mospërfillje ndaj kontrollit punëtor nga kushdo qoftë. Qëllimi i kontrollit punëtor në këto raste është të ndihmojë fshatarësinë dhe inteligjencien, me të cilat ajo është e lidhur, në një aleancë të ngushtë, që ato të përvetësojnë më thellë vijën e Partisë

dhe të luftojnë më mirë për zbatimin e saj, kundër çdo shtrembërimi, ngado që të vijë.

Për të ushtruar efektivisht kontrollin e saj të drejtëpërdrejtë është e domosdoshme që klasa punëtore të njohë mirë vijën e Partisë në çdo fushë dhe ligjet e pushtetit popullor. Prandaj organizatat e Partisë dhe të bashkimeve profesionale duhet t'i kushtojnë një rëndësi të dorës së parë edukimit ideopolitik, arsimor, kultural dhe tekniko-profesional të klasës punëtore, në mënyrë të veçantë të punëtorëve të rinj që vijnë nga fshati e nga rinia shkollore, si dhe të punëtorëve sezonalë, me qëllim që të forcohet më tej ndërgjegjia klasore dhe të zgjerohet horizonti për problemet e mëdha të vendit në të gjitha fushat e jetës.

Për të forcuar më tej kontrollin punëtor është e domosdoshme gjithashtu, që organizatat e Partisë dhe ato të masave t'i dënojnë si shumë të rrezikshme veprimet burokratike të disa kuadrove dhe organeve ekonomike e shtetërore, që paralizojnë veprimtarinë krijuese të masave, që ndrydhnin inisiativën dhe vetëveprimin e tyre; të marrin masa të rrepta ndaj atyre drejtuesve që sillen me fodullëk e arrogancë ndaj punëtorëve, që hakmerren dhe ushtrojnë presion të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë mbi ta dhe nuk ia nënshtrojnë tërë veprimtarinë e tyre kontrollit të masës. Një luftë më këmbëngulëse duhet bërë për të kapërcyer frymën e lëshimeve reciproke që vihen re në marrëdhëniet midis administratës dhe punëtorëve, për të edukuar principialitetin komunist si në kuadrot, ashtu dhe në masat.

Kuptimi i drejtë dhe nga të gjithë i këtyre çështjeve është me rëndësi të jashtzakonshme, sepse çdo nënvleftësim dhe aq më tepër çdo mohim i rolit udhëheqës e kontrollues të klasës punëtore, si klasa në fuqi, minon nga themelet Partinë dhe diktaturën e proletariatit, shpie në mënyrë të pashmangshme në degjenerimin borgjez të rendit socialist. Prandaj mbrojtja dhe zbatimi me konsekuencë në jetë i hegjemonisë dhe i kontrollit të klasës punëtore, nga lart e nga poshtë, gjatë tërë periudhës historike të kalimit nga kapitalizmi në komunizëm, janë një faktor vendimtar për ta çuar vazhdimisht përpara revolucionin tonë në të gjitha fushat, për të siguruar fitoren e plotë e përfundimtare të rrugës socialiste mbi rrugën kapitaliste.

FORCIMI I PUNËS ME KUADRIN — KUSHTI I RËNDËSISHËM PËR PËRMIRËSIMIN E PUNËS ORGANIZUESE NË TËRËSI

Në prodhim e në shkollë, në ushtri e në terren, kudo kuadrot luajnë rolin e organizatorit. Prgatitja, edukimi dhe përdorimi i drejtë i tyre përbëjnë, bashkë me kontrollin e zbatimit të detyrave, një ndër aspektet themelore e më të rëndësishme të punës organizative. Por a e kemi si duhet të organizuar punën me kuadrin në tërë sektorët dhe instancat? Duhet pranuar se nuk e kemi kudo të organizuar si duhet këtë punë.

1. — Para së gjithash, është e nevojshme të rrënjosim koncepte sa më të plota mbi kuadrin dhe mbi punën me kuadrin. Partia jonë e ka vlerësuar kurdoherë drejt rolin e kuadrit dhe ka bërë që në vendin tonë të rritet e të kalitet një armatë e madhe kuadrosh besnikë të revolucionit. Në të njëjtën kohë Partia ka theksuar se nuk duhet të gabojmë e t'i vëmë kuadrot mbi klasën, mbi masat, sepse janë masat e gjera punonjëse ato që, me klasën punëtore në krye e të udhëhequra nga Partia, bënë revolucionin dhe vazhdojnë ta çojnë përpara atë. Pa luftën dhe punën e tyre asgjë nuk mund të bëhet.

Eksperiencia e hidhur e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve të tjera revizioniste tregon se duke mbivlerësuar rolin e specialistëve dhe duke nënvleftësuar rolin e klasës punëtore, inteligjencia, megjithëse e përbërë nga bij të popullit, u bë shtresa kryesore e borgjezisë së re, mbështetja e fuqishme për restaurimin e kapitalizmit në këto vende. Prandaj, që të mos ndodhë kurrë te ne ajo që ndodhi në vendet revizioniste, duhet të ruajmë kurdoherë marrëdhënie të drejta midis kuadrove dhe masave, kuadrot të qëndrojnë kurdoherë në shërbim të klasës dhe t'ia nënshtrojnë vazhdimisht veprimtarinë e tyre kontrollit të drejtëpërdrejtë të masave punonjëse.

Koncepti i drejtë marksist-leninist se revolucioni, socializmi e komunizmi, janë vepër e masave nuk e ul aspak rolin e kuadrit në revolucion e në ndërtim, as edhe kujdesin e përgjegjësive e organizatave të Partisë dhe të organeve shtetërore për kuadrot.

Duhet të krijojmë një koncept të drejtë dhe të gjerë mbi vetë nocionin kuadër, sepse shpeshherë si kuadro kuptohen vetëm ata që përfshihen në organikat. Një gjykim i tillë i ngushtë të shpie në gabime në politikën për prgatitjen dhe trajtimin e kuadrove, si edhe në vlerësimin e tyre. Ne kemi mijëra vetë që mi-

litojnë në radhët e Partisë e të zgjedhur në organet e saja udhëheqëse, mijëra të tjerë janë të zgjedhur në këshillat popullore si përfaqësues të plotfuqishëm të popullit, apo në organet e ndryshme të organizatave të masave; kemi qindra e mijëra kuadro drejtues në sektorët e ndryshëm, duke filluar nga përgjegjësi i skuadrës apo brigadierit deri te ministri; kemi një mori kuadrosh që kryejnë punë të kualifikuara (në shkallë të ndryshme) në të gjithë sektorët; kemi mijëra propagandistë, ushtarakë, korrespondentë vullnetarë, agjitorë etj. etj. Të gjithë këta janë kuadro. Me këtë armatë të madhe duhet të merret Partia në të gjitha hallkat, me të gjitha organizmat dhe levat e saja, që t'i rritë, t'i edukojë, t'i kalitë, t'i aktivizojë, t'i hedhë në aksione, sepse kështu do të rriten vetë roli dhe efektiviteti i gjithë punës së saj.

Në të njëjtën kohë, duhet luftuar edhe kundër praktikës gjithashtu të ngushtë të disa organeve dhe organizatave të Partisë e të shtetit që e kufizojnë tërë punën me kuadrin në lëvizjen e kuadrove, në emërimet e transferimet, kurse dihet që këto përbëjnë vetëm një anë të punës dhe bile jo më kryesoren. E rëndësishme është të rritim kujdesin e organeve dhe organizatave të Partisë, të organeve shtetërore dhe të ekonomisë për probleme të tilla të punës me kuadrot, si për edukimin e tyre ideopolitik, kultural e tekniko-profesional, për revolucionarizimin e vazhdueshëm të kuadrove, për trajtimin, përdorimin apo shpërndarjen e tyre, për luftën kundër koncepteve që pengojnë një politikë të drejtë kuadri etj. etj.

2. — Revolucionarizimi i vazhdueshëm i kuadrove, ka qenë dhe mbetet një detyrë me shumë rëndësi e Partisë. Partia jonë është kujdesur vazhdimisht që t'i ruajë kuadrot e saj të pastër, që ata të jenë revolucionarë konsekuentë, të lidhur ngushtë me masat dhe t'u shërbejnë atyre me besnikëri deri në fund. Kjo vijë e drejtë e Partisë është thelluar më tej gjatë këtyre vjetëve të fundit në luftën për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit.

Vendimet e Partisë dhe mësimet e shokut Enver për thelimin e vijës së masave edhe në politikën e kuadrit, për uljen e pagave të larta, për qarkullimin e kuadrove dhe punën e tyre drejtpërdrejt në prodhim, për ngritjen e kuadrove nga radhët e punëtorëve, për heqjen e gradave në ushtri etj., kanë vlerë të madhe teorike e praktike për revolucionarizimin e kuadrove, për t'i ruajtur ata nga degjenerimi revizionist. Ato ndihmojnë për vendosjen e marrëdhënieve më të drejta midis kuadrove e masave, për ngushtimin e dallimeve esenciale midis punës mendore e asaj fizike, për çelënikosjen e unitetit të popullit tonë.

Rëndësi të veçantë në vargun e këtyre masave ka vendosja

e një sistemi të rregullt qarkullimi të kuadrove dhe puna drejtpërdrejt në prodhim që bëjnë ata. Nga eksperiencia e grumbulluar deri tani mund të thuhet se efektet e këtyre masave janë përgjithësisht pozitive, si për punën edhe për vetë kuadrot.

Por në këtë situatë kaq pozitive ka edhe disa kuadro që nuk i kanë kuptuar këto probleme ideologjike, që gjykojnë si mikroborgjezë, që s'e kanë atë predispozicion që kërkohet për të shkuar atje ku duhet e së bashku me familjet; ka nga ata që punën në prodhim e bëjnë si angari ose nuk e bëjnë fare, nuk respektojnë planin, turnet, brigadat, orarin, ka që nuk shkojnë të punojnë atje ku mund të kaliten më mirë, por ku është më lehtë etj. Ka dhe kuadro me përgjegjësi, sidomos në aparatet qendrore, të cilët nuk mungojnë të flasin për rëndësinë e qarkullimit, por kuadrot e aftë të sektorëve që drejtojnë e që kanë nevojë të qarkullojnë nuk i lënë, ashtu sikurse ua shtojnë nga një muaj në tjetrin edhe punën në prodhim.

Të kuptohet njëherë e mirë se qarkullimi i kuadrove nuk është një çështje dëshire, por një domosdoshmëri që lidhet me revolucionarizimin e tyre dhe të punës në përgjithësi, e cila është sanksionuar me orientime të veçanta të Partisë. Prandaj, për zbatimin e përpiktë të këtyre orientimeve, duhet të bëhet një luftë më e vendosur kundër qëndrimeve burokratike e teknokratike, lokaliste e sektoriale, të cilat pengojnë qarkullimin e kuadrove, sistemimin në punë dhe strehimin e tyre. Në të njëjtën kohë, të luftohet ideologjia kundër interesit të ngushtë personal, si dhe kundër konceptit që e konsideron qarkullimin si një «bcrxh», si angari — «u dërgova në bazë, punova 3 vjet, tani të kthehem përsëri në qendër»! Jo, qarkullimi nuk bëhet as me afate, as angari! Të gjithë, si ushtarë besnikë të revolucionit, do të shkojnë atje ku e kërkon interesi i atdheut, për sa kohë të ketë nevojë atdheu.

Deri tani në shumicën e tyre kuadrot kanë qarkulluar nga administratat e qendrës apo të rrethit në ato të ndërmarrjes, kooperativës ose rrethit e anasjelltas dhe shumë më pak nga administrata në prodhim. Me qëllim që të arrijmë ta bëjmë qarkullimin më shumë nga administratat në prodhim ose sa më afër prodhimit, duhet të syncjëm që me anën e punës drejtpërdrejt në prodhim, gjatë stazhit të kandidatit për ata që pranohen në Parti, kur dërgohen për kalitje, apo duke vazhduar kurse pa shkëputje nga puna, kuadrot të mësojnë të paktën një nga profesionet që ushtrohen në degën ku punojnë.

Zbatimi i orientimeve të Partisë për një kombinim më të plotë të punës drejtuese me atë prodhuese, duhet të jetë një preokupacion i vazhdueshëm i organeve të Partisë e të shtetit. Për ç'i pengon kuadrot që të zbatojnë këtë mësim që jep shoku Enver

në letrën drejtuar Alo Qoses? Kjo natyrisht do parë në çdo ndërmarrje e kooperativë. Por në përgjithësi, përveç punës për rritjen e ndërgjegjes komuniste, këtu ndikojnë seriozisht edhe mjaft dcbësi të metodës së punës, veprimet e tepërta administrative që angazhojnë në punë jo të frutshme njerëzit e zyrave. Puna prodhuese, si orientim i përgjithshëm, duhet të jetë sa më e madhe dhe në të njëjtën kohë të përmirësohet puna drejtuese. Kjo është një çështje që ka të bëjë me forcimin e lidhjeve të kuadrove me masat. Është vërtetuar tanimë nga jeta se atje dhe atëhere kur kuadrot shkëputen nga masat, lind rreziku i degjenerimit borgjez e revizionist të tyre.

Një masë tjetër me shumë efekt për revolucionarizimin e vazhdueshëm të kuadrove është që gjithë veprimtaria e tyre të vihet nën kontrollin e punonjësve. Kur në mbledhjet e ndryshme të punëtrëvë e kooperativistëve, në mbledhjet e Partisë, të këshillave popullore apo të organizatave të masave analizohen mirë gjërat, nuk bëhen parada, por punë konkrete me kritikë e auto-kritikë, kur kërkohet dhe jepet llogari, veprimtaria e kuadrove kontrollohet më mirë, mendimi për ta del më i qartë. Mbledhjet e veçanta për veprimtarinë e një kuadri të caktuar, prezantimi kur emërohet për të parën herë, kontrolli punëtor mbi veprimtarinë e kuadrove, janë gjithashtu forma shumë të efektshme të përdorura deri tani. Gjallërimi i mëtejshëm i të gjitha formave të demokracisë sonë socialiste në të gjithë sektorët dhe instancat, do të rritë akoma më shumë kontrollin e masës mbi veprimtarinë e kuadrove.

Ne do të vazhdojmë të kemi si kuadro që zgjidhen nga masat, ashtu edhe kuadro që emërohen në bazë të nomenklaturave. Jo vetëm forma e parë, por edhe e dyta është gjithashtu demokratike, pasi organet që vendosin zbatojnë plotësisht vijën e masave dhe veprojnë në emër të atyre që i kanë zgjedhur. Por duhet theksuar se edhe për ata që emërohen në forma të ndryshme duhet të merret mendimi i masës. Për disa kuadro, si përgjegjës skuadrash, brigadierë, mjeshtra e përgjegjës reparatesh e fabrikash, kur ngrihen ose ulen brenda repartit apo brigadës, kryesitë e kooperativave apo drejtoritë e ndërmarrjeve t'i bëjnë emërimet e tyre mbi bazën e propozimit të kolektivit përkatës.

Gjithë puna e Partisë për revolucionarizimin e kuadrove ka për qëllim që ata të kaliten vazhdimisht në punë e në luftë bashkë me masat, të marrin pjesë aktive në zgjidhjen e problemeve, të karakterizohen kurdoherë nga cilësi e virtyte të larta morale proletare, në mënyrë që veprimtaria dhe aftësitë e tyre krijuese t'u përgjigjen sa më mirë detyrave që shtron ndërtimi i plotë i shoqërisë sonë socialiste.

3. — Të shmangim disa anomali që kemi në shpërndarjen dhe përdorimin e kuadrove me arsim të lartë e të mesëm. Përgjithësisht struktura e përgatitjes dhe e shpërndarjes së kuadrove të ne është e drejtë, në përshtatje me kërkesat e zhvillimit të planifikuar e proporcional të degëve të ndryshme të ekonomisë e të kulturës, si dhe me kërkesat e mbrojtjes së atdheut. Kjo ka ndihmuar që të sigurohen ritmet e parashikuara në zhvillimin e vendit.

Por, si rezultat i ndryshimeve të shpejta që kanë ndodhur në zhvillimin e sektorëve dhe të rrethëve të ndryshme, i disa të metave që ka në shpërndarjen dhe rishpërndarjen e kuadrove, i disa shfaqjeve sektoriale e lokaliste që ka në këtë punë, janë krijuar shpërpjesëtime nëpër degë, sektorë e rrethe të ndryshme, si dhe midis ndërmarrjeve të së njëjtës degë. Në krijimin e këtyre anomaliave kanë ndikuar negativisht edhe disa normativa të vendosura që nuk u përgjigjen më kërkesave të zhvillimit tonë.

Një pjesë e kuadrove me arsim të lartë e të mesëm nuk merren plotësisht me kryerjen e detyrave kryesore që u takojnë si specialistë, por janë angazhuar me detyra të thjeshta administrative e të furnizimit. Shumica në vend që të merren me punën kërkimoro-shkencore dhe në prodhim, janë përqëndruar në aparate administrative të ndërmarrjeve e të dikastereve.

Në kushtet e tanishme është e nevojshme të tregohet një kujdes më i madh që në institucionet kërkimoro-shkencore, në byrotë teknike e teknologjike të caktohen kuadrot më të aftë, por dhe aq sa është e nevojshme, sepse këto duhen konsideruar gjithnjë si bërthama, rreth të cilave duhet të aktivizohet masa e gjerë e punëtorëve dhe e kuadrove të tjerë.

Në shpërndarjen e kuadrove të lartë e të mesëm duhet të mbajmë gjithnjë parasysh nevojat reale dhe kushtet konkrete në çdo ndërmarrje e sektor, gjendjen e klasës punëtore, shkallën e kualifikimit, stazhin dhe eksperiencën e saj në punë. Këtë del se duhen hedhur poshtë tendencat që vihen re në disa drejtues, të cilët kërkojnë që në çdo punë të kenë specialistë me arsim të lartë dhe nënvleftësojnë aftësitë e teknikëve të mesëm. Atje ku niveli i klasës punëtore është më i ngritur, ku stazhi dhe aftësitë e saja janë më të mëdha, atje mund të dërgojmë më pak specialistë me arsim të lartë e të mesëm, dhe anasjelltas. Në udhëheqje të ndërmarrjeve, fabrikave, reparteve dhe të kooperativave nuk është kurdoherë e domosdoshme të vëmë specialistë.

Eksperienca na ka treguar fare qartë se kuadrot nuk përgatiten vetëm në bankat e shkollës, por edhe në luftë për realizimin e programit të Partisë. Nga radhët e luftëtarëve më të mirë për realizimin e pesëvjeçarëve, të cilët pa u shkëputur nga puna

kanë marrë dhe shkollën që u duhet, kanë ndjekur kurse, kanë mësuar nga librat e nga jeta, kanë dalë qindra e qindra kuadro të aftë për të drejtuar gjithë sektorët.

Të luftohet kundër sektarizmit dhe shfaqjeve të intelektualizmit që nënvleftësojnë aftësitë e kuadrove të prodhimit. Na duhen kuadro aksioni, udhëheqës dhe organizatorë të masave, të aftë të kuptojnë thellë e të bëjnë të tyren vijën e Partisë, të zhyten në realitetin tonë e ta çojnë atë përpara, që janë në gjendje të organizojnë pa zhurmë një punë të gjallë. Në situatën e sotme kaq revolucionare, janë të gjitha mundësitë që të rriten të tillë kuadro të aftë e të devotshëm për të gjitha fushat e ndërtimit socialist.

V

TË FORCOJMË MË TEJ ROLIN DREJTUES DHE ORGANIZUES TË ORGANIZATAVE TË PARTISË

Lufta dhe puna e gjithë komunistëve për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit V të Partisë e kanë forcuar më tej Partinë, kanë gjallëruar më shumë jetën e formave e të organizatave-bazë të Partisë, kanë revolucionarizuar punën e tyre drejtuese, i kanë bërë më të afta ato për organizimin e zbatimit të detyrave të kohës.

Gjatë periudhës që na ndan nga Kongresi V i Partisë është përmirësuar përbërja shoqërore e Partisë dhe e organeve udhëheqëse të saj në rrethe e në bazë, është bërë gjithashtu një punë e mirë për shtrirjen dhe shpërndarjen e forcave të Partisë. Më 1 janar të këtij viti, efektivit i Partisë arriti në 75 673 komunistë (64 482 anëtarë dhe 11 191 kandidatë), nga 66 327 komunistë që ishin në prag të Kongresit V të Partisë. Mbi 35 për qind e të pranuarve gjatë vjetëve 1967, 1968 e 1969 janë punëtorë, 48 për qind kooperativistë dhe 16 për qind nëpunës, ndërsa shoqe janë mbi 45 për qind të të pranuarve. Kjo ka sjellë ndryshime edhe në përbërjen shoqërore të efektivit të Partisë, ku punëtorët zënë tani 35,22 për qind, nga 32,90 për qind që ishin në Kongresin V, kurse nëpunësit zbresin nga 38,12 për qind, në 35,81 për qind.

Në organet udhëheqëse të Partisë në rrethe vitin e kaluar u zgjodhën më shumë njerëz nga prodhimi. Punëtorët që punojnë drejtpërdrejt në prodhim tani zënë 34 për qind të anëtarëve të plenumëve, kooperativistët 28,5 për qind dhe shoqet 24,8 për qind. Në punën e forumeve ndjehet tani më mirë freskia e njerëzve të bazës e të prodhimit, si në shqyrtimin, ashtu dhe në kapjen e zgjidhjen e të gjitha problemeve.

Por, detyrat e mëdha që kemi përpara për thellimin e revolucionit tonë socialist në të gjitha fushat, për të përmirësuar kudo punën organizuese të Partisë, kërkojnë që të punojmë akoma më me ngulm për të forcuar më tej vetë Partinë, për të ngritur edhe më lart rolin e saj udhëheqës e organizues në të gjitha hallkat.

Te ne, na mëson shoku Enver, gjithë jeta e vendit, ekonomia dhe politika, kultura dhe ideologjia, puna në terren dhe në ushtri, në çdo sektor, drejtohet dhe duhet të drejtohet nga Partia. Organizatat e Partisë, kudo që veprojnë, në fabrikë apo në fshat, në ushtri apo në administratë, janë ato që edukojnë e mobilizojnë në masat, që vënë në lëvizje e koordinojnë përpjekjet e organeve e të organizatave shtetërore e shoqërore, që organizojnë e udhëheqin luftën për zbatimin e vijës së Partisë. Prandaj, pa ngritur rolin dhe punën e tyre në nivelin e kërkesave të kohës, nuk mund të zgjidhen me sukses detyrat e problemet e mëdha të ndërtimit socialist.

Për forcimin e rolit udhëheqës e organizues të Partisë është e domosdoshme ta përqëndrojmë vëmendjen sidomos në disa nga çështjet më të mprehta që kanë të bëjnë me jetën e brendshme të Partisë:

1. — Të zhvillojmë pareshtur inisiativë dhe vetëveprimin e organizatave-bazë dhe të çdo komunisti. Pa këtë nuk mund të bëhet thellimi i vazhdueshëm i procesit të revolucionarizimit të jetës së vendit dhe të Partisë, nuk mund të flitet për rolin pararojë të çdo organizate-bazë e të çdo komunisti. Por që të bëhet kjo, duhet, në radhë të parë, të kuptohen e të zbatohen drejt, nga çdo organizatë, nga çdo komunist, parimet e normat që udhëheqin e rregullojnë jetën e brendshme të Partisë. Kjo është e domosdoshme, pasi në mjaft organizata-bazë ka komunistë që nuk ecin me ritmin e kohës, që lodhen e thyhen para vështirësive, që nuk kryejnë si duhet detyrat e ngarkuara, që nuk vihen në rolin e udhëheqësit, që nuk qëndrojnë në radhët e para të revolucionit, që nuk janë shembull për të tjerët. Prandaj, ne duhet të punojmë më me ngulm për ta kthyer organizatën e Partisë në një organizëm të gjallë e luftarak, të gjykojë, të studjojë, të zbërthejë e të vërë në jetë çdo vendim e detyrë që shtron Partia, me inisiativë të plotë, pa prituri kurdoherë e për çdo gjë udhëzime nga lart. Ajo duhet të jetë gjithnjë në veprim, e zgjuar, dinamike, vigjilente, e shkathët për të manevruar sipas situatës.

Organizata-bazë të mos kuptohet sikur funksionon e vepron vetëm kur është e mbledhur. Nëpërmjet veprimtarisë së komunistëve ajo ndodhet e vepron kudo, në çdo skaj të kooperativës apo të ndërmarrjes, vazhdimisht, çdo ditë dhe çdo orë. Kjo kër-

kon që secili komunist të mos presë ta thotë fjalën vetëm në mbledhje por të veprimi edhe jashtë saj me inisiativë, të kërkojë llogari për çdo veprim të padrejtë të komunistëve të tjerë, të kuadrove, të punonjësve pa parti në skuadër, në brigadë, në repart, në administratë, kudo ku luftohet për realizimin e planit dhe zbatimin e vijës së Partisë. Pra, inisiativa e vetëveprimi, si një normë partie, lind nga shkalla e vetëdijes për detyrën, nga fakti se sa thellë çdo organizatë dhe çdo komunist e njeh vijën e Partisë dhe lufton për zbatimin e saj.

Zhvillimi i inisiativës kërkon një punë më të mirë për të formuar koncepte të drejta dhe bindje të thella, se për punën e Partisë është e nevojshme të preokupohen të gjithë komunistët pa përjashtim dhe jo vetëm byroja, sekretari ose një rreth i ngushtë njerëzish. Nga ana tjetër të organizohet puna brenda në organizatën-bazë për të përcaktuar më mirë vendin e çdo komunisti në jetën e Partisë, duke u nisur nga aftësitë e prirjet e secilit, nga pregatitja ideopolitike, kulturele dhe teknike, nga aftësitë si organizator, si dhe nga eksperiencia që ka fituar në punë. Për këtë qëllim duhet gjithashtu të hiqet dorë nga ato koncepte, metoda e forma burokratike që pengojnë inisiativën e vetëveprimin, siç janë mbledhjet e shumta, ku jepen vetëm porosi e udhëzime, shpesh të përsëritura e për gjëra të vogla, vendimet e shumta e të përgjithshme, pritja e udhëzimeve për çdo gjë nga lart etj. Lidhur me këtë shoku Enver thekson:

«Në njerëzit tanë, në organizmat e Partisë e të shtetit, duhet të zhvillojmë në një shkallë të lartë inisiativën krijuese revolucionare. Kjo inisiativë nuk mund të zhvillohet pa u dhënë gjithë përgjegjësinë e duhur njerëzve dhe organizmave të krijuara. Mendimit të shëndoshë krijues duhet t'i lesh fushë të lirë veprimi, eksperimentimi e kontrolli. Ndryshe, po i vumë barrikada, njëra pas tjetrës (dhe këto janë barrikada të shumëllojta, «të arsyeuara» dhe jo të arsyeuara të burokracisë), mendimi i njerëzve mpihet, ndrydhet, bëhet i rëndomtë, shterp, humbet guximi revolucionar, zhvillohet rutina, moskokëçarja. Mendimeve krijuese burokratike, me rrjetën e saj të dukshme dhe të padukshme, u errëson horizontet, njëkohësisht u heq njerëzve ndjenjën e përgjegjësisë socialiste, i vë ata në kuadrin e rregullave burokratike, përpara një përgjegjësie automate, për të qenë brenda, brenda ligjeve të burokracisë»¹.

Por për çfarë inisiativë dhe shembulli personal të komunistëve mund të flitet kur në disa kooperativa bujqësore, ndër-

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 453-454

marrje ekonomike, ose brigada ku ata punojnë e luftojnë, punët nuk shkojnë mirë dhe plani i shtetit nuk realizohet plotësisht në kohë dhe në bazë të kushteve që kërkojnë? A mund të thuhet se në 7 organizatat-bazë të kooperativës së zmadhuar të Cakranit ka inisiativë, vetëveprim dhe frymë luftarake, në një kohë kur aty vërehen shumë dobësi serioze në organizimin e punës e të prodhimit dhe në administrimin me nikoqirllëk të ekonomisë? Ku janë këtu roli pararojë dhe shembulli personal i të 170 komunistëve që militojnë në këto organizata-bazë? Sigurisht në këto kushte as që mund të bëhet fjalë për një gjë të tillë.

Komunisti që qëndron në pozita të vërteta revolucionare duhet të pyesë veten çdo ditë si e ka kryer detyrën si komunist në fushë, në fabrikë, në shoqëri, në familje, në rrugë në shkollë e kudo, në mes të masave punonjëse; çfarë i ka dhënë sot Partisë, a e ka lojtur rolin pararojë si agjikator, propagandist e organizator, si udhëheqës politik i masave, si aktivist i shquar shoqëror. Kështu përmes një jete të gjallë luftarake do të zhvillohet inisiativa e vetëveprimi te secili komunist, do të kaliten ata si revolucionarë të vërtetë.

2. — Të përmirësojmë përbërjen e Partisë, duke futur vazhdimisht gjak të ri në radhët e saja. Si kudo, edhe në këtë çështje të madhe Partia është udhëhequr kurdoherë nga mësimet e marksizëm-leninizmit që, nëpërmjet pranimeve, të forcojë gjithnjë e më shumë karakterin e vet proletar, jo vetëm nga pikëpamja ideologjike, por dhe nga pikëpamja e përbërjes shoqërore të radhëve të saja. Çështja e pranimeve, siç porosit shoku Enver, asnjëherë nuk duhet të kuptohet si një çështje fushate, ajo është një detyrë e përhershme e të gjithë organizatave. Kur flasim për ripërtëritjen e Partisë, këtë organizatat-bazë duhet ta kuptojnë drejt, t'i bëjmë ato të ndërgjegjshme që këtë çështje të mos e shikojnë si diçka të thjeshtë, të gjykojnë thellë mbi të, të kuptojnë mirë rëndësinë e madhe dhe brendinë ideologjike të pranimeve, që ka të bëjë me futjen e gjakut të ri në Parti, me ripërtëritjen e organeve të Partisë, nga e cila varet e ardhshmjia e vetë Partisë dhe e vendit.

Komiteti Qendror vazhdimisht ka theksuar se pranimi i punëtorëve në Parti përbën një problem me rëndësi për sot dhe për të ardhshmen. Prandaj, ashtu si deri tani, të synohet në pranimin e më shumë punëtorëve në Parti, sidomos nga ata që punojnë në industrinë nxjerrëse e përpunuese, në degët e reja të industrisë, në objektet e mëdha të ndërtimit dhe në frontet kryesore e më të vështira.

Një punë më e mirë duhet bërë për shpërndarjen e drejtë të forcave të Partisë midis degëve të ekonomisë, ndërmarrjeve

dhe reparteve, mbasi në këtë drejtim vërehen akoma disa dobësi. Nga një studim i bërë kohët e fundit në rrethet Korçë, Mirditë, Tiranë, Vlorë dhe Elbasan, del se komunistët që punojnë në repartet kryesore të prodhimit zënë vetëm 7,6 për qind të punëtorëve, ndërsa në repartet ndihmëse zenë 9,9 për qind. Edhe fakti që 44 për qind e komunistëve punëtorë punojnë drejtpërdrejt në maqineri dhe të tjerët në operacione të ndryshme duhet të na tërheqë vëmendjen.

Një kujdes më të madh duhet të tregojmë edhe për shtimin e radhëve të Partisë në kooperativat bujqësore, sidomos në zonat e thella malore, në organizatat me efektiv të paktë, që kanë dobësi dhe që nuk mbulojnë të gjithë sektorët. Në drejtim të fshatit duhet të punohet që, në një të ardhshme jo të largët, nëpërmjet pranimeve, të arrijmë të kemi në çdo fshat organizatë-bazë ose grup partie; në të njëjtën kohë, duhet të rritet vazhdimisht numri i komunistëve që punojnë drejtpërdrejt në prodhim.

Pas Kongresit V të Partisë janë arritur rezultate pozitive edhe në pranimin e grave në Parti. Por megjithatë, një luftë më e madhe duhet bërë kundër konservatorizmit për pranimin e shoqeve në Parti, kundër koncepteve frenuese, të huaja e të gabuara, që nënvleftësojnë rolin dhe aftësitë e grave, nën pretekstin se «gratë janë të papregatitura», «i pengojnë fëmijët», «s'kanë shkollë» etj. Fakti që në shkallë republike kemi akoma 20 përqind të organizatave-bazë të prodhimit (në ndërmarrje ekonomike dhe kooperativa bujqësore) dhe 366 fshatra pa asnjë shoqe në Parti dhe që shumë organizatë-bazë partie të tjera kanë vetëm 1-2 komuniste, tregon se ç'punë të madhe duhet të bëjë Partia për pranimin e më shumë shoqeve. Të gjitha kushtet ekzistojnë për një punë të frutshme e rezultate të mira, por kërkohet një punë edukativo-propagandistike e dendur jo vetëm nga Partia, por edhe nga të gjitha organizatat e masave, qoftë me masën e grave e të të rejave, por sidomos me burrat që mbajnë një qëndrim konservator ndaj pranimit të shoqeve në Parti.

Puna me kandidatët e Partisë merr një rëndësi të posaçme, ata sot përbëjnë rreth 15 për qind të efektivit të Partisë. Në disa rrethe, zona dhe organizatë-bazë kandidatët përbëjnë 30 deri 40 përqind të efektivit të Partisë në fshat. Kjo është e lidhur si me rritjen e pranimeve në Parti, ashtu edhe me zgjatjen e stazhit të kandidatit. Megjithatë në këto kushte ky nuk është një problem shqetësues, por ai shtron një sërë detyrash të rëndësishme, sidomos përpara komiteteve të Partisë për një punë më të kualifikuar me kandidatët dhe për ta normalizuar këtë gjendje në të ardhshmen.

3. — Të revolucionarizojmë më tej punën në plenumet dhe byrotë e komiteteve të Partisë. Përmirësimi i përbërjes shoqë-

rore të plumeve të komiteteve të Partisë, duke zgjedhur në to më shumë shokë të rinj e nga prodhimi, si dhe zbatimin e mësimëve të shokut Enver për përmirësimin e metodës e të stilit të punës, e kanë ngritur në një nivel më të lartë rolin udhëheqës të tyre. Jeta e plumeve është bërë më e gjallë e më dinamike.

Por duhet thënë se ka shumë punë për të bërë që ta revolucionarizojmë më tej punën në plenumet e Partisë, në byrotë, në sekretariatet dhe në aparatet e Partisë në rrethe. Para së gjithash duhet bërë një punë këmbëngulëse që të kuptohet nga të gjithë roli dhe përgjegjësia e plenumit si organi më i lartë udhëheqës i Partisë në rreth dhe të perfeksionohen më tej metoda dhe stili në punën e plenumit, si kusht i domosdoshëm për ngritjen e rolit të tij në nivelin e kërkesave të kohës. Në këtë drejtim duhet luftuar me të gjitha forcat për të ngritur cilësitë udhëheqëse të çdo anëtari të plenumit, duke rritur përgjegjësinë e tij, në radhë të parë, për organizatën-bazë të Partisë ku ai bën pjesë, që ajo të bëhet shembull në zbatimin e detyrave të Partisë dhe të shërbejë si model edhe për organizatat e tjera. Në të njëjtën kohë, të ndihmojë edhe organizatat e Partisë të një zone apo sektori për të gjitha problemet që shtrihen në Partia, qofshin ato politike, ideologjike, ekonomike, shoqërore, duke aktivizuar për këto çështje rreth vetes edhe komunistë e aktivistë pa parti. Duke vepruar kështu, ai do të jetë në gjendje të ngrejë përpara Partisë probleme nga më kryesoret të punës së saj dhe do të luftojë që ato të diskutohen në plenum, në byro e në sekretariat si dhe të përgjithësohen në shkallë rrethi.

Masa e rëndësishme që mori Partia për të zgjedhur në organet e saj udhëheqëse një numër të madh komunistësh nga fronti i prodhimit, jo vetëm ka përmirësuar në mënyrë të dukshme përbërjen e plumeve, por ka forcuar edhe më shumë lidhjet e Partisë me punëtorët dhe fshatarët, të udhëheqjes me bazën. Këto kadro të rinj të prodhimit që janë zgjedhur në forumet e Partisë duhet të mbahen afër, të ndihmohen, të mësohen që të përgatiten si udhëheqës. Çështja është të kuptohet mirë se anëtari i plenumit të komitetit të Partisë, i cili punon në prodhim apo kudo gjetkë, është pjesëtar i udhëheqjes së Partisë me të drejta të barabarta, se ai ka të drejtat dhe detyrat e udhëheqësit, se ai jo vetëm duhet të vihet në dijeni të problemeve që preokupojnë Partinë, por, pa spostuar veprimtarinë e organizatave dhe të organizmave të tjera të Partisë, të jetë në krye të të gjitha punëve dhe të mos presë të aktivizohet vetëm nga të tjerët.

Plenumet e Partisë nuk duhet t'i lejojnë vetes që të merren me problemet në përgjithësi dhe të gjykojnë globalisht për çështjet, siç ndodh në mjaft raste, por të thellohen si duhet për problemet e veçanta që preokupojnë rrethin, zonën ose organizatat

e ndryshme, të zërthejnë mirë e në mënyrë krijuese, në kushtet e rrethit, direktivat dhe vendimet, të kapen pas asaj që është më themelore në momentin e dhënë, të nxjerrin detyra për problemet më kryesore dhe t'i hapin kështu perspektivë tërë punës së Partisë. Dobësitë e vërtetuara kohët e fundit në rrethin e Tropojës e kanë burimin pikërisht në faktin që disa nga vendimet më të rëndësishme të Partisë nuk janë zërthyer nga plenumi në bazë të kushteve të rrethit.

Në plenumet e komiteteve të Partisë ka nevojë të forcohet më shumë ndjenja e përgjegjësisë kolektive dhe individuale, të gjallërohen më tej jeta e brendshme, debati ideologjik, kritika dhe autokritika, kërkimi dhe dhënia llogari në frymë të shëndoshë revolucionare deri në një nga të gjithë, pavarësisht nga posti që zënë në Parti dhe në pushtet. Vetëm duke vepruar kështu në forumet e Partisë, atëhere edhe në organet e pushtetit dhe të ekonomisë do të ketë më shumë kritikë e autokritikë. Po të jetë se nuk luftohet me guxim e zgjuarsë për zbatimin e këtyre normave, atëhere do t'i lëmë vend vetëkënaqësisë, shmangies nga përgjegjësia, konformizmit, ndjenjës së epërsisë të disa dhe të inferioritetit në disa të tjerë, krijimit shpesh të gjykimeve subjektive për punën me kuadrot.

Anëtarët e plenumeve e të byrove, si dhe kuadro të tjerë me përgjegjësi, kur kanë të meta e boshllëqe në punën e tyre, është e domosdoshme të kritikohen hapur në mbledhjet e forumeve, të vihen mirë para përgjegjësisë së Partisë për detyrat që nuk realizojnë dhe të thellohen për të nxjerrë shkaqet e të metave e të dobësive.

Një rol të rëndësishëm për zhvillimin e kritikës dhe të autokritikës luajnë qëndrimi parimor, shembulli personal, si brenda forumit ashtu edhe para organizatave-bazë, i shokëve kryesorë me eksperiencë udhëheqëse, sidomos i sekretarit të parë të komitetit të Partisë në rreth, si dhe i shokëve të Plenumit të Komitetit Qendror kudo që punojnë. Kjo do të bëjë që të mos ketë ngurrim, drojtje e frikë për të kritikuar hapur e ballë për ballë cilindo.

Rritja e rolit drejtues të organeve udhëheqëse të Partisë në rreth, përmirësimi i mëtejshëm i punës organizuese, i metodës dhe stilit të tyre në përgjithësi, përbën një nga hallkat më të rëndësishme të punës së Partisë për të kryer me sukses të gjitha detyrat e mëdha që na shtrohen për forcimin dhe revolucionarizimin e Partisë, për ruajtjen dhe zbatimin revolucionar të parimeve e të normave të saja dhe për ndërtimin socialist të vendit.

Shokë,

Këto ishin disa probleme që Byroja Politike mendoj t'i shtrojnë në këtë mbledhje të Komitetit Qendror. Populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, marshon përpara fitimtar në rrugën e socializmit duke mbajtur në njërin dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën. Shqipëria e re socialiste është shndërruar në një kanton të madh ndërtimi, në një shkollë masive të edukimit revolucionar dhe në një kështjellë graniti me një popull luftarak, të gatshëm për të mbrojtur në çdo rrethanë fitoret e saja historike. Ndërtimi, edukimi dhe mbrojtja e atdheut janë tri detyrat e mëdha e të pandara që duhet të zgjidhen në unitet. Kjo është rruga jonë e përgjithshme për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

Jemi përpara detyrash të mëdha historike. Gjithë punonjësit janë ngritur në këmbë për ta përfunduar me sukses planin e katërt pesëvjeçar. Nuk është larg dita kur në vendin tonë do të fillojë diskutimi i madh popullor për planin e ri pesëvjeçar. Ky plan do të shënojë një hap tjetër madhështor në rrugën e zhvillimit të vendit, drejt ndërtimit të plotë të socializmit.

Punimet e këtij Plenumi dhe zbatimi i detyrave që do të dalin prej tij do t'i japin një impuls të ri, do ta ngrënë edhe më lart gjithë punën organizuese e drejtuese të Partisë.

Le të vëmë të gjitha forcat që, nën udhëheqjen e Partisë, me shokun Enver në krye, të korrin fitore të reja sa më të mëdha!

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 153 (6817), 28 qershor 1970*

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

26 qershor 1970

Plenumi X i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur nga data 25 deri 26 qershor 1970, pasi dëgjoji dhe diskutoi gjerësisht raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Ta ngremë punën organizuese të Partisë në nivelin e detyrave të etapës së sotme të ndërtimit socialist», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH shoku Hysni Kapo,

Vendosi:

1. — Të aprovojë plotësisht raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH.

2. — Porositen të gjitha organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë, si dhe organizatat e masave, që materialet e këtij Plenumi të studjohen thellë dhe të mbahen parasysh në gjithë veprimtarinë e tyre praktike.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 152 (6816), 27 qershor 1970

PËRSHËNDETJE E KOMITETIT QENDROR TË PPSH DREJTUAR SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE ME RASTIN E 25-VJETORIT TË THEMELIMIT TË LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE TË ARTISTËVE TË SHQIPËRISË

22 tetor 1970

SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE TË SHQIPËRISË!

Të dashur shokë e shoqe,

Komiteti Qendror i Partisë ju dërgon përshëndetjet më të zjarrta dhe urimet më të përzemërta për festën tuaj jubilarë, 25-vjetorin e themelimit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë.

Ky jubile është një ngjarje me rëndësi të madhe për jetën e vendit e të popullit tonë. Në këtë ditë të shënuar, së bashku me ju shkrimtarët dhe artistët tanë të talentuar, që keni bërë e bëni një punë kaq të lavdishme e fisnike për edukimin komunist të punonjësve, për nderin dhe lavdinë e atdheut, gëzohen të gjithë, që nga kalamani e deri te më plakui, gëzohen punëtorët, kooperativistët, intelektualët, ushtarakët, gëzohen mbarë populli dhe Partia.

Një çerek shekulli më parë, me kujdesin e Partisë, u themelua Lidhja juaj. Në ato vite të vështira populli ynë artdashës, që vuante nga plagët e luftës e që akoma s'kishte bukë për të ngrënë, ëndërronte, mendonte e shqetësohej seriozisht edhe për fatet e zhvillimit të artit, pse artin ai tërë jetën e ka pasur dhe e ka në zemër. Me shëllirë e ka ngjyer kafshatën në të kaluarën populli ynë, por pjatën e drunjtë e kishte të skalitur si s'ka më bukur. Ndjenja e hollë për të bukurën dhe shija e tij e lartë estetike kanë spikatur kudo, në rapsoditë e mrekullueshme, në kostumet fantastike, në vallet e mahnitshme, në shkrimet e rilindësve apo në këngët «rebele» e të ndritshme partizane. Shkurt, gjenia artistike e popullit tonë duket ngado që të hedhësh vështrimin, ngado që të vësh dorën.

Artin populli ynë e ka konsideruar dhe e konsideron pjesë të pandarë të jetës së tij, prandaj ai e përshëndeti me entuziazëm

lindjen e organizatës suaj. Dhe shpresat e tija, si kudo, nuk shkuan kot. Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve u bë ashtu siç tha Partia, ashtu siç dëshironte populli, një organizatë luftarake, militante. Shkrimtarët dhe artistët, të udhëhequr vazhdimisht nga mësimet dhe nga porositë e Partisë, e lidhën ngushtë krijimtarinë e tyre me jetën e masave punonjëse, me përpjekjet dhe luftën e tyre heroike për ndërtimin dhe për mbrojtjen e atdheut socialist.

Gjatë këtyre 25 vjetëve, e veçanërisht pas Kongresit V të PPSH, arti ynë i realizmit socialist ka pësuar e po pëson ndryshime të papara sasiore dhe cilësore. Në luftë të pamëshirshme me çdo lloj ndikimi të huaj të ideologjisë borgjeze e revizioniste, si dhe patriarkale e konservatore, letërsia, teatri, muzika, kinematografia, piktura, skulptura dhe të gjitha gjinitë e tjera, të frymëzuara nga ideologjia dritëdhënëse e Partisë, nga heroizmi i pashembullt revolucionar i klasës punëtore dhe i mbarë masave punonjëse, si dhe të ushqyera vazhdimisht nga gurra e pashtershme e krijimtarisë popullore, ndikojnë drejtpërdrejt në edukimin e njeriut të ri me idealet e mëdha të socializmit e të komunizmit, me tiparet e moralit komunist, me shije të shëndosha dhe revolucionare.

Në pjesën më të madhe të krijimtarisë sonë letrar-artistike, që karakterizohet nga niveli i lartë ideor e artistik, njeriu ynë i ri gjen vetveten, sheh vitalitetin e popullit dhe të atdheut tonë socialist, dëgjon fjalën e dashur e të zjarrtë të Partisë dhe mbushet me kurajë e guxim për t'i ngritur kurdoherë e më lart shkallët e jetës. Kjo ngjet sepse arti ynë revolucionar frymëzimet i merr nga populli dhe ia kthen ato prapë atij, të përgjithësuara e në format më të bukura artistike, sepse shkrimtarët dhe artistët tanë kanë përvetësuar këshillat e Partisë për të qenë njëherësh nxënës e mësues të masave punonjëse.

Partia ndjek me vëmendje e interes të madh krijimtarinë frymëzuese të letrarëve, muzikantëve, aktorëve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë. Ajo përshëndet punën e këmbënguljen tuaj vetëmohuese për t'i revolucionarizuar më tej letërsinë e artet, për të futur në to atë çka është më e çmueshme — mendimin dhe emocionin popullor, botëkuptimin e klasës punëtore, zjarrin shqiptar. Sot arti ynë është bërë më i madhërishëm, si për nga përsosmëria e bukuria ideoartistike ashtu edhe për nga forca e madhe edukative. Kjo dëshmon se ai ecën në rrugë të mbarë, në rrugën e lavdishme që i ka caktuar Partia.

Të gjitha këto garantojnë se arti ynë, që ndodhet në duart e sigurta të shkrimtarëve, artistëve, kritikëve dhe studjuesve tanë të partishëm, edhe në të ardhshmen do të dijë t'i përmbushë me sukses detyrat e rëndësishme që do t'i caktojë Partia.

Tanimë që letërsia dhe artet tona kanë arritur kaq shumë suksese, sa zëri e fjala u dëgjohej me admirim të madh si brenda ashtu edhe jashtë atdheut, tani pikërisht rritet edhe më tepër përgjegjësia e tyre ndaj çështjes së socializmit e komunizmit. Në këto kushte detyrat revolucionare që shtron Partia para krijimtarisë letrar-artistike janë të mëdha, ndofta shumë më të mëdha se ç'mund të pandehen. Realizimi i tyre kërkon që socializmi dhe mendimi proletar marksist-leninist të ndjehen e të përshkojnë fund e krye çdo libër, çdo pikturë, çdo varg, çdo notë muzikore, çdo kënd e qelizë të veprës artistike. Partia ka besim të thellë se shkrimtarët dhe artistët tanë, si kurdoherë, do të kryejnë me nder këtë detyrë.

Po për këtë është e nevojshme që, krahas punës këmbëngulëse për edukimin e gjithanshëm e të thellë marksist-leninist të shkrimtarëve dhe të artistëve, të rriten pa ndërprerje kërkesat për ngritjen e nivelit ideor të veprave artistike dhe për përsosjen e mëtejshme të mjeshtërisë artistike. Vitaliteti i jetës sonë socialiste, shpirti sulmues e transformues i masave punonjëse dhe madhështia e ideve të Partisë sonë nuk mund të pasqyrohen e trupëzohen ashtu siç janë në të vërtetë veçse në një art me nivel shumë të lartë ideoartistik. Që të arrihet kjo artisti ynë novator lypset të kërkojë, gjithmonë të kërkojë, duke u nisur nga pozitave e ideologjisë sonë, duke u mbështetur fort në truallin tonë kombëtar, në traditat dhe në përvojën tonë artistike më të avancuar, si dhe në eksperiencën përparimtare botërore. Të kërkosh do të thotë të përpiqesh të zbulosh fenomenet thelbësore të realitetit tonë, të zbulosh ato elemente të reja të jetës sonë që përbëjnë filizat e së nesërme. Kjo e re, pra, që kërkohet të hyjë në art, duhet jo vetëm të njihet mirë, por edhe të shndërrohet në fenomen artistik. Në këtë mënyrë letërsia dhe artet do të ecin me hapin e masave punonjëse dhe përherë e më tepër do të bëhen një mjet i fuqishëm ideologjik për edukimin e tyre.

Bartëse e ideve revolucionare, farkëtuese e filizëve të rinj të komunizmit, është në radhë të parë klasa jonë punëtore. Ajo është rinia e përjetshme e artit revolucionar të realizmit socialist. Duke qenë kështu, figura, vepra dhe botëkuptimi i klasës punëtore në krijimtari duhet të bëhen akoma më zotërues. Kjo do të bëjë jo vetëm sepse klasa punëtore, si klasa më revolucionare e kohës sonë, e meriton plotësisht këtë, por edhe për faktin se sot revizionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, sido që bëjnë be e rrufe se «krijojnë» në emër të klasës punëtore, në të vërtetë po bëjnë çmos që figurën e saj ta dëbojnë përfundimisht nga letërsia e nga arti.

Me zhvillimin e vullshëm të revolucionit socialist te ne shtohen kërkesat dhe etja e masave punonjëse për krijime letra-

ro-artistike të përsosura. Prandaj detyra juaj është që t'i njihni mirë këto kërkesa të masave punonjëse dhe t'u përgjigjeni atyre me vepra të frymëzuara të një niveli të lartë ideoartistik. Prandaj Partia ju bën thirrje edhe një herë që të shkoni në masa e të jetoni vazhdimisht pranë tyre. Duke shkuar vazhdimisht në masa, ju, nga njëra anë, do të mësoni prej tyre, do të dëgjoni me vëmendje vërejtjet e kritikave të tyre dhe në të njëjtën kohë do të propagandoni veprat artistike, do të ndihmoni më nga afër në edukimin ideoestetik të masave, do të shtoni dashurinë e tyre për artin.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim të plotë se ju, si kurdoherë, do t'i realizoni me nder detyrat që ju shtron Partia dhe do t'i jepni popullit gjithnjë e më shumë vepra artistike që të mishërojnë idealet revolucionare të Partisë, tiparet e mrekullueshme revolucionare të popullit tonë, hovin e tij të pandalshëm në rrugën e revolucionit e të socializmit.

Lavdi artit tonë revolucionar të realizimit socialist!

Rroftë Partia jonë e lavdishme!

Në emër të Komitetit Qendror të PPSH
Sekretari i Parë

Enver Hoxha

*Botohet sipas origjinalit që
gjetet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 253 (6917), 23 tetor 1970*

K O M U N I K A T Ë

E KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI PËRFUNDIMIN PARA AFATIT TË ELEKTRIFIKIMIT TË TË GJITHA FSHATRAVE TË VENDIT TONË

3 nëntor 1970

Komiteti Qendror i PPSH i njofton popullit shqiptar shtetërisht e madh e të gëzuar — përfundimin me sukses të elektrifikimit të të gjitha fshatrave të vendit tonë.

Sot drita elektrike, «drita e Partisë», siç e quan populli, ndriçon çdo shtëpi, çdo familje fshatare deri në majat më të larta dhe skajet më të largëta të malësive tona kreshnike. Kryerja e këtij aksioni të guximshëm e revolucionar trembëdhjetë muaj para afatit të caktuar në vendimin e Plenumit IV të Komitetit Qendror të PPSH dhe 15 vjet para afatit që parashikohej në planin perspektiv¹, është një fitore e shkëlqyer historike që dëshmon për madhësinë e ideve largpamëse të Partisë, për vitalitetin e sistemit tonë socialist, për vrullin revolucionar e krijues të masave punonjëse, për gatishmërinë dhe për vendosmërinë e popullit tonë heroik në luftën e tij për çështjen e madhe të ndërtimit të socializmit e të komunizmit.

Atdheu ynë i dashur, Shqipëria socialiste, dikur vendi më i prapambetur në Evropë, bëhet një ndër vendet e para në botë me fshatra plotësisht të elektrifikuara. Në realizimin e kësaj veprë të madhërishtme, mishërohet një nga qëllimet më të larta të revolucionit tonë, kryhet një hop tjetër cilësor drejt ngritjes së mireqenies së masave punonjëse dhe drejt ngushtimit gradual të dallimeve esenciale midis fshatit e qytetit.

Çuarja e energjisë elektrike në çdo fshat, hap perspektiva të pakufishme për zhvillimin intensiv të bujqësisë e të blegtorisë,

¹ I Aprovuar në vitin 1960 parashikonte që elektrifikimi i të gjitha fshatrave të përfundonte në vitin 1985.

krijon mundësi për hapjen e degëve të reja të ekonomisë, si dhe u jep një hov akoma më të fuqishëm zhvillimit të forcave prodhuese dhe marrëdhënieve socialiste në prodhim. Me futjen në qdo vatër fshatare të dritës elektrike, krijohen mundësi më të mëdha që jeta e fshatarësisë sonë kooperativiste të bëhet akoma më e bukur, më e kulturuar, më e gëzuar. Elektrifikimi i të gjitha fshatrave do të ndikojë drejtpërsëdrejti në procesin e revolucionarizimit të gjithanshëm të jetës së fshatarësisë punonjëse, ai do të nxitë përhapjen e vrullshme të arsimit, të kulturës e të njohurive shkencore.

Komiteti Qendror i PPSH, me rastin e kësaj fitoreje madhështore, u dërgon përsëritje të zjarra revolucionare klasës punëtore, fshatarësisë kooperativiste, inteligjencies popullore, Ushtrisë Popullore, organeve të Partisë e të shtetit, organizatave të Frontit, të bashkimeve profesionale, të rinisë, të gruas, ndër-marrjeve ekonomike shtetërore, të gjithë atyre që me thirrjen e Partisë u ngritën në këmbë dhe duke punuar me një frymë revolucionare e vetëmohim të paparë, me optimizëm e me ndërgjegje të lartë socialiste, zbatuan me sukses para afatit vendimin mbi elektrifikimin e të gjitha fshatrave të vendit tonë. Si kudo edhe në këtë aksion u shpreh më së miri uniteti i pathyeshëm i popullit rreth Partisë me shokun Enver Hoxha në krye, vendosmëria e tij për ta shndërruar kurdoherë në vepër fjalën e Partisë, programin e saj për ndërtimin e socializmit.

Duke pasur besim të plotë në shpirtin krijues të popullit tonë të talentuar, Komiteti Qendror i PPSH u bën thirrje të gjitha masave punonjëse që heroizmin masiv që manifestuan në kryerjen e këtij aksioni, ta shpalosin si flamur frymëzimi, entuziazmi e gatishmërie për plotësimin me sukses të detyrave që kemi përpara dhe të objektivave të reja të mëdha që do të caktojë Partia në planin e ri pesëvjeçar dhe në Kongresin e saj VI, për lulëzimin dhe për forcimin e mëtejshëm të atdheut tonë socialist.

Komiteti Qendror i PPSH, duke u bashkuar me gëzimin e papërshkruar të masave për përfundimin e elektrifikimit të mbarë fshatrave të vendit, aprovon dëshirën e tyre që 25 tetori, dita e ndezjes së dritës elektrike edhe në fshatin e fundit, të shpallet «festë popullore e dritës» dhe të përkujtohet nga moti në mot si një fitore e madhe historike e popullit dhe e Partisë.

Ajo do të na kujtojë neve dhe brezave të ardhshëm ndër shekuj një nga periudhat më të ndritura të historisë së popullit tonë, këtë kohë të lavdishme që po jetojmë sot kur, me gjithë kushtet e vështira të rrethimit e të bllokadës imperialisto-revi-

zioniste, populli shqiptar, i mbështetur në forcat e veta, i armatosur me mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, i udhëhequr nga Partia e tij e lavdishme me shokun Enver Hoxha në krye, çan përpara dhe korr kurdoherë fitore.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 263 (6927), 4 nëntor 1970*

... Komitetit Qendror të PPSH...

... Komitetit Qendror të PPSH...

... Komitetit Qendror të PPSH...

... Komitetit Qendror të PPSH...

... Komitetit Qendror të PPSH...

TREGUESI I LËNDËS

Faqe

Parathënie 5

1966

1. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH mbi iniciativën patriotike të punonjësve të administratës për të kaluar në prodhim. 26 janar 1966 9

2. Letër e KQ të PPSH drejtuar KQ të PPB Poloneze, me anën e së cilës demaskohet qëndrimi antimarksist i revizionistëve hrushovianë ndaj çështjes vietnameze. 11 shkurt 1966 11

3. Plenumi XVI i KQ të PPSH. Tiranë, 4 mars 1966 22

- Komunikatë 22
- Letër e hapur e KQ të PPSH drejtuar komunistëve, punonjësve, ushtarëve dhe oficerëve të vendit tonë. 23

4. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi disa çështje për forcimin e mëtejshëm të demokracisë kooperativiste. 27 maj 1966 47

5. Plenumi XVII i KQ të PPSH. Tiranë, 12-13 korrik 1966 57

- Komunikatë 57
- Vendim i Plenumit të KQ të PPSH mbi thirrjen e Kongresit V të zakonshëm të PPSH. 57

6. Plenumi XVIII i KQ të PPSH. Tiranë, 14 tetor 1966. 59

- Komunikatë 59

7. Kongresi V i PPSH. Tiranë, 1-8 nëntor 1966 60

- Raport i mbajtur në Kongresin V të PPSH nga Sekretari i Parë i KQ të PPSH shoku Enver Hoxha «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të PPSH». 61
- Vendim i Kongresit V të PPSH për aprovimin e raportit «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të PPSH» 200

	Faqe
— Vendim i Kongresit V të PPSH për aprovimin e raportit të Komisionit Qendror të Revizionimit të PPSH	201
— Vendim i Kongresit V të PPSH për aprovimin e raportit «Mbi direktivat e planit të katërt pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të RPSH»...	202
— Vendim i Kongresit V të PPSH «Mbi disa ndryshime në Statutin e PPSH»	203
— Vendim i Kongresit V të PPSH mbi aprovimin e direktivave të planit të katërt pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të RPSH	204
— Direktivat e Kongresit V të PPSH mbi planin e katërt pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të RPSH për vitet 1966-1970	205
8. Përshëndetje e Komitetit Qendror të PPSH drejtuar BRPSH me rastin e 25-vjetorit të themelimit. 22 nëntor 1966	228
9. Konkluzione të Byrosë Politike të KQ të PPSH lidhur me studimin «Mbi punën e bërë dhe masat që duhen marrë nga organizatat-bazë dhe komitetet e Partisë për forcimin e përbërjes së Partisë, shtrirjen e saj dhe gjallërimin e jetës së brendshme». 19 dhjetor 1966	235
1967	
10. Letër e KQ të PPSH drejtuar komiteteve të Partisë të rretheve «Mbi luftën kundër fesë, paragjykimeve e zakoneve fetare». 27 shkurt 1967	240
11. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi disa masa për organizimin më të mirë të pjesëmarrjes së punonjësve të punës mendore drejtpërdrejt në punën prodhuese». 22 prill 1967	247
12. Orientime të përgjithshme të Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi qarkullimin e kuadrove. 29 prill 1967	253
13. Deklaratë e Komitetit Qendror të PPSH dhe e Këshillit të Ministrave të RPSH «Mbi zhvillimin e thellimin e mëtejshëm të lëvizjeve revolucionare dhe të iniciativave krijuese të masave punonjëse». 29 prill 1967	258

	Faqe
14. Plenumi II i KQ të PPSH. Tiranë, 15-16 qershor 1967	
— Komunikatë	270
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi thellimin e mëtejshëm të luftës për emancipimin e plotë të gruas dhe rritjen e rolit të saj në shoqërinë socialiste»	271
— Vendim i Plenumit të KQ të PPSH për aprovimin e raportit	314
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi përfundimet e arritura dhe masat që duhen marrë për përhapjen e eksperiencës së përparuar dhe të eksperimentimit shkencor në bujqësi»	315
— Vendim i Plenumit të KQ të PPSH për aprovimin e raportit	348
15. Plenumi III i KQ të PPSH. Tiranë, 13-14 tetor 1967	
— Komunikatë	349
— Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi punën e bërë dhe masat që duhen marrë për shfrytëzimin e plotë të aftësive prodhuese në industrinë mekanike, për specializimin dhe kooperimin e mëtejshëm të saj»	350
— Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi punën e organizatave të Partisë, organizatave të masave dhe organeve shtetërore për shpikjet, racionalizimet dhe kursimet në industri e në ndërtim dhe mbi masat e mëtejshme që duhen marrë për zhvillimin e kësaj lëvizjeje»	362
16. Plenumi IV i KQ të PPSH. Tiranë, 11-12 dhjetor 1967 ..	
— Komunikatë	373
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi plotësimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1967 dhe detyrat e projektplanit dhe të projektbuxhetit të shtetit për vitin 1968»	374
— Vendim i Plenumit të KQ të PPSH për aprovimin e raportit	407
— Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi elektrifikimin e krejt fshatrave të vendit deri më 8 nëntor 1971 me rastin e 30-vjetorit të themelimit të Partisë» ..	408

	Faqe
17. Deklaratë e Komitetit Qendror të PPSH dhe e Këshillit të Ministrave të RPSH mbi agresionin e revizionistëve sovjetikë dhe të satelitëve të tyre kundër Republikës Socialiste të Çekoslovakisë dhe popullit çekoslovak, 22 gusht 1968	411
18. Plenumi V i KQ të PPSH. Tiranë, 5 shtator 1968	
— Komunikatë	415
— «Mbi gjendjen aktuale ndërkombëtare». Raport i mbajtur në Plenumin V të KQ të PPSH nga Sekretari i Parë i KQ të PPSH shoku Enver Hoxha ..	416
— «Mbi denoncimin e Traktatit të Varshavës nga Republika Popullore e Shqipërisë». Raport i mbajtur në Plenumin V të KQ të PPSH nga anëtari i Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH, shoku Mehmet Shehu	432
— Vendim i Plenumit të KQ të PPSH për aprovimin e raporteve	446
19. Plenumi VI i KQ të PPSH. Tiranë 27-28 shtator 1968	
— Komunikatë	447
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi thellimin e revolucionit socialist nëpërmjet zhvillimit të luftës klasore dhe zbatimit të vijës së masave» ..	448
— Vendim i Plenumit të KQ të PPSH për aprovimin e raportit	493
20. Përshëndetje e Komitetit Qendror të PPSH drejtuar shokut Enver Hoxha me rastin e 60-vjetorit të ditëlindjes, 16 tetor 1968.	494
21. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH mbi studimin e Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë, 19 nëntor 1968	499
22. Plenumi VII i KQ të PPSH. Tiranë, 26-27 dhjetor 1968	
— Komunikatë	507
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi plotësimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1968 dhe detyrat e projektplanit e të projektbuxhetit të shtetit për vitin 1969»	508
— Vendim i Plenumit të KQ të PPSH për aprovimin e raportit	544

	Faqe
23. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH dhe i Këshillit të Ministrave të RPSH për ta shpallur vitin 1969 vit jubilar të 25-vjetorit të çlirimit të atdheut e të fitores së revolucionit popullor, 16 janar 1969	545
24. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH mbi kremtimin e 100-vjetorit të ditëlindjes së V. I. Leninit, 21 prill 1969	549
25. Plenumi VIII i KQ të PPSH. Tiranë, 26-28 qershor 1969	
— Komunikatë	551
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi konkluzionet e diskutimit popullor për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë»	552
— Vendim i Plenumit të KQ të PPSH për aprovimin e raportit	630
26. Orientime të Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi aktivizimin dhe edukimin e mëtejshëm të pensionistëve dhe të invalidëve», 13 shtator 1969	631
— Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për aprovimin e orientimeve	642
27. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH dhe i Këshillit të Ministrave të RPSH «Mbi uljen e çmimeve të shitjes me pakicë të disa mallrave të përdorimit të gjerë, mbi disa masa të tjera favorizuese për kooperativat bujqësore si dhe mbi heqjen krejtësisht të sistemit të taksave», 6 nëntor 1969	643
28. Plenumi IX i KQ të PPSH, Tiranë, 26-27 dhjetor 1969	
— Komunikatë	647
— Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi punën e organizatave të Partisë, të masave dhe organeve ekonomike e shtetërore për rritjen e mëtejshme të rendimentit dhe forcimin e disiplinës proletare në punë»	648
Tirazhi 20.000 kopje	Format 60x92/16
	Stash: 2204-72